

Ibnu Tejmije
Shatibiu
Ibnul Kajjim
Albani
Ibnu Bazi
Uthejmini
Abadi
*dhe Komisioni i
Përhershëm i Fetvave*

STUDIME DHE FETVA

Për çështjet e sunetit, bidatit, tekfirit, metodës së argumentimit, thirrjes, urdhërimit për mirë, ndalimit nga e keqja dhe trajtimit të fitneve.

**Mblodhi dhe përgatiti:
Ismail Bardhoshi**



PASQYRA E LËNDËS

Parathënie

Kreu 1. Hyrje në çështjet e bidatit

Kuptimi dhe përkufizimi i bidatit

Ndarjet e bidatit

Kush cilësohet bidatçi

Disa shenja të bidatçinjve

Qëndrimi i selefëve (të parëve) ndaj bidatçinjve

Kreu 2. Nxitja për pasimin e Sunetit, paralajmërimi për bidatet dhe qartësimi i rrezikshmërisë së tyre (Abdulmuhsin bin Hamed el Abad)

Vazhdimësia, gjithpërfshirja dhe përsosmëria janë tri cilësi të Sheriatit

.....

Përdorimi i fjalës “sunet”

.....

Ajete, hadithe dhe “ethere”, që flasin për pasimin e Sunetit dhe tërheqin vërejtje për bidatet dhe gjynahet

.....

Pasimi i Sunetit është detyrë, si në baza ashtu edhe në degëzime

.....

Të gjitha bidatet janë humbje dhe nuk ka asnjë bidat të mirë

Ndryshimi ndërmejt bidatit në kuptimin gjuhësor dhe atij në kuptimin fetar

.....

Dobitë e lira nuk konsiderohen bidate

.....

Bashkë me qëllimin e mirë duhet edhe përrputhja me Sunetin

.....

Rreziku i bidateve dhe sqarimi se ato janë më të rënda se gjynahet

.....

Bidatet janë në besim, vepër dhe fjalë

.....

Bidati i provokimit të njerëzve, duke kërkuar mendimin e tyre për persona të caktuar
.....

Paralajmërimi për fitnen e “texhrihut” (analizimi i gabimeve të të tjerëve) dhe cilësimit “bidatçi” nga disa prej pasuesve të Sunetit në këtë kohë
.....

Kreu 3. Të sillemi butë me pasuesit e Sunetit (Abdulmuhsin bin Hamed el Abad)

Hyrje
.....

Mirësia e të folurit dhe e qartësimit
.....

Gjuha duhet të flasë vetëm fjalë të mira dhe për mirësi
.....

Dyshimi, paragjykimi dhe hulumtimi për zbulimin e të metave të të tjerëve
.....

Butësia dhe qetësia
.....

Qëndrimi i “ehli sunetit” ndaj dijetarit nëse ai gabon, është se ai justifikohet, nuk quhet bidatçi e nuk i bëhet “hexhr”
.....

Fitneja e “texhrihit” dhe “hexhrit” nga disa anëtarë të “ehli sunetit” të kohës sonë
.....

Rruga e shpëtimit nga kjo fitne

Kreu 4. Llojet e “hexhrit” dhe rregullat e tij (Shejhul Islam ibn Tejmie)

Kreu 5. Rregullat e “tekfirit”

Ndryshimi mes tekfirit të përgjithshëm dhe tekfirit të veçantë
.....

Kushtet e tekfirit
.....

Kushti i parë. Personi i caktuar të ketë për qëllim me shprehjen e tij, domethënien për të cilën njeriu bëhet “kafir”
.....

Kushti i dytë. Informimi rreth çështjes fetare me argument

.....

Përcjellja dhe informimi i njerëzve rreth argumentit fetar, ndryshon sipas ndryshimit të kohëve, vendeve dhe personave

.....

Që të konsiderohen njerëzit të informuar rreth argumentit fetar, duhet patjetër që ta kuptojnë atë

Sqarimet e ibnul Kajim, lidhur me këtë temë, në librin “Tarikul hixhretejni”

.....

Pengesat e tekfirit

.....

Pengesa e parë. Padituria

.....

Pengesa e dytë. Interpretimi

.....

Interpretimi për të cilin një person justifikohet dhe interpretimi për të cilin nuk justifikohet ...

Pengesa e tretë. Imitimi

.....

Pengesa e katërt. Gabimi

.....

Pengesa e pestë. Detyrimi me forcë

.....

Kushtet sipas të cilave detyrimi (dhunimi për kufër) konsiderohet justifikim

.....

Kreu 6. Kush është kafir dhe kush është bidatçi (Muhamed Nasirud-din el Albani, rahimehullah)

Kreu 7. Metoda e “ehli suneh uel xhemaah” në referim dhe argumentim

Parimi i parë. Madhërimi i teksteve fetare dhe nënshtrimi ndaj tyre

.....

Parimi i dytë. Mbështetja në hadithet e sakta

.....

Parimi i tretë. Perceptimi i drejtë i teksteve të Kur’anit dhe Sunetit

.....

Parimet e perceptimit të teksteve fetare dhe studimit të tyre

.....

Disa çështje që lidhen me metodën e “ehli sunetit” në referim

.....

Faktet nga Kur’ani dhe Suneti që tregojnë se është detyrë të pranohet hadithi “ehad” në çështjet e Akides

.....

Disa nga çështjet e Akides që kanë ardhur në hadithe të sakta

.....

Grada dhe vlera e mendjes në Islam

.....

Qëndrimi i “ehli sunetit” ndaj arsyes logjike

.....

Kreu 8. Xhemati i vërtetë dhe gjërat që lidhen me emrin dhe metodën e daves së tij. Metodatat e gabuara të daves dhe qëndrimi i muslimanit ndaj tyre, nxitja për bashkim, dënimi i përçarjes, sqarimi i llojeve të mosmarrëveshjes e të tjera çështje

Ç’do të thotë “ehli suneh uel xhemaah” dhe cilët janë ata

.....

Selefët, selefizmi dhe selefijtë

.....

Sqarimet e shejh Albanit lidhur me selefët, selefijtë dhe rrugën e tyre

.....

Grupi i shpëtuar (el firkatun naxhije)

.....

Pala e ndihmuar (et-taifetul mensure)

.....

Të diturit rreth hadithit dhe pasuesit e tij (ehlul hadithi uel ether)

.....

Drejtuar atyre të cilët nuk i japin rëndësi fjalës “Filani, është apo nuk është selef”

.....

Shejh Albani dhe parimi i pastrimit dhe i edukimit (et-tesfije dhe et-terbije)

.....

Obligimi i gjykimit sipas ligjit të Sheriatit dhe refuzimi i çdo ligji tjetër që e kundërshton atë

Fetva në lidhje me xhihadin e mbrojtjes

.....

Përgjigjja e shejh Albanit lidhur me xhihadin e mbrojtjes

.....

Qëndrimi që duhet mbajtur ndaj xhemateve të ndryshme të daves

.....

Është obligim të mos përkrahet një xhemat dhe të lihet një tjetër (tërësisht)

.....

Grupi islam më i afërt me të vërtetën

.....

Xhematet e ndryshme

.....

Këshilla e dijetarit Mukbil ibn Hadi el Vadi'i drejtuar “ehli sunetit” për t’u bashkuar

.....

Shërimi i kontradiktave dhe mospajttimeve që ekzistojnë ndërmjet “ehli sunetit” në kohën tonë

Rregullat e bashkëpunimit me xhematet e ndryshme

.....

Sqarimet e shejh Albanit lidhur me organizimin e selefijve

.....

Mendimi i Shejh Albanit në lidhje me organizatat, shoqatat ose xhematet dhe grupet që grumbullohen për një qëllim të veçantë ose për të punuar në një sferë, fushë të caktuar

Dijetarët janë kundër përçarjes së Umetit dhe ndarjes së tij në grupacione

.....

Gjykimi i shejh Albanit ndaj vendosjes së kryetarëve të cilët kush i kundërshton ka kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij (ose liderë e “emirë” siç mund ta emërtojnë veten, apo udhëheqës)

Mendimi i shejh Albanit në lidhje me përçarjen aktuale të muslimanëve dhe thirrjen e disave që të bashkohemi dhe t’i lëmë përçarjet që kemi mes njëri-tjetrit

.....

Gjykimi i shejh Uthejminit për gjurmimin e të metave të dijetarëve, lëndimin e tyre, si dhe të folurën mbi ta

.....

Provokimi i njerëzve

.....

Pozita apo vendi që zenë dijetarët në Islam

.....

Forma e kritikës ndërmjet thirrësve (Nga dijetari i madh ibn Baz, Allahu e mëshiroftë)

Drejtuar atyre që u bëhet qejfi kur tjetri gabon apo bie në bidat, me qëllim që të justifikojnë ngatërresat që ngjallin mes muslimanëve

Drejtuar atyre që në emër të “xherh ue ta’dil” (analizës së gabimeve) po bëjnë hallall gibetin (përgojimin) dhe përçarjen

Metoda e krahasimit ndërmjet të mirave dhe të këqijave (muvazenati) (Nga fetvatë e ibn Uthejminit)

Ndikimi i kohës tek fetvatë

Cili është përkufizimi i plotë në çështjen e përngjasimit me jobesimtarët

Cili është standardi bazë në përngjasimin me jobesimtarët

Gjykimi ndaj “ilahive” me përmbajtje islame

Kreu 9. Thirrja (davja), rregullat e mjetet e saj, si dhe urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja

Thirrja dhe nevoja e njerëzve për të

Mënyrat e thirrjes në kohën e sotme

Këshillë e shejh Uthejminit drejtuar thirrësve

Pyetje drejtuar shejh Albanit në lidhje me obligimin e thirrjes

Mjetet e thirrjes (daves)

Pyetje drejtuar shejh ibn Uthejminit rreth mjeteve dhe mënyrave të thirrjes

.....

Pyetje drejtuar shejh ibn Uthejminit rreth mjeteve dhe mënyrave të reja të thirrjes

.....

Shumëllojshmëria e tematikave dhe mënyrave të thirrjes është rahmet (mëshirë)

.....

Kasetat islame janë të domosdoshme

.....

Gjykimi i shpërndarjes së kasetave si mjet për të bërë dave

.....

Merr dijen e tij dhe lere punën (veprimin) e tij

.....

Pyetje drejtuar shejh Albanit

.....

Sqarimet e ibnu Tejmijes lidhur me urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja

.....

..

Dobia e urdhërimit për të mirën dhe e ndalimit nga e keqja duhet të jetë më e madhe se pasoja e tij negative (dëmi)

.....

Metodologjia e urdhërimit për të mirën dhe e ndalimit nga e keqja

.....

Vështirësitë e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit të së keqes

.....

Rebelimi kundrejt imanit të muslimanëve

.....

Parimet themelore të urdhërimit dhe ndalimit

.....

Dobitë dhe dëmet përcaktohen sipas kritereve të shariatit

.....

Mëshira, durimi e toleranca, janë kushte të urdhërimit për të mirën

.....

Vështirësitë e kushteve

.....

Mosbindja ndaj Allahut sjell vështirësi dhe bindja ndaj Tij sjell lehtësim

.....

Premtimet dhe kërcënimet për ndëshkim ishin pjesa e parë e shpalljes

.....

Ndryshimet e urdhërimit dhe ndalimit janë shkak i përçarjes

.....

Kreu 10. Rregullat e trajtimit të fitneve (trazirave) (Nga Salih Ali Shejh)

Cili është përkufizimi i “Rregullit” dhe “Bazës”

.....

Dobitë që përfitohen nga ndjekja e këtyre rregullave dhe bazave

.....

Rregullat dhe bazat e Sheriatit, ndjekja e të cilave është detyrë gjatë sprovave (fitneve)

Parathënie

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirëshmit, Mëshirëplotit

Me të vërtetë falënderimi i takon Allahut, Atij i kërkojmë ndihmë, i kërkojmë të na falë gjynahet dhe të na mbrojë nga të këqijat e veteve dhe të punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu në rrugën e drejtë nuk ka kush e humb, dhe atë që Ai e humb nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të vetëm e të pashok dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, familjen dhe shokët e tij.

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun ashtu siç duhet pasur frikë Ai dhe mos vdisni ndryshe, vetëm se duke qenë muslimanë.” Ali Imran: 102.

“O njerëz! Jini të bindur (dhe përmbushni detyrimet) ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi juve nga një (shpirt) njeri i vetëm (Ademi), prej tij Ai krijoi bashkëshorten e tij dhe nga ata të dy Ai krijoi burra e gra të shumtë. Kijeni frikë Allahun nëpërmjet të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe mos i ndërprisni marrëdhëniet me barkun tuaj (të afërmit). Sigurisht Allahu është kurdoherë Gjithëvëzhgues përmbi ju.” En-Nisa: 1.

“O ju që keni besuar! Plotësoni detyrimet tuaja ndaj Allahut, kijeni frikë Atë edhe flisni (gjithnjë) të vërtetën.* Ai do t’ju drejtojë ju tek veprat e mira e të drejta dhe do t’ju falë juve gjynahet tuaja. Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij (Muhamedit, alejhi selam), me të vërtetë që ka arritur fitoren më të madhe (do të pranohet në xhenetin e begatë).” El Ahzab: 70-71.

Fjala më e mirë është Libri i Allahut, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), gjërat më të këqija janë shpikjet në fe,

çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje përfundimin e ka në zjarr.

Pas një periudhe paditurie, dekadence dhe prapambetjeje në botën islame, si rrjedhojë e mungesës së dijes së vërtetë të bazuar në Kur'an dhe Sunet dhe e mosperceptimit të drejtë të fesë, gjë e cila bëri të përhapëj idhujtaria, bidatet, gjynahet dhe t'i jepej përparësi dynjasë dhe kënaqësive të saj para ahiretit, filloi gjatë dekadave të fundit përhapja e dijes së saktë të bazuar në Kur'an dhe Sunet, ashtu siç e kanë kuptuar të parët tanë. Çdo ditë rradhëve të muslimanëve të devotshëm u shtohen njerëz të rinj, të cilët ecin në rrugën e të parëve tanë. Në mbarë botën islame sot, kemi njerëz që e njohin Islamin e pastër e të saktë, e njohin Teuhidin i cili është thelbi i fesë islame dhe e njohin Sunetin. Këta i ftojnë njerëzit në fenë e pastër dhe luftojnë shirkun e bidatin. Kjo padyshim tregon për atë që ka lajmëruar Allahu në Kur'an dhe Profeti (salallahu alejhi ue selem) në hadithe të sakta, se ardhmëria do të jetë për Islamin dhe se muslimanët do të rimëkëmben e do të dominojnë. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Ata duan ta shuajnë Dritën e Allahut (Islamin, Kur'anin) me gojë të tyre. Por Allahu do ta përmbushë Dritën e Tij, edhe pse mosbesimtarët e urrejnë (atë).* Ai është i Cili ka çuar të Dërguarin e Tij (Muhamedin, salallahu alejhi ue selem) me udhëzimin dhe fenë e së vërtetës (Islamin) për ta bërë atë të ngadhënjë mbi të gjitha fetë, edhe pse politeistët e urrejnë (atë).” Es-Saf: 8-9.

Transmetohet nga Aishja se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Nuk do të zhduket nata dhe dita derisa të adhurohet el-Lat dhe el Uz-za.” Atëherë i tha: “O i Dërguar i Allahut! Vërtet kam menduar, kur Allahu zbriti ajetin e Kur'anit ‘**Është Ai që ka sjellë të Dërguarin e Tij (Muhamedin, salallahu alejhi ue selem) me udhëzim dhe me fenë e së vërtetës (Islamin) për ta nxjerrë atë përmbi të gjitha fetë, edhe pse politeistët (paganët, mohuesit e njëshmërisë së Allahut) e urrejnë (këtë)**’ (Et-Teube: 33), që ky ngadhënjim do të jetë i plotë (i përhershëm, i vazhdueshëm).” Profeti (salallahu alejhi ue selem) tha: “Kjo do të vazhdojë aq sa të dëshirojë Allahu, pastaj Allahu do të dërgojë një erë të mirë dhe vdes çdo njeri që ka besim, qoftë edhe sa grimca e një kokrre mustarde. Kështu që mbeten ata që nuk kanë asnjë farë mirësie. Këta kthehen në fenë e baballarëve të tyre.”

Ndoshta disa njerëz mund të mendojnë se premtimi i përmendur në ajetin e Kur'anit është realizuar në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), të khulefave dhe të mbretërve të mirë, por e vërteta nuk është kështu. Ajo që është

realizuar është vetëm një pjesë e këtij premtimi të vërtetë, dhe hadithi e konfirmon qartë këtë që thamë.

Në hadithin që e transmeton Theubani, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Vërtet Allahu e mblodhi për mua tokën dhe unë pashë lindjet dhe perëndimet e saj. Pa dyshim sundimi (pushteti) i Umetit do të arrijë aq sa më është mbledhur prej saj.” Transmeton Muslimi.

Temim ed-Dari ka transmetuar se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: “Kjo fe do të përhapet deri aty ku arrin dita dhe nata. Nuk do të lerë Allahu asnjë shtëpi qerpiçi nëpër qytete e fshatra dhe asnjë çadër të ngritur me copa leshi në malësi dhe shkretëtira¹, pa hyrë në to feja islame. Ky ngadhënjim i Islamit do të shoqërohet me krenarinë e atyre që Allahu dëshiron t’i ngrejë lart, ose me poshtërimin e atyre që Allahu dëshiron t’i poshtërojë.² Allahu i Lartësuar, nëpërmjet krenarisë që u jep muslimanëve, e lartëson fenë islame dhe nëpërmjet poshtërimit të kafirëve, e poshtëron kufirin.” Transmeton Ahmedi dhe hadithi është i saktë. Ky hadith tregon se Islami do të dominojë mbi të gjithë rruzullin tokësor.

Që të bëhet e mundur kjo që është përmendur në këtë hadith të saktë, dijetarët e “ehli sunetit” kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë një punë madhështore për pastrimin e Islamit nga çdo gjë që i është mveshur dhe nuk i përket atij si shirku, kufri, idetë shkatërruese, bidatet dhe hadithet e dobëta, si dhe mendimet e gabuara. Krahas kësaj, ata bëjnë një mund të madh për kthimin e muslimanëve në Islamin e vërtetë dhe edukimin e tyre. Në këtë kuadër, ata i paralajmërojnë njerëzit që të ruhen nga kufri, shirku dhe bidatet, si dhe nga ithtarët dhe punuesit e tyre. Por të gjithë këtë ata e bëjnë duke iu përmbajtur me rigorozitet parimeve dhe rregullave të “ehli sunetit”, pa e tepruar dhe pa neglizhuar e sabotuar. Kështu që ata e dinë se çfarë është bidat dhe çfarë nuk është bidat, çfarë është kufër e shirk dhe çfarë nuk është i tillë. Ata e dinë gjithashtu se kush cilësohet “kafir” e “mushrik” dhe kush jo, kush cilësohet “bidatçi” dhe kush jo. Për të gjitha këto, “ehli suneti” ka vendosur rregulla të qarta, të cilat janë marrë nga Kur’ani, Suneti dhe qëndrimet e selefëve të këtij Umeti, pas një studimi të tërësishëm që dijetarët i kanë bërë argumenteve të këtyre tri burimeve. Këto rregulla preçize e të qarta, e mbrojnë muslimanin nga konfuzioni dhe ngatërresat.

¹) Kuptimi i hadithit është që nuk mbetet asnjë zonë, qoftë në qytete, fshatra, malësi e shkretëtira dhe asnjë shtëpi, pa hyrë në të Islami.

²) Ata që do të ngrihen lart, janë ata që përqafojnë fenë islame dhe nuk rrinë në fenë e tyre duke pranuar që të japin xhizjen. Ndërsa ata që poshtërohen janë ata që marrin përsipër të japin xhizjen dhe nuk e përqafojnë fenë islame.

Nëse muslimani do t'u përmbahet në mënyrë të përpiktë rregullave të "ehli sunetit", do ta dijë se çfarë është bidat dhe çfarë nuk është i tillë, çfarë është kufër dhe çfarë jo, kush është bidatçi dhe kush nuk është bidatçi, kush është kafir dhe kush jo. Ndërsa ai që nuk i përmbahet rregullave të "ehli sunetit" do të konsiderojë bidat atë që nuk është i tillë dhe do të konsiderojë ibadet të ligjshëm atë që është bidat; do të quajë kufër atë që nuk është kufër dhe do të quajë të lejueshme e të ligjshme atë që është kufër; do të cilësojë "bidatçi" atë që nuk është i tillë ose atë që është bidatçi nuk do ta cilësojë të tillë; atë që është musliman do ta cilësojë "kafir", ose në të kundërt, atë që është kafir do ta cilësojë musliman. E gjithë kjo katrahurë, shkaktohet si rrjedhojë e mosbazimit në Kur'an, Sunet si dhe në qëndrimet e të parëve tanë, për të përfituar rregullat që kanë të bëjnë me këtë temë.

"Ehli suneti", me rregullat që ka vendosur, ka bërë pajtimin mes argumenteve të Sheriatit dhe qëndrimeve e perceptimeve të të parëve tanë, të cilat në aparençë ndoshta ndonjërit mund t'i duken kontradiktore. Kështu që "ehli suneti" i ka pranuar e praktikuar të gjitha argumentet e Sheriatit dhe nuk ka braktisur asnjërin prej tyre. Ndërsa bidatçinjtë kanë marrë një pjesë të argumenteve apo qëndrimeve të të parëve tanë, dhe e kanë lënë pjesën tjetër. Si rrjedhim, i kanë përplasur argumentet e Sheriatit me njëri-tjetrin dhe kanë përfunduar në konfuzion, përzierje dhe humbje.

Ibnul Kajim ka thënë: "Ehli suneti" është gjykuesi midis grupeve të ndryshme ekstreme, nuk merr anën e asnjërit grup në mënyrë absolute, nuk ia refuzon asnjë grupi të drejtën që e posedon, nuk e përballon dhe e hedh poshtë bidatin me një bidat tjetër³, dhe nuk e refuzon atë që është e pavërtetë me diçka tjetër të pavërtetë. Nëse e urren një grup njerëzish për shkak se i kanë shpallur armiqësi 'ehli sunetit' dhe i kanë bërë 'kafirë', kjo nuk e bën të gjykojë padrejtësisht ndaj tyre, por përkundrazi, flet të vërtetën për ta dhe gjykon ndaj mendimeve të tyre me drejtësi. Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) që të gjykojë drejt mes grupeve: **'Kështu pra, vetëm tek kjo fe dhe ky libër ftoi njerëzit dhe ashtu siç je urdhëruar qëndro fort, i paepur në Islamin e pastër duke plotësuar gjithë detyrat dhe duke u larguar nga çdo ndalim, dhe mos ndiq dëshirat e tyre, por thuaj: 'Unë besoj në gjithë ç'ka zbritur Allahu nga libri dhe jam urdhëruar të gjykoj drejt mes jush'.'** Esh-shura: 15.

³) D.m.th. duke shpikur një bidat tjetër në fe, siç bënë p.sh. murxhiet për t'iu kundërvënë bidatit të havarixhëve, kaderijtë për t'iu kundërvënë bidatit të xhebrijve, dhe mohuesit e cilësive të Allahut për t'iu kundërvënë atyre që i përngjasojnë cilësitë e Allahut me krijesat, ose e kundërta.

Në këtë ajet, Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), të ftojë për në fenë dhe në librin e Tij dhe të zbatojë në mënyrë të përpiktë atë që është urdhëruar; të mos ndjekë dëshirën e asnjë grupi, ta besojë të vërtetën të gjithë dhe të mos besojë një pjesë e të lerë pjesën tjetër pa e besuar; gjithashtu të gjykojë drejt mes përfaqësuesve e pasuesve të feve, mendimeve dhe thënieve të ndryshme.”⁴

“Ehli suneti’ në rrugën e tij të mbarë që do ta çojë pa diskutim e dyshim në ngadhënjim dhe triumf, ka hasur dhe vazhdon të hasë vështirësi dhe pengesa, sepse kjo është natyra e daves islame. Këto pengesa dhe vështirësi do të eliminohen me lejen e Allahut dhe kurrsesi nuk do ta pengojnë vrullin e së vërtetës drejt triumfit.

Ndër vështirësitë dhe ngatërresat që ka hasuar “ehli suneti” është mosperceptimi i drejtë i Kur’anit, Sunetit dhe qëndrimeve të selefëve, mospranimi i të gjithë argumenteve fetare, mospajtimi mes tyre, mosgjykimi në mënyrë të drejtë mes ideve, mendimeve dhe thënieve, dhe përplasja e argumenteve të Sheriatit me njëri-tjetrin (nga ana e grupeve), gjë e cila solli rrëmujën dhe përzierjen që manifestohet tek ata njerëz që nuk u përmbahen rregullave të “ehli sunetit”, siç sqaruar më lart. Si rrjedhojë është bërë “kafir” ai që nuk është kafir dhe është bërë “bidatçi” ai që nuk është bidatçi dhe anasjelltas. Kjo ka ndodhur në të kaluarën dhe po ndodh edhe në kohën tonë.

Në të kaluarën u shfaqën havarixhët të cilët i përceptuan gabim argumentet e Sheriatit, i përplasën me njëri-tjetrën, pranuan një pjesë të tyre, lanë një pjesë tjetër dhe kaluan në ekstrem. Kështu që i bënë “kafirë” muslimanët, mes tyre edhe sahabët, dhe i përfshinë ata në çdo përcaktim që u përket kafirëve. Filluan të derdhin gjakun e muslimanëve, të robëronin gratë e fëmijët e tyre, dhe të merrnin pasuritë e tyre me pretekstin se janë kafirë. Po ashtu edhe në kohën tonë u ringjallën idetë dhe mendimet ekstreme të havarixhëve. U shfaqën njerëz të cilët nuk i njihnin ose nuk i respektonin rregullat e “ehli sunetit” në lidhje me gjykimin ndaj individëve dhe grupeve, nëse janë apo jo muslimanë. Si rrjedhojë i bënë “kafirë” muslimanët dhe u mveshën atyre çdo gjë që ka të bëjë me kafirët. Kjo rrymë eksteme, ndoshta burimin e ka nga segmente të huaja, dhe më vonë u pasua nga individë dhe grupe të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm. Sidoqoftë, pasojat e saj për Umetin qenë të rënda. Dijetarët e “ehli sunetit”, ashtu si të parët e Umetit, i bënë ballë këtij grupi, dhe duke u bazuar në rregullat që janë marrë nga studimi i tërësishëm i argumenteve të Sheriatit, i

⁴) “Shifaul alil fi mesailil kadai vel kaderi vet-taëlil”.

hodhën poshtë idetë e tyre dhe paralajmëruan Umetin që të ruhet prej intrigave dhe pasojave të devijimit të tyre.⁵

Në të kaluarën ka pasur njerëz dhe grupe të cilët nuk i perceptuan mirë thëniet dhe qëndrimet e selefëve në lidhje me bidatin dhe bidatçinjtë, kështu që cilësuan “bidatçinj” dijetarë të “ehli sunetit”.

Një burrë i tha Abdullah ibnul Mubarekut: “Çfarë thua për atë që bën zina dhe pi alkool, a është besimtar?” Ibnul Mubareku tha: “Nuk e nxjerr nga besimi.” Atëherë burri që e pyeti i tha: “Në këtë moshë të madhe u bërë murxhij!?”⁶ Ibnul Mubareku i tha: “Vërtet murxhijet mua nuk më pranojnë! Unë them se besimi shtohet dhe pakësohet, kurse murxhijet nuk e thonë këtë gjë. Murxhijet thonë se të mirat tona janë sigurisht të pranuar, kurse unë nuk e di nëse është pranuar prej meje qoftë edhe një e mirë! Sa nevojë paske ti që të marrësh një dërrasë dhe të ulesh me dijetarët për të mësuar!”

Imam Buhariun e akuzuan disa njerëz në kohën e tij se është bidatçi, për shkak të fjalës së tij “Të shprehurit nga ana ime e Kur’anit, është i krijuar”. Buhariu nuk donte të thoshte që Kur’ani është i krijuar, sepse ai, si mbarë të parët e Umetit besonte se ai është fjalë e Allahut dhe i pakrijuar, por qëllimi i tij ishte se fjalët dhe veprat e njeriut janë të krijuara. Disa njerëz ngaqë nuk e njohën qëllimin e dijetarëve në porosinë e tyre “Kush thotë se shprehja ime, fjala ime që shpreh me të Kur’anin, është e krijuar, ai është xhehmi”, dhe ngaqë nuk e njohën gjithashtu qëllimin e imam Buhariut me fjalën e tij, e akuzuan atë padrejtësisht. Dijetarët të cilët thanë se “kush e përdor atë shprehje është xhehmi”, jetonin në kohën kur xhehmijtë e përdornin atë fjalë për të maskuar besimin e tyre që Kur’ani është i krijuar. Pra ata janë përballur me një situatë të caktuar. Ndërsa në kohën e imam Buhariut ndryshuan gjërat, besimi se Kur’ani është fjalë e Allahut triumfoi, kështu që ishte e nevojshme që njerëzit të dinin se fjalët dhe veprat e tyre janë të krijuara nga Allahu. Në thelb Buhariu kishte të njëjtin besim me të parët, por ndryshuan qëndrimet dhe shprehjet si rrjedhojë e ndryshimit të situatave. Mirëpo disa njerëz këtë gjë e shfrytëzuan për të akuzuar Buhariun qëllimisht, dhe disa të tjerë nga ngurtësia dhe kapaciteti i tyre i kufizuar për të perceptuar thëniet dhe qëndrimet e dijetarëve. Si rrjedhojë e kësaj katrore që u shkaktua, prijësi i muslimanëve në fushën e hadithit, del nga Nejsaburi për në Buhara dhe që andej niset për në Samerkand, por pa

⁵) Duhet të sqarohet këtu se përballë havarixhëve, në të kaluarën u shfaq një ide tjetër e humbur, ajo e murxhijeve. Kjo ide ekziston edhe në kohën tonë. Si në të kaluarën, edhe në kohën tonë, ajo ka pasur pasojat e saj në përhapjen e shthurjes, shpërbërjes, gjynaheve dhe në mosrespektimin e rregullave dhe ligjeve të Sheriatit.

⁶) Murxhij është ai që beson se besimi nuk shtohet e nuk pakësohet, dhe se punët nuk janë prej besimit. Sipas tyre, gjynahet nuk kanë asnjëlloj ndikimi në besim.

arritur atje, vdes gjatë rrugës në një vend që quhej Hartenk, ku kishte edhe disa të afërm, Allahu e mëshiroftë.⁷

Ashtu si në të kaluarën edhe në kohën tonë ka njerëz që nuk i kanë respektuar rregullat dhe parimet për sa i përket përcaktimit të veprës nëse është bidat apo jo, për sa i përket gjykimit ndaj atij që vepron bidatin nëse është bidatçi apo jo, dhe qëndrimit ndaj bidatçinjve. Si pasojë e kësaj dhe e shumë arsyeve të tjera, po vërejmë njerëz që e quajnë veten selefij, të cilët përflasin dhe akuzojnë kryesisht dijetarë, kërkues dije dhe davetçij bashkëkohorë. Shpesh i akuzojnë për gjëra të rëndomta, të cilat nëse do të vlerësohen sipas kriterëve dhe parimeve të “ehli sunetit”, rezultojnë gjëra të lejueshme e të ligjshme, ose ndoshta janë bidate, por të tilla që njeriu për shkak të tyre nuk mund të cilësohet “bidatçi”, sepse bidatet nuk janë të gjitha të një kategorie dhe rangu, siç do ta mësojmë më poshtë.⁸ Ekziston mundësia që të konstatohet tek ndonjë musliman një bidat fatal, por qëndrimi që mbajnë ndaj tij nuk përkon me rregullat e “ehli sunetit” në lidhje me qëndrimin ndaj bidatçinjve. Për të qenë të drejtë, duhet të sqarojmë se mes atyre që deklarohen selefij, ka që nuk janë të tillë, kështu që gjykimi ndaj tyre është i drejtë. Por problemi i kësaj rryme ekstreme, qëndron në faktin se ata, edhe sikur ta qëllonjë të vërtetën, nuk nisen nga rregullat e “ehli sunetit” për gjykimin ndaj të tjerëve, por thjesht nga rrëmuja që kanë shkaktuar dhe nga qëllime të caktuara. Me sa duket rrëmujën dhe konfuzionin e kanë shkaktuar qëllimisht, për të nxjerrë gjykime të cilat u shërbejnë qëllimeve dhe objektivave të tyre të caktuara.⁹ Prandaj ata merren kryesisht me njerëz selefij dhe aktivistë që i ftojnë njerëzit në Teuhid e Sunet dhe luftojnë shirkun e bidatin, davja e të cilëve ka pasur dobi. Në adresë të tyre

⁷) Kjo ngjarje që i ndodhi Buhariut, na jep të kuptojmë disa gjëra: 1) Ka njerëz që i shtyn epshi, egoja dhe smira për të përfolur e akuzuar të tjerët, edhe sikur të akuzuarit të jenë prej njerëzve të dobishëm. 2) Ka njerëz që nga padituria bëhen viktima të linjave ekstreme dhe si rrjedhojë akuzojnë e përflasin njerëzit e pafajshëm. 3) Mosperceptimi i mirë i thënieve dhe qëndrimeve të selefëve, si dhe mosrespektimi i rregullave që ka vendosur “ehli suneti”, të cilat shpjegojnë dhe përfshijnë të gjitha qëndrimet e selefëve, e çon njeriun në devijim, ekstremizëm dhe padrejtësi ndaj të tjerëve. 4) Nuk i lejohet muslimanit të nxjerrë rregulla nga një qëndrim apo thënie e selefëve në lidhje me qëndrimin ndaj bidatçinjve, pa studiuar thëniet dhe qëndrimet e tjera të tyre dhe synimin e qëllimit të tyre, gjë të cilën nuk mund ta bëjnë veçse dijetarët.

⁸) Sikur të ishte i drejtë akuzimi i çdo personi që bie në bidat “bidatçi”, sido që të jetë bidati, qoftë edhe në çështjet e ixhtihadit, do të ishte e vështirë të shpëtonte ndonjëri prej dijetarëve tanë pa u cilësuar “bidatçi”. Zoti na ruajt nga ky devijim! Besoj se vetëm ky fakt është i mjaftueshëm për të kuptuar ai që është i drejtë dhe i paanshëm, se bazat dhe rregullat që kanë të bëjnë me këtë temë janë të domosdoshme, sepse ndryshe do të krijohet një konfuzion i tmerrshëm dhe do të lëshoheshin llagapet e gjykimet pa kriter, siç ka demonstruar qartë metoda e atyre që po i përshkruajmë më lart.

⁹) Duhet të theksojmë këtu se ka njerëz prej tyre që motivohen nga epshet dhe qëllimet e këqija, sikurse ka shumë të tjerë që janë viktima, të cilët janë përfshirë në këtë rrëmujë duke menduar se po luftojnë bidatçinjtë. Me këtë analizë nuk kemi për qëllim një krahinë apo vend të caktuar, por kemi për qëllim të vëmë në dukje motivet dhe shkaqet e shfaqjes së kësaj rryme ekstreme, si dhe pasojat e saj rrënuese.

lëshojnë fjalët më të rënda që ekzistojnë në fjalorin e dijetarëve kundrejt bidatçinjve, dhe mbajnë qëndrimet më ekstreme që dijetarët i kanë mbajtur ndaj atyre që kanë rënë në bidate të rrezikshme, të cilat janë kufër ose shirk.

Gjërat për të cilat ata përfliten dhe merret nëpër këmbë nderi i tyre nuk përbëjnë ndonjë problem. P.sh. akuzohen se përse nuk flasin kundër një personi apo një grupi të caktuar; përse ulen dhe bashkëpunojnë me një person të caktuar; përse marrin ose transmetojnë diçka prej një personi të caktuar ose përse nuk flasin për një çështje të caktuar, gjëra të cilat mund t'i vëresh nëse do të studiosh veprimtarinë e dijetarëve të mëdhenj. Por me sa duket për arsye objektive, autorët e kësaj rrëmuje nuk i akuzojnë dijetarët e mëdhenj, sepse e dinë që demaskohen menjëherë dhe efekti i konfuzionit dhe çorientimit në radhët e të rinjve muslimanë që ata synojnë ta shkaktojnë, do të jetë shumë i shkurtër. Nëse nuk i kanë përfolur dijetarët e mëdhenj si Albanin, ibnu Bazin, ibnu Uthejminin e të tjerë¹⁰ për arsyen që përmendëm deri tani, nuk dimë të ketë shpëtuar ndonjë nxënës i tyre pa u përfolur, dikush më shumë dhe dikush më pak. Kjo, pa dyshim, për atë që kupton, ka si synim shembjen në mënyrë indirekte të punës së bërë prej dijetarëve të “ehli sunetit.” Sikur të merreshin me ata që ftojnë në kufër, në shirk, në bidate, në ide të prishura dhe me ata që i zhysin muslimanët në kriza, kaos, shkatërrime e të tjera gjëra që muslimanët nuk janë të përgatitur për t'i përballuar, do të ishte diçka e pranueshme dhe për t'u lavdëruar, sepse dijetarët e mëdhenj pikërisht këtë kanë bërë, por duke respektuar rregullat e Sheriatit dhe etikën islame, pa kaluar në teprim apo sabotim.

Disa individë që kanë qenë pjesë e kësaj rryme ekstreme, duke parë se sulmi i krerëve të saj fokusohet ndaj disa aktivistëve bashkëkohorë¹¹, megjithëse probleme të njëjta ose të ngjashme me ato që shtroheshin nga ana e tyre, kishin edhe disa dijetarë të kaluar, të cilët kanë qenë ndoshta edhe më të mëdhej dhe disa probleme përfshinin edhe disa dijetarë selefij të kohës, vendosën të ndahen dhe u betuan që do të gjykonin drejt, sepse rregullat dhe qëndrimet që kishin vendosur apo që praktikonin krerët e rrymës, i përfshinin të gjithë. Sipas tyre nuk ka asnjë argument për të bërë ndryshim, pra për të zbatuar rregullat ndaj disave dhe për të përjashtuar e justifikuar të tjerët. Prandaj e filluan me dijetarët e kaluar që nga ibnu Hazmi, Bejhakiu, ibnul Xheuzi e të tjerë me radhë. Ndërsa ndër bashkëkohorët përfshinë edhe shejh Albanin me pretekstin se është

¹⁰⁾ Shejh Abadi e ka përmendur njërin prej tyre në mënyrë të tërthortë, në njërin prej dy librave të tij.

¹¹⁾ Prej të cilëve ka që akuzohen me të drejtë dhe ka që akuzohen padrejtësisht.

murxhie për sa i përket çështjeve të bidatit, duke thënë se është tolerant ndaj bojkotimit të bidatçinjve.¹²

Mesa duket këta nuk e kanë kuptuar qëllimin e krerëve të tyre, ose e kanë kuptuar, por epshi i motivonte që ta thellonin më shumë shkatërrimin dhe dëmin në rradhët e muslimanëve të rinj të kapur pas Sunetit. Me lejen e Allahut, përfundimi i të gjithë këtyre rrymave ekstreme do të jetë zhdukja, sepse ato manifestojnë errësirën dhe rrëmujën, kështu që si të tilla nuk mund të rezistojnë përballë dritës së të vërtetës dhe Sunetit. Dijetarët tanë, ashtu siç i janë kundërvënë çdo lloj ekstremizmi, siç e përmendëm pak më parë ndaj atyre që cilësojnë “kafirë” muslimanët me pretekstin e luftimit të shirkut dhe mbrojtjes së Teuhidit, i janë kundërvënë edhe kësaj rryme ekstreme që cilëson “bidatçi” të kapurit pas Sunetit, nën pretekstin e luftimit të bidatit dhe mbrojtjes së këtij të fundit. Këtë gjë dijetarët e kanë bërë në libra dhe në ligjërata të cilat janë inçizuar dhe përhapur mes muslimanëve, si p.sh. kaseta e shejh Albanit “Kush është bidatçi dhe kush është kafir”, në të cilën ai ka sqaruar shumë baza dhe rregulla të rëndësishme në lidhje me këtë temë, dy libra të njëpasnjëshëm të shejh Abadit si dhe shumë materiale të tjera.

Në fund të kësaj parathënie na duhet të sqarojmë disa gjëra:

E para, për të njohur punët që janë bidat nga ato që nuk janë të tilla, atë që është bidatçi nga ai që nuk është i tillë, gjykimin ndaj bidatçiut dhe qëndrimin që duhet mbajtur ndaj tij, këshillojmë të lexohen librat e mëposhtëm: “El i’tisam” i Shatibiut; në përgjithësi librat e ibnu Tejmijes si “Mexhmuul fetaua”, “Iktidaus siratil mustekim” etj.; “Hakikatul bida’ti ue ahkamuha” të Said el Gamid, si dhe “Meukifu ehli-suneh uel xhema’ah min ehliil ehuai uel bida’i” të Ibrahim Rruhajlit.

Ai që nuk i ka njohuritë e duhura në këtë çështje dhe nuk i ka lexuar librat e lartpërmendur e të tjerë si puna e tyre, të mos marrë përsipër atë që nuk është i aftë për ta bërë, por të pyesë ata që i kanë studiuar këto libra të rëndësishëm dhe kanë dije në këtë lëmi, në mënyrë që të përfitojë prej tyre dhe të qartësohet rreth çështjeve në fjalë. Leximi i ndonjë broshure në lidhje me këtë temë, ose dëgjimi i ndonjë kasete, megjithëse mund të përfitohet prej tyre, nuk është i mjaftueshëm që të bëhet pikë referimi për njerëzit, për të gjykuar ndaj tyre dhe për të mbajtur qëndrime të caktuara.

E dyta, kur disave prej atyre që janë aktivizuar për të bërë këtë rrëmujë, u thuhet se janë duke përçarë “ehli sunetin” dhe duke shkëputur lidhjet mes tyre, përgjigjen se paralajmërimi rreth bidatit dhe bidatçinjve është detyrë, duke u

¹²⁾ Mund të lexohen disa thënie të tyre në librin “Hurmetu ehliil ilm” të Muhamed Ismail el Mukadim.

mbështetur në hadithin e Hudhejjes: "...Njerëzit e pyesnin të Dërguarin e Allahut për të mirën, kurse unë e pyesja për të keqen nga frika se mos më prekte¹³..." Këtyre do t'u thonim shkurtimisht se sikur të aktivizoheshin vërtet për luftimin e bidatit dhe paralajmërimin rreth tij, si dhe për demaskimin e bidatçinjve e për shkatërrimin e planeve të tyre, kjo do të ishte gjë e lavdëruar dhe do të përfshihej puna e tyre në paralajmërimin prej së keqes që e ka synuar Hudhejfe. Por të bësh bidat atë që nuk është i tillë dhe si rrjedhojë të akuzosh pasuesit e Sunetit si bidatçinj, këtë gjë ai nuk e ka synuar. Madje këto ngatërresa dhe këto përçarje që po i përhapin, janë pjesë e së keqes prej së cilës duhet paralajmëruar për t'u ruajtur, bazuar në hadithin e Hudhejjes (radijallahu anhu).

E treta, disa çështje trajtohen nga disa njerëz para masës së muslimanëve në një mënyrë të atillë që t'u jepet të kuptojnë se ka mosmarrëveshje mes tyre dhe kundërshtarëve të tyre, ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë, p.sh. ekzistojnë shumë metoda që përdoren nga grupe të caktuara për ndryshimin e gjendjes së tanishme të muslimanëve, të cilat bien ndesh me metodën që ndoqi Profeti në lidhje me këtë çështje. Kjo do të sqarohet insha-Allahu në kapitujt e këtij libri. Megjithëse kundrejt metodave të shpikura mendimi është i njëjtë, d.m.th. që ato janë të paligjshme dhe të padobishme, njerëzit për të cilët po bëjmë fjalë, këmbëngulin t'i trajtojnë si pika konflikti mes tyre dhe mes atyre që duan t'i konsiderojnë kundërshtarë për interesa të ngushta.

E katërta, dihet që në trojet tona është punuar për të ftuar njerëzit në Islamin e pastër që prej afro pesëmbëdhjetë vjetësh. Gjatë kësaj kohe është përhapur disi thirrja e vërtetë islame. Shumë të rinj e kanë njohur Sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe janë kapur pas tij. Ndërkaq, disa njerëz, të cilët pak kohë kanë që e kanë njohur këtë dave, dhe ndoshta të parët kanë qenë shkak për t'ua bërë të njohur atë, kanë tendenca për mohimin e asaj që është arritur deri tani, dhe për zhvlerësimin e mundit të derdhur deri më sot për luftimin e shirkut, bidatit e ideve të prishura, dhe për edukimin e muslimanëve në Islamin e pastër. Mesa duket, nëpërmjet kësaj gjëje kërkojnë të shfaqen dhe t'i mveshin vetes vlera e merita që faktikisht i kanë të tjerët dhe për të cilat e lusim Allahun t'i shpërblejë sepse janë bërë shkak për udhëzimin tonë. Do të ishte më e mira për ta, që në vend të zhvlerësimit të punës së bërë dhe pretendimit se janë të vetmit që predikojnë Islamin e pastër, të bëheshin pjesë e daves që ka filluar prej mjaft vjetësh, dhe të bashkëpunojnë me ata që punojnë në terren, për forcimin dhe ecurinë e kësaj daveje të drejtë. Nuk e vëmë në

¹³) Kjo është një pjesë e hadithit të Hudhejjes që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

dyshim faktin që puna e bërë në të kaluarën ka mangësitë e saj të cilat duhen plotësuar dhe gabimet e saj që duhen korigjuar, sepse mangësitë dhe gabimet janë prej natyres së bijve të Ademit. Por plotësimet e korigjimet duhen bërë në atë mënyrë që e çon thirrjen Islame drejt përsosmërisë, përkryerjes dhe forcimit, e jo të shfrytëzohen mangësitë e gabimet si pretekst për shkatërrimin e daves dhe demaskimin e davetçijve. Do t’i ftonim sinqerisht të meditonin mbi fjalën e Profetit: “Sikur të mos bënit gjynahe, do të kisha frikë për ju diçka që është më e madhe, vetadmirimin (vetpëlqimin)¹⁴”, si dhe mbi fjalën e tij: “Tri gjëra janë shkatërruese: dorështrëngimi i respektuar, ndjekja e epshit dhe vetadmirimi¹⁵.” Në të njëjtën vazhdë është edhe thënia e hershme e dijetarëve: “Dëshira për t’u dukur të thyen shpinën.” Prandaj le të merremi me të metat tona, të mposhtim dëshirat e këqija dhe të zbresim në terrenin e daves me qetësi e butësi, të bashkëpunojmë me aktivistët aktualë të daves selefije për të luftuar shirkun, kufrin, idetë e prishura dhe bidatet, dhe për edukimin e muslimanëve në Islamin e pastër.

Për zgjedhjen e këtij materiali dhe përkthimin e tij kanë kontribuar vëllezërit: Ahmed Kalaja, Bilal Teqja, Azem Bardhoshi, Sajmir Ismaili dhe Bilal Shkrepi.

Të gjitha shënimet në libër janë vendosur nga shkruesi i kësaj parathënieje.

E lus Allahun e Lartësuar që ta bëjë këtë punë të sinqertë e të pranueshme.

Ue Subhaneke Allahum-me ue bihamdike, eshedu en la ilahe il-la Ente estagfiruke ue etubu Ilejke. Paqja, bekimi dhe mirësia qofshin mbi të Dërguarin tonë, mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Shkroi:
Ismail Isuf Bardhoshi

¹⁴) Transmeton Bejhakiu. Hadithi është i mirë siç ka përmendur në “Sahihul xhamii”.

¹⁵) Transmeton Taberaniu në “El eusat”. Hadithi është i mirë (sahihut tergibi vet terhib)

Kreu 1. Hyrje në çështjet e bidatit

Në vijim do të sqarojmë disa gjëra që kanë të bëjnë me bidatin në mënyrë të përmbledhur. Ato, inshaAllahu, do t'i shkoqisim pa përmendur qëndrimin e atyre që i perceptojnë ndryshe nga shpjegimi i dijetarëve, me qëllim që të mos zgjatemi.

Krahasimin mes asaj që do të përmendim këtu nga dijetarët e “ehli sunetit” dhe rrëmujës e konfuzionit në të cilin janë përfshirë disa njerëz, po ia lëmë lexuesit.

Kuptimi dhe përkufizimi i bidatit

Bidat nga ana gjuhësore do të thotë *diçka e shpikur pa pasur një shembull të mëparshëm*.

Përkufizimi i bidatit nga ana fetare është *një rrugë apo një gjë e shpikur në fe, e cila rivalizon rrugën, rregullat dhe gjërat e ligjëruara në Sheriat, dhe synohet nëpërmjet marrjes ose veprimit të saj, teprimi në adhurimin e Allahut të Lartësuar*.

Fragmenti *në fe* është një kufizim e përcaktim që i bëhet bidatit, sepse ai shpiket në fe, dhe për të ndikuar në fe është synimi i autorit të tij. Gjithashtu, sikur të ishte *diçka e shpikur veçanërisht për punët e dynjasë*, nuk do të quhej bidat, si p.sh. shpikjet teknologjike, e të tjera gjëra që nuk kanë ekzistuar në të kaluarën.

Duke qenë se gjërat, punët dhe mjetet në fe, ndahen në të tilla që janë të bazuara në Sheriat dhe të tjera që nuk janë të bazuara në Sheriat, në përkufizim janë përmendur vetëm gjërat që janë shpikur pa pasur shembull të mëparshëm në Sheriat, sepse vetia e bidatit është dalja e tij nga kufijtë e përcaktuar nga Ligjvënësi.

Nëpërmjet këtij kufizimi, është synuar të mos përfshihen në përkufizimin e bidatit disa gjëra të cilat mund të duken si gjëra të shpikura, por që faktikisht kanë bazë në fe dhe kanë lidhje me të, kështu që nuk janë bidat, si p.sh. shkencat gjuhësore, “usulul Fikhu” (parimet e Fikhut) dhe të gjitha njohuritë që i shërbejnë Sheriatit. Megjithëse nuk kanë qenë të përpiluara në kohën e Shpalljes, bazat e parimet e këtyre njohurive gjenden në Sheriat.

Nëse do të pyeteshim nëse përpilimi i tyre në këtë mënyrë është i shpikur, përgjigjja është se këto bazën e kanë në fe dhe argumentet specifike tregojnë për to. Edhe sikur të pranohej se nuk ka argument specifik që tregon për to,

bazat e përgjithshme të Sheriatit tregojnë për konsiderimin e tyre. Ligjshmëria e këtyre gjërave është përfituar nga baza e interesave të lira (el mesalihul murseletu). Fragmenti *e cila rivalizon rrugën, rregullin dhe gjërat e ligjëruara në Sheriat*, do të thotë që i përngjan rrugës, rregullit dhe çështjes fetare, pa qenë realisht e tillë. Madje përkundrazi, ajo e kundërshton Sheriatin në disa aspekte ndër të cilat përmendim:

1) Vendosja e kufizimeve që nuk kanë ardhur në Sheriat, p.sh. zotimi për të agjëruar duke qëndruar në këmbë nën rrezet e diellit dhe jo nën hije, përdorimi i vetëm një lloj veshjeje ose ngrënia e një lloji të vetëm ushqimi pa arsye.

2) Respektimi i disa formave dhe mënyrave të caktuara, për të cilat nuk ka argument në Sheriat, si p.sh. përmendja e Allahut nga një grup njerëzish njëzëri, festimi i ditëlindjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem) e të tjera si këto.

3) Kryerja e ibadeteve të caktuara në kohë të caktuara, nëse nuk ka argument në Sheriat që tregon për përcaktime të tilla, si p.sh. respektimi dhe synimi i agjërit të ditës së 15-të të muajit Shaban dhe falja e namazit të natës në të.

Bidatçiu e shpik bidatin për të rivalizuar Sunetin, në mënyrë që t'ua ngatërrojë të tjerëve atë. Zakonisht, njeriu nuk synon të mbledhë mbështetës e pasues nëpërmjet shpikjes së diçkaje që nuk i përngjan asaj që është e ligjshme në Islam, sepse nëse do të bënte kështu, shpikja nuk do t'i sillte ndonjë dobi, nuk do t'i shmangte ndonjë dëm dhe asaj nuk do t'i përgjigjej askush. Prandaj bidatçiu e mbështet bidatin e tij në gjëra që i bëjnë njerëzit të mendojnë se veprimi i tij është i ligjshëm nga ana fetare.

Fragmenti *dhe synohet nëpërmjet veprimit të saj teprimi në adhurimin e Allahut të Lartësuar*, është plotësues i kuptimit të bidatit, sepse ky është qëllimi i shpikjes së tij. Bidatçinjtë, pasi kanë vërejtur se qëllimi i krijimit të njerëzve dhe xhinëve është që të adhurojnë Allahun, siç ka thënë Allahu: **“Dhe Unë (Allahu) nuk i krijova xhindët dhe njerëzit, veçse që ata të më adhurojnë vetëm Mua”** (Edh-dharijat: 56), i kanë shpikur bidatet për të bërë sa më shumë adhurim dhe për t'i nxitur njerëzit për të. Pra, ata kanë marrë parasysh aspektin që jemi krijuar për të adhuruar Allahun dhe kanë shpikur gjëra të ndryshme për ta arritur këtë qëllim, por nuk kanë marrë parasysh aspektin tjetër, që rregullat dhe kufijtë e ibadeteve që i ka përcaktuar Allahu janë të mjaftueshëm, dhe se njeriu nuk mund të afrohet te Allahu e të arrijë kënaqësinë e tij, veçse nëpërmjet kryerjes së ibadeteve që kanë ardhur në Sheriat sipas formës, mënyrës dhe kufizimeve që i ka caktuar Ai.

Ibnu Tejmija ka thënë: “Bidati në fe është ajo gjë që nuk e ka ligjëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem). Pra, është ajo gjë që nuk është urdhëruar për të nëpërmjet urdhërit që e bën diçka të obligueshme dhe as nëpërmjet urdhërit që e bën diçka të pëlqyeshme.” Gjithashtu ka thënë: “Bidati është ajo gjë që kundërshton Kur’anin, Sunetin, ose ixhmain (unanimitetin e të parëve të Umetit), qofshin besime apo ibadete, si thëniet e havarixhëve, rafidijve, kaderijve ose xhehmijve; ata që adhurojnë nëpërmjet kërcimit dhe muzikës në xhami; ata që e konsiderojnë ibadet e adhurim rruajtjen e mjekrës, pirjen e hashashit e të tjera lloje bidatesh si këto, të cilat, grupet që kanë kundërshtuar Kur’anin dhe Sunetin i kryejnë duke i konsideruar ibadete.

Ndarjet e bidatit

Duke marrë parasysh aspekte të ndryshme, bidatet kanë disa ndarje:

1- Ndarja e bidateve në “hakikije” dhe “idafije”.

- Bidatet “hakikije” (reale) janë ato që nuk bazohen në asnjë argument fetar, as në Kur’an, as në Sunet, as në ixhmaë (unanimitetin, konsesusin e dijetarëve) dhe as në një argumentim të konsiderueshëm të dijetarëve, qoftë në mënyrë të përgjithshme apo në mënyrë të detajuar. Kjo është e vërteta, megjithëse bidatçiu nuk e pranon atë, sepse ai pretendon që argumentet fetare e përfshijnë veprën e tij.

Disa shembuj për këtë:

a) Bërja haram e diçkaje që e ka lejuar Allahu. P.sh. ia bën të ndaluar vetes së tij një lloj veshje ose ushqimi të lejuar, po kështu edhe ndalimin e martesës me gratë. Të gjitha këto i bën duke menduar se po bën ibadet dhe po i afrohet Allahut. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“O ju që keni besuar! Mos i bëni të paligjshme Tajjibatet (të mirat nga ushqimet, njerëzit, punët e tyre, besimin e gjithçka tjetër) të cilat Allahu i ka bërë të ligjshme për ju dhe mos i kaloni kufijtë, është e vërtetë se Allahu nuk i do thyesit e ligjeve (ata që kalojnë kufijtë e vendosur nga Allahu).”** El Maide: 87.

b) Bërja hallall e haramit, si pirja e alkolit, zinaja etj.

c) Të kushtuarit e adhurimit të tjerëve përveç Allahut.

d) Mohim i Sunetit si argument i Sheriatit, e të tjera bidate të kësaj natyre.

- Bidatet “idafije” (relative), janë ato që kushtëzohen nga dy gjëra:

E para, kanë një farë lidhje me argumentet, kështu që nga ky aspekt nuk konsiderohen bidat.

E dyta, lidhja (raporti) e tyre me argumentet, është si puna e bidateve “hakikije”, e si rrjedhojë konsiderohen bidat.

Meqë puna, e cila ka dy raporte (lidhje), nuk është përfundimisht e shkëputur nga njëra anë, e të bëhet krejtësisht e anës tjetër, i është dhënë emri bidat “idafij”, që do të thotë se ajo, për sa i përket njëres anë është sunet, sepse ka një farë lidhje me argumentet e përgjithshme dhe bazohet në to, por për sa i përket anës tjetër është bidat, sepse është e bazuar në dilemë (mëdyshje) dhe jo në argument, ose nuk është e bazuar në asgjë.

Atëherë, punët të cilat konsiderohen bidate “idafije”, për sa i përket origjinës dhe bazës janë të argumentuara, kurse për sa i përket formave dhe mënyrave, rasteve dhe gjendjeve ose detajimeve, nuk janë të argumentuara, megjithëse është e nevojshme që të jenë të mbështetura në fakte, pasi më së shumti hasen në ibadete dhe jo në gjërat që kanë të bëjnë në mënyrë totale me dynjanë. Ky është edhe ndryshimi mes bidatit “hakikij” dhe bidatit “idafij.” I pari nuk është i bazuar në argument, as për sa i përket origjinës dhe bazës, dhe as për sa i përket formës, mënyrës dhe detajimeve, kurse i dyti është i bazuar në argument për sa i përket origjinës dhe bazës, por nuk është i bazuar në argument për sa i përket formës, mënyrës dhe detajimeve.

Bidatet “idafije” ndahen në dy pjesë:

- Ato që u afrohen shumë bidateve “hakikije”, aq sa pothuajse konsiderohen të njëjta. Një shembull për këtë është kur njeriu ka dy rrugë nëpërmjet të cilave duhet të punojë për botën e përtejme. E para është e lehtë kurse e dyta është e vështirë. Që të dyja janë të barabarta për sa i përket arritjes së qëllimit, por disa njerëz të rreptë e të shtrënguar marrin atë që është më e vështirë, p.sh. përdorin ushqimet dhe rrobat më të këqija pa asnjë qëllim tjetër veçse për vështirësim, ndërkohë që mund të përdorin të tjera të cilat janë më të mira.

Një shembull tjetër është rasti kur origjina e ibadetit (adhurimit) është e ligjshme, por nëpërmjet kufizimeve e caqeve që ia vendosin apo ia heqin pa argument, kthehet në të paligjshme, edhe pse ata që i bëjnë këto shpikje mendojnë se janë të ligjshme sipas origjinës. Kjo konstatohet në rastin kur e kufizon apo e përcakton tërësinë absolute të një ibadeti apo të diçkaje tjetër me opinionin e tij, ose kur e heq kufizimin dhe cakun që ka tërësia e një ibadeti ose e diçkaje tjetër. Shembull për këtë është veçimi i të ashtuquajturave “ditë të mira” me disa lloje ibadetesh për të cilat nuk ka argument që të dëshmojë për ligjshmërinë e tyre në mënyrë të veçantë, siç është veçimi i një dite ose një nate të caktuar për të falur kaq dhe aq rekate namaz, për të dhënë kaq e aq sadaka etj.

- Bidatet “idafije” që janë larg bidateve reale, aq sa pothuajse konsiderohen sunet. Si shembull kemi rastin kur puna, për sa i përket origjinës është e ligjshme, por merr gjykimin e bidatit për të bllokuar rrugët e shpikjes së bidateve. P.sh. të kryhen nafillet si puna e suneteve të forta në mënyrë të vazhdueshme në kohë të caktuara, ose në një mënyrë të caktuar, duke falur nafillet me xhemat në xhamitë në të cilat falen namazet farze, me përjashtim të Ramazanit.

Siç e mësuam nga shembujt e mësipërm, ai që bën bidat “idafije” adhuron nëpërmjet diçkaje që për sa i përket origjinës është e ligjshme, kurse për sa i përket formës dhe mënyrës, nuk është e tillë. Adhurimi i Allahut duhet të bëhet vetëm me ibadetet që janë krejtësisht të ligjëruara. Ashtu siç është detyrë që lloji dhe origjina e ibadetit të jetë e ligjshme, po ashtu është detyrë që forma dhe mënyra se si kryhet ai të jetë e ligjshme. Kjo bazuar në hadithin e saktë: “Kur dikush punon një punë e cila nuk është në përputhshmëri me fenë tonë, ajo është e refuzuar.” (Transmeton Muslimi). Ai që shpik apo punon bidatin “idafij”, ka përzierë një punë të mirë me një punë të keqe, edhe pse mendon se puna e tij është krejtësisht e mirë.

2 - Ndarja e bidateve në “ibadije” dhe “adije”

Disa dijetarë, duke marrë parasysh lidhjen që kanë bidatet me punën e robërve, i kanë ndarë ato në bidate “ibadije” dhe “adije”.

- Bidatet “ibadije” (adhurimit, ibadetit) janë ato që kanë lidhje me një nga llojet e adhurimit. Siç ka thënë ibnu Tejmije: “Adhurimi është një emër gjithpërfshirës i të gjitha atyre punëve dhe thënieve të jashtme dhe të brendshme, që i do dhe i pëlqen Allahu.”

- Bidatet “adije” (zakoneve, gjërave që i përkasin dynjasë), janë ato që lidhen me gjërat e zakonshme.

Gjërat e zakonshme janë ato që kanë një origjinë dhe natyrë të tillë, sipas së cilës nuk është synuar që të përdoren për të adhuruar Allahun dhe për t’u afruar me to tek Ai. Megjithatë, mund të kthehen në adhurim dhe në punë që të afrojnë tek Allahu duke marrë parasysh diçka tjetër, e cila nuk rrjedh detyrimisht nga natyra e tyre (si gjëra të zakonshme).

Tek gjërat e zakonshme përfshihen të gjitha kontratat, këmbimet dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve me synim përfitimi, si dhe të gjitha përpjekjet që kanë të bëjnë me jetën e kësaj dynjaje dhe që janë mjete dhe rrugë për të arritur kënaqësitë e saj.

Të gjithë dijetarët kanë rënë dakord se bidatet konstatohen në adhurime.

Ato ekzistojnë në çështjet e besimit dhe në punët e zemrës, si dhe në veprat e gjymtyrëve, shprehjet ose punët, si p.sh. besimi i kaderijve, murxhieve, havarixhëve, mu'tezilive, idetë e liberalistëve dhe shpikja e ibadeteve që nuk kanë shembull të mëparshëm dhe nuk janë të bazuara në argumente.

Ndërsa për sa i përket depërtimit dhe pranisë të bidateve në gjërat e zakonshme, dijetarët nuk janë pajtuar. Një grup prej tyre mendon se bidatet në mënyrë absolute hyjnë dhe ekzistojnë në gjërat e zakonshme. Kurse një grup tjetër mendon se ato nuk hyjnë dhe nuk ekzistojnë absolutisht në gjërat e zakonshme. Sipas tyre bidatet kanë të bëjnë vetëm me ibadetet (adhurimet).

Imam esh-Shatibiu ka bërë një analizë të rëndësishme, e cila është mendimi i tretë në këtë çështje. Ai ka thënë: “Bidatet nuk hyjnë dhe nuk kanë të bëjnë me gjërat e zakonshme, veçse duke marrë parasysh aspektin e lidhjes që kanë me adhurimin dhe domethënien e tij të cilën e përmbajnë, pasi çdo gjë e zakonshme ka të bëjë me adhurimin. Ajo është e kufizuar dhe e përcaktuar nga rregulla fetare, të cilët njeriu e ka detyrë t’i respektojë.”

Kështu që depërtimi dhe prania e bidateve në gjërat e zakonshme, sipas Shatibiut, lidhet vetëm me këtë aspekt dhe jo me të tjerët, pra me aspektin e rregullave fetare që kanë të bëjnë me gjërat e zakonshme.

Faktikisht, përfundimi që ka nxjerrë Shatibiu përbën pajtim të dy mendimeve të tjera. Bidatet nuk hyjnë në gjërat e zakonshme duke marrë parasysh aspektin që janë gjëra të zakonshme (dynjaje), por hyjnë në to duke marrë parasysh aspektin e kundërshtimit të kufizimeve dhe rregullave që Sheriati ia ka vendosur gjërave të zakonshme dhe duke marrë parasysh shndërrimin e tyre në rite adhurimi me të cilat adhurohet Allahu.

Një shembull konkret për këtë janë taksat që vihen nga njerëzit padrejtësisht,¹⁶ në rastin kur sistemohet e kodifikohet vjelja e tyre me anë të ligjeve dhe merren me ose pa forcë. Nëse dikush nuk i jep ato ndëshkohet. Taksat në këtë mënyrë i përngjajnë zekatit dhe e rivalizojnë atë.

Për më gjerë sqarojmë se taksat në marrëdhëniet, kontratat dhe pasuritë e njerëzve mund të vilen në dy mënyra:

- Të bëhet vjelja e tyre në një mënyrë të pakodifikuar e të pasistemuar, me synimin e kufizimit të veprimtarisë së njerëzve për një farë kohe, në një situatë të caktuar, për të arritur kënaqësitë e kësaj dynjaje, në formën e grabitjes, vjedhjes, plaçkitjes e të tjera forma të ngjashme me këto. Në këtë rast taksat janë zullum e haram, si të gjitha llojet e zullumeve.

¹⁶) Ka raste kur prijësi i drejtë dhe i devotshëm i muslimanëve, ka të drejtë të detyrojë të pasurit të japin diçka më shumë se zekati nga pasuritë e tyre, sipas disa kushteve të caktuara të cilat janë përmendur në librat e Fikhut.

- Të vendoset si ligj i përhershëm ose i përkohshëm, në mynyra e sasi të caktuara, gjë e cila rivalizon atë që është ligjësuar në Sheriat. Në këtë rast taksa ka rivalizuar zekatin sepse u është obliguar njerëzve njësoj si ai, dhe nga ky aspekt ajo konsiderohet bidat.

Si përfundim çështja e taksave vërehet në dy këndvështrime:

I pari lidhet me aspektin e veprimit të një pune të ndaluar, si të gjitha llojet e padrejtësive.

I dyti lidhet me aspektin e shpikjes dhe vendosjes së një ligji që njerëzit duhet t'i përmbahen deri në vdekje, sikurse duhet t'u përmbahen të gjitha obligimeve.

Kështu që lidhur me taksat bashkohen dy ndalesa: ndalimi si gjynah e haram, dhe ndalimi si bidat e shtesë në fe.

Prej bidateve “adije” është edhe emërimi në postet e larta nëpërmjet trashëgimisë, të atyre që nuk janë të denjë.

3- Ndarja e bidateve në “fi’lije” (që kanë të bëjnë me veprimin) dhe “terkije” (mosveprimi, lënia).

Bidatet, për sa i përket veprimit dhe mosveprimit ndahen në “fi’lije” dhe “terkije.”

- Bidatet “fi’lije” janë veprimi i gjërave që nuk janë ligjësuar në fe, duke synuar t'i bëhet ibadet Allahut nëpërmjet tyre. Shumica e bidateve janë të këtij lloji. Shembujt për këtë janë të shumtë, si shpikja e haditheve me qëllim që t'i atribuohet Profetit (salallahu alejhi ue selem) ajo që është gënjeshtër, shtesa në fe e asaj që nuk është prej saj etj.

- Bidatet “terkije” janë lënia e atyre gjërave që sipas gjykimit fetar janë të lejueshme, të pëlqyeshme ose të detyrueshme, duke e konsideruar këtë diçka të mirë dhe adhurim.

Këtu nuk është përmendur lënia e haramëve dhe mekruheve (gjërave të papëlqyeshme), sepse lënia e tyre nuk është bidat, por është detyrë dhe diçka për të cilën njeriu shpërblehet.

Lënia e gjërave të lejueshme, të pëlqyeshme ose të detyrueshme, është bidat në rastin kur mosveprimi i tyre konsiderohet i mirë dhe adhurim (ibadet).

E ndërsa kur lihen nga dembelizmi apo për qëllime të tjera, nuk është bidat, por nëse ka lënë vaxhibin është gjynah, dhe nëse ka lënë diçka të pëlqyeshme ose të lejuar nuk është gjynah. Po kështu, kur ilëpër shkak të sëmundjes ose për arsye të tjera, nuk është bidat. Mospraktikuesi për shkak të sëmundjes, është i justifikuar edhe sikur të ketë lënë atë që është detyrë.

Si shembull i bidatit “terkije” që ka të bëjë me diçka të lejuar, është lënia e njërit prej ushqimeve të lejuara me qëllim adhurimi dhe devocioni fetar.

Është përmendur në një hadith që e transmeton Tirmidhiu nga ibnu Abazi se një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Kur ha mish më lind dëshira për marrëdhënie seksuale me gratë dhe më shtohet epshi, kështu që ia ndalova vetes time mishin.” Atëherë Allahu zbriti ajetin e Kur’anit: **“O ju që keni besur! Mos i bëni të paligjshme Tajjibatet (të mirat nga ushqimet, njerëzit, punët e tyre, besimin e gjithçka tjetër) të cilat Allahu i ka bërë të ligjshme për ju dhe mos i kaloni kufijtë, është e vërtetë se Allahu nuk i do thyesit e ligjeve (ata që kalojnë kufijtë e vendosur nga Allahu).”** Maide: 87.

Shembulli i bidatit “terkije” që lidhet me diçka të pëlqyeshme, është lënia e namazeve nafile, misuakut, sadakasë vullnetare etj. në mënyrë të vazhdueshme dhe duke e konsideruar të mirë një gjë të tillë.

Shembulli i bidatit “terkije” që lidhet me diçka të obligueshme, është lënia e detyrave si namazi, agjërimi, zekati, haxhi e të tjera, duke e konsideruar një gjë të tillë devocion fetar, siç bëjnë të shtururit dhe liberalët e sufistëve, të cilët thonë se ai që merr rrugën e tyre, kur arrin një gradë të caktuar, i hiqen obligimet.

4 - Ndarja e bidatit në “itikadije” (besimi) dhe “amilije” (praktike).

Bidatet që kanë të bëjnë me besimin quhen “itikadije”, ndërsa ato që kanë të bëjnë me punën dhe praktikimin quhen “amilije”.

- Bidat “itikadije” është besimi i diçkaje në kundërshtim me besimin e Profetit dhe shokëve të tij, qoftë ky besim i shoqëruar me punë ose jo.

Prej shembujve të bidateve “itikadije” është bidati i havarixhëve, mu’tezilëve, xhehmijve, kaderijve, rafidijve, murxhieve, dhe bidatet që degëzohen prej tyre. Ato janë të diferencuara në varësi të largësisë dhe afërsisë së tyre nga parimet e fesë.

- Bidat “amilije” është shpikja e një adhurimi në fe, të cilin nuk e ka ligjëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Çdo adhurim që nuk e ka ligjëruar Sheriati si detyrë ose si gjë të pëlqyeshme, është prej bidateve “amilije” (praktike).

Bidatet “amilije” ndahen në disa lloje:

a) Shpikja e një adhurimi që nuk ka origjinë dhe bazë në fe, si shpikja e një namazi të paligjshëm, një agjërimi të paligjshëm, ose një feste të paligjshme si festat e mevludeve (ditëlindjeve) etj.

b) Shtesa në një ibadet të ligjshëm, sikur të shtohet p.sh. një rekat në namazin e drekës ose të ikindisë.

c) Kryerja e adhurimit (ibadetit) të ligjshëm, në një formë apo mënyrë të paligjshme (të pabazuar në Kur'an dhe Sunet) si p.sh. bërja e dhikrit me zëra të bashkuar duke kënduar.

d) Veçimi (posaçërimi) i një kohe ose vendi për kryerjen e një adhurimi të ligjshëm në të, nëse nuk ka argument në Sheriat për një gjë të tillë, si p.sh. veçimi i ditës së 15-të të muajit Shaban për agjërime ditën dhe faljen e namazit nafile natën. Agjërime dhe namazi janë të ligjshëm, por veçimi i një kohe të caktuar për t'i bërë ka nevojë për argument.

5 - Ndarja e bidatit në “mukefire” (kufër që të nxjerr nga feja) dhe “jo mukefire” (të cilat nuk janë kufër që të nxjerr nga feja).

Bidatet, për sa i përket daljes ose mosdaljes së punuesit apo përqafuesit të tyre nga feja, ndahen në dy pjesë: bidate të cilat janë kufër dhe e nxjerrin thënësin, përqafuesin ose vepruesin e tyre nga feja, dhe bidate që nuk janë të tilla.

Përcaktimi i bidatit që të nxjerr nga feja është: çdo bidat (shpikje, risi) i cili konsiderohet kufër i madh që e nxjerr robin nga feja¹⁷.

Për të bërë dallimin ndërmjet bidatit që të nxjerr nga feja dhe atij që nuk të nxjerr prej saj, duhet të bëjmë dallimin ndërmjet gjërave që të nxjerrin nga feja dhe atyre që nuk të nxjerrin prej saj. Prandaj në vijim po përmendim disa pika, të cilat sqarojnë gjërat që janë kufër i madh, duke mos pasur për qëllim përfshirjen e kësaj teme, por thjesht për qartësim. Pra kufër i madh janë:

1) □ Mosbesimi në diçka që jemi urdhëruar për ta besuar, si Allahun e Lartësuar, melaiket, librat, të dërguarit, ringjalljen pas vdekjes dhe kaderin, ose përgënjeshtrimi i diçkaje që e ka sjellë i Dërguari i Allahut, nëse dihet në mënyrë të sigurtë që është prej fesë.

2) Mosbesimi i obligueshmërisë së detyrave të njohura, të dallueshme e “mutevatire”¹⁸, dhe mosbesimi që janë të ndaluara haramet e njohura, të dallueshme e “mutevatire”. Ai që mohon gjëra të tilla, bën kufër (del nga feja).

3) Veprimi i punëve ose haramëve që e kundërshtojnë dhe asgjësojnë besimin.

Haramet mund ta kundërshtojnë dhe asgjësojnë besimin ose jo. Nëse veprimi i tyre nuk e kundërshton dhe nuk e asgjëson besimin, si zinaja, pirja e alkoolit, vjedhja e të tjera gjynahe, vepruesi i tyre nuk del nga feja, sipas besimit unanimit të “ehli sunetit”. Kjo, nëse nuk e mohon faktin që këto vepra janë haram.

¹⁷) Kjo për sa i përket gjykimit të besimit, thënies dhe veprës, si dhe personave që i kanë këto probleme në përgjithësi, ndërsa për sa u përket personave të veçantë që bien në gjëra të tilla, rreth tyre do të sqarohet më gjerë inshaAllahu në kapitullin e tekfirit.

¹⁸) Transmetimi mutevatir është ai që përcillet nga një numër i madh transmetuesish, në mënyrë të njëpasnjëshme, brez pas brezi, gjë nga e cila përfitohet bindja se hadithet janë të saktë. Mutevatire, janë çështjet që arrijnë këtë nivel transmetimi.

Ndërsa, nëse veprimi i tyre e kundërshton dhe e asgjëson besimin krejtësisht, vepruesi i tyre bën kufër të madh, i cili e nxjerr nga feja.

Ibnul Kajim ka thënë: “Kufri i veprës ndahet në kufër që e asgjëson besimin dhe në kufër që nuk e asgjëson atë. Si shembull për atë që e asgjëson besimin janë: sexhdeja për idhullin, poshtërimi i Mus’hafit, vrasja e profetëve dhe sharja e tyre. Këto janë gjëra që e asgjësojnë besimin...”

Përcaktimi i bidateve, të cilat nuk janë kufër që të nxjerr nga feja është: çdo bidat që nuk është kufër i madh, d.m.th. që nuk përfshihet në njërën nga pikat që i përmendëm më lart.

Bidatet që nuk e nxjerrin punuesin apo përqafuesin e tyre nga feja islame, ndahen në bidate të mëdha dhe në bidate të vogla, kjo duke marrë parasysh diferencën e gradave të bidateve, ashtu sikurse edhe gjynahet ndahen në të mëdha dhe të vogla.

Bidatet e mëdha, sipas Shatibiut, janë ato që përbëjnë cënim për pesë domosdoshmëritë të cilat janë: feja, njeriu, pasardhja (pasardhësit), mendja dhe pasuria. Mbrojtja e këtyre pesë gjërave është e domosdoshme, kështu që bidatet e mëdha janë ato që i cënojnë këto pesë domosdoshmëri, ndërsa të tjerat janë të vogla.

Imam Shatibiu ka sqaruar se të gjitha bidatet në fe, janë humbje, siç ka thënë i Dërguari i Allahut: “Ruhuni nga shpikjet në çështjet e fesë, se çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje.” Transmeton ebu Davudi dhe Tirmidhiu. Hadithi është i saktë.

Gjithashtu ai ka sqaruar se gjynahu i personit që bie në bidat nuk është i një grade. Gjynahu i tij renditet në shkallë të ndryshme, në varësi të aspekteve që vijnë:

1- Shpikësi, punuesi apo përqafuesi i bidatit, pretendon që është “mushtehid” apo “mukalid.”

2- Bidati i tij ka të bëjë me ato që përbëjnë cënim për gjërat e domosdoshme që u përmendën më lart, apo ka të bëjë me gjëra të tjera.

3- Shpikësi, punuesi apo përqafuesi i bidatit e fsheh atë, apo e publikon.

4- Fton në bidatin e tij apo nuk fton në të.

5- A është jashtë “ehli sunetit” apo brenda tij.

6- Bidati i evidentuar është “hakikij” apo “idafij”.

7- Bidati është në çështje të qarta apo në çështje konfuze e të paqarta.

8- Bidati është kufër apo jo.

9- A është këmbngulës në bidatin e tij apo jo.

Të gjitha këto aspekte, janë faktorë që ndikojnë në shkallën e bidatit dhe si rrjedhojë në gjynahun e tij, për sa i përket gradës.

Nga kjo që sqaruar mësuam se bidatet, për sa i përket rangjeve të gjynahut, ndahen në tre pjesë:

- 1 - Ato që janë kufër i qartë.
- 2 - Ato që janë mëkate të mëdha
- 3 - Ato që janë mëkate të vogla.

Në mënyrë që bidati të konsiderohet mëkat i vogël ka disa kushte, të cilat nëse nuk plotësohen, bidati shndërrohet në mëkat të madh. Ato janë siç vijon:

Kushti i parë: Të mos e veprojë në mënyrë të vazhdueshme, sepse vazhdimësia në të drejtën e tij e kalon në mëkat të madh.

Kushti i dytë: Të mos ftojë në të, sepse kjo e zmadhon gjynahun, ngaqë bën të punohet dhe të përhapet më shumë.

Kushti i tretë: Të mos e veprojë në vendtubimet e njerëzve dhe as në vendet ku shfaqen dhe zbatohen sunetet.

Kushti i katërt: Të mos e nënvlerësojë dhe të mos e konsiderojë të vogël, sepse kjo tregon mospërfillje. Mospërfillja e gjynahut është më e madhe se sa vetë gjynahu.

Ndarja e bidateve në pesë lloje: të detyruara, të ndaluara, të pëlqyeshëm, të urryera (të papëlqyeshme, mekruh) dhe të lejuara, është e pavlefshme dhe e pasaktë. Asnjë argument nuk tregon për të. Madje ajo është ndarje kontradiktore.

Kjo ndarje është një gjë e shpikur dhe e pabazuar në ndonjë argument fetar. Madje është kontradiktore, pasi realiteti i bidatit është që të mos dëshmojë për të asnjë argument fetar, qoftë nga tekstet e Sheriatit apo nga bazat e tij. Sikur të kishte ndonjë argument fetar që tregon për të qenët e diçkaje detyrë, e pëlqyeshme ose e lejueshme, në këtë rast ajo nuk do të ishte bidat, por praktikimi i saj do të përfshihej në tërësinë e punëve për të cilat jemi urdhëruar t'i veprojmë, ose në tërësinë e atyre që është lënë në vullnetin tonë t'i kryejmë ose jo. Pra, pohimi i diçkaje si bidat dhe pohimi i obligueshmërisë, pëlqimit ose lejimit të saj me argument, është bashkim ndërmjet dy gjërave të kundërta.

Shembujt që kanë përmendur për bidatet të cilat janë vaxhib (sipas tyre), u përkasin të gjithë “el mesalihul murseletu” (interesave të lira) dhe nuk janë bidate të shpikura. Sahabët dhe ata që i pasuan, i kanë pranuar dhe kanë punuar me “el mesalihul murselah”, të cilat janë prej parimeve të Fikhut. Ndër ato që kanë përmendur është grumbullimi i Kur’anit në kohën e sahabëve. Kjo gjë pa dyshim është prej “el mesalihul murseleh”, dhe nuk është bidat.

Falja e taravive me xhemat në Ramazan, siç u veprua në kohën e Umerit me urdhër të tij, e cila sipas tyre është bidat i pëlqyeshëm, nuk është bidat, sepse i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) e bëri një gjë të tillë në xhaminë e tij.¹⁹

Shpikja e gjërave të lejueshme nuk është prej bidateve në fe, sepse ato kanë të bëjnë me lehtësimin në këtë dynja. Për atë që kënaqet e argëtohet me gjëra të lejuara, nuk mund të thuhet se ka shpikur e vepruar bidate. Kjo gjë, nëse do të konsiderohej e ndaluar, do të ishte e tillë për shkak të shpërdorimit dhe teprimit.

Si shembull këtu për gjërat e lejuara, të cilat janë konsideruar bidat i lejuar nga ata që kanë bërë ndarjen e lartpërmendur, mund të përmendim sitat, të cilat u shpikën pas kohës së Profetit (salallahu alejhi ue selem). Mbështetur në faktin që janë shpikur pas kohës së Profetit (salallahu alejhi ue selem), i kanë konsideruar “bidat i lejuar”. Por ky nuk është fakt i vlefshëm për t’i konsideruar bidat në fe, sepse ato kanë të bëjnë me kënaqësitë e dynjasë dhe jo me çështjet e fesë, kështu që si të tilla nuk konsiderohen bidate.²⁰

Po kështu edhe ndarja e bidateve në të mira dhe të këqija, nuk është e saktë.²¹

Kush cilësohet “bidatçi”

Është shumë e rëndësishme të njohim bidatet, për të cilat shpikësi, përqafuesi i tyre ose punuesi me to, cilësohet “bidatçi”, sepse bidatet janë të ndryshme dhe të diferencuara, sikurse e sqaruar. Nëse do të cilësohej “bidatçi” çdo njeri që bie në bidat, pa marrë parasysh se i çfarë lloji është bidati dhe i çfarë rangu është gjynahu i tij, nuk do të shpëtonin pa u cilësuar “bidatçinjtë” edhe shumë dijetarë të mëdhenj, të cilët kanë rënë në bidate “idafije” ose bidate që lidhen me çështjet “ixhtihadije.” Prandaj dijetarët e Umetit tonë, kanë vendosur një rregull të qartë i cili sqaron se për cilin bidat bëhet personi “bidatçi” dhe për cilin jo.

Në lidhje me këtë çështje ibnu Tejmija ka thënë: “Bidati, për shkak të të cilit njeriu konsiderohet prej ‘ehlil ehva’ (bidatçinjtë që ndjekin epshtet dhe dëshirat), është ai bidat, i cili është bërë i njohur te dijetarët e sunetit, si i tillë që bie në kundërshtim me Kur’anin dhe Sunetin, si p.sh. bidati i havarixhëve, rafidijve, kaderijve, dhe murxhijeve.”

¹⁹⁾ Shiko për më gjerë librin e shejh Abbadit.....

²⁰⁾ Për më gjerë të lexohet “El i’ tislam” i Shatibiut, 1/241 dhe faqet në vijim.

²¹⁾ Shiko librin e shejh Abbadit faqen ...

Nga kjo që përmendi ibnu Tejmija, mësojmë se rregulli me të cilin dallojmë bidatçinjtë nga ata që nuk janë të tillë, është siç vijon:

“Bidatçi” cilësohet personi, bidati i të cilit është bërë i njohur tek dijetarët, si i tillë që bie në kundërshtim me Kur’anin dhe Sunetin, për arsye se ka të bëjë me çështje të qarta e të njohura, kushdo qoftë përqafuesi ose punuesi i tij, i ditur apo njeri i thjeshtë (i paditur). Ndërsa për çështjet e hollësishme, të cilat janë të tilla që e vërteta rreth tyre mund të jetë e paqartë për shumë njerëz, muslimani nuk cilësohet “bidatçi”.²²

Disa shenja të bidatçinjve

1) Ndjekja e epshit.

Allahu i lartësuar ka lajmëruar për këtë gjë në Kur’an ku ka thënë: **“A e ke parë atë i cili merr nefsin e tij për ilah (të adhuruar, për zot) dhe Allahu duke e ditur (atë si të tillë) ia humbi rrugën dhe ia vulosi atij të dëgjuarit e zemrën e tij dhe ia mbuloi shikimin? Kush pra do ta udhëzojë atë pos Allahut? A nuk do të përkujtoni pra?”** El Xhathije: 23.

Ibnu Kethiri ka thënë: “D.m.th. zbaton atë që ia dikton epshi dhe dëshira e tij, çdo gjë që e mendon të mirë e bën dhe çdo gjë që e mendon të keqe e le. Ky ajet vlen si argument kundër mendimit të mu’tezilëve, të cilët i vlerësojnë gjërat të mira ose të këqija (të shëmtuara) sipas logjikës së tyre.”

2) Përçarja.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Vërtet me ata që e ndajnë fenë e tyre dhe shpërndahen në sekte e grupe (të çfardo lloji qofshin), ti (o Muhamed) muk ke aspak të bësh. Puna e tyre është vetëm tek Allahu, i Cili pas kësaj do t’u tregojë atyre çfarë ata vepronin.”** El En’am: 159.

Ibnu Kethiri në komentin e tij ka thënë: “Ky ajet përfshin të gjithë ata që ndahen nga feja e Allahut dhe e kundërshtojnë atë. Allahu e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e drejtë për ta bërë të ngadhënjejë mbi të gjitha fetë. Feja dhe ligji i Allahut është një, nuk ka në të as mosmarrëveshje dhe as përçarje. Ata që krijojnë përçarje e mosmarrëveshje në lidhje me të, dhe si rrjedhojë kthehen në grupe e parti, si puna e ithtarëve të feve, sekteve, dëshirave dhe humbjeve, nga të tillë njerëz i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) është i pastër dhe i shfajtuar, siç ka lajmëruar Allahu i Lartësuar.”

²²⁾ Ata që i bëjnë bidatçinj muslimanët për çfardolloy bidati, sado i vogël që të jetë gjynahu i tij dhe sado e paqartë të jetë çështja e tij, dhe si rrjedhojë ndërmarrin ndaj tyre qëndrimet më eksreme që dijetarët kanë pasur ndaj bidatçinjve, si puna e mu’tezilëve e të tjerë, bëjnë gabim, sepse nuk respektojnë rregullin që u sqarua më lart.

Po ashtu edhe ibnu Tejmija ka theksuar se simboli i grupeve të bidatçinjve është përçarja.

3) Ndjekja e argumenteve të paqarta.

Për këtë cilësi të tyre Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Është Ai i Cili të ka zbritur ty Librin. Në të ka vargje plotësisht të qarta të cilat janë themelet e Librit dhe të tjera jo krejt të qarta për t’u kuptuar nga njerëzit (muteshabihat). Kështu, sa për ata në zemrat e të cilëve ka largim nga e vërteta, ata ndjekin atë që nuk është plotësisht e qartë, në këtë mënyrë duke kërkuar Fitneh (mosbesim, sprovim, trazira, fatkeqësi etj.) dhe duke kërkuar interpretimin e saj....”** Ali Imran: 7.

Buhariu transmeton nga Aishja e cila thotë se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) lexoi këtë ajet dhe lidhur me të tha: “Kur të vëresh ata që ndjekin atë që nuk është plotësisht e qartë, dije se për këta ka folur Allahu në ajetin e Kur’anit dhe prandaj ruhuni prej tyre.”

Është transmetuar se Umeri ka thënë: “Do të vijmë njerëz që dialogojnë me ju duke përmendur ajetet që nuk janë krejtësisht të qarta, prandaj dialogoni me ta duke u përmendur sunetet, sepse përcjellësit e Sunetit, të diturit rreth tij dhe pasuesit e tij e njohin më mirë Librin e Allahut.”

4) Kundërshtimi i Sunetit me anë të Kur’anit.²³

Prej shenjave të bidatçinjve është kundërshtimi i Sunetit me anë të Kur’anit dhe pretendimi se Kur’ani është i mjaftueshëm për ligjet dhe rregullat e Sheriatit, ndërsa Suneti, sipas tyre nuk është i nevojshëm.

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka lajmëruar për këtë shenjë të tyre në një hadith të saktë ku thotë: “Është afruar koha kur një burri prej Umetit tim t’i arrijë hadithi nga unë, ndërkohë që është i ulur mbi kolltukun e tij, dhe ai të thotë: ‘Ndërmjet nesh dhe ndërmjet jush është libri i Allahut’, prandaj atë që në të është përmendur hallall, e bëjnë hallall, dhe atë që është përmendur në të haram, e bëjnë haram. Vërtetë ajo që e ka bërë haram i Dërguari i Allahut është si ajo që e ka bërë haram Allahu i Lartësuar.” Transmeton Tirmidhiu.

Imam Berbehariu ka thënë: “Kur të dëgjosh që burri i hedh poshtë thëniet dhe gjurmët e transmetuara, i refuzon ose synon diçka tjetër e jo ato, akuzoje atë në fenë e tij dhe mos ki asnjë mëdyshje se ai është ndjekës i epshit, bidatçi.”

5) Urrejta e pasuesve të gjurmëve të të parëve.

²³) D.m.th. kur i përmenden hadithet e Profetit (salallahu alejhi ue selem), pretendon që bien në kundërshtim me Kur’anin dhe kështu me këtë pretekst, sipas tij duhen refuzuar. Në realitet hadithet e sakta të Profetit (salallahu alejhi ue selem) nuk mund të bien në kundërshtim me Kur’anin.

Prej shenjave të bidatçinjve është urrejtja ndaj atyre që e njohin dhe e pasojnë hadithin dhe gjurmët e të parëve, si dhe përgojimi e shpifja ndaj tyre.

Ahmed el Kattan ka thënë: “Nuk ka në dynja ndonjë bidatçi që nuk i urren pasuesit e hadithit.”

Ebu Hatim err-Rrazi ka thënë: “Shenja e bidatçinjve është përgojimi dhe shpifja ndaj pasuesve të gjurmëve të të parëve, dhe shenja e ‘zindikëve’²⁴ është të emërtojnë ‘ehli sunetin’, ‘hashavije’. Ata nëpërmjet kësaj synojnë të hedhin poshtë gjurmët e transmetuara.”

6) Mosndjekja e rrugës së të parëve të këtij Umeti.

7) Cilësimi i kundërshtarëve të tyre “kafirë”, pa pasur argument.

Qëndrimi i selefëve (të parëve) ndaj bidatçinjve

Njohja e qëndrimit të selefijve ndaj bidatçinjve në drejtime dhe aspekte të ndryshme, si dhe e parimeve që i rregullojnë këto qëndrime, e mbron muslimanin nga konfuzioni dhe rrëmuja që shkaktohet si rrjedhojë e mosnjohjes së tyre. Gjithashtu i bën qëndrimet e tij të drejta e të dobishme, dhe jo të padrejta e shkatërruese.

Për të vënë në dukje rëndësinë e njohjes së kësaj teme, do të sqarojmë disa çështje që kanë të bëjnë me qëndrimin e të parëve (selefëve) ndaj bidatçinjve.

1 - Nga selefët e këtij Umeti është transmetuar se ata i urrenin bidatçinjtë dhe i urdhëronin njerëzit t'i urrenin, të mos uleshin dhe të mos shoqëroheshin me ta, të mos i dëgjonin fjalët e tyre dhe të mos dialogonin me ta. Dijetari i famshëm Ismail es-Sabuni, gjatë përshkrimit të besimit të selefëve dhe pasuesve të hadithit thotë: “Ata i urrejnë bidatçinjtë të cilët shpikën në fe atë që nuk është prej saj, nuk i duan, nuk shoqërohen me ta, nuk i dëgjojnë fjalët e tyre, nuk ulen me ta dhe nuk debatojnë e nuk dialogojnë me ta në çështjet e fesë.” Por nga ana tjetër, dijetarët e Akides sonë kanë përmendur se njerëzit që nuk cilësohen “kafirë”, duhen për aq besim e mirësi sa kanë, dhe urrehen për aq të keqe sa kanë.

Ibnu Tejmija ka thënë: “Besimtari e ka për detyrë të urrejë e të armiqësojë për hir të Allahut, dhe të miqësojë e të dojë për hir të Allahut. Përderisa njeriu është besimtar, e kemi për detyrë ta duam, edhe sikur të na ketë bërë padrejtësi.

²⁴) Zindikët janë kafirët që shtiren si muslimanë për të luftuar Islamin, të maskuar nën petkun islam.

Padrejtësia nuk është arsye për ndërprerjen e dashurisë dhe miqësisë që na e obligon besimi. Allahu ka thënë:

‘Në qoftë se dy palë prej muslimanëve bien në luftë, bëni marrëveshje (paqe) ndërmjet tyre. Në qoftë se ndonjëra prej tyre ngre krye kundër tjetrës, atëherë të gjithë ju bashkarisht luftoni ndaj atyre që ngritën krye të parët, derisa të veprojnë në përputhje me urdhërin e Allahut. Pas kësaj, në qoftë se pajtohen, vendosni paqe ndërmjet tyre me drejtësi dhe bëhuni të paanshëm në gjykim. Vërtet Allahu i do ata që janë të paanshëm. Pa dyshim besimtarët janë vëllezër.’ Huxhuratë: 8-9.

Allahu i ka konsideruar të dy palët vëllezër dhe urdhëroi për t’i pajtuar, megjithëse ndërmjet tyre ekzistoi lufta dhe padrejtësia.”

Le të meditojë thellë besimtari mbi ndryshimin ndërmjet dy llojeve të bojkotit, sa të shumtë janë ata që u përzihet njëri lloj me tjetrin. Le ta dijë se është detyrë ta dojë besimtarin, ta afrojë dhe të miqësohet me të, edhe nëse i bën padrejtësi e mizori. Kurse kafirin është detyrë ta urrejë dhe ta armiqësojë, edhe nëse i jep e i bën mirësi. Allahu i Lartësuar i ka dërguar të dërguarit dhe i ka zbritur Librat që të adhurohet i vetëm; të jetë dashuria për të dashurit e Tij dhe urrejtja për armiqtë e Tij; nderimi të jetë për të dashurit e Tij dhe poshtërimi për armiqtë e Tij; shpërblimi të jetë për miqtë e Tij dhe ndëshkimi për armiqtë e Tij.

Kur bashkohen në një person të vetëm e mira dhe e keqja, shthurja dhe bindja ndaj Allahut, mëkatet dhe veprat e mira, sunetet dhe bidatet, meriton miqësi dhe shpërblim sipas të mirës që ka dhe meriton armiqësi e ndëshkim sipas sherrit (të keqes) që ka. Pra, mund të bashkohen në një person të vetëm gjërat që e bëjnë të nderohet dhe gjërat që e bëjnë të poshtërohet, si puna e hajdutit të varfër, të cilit i pritet dora për vjedhjen e pasurisë dhe i jepet nga shtëpia e pasurisë aq sa i mjafton për nevojën e tij.

Kjo është baza për të cilën ka rënë dakord “ehli suneti dhe xhemati” dhe e kanë kundërshtuar huarixhët, mu’tezilët dhe fraksionet e tyre që janë pajtuar me ta. Huarixhët thonë se njerëzit meritojnë vetëm shpërblim, ose meritojnë vetëm dënim, kurse “ehli suneti” thotë se Allahu do të ndëshkojë me zjarr atë që dëshiron prej njerëzve që kanë punuar mëkate të mëdha, pastaj me shefatin (ndërmjetësimin) e atyre që Ai u lejon të ndërmjetësojnë, do t’i nxjerrë me

Mirësinë e Tij, siç ka ardhur në hadithe të shumta nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem).

2 - Është transmetuar se selefët nuk shoqëroheshin dhe nuk uleshin me bidatçinjtë, d.m.th. i bojkotonin ata, siç u përmend më parë në thënien e Ismail es-Sabunit. Por në lidhje me bojkotimin e tyre duhet të kemi parasysh rregullat, në mënyrë që të mos shkaktojmë dëm më të madh për muslimanët se sa dëmi i bidatit që vërehet tek bidatçi.

Këto rregulla janë siç vijon:

a) Të jetë ekzistenca e bidatit tek personi për të cilin bëhet fjalë, diçka e sigurtë. Kështu që nuk është e mjaftueshme të mbështetesh në fjalët që përhapen e qarkullojnë mes njerëzve rreth një personi, por patjetër duhet të sigurohesh duke i dëgjuar fjalët e tij, duke i parë punët e tij, ose duke lexuar shkrimet e tij, sidomos në këtë kohë, kur devotshmëria është e pakët, njerëzit e besueshëm janë të rrallë, konkurenca dhe hasedi (smira) mes njerëzve është shtuar, dhe akuzat për humbje dhe bidat janë bërë një gjë shumë e lehtë.

b) Të jetë bidati, i llojit për të cilin dijetarët e “ehli sunetit” janë pajtuar se është bidat. Prandaj nuk lejohet bojkotimi për gjërat që dijetarët e “ehli sunetit” janë në mosmarrëveshje në lidhje me konsiderimin e tyre bidat ose jo, as për gjëra që dijetari nuk është i qartë në lidhje me argumentin e tyre dhe mënyrën se si arsyetohen, dhe as për gjëra të cilat konsiderohen prej çështjeve të ixhtihadit, për të cilat muslimani kurrsesi nuk cilësohet “bidatçi”. Shumë njerëz që kanë pasion për të bojkotuar, përgojuar e paralajmëruar, këto qëndrime i mbajnë për gjëra që nuk janë bidat, ose që janë bidat, por njeriu për shkak të tyre nuk cilësohet “bidatçi”.

c) Nëse personi ndaj të cilit kërkohet të mbahet qëndrim, nuk e di që çështja në fjalë është bidat ose nuk e ka kuptuar atë, para se të bojkotohet duhet t’i bëhet e qartë e vërteta.

d) Të realizohet nëpërmjet bojkotimit qëllimi i tij fetar. Sheriati e ka ligjëruar bojkotimin e bidatçiut për të realizuar dy synimet që vijojnë:

- Edukimin e bidatçiut dhe largimin e tij nga bidati. Nëpërmjet këtij qëllimi synohet të realizohet ajo që është e dobishme për vetë bidatçiun.

- Nga frika se mos dëmtohet ai që ulet dhe shoqërohet me të, d.m.th. bëhet për shmangien e së keqes dhe parandalimin e saj. Kështu mbrohet shoqëria

islame nga dëmet e ideve dhe mendimeve që përhapen si rrjedhojë e shoqërimit me bidatçinjtë.

Nga kjo rezulton se bojkotimi i bidatçinjve nuk është i ligjshëm në çdo rast dhe as me çdo njeri. Nëse i përmbush objektivat për të cilat është ligjëruar, bëhet bojkoti, ndryshe nuk është i ligjshëm.

Ibnu Tejmija ka thënë: “Të këqijat e dukshme është detyrë që të ndryshohen dhe të ndalohen, ndryshe nga të padukshmet, sepse ndëshkimi i tyre prek vetëm vepruesin dhe jo të tjerët. Ky lloj ‘hexhri’ ndryshon sipas fuqisë ose dobësisë së bojkotuesve, si dhe pakicës ose shumicës së tyre, sepse qëllimi është që të pengohet i bojkotuari si dhe të edukohet dhe të parandalohet masa e njerëzve që të mos pasojë punën e tij. Nëse dobia e bojkotimit është më e madhe, në kuptimin që ndikon në dobësimin, minimizimin dhe fshehjen e së keqes, atëherë ai është i ligjshëm. Ndërsa, nëse bojkotimi nuk e parandalon as të bojkotuarin dhe as të tjerët, por përkundrazi ua shton të keqen, që do të thotë se dëmi i tij është më i madh se dobia e tij, për arsye se bojkotuesi është i dobët, në këtë rast ai nuk është i ligjshëm. Madje për disa njerëz afrimi është më i dobishëm se bojkotimi dhe largimi, ndërsa për disa të tjerë bojkotimi dhe largimi është më i dobishëm se afrimi. Për këtë arsye i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) i afronte disa njerëz dhe përpiqej t’ua zbuste zemrat, ndërsa disa të tjerë i bojkotonte. Kështu p.sh. tre personat që i bojkotoi i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) vetë, ishin më të mirë se shumica e njerëzve që ai përpiqej t’ua zbuste zemrat. Duke qenë se këta të fundit ishin kryetarë të respektuar nga fiset e tyre, Profeti (salallahu alejhi ue selem) përpiqej t’ua fitonte zemrat. Kurse tre personat ishin besimtarë të thjeshtë, dhe besimtarë si ata kishte shumë, prandaj bojkotimi i tyre ishte krenari për fenë dhe pastrim për mëkatet e tyre, ashtu siç është e ligjshme lufta kundrejt armikut ndonjëherë dhe marrëveshja ose marrja e xhizjes ndonjëherë tjetër. Të gjitha këto sipas gjendjes dhe dobive.

Përgjigjja e imamëve si Ahmedi e të tjerë në lidhje me këtë temë, është bazuar mbi këtë parim. Për këtë arsye ai bënte dallim ndërmjet vendeve që kishte shumë bidate, siç ishte me shumicë bidati në çështjet e kaderit në Basra, tenxhimi (astrologjia, horoskopi) në Horasan ose shiizmi në Kufe, dhe vendeve që nuk ishin ashtu. Po kështu bënte dallim mes prijësve që u binden njerëzit dhe

të tjerëve që nuk janë të tillë. Ai kur e njihte synimin e Sheriatit në lidhje me diçka, ndërmerre rrugën më të arrirë për ta realizuar.

3 - Është transmetuar nga selefët mosdialogimi me bidatçinjtë dhe ndalimi i dialogimit me ta siç e përmendëm më lart. Por nga ana tjetër është transmetuar se disa selefë kanë dialoguar me bidatçinjtë, si p.sh. Abdullah ibnu Abbasi me havarixhët dhe Umer ibnu Abdil Aziz me Gajlan ed-Dimeshki el Kaderi, derisa ky i fundit u mund, heshti dhe deklaroi teuben (pendimin). Evzaiu, pasi një kaderi i kërkoi dialog, bëri dialog me të dhe e mundi. Imam Ahmedi, në prani të Halifes së abasitëve ka dialoguar me xhehmijtë, e të tjera raste.

Për këtë arsye duhet të njohim se kur lejohet dhe kur nuk lejohet dialogimi me ta, dhe të mos e ndalojmë atë në mënyrë absolute. Qëndrimet e selefëve janë të lidhur me objektiva dhe qëllime që synonin t'i realizonin, prandaj ato ndryshonin në varësi të përmbushjes së këtyre objektivave. Ata që i njohin synimet dhe parimet e Sheriatit, e dinë se qëndrimet e tyre janë në pajtim me to dhe nuk janë kontradiktore, ndërsa ata që nuk i njohin, do të gjykojnë se janë kontradiktore, ose do të marrin një pjesë dhe do të lenë një pjesë tjetër.

4 - Të parët tanë kanë folur kundër bidatçinjve, i kanë vënë në dukje devijimet e tyre dhe i kanë paralajmëruar njerëzit që të ruhen prej tyre. Ata kanë përmendur që të folurit kundër tyre është i barazvlefshëm me xhihadin në rrugë të Allahut, madje edhe më mirë. Ibnu Tejmije ka thënë: “Është detyrë, sipas gjykimit unanim të muslimanëve, të paralajmërohet Umeti për t'u ruajtur nga prijësit e bidatit, të cilët kanë besime dhe mendime që kundërshtojnë Kur'anin dhe Sunetin, aq sa i është thënë Ahmed ibnu Hambelit: ‘Burri që falet, agjëron dhe bën i'tikaf është më i dashur tek ti, apo ai që flet kundra bidatçinjve?’. Ka thënë: ‘Kur çohet për t'u falur ose kur bën i'tikaf, prej kësaj gjëje përfiton vetë, ndërsa kur flet kundër bidatçinjve, kjo është një gjë e dobishme për muslimanët, kështu që është më e mirë’.” Pastaj Ibnu Tejmija ka vijuar me sqarimin se të folurit kundër bidatçinjve është një gjë e dobishme nga ana fetare për muslimanët në përgjithësi. Sipas tij, të folurit kundër tyre përfshihet në xhihadin që bëhet në rrugë të Allahut.

Në këtë kuadër, të parët tanë e kanë lejuar përgojimin e bidatçinjve, madje e kanë konsideruar detyrë, nëse nuk mund të dënohet, të hidhet poshtë bidati dhe të paralajmërohet rreth bidatçiu me ndonjë mënyrë tjetër përveç përgojimit (gibetit).

Hasen Basriu ka thënë: “Në diskutimin kundër bidatçinjve nuk ka gibe.”

Imam Neveviu ka thënë: “Dije se gibeti lejohet kur muslimani ka qëllim fetar të saktë, të cilin nuk mund ta arrijë veçse nëpërmjet tij, për gjashtë

shkaqe.” Ndër shkaqet ka përmendur: “I katërti, paralajmërimi i muslimanëve që të ruhen nga e keqja dhe këshillimi i tyre. Kjo bëhet në disa raste...” Pastaj ka thënë: “Prej rasteve është kur vëren një kërkues dije e Fikhu që shkon për të marrë dije prej një bidatçiu ose prej një të shthururi dhe frikësohet se mos ai dëmtohet e preket nga kjo gjë. Atëherë duhet ta këshillojë duke i përmendur gjendjen e tij, por me kusht që të synojë këshillimin e sinqertë. Mirëpo kjo është prej gjërave që njerëzit gabojnë në to, se ndoshta diskutuesin e nxit smira për të përgojuar, shejtani ia mbulon gabimin, ia errëson gjërat dhe e bën të mendojë se po këshillon sinqerisht. Për këtë gjë duhet të jemi të vëmendshëm.”

Duhet të sqarojmë se thëniet e selefëve të cilat tregojnë se lejohet përgojimi i bidatçinjve, nuk bien në kundërshtim me argumentet që e ndalojnë përgojimin, sepse ato kanë për qëllim të përmendësh për muslimanin diçka që e urren, pa ndonjë dobi fetare, ndërsa qëllimi i selefëve në lejimin e gibetit, është kur ka shkak fetar që e lejon. Por, megjithëse lejimi i përgojimit të bidatçiut është një gjykim i konfirmuar nga selefët, duhet të jemi të rezervuar te ata që nuk e kuptojnë qëllimin e përdorimit të shprehjes “në diskutimin kundër bidatçinjve nuk ka gibe”, ose shprehje të tjera të cilat janë në kuptimin e saj. Kur diskutojmë me njerëz të tillë nuk duhet t’i përdorim këto shprehje veçse duke u sqaruar atyre kuptimin e saktë të këtyre shprehjeve, në mënyrë që të mos mendojë ai që i dëgjon, se motivi i përdorimit të tyre është epshi ose ndonjë armiqësi jofetare ndaj bidatçinjve. Këtë gjë duhet ta kemi parasysh, sidomos në këtë kohë ku ata që i njohin qëndrimet e selefëve ndaj bidatçinjve janë pak, aq sa disa i keqkuptuan dhe menduan se ato bien ndesh me argumentet e Kur’anit dhe Sunetit. Madje disa të devijuar nga rruga e selefëve i shfrytëzuan për të shpifur ndaj selefëve dhe besimit të tyre të pastër. Si shkak për këtë ka shërbyer fakti që disa kërkues dije kanë përcjellë thënie të tilla nëpër hutbe, ligjërata, kuvende të veçanta dhe publike, pa e sqaruar kuptimin e tyre dhe qëllimin e selefëve në përdorimin e tyre.²⁵ Kështu që është detyrë për atë që përdor

²⁵) Thëniet e selefëve në lidhje me bojkotimin dhe përgojimin e bidatçinjve janë të shumta. Ato janë përmbledhur në shumë libra, kështu që leximi dhe transmetimi i tyre është mjaftë i lehtë. Por kjo gjë nuk tregon detyrimisht që transmetuesi ose përdoruesi i tyre i njeh rregullat që kanë të bëjnë me bidatin, dhe qëllimet që selefët synuan t’i arrijnë. Ka njerëz që i përmendin këto thënie, si p.sh. thënien e lartpërmendur të Ibnu Tejmijes, duke pasur për qëllim shfrytëzimin e tyre për përgojimin e “ehli sunetit.” Këtë gjë disa prej tyre e bëjnë të motivuar nga epshet. Ata cilësojnë “bidatçi” “ehli sunetin”, dhe si rrjedhojë i mveshin atij atë që dijetarët e kanë thënë kundër bidatçinjve. Pra, i përgojnë pasuesit e sunetit me pretekstin se janë duke përgojuar bidatçinjtë. Ndërsa disa të tjerë e bëjnë nga padituria. Atyre u është përzier e pavërteta me të vërtetën. Duke dëgjuar thëniet e selefëve kundër bidatçinjve, të cilat i përmendin të parët pa sqaruar kuptimin dhe qëllimin e tyre, i keqkuptojnë dhe përfshihen në rrëmujën e përgojimit e akuzimit të pasuesve të sunetit që i rrethojnë.

E këshillojmë kategorinë e parë t’i frikësohen Allahut dhe t’i lënë këto ngatarrësa që janë duke i shkaktuar me dije, sepse ndryshe përfundimin do ta kenë me pasoja shumë të rënda. Allahu ka thënë në Kur’an: “...Kësisoj Allahu

shprehje të tilla të transmetuara nga selefët, që t'u sqarojë njerëzve qëllimin e tyre dhe t'u japë kuptimin e saktë që përputhet me parimet e Sheriatit. Madje, nëse disa shprehje i keqkuptojnë njerëzit, më parësore është që të zëvendësohen me shprehje të tjera, të cilat e përçojnë kuptimin pa shkaktuar paqartësi. Selefët me anë të këtyre shprehjeve u janë drejtuar kërkuesve të dijes të cilët i kuptonin synimet e tyre. Nuk është shenjë urtësie dhe mençurie t'i drejtohesh masës së njerëzve sot me këto shprehje, nën pretekstin se janë transmetuar nga selefët, pa e shpjeguar kuptimin dhe pa sqaruar qëllimin e selefëve. Pas gjithë kësaj që sqaruar, duhet të mësojmë gjithashtu se përgojimi i bidatçiu ka disa kushte, të cilat nëse plotësohen, lejohet, ndryshe përgojimi mbetet i ndaluar sipas origjinës.

Kushti i parë. Sinqeriteti dhe këshillimi i muslimanëve me çiltërsi e pastërti.

Ibnu Tejmija, pas diskutimit rreth përgojimit të bidatçiu ka thënë:

“Diskutuesi që flet me dije për këto gjëra, patjetër duhet të ketë qëllim të mirë. Prandaj sikur të flasë drejt, duke synuar kryelartësinë në tokë ose shkatërrimin, ai është si puna e atij që lufton me fanatizëm dhe syfaqësi. Ndërsa, nëse flet për hir të Allahut, do të jetë prej atyre që bëjnë xhihad në rrugë të Allahut, prej trashgimtarëve të profetëve dhe zëvendësuesve të tyre (në dave dhe përcjelljen e dijes).”

Kushti i dytë. Që bidatçiu ta shfaqë bidatin dhe ta publikojë atë, kurse nëse e fsheh, nuk lejohet përgojimi i tij dhe as demaskimi i tij për këtë gjë, sepse përgojimi i bidatçiu përfshihet në dënimin dhe ndalimin e së keqes.

Kjo gjë nuk bëhet veçse kur e keqja veprohet haptazi.

Kushti i tretë. Të jetë i gjallë bidatçiu për të cilin flitet, dhe jo i vdekur.

Nëse është i vdekur nuk lejohet përgojimi i tij, as përmendja e bidateve të tij dhe as sharja e tij për to pas vdekjes, sepse i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), siç ka ardhur në “Sahihun” e Buhariut ka thënë: “Mos i shani të vdekurit, sepse ata kanë shkuar tek ajo që kanë vepruar për vetet e tyre.” Bëhet përjashtim në rastet kur i vdekuri ka shkruar libra që përmbajnë bidate, ose ka pasues që i përhapin bidatet pas tij. Nëse është kështu, atëherë paralajmërohet rreth tij.

nxjerr në shesh të vërtetën nga e pavërteta. Pastaj shkuma kalon si zgjyrë mbi brigjet e lumit, ndërsa ajo që është për të mirën e njerëzve mbetet në tokë...” Err-Rrad: 17.

Ndërsa kategorinë e dytë (të paditurit), përsëri e këshillojmë t'i frikësohen Allahut, të mos flasin për gjëra që nuk kanë dije, dhe të mos mashtrohen me njerëz të cilët punojnë për qejfet, dëshirat dhe pasionet e tyre në dëm të Umetit. Kur të dëgjojnë thënie të selefëve kundër bidatçinjve, të mos nxitohen e t'ia mveshin “ehli sunetit”.

Kushti i katërt. Kur përgojon bidatçiu duhet të jetë i drejtë dhe të mos përmendë gjë tjetër përveç bidatit që ai ka, dhe të mos shpifë ndaj tij gjëra të këqija që i largojnë njerëzit prej tij, të cilat ai nuk i ka.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“O ju që keni besuar! Jini të fortë për Allahun dhe jini dëshmitarë të drejtë e mos lejoni që armiku dhe urrejtja ndaj të tjerëve t’ju bëjnë që t’i shmangeni drejtësisë. Jini të drejtë, kjo është më afër përkushtimit dhe kini frikë Allahun. Pa dyshim që Allahu është në dijeni të plotë për çdo gjë që ju veproni.” El Maide: 8.

5 - Bashkëpunimi me bidatçiu.

Kemi për qëllim atë person, të cilin bidati i tij nuk e nxjerr nga feja islame. Nëse njerëzit me të cilët synohet të bashkëpunohet, kanë bidate ose gjynahe, atëherë bashkëpunimi ose mosbashkëpunimi, varet nga përcaktimi i dobisë dhe dëmit. Bashkëpunimi me bidatçinjtë është themeluar mbi bazën e ruajtjes së interesave fetare dhe të kryerjes së detyrave fetare, të cilat nuk mund të kryhen siç duhet pa këtë bashkëpunim me bidatçinjtë dhe gjynahqarët, ose nuk do të kryheshin e të mbroheshin fare, gjë e cila do të shkaktonte dëm më të madh se dëmi i bidateve të tyre.

Në lidhje me këtë çështje duhet të kemi parasysh rregullat që vijojnë:

- Bashkëpunimi me bidatçiu të jetë në sferat dhe gjërat që nuk ka mosmarrëveshje në lidhje me to, d.m.th. në kuadrin e së vërtetës të cilën e pranon Sheriati dhe së mirës që e do Allahu si dije, xhihad, dave e të tjera. Ibnul Kajim ka thënë: “Çdo grup ka gjëra të vërteta dhe të pavërteta, kështu që detyra kundrejt asaj që e kanë thënë, është të pajtohesh me ta në të vërtetën dhe ta refuzosh të pavërtetën. Atij që Allahu ia ka mundësuar të mbajë këtë qëndrim, ia ka hapur të gjitha mundësitë për dije e devotshmëri dhe ia ka lehtësuar shkaqet e mjetet e tyre.” Pranimi i së vërtetës që ka bidatçiu dhe përfitimi prej tij në këtë drejtim, është një lloj bashkëpunimi me të për mirësi e devotshmëri. Dëshmitë që e mbështesin këtë bashkëpunim në fushen e dijes dhe të mësimdhënies janë të shumta. Në librat e biografive dhe të “xherhit” e “ta’ dilit” janë përmendur shumë raste prej të cilave rezulton se është marrë dije prej dijetarëve që kanë qenë të prekur nga bidatet, si ato të kaderit, irrxhasë, mu’tezilëve dhe shiizmit. Si fakt për këtë shërbejnë edhe librat e terminologjisë shkencore të hadithit (mustalahul hadith), në të cilat janë përmendur mendimet e dijetarëve në lidhje me trasnmetimin prej bidatçinjve dhe rregullat e trasnmetimit prej tyre në mënyrë të detajuar. Imam Dhehebiu ka thënë: “Një grup trasnmetuesish janë njollosur me mendimet e gabuara në çështjet e kaderit,

megjithatë hadithet e tyre gjenden në dy “sahihat”, ose në njërin prej tyre. Kjo për arsye se ishin të vërtetë, të besueshëm dhe perfektë në transmetime.”²⁶

- Respektimi i parimit të përcaktimit të dëmit dhe dobisë kur bashkëpunohet me bidatçinjtë. Nëse bashkëpunimi me bidatçiun shpie në realizimin e një dobie, e cila është më e madhe se dëmi i bidatit të tij, ose në shmangjen e një dëmi, i cili është më i madh se dëmi i bidatit të tij, atëherë bashkëpunimi me të bëhet i domosdoshëm, sipas rregullit që ka të bëjë me interesat dhe dobitë. Ibnu Tejmija ka thënë: “Nëse nuk është e mundur kryerja e detyrave si dija, xhahadi e të tjera, veçse me anën e atij që ka bidate, dhe dëmi i tyre është më i vogël se dëmi i moskryerjes së asaj detyre, në këtë rast arritja e dobisë nëpërmjet kryerjes së detyrës, megjithëse është e shoqëruar nga një dëm më i vogël se dobia, është më e mirë se e kundërta.”

- Të mos e shfrytëzohet bidatçiun këtë bashkëpunim, si mundësi e mjet për të përhapur bidatin e tij, ose si shkak për t’u fuqizuar e për të forcuar pozitën e tij mbi pozitën e njerëzve me besim të drejtë dhe ibadet të saktë. Prandaj, nëse bashkëpunimi me ta shpie në gjëra të tilla, ai nuk është i lejueshëm.

- Respektimi i rregullave të bojkotimit (hexhrit), të cilat i përmendëm më lart, krahas rregullave të bashkëpunimit që i përmendëm këtu.

Studiuesi në jetëshkrimet e dijetarëve të Islamit, do të vërejë shumë raste e shembuj që dëshmojnë për këtë bashkëpunim, sipas rregullave që përmendëm. Rregullat e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me bidatçinjtë, që i përmendëm, nuk përbëjnë ftesë për në bidat, as pohim të shpikjeve në fe dhe as preferim të bidatit, Zoti na ruajtë, por ato qartësojnë metodën e drejtë dhe të paanshme të “ehli sunneh uel xhemaah” dhe sqarojnë mënyrën praktike e të ligjshme, me anë të së cilës arrihet bashkimi në të vërtetën dhe ndjekja e Sheriatit, si dhe në të njëjtën kohë realizohet shmangia e bidateve dhe mposhtja e bidatçinjve. Krahas kësaj, krijohet mundësia për t’i këshilluar sinqerisht, për të fituar zemrat e tyre dhe për të përfituar prej mirësisë dhe të vërtetës që ata kanë. Kjo është rruga e mesme, në të cilën ecën dijetarët e “ehli sunetit” nën hijen e pushtetit islam, shtetit e fuqisë së tij dhe krenarisë së muslimanëve. Ndërsa sot është më

²⁶) Ibnu Haxheri në “Hedjus sari”, ka përmendur emrat e transmetuesve në “Sahihun” e Buhariut të cilët janë akuzuar për mendime bidati. Qëllimi i përmendjes së këtyre fakteve është të sqarojmë se marrja e dijes prej atyre që janë akuzuar për bidate, është prej bashkëpunimit për mirësi e devotshmëri, sepse nëse do të lihej një gjë e tillë, do të humbiste një pjesë e madhe e hadithit të të Dërguarit të Allahut dhe do të zhdukej një pjesë e madhe e dijes fetare. Prandaj Imam Ahmedi ka thënë: “Sikur të mos trasnmetonim nga kaderijtë, do të linim transmetimin nga shumica e transmetuesve të hadithit në Basra.” Bashkëpunimi me ta në fushën e dijes dhe të tjera, është i kushtëzuar nga të gjitha rregullat që po i përmendim në lidhje me këtë çështje. Prandaj shpresojmë që askush të mos nxitohet në gjykim menjëherë pas leximit të këtij rregulli prej të cilit përfitohet ligjshmëria e bashkëpunimit me ta, pa i lexuar edhe rregullat e tjera.

e arsyeshme që të jetë detyrë, sepse jetojmë në një kohë kur Islami është bërë i panjohur mes muslimanëve, zbatimi i ligjeve të tij dhe gjykimi me to në vende të ndryshme është zbehur, gjurmët e profecisë pothuajse janë fshirë, trazirat dhe fitnet janë përhapur, kufri është rrënjësuar, shkatërrimi dhe degjenerimi po merr përmasa të gjera dhe të shthururit, të prishurit e munafikët janë fuqizuar.

Pas gjithë kësaj që sqaruam, e rëndësishme është të dimë se, janë shumë qëndrime të selefët, rreth të cilave duhet të njohim rregullat përkatëse, në mënyrë që të mos i përplasim argumentet e Sheriatit dhe thëniet e selefëve me njëra-tjetrën, të mos ngatërrohemi e të na përzihen gjërat dhe të mos bëjmë padrejtësi e të përhapim shkatërrimin.

I këshillojmë ata që i ftojnë njerëzit për të ndërmarrë qëndrime të caktuara, të lexojnë librin “Meukif ehlus-sunneh ue xhema’ah min ehlil ehui vel bida’i”, të autorit Ibrahim err-Rruhajli. Ai ka sqaruar në mënyrë të detajuar qëndrimin e “ehli sunetit” ndaj cilësimit “kafirë” dhe “fasikë” të bidatçinjve, mallkimit të tyre, pranimit të punëve të tyre tek Allahu dhe gjykimit të teubes se tyre. Gjithashtu ka sqaruar qëndrimin e “ehli sunetit” ndaj faljes së namazit pas bidatçinjve; martesës së grave të “ehli sunetit” me burrat bidatçinj, dhe të burrave të “ehli sunetit” me gratë bidatçie; ngrënies së mishit të therur nga ana e tyre; vizitimit të të sëmurëve të tyre; pjesëmarrjes në xhenazet e tyre dhe gjykimit të trashëgimisë. Po ashtu ka sqaruar qëndrimin e “ehli sunetit” ndaj urrejtjes së bidatçinjve, përgojimit të tyre, dhe shumë gjëra të tjera që kanë të bëjnë me takimin e bisedimin me ta, si dhe metodikën e ndëshkimit të tyre. Ka sqaruar qëndrimin e “ehli sunetit” ndaj pranimit të dëshmisë dhe transmetimit të bidatçinjve, si dhe ndaj përdorimit të tyre në mësimdhënie e xhihad.

Kreu 2. Nxitja për pasimin e Sunetit, paralajmërimi për bidatet dhe qartësimi i rrezikshmërisë së tyre

Shkroi: Abdulmuhsin bin Hamed el Abad

Falenderimi i takon Allahut, Atë e falenderojmë, ndihmë dhe falje prej Tij kërkojmë. Allahut i kërkojmë të na mbrojë prej të këqijave të veteve dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon, askush nuk e humb dhe atë që Allahu e humb, askush nuk e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë

veç Allahut, të vetëm e pa shok dhe dëshmoj se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) është rob dhe i Dërguari i Tij. E dërgoi Allahu me udhëzimin dhe fenë e vërtetë që ta ngadhënjejë mbi të gjitha fetë e tjera. Ai e transmetoi mesazhin, amanetin e vendosi në vend, popullin e tij e këshilloi dhe në rrugën e Allahut luftoi vërtetësisht.

O Allah, dërgo paqe dhe begati mbi të, familjen e tij, shokët e tij dhe mbi atë që u udhëzua me udhëzimin e tij dhe ndoqi rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Mirësitë e Allahut mbi robërit e tij janë të shumta dhe të panumërta. Mirësia më e madhe me të cilën Allahu i begatoi njerëzit dhe xhindët, është se dërgoi tek ata Profetin e tij të nderuar, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem). Ai u transmetoi mesazhin që Zoti u dërgoi, në formën më të plotë dhe më të përpiktë.

Imami ibn Shihab Zuhri ka thënë: “Prej Allahut i erdhi mesazhi, për të Dërguarin e Tij ishte detyrë transmetimi dhe ne kemi për detyrë dorëzimin.” Këtë thënie të tij e përmend imam Buhariu në fillim të kapitullit.²⁷

“O i Dërguar, transmetoje atë që të ka zbritur prej Zotit tënd dhe nëse nuk e bën, atëherë dije se nuk e ke transmetuar mesazhin e Tij.”

Mesazhi që ishte prej Allahut i erdhi, ashtu sikurse ka thënë Allahu:

“Tashmë kemi dërguar në çdo popull profetë (që të thonë): ‘Adhuroni Allahun dhe largojuni tagutit’.” En-Nahl: 36.

“Me të vërtetë Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe, kur dërgoi tek ata një të dërguar nga mesi i tyre, që t’u lexonte ajetet e Tij, t’i pastronte ata dhe t’u mësonde atyre librin dhe urtësinë, edhe pse ata më parë ishin në humbje të qartë” Ali Imran: 164.

Transmetimi, që ishte detyrë e Profetit (salallahu alejhi ue selem), u realizua në formën më të përsosur dhe më të plotë sikurse ka thënë Allahu:

“A janë të ngarkuar të dërguarit me gjë tjetër, veçse të transmetojnë

) Kapiulli i Teuhidit, në “Sahihun” e imam Buhariut, 13-503.²⁷

qartë mesaxhin.” En-Nahl: 35.

“Detyra e të Dërguarit është vetëm transmetimi i qartë.” En Nur: 54.

Ndërsa obligimi i robërve është dorëzimi dhe nënshtrimi. Njerëzit në lidhje me nënshtrimin janë ndarë në:

- Të udhëzuar - pasues të rrugës së drejtë
- Të paudhëzuar - pasues të rrugëve të tjera

“Kjo është rruga ime e drejtë, prandaj ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera, se do t’ju përçajjnë e do t’ju largojnë nga rruga e Tij. Me këtë ju ka porositur Allahu, që të jeni të devotshëm.” El En’am: 153.

Vazhdimësia, gjithpërfshirja dhe përsosmëria janë tri cilësi të Sheriatit

Ky Sheriat, me të cilin Allahu ka dërguar Profetin e tij (salallahu alejhi ue selem), karakterizohet nga tri cilësi të cilat janë:

1. Qëndrueshmëria gjatë kohërave
2. Gjithpërfshirja
3. Përsosmëria

➤ Ky Sheriat do të qëndrojë deri Ditën e Kiametit. Allahu ka thënë:

“Muhamedi nuk ka qënë babai i ndonjërit prej burrave tuaj, por i Dërguari i Allahut dhe Profeti i fundit prej profetëve.” El Ahzab: 40.

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë që Muavija (radijallahu anhu) ka thënë se e ka dëgjuar të Dëguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) të thotë: “Atij të cilit Allahu dëshiron t’i bëjë mirësi, i jep dituri në fe. Unë ndaj, ndërsa Allahu është ai që jep. Do të vazhdojë ky Umet të jetë i kapur pas fesë së Allahut dhe nuk e dëmton atë askush që e kundërshton, derisa të vijë urdhëri i Allahut.”²⁸

➤ Ky Sheriat përfshin të gjithë njerëzit dhe xhindët. Të gjithë ata bëjnë pjesë

) Transmeton Buhariu, nr. 71 dhe Muslimi, nr. 1037.²⁸

në Umetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem), Umetin e thirrjes islame, sepse çdo njeri dhe xhind, prej kohës së dërgimit të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), deri në Ditën e Gjykimit, është i ftuar për të hyrë në fenë e drejtë me të cilën Allahu dërgoi Profetin e tij bujar, sikurse ka thënë Allahu:

“Allahu fton për në shtëpinë e paqes dhe udhëzon kë dëshiron në rrugë të drejtë.” Junus: 25.

Në këtë ajet flitet për umetin e thirrjes dhe për umetin e përgjigjes. Umeti i thirrjes përmendet në fjalën e Allahut: **“Allahu fton për në vendin e paqes”**, pra fton çdokënd prej jush. Ndërsa umeti i përgjigjes përmendet në fjalën e Allahut: **“udhëzon kë dëshiron në rrugë të drejtë”**, pasi ata të cilët Allahu i udhëzoi në rrugën e drejtë janë ata që iu përgjigjën thirrjes së Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) duke hyrë në fenë e tij të drejtë dhe u bënë muslimanë.

Udhëzimi i Umetit që u përgjigj ishte me mirësinë dhe udhëzimin e Allahut. Këtë udhëzim nuk e posedon askush tjetër veç tij, sikurse ka thënë Allahu: **“Ti nuk mund të udhëzosh atë që dëshiron, por Allahu udhëzon atë që dëshiron.”** (El Kasas: 56) Ndërsa udhëzimin e drejtimit dhe orientimit Allahu e ka pohuar edhe për Profetin e Tij (salallahu alejhi ue selem): **“Padyshim që ti udhëzon për në rrugë të drejtë”** (Esh-Shura: 52), pra, drejton dhe orienton.

Argument që tregon përfshirjen e mbarë njerëzve në thirrjen e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), është edhe fjala e Allahut: **“Thuaj: ‘O njerëz! Unë jam i dërguar i Allahut tek të gjithë ju.’”** Al A’raf: 158.

Gjithashtu argument është edhe fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): **“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Nuk dëgjon për mua ndonjë prej këtij populli, hebre qoftë apo i krishterë, pastaj vdes duke mos besuar atë që u dërgova, e të mos jetë prej banorëve të zjarrit.”**²⁹

Vërtetimi i këtij hadithi, siç ka thënë Seid bin Xhubejri, ka ardhur në Kur’an në fjalën e Allahut:

) E transmeton Muslimi në librin e tij të saktë, nr. 153.²⁹

“E kush prej atyre grupeve, (çifutë, kristianë dhe gjithë popujt jomuslimanë) e mohuan atë, vendi i tyre është zjarri” Hud: 17.

Këtë fjalë të tij e ka përmendur ibn Kethiri në komentin e këtij ajeti.

Ndërsa argument që tregon përfshirjen e xhindëve në ftesën e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), është fjala e Allahut: **“Kur Ne dërguam drejt teje një grup të vogël xhindësh të dëgjojnë Kur’anin dhe kur prezantuan thanë: ‘Dëgjoni në heshtje!’ Kur mbaroi ata u kthyen tek populli i tyre si këshillues. Thanë: ‘O populli ynë! Kemi dëgjuar një libër që zbriti pas Musait, vërtetues i atyre që ishin para tij, udhëzon për tek e vërteta dhe në rugën e drejtë’. Ata thanë: ‘O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besojeni atë. Ai (Allahu) do t’jua falë gjynahet tuaja dhe do t’ju shpëtojë prej dënimit të dhembshëm. Kush nuk i përgjigjet thirrësit të Allahut, ai nuk mund të shpëtojë në tokë dhe nuk do të ketë për të asnjë mbrojtës përveç Allahut. Të këtillët janë në gabim e humbje të qartë.”**

Po ashtu Allahu ka thënë në suren “Err-Rrahman”: **“Atëherë pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhindë) e mohoni?”** Në këtë ajet Allahu u është drejtuar njerëzve dhe xhindëve dhe ajeti është përmendur në këtë sure plot 31 herë.

Në “Sunenin” e Tirmidhiut transmetohet nga Xhabiri se ka thënë: “Profeti (salallahu alejhi ue selem) doli për tek shokët e tij dhe u lexoi atyre suren “Err-Rrahman” nga fillimi deri në fund, ndërsa ata heshtën. U tha: ‘Ua lexova këtë sure xhindëve natën kur u takova me ta dhe u përgjigjën më mirë se ju. Sa herë që vija tek fjala e Allahut: **‘Atëherë pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju e mohoni’**, thonin: ‘Asnjë nga mirësitë e Tua nuk përgënjeshtrojmë o Zoti ynë, Ty të takon falenderimi’.”³⁰

Prej sureve të Kur’anit është edhe surja “El Xhin” ku Allahu i Madhëruar përmend një pjesë të fjalëve të xhindëve.

) E transmeton Tirmidhiu, nr. 3291. Për këtë hadith dëshmon transmetimi i ibën Umerit, të cilin e ka transmetuar³⁰ ibën Xheriri. Shiko “Es silsiletus sahihah” të Albanit, hadithi nr. 2150.

➤ Karakteristika e tretë e këtij Sheriati është se ai është i plotë dhe i përsosur.

Allahu në librin e tij ka thënë:

“Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe.” El Maide: 3.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ju kam lënë si në shembullin e një fushe, nata e së cilës është si dita e saj. Nuk humbet prej saj vetëm se i shkatërruari.”³¹

Ndërsa në “Sahihun” e Muslimit transmetohet nga Selmani (radijallahu anhu) se dikush i tha: “Ju ka mësuar Profeti juaj (salallahu alejhi ue selem) çdo gjë, madje edhe edukatën e kryerjes së nevojës personale.” Tha: “Sigurisht! Na ka ndaluar t’i drejtohem kibles gjatë kryerjes së jashtëqitjes së trashë, të hollë, të pastrohemi me të djathtën apo të pastrohemi me më pak se tre gurë, të pastrohemi me jashtëqitjet e thata të kafshëve ose me kocka.”³²

Kjo thënie tregon përsosmërinë dhe gjithpërfshirjen e këtij Sheriati për çdo gjë për të cilën ka nevojë ky Umet, deri edhe edukatën e kryerjes së nevojës personale.

Po në “Sahihun” e Muslimit, transmetohet nga Abdullah ibën Amr ibën Asi (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk ka pasur ndonjë profet para meje, vetëm se ka qenë detyrë mbi të, që ta orientojë popullin e tij drejt më të mirës që dinte për ta dhe t’u tërhiqte vërejtjen prej më të keqes që dinte për ta.”³³

Buhariu në “Sahihun” e tij transmeton nga ebi Xhuejrije: “E pyeta ibën Abasin për *badhik-un* e ai më tha: ‘E ka paraprirë Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) me ndalim *badhik-un*, sepse çdo gjë dehëse është haram.’ Thashë: ‘Pija që lejohet, është pija e mirë’. Tha: ‘Pas të lejuarës së mirë, ka vetëm të

) Hadithi është i saktë, e ka transmetuar ibën ebi Asim në “El sunne”, nr. 48 nga Irbad ibën Sarijeh. Gjithashtu ³¹ është transmetuar hadithi me nr. 47 prej ebu Dardasë.

) Transmeton Muslimi, nr. 262.³²

) Transmeton Muslimi, nr. 1844.³³

ndaluar të keqe’.”³⁴ *Badhik-u* është një lloj pije e cila nuk ka qenë në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) por Sheriati që solli Profeti (salallahu alejhi ue selem), e përfshin këtë pije dhe të tjerat në fjalën e përgjithshme të tij: “Çdo gjë që deh është e ndaluar.” Gjithpërfshirja e këtij hadithi tregon se çdo gjë dehëse që ka qenë në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) apo të tjera pas kohës së tij, qofshin lëngje apo të ngurta, janë haram dhe çfarë nuk është e tillë është e lejuar.

Edhe për duhanin, i cili është njohur më vonë, themi të njëjtën fjalë që u tha për *badhik-un*; që argumentet e Sheriatit përfshijnë në tërësinë e tyre ndalimin e tij. Kjo gjë vihet re në fjalën e Allahut kur flet për Profetin e Tij (salallahu alejhi ue selem): “**U lejon atyre të mirat dhe u ndalon të këqijat.**” (El Araf: 157) Duhani nuk është gjë e mirë, përkundrazi ai është i keq, prandaj është haram, pa shtuar faktin që ai shkakton sëmundje vdekjeprurëse, shpërdoron pasurinë dhe provokon siklet me erën e tij të keqe. Të gjitha këto dëshmojnë se ai është haram.

Ebu Dherri (radijallahu anhu) ka thënë: “U nda nga ne i Dërguari i Allahut³⁵ dhe për çdo zog që fluturonte me krahët e tij, ne kishim dije.”³⁶

Prej diturisë që disponojmë nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) rreth zogjve, është ajo që transmeton Muslimi në “Sahihun” e tij nga ibn Abasi, i cili thotë: “Ka ndaluar i Dërguari i Allahut (të hahet) çdo kafshë grabitqare me dhëmbë shqyes dhe çdo shpend me kthetra.”³⁷ Ky hadith tregon se mishi i çdo shpendi me kthetra me të cilat gjuan, është i ndaluar të hahet. Kjo është prej fjalëve gjithpërfshirëse të Profetit (salallahu alejhi ue selem). Kjo për sa i përket anës legjislative, ndërsa në atë informative të lajmeve rreth zogjve është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Nëse ju do t’i mbështeteshit Allahut me një mbështetje të vërtetë, do t’ju furnizonte ju ashtu siç e furnizon

) Transmeton Buhariu, nr. 5598.³⁴

) D.m.th. u nda nga ne me vdekjen e tij.³⁵

) Transmeton ebu Hatim ibn Hibani në “Sahihun” e tij nr: 65 dhe thotë: “Me fjalën ‘Na pati dhënë dituri rreth tij’³⁶ nënkuptohen urdhëresat, ndalesat, lajmet, veprat dhe lejimin e tij. Shejh Albani e ka saktësuar këtë hadith në “Sahih Meuaridi dham’an fi zeuaidi ibni Hiban lil Hejthemij” (1/119).

) Transmeton Muslimi nr.1934.³⁷

zogun i cili del i uritur dhe kthehet i ngopur.”³⁸

Imam ibn Kajimi në librin e tij “I’alamul mueki’ine”, kur flet për përsosmërinë e ligjit islam thotë:

“Kjo bazë është nga bazat më të rëndësishme dhe me të dobishme, e cila mbështetet në një gjë të vetme, që është gjithpërfshirja në mesazhin e Profetit (salallahu alejhi ue selem), e çdo gjëje për të cilën kanë nevojë njerëzit në njohuritë, shkencat dhe punët e tyre. Ai nuk e la Umetin e tij të ketë nevojë për tjetërkënd pas (vdekjes së) tij, por nevoja e Umetit mbetet vetëm tek ata që do të transmetojnë atë që ka sjellë ai.

Kështu mesazhi i tij ka dy tërësi absolute, prej të cilave nuk përjashtohet asgjë:

1- Adresimi i këtij mesazhi tek të gjithë ata për të cilët Profeti (salallahu alejhi ue selem) është dërguar.

2- Tërësia dhe përfshirja e çdo gjëje që kanë nevojë ata që u është dërguar mesazhi, si në bazat e fesë ashtu edhe në degëzimet e saj.

Prandaj ky mesazh është i plotë, i mjaftueshëm, shërues (i konflikteve, konfuzioneve, dilemave, problemeve dhe sëmundjeve), i gjithanshëm, gjithpërfshirës dhe nuk ka nevojë për mesazh tjetër pas tij. Atëherë besimi nuk plotësohet ndryshe, vetëm se duke pohuar tërësinë e mesazhit të Profetit (salallahu alejhi ue selem) në kushtin e parë dhe në kushtin e dytë. Askush prej njerëzve dhe xhindëve të ngarkuar me detyra, nuk përjashtohet nga ky mesazh. Asnjë lloj i së të drejtës për të cilën ka nevojë Umeti në shkencat dhe në punët e tij, nuk përjashtohet nga ajo me të cilën ka ardhur Muhamedi (salallahu alejhi ue selem). I Dërguari vdiq dhe për çdo zog me flatra që fluturonte në qiell i mësoi Umetit dije rreth tij. U mësoi atyre çdo gjë, madje edhe edukatën e kryerjes së nevojës, edukatën e marrëdhënieve seksuale, të

) Transmeton Ahmed, Tirmidhiu, Nesaiu, ibn Maxheh, ibn Hibani dhe el Hakimi. Tirmidhiu thotë se hadithi është ³⁸ hasen, sahih, po ashtu ky është njëri prej haditheve që ka shtuar ibën Rexhepi tek 40 hadithet e Neueuiut.

gjumit, të ngritjes, të uljes, të ngrënies, të pirjes, të hipjes në mjet dhe zbritjes prej tij, të udhëtimit, të qëndrimit, të heshtjes, të fjalës, të veçimit prej njerëzve, të përzierjes me ta, të pasurisë, të varfërisë (të skamjes), të shëndetit, të sëmundjes dhe të gjitha ligjet që kanë lidhje me jetën dhe vdekjen. U përshkroi atyre Arshin, Kursinë, melaiket, xhindët, zjarrin, xhenetin, xhehenemin, Ditën e Gjykimit dhe çfarë ka në të, aq sa të duket se po i shikon me sytë e tu. U përshkroi atyre të adhuruarin e tyre me përshkrimin më të plotë, sa që u dukej sikur ishin duke e parë Atë. I njohu me profetët dhe popujt e tyre, me mirësitë apo ndëshkimet që u erdhen, sikur të ishin në mesin e tyre. U mësoi atyre rrugët e së mirës dhe së keqes, të vogla qofshin ato apo të mëdha, aq sa asnjë profet më parë nuk e mësoi popullin e tij si ai. I njohu ata me vdekjen, me mirësitë dhe dënimin e trupit dhe të shpirtit në jetën e varrit si asnjë profet më parë. U mësoi argumentet e Teuhidit, profecisë, ringjalljes edhe kundërpërgjigjes ndaj çdo grupi kafirësh e të humburish, sa që njohësi i këtyre argumenteve, nuk ka nevojë për askënd tjetër pas tij, përveç atij që ia transmeton këto argumente, duke i sqaruar dhe shpjeguar ato që nuk i kupton dot. U tregoi atyre strategjitë e luftës në ballafaqimin me armikun dhe rrugët e triumfit dhe fitores. Nëse do t'i mësojnë, do t'i logjikojnë dhe do t'i ruajnë ato ashtu siç duhet, armiku kurrë nuk do t'u bëjë ballë. Gjithashtu i njohu ata me hilet e shejtanit dhe rrugët me të cilat ai vjen. Si të ruhen prej tij dhe mashtrimeve të tij, si t'i largohen së keqes së tij, pa pasur nevojë t'i shtohet sqarimit të tij asgjë. I njohu ata me gjendjet, cilësitë, intrigat dhe fshehtësitë e veteve të tyre, aq sa ata nuk kanë nevojë për tjetërkënd veç tij. I njohu ata me çështjet e jetës së tyre aq sa po t'i studionin dhe t'i zbatonin, do rregullohej në maksimum jetesa e tyre në këtë botë.

Pra u erdhi atyre me të gjitha mirësitë e kësaj bote dhe të botës tjetër, pa i lënë ata Allahu të kenë nevojë për askënd tjetër pas tij. Atëherë si mund të mendohet se legjislacioni i tij i plotë, kur bota nuk ka parë legjislacion më të përsosur se ai, është i mangët dhe ka nevojë për një politikë të jashtme që ta plotësojë apo për një analogji, realitet ose arsye jashtë tij?!

Kush mendon kështu, është si ai që mendon se njerëzit kanë nevojë për një profet tjetër pas tij. Shkaku i gjithë kësaj është mosinformimi i këtyre njerëzve, për atë me të cilën ka ardhur ai, apo mospajisja e tyre me të kuptuarit që Allahu u dha shokëve të Profetit të Tij (salallahu alejhi ue selem), të cilët u mjaftuan me mesazhin dhe nuk patën nevojë për diçka tjetër veç tij. Me këtë mesazh ata çliruan zemrat dhe vendet. Thonin: “Këtë na e la në mirëbesim Profeti ynë dhe ne po ua lëmë në mirëbesim juve.”³⁹

Përdorimi i fjalës “sunet”

Ky legjislacion i plotë, është suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem) duke e marrë në kuptimin e përgjithshëm, sepse shprehja “sunet” ka katër përdorime:

I pari. Çdo gjë që transmetohet në Kur’an dhe në hadith është sunet i Profetit (salallahu alejhi ue selem), pra rruga në të cilën ai ka qenë, sikurse ka thënë Profeti: “Kush e refuzon sunetin tim nuk është prej meje.”⁴⁰

I dyti. Shprehja “sunet” merr kuptimin e fjalës “hadith”, atëherë kur shoqërohet me fjalën “Kur’an”, si në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “O ju njerëz. Unë u kam lënë juve atë, që nëse do të kapeni pas tij nuk do të humbni asnjëherë, Librin e Allahut dhe sunetin e Profetit të tij.” Po ashtu fjala e tij: “Kam lënë tek ju dy gjëra pas të cilave nuk do të humbisni; Librin e Allahut dhe Sunetin tim.”⁴¹

Këtu hyn edhe fjala e disa dijetarëve në trajtimin e çështjeve kur thonë se “për këtë çështje ka argument nga Kur’ani, Suneti dhe ixhmai.

I treti. Shprehja “sunet” përdoret si antonim i fjalës bidat, siç thuhet në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) në hadithin e Irbad ibn Sarijes: “Ai që do të jetojë prej jush pas meje, do të shohë përçarje të shumta, prandaj kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të khulefave të udhëzuar e të drejtë. Kapuni pas tij,

) “I’lamul mueki’ine”, vëll. 4, fq. 375-376.³⁹

) Transmeton Buhariu, nr. 5063 dhe Muslimi, nr. 1041.⁴⁰

) Këto dy hadithe i ka transmetuar Hakimi në Mustedrekun e tij (1-93).⁴¹

shtrëngojeni atë me dhëmbë dhe ruhuni prej shpikjeve në fe, sepse çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje.”⁴²

Prandaj disa dijetarë të hershëm të hadithit i kanë titulluar librat e tyre të Akides me emrin “Es-sunneh” si për shembull “Es-sunneh” i Muhamed ibn Nasër Merueziut, “Es-sunneh” i Ebi Asimit, “Es-sunneh” i Lelekait e të tjerë. Po kështu në librin e “Sunetit” të ebi Daudit, ndodhet një kapitull me emrin “Kapitulli i Sunetit” i cili përmbledh hadithe të shumta rreth Akides.

I katërti. Shprehja “sunet” vjen me kuptimin “i pëlqyeshëm”. Ky kuptim vjen atëherë kur urdhëri është në formën e të qenit i preferuar dhe jo në formën e obligimit. Ky përdorim përdoret nga juristët (dijetarët e Fikhut). P.sh. në fjalën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): “Sikur të mos e rëndoja Umetin tim, do t’i urdhëroja ata të përdornin misvakun për çdo namaz”,⁴³ urdhëri për përdorimin e misvakut si gjë e pëlqyeshme është i sigurtë, por Profeti (salallahu alejhi ue selem) e la urdhërin obligues, nga frika se mos Umeti haste në vështirësi.

Ajete, hadithe dhe “ethere”, që flasin për pasimin e Sunetit dhe tërheqin vërejtje për bidatet dhe gjynahet

Në Kur’an përmenden shumë ajete të cilat nxisin dhe inkurajojnë për pasimin e sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe shumë ajete të cilat tërheqin vërejtje për moskundërshtimin e Profetit në të vërtetën dhe udhëzimin, si dhe tërheqin vërejtje për shirkun, bidatet dhe mëkatet:

“Kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera, pasi ato do t’ju ndajnë e do t’ju largojnë nga udha e Tij. (Allahu) Me këtë ju ka porositur që të ruheni.” El En’amë: 153.

) Transmeton ebu Daudi, nr. 4607. Ky është teksti i ebu Daudit. E ka transmetuar edhe Tirmidhiu, nr. 2676 dhe ⁴² ibën Maxheh, nr. 4443. Tirmidhiu ka thënë se hadithi është hasen, sahih.

) Transmeton Buhariu, nr. 887 dhe Muslimi, nr. 252.⁴³

“Nuk i takon besimtarit dhe as besimtares, kur Allahu dhe i Dërguari i tij vendosin për një çështje, që ata të kenë zgjedhje tjetër në vendimin e tyre. Kushdo që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai ka humbur në humbje të qartë.” Ahzab: 36.

“Le të bëjnë kujdes ata që kundërshtojnë urdhërin e tij, se mos i godet ata ndonjë fitne ose mos i godet ndonjë ndëshkim i dhembshëm.” Nur: 63.

Ibën Kethiri në tefsirin e këtij ajeti thotë:

“Pra (kundërshtojnë) urdhërin e Profetit të Allahut (salallahu alejhi ue selem). Ky urdhër është rruga, metoda, suneti dhe legjislacioni i tij. Fjalët dhe punët duhet të peshohen me fjalët dhe punët e tij, nëse përputhen pranohen, dhe nëse s’përputhen, ato refuzohen, kushdo qoftë thënësi apo vepruesi i tyre, sikurse trasmetohet në dy sahihet dhe në libra të tjerë, se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush punon ndonjë punë e cila nuk është prej fesë sonë, ajo është e refuzuar.”

Prandaj të frikësohen ata që kundërshtojnë Sheriatin e Profetit (salallahu alejhi ue selem) haptazi apo fshehurazi **“se mos i godet ata ndonjë fitne”** në zemrat e tyre, si kufri, nifaku apo bidati, **“apo mos i godet ata ndonjë dënim i dhembshëm”** në dynja, me ekzekutim, dënim penal, burgim apo ndonjë dënim tjetër.”

Allahu thotë: **“Tashmë keni pasur tek i Dërguari i Allahut një shembull mjaft të mirë për atë që shpreson Allahun dhe ditën e fundit dhe që e kujton Allahun shumë.”** Ahzab: 21.

“Thuaj: Nëse e doni Allahun atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë ju dhe t’jua falë gjynahet tuaja se Allahu është Falës dhe Mëshirues.” Ali Imran: 31.

Ibën Kethiri në tefsirin e këtij ajeti thotë: “Ky ajet i nderuar gjykon se çdo person që pretendon dashurinë e Allahut kur ai nuk është në rrugën e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), realisht është gënjeshtar, derisa të pasojë Sheriatin dhe fenë e tij në të gjitha fjalët dhe veprat, siç pohohet në

hadithin e saktë nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), i cili ka thënë: “Kush punon ndonjë pune që nuk është prej fesë sonë, ajo është e refuzuar.” Prandaj Allahu thotë: **“Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua t’ju dojë Allahu”**, d.m.th. të arrini më shumë se sa dashuria juaj për Allahun të cilën e synuat, e ajo është dashuria e Allahut ndaj jush. Kjo e fundit është më e madhe se e para, sikurse kanë thënë disa dijetarë të urtë: “Nuk është arritje të duash, por arritje është të të duan.”

Hasan Basriu dhe selefë të tjerë kanë thënë: “Disa njerëz pretenduan se e donin Allahun dhe Ai i sprovoi me këtë ajet: **‘Thuaj: Nëse e doni Allahun më pasoni mua që Allahu t’ju dojë ju’.**”

Gjithashtu Allahu thotë: **“Kush e pason udhëzimin tim nuk ka frikë për ta dhe as pikëllim.”** Bekare: 38.

“Kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në dunja) e as nuk ka për të dështuar (në botën tjetër). E kush ia kthen shpinën udhëzimit tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kiametit do ta ringjallim të verbër.” Ta Ha: 123-124.

“Por jo, për Zotin tënd! Ata nuk besojnë përderisa të të bëjnë ty gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, derisa të mos mbetet në vetet e tyre asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve të tua dhe derisa t’i pranojnë ato plotësisht dhe të nënshtruar.” Nisa: 65.

“Ndiqni çfarë ju është zbritur juve nga Zoti juaj dhe mos ndiqni eulija (ndihmues a mbrojtës që ju urdhëron të adhuroni tjetër përveç Allahut) përveç Tij (Allahut). Sa pak që përkujtoni.” Al A’raf: 3.

“Kushdo që largohet (verbon veten) nga përkujtimi i të Mëshirëshmit, Ne i caktojmë atij një shejtan që të jetë për të shok e mik i ngushtë. Në fakt (shejtanët) i pengojnë ata nga udha (e Allahut) ndërsa ata mendojnë se janë të udhëzuar.” Ez-Zukhruf: 36 -37.

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe parisë suaj, dhe nëse kundërshtoheni për diçka atëherë kthejeni atë te

Allahu dhe i Dërguari, nëse besoni Allahun dhe ditën e fundit.” Nisa: 59.

“Për çfarëdo që të kundërshtoheni, gjykimi i asaj i takon Allahut.” Esh-Shura: 10.

“Thuaj: ‘Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit’, por nëse ju shmangeni, ai (i Dërguari, Muhamedi) është përgjegjës vetëm për detyrën e ngarkuar ndaj tij (të shpallë mesazhin) dhe ju për atë që ju është ngarkuar juve. Në qoftë se i bindeni atij do të udhëzoheni dhe i Dërguarit ka detyrë vetëm përcjelljen e qartë.” En-Nur: 54.

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari merreni dhe çfarëdo që jua ndalon hiqni dorë prej saj dhe kini frikë Allahun, pasi Allahu është i ashpër në ndëshkim.” Hashër: 7.

“O ju që keni besuar! Mos vendosni para se të vendosë Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe kini frikë Allahun, pasi Allahu është Dëgjues, i Ditur.” Huxhurat: 1.

“O ju të cilët keni besuar! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret për atë që ju jep jetë dhe dijeni se Allahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni.” Enfal: 24.

“Fjala e vetme e besimtarëve kur ata thirren për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij për të gjykuar mes tyre, është që të thonë “dëgjuam dhe u bindëm” dhe ata janë të shpëtuarit. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, i frikësohet Allahut dhe i ruhet Atij, tamam këta janë të fituarit.” Nur: 51-52.

“Për ata që thanë “Zoti ynë është Allahu” dhe pastaj i qëndruan (fjalës së tyre), nuk do të ketë frikë dhe as nuk do të pikëllohen.” Ahkaf: 13.

“Ata që thanë “Zoti ynë është Allahu” dhe pastaj i qëndruan (fjalës së tyre), tek ata do të zbresin melaiket (duke u thënë në kohën e marrjes së shpirtit): ‘Mos kini frikë e as mos u pikëlloni, por përgëzohuni me xhenetin që u qe premtuar’.” Fusilet: 30.

“Apo kanë ata shokë e të barabartë me Allahun, të cilët u ligjëruan

atyre ndonjë fe që nuk e ka urdhëruar e përcaktuar Allahu.” Shura: 21.

“Ata që e besuan, e përkrahën dhe e ndihmuan atë dhe ndoqën dritën që u zbrit me të, ata janë të shpëtuarit.”

“Ata thanë: ‘O populli ynë! Me të vërtetë që kemi dëgjuar një libër (Kur’anin) të zbritur pas Musait duke vërtetuar çfarë ka ardhur para tij. Ai të udhëzon tek e vërteta dhe tek udha e drejtë. O populli ynë, përgjigjuni (me bindje) thirrësit të Allahut (të Dërguarit të Allahut, Muhamedit) dhe besojeni atë. Ai (Allahu) do t’jua falë juve mëkatet tuaja dhe do t’ju shpëtojë nga ndëshkimi i dhemshëm (i xhehenemit), dhe kushdo që nuk i përgjigjet thirrësit të Allahut, ai nuk mund të shpëtojë në tokë dhe nuk do të ketë asnjë mbrojtës për të përveç Allahut (nga ndëshkimi i Tij).” Ahkaf: 30-33.

Në sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem) transmetohen shumë hadithe të cilat nxisin për pasimin e Sunetit dhe tërheqin vërejtje për bidatet duke sqaruar rrezikshmërinë e tyre:

“Kush shpik në fenë tonë çka nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”⁴⁴ Në tekstin e Muslimit thuhet: “Kush punon ndonjë punë e cila nuk është prej fesë sonë, ajo është e refuzuar.”⁴⁵ Transmetimi i Muslimit është më i përgjithshëm nga ai i Buhariut, pasi përfshin atë që shpik bidatin, bashkë me atë që e pason atë që shpiku bidatin.

Gjithashtu ky hadith është argument për njërin nga dy kushtet e pranimit të punës. Ky kusht është pasimi i Profetit (salallahu alejhi ue selem), sepse çdo punë me të cilën personi kërkon të afrohet tek Allahu, pranohet vetëm pasi të ketë plotësuar dy kushte:

a) Të kryhet me sinqeritet vetëm për Allahun, dhe kjo është prej detyrave që rrjedhin nga dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut.

) E transmeton Buhariu, nr. 2697.⁴⁴

) E transmeton Muslimi, nr. 1718.⁴⁵

b) Pasimi i Profetit (salallahu alejhi ue selem), dhe kjo është prej detyrave që rrjedhin nga dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

Shejhul Islam ibn Tejmije në “Mexhmua el Fetua”, përmend se Fudejl ibn Ijadi në komentin e fjalës së Allahut “...**që t’ju provojë kush nga ju është më i miri në vepra**”, ka thënë: “Më e sinqerta dhe më e sakta (e qëlluara), sepse puna nëse është e sinqertë dhe nuk është e qëlluar nuk pranohet dhe nëse është e qëlluar por nuk është e sinqertë nuk pranohet, derisa t’i ketë të dyja këto cilësi. E sinqertë është kur bëhet vetëm për Allahun dhe e qëlluar kur bëhet sipas Sunetit.”⁴⁶

Ibën Kethiri në komentin e fjalës së Allahut “**Kush shpreson takimin e Zotit të tij, le të punojë punë të mirë dhe mos t’i shoqërojë në adhurim Zotit të tij askënd**” thotë:

“**Le të punojë punë të mirë**’, punë që është në përputhje me Sheriatin e Allahut, ndërsa ‘**të mos i shoqërojë në adhurim Zotit të tij askënd**’ ajo është puna me të cilën personi ka për qëllim vetëm fytyrën e Allahut, pa i bërë shok Atij. Këto janë dy shtyllat e punës së pranueshme, e cila duhet patjetër të jetë e sinqertë për Allahun dhe e qëlluar sipas Sheriatit të Profetit (salallahu alejhi ue selem).”

Irbad ibn Sarije (radijallahu anhu) ka thënë: “Na këshilloi Profeti (salallahu alejhi ue selem) me një këshillë të tillë, sa sytë rrodhën lot dhe zemrat u tronditën prej saj.” Dikush tha: “O i Dërguar i Allahut! Sikur të ishte kjo këshilla e lamtumirës, prandaj çfarë porosie do të na lesh?” Ai tha: “U porosis për devotshmëri ndaj Allahut, të dëgjoni dhe të bindeni edhe nëse bëhet i pari juaj një rob etiopian, sepse ai që do të jetojë prej jush pas meje, do të shohë përçarje të shumta. Prandaj kapuni fort pas sunetit tim dhe sunetit të khulefave të udhëzuar dhe të drejtë. Kapuni fort pas tij dhe shtrëngojeni me dhëmbë. Ruhuni prej shpikjeve në fe, sepse çdo shpikje

) “Mexhmua el Fetua”, vëll.18, fq. 150.⁴⁶

është bidat dhe çdo bidat është humbje.”⁴⁷

Profeti (salallahu alejhi ue selem) njoftoi për përcarjet që do të ndodhnin pranë kohës në të cilën ai jetoi, se ato do të ishin të shumta dhe ai që do të jetonte prej tyre, do t’i shihte ato. Më pas udhëzoi për mënyrën e ruajtjes dhe shpëtimit, të cilat janë: pasimi i sunetit të tij dhe i sunetit të halifëve të drejtë, si dhe lënia e bidateve dhe shpikjeve në fe. Nxiti për pasimin e Sunetit me fjalën e tij: “Kapuni fort pas sunetit tim dhe sunetit të halifeve të drejtë” dhe tërhoqi vërejtje prej bidatit dhe shpikjeve në fe me fjalën e tij: “Ruhuni prej shpikjeve në fe, sepse çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje.”

Muslimi në “Sahihun” e tij, transmeton nga Xhabir ibën Abdullahi (radijallahu anhu) se Profeti (salallahu alejhi ue selem), kur mbante hutben e xhumasë thoshte: “Në vijim, fjala më e mirë është fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (salallahu alejhi ue selem). Gjërat me të këqia janë shpikjet në fe dhe çdo shpikje në fe është humbje.”⁴⁸

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush e kundërshton sunetin tim, ai nuk është prej meje.”⁴⁹

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “O njerëz. Kam lënë tek ju diçka, që nëse kapeni pas saj nuk do të humbni asnjëherë, Librin e Allahut dhe sunetin e Profetit të Tij.”

Po ashtu ka thënë: “Kam lënë tek ju dy gjëra, që nëse kapeni pas tyre nuk do të humbni asnjëherë, Librin e Allahut dhe sunetin tim.”⁵⁰ Ndërsa tek Muslimi në hadithin e gjatë të Xhabirit (radijallahu anhu) në haxhin e lamtumirës, gjendet fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kam lënë tek ju diçka që nëse do të kapeni pas saj nuk do të humbni asnjëherë, Librin e Allahut. Ju do të pyeteni për mua, e çfarë do të thoni?” Ata thanë: “Dëshmojmë se ti e ke përcjellë, kryer dhe këshilluar.” Atëherë e ngriti gishtin e tij lart nga qielli duke

) Transmeton ebu Daudi, nr. 4467. Ky është teksti i tij. Po ashtu Tirmidhiu, nr. 2676 dhe ibn Maxheh, nr. 4443. ⁴⁷ Tirmidhiu ka thënë se hadithi është i mirë, i saktë.

) Transmeton Muslimi, nr. 867.⁴⁸

) Transmeton Buhariu, nr. 5063 dhe Muslimi, nr. 1401.⁴⁹

) Transmeton Hakimi, 1-93.⁵⁰

bërë me shenjë nga njerëzit dhe tha: “O Allah dëshmo! O Allah dëshmo! O Allah dëshmo! (tri herë).”⁵¹

Transmeton Buhariu nga ebu Hurejra (radijallahu anhu) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “I gjithë Umeti im do të hyjë në xhenet, përveç atij që refuzon.” Thanë: “O i Dërguari i Allahut! Kush është ai që refuzon?” Tha: “Kush më bindet mua, hyn në xhenet, dhe kush më kundërshton mua, ka refuzuar.”⁵²

Buhariu dhe Muslimi, (teksti është i Muslimit) transmetojnë nga ebu Hurejra (radijallahu anhu) se ai e ka dëgjuar Profetin (salallahu alejhi ue selem) të thotë: “Nga ajo që ju kam ndaluar largohuni, ndërsa atë që jua kam urdhëruar kryejeni sa të keni mundësi, sepse ata që kanë qenë para jush janë shkatërruar nga pyetjet e shumta dhe kundërshtimet ndaj profetëve të tyre.”⁵³

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk beson askush prej jush, derisa pasioni (dëshira) i tij, të jetë pasues i asaj me të cilën kam ardhur.”⁵⁴

Hafidh ibn Haxheri në “El Fet’h” ka thënë: “Bejhakiu në ‘El med’hal’ dhe ibn Abdulberri në ‘Bejanul ilm’, transmetojnë nga një grup prej tabiinëve si Haseni, ibën Sirini, Shurejhi, Shabiu, Nehaiu, me zinxhirë transmetimi të mirë, për qortimin e fjalëve që thuhet në fe vetëm me opinione të pabazuara. Të gjitha thëniet e tyre i përmbledh hadithi i ebu Hurejres (radijallahu anhu): “Nuk beson askush prej jush derisa epshi (pasioni) i tij të jetë pasues i asaj me të cilën kam ardhur.”⁵⁵

Transmeton Buhariu dhe Muslimi se Umeri (radijallahu anhu) shkoi tek guri i zi, e puthi dhe tha: “Unë e di se ti je gur, nuk bën as dëm e as dobi. Nëse nuk do të kisha parë të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem) të të puthte, nuk do të të kisha puthur.”⁵⁶

) Transmeton Muslimi, nr. 1218.⁵¹

) Transmeton Buhariu, nr. 7280.⁵²

) Transmeton Buhariu, nr. 7288 dhe Muslimi nr. 1337.⁵³

⁵⁴) E ka saktësuar Neveviu tek 40 hadithet. Hadithi është nga Abdullah ibën Amri.

) “El Fet’h” (13/289). Ndërsa hadithin e transmeton Hasen ibën Sufjani dhe të tjerë veç tij. Trasmëtuesit e tij janë ⁵⁵ të besueshëm dhe imam Neueviu e ka saktësuar këtë hadith në fundin e 40 haditheve.

) Transmeton Buhariu, nr. 1597 dhe Muslimi, nr. 1270.⁵⁶

Transmeton Muslimi nga ebu Hurejra (radijallahu anhu) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush fton në udhëzim, ka shpërblim sa shpërblimi i të gjithë atyre që e kanë pasuar, pa u pakësuar prej shpërblimit të tyre asgjë. Kush fton në humbje, ka mëkat sa mëkati i të gjithë atyre që e kanë pasuar, pa u pakësuar prej mëkateve të tyre asgjë.”⁵⁷

Ashtu siç erdhën në Kur’an dhe Sunet argumente që nxisin për pasimin e Sunetit dhe tërheqin vërejtje për bidatin, po ashtu transmetohen thënie të shumta nga të parët e këtij Umeti, pasues të Kur’anit dhe Sunetit, nga sahabët, tabi’inët dhe të tjerë pas tyre, të cilët nxisin për pasimin e Sunetit dhe tërheqin vërejtje për bidatet duke sqaruar rrezikun e tyre:

- Abdullah ibn Mesudi ka thënë: “Pasoni dhe mos shpikni sepse ju mjafton.”⁵⁸

- Uthman ibn Hadiri ka thënë: “Hyra tek ibn Abasi dhe i thashë: ‘Më këshillo.’ Më tha: ‘Po! Bëhu i devotshëm ndaj Allahut, përqëndrohu, paso dhe mos bëj bidat.’”⁵⁹

- Abdullah ibn Mesudi ka thënë: “Kush dëshiron ta takojë Allahun nesër si musliman, le t’i ruajë këto namaze kur thërritet për to, sepse Allahu i ka ligjëruar Profetit tuaj (salallahu alejhi ue selem) rrugët e udhëzimit. Këto namaze janë prej rrugëve të udhëzimit, e nëse ju do të faleni në shtëpitë tuaja, ashtu siç falet ai që nuk merr pjesë me xhematin, do të linit rrugën e Profetit tuaj (salallahu alejhi ue selem). Nëse do të linit sunetin e të Dërguarit tuaj do të humbisnit.”⁶⁰

- Abdullah ibn Umeri (radijallahu anhu) ka thënë: “Çdo bidat është humbje edhe nëse njerëzve u duket i mirë.”⁶¹

) Transmeton Muslimi, nr. 2674.⁵⁷

⁵⁸) Transmeton Darimiu, nr. 211.

) Transmeton Darimiu, nr. 141.⁵⁹

) Transmeton Muslimi (654).⁶⁰

) Transmeton Muhamed ibn Nasër Mervezi në librin e tij “Es Suneh”.⁶¹

- Muadh ibën Xhebel ka thënë: “Ruhuni prej asaj që shpiket, sepse ajo që shpiket është humbje.”⁶²

Një burrë i shkroi Umer ibën Abdulazizit (radijallahu anhu) rreth caktimit (kaderit). Umeri (radijallahu anhu) i shkruajti duke i kthyer përgjigje: “Në vijim të porosis për devotshmëri ndaj Allahut dhe të jesh i mesëm në fenë e tij, ta pasosh sunetin e Profetit të tij (salallahu alejhi ue selem), dhe të lesh çdo gjë që kanë shpikur bidatçinjtë, pasi është përhapur suneti tij (salallahu alejhi ue selem). Është e mjaftueshme mbajtja e tij, prandaj, kapu fort pas Sunetit se ai, me lejen e Allahut, është mburojë për ty.”⁶³

- Sehl ibn Abdullah Tusteriu ka thënë: “Kush shpik diçka në dije, do të pyetet për të Ditën e Gjykimit, nëse përputhet me Sunetin shpëton, në të kundërt jo.”⁶⁴

- Ebu Uthman Nejsaburi ka thënë: “Kush bën Sunetin prijës për veten, fjalët dhe veprat e tij, do të flasë me urtësi. Kush bën prijës epshin do të flasë me bidate.”⁶⁵

- Imam Maliku ka thënë: “Kush shpik në Islam një bidat të cilin e mendon të mirë, ai ka pretenduar se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) ka tradhëtuar shpalljen, sepse Allahu ka thënë: **‘Këtë ditë e përsosa fenë tuaj, plotësova mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe.’**”⁶⁶

- Imam Ahmedi ka thënë: “Bazat e Sunetit tek ne janë: kapja pas rrugës së shokëve të Profetit (salallahu alejhi ue selem), pasimi i tyre dhe lënia e bidatit, sepse çdo bidat është humbje.”⁶⁷

Pasimi i Sunetit është detyrë, si në baza ashtu edhe ne degëzime

) Trasnsmeton ebu Daudi (4611).⁶²

) Transmeton ebu Daudi (4612).⁶³

) “Fet’h el Bari”, fq. 13-219.⁶⁴

) “Hiljetu el Eulija“, 10-144.⁶⁵

) “El Iatizam” i Shatibiut, fq. 1-28.⁶⁶

) “Sherh usul i’atikad es-sunneh” i Lalekait, fq. 317.⁶⁷

Pasimi i sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem), duke i bërë gjërat sipas Kur'anit dhe Sunetit, siç është obligim në çështjet e Akides, bazuar në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Ai që do të jetojë prej jush, do të shohë përçarje të shumta, prandaj kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të halifëve të udhëzuar dhe të drejtë”, po ashtu është obligim edhe në çështjet e Fikhut, në të cilat lejohet “ixhtihadi” kur argumenti është i qartë. Dijetarët e hershëm të këtij Umeti, prej tyre katër imamët: ebu Hanife, Maliku, Shafiu, dhe Ahmedi, Allahu i mëshiroftë, kanë porositur që të merret nga mendimet e tyre ajo që argumentohet me argument dhe të lihen këto mendime nëse nuk përputhen me hadithin e saktë të Profetit (salallahu alejhi ue selem). Thënia e imam Malikut: “Prej çdokujt merret dhe lihet, përveç Profetit (salallahu alejhi ue selem)”, tashmë është bërë shumë e njohur. Po ashtu imam Shafiu ka thënë: “Kanë rënë dakort të gjithë njerëzit (prej muslimanëve), se kujt i bëhet i qartë suneti i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), nuk i lejohet ta lerë atë, për shkak të fjalës së askujt.”⁶⁸

Ibn Kajim, pak para se të përmendë këtë thënie thotë:

“Kush i vë dhe i peshon fjalët e dijetarëve me argumentet e Kur'anit dhe Sunetit, pastaj refuzon ato fjalë që nuk përputhen me argumentet (Kur'anin dhe Sunetin), nuk i ka nënvlerësuar fjalët dhe vlerën e dijetarëve, përkundrazi, ai i ka ndjekur ata, pasi të gjithë ata për këtë kanë urdhëruar. Pasues i vërtetë i tyre është ai që zbaton porositë e tyre, jo ai që i kundërshton ata.”

Shumë dijetarë që punonin në Fikhun e dijetarëve të katër medhhebeve, bazoheshin në argumentet e sakta kur ato vinin në kundërshtim me fjalët (e medhhebit) e tyre.

Kështu Esbeg ibn Ferexh thotë: “Fërkimi (mbi meste) nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dhe sahabët e mëdhenj, kur je në vendin tend, është më i fortë dhe më i vërtetuar për ne, se sa të pasojmë Malikon që nuk pajtohet

) “Err-Rruh” i ibën Kajim, fq. 395.⁶⁸

me të.”⁶⁹

Ibn Haxheri në “El fet’h” thotë: “Malikijtë nuk mendojnë se duhet përdorur dheu në larjen e enës kur e lëpin qeni. Ndërsa Karafi, i cili është prej tyre, ka thënë se ‘Hadithet janë saktësuar rreth kësaj, prandaj është çudi se si ata nuk mendojnë kështu’.”

Dijetari maliki ibn Arabiu ka thënë: “Namazi i xhenazes në mungesë, sipas malikijve, nuk i lejohet askujt përveç Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), ndërsa ne mendojme se atë që e ka vepruar Muhamedi (salallahu alejhi ue selem), e vepron edhe Umeti i tij, pasi veprimi (i Profetit) në origjinë nuk është i veçantë (vetëm për Profetin). Na thonë: ‘Atij iu mbështoll toka dhe xhenazja ishte prezente përpara tij.’ U themi: ‘Zoti ynë është i plotfuqishëm për një gjë të tillë dhe Profeti ynë (salallahu alejhi ue selem) e meriton atë, por ju duhet të flisni vetëm atë që transmetohet dhe mos shpikni hadithe nga vetja juaj. Transmetoni vetëm hadithe të sakta dhe lërinë të dobtat, sepse ato janë rrugë shkatërrimi që të çon drejt asaj që nuk rregullohet’.”⁷⁰

Ibën Kethiri, kur flet për namazin e mesëm thotë: “Është vërtetuar në sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem) se ai është namazi i ikindisë, prandaj është detyrë ndjekja e tij.” Më pas përmend fjalën e imam Shafiut i cili ka thënë: “Për çdo gjë që kam thënë në kundërshtim me fjalën e saktë të Profetit (salallahu alejhi ue selem), përparësia i takon fjalës së tij dhe mos më imitoni mua.” Gjithashtu ka thënë: “Nëse kam thënë një fjalë e cila është në kundërshtim me hadithin e saktë, atëherë unë tërhiqem prej fjalës sime dhe them atë që thotë hadithi.”

Më pas ibn Kethiri vijon në fjalën e tij:

“Ky është virtyt i besnikërisë dhe i lartësisë së tij. Këtë karakter kanë edhe vëllezërit e tij dijetarë, Allahu i mëshiroftë dhe qoftë i kënaqur prej të gjithëve, amin. Prandaj gjykatësi el Mauerdi e ka thënë prerë se Shafiu mendon që

) “Fet’hul bari”, vëll. 1, fq. 306.⁶⁹

) “El fet’h”, vëll. 3, fq. 189. Shiko edhe tek “Nejlu el eutar” të Sheukanit, vëll. 4, fq. 54.⁷⁰

namazi i mesëm është ai i ikindisë, bazuar në saktësinë e haditheve që dëshmojnë për këtë, edhe pse sipas “mendimit të ri” ai është namazi i sabahut. Me metodën e tij janë pajtuar edhe disa dijetarë të hadithit në medhhebin e Shafiut dhe për këtë falenderimi dhe mirësia i takon Allahut.”⁷¹

Ibën Haxheri në “El fet’h” thotë: “Ibën Huzejme, për ngritjen e duarve kur çohesh pas dy rekateve të para, ka thënë se ‘Ajo është sunet, edhe pse Shafiun nuk e ka përmendur, pasi zinxhiri i transmetuesve është i saktë, dhe vetë ai ka thënë: ‘Thoni (Veproni) sipas Sunetit dhe lereni fjalën time.’”⁷²

Gjithashtu thotë se ibën Huzejme ka thënë: “Dijetari e ka të ndaluar ta kundërshtojë Sunetin, pasi e ka ditur atë.”⁷³

Sërish në “El fet’h” ka thënë se Bejhakui në “El marife” transmeton nga Rabiun i cili thotë se Shafiun ka thënë: “Transmetohet një hadith ku thuhet që gratë lejohen të jenë të pranishme në ditë bajramesh. Nëse ky hadith është i saktë, atëherë ky është mendimi im.” Bejhakui më pas thotë: “Hadithi është i saktë, e transmeton Buhariu dhe Muslimi prej Ummu Atijes, prandaj shafinjtë duhet ta pranojnë atë.”⁷⁴

Neveviu kur shpjegon sahiun e Muslimit, përmend mospajtimin e dijetarëve për abdesin pas ngrënies së mishit të devesë dhe më pas thotë: “Ahmed ibn Hambeli dhe Is’hak ibn Rahavejhi kanë thënë se për këtë çështje janë transmetuar dy hadithe, ai i Xhabirit dhe ai i Berrasë. Ky mendim ka argument më të fortë, edhe pse shumica e dijetarëve janë kundër tij.”⁷⁵

Ibn Haxheri në komentimin e hadithit të ibn Umerit (radijallahu anhu): “Jam urdhëruar të luftoj njerëzit”,⁷⁶ thotë: “Në këtë ngjarje ka argument se Suneti mund të mos ruhet (dihet) nga disa prej sahabëve të mëdhenj, por dihet nga disa të tjerë. Prandaj nuk vështrohen mendimet, sado të forta qofshin, nëse Suneti i

) Shiko tefsirin e ibën Kethirit në komentimin e fjalës së Allahut të Madhërishtëm: “**Ndiqni rreptësisht faljen, e sidomos faljen e mesme dhe qëndroni para Allahut me bindje e përkushtim.**” El Bekare: 238.

) “El fet’h”, vëll. 2, fq. 222.⁷²

) “El fet’h”, vëll. 3, fq. 95.⁷³

) “El fet’h”, vëll. 2, fq. 470.⁷⁴

) Shpjegimi i sahiuhut të Muslimit, vëll. 4, fq. 49.⁷⁵

) Në ngjarjen e debatit mes ebu Bekrit dhe Umerit rreth luftimit të penguesve të zekatit.⁷⁶

kundërshton ato dhe nuk thuhet se ‘si ka mundësi që filani nuk e di këtë’.”⁷⁷

Gjithashtu thotë: “Kështu mendon për shenjën e ‘hedjit’ në haxh shumica e dijetarëve të hershëm dhe të mëvonshëm, bazuar në saktësinë e haditheve që dëshmojnë për këtë. Tahaviu në librin ‘Ihtilaful ulema’ përmend se ebu Hanife mendonte se ishte mekruh, ndërsa të tjerët e shikonin për të pëlqyer si pasim (për sunetin e saktë), saqë edhe dy nxënësit e tij, Muhamedi dhe ebu Jusufi kanë thënë se ajo është e mirë.”⁷⁸

Të gjitha bidatet janë humbje dhe nuk ka asnjë bidat të mirë

Të gjitha bidatet janë humbje, bazuar në fjalën gjithpërfshirëse të Profetit (salallahu alejhi ue selem) në dy hadithet e mëparshme të Xhabirit dhe Urbadit: “Çdo bidat është humbje.” Kjo gjithëpërfshirje në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), tregon se fjala e atyre që thonë se në Islam ka bidate të mira, është e kotë. Për këtë ibn Umeri (radijallahu anhu) në një transmetim që u përmend pak më parë thotë: “Çdo bidat është humbje, edhe nëse njerëzit e shohin të mirë atë.”

Nuk thuhet se në Islam ka bidat të mirë, duke u bazuar në fjalët e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush bën në Islam një sunet të mirë, ka shpërblimin e tij dhe të atyre që punojnë me të pas tij, pa u pakësuar prej shpërblimeve të tyre asgjë. Kush bën në Islam një sunet të keq, ka mëkatin e tij dhe mëkatin e atyre të cilët punojnë me të pas tij, pa u pakësuar prej mëkateve të tyre asgjë”,⁷⁹ sepse qëllimi në këtë hadith është shpejtimi për veprat e mira dhe pasimi i atij që shpejton në to, siç shihet qartë kjo në shkakun e hadithit të përmendur në “Sahihun” e Muslimit, para thënies së këtyre fjalëve në hadith. Në të tregohet se një grup njerëzish prej fisit Mudar erdhën në Medine. Ata shfaqnin shenjat e varfërisë dhe skamjes, prandaj Profeti (salallahu alejhi ue selem) i nxiti njerëzit që të jepnin sadaka. Erdhi një burrë prej ensarëve dhe në

) “El fet’h” (1-76).⁷⁷

) “El Fet’h” vëll. 3, fq. 544.⁷⁸

) Transmeton Muslimi (1017).⁷⁹

dorën e tij kishte një qese me para të mbushur aq plot, sa gati nuk e mbante dot. Pas tij njerëzit erdhën radhë-radhë për të dhënë sadaka. Atëherë Profeti (salallahu alejhi ue selem) tha: “Kush bën në Islam një sunet të mirë...”, e deri në fund.

Në këtë hadith hyn edhe ai që ringjall një sunet të saktë të Profetit (salallahu alejhi ue selem) në një vend ku ky sunet nuk është i njohur. Por nuk është e mundur që ai të ketë kuptimin e shpikjes së diçkaje në fe, sepse Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”

Sheriati islam është i plotë dhe nuk ka nevojë për shpikje të reja, pasi me shpikjen e bidateve ai akuzohet se është i mangët dhe i paplotësuar. Më parë përmendëm fjalën e ibën Umerit (radijallahu anhu): “Çdo bidat është humbje, edhe nëse njerëzit e shohin të mirë atë” dhe fjalën e imam Malikut: “Kush shpik në Islam një bidat të cilin e mendon të mirë, ka pretenduar se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) ka tradhëtuar shpalljen, sepse Allahu ka thënë: **‘Sot plotësova fenë tuaj për ju’** dhe çdo gjë që nuk ka qenë prej fesë në atë kohë, nuk është as sot.”

Ndërsa bashkimi me një imam që Umeri (radijallahu anhu) u bëri njerëzve në namazin e teravive, është në aspektin e ringjalljes së Sunetit dhe shfaqjes së tij, pasi Profeti (salallahu alejhi ue selem) u priu njerëzve në namazin e teravisë disa netë, por nuk vazhdoi më nga frika se mos bëhej obligim për Umetin.⁸⁰ Por me vdekjen e Profetit (salallahu alejhi ue selem) shpallja u ndërpre dhe nuk kishte si të bëhej më obligim, kështu që mbeti në gradën e punëve të pëlqyera. Atëherë Umeri (radijallahu anhu) i bashkoi njerëzit në namazin e teravisë, ndërsa fjala e tij në lidhje me faljen e taravive siç e transmeton Buhariu: “Sa bidat i mirë është ky”,⁸¹ ka për qëllim bidatin në kuptimin gjuhësor dhe jo në atë të Sheriatit.

) Transmeton Buhariu, nr. 1129.⁸⁰

) E transmeton Buhariu, nr. 2010.⁸¹

Ndryshimi ndërmejt bidatit në kuptimin gjuhësor dhe atij në kuptimin fetar

Kuptimet gjuhësore, në shumicën e rasteve, janë më të përgjithshme se kuptimet e Sheriatit, pasi domethënia e Sheriatit, në shumicën e rasteve është pjesë e domethënieve gjuhësore. Si shembull i kësaj janë fjalët “et-takua”, “el sijam”, “el haxh”, “el umre”, “el bidat” etj.

Në kuptimin gjuhësor fjala “takua” do të thotë të vendosë njeriu mes tij dhe mes çdo gjëje që ka frikë, një mburojë e cila e mbron prej saj, si psh. ndërtimi i shtëpive ose i çadrave për t’u mbrojtur nga i nxehti dhe i ftohti, apo përdorimi i këpucëve për t’u mbrojtur nga çdo gjë që na mundon gjatë ecjes në tokë. Ndërsa në Sheriat me “takua” nënkuptohet të vendosë muslimani ndërmjet tij dhe zemërimit të Allahut, një mburojë e cila e mbron nga ky zemërim. Kjo gjë arrihet duke zbatuar urdhërat dhe duke u larguar nga ndalesat.

“Sijam” në gjuhën arabe, ka kuptimin e privimit. Ndërsa në Sheriat është privim i veçantë, duke u privuar prej ngrënies, pirjes dhe çdo gjëje tjetër që e prish agjërimin, nga momenti i agimit deri në perëndim të diellit.

“Haxh” në gjuhën arabe është çdo lloj synimi, ndërsa në Sheriat është synimi i vajtjes në Mekë për të kryer rite të caktuara.

“Umre” në gjuhën arabe ka kuptimin e çdo vizite, ndërsa në Sheriat është vizita e Kabes bashkë me tavafin rreth saj, ecja ndërmjet Safasë dhe Mervasë dhe rruajtja e flokëve ose shkurtimi i tyre.

“Bidat” në gjuhën arabe ka kuptimin e çdo shpikjeje, e cila nuk ka pasur shembull më parë, ndërsa në Sheriat ka kuptimin e çdo shpikjeje, e cila nuk ka bazë në fe, pra është antonim i Sunetit.

Dobitë e lira nuk konsiderohen bidate

Dobia e lirë (el mesalihul el murseletu), është ajo dobi të cilën Sheriati as nuk e ka marrë në konsideratë dhe as nuk e ka mohuar. Ajo është mjet për të

realizuar diçka të ligjëruar, si p.sh. mbledhja e Kur'anit në kohën e ebu Bekrit dhe Uthmanit (radijallahu anhum), regjistrimi i gjendjes civile dhe regjistrimi i nënpunësve. Në Sheriat nuk ka ndonjë argument që pohon apo mohon ndonjërin prej tyre. Por mbledhja e Kur'anit është një rrugë për ta ruajtur dhe për të mos humbur asgjë prej tij. Gjithashtu me të realizohet fjala e Allahut: **“Ne e zbritëm Kur'anin dhe ne do ta ruajmë atë.”** Kur Umeri i propozoi ebu Bekrit (radijallahu anhum) mbledhjen e Kur'anit, ky i fundit hezitoi dhe i tha: “Si të bëj atë që nuk e ka bërë Profeti?” Umeri tha: “Pasha Allahun, kjo është e dobishme.” Pastaj Umeri vazhdoi t'i bënte një propozim të tillë, derisa Allahu ia hapi gjoksin dhe mendoi ashtu siç mendoi Umeri.”⁸² Ebu Bekri e mblodhi Kur'anin në dorëshkrime, ndërsa Uthmani në një libër të vetëm.

Ndërsa regjistrimi në regjistra u bë në kohën e Umerit (radijallahu anhu), atëherë kur u shtuan çlirimet dhe plaçka e luftës. Kështu u bë e nevojshme regjistrimi i emrave të ushtarëve dhe nëpunësve. Kjo nuk praktikohet para kohës së tij, por ajo ishte një mënyrë që bënte të mundur t'i arrinte e drejta atij që i takonte, pa humbur asgjë prej saj.

Nuk mund të thuhet se disa bidate janë të mira prandaj i konsiderojmë ato si “dobitë e lira”, sepse “dobitë e lira” janë mjete që çojnë në realizimin e diçkaje të ligjëruar në Sheriat, në dallim nga bidatet të cilat përmbajnë në vetvete akuzën ndaj Sheriatit për mangësi, sikurse u sqarua kjo në fjalën e imam Malikut.

Bashkë me qëllimin e mirë duhet edhe përputhja me Sunetin

Dikush që nënvlerëson çështjen e bidateve mund të thotë se ai që punon bidatin për t'u afruar tek Allahu, qëllimin e ka të mirë, prandaj në këtë aspekt, puna e tij është e lavdëruar. Atij i përgjigjemi se bashkë me qëllimin e mirë, duhet patjetër që puna të jetë në përputhje me Sunetin, e cila është një nga dy kushtet e pranimit të punës së mirë, të përmendura më parë. Ato janë sinqeriteti

) Transmeton Buhariu, nr. 4679.⁸²

për Allahun dhe pasimi i sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem).

E përmendëm më sipër hadithin që tregon refuzimin e bidatit prej atij që e punon atë. Kjo është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem) në hadithin e transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi: “Kush shpik në fenë tonë, çka nuk është prej saj ,ajo është e refuzuar”, ndërsa në tekstin e Muslimit: “Kush punon ndonjë punë e cila nuk është prej fesë sonë, ajo është e refuzuar.” Argumenti që tregon se qëllimi i mirë patjetër duhet të shoqërohet me përputhjen e Sunetit, është ngjarja e sahabiut që theri kurbanin e tij para namazit të Bajramit. Profeti (salallahu alejhi ue selem) i tha: “Delja jote është dele mishi.”⁸³

Hafidhi ibn Haxheri, në shpjegimin e këtij hadithi në “El fet’h” thotë: “Shejh ebu Muhamed ibn ebi Xhemreti ka thënë se në këtë hadith ka argument se puna, edhe nëse është me qëllim të mirë, është e saktë vetëm pasi të jetë në përputhje me Sheriatin.”⁸⁴

Gjithashtu, për këtë gjë argumenton ajo që transmetohet në “Sunenin” e Darimiut me zinxhir transmetimi të saktë, se Abdullah ibn Mesudi (radijallahu anhu) erdhi tek disa njerëz të ulur në xhami në formë rrethi. Në duar mbanin guralecë dhe një burrë u thoshte: “Thoni *Allahu Ekber* 100 herë.” Ata thonin 100 herë *Allahu Ekber* duke numëruar me guralecë. Pastaj u thoshte: “Thoni *La ilahe il Allahu uahdehu la sherike lehu lehul mulku ue lehul hamdu ue hue ala kuli shejin kadir* 100 herë, *subhan Allah* 100 herë.” Qëndroi pranë tyre dhe tha: “Çfarë është kjo që po shoh të bëni?” Thanë: “O ebu Abdurrahman! Numërojmë dhikrin me guralecë.” Tha: “Numëroni të këqijat tuaja, sepse për të mirat tuaja bëhem unë garant që nuk ju humbet asgjë. Të mjerë ju o Umeti i Muhamedit! Sa i shpejtë është shkatërrimi juaj! Shokët e Profetit tuaj (salallahu alejhi ue selem) akoma janë të shumtë, rrobat e tij akoma nuk janë tretur, enët e tij akoma nuk janë thyer. Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirt im, ju ose jeni në një rrugë më të mirë se sa rruga e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), ose keni hapur portën e humbjes!” Thanë: “Për Zotin o ebu Abdurrahman, deshëm vetëm hajër.” Tha: “Sa shumë janë ata që e duan të

) Transmeton Buhariu, nr. 955 dhe Muslimi, nr. 1961.⁸³

) “El fet’h”, vëll. 17, fq. 109.⁸⁴

mirën, por nuk e arrijnë atë ...”⁸⁵

Rreziku i bidateve dhe sqarimi se ato janë më të rënda se gjynahet

Rreziku i bidateve është i madh dhe e keqja e tyre është e madhe. Ato janë më të rrezikshme se gjynahet, sepse gjynahqari e di që ka bërë një gjë të ndaluar, mund ta lerë atë dhe të pendohet, ndërsa bidatçiu mendon se është në të drejtë dhe mund të vazhdojë të punojë bidatin e tij derisa të vdesë, ndërsa në realitet ai është pasues i tekave (epshit) dhe i devijuar nga rruga e drejtë.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Atij iu duk e bukur puna e tij e keqe dhe e kujtoi atë për të mirë. Allahu udhëzon kë dëshiron dhe humbet kë dëshiron.” Fatir: 8.

“A është ai i cili është në dëshmi të qartë nga Zoti i tij, si ata të cilëve veprat e liga që ata bëjnë, u zbukurohen para syve të tyre ndërsa ndjekin nefsën e vet (e dëshirat e liga)?” Muhamed: 14.

“O Daud! Me të vërtetë që Ne të kemi vendosur ty si trashëgues në tokë, kështu që gjyko mes njerëzve me të vërtetën e drejtësinë dhe mos ndiq dëshirën tënde, pasi ajo do të të largojë nga rruga e Allahut. Sigurisht që ata të cilët enden të humbur larg Udhës së Allahut (do të) kenë ndëshkim të rreptë për shkak se ata harruan Ditën e Llogarisë.” Sad: 26.

“Por nëse ata nuk të përgjigjen ty (nuk të besojnë ty dhe Mesazhin tënd të besimit islam, as nuk të ndjekin ty), atëherë dije pra se ata ndjekin vetëm dëshirat e tyre. Dhe kush është më i gabuar se ai i cili ndjek dëshirat e veta pa udhëzim nga Allahu? Sigurisht që Allahu nuk e udhëzon popullin Dhalimun (politeist, mosbesimtar, keqbërës e të pabindur ndaj Allahut).” Kasas: 50.

Nga Enesi (radijallahu anhu) është transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Allahu e ka penguar teuben ndaj çdo bidatçiu derisa ta lerë

) E transmeton Darimiu në “Sunenin” e tij, nr. 210. Shiko “Es silsiletu es sahihatu” të shejh Albanit, 2005.⁸⁵

bidatin e tij.”⁸⁶

Bidatet janë në besim, vepër dhe fjalë

Bidat ndahen në disa lloje, në besim, në shprehje dhe në vepra. Bidati në vepra ndahet sipas kohës dhe sipas vendit.

- Bidatet në besim janë si bidati i havarixhëve, i shiave, i mu'tezilëve etj., të cilët bazohen në “ilmul kelam” dhe disa të tjerë bazohen në hadithe të shpikura.

Ibn Abdulberri në librin e tij “Xhamiul bejanil ilm” thotë: “Dijetarët e Fikhut dhe të hadithit në gjithë vendet islame, janë pajtuar unanimisht se “ehlul kelami” janë bidatçinj dhe të devijuar. Ata sipas të gjithëve dhe në të gjitha vendet, nuk renditen në radhën e dijetarëve. Dijetarë janë vetëm ata që pasojnë hadithin dhe e kuptojnë atë, e të cilët shquhen për përvetësimin dhe veçoritë e tij.”⁸⁷

- Bidatet në shprehje janë si shprehja e nijetit me zë, p.sh. “kam bërë nijet të fal këtë”, “kam bërë nijet të agjëroj këtë” etj. Këtu bën përjashtim vetëm haxhi dhe umreja. Ai që bën umre thotë “lebejke umreten”, ai që bën haxh “ifrad” thotë “lebejke haxhen”, ndërsa ai që bën haxh “kiran” thotë “lebejke umreten ue haxhen”, sepse kjo është transmetuar në Sunet.

Prej bidateve në shprehje është t’i lutesh Allahut me pozitën apo të drejtën e dikujt, e të tjera si këto, të cilat nuk janë transmetuar në hadithe të sakta nga Profeti (salallahu alejhi ue selem). Disa bidate në shprehje janë kufër, si për shembull t’u lutesh të vdekurve dhe t’u kërkosh atyre ndihmë për zgjidhjen e halleve, largimin e fatkeqësive e të tjera gjëra të cilat kërkohen vetëm prej Allahut, sikurse ka thënë Allahu: **“Vërtet që xhamitë janë për Allahun, kështu që mos lutni asnjë tjetër bashkë me Të.”** El Xhin: 18.

) E ka përmendur el Mundhiri në librin e tij: “Et-tergibu uet-terhib” (86), kur flet për frikësimin e lënies së Sunetit, ⁸⁶ rënies në bidate dhe rendjes pas tekave (epsheve). Ka thënë se këtë hadith e ka transmetuar Taberani, zinxhiri i transmetimit është i mirë. Shiko edhe “Es-silsiletu es-sahihiletu” të shejh Albanit, nr. 1620.

) “Xhamiul bejanil ilm”, vëll. 2, fq. 95.⁸⁷

“Kush është ai që i përgjigjet të pikëlluarit kur ai lutet dhe e largon të keqen dhe u bën ju trashëgues të tokës brez pas brezi? A ka të adhuruar tjetër me Allahun? Sa pak përkujtoni!” En-Neml: 62.

Ndërsa gjykimi për atë që i thotë këto shprehje, se është kafir, bëhet vetëm pasi t’i jetë sqaruar argumenti. Ky është mendimi i shumë dijetarëve. Në kapitullin e pestë të librit tim “Mukadimetut tat’hiril itikad” kam përmendur shtatë prej tyre duke filluar me imam Shafiun dhe duke mbaruar me imam Muhamed ibn Abduluehab.

- Bidatet në vepra janë vendore dhe kohore.

a) Bidatet vendore janë si p.sh. prekja e varreve dhe puthja e tyre. Neueuiu në “El mexhmua” thotë për prekjen dhe puthjen e murit të varrit të Profetit (salallahu alejhi ue selem):

“Askush nuk duhet të mashtrohet nga kundërshtimi dhe veprimi i shumicës, pasi pasimi dhe puna duhet të bazohen në hadithe të sakta dhe në fjalët e dijetarëve dhe jo tek risitë apo injoranca e këtyre njerëzve apo e tjetërkujt. Në “Sahihun” e Buhariut dhe Muslimit, transmetohet nga Aishja (radijallahu anha) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”

Në një trasmetim tek Muslimi: “Kush punon një punë që nuk është në fenë tonë ajo është e refuzuar.” Ndërsa ebu Hurejra (radijallahu anhu) tregon se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Mos e bëni varrin tim vendtubim (për festim), por dërgoni salavate për mua, sepse salavatet tuaja më arrijnë mua kudo që të jeni.” Transmeton ebu Daudi me zinxhir të saktë.

Fudejl ibën Ijad, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Ndiq rrugët e udhëzimit dhe mos të të dëmtojë ty numri i paktë i atyre që ndjekin këtë rrugë. Kujdes nga rrugët e humbjes dhe mos u mashtro me shumicën e të shkatërruarve. Kush kujton se prekja me dorë apo diç e tillë, është më e plotë në bereket, atë e ka nga injoranca dhe shkujdesja e tij, sepse bereketi është vetëm në atë që pajtohet me Sheriatin, e si mund të kërkohet mirësia duke kundërshtuar të

drejtën?!”⁸⁸

b) Prej bidateve kohore është festimi i ditëlindjeve, si festimi i ditëlindjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem), (mevludi), i cili është bidat i shpikur në shekullin e katërt të hixhretit, pasi nuk transmetohet që Profeti (salallahu alejhi ue selem), halifët, sahabët, tabiinët dhe ndjekësit e tyre e festonin atë. Në treqind vitet e para pas Profetit (salallahu alejhi ue selem) ky bidat nuk ekzistonte. Në librat e hartuar gjatë kësaj periudhe, mevludi nuk përmendet. Në fakt ky bidat lindi në shek. IV të hixhretit. Atë e shpikën ubejditët të cilët sunduan Egjiptin. Takijudin Ahmed ibn Ali Makrizi, në librin e tij “El meuaidh bi dhikril hutat uel athar”, tregon që fatimitët kishin festa dhe ditë të shënuara gjatë vitit. Ai i përmendi këto festa të cilat ishin shumë, dhe prej tyre ishte mevludi i Profetit (salallahu alejhi ue selem), lindja e Aliut, Fatimes, Hasanit dhe Husejnit (radijallahu anhum) dhe lindja e halifit Hadir.⁸⁹ Ibn Kethiri në “El bidaje uen nihaje” për ndodhitë e vitit 567, vit i cili përkon me fundin e shtetit të tyre, ka thënë: “Në shtetin e tyre u shfaqën bidate dhe haramet, u shtuan të shthururit dhe u pakësuan dijetarët dhe adhuruesit e mirë...”

Pak para kësaj, ibën Kethiri përmend se Salahudini hoqi nga ezani fjalët (hajaaleh-hajril a'mel) në të gjithë Egjiptin.

Libri “El koulul fasl fi hukmil ihtifal bi meuludi hajrir rusul” i shejh Ismail ibn Muhamed Ensariut është nga librat më të mirë të shkruar për këtë çështje.

Nuk ka dyshim se dashuria për Profetin (salallahu alejhi ue selem), duhet të jetë në zemrën e çdo besimtari më e madhe se dashuria e tij për babain, nënën, djalin, vajzën e tij dhe njerëzit e tjerë, nisur nga fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Nuk beson askush prej jush derisa të jem më i dashur tek ai se prindi, fëmija e tij dhe të gjithë njerëzit.”⁹⁰ Mirëpo dashuria për Profetin (salallahu alejhi ue selem) është vetëm me ndjekjen e tij dhe me ecjen sipas metodës së tij, dhe jo me bidate të shpikura, siç thotë Allahu: **“Thuaj! Nëse e**

) “El Mexhmua”, vëll. 8, fq. 206.⁸⁸

) “El meuaidh bi dhikril hutat uel athar” (1-490).⁸⁹

) Transmeton Buhariu dhe Muslimi.⁹⁰

doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, Allahu do t'ju dojë ju dhe do t'ju falë gjynahet tuaja. Allahu është Falës, Mëshirues.” Ali Imran: 31.

Bidati i provokimit të njerëzve, duke kërkuar mendimin e tyre për persona të caktuar

Një bidat i urryer i shfaqur në këtë kohë, është se disa pasues të Sunetit provokojnë njëri-tjetrin duke kërkuar mendimin e tyre për persona të caktuar, çfarëdo qoftë arsyeja e provokimit, ose për ta nënvlerësuar njeriun për të cilin pyetet, apo për ta lavdëruar më tepër seç duhet. Nëse pas këtij provokimi pajtohesh me mendimin e provokuesit, atëherë të mirëpret, të falënderon dhe të lavdëron, përndryshe të bën “xherh” (të analizon gabimet), të quan bidatçi, të bojkoton dhe paralajmëron të tjerët që të ruhen prej teje.

Këto citime, të cilat janë marrë nga shejhul islam ibn Tejmije, Allahu e mëshiroftë, në fillim flasin për bidatin e provokimit për persona të cilët i urren, ndërsa në fund flasin për bidatin e provokimit për persona të tjerë të cilët i lavdëron tej mase.

Shejhul islami në “Mexhmu’ul fetava”, duke folur rreth Jezid ibn Muavijes thotë: “Mendimi i saktë është qëndrimi që kanë mbajtur dijetarët, që ai nuk veçohet me dashuri por as nuk mallkohet. Megjithatë, edhe nëse ai ka qenë i prishur ose i padrejtë, Allahu e fal të prishurin dhe të padrejtin, sidomos nëse ka kryer të mira të mëdha. Imam Buhariu transmeton në “Sahihun” e tij nga ibn Umeri (radijallahu anhu) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ushtrisë së parë që do të përleshet me Konstandinopojën do t’i falen mëkatet.” Ushtria e parë e cila e sulmoi atë, kishte për komandant Jezid ibn Muavijen dhe në ushtrinë e tij bënte pjesë ebu Ejub Ensariu (radijallahu anhu).

Prandaj duhet të jemi racionalë në këtë çështje, duke mos e përmendur Jezid ibn Muavijen dhe duke mos provokuar muslimanët për të, sepse ky provokim është prej bidateve që kundërshtojnë rrugën e ‘ehli suneh uel

xhema'ah'.”⁹¹

Në faqen 415 thotë: “Njësoj është edhe përçarja e Umetit dhe provokimi i tyre me atë që as Allahu dhe as i Dërguari i tij (salallahu alejhi ue selem) nuk kanë urdhëruar.”

Në të njëjtin libër thotë: “Askujt nuk i lejohet të ngrejë për këtë Umet figurën e dikujt tjetër veç Profetit (salallahu alejhi ue selem), duke i ftuar njerëzit në rrugën e tij dhe duke i miqësuar dhe armiqësuar ata për hir të tij. Po ashtu askush nuk mund të përhapë ndonjë fjalë, me qëllim që të miqësojë apo armiqësojë nëpërmjet saj, përveç fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe për atë që ka rënë dakord unanimisht i gjithë Umeti. Kjo është vepër e bidatçinjve të cilët provokojnë njerëzit duke kërkuar mendimin e tyre për persona të caktuar apo fjalë, dhe me to përçajnë Umetin, miqësojnë dhe urrejnë për hir të kësaj fjale apo asaj përkatësie.”⁹²

Gjithashtu thotë: “Nëse profesori apo mësuesi urdhëron për bojkotin, uljen ose largimin e një personi, atëherë shikohet problem i këtij personi. Nëse ka bërë ndonjë gjynah, sipas Sheriatit ai ndëshkohet aq sa duhet ndëshkuar ky mëkat dhe jo më tepër, por nëse nuk ka bërë gjynah, sipas Sheriatit nuk lejohet të ndëshkohet për shkak të qëllimit të profesorit apo të tjetërkujt.

Mësuesit nuk duhet t’i përçajnë njerëzit në grupacione dhe të veprojnë gjëra që fusin mes tyre urrejtje dhe armiqësi. Përkundrazi, ata duhet të jenë vëllezër që ndihmojnë njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri, sikurse ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Ndihmoni njëri-tjetrin në të mira dhe në devotshmëri, dhe mos bashkëpunoni në të këqija dhe padrejtësi.”**⁹³

Nëse në këtë kohë, do të lejohej provokimi i njerëzve me emrin e ndonjë personi, për të njohur se kush është pasues i Sunetit e kush jo, kjo do t’i takonte shejhut islam, myftiut të dynjasë, imamit të pasuesve të Sunetit në kohën e tij,

) “Mexhmul fetava”, vëll. 3, fq. 413-414.⁹¹

) “Mexhmu el fetava”, vëll. 20, fq. 164.⁹²

) “Mexhmu el fetava”, vëll. 28, fq. 15-16.⁹³

shejhut tonë, dijetarit Abdulaziz bin Abdullah bin Baz, i cili vdiq më 27 Muharrem të vitit 1420 h., Allahu e mëshiroftë, e faltë dhe e shpërbleftë pa kufi.

Atë e ka njohur i madh e i vogël për diturinë e tij të gjerë, dobinë e madhe, sinqeritetin, butësinë, keqardhjen, përkujdesin dhe përkushtimin e treguar për udhëzimin e njerëzve. Ne kështu e njohim atë, por nuk pastrojmë para Allahut askënd. Ai kishte një menhexh të rrallë në thirrjen për tek Allahu, në mënyrën se si u mësonte njerëzve gjërat e vlefshme, në urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Ai karakterizohej për butësinë e tij, si në këshilla, ashtu edhe në kritikën e tij të shumta ndaj të tjerëve. Me këtë menhexh të drejtë ai drejtonte pasuesit e Sunetit dhe nuk i sulmonte ata, i ngrinte lart dhe nuk u kundërvihej, i lartësonte dhe nuk u mvishte epitete. Me këtë menhexh bashkonte dhe nuk përçante, lehtësonte dhe nuk vështirësonte, i drejtonte dhe nuk i ndante. Sa nevojë kanë ata që prokupojnë me dijen dhe kërkimin e saj, për ndjekjen e kësaj rruge të drejtë dhe ndjekjen e këtij menhexhi të madh, për mirësinë që u sjell muslimanëve dhe dëmin që largon prej tyre.

Detyra e pasuesve dhe të pasuarve, të cilët kanë rënë në këtë provokim, është lënia e kësaj rruge që përçau pasuesit e Sunetit dhe futi mes tyre armiqësi. Pasuesit (e këtij bidati) duhet ta lënë këtë provokim dhe çdo rrjedhojë të tij si urrejtja, bojkoti e shkëputja e marrëdhënieve dhe duhet të jenë vëllezër të dashur e të bashkuar, ndihmues të njëri-tjetrit në mirësi dhe devotshmëri.

Ndërsa të pasuarit (në këtë bidat) duhet të distancohen prej kësaj rruge në të cilën u pasuan, duke e deklaruar hapur distancimin e tyre prej saj dhe prej aktivitetit të çdokujt që ka rënë në ndikimin e saj. Kështu pasuesit do të shpëtojnë prej kësaj sprove, dhe të pasuarit do të shpëtojnë nga pasimi si shkaktarë të këtij provokimi dhe të dëmeve që vijnë prej tij, dëme të cilat bien mbi ta dhe mbi të tjerët.

Paralajmërimi për fitnen e “texhrihut” (analizimi i gabimeve të të tjerëve) dhe cilësimit “bidatçi” nga disa prej pasuesve të Sunetit në këtë

kohë

I përfaqësuar me bidatin e provokimit të njerëzve duke kërkuar mendimin e tyre për persona të caktuar, është ajo që ndodh në këtë kohë nga një grup i vogël i pasuesve të Sunetit, të cilët kanë rënë në fitne duke bërë “xherh” (analiza e gabimeve) dhe duke i bërë bidatçinj disa vëllezër të tyre prej “ehli sunetit”. Si pasojë e kësaj u përhap “hexhri” (bojkoti), shkëputja e marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe pengimi i njerëzve që të përfitojnë prej tyre.

Ndonjëherë ky “xherh” dhe shpallja si bidatçi, bazohet në diçka që në realitet nuk është bidat, duke thënë se është bidat. Shembull për këtë është fetvaja që i kanë dhënë një xhemati dy dijetarët e mëdhenj, Abdulaziz bin Bazi dhe ibën Uthejmini, Allahu i mëshiroftë, që ky xhemat të angazhohej në një çështje, të cilën këta dijetarë e panë me interes. Prej atyre që nuk u pëlqeu kjo fetva ishte edhe ky grup i vogël, të cilët e kritikuan dhe e qortuan atë xhemat për veprën që bënë. Por puna nuk përfundoi këtu, pasi ata filluan të qortojnë edhe ata që bashkëpunonin me atë xhemat për dhënie ligjëratash, duke i cilësuar si të devijuar nga “menhexhi i selefët”, edhe pse këta dy dijetarë të mëdhenj u mbanin ligjëratat këtij xhemati nëpërmjet telefonit.

Po ashtu është edhe paralajmërimi për t’u ruajtur nga prezantimi në mësimin e ndonjë personi, sepse ai nuk flet kundër një personi apo një xhemati të caktuar.

Ai që ka më shumë gisht në këtë, është njëri prej nxënësve të mi, i cili është diplomuar në fakultetin e Sheriatit në Universitetin Islamik në vitin 1395-1396 h., dhe nga 119 të diplomuar në atë vit, ky ishte i 104-ti në listën e renditjes. Ai nuk është i njohur për preokupim në dije dhe nuk di që të ketë mësimet dijetarësh të inçizuar, apo ndonjë libër dije të vogël apo të madh. Gjithë bagazhi i tij është t’i bëjë “xherh” dhe të cilësojë “bidatçinj” njerëzit, si dhe t’i paralajmërojë ata që të ruhen prej një pjese të madhe të “ehli sunetit”. Ky analist i gabimeve, nuk u arrin as në majën e gishtit atyre kundër të cilëve ka folur, për shkak se dobia është e madhe në mësimet, ligjëratat dhe shkrimet e tyre. Çudia gati nuk mbaron, kur njeriu i logjikshëm dëgjon një kasetë të këtij personi që përmban

inçizimin e një telefonate të gjatë ndërmjet Medines dhe Algjerisë. Ky person ka ngrënë në të mishin e shumë prej vëllezërve të “ehli sunetit”, ndërsa pyetësi ka humbur pasurinë e tij duke e shpenzuar padrejtësisht. Është pyetur në këtë kasetë për më shumë se 30 vetë, mes të cilëve më i madhi në pozitë është një ministër, deri tek një pakicë, për të cilët nuk të vjen keq që ka folur kundër tyre. Disa persona për të cilët nuk është pyetur në këtë kasetë, kanë shpëtuar, por edhe këta të cilët shpëtuan prej kësaj kasete, nuk kanë shpëtuar pa u përfolur në disa kaseta të tjera të tij, të cilat i gjen në internet. Ky person e ka për obligim të ndalojë së ngrëni mishin e dijetarëve dhe të nxënësve të dijes, ndërsa të rinjtë dhe nxënësit e dijes e kanë obligim që të mos e kthejnë vështrimin e tyre te ky lloj “xherhi” dhe te kjo tendencë e “bërjes bidatçi”, e cila sjell dëm e jo dobi. Le t’i përkushtohen preokupimit me dijen e dobishme, e cila gjithmonë u sjell mirësi dhe fund të suksesshëm në dynja dhe në ahiret.

Hafidh ibën Asakër, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij “Tebjину kedhibil mufteri” në fq. 29 ka thënë: “Dije vëllai im! Allahu na dhëntë sukses për të arritur kënaqësinë e Tij dhe na bëftë prej atyre që i frikësohen Atij ashtu siç e meriton t’i frikësohesh, dije se mishi i dijetarëve, Allahu i mëshiroftë është i helmuar, ndërsa veprimi i Allahut ndaj atyre që nënvlerësojnë dijetarët është i ditur.”

Në librin tim “Të sillemi butë me pasuesit e Sunetit”, kam përmendur një numër të madh ajetesh, hadithesh dhe fjalësh të dijetarëve rreth rëndësisë së ruajtjes së gjuhës ndaj cënimit të “ehli sunetit” dhe në mënyrë të veçantë të dijetarëve. E megjithatë, ky person që bën “xherh” nuk e pëlqeu librin dhe e cilësoi si të pavlefshëm për t’u shpërndarë. Ai paralajmëroi për t’u ruajtur prej këtij libri dhe prej atij që e shpërndan atë. Pa dyshim se kushdo që shikon këtë “xherh” dhe librin, do të vërejë se gjykimi i tij është në një luginë, ndërsa libri në një luginë tjetër. Është me të vërtetë ashtu sikurse ka thënë poeti:

Syri mund ta mohojë dritën e diellit, prej hirit në të

Dhe goja shijen e ujit, për shak të sëmundjes.

Përsa i përket fjalës së këtij nxënësi që i ka bërë “xherh” librit “Të sillemi butë me pasuesit e Sunetit” se: “Menhexhi i shejh Abdulaziz bin Bazit dhe shejh ibën Uthejminit ndryshon nga menhexhi i pjesës tjetër të ‘ehli sunetit’”, pa dyshim që kjo fjalë është gabim. Kjo do të thotë se ata nuk bëjnë shumë kundërpërgjigje dhe nuk u përgjigjen kundërshtarëve. Nëse do të ishte e saktë, kjo gjë është në kundërshtim me menhexhin e “ehli sunet uel xhema’ah”. Kjo fjalë në të vërtetë është goditje kundër dy dijetarëve dhe të tjerëve veç tyre, për të cilët mund të thuhet këto fjalë.

Përgënjeshtrimi i fjalës së tij organizohet në tri pika:

E para. Në libër nuk thuhet se shejh Abdulaziz bin Bazi, Allahu e mëshiroftë, nuk i ka të shumta kundërpërgjigjet, përkundrazi, kundërpërgjigjet e tij janë të shumta. Në fq. 51 të librit është përmendur: “Të jetë kundërpërgjigjja me butësi dhe dëshirë të fortë, në mënyrë që personi i cili ka gabuar, të shpëtojë prej gabimit kur ai është i qartë dhe i dukshëm. Prandaj duhet të kthehemi në kundërpërgjigjet e shejh Abdulaziz bin Bazit, Allahu e mëshiroftë, për të përfituar prej tyre mënyrën se si duhet të jetë kundërpërgjigjja.

E dyta. Nuk kam përmendur aspak menhexhin e shejh ibën Uthejminit, Allahu e mëshiroftë, në kundërpërgjigje, dhe kjo sepse unë nuk njoh ndonjë libër të tij, qoftë i madh apo i vogël, në aspektin e kundërpërgjigjeve. Pyeta njërin prej nxënësve të tij të afërt për këtë dhe më njoftoi se nuk dinte për ndonjë libër të shejhut rreth kundërpërgjigjeve. Megjithatë, kjo nuk e ul aspak gradën e shejhut, sepse ai ishte i preokupuar për sqarimin e dijes, përhapjen e saj dhe shkrimin e librave.

E treta. Menhexhi i shejh Abdulaziz bin Bazit, Allahu e mëshiroftë, ndryshon nga menhexhi i këtij nxënësi që bën “xherh” dhe i kujtudo tjetër që është i ngjashëm me të. Kjo sepse menhexhi i shejh bin Bazit karakterizohet nga butësia, përkujdesja dhe interesimi që i këshilluari të përfitojë, si dhe marrja e tij për dore në rrugën e shpëtimit. Ndërsa ky që bën “xherh” dhe ata që

i ngjasojnë këtij, karakterizohen nga ashpërsia, largimi dhe paralajmërimi për t'u ruajtur prej personave të caktuar. Shumë prej atyre të cilëve ky person u ka bërë “xherh” në kasetat e tij, shejh bin Bazi i lavdëronte, lutej për ta, i nxiste për dave dhe ftimin e njerëzve. Po kështu ka nxitur që të përfitohet dhe të merret dituri prej tyre. Megjithatë unë nuk kam thënë për shejh Abdulaziz bin Bazin, Allahu e mëshiroftë, se nuk i është kundërpërgjigjur të tjerëve. Ndërsa ibn Uthejminin nuk e kam përmëndur fare tek çështja e kundërpërgjigjeve. Atëherë ajo që përmend ky person që bën “xherh”, nuk është në përputhje me atë që thuhet në këtë libër. Kjo është prej argumenteve më të qarta për shpërqëndrimin dhe pasaktësinë e këtij personi. Kur kjo gjë ekziston tek ai në fjalët e shkruara, atëherë si do të jetë puna në të pashkruarat?!

Përsa i përket fjalës së atij që i ka bërë “xherh” librit: “Unë realisht, e kam lexuar librin dhe e njoha qëndrimin e ‘ehli sunetit’ ndaj tij, mbase edhe ju i keni parë kundërpërgjigjet e disa dijetarëve e shejhëve dhe nuk mendoj se kundërpërgjigjet do të ndalen me kaq, sepse ka edhe të tjerë që do t'i kundërpërgjigjen atij, sikurse ka thënë një poet:

Erdhi një vëlla me heshtë në dorë,

Por edhe fisi i xhaxhait tënd ka heshta.

përgjigjja është si më poshtë:

Pasuesit e Sunetit, të cilët i ka pasur për qëllim, janë po ata, menhexhi i të cilëve ndryshon nga menhexhi i shejh Abdulaziz bin Bazit, Allahu e mëshiroftë, të cilin e përmenda pak më parë.

Ai me këtë fjalë kërkon të nxisë vullnetin (dëshirën) e atyre që nuk i njeh, për të shkruar kundër librit, pasi nxiti vullnetin e atyre që i njihte.

Unë realisht nuk nxorra ndonjë heshtë, por paraqita një këshillë, të cilën ai që bën “xherh” dhe të tjerë si puna e tij nuk e pranuan. Sepse këshilla për të këshilluarin është si ilaçi për të sëmurin, ndërkohë që ka prej të sëmurëve që i përdorin ilaçet edhe pse janë të hidhura, duke shpresuar dobinë e tyre dhe ka prej të këshilluarve të cilët epshi dhe kapriçoja e tyre i largon nga pranimi i

këshillës, madje paralajmërojnë që të ruhesh prej saj.

Lus Allahun për të gjithë të kenë sukses, udhëzim dhe shpëtim prej mashtrimeve të shejtanit dhe kurtheve të tij.

Nxënësin që bën “xherh” e kanë shoqëruar edhe tre të tjerë, prej të cilëve njëri në Mekë dhe tjetri në Medine. Ishin prej nxënësve të mi në Universitetin Islamik në Medine. I pari është diplomuar në vitin 1384-1385 h., i dyti është diplomuar në vitin 1391-1392 h., kurse i treti ndodhet në vendin më të largët të jugut të Saudisë. I dyti dhe i treti i kanë cilësuar si bidatçinj ata që shpërndajnë librin, dhe kjo është të bësh bidatçi në përgjithësi, në masë. Nuk e di nëse e kanë ditur apo nuk e kanë ditur se këtë libër e kanë shpërndarë dijetarë dhe nxënës dije, të cilët aspak nuk cilësohen si bidatçinj. Shpresoj prej tyre që të më dërgojnë ato pika mbi të cilat ngrihet gjykimi i bërjes bidatçi në masë, nëse ekzistojnë, në mënyrë që t’i shikoj ato.

Shejh Abdurrahman Sudejsi, imami dhe hatibi i xhamisë së Kabes, ka mbajtur hytbe në të cilën tërhoqi vërejtje për përfoljen e pasuesve të Sunetit mes njëri-tjetrit. Le të merret kjo hytbe në konsideratë, se është e rëndësishme dhe e dobishme.

Lus Allahun e Madhëruar që t’u japë sukses të gjithëve për atë çka e kënaq Atë, për kuptimin e drejtë të fesë, për vendosmërinë në të drejtën dhe për të punuar e për t’u preokupuar me çka na intereson, duke lënë atë që nuk na intereson. Ai është i Plotfuqishëm për këtë dhe paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), mbi familjen dhe shokët e tij.

Kreu 3. Të sillemi butë me pasuesit e Sunetit

Shkroi: Abdulmuhsin bin Hamed el Abad.

Hyrje

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirëshmit, Mëshiruesit.

Falënderimi i takon Allahut i Cili bashkoi zemrat e besimtarëve dhe i nxiti për bashkim, unitet dhe pajtim, si dhe u tërhoqi vërejtjen që të ruhen nga përçarja dhe mosmarrëveshja.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut, i Cili krijoi dhe përcaktoi masë për çdo gjë. Ai është i Cili vendosi dispozita dhe i bëri ato të lehta duke qenë i Mëshirshëm me besimtarët. Dëshmoj se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij, i cili ka urdhëruar për lehtësim dhe përgëzim (në fjalën e tij): “Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos i bëni njerëzit të ikën e të largohen.” O Allah! Shpëtoje dhe bekoje atë, familjen e tij të pastër, shokët e tij të cilët Allahu i ka përshkruar si të ashpër ndaj mosbesimtarëve dhe të mëshirshëm me njëri-tjetrin. Shpëtoji dhe bekoji të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. O Allah! Më udhëzo mua e më bëj shkak për udhëzimin e të tjerëve. O Allah! Pastroje nga smira zemrën time dhe më mundëso që të them të vërtetën me fjalën time. O Allah! Unë kërkoj mbrojtjen Tënde që të më ruash të mos largohem nga e vërteta e as të mos më largojnë nga e vërteta. Kërkoj mbrojtjen Tënde që të më ruash të mos bie në mëkat dhe as të mos më çojë dikush në mëkat. Kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos i bëj padrejtësi ndonjërit dhe as të mos më bëjë padrejtësi ndokush. Kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos injoroj askënd dhe askush të mos më injorojë.

“Ehli suneh uel xhem’ah” janë ata që ndjekin rrugën e Profetit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe shokëve të tij. “Ehli suneti” është ndjekës

rigoroz i sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem), sunet për të cilin i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të katër halifëve te drejtë e të udhëzuar pas meje. Kapuni pas tij dhe shtrëngojeni fort atë me dhëmballë.”

Ai na ka tërhequr vërejtje që të ruhemi nga kundërshtimi i tij duke thënë: “Ruhuni nga gjërat e shpikura në çështjet e fesë, sepse çdo gjë e shpikur është bidat dhe çdo bidat është humbje.” Gjithashtu ka thënë: “Kush largohet nga suneti im, nuk është prej meje.”

E gjithë kjo është në kundërshtim me “ehlul ehua” (ata që ndjekin epsheet dhe bidatet), bidatçinjtë të cilët kanë marrë rrugë që nuk i përkasin të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe shokëve të tij. Besimi i “ehli sunetit” është shfaqur me dërgimin e shpalljes të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), ndërsa besimet e bidatçinjve kanë lindur pas kohës së Profetit (salallahu alejhi ue selem). Disa prej besimeve të tyre janë shfaqur në fundin e kohës së sahabëve, ndërsa disa të tjera janë shfaqur me vonë. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka lajmëruar se kush do të jetojë prej shokëve të tij do ta arrijë këtë përçarje dhe mosmarrëveshje. Ai ka thënë: “Vërtet kush do të jetojë prej jush do të shohë shumë kundërshtime.” Pastaj ka udhëzuar për të ndjekur rrugën e drejtë, e cila është suneti i tij dhe ai i halifëve te drejtë. Ai ka tërhequr vërejtjen që të ruhemi nga shpikjet në çështjet e fesë dhe ka lajmëruar se ato janë humbje.

Nuk është as e logjikshme dhe as e pranueshme që sahabëve t’u ketë shpëtuar njohja e një të vërtete ose udhëzimi fetar e të ruhet ajo për t’u njohur më vonë nga ata që erdhën pas tyre. Të gjitha bidatet e shpikura janë të këqija. Sikur të kishte mirësi në diçka prej tyre, atëherë sahabët do të kishin qenë të parët që do t’i kishin vepruar ato, por në të vërtetë bidatet janë sherr me të cilin janë vënë në provë shumë prej atyre që kanë ardhur pas sahabëve e që kanë devijuar nga rruga e tyre. Imam Malik ka thënë: “Nuk do të rregullohet fundi i këtij Umeti veçse me atë që u rregullua fillimi i tij.” Për këtë arsye “ehli suneti” ndjek me përpikmëri sunetin e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), kurse të tjerët ndjekin besimet dhe idetë e tyre të pasakta siç janë el Xhebrijet, el Kaderijet, el Murxhitë, el Imamije, el Ithna asherij-jeh ose persona të caktuar siç janë el Xhehmijet dhe ez-Zejdijet, esh-Sharijet dhe el Ibadijet.

Nuk është e drejtë të thuhet se e tillë është dhe “el Uehabije”, që i mvishet Muhamed ibn Abdul Uehabit, Allahu e mëshiroftë, sepse ai nuk ka ardhur me diçka të re, por ka ndjekur rrugën e muslimanëve të parë e të devotshëm dhe ka thirrur dhe propoganduar sunetin e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue

selem). Emërtimi “el Uehabije” përdoret nga ata që urrejnë thirrjen ripërtëritëse të shejh Muhammed ibni Abdul Uehabit, Allahu e mëshiroftë, me qëllimin që të ngatërrojnë çështjet, t’i shmangin njerëzit nga ndjekja e së vërtetës dhe udhëzimit dhe t’i lënë ata në bidatet e shpikura, të cilat bien në kundërshtim me rrugën e “ehli sunetit dhe xhematit”.

Imam esh-Shatibiu, në librin e tij “El I’ëtisam” (1/79) tregon se Abdurrahman ibn Mehdi transmeton se është pyetur Malik ibn Enes për Sunetin e ai ka thënë: “Suneti është ai që nuk ka emërtim tjetër veç Sunet”, dhe pastaj lexoi fjalën e Allahut: **“Dhe vërtet kjo është rruga Ime e drejtë, kështu që ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë tjetër, pasi ato do t’ju ndajnë dhe do t’ju largojnë nga rruga Ime...”**

Ibnul Kajim në “Medarixhus salikin” (3/179) ka thënë: “Disa dijetarë janë pyetur për Sunetin dhe kanë thënë se ‘sunet është ajo që nuk emërtohet me diçka tjetër veç këtij emri’, pra ‘ehli suneti’ nuk ka emër tjetër me të cilin emërtohet.”

Në librin “El intika” të ibn Abdul Berrit, është përmendur se një burrë e pyeti imam Malikun: “Kush janë ‘ehli suneh’?” Ai iu përgjigj: “Ehli suneh janë ata të cilët nuk kanë emër tjetër me të cilin njihen (përveç emrit ‘ehli suneh’). Nuk janë as xhehmij, as kaderinj e as rafidinj.”

Nuk ka dyshim se detyra e “ehli sunetit” në çdo kohë e në çdo vend është që të bashkohen, ta mëshirojnë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë në vepra të mira. Prej gjërave që të bëjnë të ndihesh keq sot, është egërsia, ashpërsia dhe konfliktet që hasen nga një pjesë e “ehli sunetit”. Kështu këta merren me njëri-tjetrin duke bërë “xherh”⁹⁴, “tahdhir” dhe “hexhr”. Ndërkohë është detyrë për ta që të gjithë përpjekjet e tyre të drejtohen kundër kafirëve dhe bidatçinjtë të cilët luftojnë Sunetin. Gjithashtu është detyrë që “ehli suneti” të jetë i bashkuar, të afrohen, të mëshirojnë njëri-tjetrin dhe të këshillojnë njëri-tjetrin me butësi. Për këtë arsye e kam parë të arsyeshme të shkruaj disa fjalë duke këshilluar për këtë çështje. I lutem Allahut të bëjë dobi me këto fjalë. Unë vetëm dëshiroj përmirësimin me aq sa kam mundësi e udhëzimi dhe suksesi im mundet të vijë vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i kthehem me pendim. Këtë këshillë e kam titulluar: “Rifkan ehle suneti bi ehli suneh” – “Të sillemi butë me pasuesit e Sunetit”.

) Xherhi në “Mustalah Hadith” (shkencën e hadithit) është përmendja e një transmetuesi me një cilësi që tregon se nuk pranohet transmetimi i tij. Shejhu këtu ka për qëllim akuzimin e dijetarëve dhe thirrësve në Islam me akuza të ndryshme si p.sh. bidatçi, me qëllim që të mos merret dije prej tyre.

Tahdhir do të thotë të tërheqësh vëretje për t’u ruajtur nga diçka ose dikush.

Hexhr do të thotë të ndërpreh marrëdhëniet me dikë.

Lus Allahun të japë për të gjithë mbarësi e sukses dhe orientim për drejtësi. Lus Allahun që t'i rregullojë lidhjet mes tyre, t'i bashkojë zemrat e tyre, t'i udhëzojë në rrugët e paqes dhe t'i nxjerrë nga errësira në dritë. Vërtet Ai është Gjithdëgjues, Përgjigjës (që i përgjigjet lutjes së lutësit).

Mirësia e të folurit dhe e qartësimit

Mirësitë e Allahut ndaj robërve të Tij nuk numërohen dhe nuk llogariten. Prej begative më të mëdha është mirësia e të folurit, me të cilën njeriu sqaron qëllimin e tij, thotë fjalën e drejtë, urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja. Ai që nuk e posedon këtë mirësi, nuk i arrin këto gjëra që përmendëm dhe nuk mund të merret vesh me të tjerët përveçse me anë të shenjave ose shkrimit.

Allahu në Kuran ka thënë: **“Allahu sjell një shembull tjetër: dy njerëz, njëri pa gojë që nuk ka fuqi për të bërë asgjë, i cili është barrë për kujdestarin e tij, ngado që ta çojë ai nuk i sjell asnjë të mirë atij. A është një njeri i tillë njësoj me një tjetër i cili urdhëron drejtësi dhe vetë është në rrugën e drejtë?”** En-Nahl: 76.

Në komentin e këtij ajeti disa dijetarë kanë thënë se: “Allahu ka dhënë një shembull për veten e Tij dhe për idhullin”, disa të tjerë kanë thënë se: “Ky është shembulli i kafirit me besimtarin”. El Kurtubi ka thënë (9/149): “Ky koment është transmetuar nga ibn Abasi, ai është i mirë, sepse është i përgjithshëm (i tërësishëm, përfshirës).”

Ky shembull në mënyrë të qartë tregon vlerën e ulët të skllavit që nuk ka gojë, nuk u bën dobi të tjerëve dhe nuk përfiton prej tij pronari i tij, kudo që ta drejtojë.

Gjithashtu Allahu i Lartësuar në Kur'an ka thënë: **“Për Zotin e qiellit e të tokës ajo është e vërtetë (ajo që ju është premtuar) siç është e vërtetë të folurit tuaj.”** Allahu është betuar në Vetën e Tij për ndodhinë e Ringjalljes dhe shpërblimet për punët, sikurse edhe të folurit është realitet, pra kjo tregon dhe nxjerr në pah mirësinë e të folurit. Gjithashtu Allahu në Kur'an ka thënë: **“Ai krijoi njeriun e i mësoi atij të folurin e bukur (e të shprehurin).”**

El Hasen e ka komentuar fjalën *el bejan* të përmendur në ajet me “të folurit”. Kjo tregon dhe tërheq vëmendjen për mirësinë e të folurit me anë të të cilit njeriu sqaron atë që dëshiron.

Gjithashtu Allahu në Kur'an ka thënë: **“A nuk bëmë Ne për të dy sy dhe një gjuhë e dy buzë ...?”**

Ibn Kethiri ka thënë në tefsirin e tij: “Fjala e Allahut ‘**A nuk bëmë Ne për të dy sy**’, do të thotë dy sy që të shikojë me ta; ‘**dhe një gjuhë**’, do të thotë që të flasë me të dhe të shprehet për atë që ndjen në vetvete; ‘**e dy buzë**’, do të thotë se me anë të tyre flet dhe ha ushqim, dhe në të njëjtën kohë janë bukuri për fytyrën dhe gojën e tij. Dihet që kjo mirësi nuk mundet të jetë mirësi e vërtetë, vetëm nëse të folurit e përdorim në hajër (të mirë), kurse nëse do të përdorej në të keqe, atëherë të folurit do të ketë pasoja të këqija për folësin. Dhe ai që nuk e përdor këtë mirësi do të jetë në një gjendje më të mirë sesa ai që e ka dhe e përdor për keq.

Gjuha duhet të flasë vetem fjalë të mira dhe për mirësi

Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“O ju të cilët keni besuar! Friksojuni Allahut dhe thoni fjalë të mira e të drejta. Allahu do t’jua përmirësojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet tuaja. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij me të vërtetë ka fituar fitimin e madh.”

“O ju të cilët keni besuar! Ruhuni prej hamendjeve se me të vërtetë shumë prej hamendjeve janë gjynah tek Zoti. Mos spiunoni! Mos përgojoni njëri-tjetrin! A dëshiron ndonjëri prej jush të ushqehet me mishin e vëllait të tij të vdekur. Pa dyshim që ju e urreni një gjë të tillë. Friksojuni Allahut, me të vërtetë Allahu është Pranues i pendimit, i Mëshirshëm.”

“Ne e krijuam njeriun dhe e dimë fare mirë se çfarë përshpërisni në vetvetet tuaja. Ne jemi më afër jush se sa vetë damarët e qafave. Kur të tubohen dy melaiket, i së majtës dhe i së djathtës që janë gjithmonë prezentë. Nuk shpreh diçka vetëm se ka pranë tij mbikqyrës, llogaritës të rreptë.”

“Ata të cilët i dëmtojnë besimtarët për diçka që s’e kanë bërë, të tillët kanë bërë (mbartur në vetet e tyre) shpifjen më të madhe.”

Në “Sahihun” e imam Muslimit (hadithi 2589), transmetohet nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “E dini ju ç’është përgojimi?” Thanë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri!” Atëherë tha: “Të përmendësh prej vëllait tënd ndonjë gjë që ai urren të përmendet.” Dikush tha: “Po sikur ta ketë atë gjë që po e përmend.” I

Dërguari (salallahu alejhi ue selem) tha: “Nëse ti përmend diçka që e ka, ky është përgojimi, e nëse thua diçka që nuk e ka, ti ke shpifur për të.”

Allahu thotë:

“Mos merr përsipër të flasësh për atë që nuk ke dije, se me të vërtetë dëgjimi, shikimi dhe të menduarit, për të gjitha do të merret njeriu në llogari.”

Nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) transmetohet se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Allahu kënaqet prej jush kur bëni tri gjëra dhe urren prej jush të bëni tri të tjera. Kënaqet prej jush ta adhuroni të vetëm e të mos i shoqëroni Atij askënd, të bashkoheni të gjithë në fenë e Allahut dhe të mos përçaheni. Urren thashethemet, pyetjet e shumta dhe shpërdorimin e pasurisë.” (Muslimi, hadithi 1715)

Njëkohësisht këto gjëra të urryera kanë ardhur dhe në hadithin e Mugires që transmeton Buhariu në “Sahihun” e tij nr. 2408, po kështu vetëm kjo pjesë në “Sahihun” e Muslimit.

Nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) transmetohet se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Gjithsecilit prej njerëzve i regjistrohet gjynahu i imoralitetit, do apo jo ai. Sytë bëjnë imoralitet dhe imoraliteti i tyre është shikimi në ato gjëra që janë të ndaluara; veshët bëjnë imoralitet dhe imoraliteti i tyre është dëgjimi i gjërave të ndalura (me dëshirë); po kështu edhe gjuha, e imoraliteti i gjuhës është e folura (në haram); po kështu edhe dora, e imoraliteti i saj është lëvizja e saj në haram; po kështu edhe këmba, e imoraliteti i saj është hedhja e hapave për në haram; ndërsa organet seksuale i vendosin vulën kësaj, duke e bërë imoralitetin ose jo.” Buhariu (6612), Muslimi (2658). Shprehjet këtu janë prej librit të imam Muslimit. Buhariu transmeton në “Sahihun” e tij (10) nga Abdullah ibn Amër (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Musliman është ai që muslimanët e tjerë janë të qetë prej dorës dhe gjuhës së tij.” E transmeton edhe imam Muslimi në “Sahihun” e tij (64) me tekstin: “Një burrë e pyeti të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem): ‘Kush është muslimani më i mirë?’ I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) iu përgjigj: ‘Ai që muslimanët e tjerë janë të qetë prej dorës dhe gjuhës së tij.’” Muslimi në hadithin nr. 65 nga Xhabiri, sipas tekstit të parë të Abdullah ibn Amrit (radijallahu anhu) që e përmendëm tek Buhariu më lart.

El Hafidh ibni Haxher, në komentin e këtij hadithi ka thënë: “Hadithi ka gjykim të përgjithshëm për gjuhën, jo dorën. Se gjuha mund të flasë keq për të vdekurit, të gjallët dhe për ata që do të vijnë, ndryshe nga dora. Edhe dora

mund të ketë gjynah si gjuha kur ajo shkruan keq për të tjerët e në këtë rast edhe dora përfshihet në gjithçka që u përmend më sipër, e pa dyshim dëmi i dorës është i madh.”

Pothuajse këtë domethënie poeti ka dashur të thotë në vargjet e tij:

Shkrova tepër i sigurtë atë ditë për ato që shkruhet.

Se dora ime një ditë do të tretet, po shkrimi s’do të shuhet.

Sikur të bëja mirë do të shpërblehesha me më të mirin shpërblim.

E në të kundërt, unë jam ai që do t’i vuajë pasojat me dënim.

Buhariu në “Sahihun” e tij (6474) nga Sehl ibn Sad (radijallahu anhu) transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush më garanton të ruajë atë që ka ndërmjet nofullave dhe kofshëve, unë i garantoj atij Xhenetin.” Pra atij që ruan gjuhën dhe organet seksuale, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) i garantoj Xhenetin.

Buhariu në “Sahihun” e tij (6475) dhe Muslimi në “Sahihun” e tij (74), transmetojnë nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit, të flasë mirë ose të heshtë.”

Neveviu në librin e tij “Shpjegimi i dyzet haditheve”, e ka shpjeguar këtë hadith duke thënë: “Imam Shafiu ka thënë se hadithi ka këtë kuptim: Kush dëshiron të flasë të mendojë mirë. Nëse nuk ka dëm nga e folura e tij, le të flasë. Nëse ka dëm apo dyshon se mund të ketë dëm nga e folura e tij, le të heshtë.” Në të njëjtin vend ai citon thënien e disa dijetarëve: “Nëse ju do të blinit regjistrat e melaikeve që shkruajnë veprat tuaja, do të largoheshit prej shumë fjalëve.”

Imam ebu Hatim, biri i Hiban el Bustij, në librin “Reudatul ukalai ue nuz, hetul fudalai” (fq. 45) thotë: “Obligim për çdo të mençur është që të heshtë veçse kur i duhet të flasë. Sa shpesh njerëzit qortojnë veten e tyre kur flasin dhe sa pak qortohen ata që heshtin. Njeriu më i dëshpëruar dhe më fatkeq është ai që është sprovuar me gjuhë të shfrenuar dhe zemër e mendje të pllakosur.”

Ndërsa në faqen 47 thotë: “I mençuri më shumë dëgjon sesa flet. Janë krijuar dy veshë e një gojë, më shumë për të dëgjuar sesa për të folur. Nëse flet, mbase pendohet për ç’ka folur, nëse ka heshtur, s’ka përse të pendohet. Refuzimi i asaj që s’e ka shprehur është më i lehtë për të sesa refuzimi i asaj që e ka shprehur. Fjalën kur e nxjerr, të sundon, ndërsa kur nuk e nxjerr je ti sunduesi i saj.”

Në faqen 49 të të njëjtit libër thotë: “Gjuha e të mençurit është pas zemrës së tij. Nëse dëshiron të thotë diçka, kalon te zemra, e nëse është në të mirë të tij e thotë, përndryshe jo. Injoranti e ka zemrën në majë të gjuhës, çfarë i vjen e thotë. Nuk e ka kuptuar fenë e tij ai që nuk e ruan gjuhën e tij.”

Buhariu (6477) dhe Muslimi (2988) sipas tekstit të Muslimit, transmetojnë nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Vërtet njeriu flet ndonjë fjalë pa u siguruar në atë që thotë, si pasojë zhytet për shkak të saj në zjarr, më shumë se largësia e lindjes me perëndimin.”

Në mbyllje të hadithit të njohur si porosia e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) drejtuar Muadhrit, birit të Xhebelit (radijallahu anhu), i Dërguari i Allahut tha: “A mos vallë hidhen njerëzit në zjarr me fytyra apo me hundë për tjetër gjë, veç për shkak të të korrurave të gjuhëve të tyre?” Kjo erdhi si përgjigje kur Muadhi pyeti: “A mos vallë o i Dërguari i Allahut, do të merremi në llogari për atë që flasim?” Transmeton Tirmidhiu (2616) dhe ka thënë se hadithi është hasen, sahih.

El Hafidh ibnu Rexheb, në shpjegimin e këtij hadithi në librin e tij “Xhamiul ulumi uel hikem” (2/147) shkruan: “Kuptimi i pjesës të *korrurat e gjuhës* të përmendur në hadith, është shpërblimi dhe dënimi për fjalët e ndaluara. Njeriu me gjuhën e tij mbjell të mirat ose të këqijat e pastaj do të korrë në Ditën e Gjykimit atë që mbolli. Cilido që mbjell mirësi me të folurën dhe me veprën e tij, do të korrë nderim, e ai që mbolli të këqija me të folurën apo veprën e tij, do të korrë qortim e keqardhje.”

Në të njëjtin libër dhe në të njëjtin hadith thotë (2/146): “Të gjitha sa u përmendën tregojnë se mbajtja e gjuhës, ruajtja dhe izolimi i saj është origjina e mirësive. Dhe kush e ruan gjuhën e tij ka zotëruar dhe ka vënë në kontroll hallet, punët dhe çështjet e tij.”

Ka përmendur (2/149) nga Junuz ibn Ubejd: “Kam vënë re se çdokush që logjikon atë që i flet gjuha, ka qenë i kompletuar dhe i përsosur në veprat e tij.”

Jahja ibn ebi Kethir ka thënë: “Nuk është përmirësuar e folura e dikujt, veçse do të vesh re një gjë të tillë në të gjitha veprat e tij, dhe nuk është prishur e folura e dikujt, vetëm se do të vesh re një gjë të tillë në veprat e tij.”

Muslimi në “Sahihun” e tij (hadithi 2581) transmeton nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “A e dini se kush është i falimentuari?” Thanë: “Ai që s’ka as dirhem, as pasuri tjetër.” Tha: “I falimentuari nga Umeti im është ai që do të vijë Ditën e Gjykimit me namaz, zekat e agjërim, mirëpo ka sharë dikë, ka akuzuar dikë, ka

marrë pasurinë e dikujt, ka derdhur gjakun e dikujt dhe ka goditur dikë. Këtij do t'i merren prej të mirave dhe nëse i mbarojnë personit në fjalë të mirat, pa u shlyer të drejtat e të tjerëve, do të merren gjynahet e të tjerëve dhe do t'i hidhen atij, e për shkak të tyre do të hidhet në zjarr.”

Muslimi (hadithi 2564) transmeton nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) një hadith të gjatë në fundin e të cilit citohet: “Mjafton si e keqja më e madhe për ndonjërin prej jush që të nënvlerësojë e të përçmojë vëllain e tij musliman. Çdo musliman e ka të ndaluar gjakun, nderin dhe pasurinë e muslimanit tjetër.”

Buhariu në “Sahihun” e tij (1739) dhe Muslimi gjithashtu (teksti këtu është i Buhariut), transmetojnë nga ibn Abasi (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka mbajtur një hutbe ditën e Bajramit të Kurbanit në të cilën tha: “O ju njerëz! Në cilën ditë jemi?” Thanë: “Në një ditë të shenjtë.” Pyeti: “Në ç’vend jetojmë?” Thanë: “Në një vend të shenjtë.” Pyeti: “Në cilin muaj jemi?” Thanë: “Në një muaj të shenjtë.” Pastaj tha: “Padyshim gjaku, pasuria dhe nderi juaj janë të shenjta për ju si shejtëria e kësaj dite, e këtij vendi, e këtij muaji.” Këtë fjali e përsëriti disa herë pastaj ngriti kokën dhe tha: “O Allah a e përçolla (fenë)? O Allah a e përçolla (fenë)?”

Ibnu Abasi (radijallahu anhu) tha: “Betohem në Atë në dorën e të Cilit ndodhet shpirti im! Kjo është porosia e tij (salallahu alejhi ue selem) për Umetin e tij. Kështu, ai që është i pranishëm t’ia transmetojë atij që nuk është, dhe mos u ktheni pas meje në mohues duke luftuar njëri-tjetrin.”

Muslimi në “Sahihun” e tij (2674) transmeton nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush bëhet shkak për një udhëzim, do të marrë shpërblimin e atyre që e pasojnë, pa iu pakësuar shpërblimeve të tyre asgjë. Kush bëhet shkak për një humbje (devijim), merr gjynahun e atyre që e pasojnë, pa iu pakësuar atyre asgjë.”

El Hafidh el Mundhiri në librin e tij “Et-tergib uet-terhib” (1/65), duke komentuar hadithin “Nëse vdes njeriu i ndërpriten veprat vetëm se në tri raste...”, ka thënë: “Ai që ka shkruar dijen e dobishme ka shpërblimin e tij, gjithashtu shpërblimin e atij që e lexon apo që më vonë e shkruan apo vepron me të, për aq kohë sa mbetet shkrimi i tij e të treguarit për të, siç tregon ky hadith dhe hadithe të tjera. Ndërsa ai që shkruan dije të padobishme prej së cilës meritohet dënimi, merr gjynahun e tij dhe të atij që e lexon, e shkruan dhe punon me të më pas, për aq kohë sa mbetet shkrimi apo vepra e tij. Kjo kuptohet nga hadithi: ‘Kush ringjall në Islam një traditë të mirë apo të keqe...’, dhe Allahu e di më së miri.”

Buhariu në “Sahihun” e tij (6502) transmeton nga ebu Hurejre (radijallahu anhu) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Allahu i Lartësuar ka thënë: *‘Kushdo që armiqëson një prej të dashurve të Mi, Unë atij i kam shpallur luftë ...’*.”

Dyshimi, paragjykimi dhe hulumtimi për zbulimin e të metave të të tjerëve

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“O ju që keni besuar! Largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit.” Huxhurat: 12.

Në këtë ajet urdhërohet që të lihen dyshimet dhe kuptohet qartë se prej dyshimeve ka edhe nga ato që të çojnë në mëkat. Në ajetin e lartpërmendur, gjithashtu ndalohet dhe hulumtimi për zbulimin e të metave të njerëzve, gjë e cila vjen si pasojë e paragjykimeve dhe dyshimeve të këqija.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kini kujdes (ruhuni) nga dyshimi, sepse dyshimi është fjala më e rreme. Mos përgjoni, mos hulumtoni për zbulimin e të metave të të tjerëve, mos kini smirë (zili) ndaj njëri-tjetrit, mos u zemëroni me njëri-tjetrin, mos i ktheni shpinën njëri-tjetrit, por jini rob të Allahut, vëllezër.” Buhariu (6064) dhe Muslimi (2563).

Prijësi i besimtarëve, Umer ibn Hatab (radijallahu anhu) ka thënë: “Mendo vetëm mirë për fjalën që nxjerr vëllai yt besimtar, përderisa t’i mund t’i gjesh asaj justifikim të mirë!” (Siç e përmendi ibn Kethiri në tefsirin e ajetit të sures “Huxhurat”.)

Bekr ibn Abdullah el Muzeniu ka thënë (siç përmendet në biografinë që i është bërë në librin “Tehdhibut-tehdhib”): “Ruhu prej fjalës, të cilën nëse e ke thënë të vërtetë nuk merr shpërblim për të, e nëse e ke thënë gabim ngarkohesh me gjynah prej saj. Ajo fjalë është paragjykimi i keq dhe dyshimi ndaj vëllait tënd.”

Ebu Kalabeh Abdullahi, i biri i Zejd el Xhuremiut ka thënë (siç përmend ebu Nuajmi në librin “Hiljetul eulija” 2/285): “Nëse nga vëllai yt të vjen diçka që nuk e pëlqen prej tij, atëherë me të gjitha mundësitë e tua justifikojë atë. Nëse

nuk gjen ndonjë justifikim, atëherë thuaj me veten tënde: ‘Mbase vëllai im ka ndonjë arsye që unë nuk e di’.”

Sufjan ibn Husejn ka thënë: “Përmenda për keq një burrë në prezencë të Ijjas bin Muaujes. Ky i fundit më pa në fytyrë dhe më tha: ‘Ai i ke luftuar romakët?’ Thashë: ‘Jo!’ Tha: ‘Po sindët, indianët apo turqit?’ Thashë: ‘Jo!’ Tha: ‘Romakët, sindët, indianët e turqit janë të qetë prej teje, ndërsa vëllain tënd musliman nuk e ke lënë të qetë’. Nuk e përsërita më një gjë të tillë.” (“El bidajetu uen-nihajeh” e ibn Kethir, 13/121)

Them (shejh Abadi): “Sa përgjigje të mirë që dha Ijjas ibn Muaujeh, i cili njihej për zgjuarsinë e tij.”

Ebu Hatim ibn Hiban el Busti ka thënë në librin “Reudatul ukalai” (fq. 131): “Është obligim për këdo që ka logjikë, të lerë përgjimin e të metave të njerëzve e të merret me të metat e tij. Ai që merret me të metat e tij duke lënë ato të tjerëve, i dhuron rehati trupit të tij e nuk e lodh zemrën e tij. Sa herë që shikon ndonjë të metë tek vetja, i duket më e lehtë kur të njëjtën e shikon tek vëllai i tij. Ndërsa ai i cili merret me të metat e njerëzve dhe ilëtë vetat, i verbërohet zemra, i lodhet trupi dhe i vështirësohet lënia e të metave të veta.”

Në faqen 133 ai thotë: “Përgojimi është pjesë e hipokrizisë, sikurse të mendosh mirë (për muslimanët) është shenjë e Imanit. Ai që ka logjikë mendon mirë për vëllezërit e tij dhe veçohet me zemërimet dhe mërzitë e tij, ndërsa injoranti (xhahili) mendon keq për vëllezërit e tij e nuk mendon për krimet dhe të këqijat e tij.”

Butësia dhe qetësia

Allahu e ka cilësuar Profetin e Tij, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), si njeri me moral të lartë: **“Vërtet ti je në një shkallë të lartë morali.”** El Kalem: 4.

E ka përshkruar atë si njeri të butë dhe dashamirës: **“E ti ishe i butë ndaj tyre, sepse Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë ata do të iknin larg prej teje ...”** Ali Imran: 159.

E ka përshkruar të mëshirshëm ndaj besimtarëve dhe të dashur me ta: **“Juve ju erdhi i Dërguari nga lloji juaj; atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”** Teube: 128.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka urdhëruar dhe ka nxitur për butësi dhe dashamirësi duke thënë: “Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos largoni.” (Buhariu 69 dhe Muslimi 1734 nga Enesi). Gjithashtu ka transmetuar Muslimi (1732) nga ebu Musa el Eshari me tekst: “Përgëzoni dhe mos largoni, lehtësoni dhe mos vështirësoni.” Ndërsa Buhariu në librin e tij të haditheve të vërteta, ka nxjerrë një hadith (220) nga ebu Hurejre ku Profeti (salallahu alejhi ue selem) u ka thënë shokëve të tij kur një beduin urinoi në xhami: “Lereni atë të qetë, ndërsa urinës së tij hidhini një kovë ujë, sepse ju jeni dërguar lehtësues e jo vështirësues.”

Gjithashtu Buhariu në hadithin nr. 6927 transmeton nga Aishja (radijallahu anha) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) i ka thënë asaj: “O Aishe, Allahu është i Butë dhe e do butësinë në çdo gjë.” Ndërsa Muslimi (2593) e ka nxjerrë me këtë tekst: “O Aishe, Allahu është i Butë dhe jep për të (butësinë) atë që s’e jep për ashpërsinë, si dhe për asgjë tjetër.”

Po ashtu Muslimi ka nxjerrë në librin e tij të haditheve të vërteta (2594) nga Aishja (radijallahu anha) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Butësia zbukuron çdo gjë në të cilën ndodhet, e ajo nuk hiqet prej diçkaje e të mos e shëmtojë atë.”

Po tek Muslimi (2592) transmetohet nga Xherir ibn Abdullah se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kujt nuk i është dhënë butësia i është ndaluar mirësia.”

Allahu ka urdhëruar profetët e nderuar Musa dhe Harun të thërrisin Faraonin me qetësi dhe butësi kur thotë: **“Shkoni ju të dy tek Faraoni, sepse ai vërtet e ka tepruar; atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai përkujton ose frikësohet.”** Ta Ha: 43-44.

Allahu i ka përshkruar sahabët e nderuar si të mëshirshëm me njëri-tjetrin kur thotë: **“Muhamedi është i Dërguari i Allahut, e ata që janë me të janë të ashpër kundër mosbesimtarëve dhe të mëshirshëm ndërmjet veti ...”** El Fet’h: 29

Qëndrimi i “ehli sunetit” ndaj dijetarit nëse ai gabon, është se ai justifikohet, nuk quhet bidatçi e nuk i bëhet “hexhr”

Askujt pas të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) nuk i takon “ismet” (pagabueshmëria). Asnjë dijetar nuk i shpëton gabimit, por ai që gabon

nuk ndiqet në gabimin e tij, sikurse ky gabim nuk bëhet shkas për ta quajtur të mangët ose për të bërë “tehdhir” (tërheqje e vërjetjes për t’u ruajtur prej tij). I falet gabimi i vogël me anë të mirësisë së tij të madhe. Prej dijetarëve të kaluar të cilët mund të kenë gabuar, përfitohet dije, duke pasur kujdes që të mos ndiqen gabimet e tyre. Bëhet dua (lutje) dhe i kërkohet Allahut mëshirë për ta. Ndërsa atij që është gjallë, dijetar apo nxënës dije qoftë, i bëhet vërejtje për gabimin e tij me dashamirësi dhe butësi, duke dashur që ai ta lerë atë gabim e të kthehet në të saktën.

Ka prej dijetarëve që kanë kaluar, të cilët kanë pasur mangësi në çështje të Akides, por dijetarët dhe nxënësit e dijes nuk e kanë lënë dijen e tyre, madje librat e tyre konsiderohen si referenca të rëndësishme për këdo që merret me dijen, siç kanë qenë imamët el Bejheki, en-Neueui dhe ibn Haxher el Askalani.

Imam Dhehebiu në librin e tij “Es-sijer” (18/163) kur flet për imam Ahmed ibn Husejn ebu Bekr el Bejheki thotë: “Ai është hafidhi, dijetari i saktë, fakihu, shejhu i Islamit” - “është begatuar në dijen e tij, ka shkruar vepra të dobishme.” Po ashtu thotë për të: “Iku nga vendlindja e tij për të mbledhur dije e për të shkruar dhe bëri librin e madh “Es-Sunen” me 10 vëllime, e askush nuk ka bërë libër si ai.” Gjithashtu ka përmendur edhe libra të tjerë të tij.

Përcjell nga hafidhi Abdul Gafir ibn Ismail se ai ka thënë për el Bejheki: “Librat e tij arrijnë gati 1000 vëllime, gjë të cilën s’e kish bërë njeri përpara tij. Kish bashkuar mes dijes së hadithit dhe Fikhut, sqarimit të të metave e difekteve të hadithit dhe bashkimit të haditheve me njëri-tjetrin.” Po ashtu thotë: “Shkrimet e Bejhekiut janë me vlerë të madhe e me dobi të shumta, janë të pakët ata që i kanë përsosur librat si imam ebu Bekri (el Bejheki). Kështu, duhet që dijetari të tregojë rëndësi ndaj këtyre (njerëzve dhe librave të tyre) sidomos librit të tij ‘Es-Sunenul kubra’.”

Ndërsa për imam Jahja ibn Sheref en-Nevevi, imam Dhehebiu në librin e tij “Tedhkiretul hufadh” (4/259), ka thënë: “(ai është) Imami, hafidhi, i vetmi, shembulli, shejhu i Islamit, flamuri i eulijave... autori i veprave të dobishme”, sikurse ka thënë “Me gjithë cilësitë e tij të mira, si përpjekja me vetveten e tij, veprimi i gjërave më të imta të devotshmërisë, pastrimit të nefsit prej gjërave të papastra dhe ndalimi i vetes nga qëllimet e këqija, ai ka qenë hafidh në hadith, në shkencat dhe biografite e burrave të hadithit, në njohjen e haditheve të vërteta, në njohjen e të metave dhe defekteve të tij. Ka qenë kokë në njohjen e medh’hebit të tij.”

Ibn Kethiri në librin “El bidajetu uen-nihajeh” (17/540), ka thënë për Neveviun: “Pastaj iu kushtua shkrimit të veprave, përmbledhi në to dije të

shumtë, disa prej veprave i përfundoi dhe disa s'mundi t'i përfundojë. Prej atyre që ka përfunduar janë: 'Sherhu muslim' (Shpejgim i hadithetheve të vërteta të Muslimit), 'Er-reudah', 'El minhaxh', 'Er-rijad', 'El edhkar', 'Et-tibjan', 'Tahriru-teubih ue tes'hihuhu', 'Tehdhibul esmai uel-lugat', 'Tabekatul fukahai' etj. Ndërsa prej atyre që nuk ka përfunduar, e sikur t'i kishte përfunduar nuk do të kishte të njëjtë me të në ato tema të trajtuara, është 'Sherhul muhedh-dheb', të cilin e ka quajtur 'El mexhmu', ku ka arritur deri në kapitullin e kamatës. Këtë vepër e ka përsosur, e ka mbushur plot dobi, ka përdorur në të kritikën në mënyrë të përsosur, ka nxjerrë në të Fikhun e medh'hebit të tij dhe të medh'hebeve të tjera, i ka sqaruar hadithet siç duhet, ka shpejguar gjërat e pazakonta (të vështira), ka përdorur gjuhë të qartë e të përshtatshme dhe ka përmendur gjëra të rëndësishme të cilat nuk përmenden diku tjetër. Nuk di të ketë në shkencën e Fikhut libër më të mirë se ai, megjithëse ka nevojë që t'i shtohen dhe t'i bashkangjiten disa gjëra." Me gjithë këtë gjerësi në veprat e tij, ai nuk ka qenë prej njerëzve që kanë jetuar gjatë (mosha e tij arriti 45 vjeç, 631-676 h.).

Ndërsa el Hafidh Ahmed ibn Ali ibn Haxher el Askalani, është imam i njohur me vepra të shumta. Më e rëndësishmja është "Fet'hul bari" i cili është koment i "Sahihul Buhari". Kjo është referencë madhështore për dijetarët. Gjithashtu prej veprave të tij janë: "El isabeh", "Tehdhibut-tehdhib ue tekribuhu", "Lisanul mizan", "Teaxhilul menfe'ah", "Bulugul meram" etj.

Ndërsa nga dijetarët e shquar bashkëkohorë, është dijetari i shquar në fushën e hadithit, Muhamed Nasirudin el Albani, të cilin nuk di të ketë ndonjë që e konkuron në këtë kohë në kujdes (interesin që ai ka treguar ndaj hadithit dhe njohuritë e thella në këtë fushë). Megjithatë ai nuk ka shpëtuar nga rënia në disa çështje të cilat konsiderohen si gabime të tij nga shumë dijetarë, si interesimi i tij në çështjen e "hixhabit" dhe vendimi i tij se mbulimi i fytyrës së gruas nuk është "vaxhib", por është "mustehab". Edhe sikur të jetë e vërtetë ajo që thotë ai, ajo konsiderohet prej së vërtetës që duhet të fshihet, për shkak të pasojave që sjell kjo te gratë që dëshirojnë zhveshjen e tyre.

Po kështu fjala e tij në librin "Forma e namazit të Pejgamberit" (salallahu alejhi ue selem): "Vërtet vendosja e duarve në gjoks pas ngritjes nga rukuja është bidat, humbje", e kjo është çështje për të cilën dijetarët kanë mendime të ndryshme.

Gjithashtu është ajo që ka përmendur në "Silsiletu ed daife" (2355) se "moshkurtimi i mjekrës që del poshtë kapjes së dorës është bidat", dhe bërja haram prej tij e rrethit të floririt për gratë.

Me gjithë kundërshtimin që i kam bërë atij për këto çështje, mendoj se unë dhe të tjerë veç meje, kemi nevojë për librat e tij dhe përfitimin prej tyre.

Sa e bukur është fjala e imam Malik (rahimeullah): “Çdokujt mund t’i merret ose t’i lihet prej thënieve të tij, përveç atij që gjendet në këtë varr”, dhe bëri me shenjë nga varri i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem).

Më poshtë po sjellim thënie nga një grup dijetarësh në qartësimin e faktit se dijetarit nuk i merren parasysh gabimet e vogla përballë të mirave të tij të shumta.

Sejid ibn Musejeb (93 h.) ka thënë: “Nuk ka ndonjë dijetar ose ndonjë të nderuar e njeri me vlera, që të mos ketë mangësi, por atij që ka më shumë vlera (mirësi) sesa mangësi, nuk i vihen re mangësitë për shkak të vlerës së tij, ashtu siç vlen e kundërta për atë tek i cili dominon mangësia.”

Kurse një tjetër dijetar ka thënë: “Nuk shpëton dijetari nga gabimi, por ai që gabon pak dhe të mirën e ka më të madhe është dijetar, e kush gabon shumë dhe të mirën e ka të pakët është injorant.” (“Xhamiul bejan el ilm ue fadlihi” e ibn Abdil-Berr, 2/48)

Abdullah ibn Mubarek (181 h.) ka thënë: “Kur të mirat e një burri janë më të shumta se të këqijat e tij, nuk i përmenden të këqijat e tij, ndërsa kur të këqijat e tij janë më të shumta se të mirat, nuk i përmenden të mirat e tij.” (“Sijeru ea’lam en-nubela” e Dhehebiut, 8/352, botimi i parë)

Imam Ahmedi (241 h.) ka thënë: “Nuk e kalon askush urën nga Horasani si Is’haku (pra Is’hak ibn Rahauējhi) edhe pse ai na kundërshton në disa çështje, sepse njerëzit përherë kanë pasur mospajtime në mendimet e tyre.”⁹⁵ (“Sijeru ea’lam en-nubela”, 11/371)

Ebu Hatim ibn Hiban (354 h.) ka thënë: “Abdul Melik (pra i biri i ebu Sulejmanit) ka qenë nga banorët më të zgjedhur të Kufes dhe hafizëve të saj. Dihet se ai që flet nga kujtesa e tij gabon dhe nuk është e drejtë që të lihet hadithi i një dijetari të saktë e të drejtë për shkak të ndonjë gabimi në transmetimet e tij. Sikur të ecnim në këtë mënyrë, duhej të mos pranohet hadithin e imam Zuhriut, ibni Xhurejxhit, Theuriut dhe Shu’bes. Të gjithë këta kanë qenë të përsosur dhe kanë transmetuar prej kujtesës së tyre, e megjithatë nuk kanë qenë të pagabueshëm. Mënyra që duhet ndjekur është të pranohet transmetimi i njerëzve të saktë dhe lënia e atyre transmetimeve në të cilat është vërtetuar gabimi i tyre. Kjo përderisa gabimet e tyre janë më të vogla sesa

) Imam Ahmedi do të thotë në fjalën e tij se në atë vend, në Horasan, nuk kishte njeri më të ditur sesa dijetari i ⁹⁵ Islamit Is’hak ibn Rahauējhi. (sh. p.)

saktësia e tyre, në të kundërt do të meritonin mospranimin e hadithit të transmetuar prej tyre.” (“Eth-thikat, 7/97-98)

Shejhul islam ibn Tejmije (728 h.) ka thënë: “Nga çështjet që duhet të dihen është se grupet që i përkushtohen ndjekjes së bazave të fesë dhe të ‘kelamit’ janë në grada të ndryshme. Ka prej tyre që e kanë kundërshtuar Sunetin në bazat e tij dhe ka prej tyre që e kanë kundërshtuar në çështje të hollësishme. Ai i cili është më pranë Sunetit, në rast se kundërshton atë që është më larg prej tij, lavdërohet për këtë kundërshtim dhe për të vërtetën që ka thënë. Por ka prej tyre që kundërshtojnë edhe një pjesë të së vërtetës, p.sh. kundërshton një bidat të madh me një më të vogël, ose një të kotë me një të kotë më të vogël se e para. Kjo është gjendja e shumicën së ‘ehli kelamit’ që pretendojnë se janë prej ‘ehli sunetit’. Nëse atë që thanë nuk e bëjnë thënie me të cilën përçajjnë muslimanët dhe nuk duan e urrejnë për hir të saj, mendimi që kanë shprehur konsiderohet prej gabimeve të tyre, të cilat shpresojmë që Allahu t’ua falë, sepse Allahu i Lartësuar ua fal besimtarëve gabimet e tyre në të tilla çështje.

Për këtë shumë nga selefët e këtij Umeti dhe nga imamët e tyre, kanë dhënë mendime nga ‘ixhtihadi’ i tyre, të cilat kundërshtojnë atë që është në Kur’an dhe Sunet, duke rënë në gabimin e përmendur më sipër. Kjo është ndryshe nga ata të cilët me gabimin e tyre kanë përçarë muslimanët, duan dhe urrejnë për hir të tij, bëjnë ‘kafirë’ dhe ‘fasikë’ kundërshtarët e mendimeve dhe ‘ixhtihadit’ të tyre dhe e bëjnë të lejuar luftimin e këtyre kundërshtarëve. Të tillët janë përçarës.” (“Mexhmul fetaua”, 3/348-349)

Po ashtu ka thënë (19/191-192): “Shumë prej muxhtehidëve të selefëve dhe halefëve (pasardhësve) kanë thënë dhe vepruar gjëra që janë bidat, ose për arsye të hadithit të dobët që kanë menduar se është i saktë, ose për shkak të moskuptimit ashtu siç duhet të qëllimit të ajeteve, ose për shkak të ndonjë mendimi që kanë pasur. Të tillët nëse i frikësohen Allahut sa kanë mundësi, hyjnë në ajetin: **‘Zoti ynë! Mos na ndëshko nëse harrojmë apo biem në gabime.’** Në hadith të saktë thuhet se Allahu ka thënë: “E kam bërë (pra e kam pranuar lutjen tuaj).”

Imam Dhehebiu (748 h.) ka thënë: “Përsa u përket imamëve të mëdhenj, nëse saktësia e tyre është e madhe, dihet përpjekja e tyre për arritjen e së vërtetës, dija e gjerë e tyre, zgjuarsia e tyre, mirësia e tyre, ruajtja nga të këqijat dhe devotshmëria e tyre. Nuk u merren parasysh atyre gabimet, nuk i bëjmë ata të humbur, t’i hedhim poshtë e t’i harrojnë të mirat e tyre. Po! Nuk i ndjekim ata në bidatin apo gabimin e tyre, por shpresojnë që ata të pendohet për to.” (“Sijeru ae’lam en-nubela, 5/271)

“Sikur ne, sa herë që ndonjë imam në ‘ixhtihadin’ e tij në ndonjërin prej çështjeve të bëjë gabim të falshëm, ta bëjmë ‘bidatçi’ dhe ta lëmë atë, nuk do të kishte shpëtuar as ibn Nasr, as ibn Mendeh dhe as ata që janë më të mëdhenj sa këta të dy. Allahu është Udhëzuesi i krijesave për të vërtetën dhe Ai është më i Mëshirëshmi ndër të mëshirëshmit. Lusim Allahun që të na mbrojë nga pasioni dhe ashpërsia.” (“Es-sijer”, 14/39-40)

“Sikur çdonjërin që gabon në ‘ixhtihadin’ e tij duke qenë se besimin e ka të saktë dhe përpiket për të ndjekur të vërtetën, ta nxjerrim jashtë dhe ta bëjmë ‘bidatçi’, të paktë do të jenë ata që do të shpëtojnë prej kësaj. Allahu i mëshiroftë të gjithë me Mirësinë e Tij, Bujarinë dhe Fisnikërinë e Tij.” (“Es-sijer”, 14/376)

“Ne e duam Sunetin e ata që janë në Sunet dhe e duam dijetarin për cilësitë e mira që ai ka në ndjekjen e së vërtetës, por nuk ia duam bidatin që ai ka për shkak të ndonjë interpretimi.” (“Es-sijer”, 20/46)

Imam ibnul Kajim (751 h.) ka thënë: “Njohja e vlerës së imamëve të Islamit, e drejtësisë së tyre, e gradës së tyre, e dijes së tyre dhe këshillës së tyre për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), nuk na detyron të pranojmë çdo gjë prej thënieve dhe fetvave të tyre në ato çështje që nuk kanë argument. Ata thanë atë që dinin, ndërsa e vërteta mund të jetë në kundërshtim me fjalën e tyre. Kjo nuk çon në hedhjen e të gjitha thënieve të tyre, në sharjen dhe përgojimin e tyre. Përkrahja për çdo gjë dhe hedhja poshtë e çdo gjëje, janë ekstreme dhe larg rrugës së drejtë. Rruga e drejtë është ndërmjet këtyre të dyjave, as nuk i bëjmë mëkatarë, as nuk themi se janë të pagabueshëm

Kush ka dije për Sheriatin dhe realitetin, e di në mënyrë të sigurtë se një njeri me vlera të larta, i cili prej kohësh ka ndikim dhe pozitë të mirë në Islam dhe tek muslimanët, mund bjerë në ndonjë gabim për të cilin ai është i justifikuar, madje është i shpërblyer për ‘ixhtihadin’ e tij, edhe pse nuk lejohet që të pasohet në këtë gjë. Gjithashtu nuk lejohet të zbritet nga pozita, imamllëku dhe grada që ka në zemrat e muslimanëve.” (“I’lam el mu’uekiinë”, 3/295)

Ibn Rexhep el Hambelij (795 h.) ka thënë: “Allahu e ka refuzuar pagabueshmërinë për ndonjë libër veç Librit të Tij. I drejtë është ai që i fal gabimet e pakta të personit përballë saktësisë së vazhdueshme të tij.” (“El kauaid”, fq. 3)

Fitneja e “texhrihit” dhe “hexhrit” nga disa anëtarë të “ehli sunetit” të kohës sonë

Në kohën tonë ka ndodhur që disa prej “ehli sunetit” po merren me njëri-tjetrin duke bërë “xherh” dhe “tahdhir” (tërheqje vërejtjeje për t’u ruajtur dhe bërë kujdes nga diçka a dikush). Kjo gjë ka çuar në përçarje, kontradikta dhe braktisje të njëri-tjetrit. Duhet që ata të tregojnë dashuri dhe mëshirë ndërmjet tyre, e të gjithë së bashku të qëndrojnë si një trup i vetëm përballë njerëzve të bidatit dhe atyre që ndjekin pasionet duke kundërshtuar “ehli suneh uel xhemah”. Kjo është pasojë e dy shkaqeve:

Së pari, ka nga “ehli suneti” në kohën tonë, që puna me të cilën merren dhe i janë përkushtuar është ndjekja dhe zbulimi i gabimeve të të tjerëve, qofshin këto gabime nëpër shkrime apo kasete, e më pas bërja “tahdhir” atyre të cilëve u gjendet ndonjë gabim. Nga gabimet për të cilat u bëjnë “texhrih” njerëzve dhe “tehdhir” janë p.sh. bashkëpunimi me ndonjë shoqatë në të cilën jepet ndonjë ligjëratë apo pjesëmarrje me ta në simpoziume e seminare, e mundet që shejh Abdul-Aziz bin Bazi dhe shejh Muhamed ibn Uthejmini të kenë mbajtur ligjëratë me to nëpërmjet telefonit. I llogaritet si gabim e mangësi kësaj shoqate se ka hyrë në një çështje për të cilën i kanë dhënë fetva këta dijetarë të respektuar.

Ndërsa parësorja është që njeriu të akuzojë mendimin e tij para se të akuzojë atë të tjetrit, aq më tepër kur është mendim të cilin e kanë shprehur dijetarët e mëdhenj. Disa prej sahabëve të Profetit (salAllahu alejhi ve selem), pas marrëveshjes në Hudejbie thonin: “Nuk ngrihen gjykimet mbi opinione, por mbi argumente dhe fe.”

Ka nga njerëzit që u është bërë “texhrih”, dobia e të cilëve është e madhe, qoftë me mësimet, bashkimin dhe dashurinë që përcjellin, qoftë me hytbet e tyre, e kur vjen puna u bëhet “tahdhir” për shkak se p.sh. nuk kanë folur për ndonjë person apo xhemat të caktuar.

Madje “texhrihu” dhe “tahdhiri” ka arritur kulmin në disa vende arabe ndaj disa njerëzve, dobia e të cilëve është tepër e konsiderueshme dhe përpjekjet e tyre janë madhështore në triumfimin e përhapjen e Sunetit dhe thirrjen në të. Nuk ka dyshim se “tahdhiri” për të tillë njerëz është prerje e rrugës mes nxënësve të dijes dhe atyre, nga dija dhe morali i të cilëve përfitohet.

Së dyti, ka prej “ehli sunetit” që nëse shohin gabime prej dikujt po prej “ehli sunetit”, shkruajnë kundërpërgjigje për ta dhe ai të cilit i drejtohet kundërpërgjigjia shkruan kundërpërgjigje për kundërpërgjigjen që i drejtohet. Pastaj gjithsecili prej tyre merret me leximin e shkrimeve të tjetrit, të vjetra e të

reja, dhe me dëgjimin e kasetave të njëri-tjetrit, me qëllim që të kapë gabimet dhe të gjejë të metat. E disa prej gabimeve mund të jenë të paqëllimshme (lapsuse) të cilat i ka korrigjuar vetë personi ose dikush tjetër ia ka korrigjuar. Më pas këta shpejtojnë e përpiqen kush e kush të mbledhë më shumë përkrahës të vetvetes dhe përçmues të tjetrit, e çdokush prej përkrahësve mundohet të mbrojë thëniet e atij që përkrah dhe të përçmojë palën tjetër. Detyrojnë ata që i takojnë dhe u flasin, që të mbajnë qëndrim ndaj palës tjetër dhe nëse nuk e bëjnë, i quajnë bidatçinj sepse nuk flasin dhe nuk mbajnë qëndrim ndaj bidatçinjve, d.m.th. palës tjetër. Këtë më pas e pasojnë duke i braktisur personat që s'u binden.

Puna e përkrahësve të çdo pale, si dhe e përçmuesve të palës tjetër, është një nga shkaqet më të mëdha në përhapjen dhe sundimin e fitnes në shtrirje të gjerë.

Edhe më tepër rëndohet kjo çështje kur gjithsecila palë përhap dhe nxjerr në internet përçmime ndaj palës tjetër. E pastaj të rinjtë nëpër vende, madje kontinente të ndryshme, merren me ndjekjen e atyre lajmeve që përhapen nëpër faqet e adresat e internetit të njëri-tjetrit, të cilat janë përgojime dhe thashetheme që nuk sjellin asnjë dobi (hajr), por vetëm dëm (sherr) dhe përçarje, gjë e cila i ka bërë përkrahësit e secilës palë të ngjajnë me ata që dalin në tabelat e reklamave dhe përhapin diçka me rëndësi, ose t'u ngjajnë atyre njerëzve tifoze, ku gjithsecili bën tifozllëk për skuadrën e tij dhe në fund, si rezultat i kësaj, ndodh armiqësi, grindje dhe vetmi.

Rruga e shpëtimit nga kjo fitne

Së pari, për sa i përket “texhrihut dhe tahdhirit” duhen pasur kujdes këto gjëra:

- T'i frikësohet Allahut ai i cili merret me “texhrihun” e dijetarëve dhe nxënësve të dijes, si dhe me “tahdhir” ndaj tyre.

Le të merret me hulumtimin e të metave të vetvetes që t'i rregullojë ato, në vend që të merret me të metat e të tjerëve.

Le të ruajë sevapet (punët e tij të mira) e të mos i harxhojë ato duke ia shpërndarë atyre të cilëve u bën “texhrih” dhe merret me gabimet e tyre. Le ta dijë se ai është më nevojtar për ato sevape në ditën kur nuk bën dobi as pasuria e as fëmijët, përveç atij që i paraqitet Allahut me zemër të shëndoshë.

- Le të merret me marrjen e dijes së dobishme në vend që të merret me “texhrih” dhe “tahdhir”. Le të përpiqet të tregojë seriozitet në dije që të përfitojë e t’u sjellë dobi të tjerëve. Është mirësi për njeriun të merret me dijen, ta mësojë, ta transmetojë atë dhe të bashkojë zemrat me sa të mundet, që të jetë prej atyre që ndërtojnë e rregullojnë.

Të mos merret me “texhrihun” e dijetarëve dhe nxënësve të dijes prej “ehli sunetit”, dhe si pasojë t’i ndërpresë rrugën vetes dhe të tjerëve për të përfituar prej tyre, duke u bërë kështu shkatërrues. Ai që merret me “texhrih”, nëse vdes, nuklëpas tij dije të dobishme dhe njerëzit me vdekjen e tij nuk humbasin ndonjë dijetar prej të cilit përfitohet, përkundrazi, rehatohen prej sherrit të tij.

- I këshilloj nxënësit e “ehli sunetit” që të shkojnë në çdo vend për të marrë dijen e për të lexuar librat e dobishëm dhe të dëgjojnë kasetat e dijetarëve si shejh ibn Bazi dhe shejh ibn Uthejmini, në vend që të merren me telefonata ndërmjet njëri-tjetrit e të pyesin: “Ç’ mendim ke për filanin apo filanin?” (Ç’farë mund të thuash për thënien e filanit për filanin etj.?)

- Kur të pyesin nxënësit e dijes për dikë prej njerëzve që merret me dijen, duhet të kthehen tek Qendra e Fetvave në Rijad për të pyetur rreth tyre dhe se a duhet të marrin fetva dhe dije prej këtij personi, apo jo. Ai i cili ka dijeni për gjendjen e dikujt, mund t’i shkruajë këtij organi (Qendrës së Fetvave në Rijad) ndonjë sqarim në lidhje me dikë, për t’u sqaruar çështja e tij. Pra, edhe nëse bëhet “texhrih” apo “tahdhir”, të bëhet nga ata të cilëve u merret për bazë fetvaja dhe sqarimi se prej kujt vlen të merret dija. Nuk ka dyshim se ana së cilës mund t’i kthehemi për fetva në çështje të ndryshme, është po ajo tek e cila mund të kthehemi për të pyetur se ku vlen të merret fetva dhe dije. Askush nuk duhet ta quajë veten si pikë referimi për të tilla çështje të mëdha, sepse prej fesë së mirë të personit është lënia prej tij e atyre gjërave që nuk i interesojnë apo nuk i takojnë.

Së dyti, për sa i përket kundërpërgjigjes ndaj atyre që kanë gabuar duhen pasur parasysh këto gjëra:

- Të bëhet me dashamirësi, butësi dhe dëshirë të madhe që gabimtari të kthehet nga gabimi i tij, kur gabimi është i qartë. Duhet të kthehet tek kundërpërgjigjet e shejh Abdul-Aziz bin Bazit, Allahu e mëshiroftë, për të përfituar prej tyre dhe mënyrës e cila duhet ndjekur në kundërpërgjigje.

- Nëse gabimi të cilit i është bërë kundërpërgjigje nuk është i qartë, por është nga çështjet në të cilat kundërpërgjigjesi mund të jetë ose gabim, ose në të drejtë, duhet kthyer çështja tek drejtuesit e Qendrës së Fetvave që të gjykojnë për çështjen.

Nëse gabimi është i qartë, atëherë personi të cilit i është bërë kundërpërgjigje, duhet të kthehet nga gabimi i tij, sepse kthimi në të vërtetën është më i mirë sesa vazhdimi në të kotën.

- Nëse dikush i bën kundërpërgjigje dikujt, e ka kryer obligimin e tij, prandaj të mos merret më me ndjekjen e kundërpërgjigjes së palës tjetër, por të merret me dijen që i bën dobi atij dhe të tjerëve. Kjo ka qenë rruga që ndiqte shejh Abdul-Aziz bin Bazi, Allahu e mëshiroftë.

- Nuk i lejohet asnjë nxënësi të dijës të sprovtojë të tjerët duke mbajtur qëndrim ndaj tyre, nëse u ka bërë kundërpërgjigje apo e kundërta, si p.sh.: “Nëse ai kthehet, shpëton, e nëse nuk kthehet është bidatçi dhe duhet braktisur”.

Askush nuk duhet që këtë rrëmujë (duke bërë njerëzit bidatçi dhe duke braktisur të tjerët), t’ia dedikojë (menhexhit të) “ehli sunetit”. Sikurse askujt nuk i takon që të cilësojë ata që nuk ndjekin këtë metodë rrëmuje e zhurme, se kanë shkrirë (lënë) menhexhin e selefëve.

“Hexhr” (distancim, bojkotim) i saktë mes “ehli sunetit” është ai që i bën dobi personit të cilit i bëhet, si p.sh. “hexhri” që i bën prindi fëmijës së tij apo shejhu nxënësit të tij dhe po ashtu “hexhri” që ndodh nga një person me pozitë të lartë dhe me influencë tek njerëzit. Pra, pa dyshim, këto lloje “hexhri” i sjellin dobi personit të braktisur.

Ndërsa “hexhri” që i bëjnë disa nxënës disa të tjerëve për gjëra për të cilat nuk bëhet “hexhr”, nuk i bën asnjë dobi palës së braktisur, madje sjell vetëm vetmi, kthimin e shpinës njëri-tjetrit dhe përçarje.

Shejhul islam ibn Tejmije, në librin e tij “Mexhmuul fetaua” (3/413-414) ka thënë për Jezid ibn Muauijeh: “E vërteta është ajo mbi të cilën qëndrojnë imamët, se ai as nuk veçohet me dashuri të veçantë, por as nuk mallkohet. Nëse ka qenë ‘fasik’ (mëkatar, i prishur) apo ‘dhalim’ (i padrejtë), Allahu e fal edhe ‘fasikun’, edhe të padrejtin, aq më tepër kur punon punë të mira e madhështore. Ka transmetuar Buhariu në “Sahihun” e tij nga ibn Umeri, se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ‘Ushtrinë e parë që do të luftojë Kostandinopojën, Allahu e ka falur’. Dhe ushtria e parë e cila ka luftuar Kostandinopojën ka pasur për prijës të saj Jezid ibn Muauijeh, e me të ka qenë ebu Ejub el Ensari. Pra është detyrë largimi nga këto gjëra sepse janë bidat i cili bie në kundërshtim me ‘ehli suneh uel xhemah’.”

Gjithashtu ka thënë (3/415): “Po kështu përçarja në Umet dhe sprovimi i besimtarëve me atë gjë që nuk ka urdhëruar Allahu dhe as i Dërguari i Tij, nuk lejohet.”

Po kështu ka thënë (20/164): “Nuk ka të drejtë asnjëri që të vendosë për Umetin ndonjë personalitet (njeri të rëndësishëm), të thërrasë për në rrugën e tij e për shkak të kësaj rruge të dojë e të urrejë. Kjo gjë lejohet vetëm kur bëhet fjalë për fjalën e Allahut (subhanehu ue teala) dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem), si dhe për ato çështjet për të cilat ka ‘ixhma’ (mendim unanim) në Umet. Nëse ndodh që dikush do dhe urren për hir të diçkaje tjetër veç asaj që përmendëm, është duke vepruar si bidatçinjtë, të cilët ngrenë dikë apo ndonjë fjalë, për hir të së cilës duan e urrejnë (dhe përçajnë).”

El Hafidh ibn Rexheb, duke shpjeguar hadithin: “Prej Islamit të mirë të njeriut është lënia e asaj që nuk të intereson”, në librin “Xhamiul ulumi uel hikem” (1/288) ka thënë: “Ky hadith konsiderohet gur themeltar në bazën madhështore të moralit.”

Imam ebu Amr ibn Salah ka transmetuar nga ebu Muhamed ibn ebu Zejd, i cili ishte një prej imamëve të shquar malikij në kohën e tij, se ai ka thënë: “Edukata, morali, bamirësia dhe çka buron prej tyre, përmbledhet në katër hadithe.”

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

- “Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit le të thotë fjalë të mira ose të heshtë.”
- “Prej Islamit të mirë të njeriut është lënia e asaj që nuk i intereson.”
- “Mos u zemëro.”
- “Besimtari do për vëllain e tij atë që do për vete.”

Sa nevojë kanë nxënësit e dijes që të edukohen me këtë moral dhe edukatë prej të cilave ata dhe të tjerët përfitojnë duke iu larguar ashpërsisë që nuk jep fryte të tjera veçse egërsim, ndarje, grupime, largim zemrash dhe përçarje.

- Eshtë obligim për çdo nxënës dije të jetë këshillues i vetes së tij dhe të largohet nga pasimi i asaj që shpërndahet në internet. Kur të hapin internetin, të shohin në faqen e shejh bin Bazit (Allahu e mëshiroftë) për të parë kërkimet e tij që tashmë kanë arritur në njëzet e një vëllime dhe fetvatë e Komisionit të Përhershëm të Fetvave, të cilat kanë arritur gjithashtu në njëzet e një vëllime. Të shohin gjithashtu në faqen e shejh Muhamed bin Uthejminit (Allahu e mëshiroftë), librat dhe fetvatë e tij të shumta.

Në mbyllje i këshilloj nxënësit e dijes që të falenderojnë Allahun (subhane ue teala) për sukseset që u ka dhënë, pasi i përzgjedhi që të jenë nxënës të fesë së Tij. T’i kushtojnë rëndësi të veçantë sinqeritetit në kërkimin e dijes, t’i japin çdo gjëje të shtrenjtë dhe me vlerë shpirtrat e tyre, që të marrin sa më shumë dije. Dija nuk arrihet duke u zhytur në dembelizëm.

El Jemamiu, Jahja ibn ebu Kethir ka thënë: “Nuk arrihet dija duke u qetësuar trupi.” Transmeton Muslimi në “Sahihun” e tij kur ka përmendur hadithet që kanë të bëjnë me kohët e namazit.

Sa ajete në Librin e Zotit dhe sa hadithe nga suneti i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) tregojnë vlerën e pozitën e dijes dhe mirësinë e mbartësve të saj. Allahu thotë:

“Allahu ka dëshmuar se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, gjithashtu dëshmuar melaiket dhe dijetarët. Të gjithë këta dëshmuar me të drejtë, vërtetësi.”

“Thuaj: ‘Mos vallë mund të barazohen ata që dinë me ata që nuk dinë?’”

“Allahu, ata të cilët kanë besuar prej jush dhe që u është dhënë dije, i ngre në grada ...”

“Thuaj: ‘O Zoti im, ma shto dijen!’”

Kurse prej haditheve është thënia e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem):

“Atë që Allahu i dëshiron mirësi e bën të kuptojë fenë e Tij.” Buhariu (81), Muslimi (1037).

Hadithi tregon se prej shenjave që Allahu dëshiron mirësi për dikë, është që t’i japë sukses atij në mësimin dhe kuptimin e fesë, sepse duke mësuar dhe kuptuar mirë fenë e Allahut, adhurohet Allahu me dije e dritë dhe thirret në dije dhe dritë.

“Më i miri ndër ju është ai që mëson Kur’an dhe ia mëson atë të tjerëve.” Buhariu (5027)

“Allahu me këtë libër ngre popuj dhe ul popuj të tjerë.” Muslimi (817)

“E ndriçoftë Allahu atë njeri që e dëgjon fjalën time, e mëson atë siç u tha dhe e transmeton ashtu siç e dëgjon.” Ky hadith është “muteuatir” dhe e kanë transmetuar më shumë se njëzet sahabë.

Transmetimet i kam përmendur më gjerë në librin tim “Dirasetu hadith nadar Allahu imreen semia me ka letijn rivajeten e dirajeten”.

“Atij që i futet një rrugë për të kërkuar dije, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet. Melaiket i vendosin krahët e tyre si shfaqje e kënaqësisë për atë që bën nxënësi i dijes. Për dijetarin kërkon falje ç’është në qiej e në tokë si dhe peshqit në ujë. Vlera e të diturit ndaj adhuruesit pa dije është si vlera e hënës së plotë në krahasim me yjet. Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve. Profetët nuk kanë lënë si trashëgimi dinarë e dirhem, por dijen, e kush kapet dhe merr prej saj ka fituar mirësinë më të madhe.”

Ky është hadith “hasen ligajrihi” (për shkak të shumë transmetimeve që përforcojnë dhe ngrenë njëri-tjetrin). Transmeton ebu Daudi, nr. 3628. (Shih transmetimet e këtij hadithi në “Sahihut-tergib uet-terhib” fq. 80, si dhe komentin e Musnedit të imam Ahmedit për këtë hadith, nr. 21715.)

El Hafidh ibnu Rexhebi e ka komentuar këtë hadith në një vëllim më vete, fjalia e parë është transmetuar në “Sahihun” e imam Muslimit (2699).

“Kur vdes biri i Ademit, i ndërpriten të gjitha veprat e mira me përjashtim të tri gjërave: sadakaja e vazhdueshme, dija që njerëzit përfitojnë prej saj dhe fëmija e mirë kur lutet për të.” Muslimi (1631)

“Çdokush që thërret në një udhëzim, merr shpërblim njësoj si shpërblimi i atyre që e pasojnë, pa iu pakësuar atyre ndonjë gjë. Çdokush që thërret në humbje merr gjynah njësoj si ata që e pasojnë, pa iu pakësuar atyre ndonjë gjë.” Muslimi (2684)

Këshilloj të gjithë të shfrytëzojnë kohën dhe të përfitojnë prej saj sa më shumë për gjërat që janë në dobi të njerëzimit, sepse i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) thotë: “Në dy begati mashtrohen shumë njerëz, në shëndet dhe kohën e lirë.” Buhariu (6412)

Ky është hadithi i parë që imam Buhariu ka përmendur në kapitullin “Er-rikak”. Po ashtu, në të njëjtin kapitull në “Fethul bari” (11/235), imam Buhariu ka shkruar një shprehje nga Ali ibn ebu Talib (radijallahu anhu): “Kjo botë po shkon dhe bota tjetër po vjen. Gjithësecila prej dy botëve ka bijtë e saj. Jini prej bijve të botës tjetër dhe jo prej bijve të kësaj bote, sepse sot ka punë e jo llogari dhe nesër ka llogari e jo punë.”

Këshilloj të angazhohen me gjëra që u interesojnë dhe të lenë gjërat që nuk u interesojnë. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Prej Islamit të mirë të personit është lënia e asaj që nuk i intereson.” Hadith hasen, trans. Tirmidhiu (2317) e të tjerë, njëkohësisht është hadithi i 12-të prej dyzet haditheve të imam Neueuiut.

Këshilloj për drejtësi midis teprimit dhe lënies mangut sepse i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ruhuni nga teprimi në fe. Vërtet janë shkatërruar ata që ishin përpara jush ngaqë e tepruan në fenë e tyre.” Hadith sahih, transmeton Nesaiu e të tjerë, është prej haditheve të Haxhit të Lamtumirës. Shih në “Silsiletus-sahiha” të Albanit (1283).

Këshilloj që të ruheni nga padrejtësia. Në hadith “kudsij” Allahu thotë: **“O robërit e Mi! Unë ia kam bërë haram Vetes Time padrejtësinë dhe e bëra atë haram ndërmjet jush, kështu që mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit.”** Muslimi (2577)

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ruhuni prej padrejtësisë se padrejtësia do të jetë errësirë në Ditën e Gjykimit.” Muslimi (2578)

Allahun e Lartmadhëruar e lus të na japë sukses të gjithëve që të marrim dije të dobishme, të punojmë me të e të thërrasim në të. Lus Allahun të na bashkojë të gjithëve në udhëzim të drejtë e të na mbrojë prej sprovave të dukshme e të padukshme. Allahu është i Plofuqishëm që t’i përgjigjet lutjes sonë dhe i Vetmi që e meriton atë. Paqja, mëshira, shpëtimi dhe begatitë e Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), mbi familjen dhe shokët e tij e mbi të gjithë ata që i pasojnë deri në Ditën e Gjykimit.

Kreu 4. Llojet e “hexhrit” dhe rregullat e tij (Shejhul Islam ibn Tejmie)

Përgjigjja e shejhul islam ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë), duke sqaruar llojet e “hexhrit” dhe rregullat e tij.

U pyet - Cilin është detyrë ose lejohet ta urresh ose ta bojkotosh (t’i bësh “hexhr”) për hir të Allahut? Cilat janë kushtet që duhet të përmbushë ai që urren dhe bojkoton për hir të Allahut? A konsiderohet mosdhënia e selamit bojkotim (hexhr)? Nëse i bojkotuari i jep selam (fillon me selam) bojkotuesit, a është detyrë që ky i fundit t’ia kthejë selamin apo jo? A duhet të vazhdojë urretja dhe “hexhri” për hir të Allahut, derisa të vërtetohet zhdukja e karakterit, cilësisë dhe punës për të cilën e urreu dhe i bëri “hexhr”, apo ka ndonjë kohë të caktuar? Nëse ka ndonjë kohë të caktuar sa është ajo? Na jepni përgjigje (fetva), u shpërblefshi me të mira!

Shejhu, Allahu e mëshiroftë, u përgjigj - “Hexhri” i ligjshëm në Sheriat është dy llojesh:

- 1- Për lënien e mëkateve.
- 2- Si ndëshkim.

- Lloji i parë është ai që përmendet në fjalën e Allahut: **“Nëse i sheh ata që angazhohen me biseda boshe në lidhje me vargjet, ajetet tona të Kur’anit duke i përqeshur, rri larg tyre derisa të kalojnë në çështje tjetër. Nëse prej shejtanit ndonjëherë harron, kur të kujtohesh mos u ul më me njerëzit e padrejtë.”** En Aam: 68.

“Tashmë të është bërë e ditur në Libër (Kur’an) që kur të dëgjosh të mohohen ajetet e Allahut ose të përqeshen, atëherë mos rri me ta derisa të ndërrojnë bisedë (sikur të ulesh me ta). Në këtë mënyrë. padyshim që edhe ti do të jesh si ata. Sigurisht që Allahu do t’i bashkojë hipokritët dhe mohuesit në Xhehenem.” En-Nisa: 140.

Në këto ajete Allahu ka për qëllim mospraninë në të këqija pa qenë e nevojshme. P.sh. kur disa janë duke pirë alkool, të mos ulesh tek ata, kur të ftojnë në një darkë ku ka pije alkoolike dhe muzikë, të mos i përgjigjesh ftesës së tyre e të tjerë shembuj si këto. Në këtë gjykim nuk bëhet fjalë për atë që merr pjesë për të ndryshuar të keqen dhe për t’i kritikuar punuesit e saj dhe as për atë që merr pjesë pa vullnetin e tij... Prandaj thuhet se ai që merr pjesë në vendet ku veprohet e keqja është njëlloj si vepruesi i saj. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: **“Kush beson në Allahun dhe në botën tjetër të mos ulet në një tavolinë në të cilën pihet alkool.”** Trasmeton Ahmedi, Tirmidhiu dhe e ka saktësuar shejh Albani në **“Irva”**.

Ky bojkotim përfshihet në llojin e bojkotit të punëve të këqija, prej të cilave njeriu e distancon veten e tij, siç ka thënë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem): **“Muhaxhir (emigrues, bojkotues) është ai i cili është larguar prej gjërave që i ka ndaluar Allahu.”** Trasmeton Buhariu.

Në këtë lloj futet edhe emigrimi (hixhreti) nga vendet e kufrit dhe mëkateve për në vendet e Islamit dhe imanit, sepse në këtë rast emigruesi është larguar nga qëndrimi midis kafirëve dhe munafikëve, të cilët nuk e lenë ose nuk i japin mundësi të veprojë atë që ka urdhëruar Allahu. Për këtë flet dhe ajeti: **“Larg nga idhujt (er-ruxhz) qëndro!”** Mudethir: 5.

- Lloji i dytë është largimi si masë edukative dhe ndëshkimore nga personi që i shfaq mëkatet hapur. Këtij personi i bëjmë **“hexhr”** derisa të pendohet (të

bëjë teube) nga mëkati, ashtu siç veproi Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) dhe muslimanët me tre personat të cilët pa ndonjë arsye nuk morën pjesë në luftën e Tebukut, megjithëse e patën detyrë. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) i bojkotoi së bashku me muslimanët dhe nuk dha gjykim për veprën e tyre derisa zbriti shpallja për pranimin e teubes së tyre. Ndërsa atë që paraqiti arsye të mirë e të pranueshme në aparence, nuk e bojkotoi, megjithëse mund të ishte munafik (hipokrit). Pra, ky bojkotim ishte masë ndëshkuese.

Masa ndëshkimore merret ndaj atij që kuptohet (evidentohet) se ka lënë detyrat dhe ka vepruar haramet, si p.sh. ai qëlënamazin ose zekatin, ai që shfaq mizori dhe gjëra të ndyra (si zinaja etj), si dhe ai që fton në bidate të cilat kundërshtojnë Kur'anin, Sunetin dhe ixhmain e selefëve të këtij Umeti dhe dihet qartë se janë bidate.

Ky është realiteti i fjalës së selefëve dhe imamëve që kanë thënë: “Vërtet atyre që ftojnë në bidat nuk u pranohet dëshmia, nuk falet namazi pas tyre, nuk merret dije prej tyre dhe as nuk u jepet vajza për martesë. Ky është ndëshkim për ta, derisa të ndalen. Për këtë arsye ata bëjnë dallim midis atij që fton në bidat dhe atij që nuk fton, sepse ftuesi e shfaq të keqen haptazi dhe prandaj meriton ndëshkimin. Ndryshe është puna e atij që e fsheh bidatin, sepse ai nuk është më i keq se munafikët, të cilëve i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), megjithëse e dinte gjendjen e shumë prej tyre, ua pranonte atë që shfaqnin dhe i linte të fshehtat e tyre për t’i gjykuar Allahu. Për këtë ka ardhur në hadith: “E keqja, kur nuk shfaqet, dëmton vetëm atë që e bën, ndërsa kur shfaqet dhe nuk ndryshohet e kundërshtohet, dëmton tërë masën e njerëzve.” Gjithashtu në një hadith tjetër i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kur njerëzit të shohin të keqen dhe të mos e ndryshojnë, është afruar koha për t’i përfshirë Allahu të tërë me ndëshkim.” Transmeton Ahmedi, ebu Daudi, Tirmidhiu, ibn Maxhe dhe e ka saktësuar shejh Albani.

Të këqijat e dukshme është detyrë që të ndryshohen dhe të ndalohen, ndryshe nga të padukshmet, sepse ndëshkimi i tyre prek vetëm vepruesin dhe jo të tjerët. Ky lloj “hexhri” ndryshon sipas fuqisë së bojkotuesve, si dhe pakicës ose shumicës së tyre, sepse qëllimi është të pengohet i bojkotuari, të edukohet dhe të parandalohet masa e njerëzve që të mos e ndjekin punën e tij.

Nëse dobia e bojkotimit është më e madhe, në kuptimin që ndikon në dobësimin, minimizimin dhe fshehjen e së keqes, atëherë ai është i ligjshëm. Ndërsa, nëse bojkotimi nuk e parandalon as të bojkotuarin dhe as të tjerët, por përkundrazi, ua shton të keqen, që do të thotë se dëmi i tij është më i madh se dobia e tij për arsye se bojkotuesi është i dobët, në këtë rast ai nuk është i ligjshëm.

Madje për disa njerëz afrimi është më i dobishëm se sa bojkotimi dhe largimi. Ndërsa për disa të tjerë bojkotimi dhe largimi është më i dobishëm sesa afrimi. Për këtë arsye i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) i afronte disa njerëz dhe përpiquej t'ua zbuste zemrat, ndërsa disa të tjerë i bojkotonte. Kështu p.sh. tre personat që i bojkotoi i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ishin më të mirë se shumica e njerëzve që Profeti përpiquej t'ua zbuste zemrat, duke qenë se ata ishin kryetarë të respektuar nga fiset e tyre. Tre personat ishin besimtarë të thjeshtë dhe besimtarë si puna e tyre kishte shumë, prandaj bojkotimi i tyre ishte krenari për fenë dhe pastrim për mëkatet e tyre, ashtu siç është e ligjshme lufta kundrejt armikut ndonjëherë dhe marrëveshja ose marrja e xhizjes ndonjëherë tjetër. Të gjitha këto sipas gjendjes dhe dobive.

Përgjigjja e imamëve si Ahmedi e të tjerë në lidhje me këtë temë është bazuar mbi këtë parim. Për këtë arsye ai bënte dallim ndërmjet vendeve që kishte shumë bidate, siç ishte me shumicë bidati në çështjet e kaderit në Basra, “tenxhimi” (astrologjia, horoskopi) në Horasan ose shiizmi në Kufe, dhe vendeve që nuk ishin ashtu. Po kështu bënte dallim mes prijësve që u binden njerëzit dhe të tjerëve që nuk janë të tillë. Ai, kur e njihte synimin e Sheriatit në lidhje me diçka, ndërmerre rrugën më të arrirë për ta realizuar.

Bojkotimi fetar është prej punëve që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, d.m.th. është ibadet dhe ibadetet patjetër duhet të bëhen për hir të Allahut dhe në përputhshmëri me urdhërin e Tij. Me fjalë të tjera, duhet të jenë të sinqerta dhe të sakta.

Kushdo që bojkoton dikë për hir të epshit të tij ose në një mënyrë që bie në kundërshtim me atë që është urdhëruar, ai është jashtë parimeve që i

përmendëm. Sa shumë veprojnë njerëzit sipas tekave, dëshirave dhe epsheve, me pretekstin se po e bëjnë si bindje ndaj Allahut!

Bojkotimi për shkak të ngatërresave dhe çështjeve personale nuk lejohet më tepër se tri ditë, siç ka ardhur në dy librat e saktë të hadithit se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk i lejohet muslimanit ta bojkotojë vëllain e tij musliman më tepër se tri ditë. Ndoshta takohen ose përballen me njëri-tjetrin dhe nëse njëri kthen shpinën, po ashtu edhe tjetri e kthen shpinën. Më i miri i tyre është ai që fillon me selam.” Pra nuk ka toleruar që ky bojkotim të zgjasë më shumë se tri ditë, ashtu siç nuk ka lejuar të mbahet zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, përveç gruas për burrin e saj. Gjithashtu është transmetuar tek Buhariu dhe Muslimi se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Hapen dyert e xhenetit çdo të hënë dhe të enjte dhe i falen gjynahet çdo robi që nuk i bën shok Allahut, me përjashtim të një personi që ka pasur ndërmjet tij dhe vëllait të tij zënie (armiqësi). Për ata thuhet: ‘Vonojini këta të dy derisa të pajtohen’.” Mëria dhe bojkotimi për hir të së drejtës vetjake është e ndaluar (haram), me përjashtim të disa rasteve, si p.sh. tolerimi që burri ta bojkotojë e ta largojë bashkëshorten e tij nga shtrati kur ajo bëhet e pabindur, si dhe tolerimi për të bojkotuar tri ditë dhe jo më shumë (siç u bë sqarimi më lart).

Duhet të bëhet dallim ndërmjet bojkotit që bëhet për të drejtën e Allahut dhe bojkotit që bëhet për të drejtën vetjake. I pari është i urdhëruar, kurse i dyti është i ndaluar sepse besimtarët janë vëllezër. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), në një hadith të saktë të cilin e transmeton Muslimi, ka thënë: “Mos i prisni lidhjet me njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos e urreni njëri-tjetrin dhe mos e kini zili njëri-tjetrin. Bëhuni, o robërit e Allahut, vëllezër! Muslimani është vëlla i muslimanit.” Kurse në një hadith tjetër i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) thotë: “A t’ju lajmëroj juve për atë që është më e vlefshme se grada e namazit, e agjërimit, e sadakasë (nafilë) dhe e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja?” Thanë: “Posi jo, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “Rregullimi i lidhjeve mes veti, sepse përçarja është rruajtëse, nuk them rruajtëse e flokëve, por e rruan (gërryen) fenë e njeriut.” (Transmeton Ahmedi, ebu Daudi, Tirmidhiu dhe e ka saktësuar shejh Albani.)

Gjithashtu në hadithin që e trasmeton Buhariu dhe Muslimi, i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) thotë: “Shembulli i besimtarëve në dashurinë e tyre, në mëshirën e tyre, në butësinë dhe ndjenjat e tyre mes njëri-tjetrit është si shembulli i një trupi të vetëm, kur një gjymtyrë ankohet nga dhimbja, temperatura dhe pagjumësia përfshin të gjithë trupin.”⁹⁶

“Hexhri” konsiderohet prej ndëshkimeve penale që i përmban Sheriati. Ai përfshihet në tërësinë e përpjekjeve dhe xhihadit që bëhet në rrugë të Allahut, xhihadit që bëhet me qëllim që të jetë Fjala e Allahut më e Larta dhe të jetë feja e gjithë për Allahun.

Besimtari e ka për detyrë të urrejë e të armiqësojë për hir të Allahut dhe të miqësojë e të dojë për hir të Allahut. Përderisa njeriu është besimtar, e kemi për detyrë ta duam, edhe sikur të na ketë bërë padrejtësi. Padrejtësia nuk është arsye për ndërprerjen e dashurisë dhe miqësisë që na e obligon besimi. Allahu ka thënë: **“Në qoftë se dy palë prej muslimanëve bien në luftë, bëni marrëveshje (paqe) ndërmjet tyre. Në qoftë se ndonjëra prej tyre ngre krye kundër tjetrës, atëherë të gjithë ju bashkarisht luftoni ndaj atyre që ngritën krye të parët, derisa të veprojnë në përputhje me urdhërin e Allahut. Pas kësaj, në qoftë se pajtohen, vendosni paqe ndërmjet tyre me drejtësi dhe bëhuni të paanshëm në gjykim. Vërtet Allahu i do ata që janë të paanshëm. Pa dyshim besimtarët janë vëllezër.”** (Huxhuratë 8-9) Allahu i ka konsideruar të dy palët vëllezër dhe urdhëroi për t’i pajtuar, megjithëse ndërmjet tyre pati luftë dhe padrejtësi.

Le të meditojë thellë besimtari mbi ndryshimin ndërmjet dy llojeve të bojkotit, sa të shumtë janë ata që u përzihet njëri lloj me tjetrin.

Le ta dijë se është detyrë ta dojë besimtarin, ta afrojë dhe të miqësohet me të, edhe nëse i bën padrejtësi e mizori. Kurse kafirin është detyrë ta urrejë dhe ta armiqësojë edhe nëse i jep e i bën mirësi. Allahu i lartësuar i ka dërguar të

⁹⁶) Përmendja e haditheve që nxisin për forcimin e lidhjeve ndërmjet muslimanëve në mesin e kësaj teme është shumë domethënëse, sepse ato i tërheqin vëmendjen diskutuesve rreth kësaj teme se forcimi i lidhjeve ndërmjet muslimanëve është origjina, ndërsa bojkotimi është përjashtim. Këtë realitet duhet ta kenë parasysh ata që motivohen nga epshet për brutalitet, ashpërsi dhe bojkot, si dhe ata që nuk i njohin bazat që kanë të bëjnë me bidatin në përgjithësi dhe bojkotin në veçanti. Ata duhet të kenë parasysh se gabimi në këtë drejtim do të thotë të zhvishesh nga vlerat e sjelljes islame dhe të jesh në kundërshtim me hadithet e lartpërmendura.

dërguarit, dhe i ka zbritur librat që të adhurohet i vetëm, të jetë dashuria për të dashurit e Tij dhe urrejtja për armiqtë e Tij, nderimi për të dashurit e Tij dhe poshtërimi për armiqtë e Tij, shpërblimi për miqtë e Tij dhe ndëshkimi për armiqtë e Tij.

Kur bashkohet në një person të vetëm e mirë dhe e keqe, shturje dhe bindje ndaj Allahut, mëkate dhe vepra të mira, Sunet dhe bidat, meriton miqësi dhe shpërblim sipas të mirës që ka dhe meriton armiqësi e ndëshkim sipas sherrit (të keqes) që ka. Pra, mund të bashkohen në një person të vetëm gjërat që bëjnë të nderohet dhe gjërat që bëjnë të poshtërohet, si puna e hajdutit të varfër, të cilit i pritet dora për vjedhjen e pasurisë dhe i jepet nga shtëpia e pasurisë aq sa i mjafton për nevojën e tij.

Kjo është baza për të cilën kanë rënë dakord “ehli suneti dhe xhemati” dhe e kanë kundërshtuar hauarixhët, muëtezilët dhe fraksionet e tyre që janë pajtuar me ta. Hauarixhët thonë se njerëzit meritojnë vetëm shpërblim, ose meritojnë vetëm dënim. Kurse “ehli suneti” thotë se Allahu do të ndëshkojë me zjarr atë që dëshiron prej njerëzve që kanë punuar mëkate të mëdha, pastaj me shefatin (ndërmjetësimin) e atyre që Ai u lejon të ndërmjetësojnë do t’i nxjerrë me Mirësinë e Tij nga zjarri, siç ka ardhur në hadithe të shumta nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem).

Allahu i Lartësuar është më i Dituri. Paqja, mëshira, begatitë dhe Lavdërimi i Tij qofshin mbi Muhamedin (salallahu alejhi ue selem) dhe gjithë ndjekësit e shokët e tij.

“Mexhmu el fetaua” vëll. 28, f. 203-210 (Botim i Ministrisë së Fesë, Propagandës dhe Çështjeve Islame në K.S.A. Medine 1416 h. – 1995 g.)

Po kështu ka folur në vëll. 24, fq. 174-175 dhe vëll. 29, fq. 231-232.

Kreu 5. Rregullat e “tekfirit”⁹⁷

) Tekfir është cilësimi i një personi “kafir”. Ky kapitull është i përbërë nga tri pjesë: “Ndryshimi mes tekfirit të ⁹⁷ përgjithshëm dhe tekfirit të veçantë”, “Kushtet e tekfirit” dhe “Pengesat e tekfirit”.

Ibnu Uthejmini ka thënë:

▪ “Cilësimi i njeriut “kafir” ose “fasik”, merret nga libri i Allahut dhe suneti i të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), pra ky cilësim është prej rregullave të Sheriatit, për të cilat duhet t’i referohemi Kur’anit dhe Sunetit.

Në çështjen e tekfirit, është detyrë që të verifikojmë dhe të sigurohemi në mënyrë maksimale. Kafir bëhet vetëm ai, për kufirin e të cilit tregon Kur’ani dhe Suneti. Origjina tek muslimani, është që të thuhet për të se është musliman, derisa të vërtetohet në mënyrë të sigurtë që ka dalë nga Islami, sipas argumentit fetar.

▪ Nuk lejohet neglizhenca në tekfirin e muslimanit sepse kjo ka dy pasoja të mëdha:

1- Shpifja e gënjeshtëris ndaj Allahut, në gjykimin që e ka dhënë dhe ndaj të cilësuarit “kafir”.

2- Kalimi i cilësimit “kafir”, tek ai i cili etiketon me këtë cilësi vëllain e tij musliman, nëse ky i fundit nuk është i tillë.

Abdullah ibn Umeri ka transmetuar se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Në qoftë se një person do ta cilësojë “kafir” vëllain e tij, kjo fjalë do t’i kthehet njërit prej të dyve.” Transmeton Muslimi.

Në një transmetim tjetër ka ardhur: “... në qoftë se është siç ka thënë (shpëton nga pasoja), përndryshe i kthehet atij.”

▪ Është detyrë që para se të cilësohet një musliman “kafir” të vërehen dy gjëra:

E para, të vërtetohet me argument të saktë nga Kur’ani ose Suneti, që një thënie ose një vepër është nga ato të cilat e çojnë njeriun në kufër.⁹⁸

E dyta, përputhja e këtij gjykimi me një thënës ose veprues të caktuar, d.m.th. të plotësohen kushtet e tekfirit dhe të eliminohen pengesat e tij.⁹⁹

) Ky parim ka të bëjë me gjykimin e veprës se a është kufër apo jo, pa marrë parasysh se çfarë gjykimi ka ai që⁹⁸ bën veprimin, sepse gjykimi ndaj tij do të diskutohet në parimin e dytë. Prandaj, para se të gjykosh ndaj një personi ose grupi, duhet të njohësh gjykimin e veprës ose thënies së tij në Sheriat. Shumë njerëz konsiderojnë kufër gjëra të cilat sipas argumenteve të Sheriatit nuk rezultojnë të jenë kufër, dhe si rrjedhojë, i cilësojnë muslimanët padrejtësisht “kafirë”. Sikundër ka gjëra, që sipas argumenteve të Sheriatit janë kufër, por shumë njerëz nuk i konsiderojnë të tilla, dhe si rrjedhojë, shfaqet neglizhenca në çështjet e fesë, duke mos u cilësuar “kafir” ai që sipas argumenteve të Sheriatit është me të vërtetë i tillë. Nga ana tjetër, ka gjëra rreth të cilave dijetarët e “ehli sunetit” nuk janë pajtuar se a janë kufër apo jo. Ndikimi i mosmarrëveshjes në lidhje me këto gjëra, shfaqet edhe në gjykimin ndaj personave të caktuar.

Në lidhje me gjykimin e punëve për të cilat bën fjalë ky parim, duhet një sqarim në mënyrë të detajuar.

Ndoshta këtë gjë do ta bëjmë në një botim ose libër tjetër insha-Allahu, por në këtë kapitull do të flasim vetëm rreth parimit të dytë.

) Kjo që është përmendur në parimin e dytë, do të jetë tema për të cilën do të flitet në këtë kapitull, pra, do të⁹⁹ sqarohen principet e gjykimit ndaj një personi të caktuar.

Ndryshimi mes tekfirit të përgjithshëm¹⁰⁰ dhe tekfirit të veçantë¹⁰¹

Ibnu Tejmija ka thënë: “Veprimi ose thënia mund të jetë kufër, kështu që cilësohet ‘kafir’ ai që e thotë atë thënie ose e bën atë veprim, duke thënë se ‘kush thotë kështu është kafir’, ose ‘kush vepron kështu është kafir’. Por lidhur me një person të caktuar që e thotë atë fjalë ose që e bën atë veprim, nuk gjykohet se është kafir, derisa t’i përcillet argumenti, të cilin kush e refuzon bëhet kafir. Sipas ‘ehli sunetit’, kjo çështje përfshin të gjitha tekstet që përmbajnë ‘vaid’.¹⁰² ‘Ehli suneti’ nuk gjykon për asnjë person të caktuar të ‘ehli kibles’ që është prej banorëve të zjarrit, pasi ekziston mundësia që ai të mos ndëshkohet, për shkak të mosplotësisimit të një kushti ose të ekzistencës së ndonjë pengese.” (“Mexhmul fetaua”, fq. 35/165)

Gjithashtu ai ka thënë: “Unë, dhe ata që ulen pranë meje e dinë mirë, jam ndër njerëzit që më së shumti e ndalojnë cilësimin e një personi të caktuar ‘kafir’, ‘fasik’ ose gjynahqar, vetëm në qoftë se është bërë e ditur se i ka arritur argumenti fetar, të cilin kush e kundërshton mund të bëhet kafir, fasik ose gjynahqar (sipas kundërshtimit). Unë pohoj dhe konfirmoj se Allahu ia ka falur

) Tekfiri i përgjithshëm - Gjykimi për një punë, një thënie, ose për besimin që e kundërshton dhe e asgjëson bazën¹⁰⁰ e fesë islame, se është kufër, si dhe gjykimi në mënyrë të përgjithshme ndaj vepruesve të tyre se janë kafira, pa përcaktuar ndonjë person të veçantë. Kështu që thuhet se kush beson kështu është kafir, ose kush vepron kështu është kafir. Cilësimi “kafir” në mënyrë të përgjithshme i atij, prej të cilit konstatohet diçka që është kufër, është i bazuar në argumentet e Kur’anit, Sunetit dhe thëniet e selefëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Sigurisht, ata që nuk besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që duan të bëjnë dallim mes besimit në Allahun dhe besimit në të Dërguarin e tij (duke e besuar Allahun dhe duke mos i besuar të Dërguarit) duke thënë: ‘Ne besojmë disa prej tyre por i mohojmë të tjerët’ dhe që duan të bëjnë për vete një rrugë të ndërmjetme. Këta në të vërtetë janë mosbesimtarë dhe për mohuesit Ne kemi përgatitur ndëshkim poshtërues.”** En-Nisa 150-151.

“Dhe kushdo që lut (ose adhuron) në vend të Allahut çdo ilah (zot) tjetër për të cilin nuk ka asnjë orovë, atëherë llogaria e tij është vetëm te Zoti i tij. Vërtet që kafirët (mohuesit e Njëshmërisë së Allahut, politeistët. paganët) nuk do të kenë kurrë sukses.” El Mu’minun: 117.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kushdo që vdes duke i bërë shok Allahut në diçka, hyn në zjarr.” Prej thënieve të selefëve kemi këto që vijojnë.

Sufjan ibni Ujejne ka thënë: “Kur’ani është fjalë e Allahut, kush thotë se është i krijuar është kafir, dhe kush dyshon në kufrin e tij, po ashtu është kafir.”

Bisher ibnil Harith ka thënë: “Kush i shan shokët e Profetit është kafir, edhe sikur të falet e të agjërojë dhe të pretendojë se është musliman.”

Ahmedi ka thënë: “Kaderij është ai që thotë se Allahu nuk i di gjërat derisa të ndodhin, dhe ky është kafir.”

Prandaj cilësimi “kafirë” i atyre, për të cilët argumentet tregojnë se janë të tillë, është prej parimeve më të rëndësishme të besimit të “ehli suneh vel xhemaah”, aq sa dijetarët kanë gjykuar se është kafir ai që nuk i cilëson “kafira” kafirët, ose dyshon në kufrin e tyre. El Kadi Ijad ka përcjellë ixhmajn (konsensusin) e dijetarëve në lidhje me gjykimin “kafir” ndaj atij që nuk e cilëson “kafir” ndojnë kristian ose çifut dhe cilindo që del nga feja e muslimanëve, ose dyshon në kufrin e tyre.

) Tekfiri i veçantë: Gjykimi ndaj një personi të caktuar se është kafir, ngaqë është konstatuar prej tij diçka që e¹⁰¹ kundërshton Islamin, pas plotësisimit në të drejtën e tij të kushteve të tekfirit dhe eliminimit të pengesave të tij.

) Kërcënim për ndëshkim.¹⁰²

këtij Umeti atë që ndodh gabimisht. Kjo përfshin gabimin në çështjet e besimit dhe në çështjet praktike. Që prej kohësh selefët kanë pasur mosmarrëveshje në shumë prej këtyre çështjeve, por asnjëri prej tyre nuk ka dëshmuar kundër tjetrit as për kufër, as për fisk (mëkat të madh) e as për gjynah”, dhe pastaj ka përmendur shembuj nga jeta e tyre.

Më pas ka thënë: “Kam sqaruar se thëniet të cilat janë transmetuar nga selefët dhe dijetarët për cilësimin në mënyrë të përgjithshme ‘kafir’, të atij që thotë kështu dhe kështu, gjithashtu janë të drejta, por duhet të bëhet dallimi ndërmjet cilësimit ‘kafir’ në përgjithësi dhe cilësimit ‘kafir’ të një personi të caktuar.”

Gjithashtu ibnu Tejmija ka thënë: “Tekfiri është prej ‘ueidit’.¹⁰³ Megjithëse thënia është përgënjeshtër i asaj që e ka thënë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), i zoti i saj nuk cilësohet ‘kafir’, derisa t’i arrijë argumenti (të informohet mirë rreth asaj çështjeje me argument), sepse mund të jetë i ri në Islam, ose të jetë rritur në një zonë të largët e të veçuar nga qendrat e banuara.

Ndoshta njeriu mund të mos i ketë dëgjuar ato argumente, ose i ka dëgjuar dhe nuk i vlerëson të sakta sipas mendimit të tij, ose sepse sipas tij i ka kundërshtuar një argument tjetër më i fortë, i cili e obligon interpretimin e tyre. Ai në këto mendime është gabimtar, por ato vlejnë për ta justifikuar. Unë gjithmonë kam përmendur hadithin që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, për atë personin që tha: ‘Kur unë të vdes, më digjni, më thërrmoni dhe pastaj më hidhni në det, se betohem në Allahun, në qoftë se Allahu do të ketë fuqi të më ringjallë, do të më ndëshkojë me një të tillë ndëshkim që nuk ka ndëshkuar me të asnjë tjetër përpara meje’. Vepruan me të ashtu siç i porositi. Allahu pasi e ringjalli i tha: ‘Çfarë të shtyu që ta bëje këtë?’ Tha: ‘Frika nga Ti.’ Allahu i Lartësuar e fali.

Ky burrë dyshoi në fuqinë e Allahut dhe në ringjalljen e Tij, pasi të thërrmohej dhe të hidhej në det, madje besoi se nuk do të ringjallej. Kjo është kufër tek të gjithë muslimanët unanimisht, por ai ishte i paditur dhe ishte besimtar. Ai kishte frikë se Allahu do ta ndëshkonte, por Allahu e fali. Interpretuesi i cili ka kapacitetin e duhur për të bërë ‘ixhtihad’ dhe është i interesuar për ndjekjen e të Dërguarit, ka më tepër përparësi që të falet, sesa personi që u përmend më lart.”

Po kështu ibnu Tejmija ka thënë: “Kur’ani, Suneti dhe ixhmai, na tregojnë se është obligim që të themi për një vepër që është kufër se është kufër. Pra thuhet për të ‘kufër’, në mënyrë të pakufizuar, ashtu siç tregojnë argumentet fetare,

) Paralajmërimin për ndëshkim.¹⁰³

sepse besimi është prej ligjeve që merren vetëm prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Besimi nuk është prej gjërave, për të cilat njerëzit gjykojnë me hamendjet dhe me epshet e tyre. Nuk është detyrë që çdo person që e thotë fjalën e kufrit, të cilësohet ‘kafir’, derisa të vërtetohen në të drejtën e tij kushtet e tekfirit dhe të eliminohen pengesat e tij.”

Ibnu ebi Iz-z el Hanefi ka thënë: “Qëllimi është që të sqarojmë se bidatet janë prej këtij lloji:¹⁰⁴

- Njeriu mund të jetë besimtar me zemër dhe në atë që e shfaq, por bën një interpretim në të cilin gabon, ose si rrjedhojë e “ixhtihadit”, ose si rrjedhojë e neglizhencës dhe mospërpjekjes për të qëlluar të vërtetën. Kjo bën që ai të cilësohet “gjynahqar”, por nuk lejohet të thuhet për se besimi i tij asgjësohet thjesht për shkak të kësaj gjëje, me përjashtim të rastit kur argumenti fetar tregon për asgjësimin e besimit të tij. Madje thënia që besimi i tij asgjësohet, përfshihet në llojin e mendimeve të huarixhëve dhe muëtezilëve. E megjithatë nuk themi që nuk bën kufër. Drejtësia në lidhje me këtë temë është qëndrimi i mesëm, që mendimet (thëniet) e pavërteta, të shpikura dhe të ndaluara, të cilat përmbajnë mohim të asaj që e ka pohuar i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), pohim të asaj që e ka mohuar i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), urdhërim për atë që e ka ndaluar, ose ndalim për atë që ka urdhëruar, për të gjitha këto thuhet e vërteta, pohohet e konfirmohet ndaj tyre kërcënimi për ndëshkim, të cilin e tregojnë argumentet e Kur’anit dhe Sunetit. Sqarohet që ato janë kufër dhe thuhet se ai që i thotë këto thënie, ose ai që i ka këto mendime, është kafir, siç përmendet kërcënimi për ndëshkim i padrejtësisë në gjakun dhe pasurinë e njerëzve, dhe siç kanë thënë shumë dijetarë të shquar të ‘ehli sunetit’, se kush thotë që Kur’ani është i krijuar është kafir, kush thotë se Allahu nuk shikohet në ahiret është kafir dhe kush thotë që Allahu nuk i di gjërat para se të ndodhin është kafir.”

Nga ebi Jusufi transmetohet se ka thënë: “Kam dialoguar me ebu Hanifen për një periudhë të caktuar kohe, derisa u pajtua mendimi im me mendimin e tij, se kush thotë që Kur’ani është i krijuar, është ‘kafir’.”¹⁰⁵

Në qoftë se do të na thuhej për një person të caktuar se “a dëshmoni që ai do të ndëshkohet ose që është kafir?”, nuk e bëjmë këtë, përveçse nëse na bëhet e ditur diçka që e bën të lejueshme një dëshmi të tillë, pasi prej padrejtësisë më të

) D.m.th.bidatet dhe punuesit e tyre janë si puna e mëkateve të mëdha dhe punuesve të tyre për sa i përket ¹⁰⁴ kërcënimit për ndëshkim që ka ardhur në lidhje me to dhe qëndrimin të “ehli sunetit” ndaj çështjeve të tilla.

) Deri këtu autori foli rreth gjykimit të veprës dhe thënies së kufrit, si dhe rreth cilësimit “kafir” në përgjithësi pa ¹⁰⁵ përcaktim, kurse në pjesën që vijon flet rreth gjykimit të një personi të caktuar.

madhe, është që të dëshmosh në mënyrë të paligjshme ndaj një individi të caktuar se Allahu nuk e fal dhe nuk e mëshiron, por do ta bëjë prej banorëve të përhershëm të zjarrit, siç ndodh me kafirin pas vdekjes. Prandaj ebu Daudi në “Sunenin” e tij, në kapitullin e edukatës në nëntemën “Ndalimi i padrejtësisë dhe tiranisë”, ka përmendur hadithin e ebu Hurejres i cili ka thënë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: ‘Ishin dy burra nga benu israilët, të cilët kishin angazhime të kundërta. Njeri prej tyre bënte gjynahe, ndërsa tjetri ishte i zellshëm në ibadet. Sa herë që i zellshmi në adhurim e shikonte tjetrin duke bërë gjynah, i thoshte: ‘Mos bëj gjynah!’ Një ditë e gjeti duke bërë gjynah dhe i tha: ‘Lere dhe mos e bëj!’ Tjetri iu përgjigj: ‘Lere këtë punë ndërmjet meje dhe Zotit tim, mos vallë je dërguar mbikqyrës mbi mua?’ I zellshmi në adhurim i tha: ‘Për Allahun! Allahu ty nuk të fal, ose nuk të fut në xhenet.’ Allahu ua mori shpirtrat të dyve dhe u takuan së bashku tek Zoti i botëve. Allahu i Lartësuar i tha të zellshmit në adhurim: ‘A e dije ti se çfarë do të bëj Unë, apo ke pasur fuqi për të vepruar atë që është në dorën Time?’ Pastaj gjynahqarit i tha: ‘Shko dhe futu në xhenet me mëshirën Time’, kurse për tjetrin tha: ‘Çojeni në zjarr’.”

Në lidhje me këtë hadith, ebu Hurejre tha: “Betohem në atë, në dorën e të Cilit është shpirti im. Padyshim që tha një fjalë, e cila i shkatërroi dynjanë dhe ahiretin.” Hadithi është i mirë.

Gjithashtu arsyeja është se personi i caktuar mund të jetë përpjekur për të qëlluar të vërtetën por ka gabuar, kështu që i falet gabimi. Mund të mos i kenë arritur argumentet në lidhje me këtë çështje, ose mund të ketë besim (iman) të fortë dhe të mira, të cilat e bëjnë të denjë për mëshirën e Allahut, sikur që Allahu ia fali gjynahun atij që tha: “Kur unë të vdes, më digjni, pastaj më dërrmoni dhe pastaj më hidhni në det, se betohem në Allahun, në qoftë se Allahu do të ketë fuqi të më ringjallë, do të më ndëshkojë me një ndëshkim që nuk ka ndëshkuar me të asnjë.” Pra këtij personi, Allahu ia fali gjynahun për shkak të frikës së tij. Ky njeri mendonte që Allahu nuk ka fuqi ta mbledhë dhe ta rikthejë në jetë, ose dyshonte në këtë gjë.

Mosdiskutimi rreth përfundimit të personave të tillë në Ahiret, nuk na ndalon që t’i ndëshkojmë në këtë dynja për të ndaluar bidatin e tyre, dhe gjithashtu nuk na ndalon që të kërkojmë prej tyre që të pendohen. E si rrjedhojë, nëse pendohen, u pranohet pendimi, ndryshe vriten.¹⁰⁶

) Këto janë masa që zbatohen nga autoritetet e shtetit Islam.¹⁰⁶

Kur thënia është kufër, thuhet për të që është kufër dhe thënësi i saj bëhet kafir, në qoftë se plotësohen kushtet dhe evitohen pengesat. Kjo nuk mund të konstatohet përveçse tek ai që është “munafik” (hipokrit) ose “zindik”.¹⁰⁷

Nuk përfytyrohet të cilësohet “kafir” askush prej “ehli kibles”,¹⁰⁸ i cili shfaq Islamin, përveç atij që është “munafik” ose “zindik.” Libri i Allahut e sqaron këtë gjë. Allahu i Lartësuar në Kur’an, i ka ndarë njerëzit në tri kategori:

- Kafirët prej mushrikëve (idhujtarëve) dhe ithtarëve të librit, të cilët nuk i pohojnë dy dëshmitë.

- Besimtarët nga brenda dhe jashtë (d.m.th. me zemër dhe në atë që shfaqet në aparence).

- Ata që kanë pohuar në aparence (në atë që shfaqet me gojë) dhe jo me zemër.

Këto tri kategori njerëzish janë përmendur në fillimin e sures “Bekare”. Çdo njeri që vërtetohet se është kafir, dhe ai pohon dy dëshmitë, nuk mund të jetë tjetër veçse “zindik”. Zindik është munafiku (hipokriti).

Këtu shfaqet gabimi i dy palëve ekstreme. Ai që e bën “kafir” në brendësi (në zemër) çdonjërin që thotë thënie të shpikur (bidat), është i detyruar, sipas rregullit të ndjekur prej tij, të bëjë “kafirë” njerëz që nuk janë në zemër munafikë. Por përkundrazi, ata në brendësi (në zemër) e duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), megjithëse janë gjynahqarë, siç ka ardhur në “Sahihun” e Buhariut nga Eslem, shërbëtori i Umerit, i cili transmeton se ky i fundit ka treguar për një burrë që jetonte në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), emri i të cilit ishte Abdullah dhe e thërrisnin me pseudonimin “Himar”. Ai e bënte për të qeshur Muhamedin (salallahu alejhi ue selem) me veprat që bënte, ose me ato që i thoshte. Profeti (salallahu alejhi ue selem) e kishte dënuar me rrahje për shkak se kishte pirë alkool, por ai përsëri vazhdonte të pinte. Kështu që e sollën një ditë dhe Profeti (salallahu alejhi ue selem) urdhëroi që të rrihej (të kamzhikohej si masë ndëshkuese e pirjes së alkoolit). Një burrë nga ata që ishin të pranishëm tha: “O Allah mallkoje! Sa shpesh që po e sjellin (të pirë)!” Profeti (salallahu alejhi ue selem) tha: “Mos e mallkoni, sepse ai e do Allahun dhe Dërguarin e Tij.”¹⁰⁹

) Zindik është kafiri që shfaq Islamin dhe fsheh mosbesimin dhe përgënjeshttrimin, me qëllim që i maskuar nën¹⁰⁷ petkun e Islamit, të përhapë idetë ateiste, materialiste dhe natyraliste, të cilat bien ndesh me parimet e fesë sonë.

) Nga ana gjyhesore “ehlu kible” janë ata që i drejtohen Kibles në namaz. Autori me këtë term synon ata që¹⁰⁸ pretendojnë se janë muslimanë dhe i drejtohen Kibles, edhe sikur të ndjekin dëshirat (bidatet), ose të bëjnë gjynahe, përderisa nuk përgënjeshtrojnë diçka me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem). (Shiko: “Sherhul akidetit tahavije”, 2/426.)

) Ibnu Tejmija është bazuar në këtë hadith, për të bërë ndryshimin mes gjykimit të përgjithshëm, absolut, e të¹⁰⁹ pakufizuar dhe gjykimit ndaj një personi të veçantë. Ai ka thënë: “Pejgamberi e ndaloi mallkimin e tij, edhe pse

Është e sigurtë që shumë grupe dhe prijës në dije dhe devocion fetar, e duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), dhe besojnë në Allahun e të Dërguarin, megjithëse kanë pasur disa mendime të xhehmive, murxhiëve, kaderive, shiave ose havarixhëve. për sa u përket prijësve në dije dhe devocion fetar, ata nuk e kanë përqafuar atë bidat tërësisht, por një pjesë të tij. Kjo është arsyeja që ndjekësit e këtyre bidateve, shtiren si përqafues të ideve të një pjese të selefëve të njohur.

Nga të metat e bidatçinjve, është se ata e cilësojnë njeri-tjetrin ‘kafir’, ndërsa nga të mirat e dijetarëve është se ata i vënë në dukje gabimet e të tjerëve dhe nuk i cilësojnë ‘kafirë’ (ata që nuk janë të tillë).¹¹⁰

Disa njerëz, duke lexuar këto fakte mund të mendojnë që “ehli suneti” nuk e cilëson asnjëherë “kafir” një person të caktuar. Ky mendim, është i ngjashëm me atë të atyre që mendojnë se “ehli suneti” toleron dhe neglizhon në çështjen e tekfirit. Ai që i studion thëniet e selefëve në lidhje me këtë temë, do të shohë se ata ishin shumë të kujdesshëm dhe të rezervuar në cilësimin e të tjerëve “kafirë”, vetëm në qoftë se informoheshin rreth argumentit.

Nga kjo kuptohet intuitivisht se për një person të caktuar (kur bëhet fjalë për gjykimin e tij), kur i përcillet argumenti dhe këmbëngul në punën e kufrit, gjykohet se është kafir. Kështu që i bëhet kërkesë për t’u penduar dhe në qoftë se pendohet i pranohet pendimi, përndryshe vritet.¹¹¹

Le të lexojmë atë që ka përmendur ibn Tejmije në lidhje me këtë temë:

“Në qoftë se kjo është bërë e njohur, atëherë nuk lejohet që të cilësohet ky person (një person i caktuar), nga këta xhahilë dhe të ngjashmit me ta, ‘kafir’, vetëm në qoftë se informohet rreth argumentit fetar, nëpërmjet të cilit del në pah se ai është kundërshtar i të dërguarve. Pra, megjithëse mendimi i tij është kufër, pa dyshim, për një person të caktuar, nuk gjykohet ‘kafir’, derisa t’i përcillet argumenti.

vazhdonte me këmbëngulje në pirjen e alkoolit, duke arsyetuar që ai e do Allahun dhe të Dërguarin, megjithëse Pejgamberi ka mallkuar në lidhje me alkoolin dhjetë vetë: ‘Mallkimi i Allahut qoftë mbi pijet dehëse, mbi atë që i pi, mbi atë që i shet, mbi atë që i blen, mbi atë që shërben dhe i ofron për t’i pirë, mbi atë që i prodhon duke shtrydhur lëndët, mbi atë që kërkon të prodhohen për të nëpërmjet shtrydhjes, mbi atë që i mban dhe mbi atë që kërkon t’ia sjellin dhe t’ia përcjellin’, në një transmetim tjetër ka ardhur: ‘dhe mbi atë që e ha çmimin dhe vlerën e saj’. Mirëpo mallkimi i përgjithshëm e i pakufizuar, nuk tregon detyrimisht për mallkimin e një personi të caktuar që ka një atribut, i cili e pengon të përfshihet në këtë mallkim. Po kështu është edhe tekfiri i përgjithshëm dhe paralajmërimi i përgjithshëm për ndëshkim. Prandaj pësimi i ndëshkimit të paralajmëruar për të, në mënyrë të përgjithshme e të pakufizuar, në Kur’an dhe Sunet, është i kushtëzuar nga plotësimi dhe evidentimi i kushteve dhe nga eliminimi i pengesave.”

) Marrë nga: “Sherhul akidetit-tahavijeti”.¹¹⁰

) Rregullin e vrasjes e zbaton prijësi i muslimanëve dhe të autorizuarit e tij.¹¹¹

Kështu duhet të gjykohet dhe të diskutohet rreth të gjithë personave të caktuar, megjithëse disa bidate janë më të mëdha se të tjerat dhe disa bidatçinjtë kanë besim më shumë se të tjerët. Asnjërit nuk i lejohet ta bëjë muslimanin “kafir”, edhe sikur të gabojë, derisa t’i arrijë argumenti fetar dhe t’i bëhet e qartë rruga e drejtë.

Përderisa Islami i dikujt vërtetohet në mënyrë të sigurtë, nuk lejohet që ai të nxirret prej tij me dyshim. Kurrsesi nuk lejohet të nxirret nga Islami, vetëm se pas përcjelljes së argumentit fetar dhe zhdukjes së mëdyshjes (dilemës).”

Kushtet e tekfirit

Kushti i parë. Personi i caktuar të ketë për qëllim me shprehjen e tij, domethënien për të cilën njeriu bëhet “kafir”

Tekfiri është një gjykim fetar, për të cilin, para se të cilësojmë një person të caktuar të “ehlul kibles” si “kafir”, duhet të sigurohemi se ai ka bërë kufër dhe ka dalë nga feja. Prandaj është detyrë e domosdoshme që të njohim qëllimin e personit të caktuar për të cilin bëhet fjalë, dhe të njohim se a e pranon kuptimin i cili është kufër apo nuk e pranon. Kjo sepse disa shprehje mund të përmbajnë në vetvete disa kuptime, dhe ndoshta personi i caktuar, ka pasur për qëllim nëpërmjet përdorimit të një shprehjeje, një kuptim që nuk është kufër. Po kështu, ai mund të shprehë një mendim, i cili detyrimisht tregon për gjëra që janë kufër, të cilat nuk i ka për qëllim dhe nuk i pranon si mendime të tij.

Ibnu Tejmija ka thënë: “Mohimi i kuptimit se Allahu është i ndarë e i shkëputur nga krijesat dhe mohimi i lartësisë së Allahut mbi krijesat, është i pavlefshëm, i kotë. Madje këto mendime, në mënyrë të pashmangshme (të domosdoshme), tregojnë për përgënjeshtimin e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) në ato që ia ka pohuar Zoti i tij dhe të cilat janë lajmërim rreth Tij. Kështu që këto janë kufër, por jo çdo njeri që e shpreh kufrin, bën kufër (del nga feja). Ai nuk del nga feja, derisa t’i përcillet argumenti që e bën të qartë dhe e konfirmon kufrin e tij. Kur të mirinformohet me një argument të saktë, atëherë bëhet kafir. Madje mohimi i këtyre gjërave,¹¹² në mënyrë të detyrueshme, përbën akuzë ndaj të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe do të thotë të bëhet kafir, sepse sipas tyre, i ka atribuar Allahut gjëra që janë të pavërteta, pra ka bërë kufër. Madje më shumë se kaq, mohimi i

) Të cilat u përmendën më lart si lartësia e Allahut etj.¹¹²

këtyre gjërave, në mënyrë të pashmangshme do të thotë mohim i Krijuesit. Përderisa mohimi i tyre, për sa i përket këtij aspekti, tregon detyrimisht për kufër, ndërkohë që këtë e kanë bërë shumë grupe besimtarësh, nga kjo rezulton se ajo çka tregon detyrimisht shprehja e personit, nuk konsiderohet prej mendimit (bindjes) të tij, vetëm në qoftë se ai i cili e ka këtë mendim, do të pranojë si të vërtetë domethënien e pavlefshme që derivon domosdoshmërisht nga mendimi i tij.¹¹³

Shumë njerëz mohojnë ose pohojnë shprehje, madje mohojnë ose pohojnë kuptime, të cilat detyrimisht tregojnë për gjëra që janë kufër, ndërkohë që ata nuk e dinë se mendimet e tyre medoemos tregojnë për gjëra të tilla. Kështu që ata bien në kontradiktë me vetveten. Sa shumë që njerëzit e kundërshtojnë vetveten, sidomos në këtë temë. Por kjo lloj kontradikte nuk është kufër.”

Gjithashtu ai ka thënë: “E vërteta është se ideja për të cilën tregon detyrimisht shprehja e një personi, nuk konsiderohet si ide e tij, përderisa ai nuk e pranon dhe nuk e pohon. Sepse kur ai e mohon dhe e përgënjeshton, nëse do t’ia mveshësh, është gënjeshtër ndaj tij. Por nga ana tjetër, kjo tregon se mendimi i tij, është i pasaktë dhe se ai është kontradiktor në besimin e tij.”

Ibnu Tejmija ka thënë: “Dijetarët e muslimanëve, unanimish, janë pajtuar kundër këtij gjykimi.¹¹⁴ Ata kanë sqaruar se kur muslimani ka për qëllim një kuptim të vërtetë në të drejtën e Allahut ose të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), por për arsye se nuk i njeh domethëniet e fjalëve, përdor një shprehje duke menduar që tregon për kuptimin e vërtetë, ndërkohë që ajo tregon për një kuptim të pavërtetë, ai nuk bën kufër. Kush e bën ‘kafir’ një person të tillë, e meriton më tepër se ai që t’i mvishet kufri, sepse gjykimi i tij bie në kundërshtim me Librin e Allahut, sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe ixhmain (unanimitetin, konsensusin) e muslimanëve.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **‘O ju që keni besuar! Mos thoni (të Dërguarit) Ra’ina...’**¹¹⁵ El Bekare: 104.

Këtë shprehje e përdornin çifutët, duke pasur për qëllim ofendimin dhe lëndimin e Profetit (salallahu alejhi ue selem), ndërsa muslimanët nuk e kishin

) Për t’u kuptuar më qartë ky fragment, do ta ilustrojmë me shembullin që u përmend më lart, se mendimi dhe ¹¹³ bindja se Allahu nuk është në lartësi dhe i ndarë nga krijesat e Tij, detyrimisht do të thotë mohim i Krijuesit, por ky mohim, që në mënyrë të detyrueshme tregon për të, mohimi i lartësisë së Allahut mbi krijesat, nuk konsiderohet mendim i atij që e mohon lartësinë e Allahut mbi krijesat, vetëm në qoftë se e pranon si mendim të tij dhe i përmbahet.

) Këtë që po e përmendim, ibnu Tejmija e ka thënë gjatë një përgjigjeje, ku ka hedhur poshtë mendimin e dikujt që ¹¹⁴ ka thënë se njeriu bën kufër (del nga feja, bëhet kafir), në qoftë se shpreh një shprehje që gjykohet se është e keqe, edhe pse ka pasur qëllim të mirë.

) Ra’ina në arabisht do të thotë “Ki kujdes, na dëgjo ne dhe ne të dëgjojmë ty”, ndërsa në hebraisht ajo nënkupton ¹¹⁵ ofendim dhe çifutët gjithnjë ia thonin Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) me qëllime të këqija.

një qëllim të tillë, prandaj Allahu ua ndaloi përdorimin e saj, por nuk i bëri ‘kafir’ për shkak të thënies së saj.”

Kjo thënie e Ibnu Tejmijes dhe dy të tjerat që përmendëm më lart, sqarojnë faktin që nuk bëhet “kafir” personi i caktuar (i veçantë) për shkak të diçkaje që nuk e ka pasur për qëllim. Si p.sh. kur përdor një shprehje duke menduar se ajo tregon për një kuptim të mirë e të vërtetë, por ajo tregon për një kuptim tjetër jo të mirë dhe jo të vërtetë, i cili është kufër. Ky person bëhet “kafir” vetëm në qoftë se ka për qëllim kuptimin që është kufër. Po ashtu edhe kur shpreh një mendim i cili detyrimisht tregon për gjëra që janë kufër, të cilat nuk i ka për qëllim dhe nuk i pranon si mendime të tij.

Kushti i dytë. Informimi rreth çështjes fetare me argument

Ibn Tejmije ka thënë: “Kur’ani dhe Suneti tregojnë që Allahu nuk ndëshkon askënd, veçse pas dërgimit të një të dërguari. Atij që nuk i ka arritur fare, nuk e ndëshkon, ndërsa atë që i ka arritur shpallja në mënyrë të përgjithshme, por disa gjëra të detajuara nuk i kanë arritur, nuk e ndëshkon përveçse për mohimin e asaj për të cilën është informuar.”

Për këtë tregojnë ajetet që vijojnë:

“Të Dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues në mënyrë që njerëzimi të mos ketë më arsye për t’u shfajësuar ndaj Allahut pas të Dërguarve. Dhe Allahu është kurdoherë i Gjithfuqishëm, më i Urti Gjithëgjykues.” En-Nisa: 165.

“O ju bashkësi e xhindëve dhe e njerëzve! A nuk erdhën tek ju të Dërguar nga mesi juaj duke ju shpallur Vargjet e mia dhe duke ju paralajmëruar për takimin në këtë Ditë tuajën?” Ata do të thonë: **‘Ne dëshmojmë përkundër vetvetes sonë.’** Ishte pikërisht jeta e kësaj bote që i gënjeu ata dhe vetë ata do të dëshmojnë kundër vetvetes, se me të vërtetë kanë qenë mosbesimtarë.” En-Aam: 130.

“Dhe atje ata do të bërtasin: ‘Zoti ynë! Na nxirr të punojmë mirësi e drejtësi, jo ato (vepra të këqija) që punuam gjithnjë.’ (Allahu do t’u përgjigjet) **A nuk u dhamë Ne jetë mjaft të gjatë, saqë kushdo që donte të merrte këshillim, mund ta merrte atë? Edhe këshilluesi ju erdhi. Shijoni pra, (të keqen e punëve tuaja)! Për Dhalimunët (mosbesimtarët dhe keqbërësit) nuk ka asnjë ndihmës.”** Fatir: 37.

“Dhe ata që nuk besuan do të drejtohen dhe do të çohen në grupe në Xhehenem, derisa kur të arrijnë tek ai, dyert do të hapen (menjëherë si një

burg, kur sapo arrijnë të burgosurit). **Dhe ruajtësit e tij do të thonë: ‘A nuk ju erdhën juve nga mesi i juaj të Dërguarit duke ju bërë të njohur Vargjet e Zotit tuaj dhe duke ju këshilluar për Takimin e kësaj Ditës suaj?’ Do të thonë: ‘Po’, por është përligjur dhe është vërtetuar fjala e ndëshkimit kundër mosbesimtarëve!’** Ez-Zumer: 71.

“Kushdo që ecën drejt, ai ecën drejt për të mirën e vetes së vet dhe kushdo që ecën shtrembër, ai ecën shtrembër me humbje të vetes së vet. Asnjë i rënduar me barrë nuk mund të mbajë barrën e një tjetri (secili mban barrën e vet) dhe Ne nuk ndëshkojmë përderisa të çojmë të dërguar (për të udhëzuar e këshilluar).” El Isra: 15.

“Dhe kurrë Zoti yt nuk do të shkatërrojë vendbanime, derisa Ai të çojë në kryeqendër të tyre një të Dërguar që t’u lexojë atyre Vargjet Tona. Dhe kurrë Ne nuk do t’i shkatërronim qytetet, veçse kur banorët atje të jenë Dhalimunë (politeistë, keqbërës, mosbesimtarë të Njëjtësisë së Allahut).” El Kasas: 59.

“Ai pothuaj shpërthen me vrull. Çdo herë që hidhet në të një grup (të caktuar për të hyrë në të), ruajtësi i tij do të pyesë: ‘A nuk erdhi tek ju këshillues? Ata do të thonë: ‘Po sigurisht! Vërtet që një këshillues na erdhi neve, por ne e përgënjeshtroam atë dhe thamë: ‘Allahu as që ka zbritur gjë (shpallje të Tij), veçse ju jeni në gabim të madh’.” El Mulk: 8-9.

“Dhe po t’i kishim shkatërruar ata me një ndëshkim para këtij (para ardhjes së Muhamedit si i Dërguar dhe para shpalljes së Kur’anit), ata padyshim që do të kishin thënë: ‘Zoti ynë! Veç sikur Ti të na kishe sjellë një të Dërguar, ne sigurisht që do të kishim ndjekur Ajetet (vargjet, urdhërat, provat, shpalljet) para se të ishim poshtëruar e turpëruar’.” Ta Ha: 134.

“Dhe në qoftë se nuk (do të të kishim dërguar Ne te populli i Mekës) në rast se do t’i kapte ata ndonjë fatkeqësi për (veprat që) ata vetë me duart e tyre i kryen, do të kishin thënë: ‘Zoti ynë pse nuk na çove neve të Dërguar? Ne do t’i kishim ndjekur ajetet e Tua (shpalljet e Tua, Kur’anin) dhe do të kishim qenë prej besimtarëve’.” El Kasas: 47.

Ajete të tilla në Kur’an janë përmendur në vende të shumta. Ai që i ka besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem), por nuk i ka ditur disa gjëra që ka ardhur me to i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), dhe si rrjedhojë nuk ka besuar në to në mënyrë të detajuar, ose për shkak se nuk ka dëgjuar për to, i janë përcjellë nëpërmjet një rruge që nuk e ka detyrë t’i besojë, ose ka besuar një domethënie tjetër, përmes një lloji të interpretimit me

të cilin justifikohet, këtij njeriu i është dhënë aq besim në Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), sa që e bën të denjë ta shpërblejë Allahu për të. Ndërsa atë që nuk e ka besuar, nuk i ka arritur në lidhje me të argumenti fetar, të cilin kush e kundërshton bëhet kafir.

Përcjellja dhe informimi i njerëzve rreth argumentit fetar, ndryshon sipas ndryshimit të kohëve, vendeve dhe personave¹¹⁶

Ibn Tejmije ka thënë: “Shumë njerëz jetojnë në vende dhe kohëra, në të cilat zhduken shumë njohuri profetike (njohuri që e kanë burimin nga Profeti), aq sa nuk mbetet kush për të përcjellë Kur’anin dhe urtësinë (Sunetin) me të cilën Allahu dërgoi të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem). Kështu që këta njerëz nuk i njohin shumë gjëra me të cilat Allahu dërgoi të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe nuk ekzistojnë njerëz që t’ua përcjellin ato. Njerëz të tillë nuk bëhen kafirë. Prandaj dijetarët janë pajtuar të gjithë, se kush është rritur në një shkretirë që është larg njerëzve të diturisë dhe besimit, apo është i ri në përfaqimin e Islamit dhe si rrjedhojë i ka mohuar disa rregulla që janë të qarta e të dukshme, mutevatire,¹¹⁷ ndaj këtij personi nuk gjykohet që është kafir, derisa të njohë atë që ka ardhur me të i Dërguari salallahu alejhi ue selem. Prandaj është transmetuar në hadithin e Hudhejjes se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ‘Zhduket Islami siç zhduket ngjyra e rrobës, derisa të mos dihet ç’është agjërimi, namazi, kurbanit dhe sadakaja. Libri i Allahut do të ngrihet (do të hiqet dhe të zhduket nga mus’hafët dhe gjokset e njerëzve) në një natë, dhe prej tij nuk mbetet asnjë ajet. Si rrjedhojë mbeten disa grupe njerëzish, pleqtë dhe plakat, të cilët thonë: ‘I kemi gjetur baballarët tanë në këtë fjalë ‘La Ilahë il-lall-llah’, kështu që edhe ne e themi.’”

Atëherë Siletu¹¹⁸ tha: “Çfarë dobie do t’u bëjë ‘La Ilahë il-lall-llah’, ndërkohë që ata nuk dinë ç’është namazi, agjërimi, kurbanit dhe sadakaja?” Hudhejfe nuk i ktheu përgjigje. Ia përsëriti për së dyti por Hudhejfe prapë nuk

) Çështja e arritjes së dijes fetare te njerëzit është relative dhe jo absolute. Ndoshta në një vend është përcjellë¹¹⁶ argumenti fetar (el huxh-xhetu), për shkak të përhapjes së dijes dhe dijetarëve, ndërsa në një vend tjetër nuk është përcjellë për shkak të dobësisë dhe pakicës së atyre që ftojnë dhe përhapin dijen islame. Ndoshta një personi i është përcjellë argumenti për shkak të dijes dhe aftësisë së tij për perceptim, ndërsa një tjetri nuk i është përcjellë argumenti fetar, për shkak të pamundësisë së tij për të marrë dije fetare, sepse është i ri në përfaqimin e Islamit, ose sepse është rritur dhe ka jetuar në një zonë të largët nga dija si p.sh. zonë malore, shkretëtirë etj.

) Mutevatire janë çështjet që argumentet e transmetimit të tyre arrijnë nivelin “teuatir”, prej të cilit përfitohet¹¹⁷ bindje e sigurtë.

) Një dijetar dhe transmetues hadithesh.¹¹⁸

i ktheu përgjigje. Kur ia përsëriti për së treti, Hudhejfje ia ktheu përgjigjen duke i thënë tri herë: “O Sileh, i shpëton nga zjarri.”¹¹⁹

Ibnu Tejmija ka thënë: “Ndërsa, për sa i përket tekfirit, e vërteta është se cilido nga Umeti i Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) që përpiket për të vërtetën dhe e synon atë, por gabon, nuk bëhet kafir, madje i falet gabimi.

Ai që i sqarohet ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), dhe ndjek një rrugë tjetër e jo rrugën e besimtarëve, është kafir. Ai që ndjek epshin e tij, neglizhon në kërkimin e së vërtetës dhe flet pa dije, është gjynahqar dhe mund të cilësohet ‘fasik’ (mëkatar i madh). Mundet që të mirat e tij të jenë më të shumta se të këqijat e tij. Pra tekfiri ndryshon sipas ndryshimit të gjendjes së personit. Nuk është çdo gabimtar, as çdo bidatçi, as çdo i paditur dhe as çdo i humbur ‘kafir’, madje as ‘fasik’ dhe as gjynahqar (kundërshtar).”

Ai gjithashtu ka thënë: “Ndoshta një diskutues mund të hedhë poshtë mendimin e diskutuesit tjetër, duke përdorur një mënyrë përgënjeshtrimi, prej së cilës rezulton të bëhet ‘kafir’, bidatçi, gjynahqar e i prishur dhe që meriton të bojkotohet, megjithëse mundet që të mos e meritojë një gjë të tillë. Kjo mënyrë e përdorur për përgënjeshtimin e mendimit të kundërshtarit është ‘ixhtihad’. Ashpërsia mund të jetë e saktë ndaj disa personave, ose në disa raste, ngaqë shfaqet dhe dominon Suneti, kundërshtari i të cilit bëhet ‘kafir’, dhe ngaqë dëmi i shkaktuar prej mendimit tjetër që bie ndesh me Sunetin, është i tillë që i zoti i tij bëhet bidatçi. Këto janë gjëra që duhet t’i dijë i mençuri.

Atributi i thënies ose lajmit të vërtetë është që të jetë në përputhshmëri me realitetin, por për sa i përket atij që e dëgjon, ajo mund të jetë e njohur, mund të jetë e panjohur, ose mundësia më e madhe është që të jetë e njohur. Mund të jetë e prerë, e padiskutueshme apo hipotezë; pranimi i saj mund të jetë detyrë, ose mund të jetë i ndaluar; mund të cilësohet ‘kafir’ ai që e përgënjeshton dhe mund të mos cilësohet ‘kafir’. Kështu që këto janë vendime dhe rregulla praktike, të cilat ndryshojnë në varësi të personave dhe rasteve.

Nëse do të vëresh që një dijetar ia hedh poshtë dikujt bindjen e tij me ashpërsi, ose e bën ‘kafir’ për shkak të saj, ky nuk është gjykim i përgjithshëm ndaj çdonjërit, vetëm në qoftë se realizohet kushti, për të cilin meriton të trajtohet me ashpërsi dhe të bëhet ‘kafir’. Sepse ai që përgënjeshton diçka nga rregullat e njohura dhe të qarta të fesë, duke qenë i ri në Islam, ose banues dhe jetues në një vend paditurie, nuk bëhet ‘kafir’ derisa t’i arrijë argumenti fetar që ka ardhur nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem). Po kështu është

) Transmeton ibnu Maxhah dhe hadithi është i saktë.¹¹⁹

edhe e kundërta. Kur vëren një mendim apo thënie të gabuar, që e ka pasur një prijës dijeje i hershëm, të cilit i falet dhe nuk i merret në konsideratë për arsye se nuk i ka arritur argumenti, ky mendim i gabuar nuk i falet atij që i ka arritur argumenti.

Prandaj p.sh. atij që i kanë arritur hadithet e ndëshkimit të varrit dhe i mohon, cilësohet ‘bidatçi’, ndërsa Aishja e të tjerë si puna e saj që nuk e kanë ditur se të vdekurit dëgjojnë në varret e tyre,¹²⁰ nuk bëhen ‘bidatçinj’. Ky është një parim i madhërishëm, medito mbi të sepse është i dobishëm.” (“Mexhmu-ul fetaua”, 6/60-61).

Gjithashtu, duke folur për disa nga dijetarët e filozofëve (skolastikët, ehlul kelam) ka thënë: “Ka njerëz që janë renegatë (femohues) për shkak të mohimit të bazës së fesë, ose për shkak të mohimit të disa gjërave që i përkasin fesë. Renegimi i tyre nga feja, rrjedh nga hipokrizia ose nga kufri. Kjo është një dukuri e shumë dhe dominante, sidomos në kohët dhe në vendet ku dominon xhahilijeti (injanca), kufri, dhe hipokrizia (nifaku). Këta njerëz kanë aq shumë çudira injorance, padrejtësie, gënjeshtre, kufri, hipokrizie dhe humbjeje, sa që nuk mund të përmenden në këtë shkrim. Nëse do të konstatoheshin të gjitha këto në thënie dhe mendime të paqarta e të fshehta, mund të thuhej që kanë gabuar, kanë devijuar nga e vërteta dhe nuk u është përcjellë argumenti, të cilin kush nuk e pranon, bën kufër. Por gjëra të tilla, disa grupe prej tyre i kanë në rituale të dukshme dhe të qarta, të cilat edhe elita, edhe masa e gjerë e muslimanëve e dinë që i përkasin Islamit. Madje çifutët dhe kristianët e dinë që Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) është dërguar me to dhe i ka bërë kafirë ata që i kundërshtojnë, si p.sh. urdhërimi i tij që të adhurohet Allahu një e i Vetëm, pa i bërë shok në adhurim, dhe ndalimi i adhurimit të të tjerëve përveç Allahut, si melaiket, profetët e të tjerë.¹²¹ Kjo është gjëja më e qartë dhe më e dukshme e Islamit. Gjithashtu si shembull është armiqësimi i çifutëve, kristianëve dhe mushrikëve, si dhe ndalimi i veprave të ulëta, imoralitetit, alkoolit, bixhozit, e të tjera.”

) E vërteta është që të vdekurit nuk dëgjojnë në varr, përveç rasteve që përjashtohen, siç është dëgjimi i kafirëve¹²⁰ që u hodhën në pusin e Bedrit. Për më gjerë rreth kësaj teme të shihet libri “Elajatul bej-jinat fi ademi semail emuat”.

) Kjo thënie e ibnu Tejmijes nuk do të thotë që ai nuk justifikon për shkak të paditurisë në parimet e fesë, siç e¹²¹ interpretojnë disa, ose në çështjet e shirkut siç thonë disa të tjerë. Kjo sepse nga konteksti dhe përmbajtja e tekstit kuptohet që ai bën fjalë për filozofët (ehlul kelam). Siç dihet, ata nuk janë të rinj në Islam dhe nuk janë rritur në ndonjë shkretëtirë të largët, pra, ata nuk përfshihen në katagorinë e njerëzve që i justifikon padituria në çështjet që janë të dukshme dhe të qarta. Kjo që e kemi kuptuar nga thënia e tij, është në pajtim me thëniet e ibnu Tejmijes që do t’i përmendim në vazhdim, insha-Allahu, në lidhje me justifikimin me anë të paditurisë, qoftë edhe në çështjet e dukshme dhe të qarta të fesë.

Që të konsiderohen njerëzit të informuar rreth argumentit fetar, duhet patjetër që ta kuptojnë atë

Argumenti fetar, mund të konsiderohet se i është përcjellë një personi të caktuar, vetëm pasi ky i fundit ta ketë kuptuar atë, sepse shumë argumente fetare tregojnë për justifikimin që rrjedh nga moskuptimi i rregullave të Sheriatit. Atëherë si të mos justifikohet ai që nuk e kupton çështjen më të rrezikshme dhe më të rëndësishme, e cila është çështja e tekfirit!?

Ibn Tejmije ka thënë: “Kështu është edhe puna e thënieve të cilat ai që i thotë bën kufër. Ndoshta atij që i thotë, nuk i kanë arritur argumentet që ia mundësojnë të njohë të vërtetën; ndoshta i kanë arritur, por sipas tij, nuk janë evidente e të sakta, nuk i është dhënë mundësia për t’i kuptuar, ose ndoshta has në dilema për të cilat Allahu ia pranon arsyen dhe e justifikon. Allahu ia fal gjynahun besimtarit që është përpjekur për të njohur të vërtetën dhe nuk e ka qëlluar, cilido qoftë (ky besimtar).”

Në vijim po përmendim disa argumente, të cilat tregojnë se kuptimi i argumentit nga ana e atij që i përcillet, është kusht për të gjykuar se është informuar rreth argumentit fetar.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Allahu nuk e obligon askënd përtej mundësive që ai ka. Secili merr shpërblim për atë të mirë që ka fituar dhe po kështu secili merr dënim për atë të keqe që ka fituar. Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime...”** El Bekare: 286.

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar ka lajmëruar se nuk obligon asnjë mbi mundësitë që ka. Pastaj ka përmendur lutjen e Umetit për të mos i ndëshkuar Allahu nëse gabojnë ose harrojnë. Në hadith të saktë, është transmetuar se Allahu ka thënë: **“E kam bërë”** (d.m.th. e kam pranuar lutjen tuaj dhe nuk do t’u ndëshkoj në raste të tilla). Ajeti dhe hadithi tregojnë për justifikimin e Umetit për shkak të moskuptimit, në tri aspekte.

Së pari, Allahu ka lajmëruar që nuk e obligon njeriun përtej mundësive të tij. Moskuptimi, nëse nuk shoqërohet me mospërfillje dhe indiferencë, nuk është në mundësitë e njeriut. Obligimi për atë që nuk e kupton, është obligim për atë që nuk ka mundësi për ta bërë. Këtë lloj obligimi Allahu e ka mohuar.

Së dyti, Allahu e ka justifikuar personin që ka pasur dituri dhe pastaj ka harruar. Përderisa kuptimi është dituria rreth diçkaje, ai që nuk kupton fare, është më me përparësi për t’u justifikuar se sa ai që harron.

Së treti, moskuptimi është një lloj gabimi, prandaj thuhet se filani ka gabuar në kuptimin e kësaj çështjeje. Ajeti tregon për justifikimin e atij që gabon, kështu që ai përmban edhe justifikimin e atij që nuk kupton.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Katër kategori njerëzish japin arsyet e tyre para Allahut në Ditën e Gjykimit: Burri shurdh, i cili nuk dëgjon; burri i matufepsur që i ka ikur mendja për shkak të pleqërisë së thyer; burri i çmendur e budalla dhe burri që ka vdekur në ‘el fetre’ (periudhën e ndërprerjes së mesazhit hyjnor). Shurdhi thotë: ‘Zoti im, vërtet erdhi Islami dhe unë nuk dëgjoja asgjë’. Budallai i çmendur thotë: ‘Zoti im, Islami erdhi në një kohë kur mua fëmijët më gjuanin me bajga (nga që isha i çmendur)’. Plaku i matufepsur të cilit i ka shkuar mendja thotë: ‘Zoti im, Islami erdhi dhe unë nuk kuptoja asgjë’. Ndërsa ai që ka vdekur në periudhën e ndërprerjes së mesazhit hyjnor thotë: ‘Zoti im, mua nuk më ka ardhur i Dërguari për të ndjekur fenë tënde’. Atëherë Allahu i Lartësuar u merr besën dhe premtimet se do t’i binden dhe u dërgon një të Dërguar, i cili u thotë që të hyjnë në zjarr.” Pastaj tha: “Beto hem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur të futeshin në të, do të ishte i ftohtë dhe shpëtim e siguri për ta.” Në një shtojcë të këtij hadithi, që e transmeton ebu Hurejre, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ‘Për atë që hyn në të, bëhet i ftohtë, shpëtim e siguri për të, dhe kush nuk hyn në zjarr, tërhiqet për t’u futur në të’.” Hadithin dhe shtojcën e transmeton Ahmedi. Që të dyja janë të sakta, siç ka thënë Albani në serinë e haditheve të sakta.

Allahu e pranon arsyen e këtyre katër kategorive dhe i justifikon. Ai që nuk dëgjon dhe ai që vdes në periudhën e ndërprerjes së mesazhit hyjnor, justifikohen për shkak se nuk u ka arritur argumenti. Ndërsa i çmenduri dhe i matufepsuri, që i ka ikur mendja për shkak të pleqërisë, është e qartë që justifikohen për shkak se nuk e kanë kuptuar argumentin.

Ibnul Kajim ka thënë: “Argumenti mund t’i arrijë një personi dhe jo një tjetri, ose për shkak të mospasjes së mendjes dhe aftësisë për të dalluar gjërat, siç është puna e të vegjëlve dhe të çmendurve, ose për shkak të moskuptimit, si puna e atij që nuk e kupton bisedën dhe nuk ka përkthyes për t’ia përkthyer. Ky është në rangun e shurdhit, i cili nuk dëgjon asgjë dhe nuk ka mundësi për të kuptuar. Në Ditën e Gjykimit ai do të bëjë pjesë në njërin prej katër kategorive të njerëzve që do të japin arsyet e tyre përpara Allahut, siç përmendet në hadithin e el Esved, ebi Hurejres e të tjerë.”¹²²

) Disa argumente të tjera në lidhje me këtë janë përmendur në librin “Meukif ehlus suneh vel xhemaah min ehliil ehvai vel bidai.”¹²²

Kjo thënie e ibnul Kajim tregon se që të konsiderohet argumenti fetar i përcjellë tek njerëzit, duhet patjetër që ata ta kuptojnë. Kështu që, nëse do t'i përcillej Kur'ani ndonjë joarabi, për ta konsideruar argumentin të përcjellë ndaj tij, duhet patjetër që të jetë i përkthyer në gjuhën e tij, në mënyrë që ta kuptojë. Mirëpo në lidhje me kuptimin dhe perceptimin e argumentit duhet të kemi parasysh dy gjëra:

E para, duhet të bëjmë dallim ndërmjet kuptimit të argumentit, i cili të bën të mirinformuar rreth tij, pa marrë parasysh nëse udhëzohesh ose e beson apo jo, dhe ndërmjet kuptimit që shoqërohet me udhëzim dhe besim. Jo çdo njeri që i përcillet argumenti dhe e kupton atë, beson dhe udhëzohet.

Allahu e ka bërë kuptimin që të bën të mirinformuar, kusht për obligimin e njerëzve në tërësi, besimtarë dhe kafirë, ndërsa kuptimin që shoqërohet me udhëzim dhe besim, ia ka dhënë vetëm atij që ka dashur.

Në ajetet e Kur'anit, ku Allahu i Lartësuar ua mohon disa njerëzve të kuptuarit dhe dijen, dhe megjithatë i cilëson kafirë, bëhet fjalë për kuptimin që shoqërohet me udhëzimin dhe me besimin dhe jo për llojin e pare:

“Ne vumë mbështjellje mbi zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë (Kur'anin), dhe në veshët e tyre shurdhim, ndërsa kur ti përmend Zotin tend, Një e të Vetëm në Kur'an, ata kthejnë shpinën duke ikur me urrejtje (nga e Vërteta).” El Isra: 46.

“Apo mendon se shumica e tyre dëgjojnë ose kuptojnë? Ata janë si bagëtitë, madje janë edhe më të humbur nga e vërteta.” El Furkan: 44.

“Vërtet që nga qeniet e gjalla, më të këqijat tek Allahu janë shurdhët dhe memecët, ata që nuk kuptojnë (mosbesimtarët). Po të dinte Allahu ndonjë të mirë tek ata, padyshim që Ai do t'i kishte bërë ata që të dëgjojnë, por edhe sikur Ai t'i kishte bërë që të dëgjonin, ata prapë vetëm se do të ishin larguar e do të ktheheshin përsëri tek e gabuara.” El Enfal: 22-23.

Këto ajete dhe të tjera si puna e tyre, nuk tregojnë që njerëzit për të cilët bëhet fjalë, nuk e kuptojnë argumentin. Përkundrazi, ato tregojnë që i kuptojnë dhe pastaj shmangen prej tyre e nuk i përfillin.

Sheukani, në komentin e ajetit të sures “Furkan”, ka thënë: “D.m.th. ata në përfitimin prej asaj që e dëgjojnë, janë si bagëtitë, të cilat nuk kanë aftësi dëgjimi dhe nuk mund të mendojnë. Kështu që mos ki lakmi për t'i udhëzuar, sepse atyre u mungon dobia e dëgjimit dhe e mendjes. Ata e dëgjojnë atë që u thuhet dhe i kuptojnë ajetet që u lexohen, por nga që nuk kanë pasur dobi prej kësaj gjëje, janë në rangun e atyre që nuk e kanë aftësinë e dëgjimit dhe të mendjes.”

Në komentin e ajetit të sures “Enfal”, fq. 23, ibnul Kajim thotë: “Allahu i Lartësuar ka lajmëruar që ata nuk janë të denjë për t’u bërë besimtarë, sepse në zemrat e tyre nuk ka mirësi, për shkak të së cilës do të hynte besimi në zemrat e tyre. Pra Allahu nuk ua ka mundësuar të dëgjonin në atë mënyrë që të kuptonin dhe të përfitonin, megjithëse dëgjonin aq sa për t’u konsideruar në rangun e atyre që u është përcjellë argumenti fetar.”

Abdurr-Rahman ibnu Sadi ka thënë: “Dëgjimi që ua ka mohuar Allahu është ai i nivelit të tillë, që ndikon dhe influencon në zemër, ndërsa dëgjimi i argumentit fetar është një gjë e konstatueshme tek ata, sepse ata i dëgjonin ajetet e Kur’anit. Dëgjimi që u është mohuar është ai që bën dobi. Këtë gjë Allahu nuk ua ka dhënë, sepse sipas dijes së Allahut, ata nuk kishin asgjë të mirë që t’i bënte të denjë për të përfituar nga dëgjimi i ajeteve të Tij.

Nga faktet që tregojnë për këtë që sqaruar, është se Allahu i ka përshkruar ithtarët e librit si njerëz që e njohin Librin e Allahut dhe fenë islame ashtu siç njohin fëmijët e tyre (El Bekare: 146). Pastaj, në disa ajete të tjera i ka përshkruar si njerëz që nuk kuptojnë, si p.sh. në fjalën e tij:

“Dhe kur ju jepni thirrjen për falje (ezanin) ata e marrin atë për tallje dhe dëfrim. Kjo ngaqë ata janë popull që nuk kupton.” El Maide: 58.

Kjo tregon se përshkrimi i ithtarëve të librit si njerëz që nuk kuptojnë, nuk do të thotë se ata nuk e kuptojnë argumentin fetar dhe mesazhet që ua ka drejtuar Allahu, sepse siç e përmendëm, Allahu ka lajmëruar që ata e njohin librin, ashtu siç njohin fëmijët e tyre, por e merituan atë dënim dhe ofendim, sepse u shmangën nga pranimi i argumentit fetar, pasi e kuptuan atë.

Të gjitha këto përshkrime, Allahu ua ka bërë jobesimtarëve në fillimin e sures “Fussilet”, aj. 1-4:

“Ha – Mim (Këto shkronja janë nga mrekullitë e Kur’anit dhe vetëm Allahu e di kuptimin e tyre).

Shpallje nga Allahu, i Gjithmëshirëshmi, Mëshirëploti.

Një libër në të cilin Vargjet e tij shtjellohen me imtësi; Një Kur’an arabisht për popullin që di.

Përgëzues (i Xhenetit për beësimtarët e përkushtuar në besimin e Fenë e Tij, Islam) **dhe këshillues** (ndaj ndëshkimit në Xhehenem për çdo mohues të Njëshmërisë së Allahut e të Fesë së Tij, Islamit), **por shumica e tyre kthejnë shpinën e largohen, kështu që ata nuk dëgjojnë.”**

Fillimisht i ka cilësuar si njerëz që i dinë kuptimet e ajeteve të librit, pastaj ka lajmëruar për shmangien dhe largimin nga e vërteta pasi e mësuan atë, dhe

së treti, si rrjedhojë e largimit nga e vërteta pasi e mësuan atë, i ka cilësuar si njerëz që nuk dëgjojnë.

Kuptimi i argumentit, nuk do të thotë që i informuari rreth tij ta perceptojë atë hollësisht njëllor si dijetarët. Muhamed ibn Abdul Vehab ka thënë: “Përderisa personi i veçantë bëhet ‘kafir’ vetëm pasi i përcillet argumenti, kjo nuk do të thotë që ai duhet ta kuptojë fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem) siç e ka kuptuar p.sh. ebu Bekri, në mënyrë që të konsiderohet argumenti i përcjellë tek ai. Kur i përcillet fjala e Allahut dhe të Dërguarit Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe nuk ka diçka që e justifikon mospranimin e tij, bëhet ‘kafir’.”

Sqarimet e ibnul Kajim, lidhur me këtë temë, në librin “Tarikul hixhretejni”¹²³

Ibnul Kajim, gjatë sqarimit të gradave të të obliguarve në Ahiret dhe kategorive të tyre ka thënë:

Kategoria e shtatëmbëdhjetë:

- Kategoria e imituesve, të cilët janë të paditurit e kafirëve, pasuesit e tyre dhe gomerët e tyre. Kjo kategori njerëzish bashkohet me kafirët dhe shkon pas tyre duke thënë: **“Përkundrazi! Ata thonë: ‘Ne gjetëm baballarët tanë të ndjekin një farë rruge dhe një lloj feje dhe ne e udhëzojmë veten pas gjurmëve të tyre’.”** Ez-Zukhruf: 22.

Megjithëkëtë, ata nuk u kanë shpallur luftë muslimanëve. Shembulli i tyre është si gratë, shërbëtorët dhe pasuesit e armiqve, të cilët nuk janë angazhuar, siç angazhohen armiqtë kundër Islamit për shuarjen e dritës së Allahut, shembjen e fesë dhe fjalëve të Tij. Këta njerëz janë në rangun e kafshëve. I gjithë Umeti është pajtuar që kjo kategori njerëzish janë kafirë, megjithëse janë të paditur dhe imitojnë krerët dhe prijësit e tyre, përveç mendimit që transmetohet nga disa bidatçinj, të cilët nuk gjykojnë për këtë kategori se janë prej banorëve të zjarrit. Sipas tyre, ata janë në rangun e atyre që nuk u ka arritur davja (thirrja islame). Ky është një mendim, të cilin nuk e ka thënë askush prej dijetarëve të muslimanëve, as sahabet, as tabiinët dhe as ata që erdhën pas tyre. Ai njihet vetëm si mendim i disa filozofëve (skolastëve, ehlul kelam) të cilët kanë shpikur në fenë islame atë që nuk është prej saj.

) Meqenëse kjo pjesë e librit të lartpërmendur të ibnul Kajim, përmban sqarime të rëndësishme në lidhje me ¹²³ shumë çështje të tekfirit, përcjelljes së argumentit dhe kuptimin e perceptimin e tij, e kemi përmendur pothuajse të plotë në fundin e këtij kushti.

Në një hadith të saktë është transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Çdo fëmijë lind në ‘el fitrah’ (natyrshmëri të pastër, të rregullt, në Islam), por prindërit e tij e bëjnë çifut, kristian ose zjarrputist.” Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Pra, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka lajmëruar që prindërit e tij e kalojnë nga “el fitra” për në hebraizëm, kristianizëm dhe zjarrputizëm. Siç vërehet qartë, Profeti (salallahu alejhi ue selem) e ka gjykuar diçka të konsiderueshme faktin që janë edukuar dhe zhvilluar në rrugën dhe fenë e prindërve të tyre. Gjithashtu, në një tjetër hadith të saktë, është transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Vërtet në xhenet hyn vetëm qenia (nefsi) muslimane.” (Buhariu dhe Muslimi). Këta imitues nuk janë muslimanë, sepse ata janë të mençur dhe të obliguar (të ngarkuar me detyra dhe obligim nga Allahu). Çdo i mençur dhe i obliguar, patjetër është ose musliman ose kafir. Ndërsa atyre që nuk u ka arritur thirrja islame, ata nuk janë të obliguar, përderisa janë në një gjendje të tillë. Ata janë në rangun e fëmijëve dhe të çmendurve, për të cilët kemi diskutuar më parë.¹²⁴

¹²⁴) Rreth këtyre njerëzve ka diskutuar në kategorin e katërbëdhjetë ku ka thënë: “Kategoria e 14-të janë njerëzit që nuk kanë as bindje (ibadete) dhe as gjynahe (mëkate, kundërshtime, shkelje), as kufër dhe as besim. Në këtë kategori përfshihen disa lloje:

- 1) Ata që nuk u ka arritur fare thirrja islame dhe nuk kanë dëgjuar asgjë rreth saj.
- 2) I çmenduri që nuk mund të logjikojë dhe të dallojë të mirën nga e keqja.
- 3) Shurdhi që kurrë në jetën e tij nuk mundet që të dëgjojë.
- 4) Fëmijët e mushrikëve (idhujtarëve), të cilët kanë vdekur para se të arrinin moshën e aftësisë logjike (mendore) për të dalluar gjërat.”

Dijetarët e Umetit kanë pasur shumë mosmarrëveshje në lidhje me gjykimin ndaj kësaj kategorie. Çështja rreth së cilës kanë diskutuar më gjerë, është ajo e fëmijëve të mushrikëve.

Ndërsa për sa u përket fëmijëve të muslimanëve, imam Ahmedi ka thënë: “Askush nuk ka kundërshtuar në lidhje me përfundimin e tyre, d.m.th. që ata janë në xhenet.”

Pas përmendjes së mendimeve të dijetarëve në lidhje me fëmijët e idhujtarëve, ibnul Kajim ka zgjedhur mendimin që ata do të sprovohen në “Arasat” në Ditën e Gjykimit. Atë ditë, atyre dhe të gjithë ata që nuk u ka arritur thirrja, do t’u dërgohet një i dërguar. Ai që i bindet të dërguarit, hyn në xhenet, ndërsa ai që e kundërshton të dërguarin hyn në zjarr. Sipas këtij mendimi disa hyjnë në xhenet dhe disa hyjnë në zjarr. Kështu bëhet pajtimi ndërmjet të gjitha argumenteve dhe haditheve që kanë të bëjnë me këtë temë. Ajo që Allahu e ka ditur në lidhje me përfundimin e tyre, të cilën Profeti (salallahu alejhi ue selem) ia ka referuar duke thënë: “Allahu është i ditur rreth asaj që ata do të punonin”, do të shfaqet në Ditën e Gjykimit.

Pastaj ibnul Kajim e ka bazuar mendimin që zgjodhi në hadithin që e transmeton el Esued ibni Serië se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Katër kategori njerëzish japin arsyet e tyre para Allahut në ditën e gjykimit: burri shurdh i cili nuk dëgjon; burri i matufepsur që i ka ikur mendja për shkak të pleqërisë së thyer; burri i çmendur e budalla dhe burri që ka vdekur në ‘el fetre’ (periudhën e ndërprerjes së mesazhit hyjnor)...”, e deri në fund të hadithit që u përmend edhe më lart, me gjithë shtojcën e transmetuar nga ebu Hurejre. Ky që ka zgjedhur ibnul Kajim, është mendimi i shumicës së të parëve tanë. Prej dijetarëve që e kanë mbështetur këtë mendim janë edhe Muhamed ibni Nasër el Meruzi, el Bejhaki, ibnu Tejmije, ibnu Kethiri etj.

Këtu përfshihen ata të cilët dijetarët i cilësojnë “ehlul fetreh.” Sipas sqarimit të dijetarëve, “ehlul fetreh” janë popujt që kanë jetuar në kohën ndërmjet të dërguarve, tek të cilët nuk është dërguar i dërguar i parë dhe nuk e kanë arritur të dytin.

Islami është njësimi i Allahut një të Vetëm dhe adhurimi i Tij pa i bërë shok, besimi në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), dhe ndjekja e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) në atë me të cilën është dërguar. Në qoftë se robi nuk i ka dhe nuk i pranon këto gjëra, nuk është musliman.¹²⁵ Ai edhe sikur të mos jetë kafir, kryeneç e i pabindur, është kafir i

Ibnu Kethiri ka thënë: “el fetretu” është periudha e ndërprerjes (së mesazhit qiellor) ndërmjet dy profetëve, si p.sh. ndërprerja e mesazhit (revelatës) ndërmjet Isës dhe Muhamedit salallahu alejhi ue selem.

Shumë dijetarë e përdorin këtë term për të gjithë ata që nuk u ka arritur thirrja islame, përfshi këtu edhe fëmijët e kafirave.

Në lidhje me “ehlul fetreh” ose ata që nuk u ka arritur thirrja islame duhet të kemi parasysh disa gjëra:

1) Diskutimi rreth “ehlul fetreh” ose atyre që nuk u ka arritur thirrja, nuk ka të bëjë me çështjen e justifikimit me anë të paditurisë, sepse në çështjen e justifikimit bëhet fjalë për atë që është evidentuar Islami i tij dhe pastaj bën diçka që është në kundërshtim me Islamin, duke qenë i paditur.

2) Mosmarrëveshja e konstatuar mes dijetarëve në lidhje me ata që nuk u ka arritur thirrja, është vetëm për sa i përket përfundimit të tyre në Ahiret, ndërsa për sa i përket gjykimit të tyre në dynja, nuk ekziston asnjë lloj mosmarrëveshje. Asnjëri nga dijetarët nuk ka thënë që ata janë muslimanë, ose në të drejtën e tyre zbatohen rregullat që kanë të bëjnë me muslimanët. Ibnul Kajim, në një fragment gjatë sqarimit rreth kategorisë së 17-të që po përmendet më lart, ka thënë: “Robi e ka detyrë të besojë që çdo njeri që pranon e përqafton fe tjetër përveç fesë islame është kafir, dhe se Allahu nuk ndëshkon askënd veçse pasi t’i përcillet argumenti nëpërmjet të dërguarve. Kështu gjykohet në përgjithësi për ta. Ndërsa gjykimi ndaj personave të veçantë (të caktuar), për sa i përket shpërbllimit dhe ndëshkimit, lihet për dijen e Allahut dhe vendimin e Tij. Kjo për sa i përket përfundimit të tyre në Ahiret, kurse rregullat e dynjasë zbatohen sipas asaj që shfaqet prej tyre. Kështu që fëmijët e kafirëve dhe të çmendurit e tyre, janë kafirë në rregullat dhe ritualet e dynjasë, pra, zbatohet në të drejtën e tyre ajo që zbatohet ndaj kujdestarëve të tyre.

3) Për sa i përket përfundimit të tyre në Ahiret, megjithëse dijetarët kanë mosmarrëveshje, mendimi më i saktë është se ata do të sprovohen atje, me anë të dërgimit të të dërguarit. Ai që i bindet shkon në xhenet, e ai që nuk i bindet shkon në zjarr, siç tregon hadithi i Profetit (salallahu alejhi ue selem).

4) Mendimi më i saktë i dijetarëve është se idhujtarët e Mekës që kanë vdekur para se të dërgohej Muhamedi (salallahu alejhi ue selem), nuk konsiderohen prej atyre që nuk u ka arritur thirrja e Teuhidit, sepse midis tyre kishte njerëz që e ndiqnin rrugën e Ibrahimit në adhurimin e Allahut një të Vetëm, pa i bërë shok. Kështu që hadithet e Profetit (salallahu alejhi ue selem) ku përmendet se disa idhujtarë të Mekës, para se të dërgohej Muhamedi (salallahu alejhi ue selem), janë prej banorëve të zjarrit, nuk bien në kundërshtim me argumentet që tregojnë se ata që nuk u ka arritur thirrja, do të sprovohen në Ahiret

) Ky sqarim që ka bërë ibnul Kajimi tregon se ai që nuk pranon e nuk njuh parimin e adhurimit të Allahut një të¹²⁵ Vetëm pa i bërë shok dhe parimin e ndjekjes dhe respektimit të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) në mënyrë të përgjithëshme, nuk konsiderohet musliman. Pohimi në mënyrë të përgjithëshme i Islamit, njësimit të Allahut dhe dëlirja e shfajësimit në mënyrë të përgjithëshme nga shirku (idhujtaria) dhe idhujtarët, është e domosdoshme për një njeri që të konsiderohet dhe të radhitet prej “ehlul kible”, rreth të cilëve vërtiten rregullat e tekfirit që po i sqarojmë. Në qoftë se njeriu bie në gjëra të cilat përbëjnë përgënjeshttrim dhe rrënim të përgjithshëm të parimeve të fesë, si p.sh. të mohojë profecinë e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), të mos besojë në Ditën e Gjykimit, të pretendojë që Allahu ka bashkëshorte ose fëmijë, ose të besojë dhe të bëjë idhujtari, si puna e disa batinijve, një person i tillë nuk ka hyrë dhe nuk e ka përqaftuar fenë islame, edhe sikur ta deklarojë veten musliman. Por duhet të kemi parasysh që persona të tillë të cilët nuk pranojnë parimin e adhurimit të Allahut një të Vetëm e pa i bërë shok, dhe që bien në gjëra të cilat përbëjnë përgënjeshttrim të përgjithshëm të parimeve të fesë, nëse u ka arritur argumenti i mesazhit hyjnor dhe nuk e kanë pranuar, janë kafirë në rregullat dhe vendimet e dynjasë dhe të Ahiretit. Ndërsa, nëse nuk u ka arritur thirrja islame, ose u ka arritur në një mënyrë të shtrembëruar e të shpërftyruar, gjë e cila i largon njërëzit nga Islami, në rast të tillë ata konsiderohen kafirë në rregullat dhe vendimet e dynjasë, kurse në Ahiret Zotit e di më së miri përfundimin e tyre. Ndryshe është puna me ata, Islami i të cilëve është evidentuar, dhe të cilët në përgjithësi besojnë në parimet e Islamit si në profecinë e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), në Ditën e Gjykimit, e pranojnë parimin e adhurimit të Allahut një të Vetëm, pa i bërë shok, dhe parimin e respektimit dhe pranimit të Sheriatit në përgjithësi. Këta njerëz, edhe sikur të bien në gjëra që janë shirk i madh apo i vogël, gjëra që

paditur. Më e pakta që mund të thuhet në lidhje me këtë kategori, është se ata janë kafirë të paditur dhe nuk janë kryeneçë. Mosqenia e tyre kryeneçë e kokëfortë, nuk do të thotë që nuk janë kafirë, se kafir është ai që e mohon njësimin e Allahut dhe e përgënjeshton të Dërguarin nga kryeneçësia, ose nga padituria dhe imitimi i njerëzve kryeneçë e të pabindur. Ky njeri, edhe nëse nuk është kryeneç, është pasues i njerëzve të tillë. Në shumë vende në Kur'an, Allahu i Lartësuar na ka lajmëruar për dënimin e atyre të cilët imitojnë të parët e tyre kafirë. Ai na ka lajmëruar që pasuesit do të jenë me të pasuarit, se ata do të grinden në zjarr dhe se pasuesit thonë:

“...Zoti ynë: ‘Këta na humbën ne. Jepu atyre sa dy herë dënimin tonë në zjarr!’ (Allahu) do t’u thotë: ‘Për secilin prej jush ka dyfish (dënim), por ju nuk e dini’.” El Arafë: 38.

“Kur të jenë duke u grindur në zjarr, të dobtit do t’u thonë atyre që ishin kryelartë: ‘Vërtet që ne ju ndoqëm ju. A mundeni tani të merrni prej nesh ndopak nga zjarri?’ Ata që ishin kryelartë do të thonë: ‘Ne jemi të gjithë në këtë (zjarr)! Vërtet që Allahu ka gjykuar mes robëve (të Tij)!’” Gafir: 47-48.

“Ata që mohojnë thonë: ‘Ne nuk besojmë në këtë Kur’an, as në çfarë ishte para tij’, por veç të mund t’i shihje kur Dhalimunët (politeistët, keqberësit) të detyrohen të qëndrojnë para Zotit të tyre, se si do t’ia hedhin fajin njeri-tjetrit! Ata që ishin të dobët do t’u thonë atyre që ishin kryelartë: ‘Po të mos kishit qenë ju, ne sigurisht do të kishim qenë besimtarë!’ E ata që ishin kryelartë do t’u thonë atyre që ishin të dobët: ‘A ne u ndaluan ju nga udhëzimi që të drejtoheshit, pasi ai erdhi te ju? Përkundrazi, ju ishit Muxhrimunë (politeistë, mëkatarë, kriminelë, të pabindur ndaj Allahut).’ Ndërsa ata që ishin të dobët do t’u thonë atyre që ishin kryelartë: ‘Jo, ishte përbetimi juaj që thurnit natën e ditën, kur ju na urdhëronit ne që të mos besojmë Allahun dhe t’i bashkojmë Atij shokë!’ Secila (palë) prej tyre do të fshehë keqardhjen e vet (për mosnënshtrimin ndaj Allahut në jetën e kësaj bote), kur të shohin ndëshkimin. Ne do të vëmë jaka hekuri në qafat e atyre që mohuan. A janë shpërblyer për (tjetër), veç për çfarë patën vepruar?’” Sebe: 31- 33.

kanë të bëjnë me detajet e Teuhidit, ose të bien në devijime që kanë të bëjnë me detaje të tjera të besimit, si mohimi i disa gjërave të detajuara në lidhje me botën e përtejme, mohimi i ndonjë cilësie të Allahut, ose disa detaje të ligjit të Sheriatit, nuk bëhen kafirë, vetëm në qoftë se u ka arritur argumenti fetar rreth gjërave të detajuara. Në gjëra të tilla, muslimani justifikohet me anë të paditursë, përderisa nuk është i mirinformuar rreth argumentit fetar. E shikoj të arsyeshme ta theksoj edhe një herë, se ai që e pranon parimin e Teuhidit dhe nga padituria përzihet e vepron gjëra që janë “shirk”, duke menduar se nuk janë “shirk”, sipas besimit unanimit të “ehli sunetit”, nuk bëhet “kafir”, vetëm nëse i përcillet argumenti fetar.

Në këto ajete Allahu lajmëron dhe paralajmëron se të pasuarit dhe pasuesit, dënimin do ta kenë të përbashkët. Pasuesve nuk u bën fare dobi fakti që kanë qenë imitues.

Më e qartë se kjo që përmendëm është fjala e Allahut:

“Kur ata të cilët u ndoqën (në adhurimin nga njerëzit) do t’i mohojnë (e ta shpallin veten të pafajshëm nga) ata të cilët i adhuruan dhe ata të shohin dënimin, atëherë të gjitha lidhjet e tyre do t’u shkëputen.* Ndërsa ata që i ndoqën do të thonë: ‘Eh, sikur të kishim një rast të ktheheshim (në dynja), se do t’i mohonim ata si të adhuruarit tanë, siç na mohuan ata ne dhe e shpallën veten të pafajshëm prej nesh’. Kështu Allahu do t’ua tregojë atyre veprat e tyre si keqardhje për ta. Dhe ata nuk do të dalin kurrë prej zjarrit.” El Bekare: 166-167.

Në një hadith të saktë, është transmetuar se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kushdo që fton në humbje, do të marrë gjynahe njëlloj si gjynahet e atyre që e ndjekin, duke mos u mangësuar aspak gjynahet e atyre që e ndoqën.” Transmeton Muslimi.

Kjo tregon se kufri i pasuesve ndodh thjesht për shkak të ndjekjes së verbër dhe imitimit (të të parëve). Mirëpo në lidhje me këtë temë, patjetër duhet të bëjmë një shkoqitje, e cila e asgjëson mendimin që mund t’i lindë dikujt, se këtu kemi të bëjmë me një paradoks. Kjo sepse ka ndryshim ndërmjet imituesit që ka pasur mundësi për të marrë dije dhe për të njohur të vërtetën, por u largua dhe u shmang prej saj, dhe ndërmjet imituesit që nuk ka pasur kurrfarë mundësie të tillë. Që të dy llojet e imituesve, janë realitet ekzistues në përgjithësi. Ata që kanë mundësi për të njohur të vërtetën dhe largohen prej saj, kanë neglizhuar dhe nuk e kanë bërë detyrën, kështu që nuk ka arsye e cila i justifikon tek Allahu. Ndërsa ata që nuk kanë pasur kurrfarë mundësie e aftësie për të pyetur dhe për të marrë dije, ndahen në dy pjesë gjithashtu:

- Në ata që e duan udhëzimin dhe e preferojnë atë, por nuk kanë mundësi që ta gjejnë, për shkak se nuk ka kush i orienton. Këta i përfshin gjykimi i atyre që jetojnë në periudhat e ndërprerjes së shpalljes hyjnore dhe atyre që nuk u ka arritur thirrja.

- Në të shmangurit (indiferentët) që nuk kanë dëshirë për të njohur të vërtetën dhe nuk mendojnë në vetvete, përveçse për bindjet që kanë.

Njerëzit e pjesës së parë thonë: “O Zot, sikur të dinim se ka fe tjetër më të mirë se bindjet që kemi, do ta pasonim, por nuk njohim veçse këtë që kemi dhe nuk kemi mundësi për të njohur diçka tjetër. Ky është kulmi i mundësive dhe i njohurive tona.

Ndërsa njerëzit e pjesës së dytë janë të kënaqur me bindjet që kanë, nuk preferojnë mbi to asgjë tjetër dhe nuk kërkojnë veçse ato. Qëndrimi i këtyre do të jetë i njëjtë, pa asnjëfarë ndryshimi, si në rastin kur janë të aftë dhe të mundshëm për të njohur të vërtetën, po ashtu edhe kur nuk janë të tillë.

Megjithëse njerëzit e të dy grupeve, nuk kanë mundësi e aftësi për të njohur besimin e drejtë, grupi i dytë nuk duhet të trajtohet si i pari, sepse mes tyre ka ndryshim. Grupi i parë i njerëzve është si puna e atyre që kërkojnë fenë e drejtë në periudhën e ndërprerjes së shpalljes hyjnore dhe nuk e gjejnë. Kështu që ata vdesin në bindje të tjera, nga paaftësia dhe padituria, pasi kanë dhënë të gjithë mundin për kërkimin e së vërtetës. Ndërsa grupi i dytë i tyre, është si puna e atij që nuk e kërkon fenë e drejtë dhe nuk mundohet për ta gjetur, por vdes në shirk dhe në bindjet e tij, edhe pse sikur ta kërkonte, nuk do të kishte mundësi ta gjente. Kështu që ka ndryshim ndërmjet pamundësisë së atij që e kërkon fenë e vërtetë dhe pamundësisë së mospërfillësit, të shmangurit e indiferentit.

Mendo thellë mbi këtë arsytim! Allahu do të gjykojë ndërmjet robërve të Tij në Ditën e Gjykimit me vendimin dhe drejtësinë e Tij. Ai do të ndëshkojë vetëm atë që i ka arritur argumenti, të cilin e kanë përcjellë të dërguarit e Tij. Kjo gjë, për sa i përket krijesave në përgjithësi, është e prerë dhe e padiskutueshme. Ndërsa për sa u përket individëve të veçantë ne nuk mund të ndërhyjmë ndërmjet Allahut dhe robërve të Tij për të gjykuar se a u ka arritur argumenti apo jo. Detyra e robit është që të besojë se çdo njeri që pranon e përqafton fe tjetër përveç fesë islame është kafir, dhe se Allahu nuk ndëshkon askënd, veçse pasi t'i përcillet argumenti nëpërmjet të dërguarit. Kështu gjykohet në përgjithësi për ta. Kurse gjykimi ndaj personave të veçantë (të caktuar), për sa i përket shpërblimit dhe ndëshkimit, lihet për dijen e Allahut dhe vendimin e Tij.

Kjo për sa i përket përfundimit të tyre në Ahiret, kurse rregullat e dynjasë zbatohen sipas asaj që ata shfaqin. Kështu që fëmijët e kafirëve dhe të çmendurit e tyre, janë kafirë në rregullat dhe ritualet e dynjasë, pra zbatohet në të drejtën e tyre ajo që zbatohet ndaj kujdestarëve të tyre.

Sqarimi që kemi bërë është i bazuar në katër parime:

Parimi i parë. Allahu i Lartësuar nuk ndëshkon asnjë, veçse pasi t'i arrijë argumenti, siç ka thënë:

“Kushdo që ecën drejt, ai ecën drejt për të mirën e vetes së vet, dhe kushdo që ecën shtrembër, ai ecën shtrembër me humbje të vetes së vet. Asnjë i rënduar me barrë, nuk mund të mbajë barrën e një tjetri (secili

mban barrën e vet) dhe **Ne nuk ndëshkojmë përderisa të çojmë të dërguar** (për të udhëzuar e këshilluar).” El Isra: 15

“Të dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues në mënyrë që njerëzimi të mos ketë më arsye për t’u shfajësuar ndaj Allahut pas tyre. Allahu është kurdoherë i Gjithëfuqishëm, më i Urti Gjithëgjykues.” En-Nisa: 165.

“Ai pothuaj shpërthen me vrull. Çdo herë që hidhet në të një grup (që është caktuar për të hyrë në të), ruajtësi i tij do të pyesë: ‘A nuk erdhi tek ju këshillues?’ Ata do të thonë: ‘Po, sigurisht! Vërtet që një këshillues na erdhi neve, por ne e përgënjeshtroam atë dhe thamë: ‘Allahu as që ka zbritur gjë (shpallje të Tij), veçse ju jeni në gabim të madh.’ Dhe do të thonë: ‘Veç sikur të kishim dëgjuar ose të kishim menduar, ne nuk do të kishim qenë mes banorëve të zjarrit flakërues!’ Pastaj ata do të dëshmojnë mëkatën e tyre. Kështu pra, larg prej banorëve të zjarrit flakërues!” El Mulk: 8-11.

“O ju bashkësi e xhindëve dhe e njerëzve! A nuk erdhën te ju të dërguar nga mesi juaj duke ju shpallur Vargjet e Mia dhe duke ju paralajmëruar për takimin në këtë Ditë tuajën?” Ata do të thonë: **“Ne dëshmojmë përkundër vetvetes sonë.”** Ishte pikërisht jeta e kësaj bote që i gënjeu ata, dhe vetë ata do të dëshmojnë kundër vetvetes, se me të vërtetë kanë qenë mosbesimtarë.” En Aam: 130.

Argumente të tilla ka shumë në Kur’an. Njëpërmjet tyre Allahu i Lartësuar lajmëron se ndëshkon vetëm atë që i ka ardhur i dërguari dhe i ka arritur argumenti. Pra ai që do të ndëshkohet është gjynahqari që e pohon gjynahun e tij.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Ne nuk u bëmë padrejtësi atyre, por ata ishin të padrejtë.”** Ez-zuhruf: 76.

I padrejtë është ai që e ka njohur shpalljen që ka ardhur me të i dërguari, ose që ka pasur mundësi për ta njohur, por e ka kundërshtuar dhe është shmangur prej saj. Ndërsa për atë që nuk ka pasur asnjëfarë lajmi nga i dërguari dhe asnjëfarë mundësie për ta njohur, si mund të thuhet se është i padrejtë?

Parimi i dytë. Njeriu e meriton ndëshkimin për dy shkaqe:

- Mospërfillja e argumentit, shmangia prej tij, mosdëshirimi i tij dhe mospunimi me të, si dhe me atë që rrjedh prej tij.

- Refuzimi dhe përgënjeshtrimi i argumentit me kryeneçësi pasi i ka arritur, dhe mospasja dëshirë për të pranuar dhe për të praktikuar atë për të cilën tregon argumenti.

I pari është kufër shmangieje (mospërfillje e së vërtetës dhe indiferencë ndaj saj) dhe i dyti është kufër kryeneçësie. Ndërsa atë që e bën kufrin për shkak të paditurisë (xhehlit), pasi nuk i ka arritur argumenti dhe nuk ka pasur mundësi për ta njohur atë, Allahu nuk e ndëshkon derisa t’i arrijë argumenti.

Parimi i tretë. Informimi i njerëzve rreth argumentit fetar ndryshon sipas kohërave, vendeve dhe personave. Ndoshta mund t’u arrijë kafirëve argumenti i Allahut në një kohë të caktuar dhe jo në një kohë tjetër, mund t’u arrijë në një vend dhe jo në një vend tjetër, sikur që mund t’i arrijë një personi dhe jo një tjetri, ose për shkak të mospasjes së mendjes dhe aftësisë për të dalluar gjërat, siç është puna e të vegjëlve dhe të çmendurve, ose për shkak të moskuptimit, si puna e atij që nuk e kupton bisedën dhe nuk ka përkthyes për t’ia përkthyer. Ky është në rangun e shurdhit, i cili nuk dëgjon asgjë dhe nuk ka mundësi për të kuptuar. Në ditën e gjykimit ai do të jetë njëri prej katër kategorive të njerëzve që do të japin arsye para Allahut, siç përmendet në hadithin e el Esved, ebi Hurejres etj.

Parim i katërt. Allahu vepron sipas urtësisë së Tij, gjë të cilën ai nuk e thyen (cënon). Njëpërmjet veprave të Tij, Ai ka për qëllim synimet dhe përfundimet e tyre të lavdishme. Ky parim është themeli mbi të cilin bazohet diskutimi rreth këtyre kategorive dhe krahas tij, është edhe marrja e gjykimeve dhe vendimeve rreth tyre nga tekstet e Kur’anit dhe Sunetit, e jo nga mendimet e njerëzve dhe arsyetimet e tyre.¹²⁶

Pengesat e tekfirit¹²⁷

Pengesa e parë. Padituria

Ibnu Tejmije ka thënë: “Për këtë parim tregon hadithi i ebi Hurejres, të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ‘Një burrë, i cili nuk kishte punuar kurrë mirësi, u tha bijve të tij (kur i erdhi vdekja): ‘Kur të vdes, më digjni dhe pastaj gjysmën e hirit (mbetjes së trupit të djegur) ma hidhni në tokë dhe gjysmën në det, se vall-llahi, nëse Allahu do të ketë fuqi të më ringjallë, (pasi të më digjni dhe të përhapni thërmijat e hirit në det dhe në tokë), do të më ndëshkojë me një ndëshkim me të cilin nuk ka ndëshkuar asnjë njeri më parë.’ Kur ai vdiq, fëmijët e zbatuan porosinë e tij. Atëherë Allahu e urdhëron tokën dhe detin që të grumbullojnë atë

) Marrë nga “Tarikul hixhretejni” me pak shkurtime.¹²⁶

¹²⁷) Siç kemi sqaruar, ndoshta një person i caktuar prej muslimanëve, mund të thotë ose të veprojë atë që është kufër, por ka diçka që e pengon cilësimin e tij kafir. Kështu që në këtë kapitull do të flitet për pengesat e tekfirit, ndërsa në kapitullin e kaluar është folur për principet dhe kushtet e tekfirit.

që ishte hedhur në to. Kështu që u mblodhën mbetjet e tij dhe ai u formësua përsëri dhe u ringjall. Pastaj Allahu i tha: ‘Pse e bëre këtë?’ Tha: ‘Nga frika që kisha prej Teje o Zot, dhe Ti e di.’ Allahu ia fali gjynahet.’

Ky njeri mendoi se Allahu nuk do të kishte fuqi ta ringjallte, nëse do të përhapej trupi i tij në këtë mënyrë në det dhe në tokë. Pra ai mendoi që Allahu nuk do ta kthente në jetë nëse do të shpërbëhej trupi i tij pas vdekjes. Çdonjëra prej të dyjave, si mohimi i fuqisë së Allahut, po ashtu dhe mohimi i ringjalljes së trupave, edhe nëse shpërndahen në atë mënyrë, është kufër. Por ai krahas besimit në Allahun, në urdhërin e Tij dhe frikën që kishte prej Tij, nuk i dinte këto gjëra, si rrjedhojë gaboi dhe devijoi në mendimin e tij, dhe kështu Allahu ia fali këto. Hadithi tregon qartë që personi synonte të mos e ringjallte Allahu nëse do të vepronte kështu. Më së pakti, kjo gjë tregon se ai dyshonte tek ringjallja. Ky dyshim është kufër, dhe nëse njeriu këmbëngul në të pasi i përcillet argumenti, cilësohet ‘kafir’.”

Në një vend tjetër ibnu Tejmija ka thënë: “Ky njeri dyshoi dhe nuk e dinte faktin që Allahu ka fuqi për ringjalljen e birit të Ademit, pasi të digjet dhe të përhapen grimcat e tij. Ai nuk e dinte se Allahu e kthen të vdekurin në jetë dhe e tubon me krijesat e tjera, qoftë edhe kur bëhet siç ndodhi me të. Këtu kemi të bëjmë me dy parime të madhërishtme: I pari ka të bëjë me Allahun, d.m. th. me besimin se Allahu ka fuqi për çdo gjë.

I dyti ka të bëjë me besimin në Ahiret, d.m. th. me besimin që Allahu e ringjall këtë të vdekur dhe e shpërblen për punët e tij. Megjithëkëtë, ai në përgjithësi besonte në Allahun dhe po ashtu, në përgjithësi besonte në botën e përtejme ¹²⁸, d.m.th. besonte që Allahu shpërblen dhe ndëshkon pas vdekjes. Nga ana tjetër ai veproi një punë të mirë, e cila është frika që kishte prej Allahut. Për të gjitha këto, Allahu ia fali gjynahet, pra për shkak të besimit që kishte në Allahun, në botën e përtejme (në përgjithësi) dhe për punën e mirë që veproi.”

Hadithet që dëshmojnë se muslimani që bie në shirk ose kufër nga padituria, justifikohet përderisa nuk i është përcjellë argumenti fetar dhe nuk është mirinformuar, janë të shumta. Njëri prej tyre është hadithi i Muadhit, i cili kur erdhi nga Shami i bëri sexhde Profetit (salallahu alejhi ue selem), e megjithatë, për arsye se nuk e dinte, nuk u cilësua “kafir”. Në lidhje me këtë hadith Sheukani ka thënë: “Ky hadith vlen si argument për të provuar se ai që nga padituria i bën sexhde dikujt tjetër përveç Allahut, nuk është kafir.”

¹²⁸) Bëj krahasimin mes kësaj që ka përmendur ibnu Tejmija këtu, dhe shënimit që e kemi bërë në faqen... për të mësuar vërtetësinë dhe vlefshmërinë e sqarimit që kemi bërë atje.

Por duhet të dimë që sexhdeja dhe përulja para një personi, nuk tregon detyrimisht për adhurimin ndaj tij. Ajo mund të bëhet për adhurim ose për përshëndetje dhe respektim, siç ka ndodhur me Muadhin në hadithin e lartpërmendur.¹²⁹ Ndryshe është puna kur ndonjëri i bie në sexhde idhullit. Në këtë rast nuk mund të jetë veçse shirk në adhurim. Sidoqoftë, hadithi i Muadhit është argument për justifikimin e të paditurit, sepse në këtë temë nuk ka ndryshim mes gjërave që kanë të bëjnë me besimin, adhurimin dhe Akiden, dhe gjërave që kanë të bëjnë me rregullat dhe çështjet praktike të Fikhut, siç do ta sqarojmë.

Prej argumenteve është edhe hadithi i ebi Uakidi el Lejthi, i cili sqaron se gjatë marshimit për në Hynejn, disa muslimanë të rinj të cilët nuk i njihnin disa detaje të Teuhidit, i kërkuan Profetit (salallahu alejhi ue selem) të caktonte për ta një pemë, për të qëndruar pranë saj dhe për të lidhur në të armët e tyre duke pasur për qëllim kërkimin e bereqetit, ashtu siç vepronin edhe mushrikët. Megjithëse kërkesa e tyre ishte shirk, sikur që bëhet e qartë nga fjalët që ua tha Profeti (salallahu alejhi ue selem), ata u justifikuan për shkak të paditurisë dhe nuk u bënë kafirë. Në lidhje me këtë hadith, Muhamed ibnu Abdul Vehab ka thënë: “Nuk ka asnjë kundërshtim se ata që i ndaloi Profeti (salallahu alejhi ue selem), sikur të mos bindeshin dhe të varnin armët në pemë duke synuar bereqetin e saj, do të bënë kufër (do të dilnin nga feja). Kjo është ajo që duhej ta sqaronim. Por ngjarja tregon se muslimani, madje edhe dietari, mund të bjerë në disa lloje shirku duke mos e ditur. Kështu që ajo tregon se është detyrë e domosdoshme të mësosh dhe të ruhesh. Gjithashtu ajo dëshmon se muslimani që përpiqet për ta qëlluar të vërtetën, kur shpreh diçka që është kufër duke mos e ditur se është e tillë dhe pasi i tërhiqet vëmendja për këtë gjë pendohet menjëherë, ai nuk bën kufër (nuk del nga feja), siç bënë beni israilët dhe ata që pyetën Profetin (salallahu alejhi ue selem).”

Disa studiues janë të mendimit se kërkesa e sahabëve është një lloj përngjasimi me kafirët, dhe si e tillë nuk është shirk i madh. Për t’u kthyer përgjigje në mënyrë të përmbledhur do të thonim se sikur kërkesa e tyre të ishte thjesht për përngjasim, nuk do të ishte betuar Profeti (salallahu alejhi ue selem) që ata thanë sikur që i thanë benu israilët Musës: **‘Bëj për ne një idhull sikur që ata kanë idhuj.’** Kjo faktori se kërkesa e tyre ishte përngjasim i plotë me kafirët. Ajo që ata kërkonin, përfshihet në llojin e adhurimit të idhujve përveç

¹²⁹) Shiko për më gjerë në lidhje me këtë “Mexhmuul fetva” (1/372). Hadithin e Muadhit e transmeton ibnu Maxhe dhe ai është i mirë, siç thotë Albani. Hadithin e ebi Uakidit e transmeton imam Ahmedi dhe ai është i saktë, siç thotë Tirmidhiu.

Allahut. Duhet të marrim parasysh edhe faktin që ata ishin muslimanë të rinj, kështu që nuk ishte e çuditshme të kërkonin diçka që ishte shirk. Sikur të ishte ajo që u konstatua prej tyre thjesht një përngjasim dhe jo shirk, Profeti (salallahu alejhi ue selem) nuk do të çuditej prej kërkesës së tyre, sepse kjo gjë mund të konstatohej edhe prej atyre që e kishin pranuar Islamin më herët. Pastaj edhe sikur ta konsideronim kërkesën e tyre shirk të vogël, siç shpjeguem për hadithin e kaluar, ai është argument për justifikimin me anë të paditurisë, sepse në këtë aspekt, nuk ka ndryshim mes shirkut të madh dhe të voglit. Nga argumentet që tregojnë për këtë, është edhe hadithi që e transmeton nëna e besimtarëve Aishja se Profeti i Allahut (salallahu alejhi ue selem) dërgoi ebu Xhehm ibn Hudhejfe për të mledhur zekatin prej atyre që e kishin obligim. Një burrë e kundërshtoi dhe u grind me të për çështjen e dhënies së zekatit dhe për këtë arsye ebu Xhehmi e goditi, gjë e cila i shkaktoi çarje dhe plagë në kokë. Njerëzit e personit të goditur erdhën tek Profeti (salallahu alejhi ue selem) dhe i thanë: “Duam të marrim hak, o i Dërguar i Allahut!” Profeti (salallahu alejhi ue selem) u tha: “Do t’ju jap një dëmshpërblim, në mënyrë që të mos kërkonti të çani në kokë goditësin për të marrë hak.” Por ata nuk u kënaqën. Profeti (salallahu alejhi ue selem) u tha përsëri duke ua shtuar shumën: “Do t’ju jap kaq dhe kaq.” Atëherë ata u kënaqën dhe Profeti (salallahu alejhi ue selem) u tha: “Pasdreke unë do të diskutoj para njerëzve dhe do t’i lajmëroj që ju jeni të kënaqur.” Ata thanë: “Po, thuaju.” Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ligjëroi para njerëzve dhe tha: “Vërtet fisi i Lejthit erdhën dhe më kërkuan të merrnin hak. Unë ua shpagova me kaq dhe kaq dhe ata u kënaqën.” Pastaj iu drejtua atyre, para njerëzve, dhe u tha: “A u kënaqët?” Thanë: “Jo!” Muhaxhirët tentuan t’i ndëshkonin ose t’i kërcënonin, por i Dërguari i Allahut i urdhëroi të mos u bënë gjë, prandaj ata u përmbajtën. Pastaj i Dërguari i Allahut i thirri, ua shtoi më shumë vlerën e dëmshpërblimit dhe u tha: “A jeni të kënaqur?” Thanë: “Po.” Atëherë u tha: “Unë do të ligjëroj para njerëzve dhe do t’i lajmëroj që ju jeni të kënaqur.” Thanë: “Po, lajmëroji.” Profeti (salallahu alejhi ue selem) ligjëroi para njerëzve, pastaj iu drejtua atyre e u tha: “A u kënaqët?” Thanë: “Po.”¹³⁰

Në lidhje me këtë hadith ibnu Hazmi ka thënë: “Ky hadith dëshmon për justifikimin e të paditurit dhe për atë se ai nuk del nga Islami, nëse bën diçka, të cilën nëse do ta vepronte një i ditur që i ka arritur argumenti, do të cilësohej ‘kafir’. Kjo sepse njerëzit e fisit Lejth e përgënjeshtroan Pejgamberin (salallahu alejhi ue selem). Përgënjeshtrimi i tij është kufër, pa kundërshtim, por për

¹³⁰) Hadithin e transmeton imam Ahmed, ebu Davudi e të tjerë.

shkak se ishin të paditur, beduinë, u justifikuan me anë të paditurisë dhe nuk u bënë kafirë.”

Këto ishin disa argumente në lidhje me këtë çështje. Ka edhe shumë argumente të tjera, të cilat nuk po i përmendim, duke synuar që materiali të jetë sa më i përmbledhur.

Para se ta mbyllim këtë çështje, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen për disa gjëra të rëndësishme, sepse qartësimi i tyre ndihmon për ta kuptuar më mirë atë:

- E para, shprehja e dy shehadeteve është e mjaftueshme për të gjykuar që njeriu është bërë musliman.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Prej normave të fesë së të Dërguarit tonë, të cilat detyrimisht janë të njohura, dhe për të cilat është pajtuar i gjithë Umeti, është se parimi i Islamit dhe gjëja e parë që urdhërohen për të krijesat është dëshmia që nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe që Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) është i Dërguari i Allahut. Nëpërmjet kësaj gjëje, kafiri bëhet musliman,¹³¹ armiku bëhet mik i dashur, dhe kur gjaku dhe pasuria e dikujt janë të lejuara, pas shprehjes së shehadetit prej tij, ato bëhen të pacënueshme”

Ibnu Rexhepi ka thënë: “Është detyrimisht e njohur, se çdo njeriu që i vinte Profetit (salallahu alejhi ue selem) për të hyrë në Islam, ai e pranonte si musliman dhe e konsideronte gjakun e tij të mbrojtur, vetëm nëpërmjet shprehjes së dy dëshmimeve. Prandaj Profeti (salallahu alejhi ue selem) e dënoi veprimin e Usametui ibnu Zejd, i cili vrau atë që tha ‘La il-lahe il-All-llah’ pasi Usamja i kishte ngritur shpatën mbi kokë.”

Thëniet e lartpërmendura të dijetarëve tregojnë se thjesht shprehja e dy dëshmimeve është e mjaftueshme për të gjykuar që njeriu është bërë musliman. Ky gjykim vazhdon të jetë i vlefshëm, përderisa nuk bën diçka që i kundërshton ato, pasi që i ka arritur argumenti. Kjo për sa i përket rregullave të dynjasë, ndërsa për sa i përket Ahiretit, njeriu nuk mund të shpëtojë thjesht duke shprehur shehadetin, por vetëm nëse ka përmbushur kushtet e tij.

Është e rëndësishme të njohim dallimin mes evidentimit të përkatësisë islame fillimisht, dhe më pas qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së saj. Për të dalluar që një person është bërë musliman, mjafton pohimi i përgjithshëm.

¹³¹) Duhet të dimë që shprehja e dy dëshmimeve nuk është forma e vetme për të pohuar e përqaftuar fenë islame, por ngaqë në të shumtën e rasteve, ai që pranon fenë islame shpreh dy dëshmitë, dijetarët i përmendin e i theksojnë në sqarimet e tyre. Profeti ka pranuar prej atyre që përqaftonin Islamin edhe forma të tjera, si për shembull, shprehjen “eslemtu lil-lahi” (iu nënshtrova Allahut, u bëra musliman), siç përmendet në hadithin e el Mikdad ibnil Esved, të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi në sahihat e tyre.

Ndërsa qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e këtij gjykimi, është e kushtëzuar nga moskundërshtimi me diçka që e asgjëson besimin.

- E dyta, ndarja e çështjeve të fesë në parime për të cilat nuk justifikohesh me anë të paditurisë, dhe degëzime (çështje Fikhu praktike) për të cilat justifikohesh me anë të paditurisë, është gabim.¹³² Madje është bidat i shpikur nga “ehlul kalam” (skolastikët).

Ibnu Tejmija ka thënë: “Asnjëri nga selefët dhe prijësit e dijes nuk ka bërë ndryshim mes parimeve dhe degëzimeve (çështjeve praktike). Madje ndarja e fesë në dy pjesë, në parime dhe në degëzime, nuk ka qenë diçka e njohur tek sahabet dhe tabiinët. Asnjëri prej tyre dhe prej selefëve nuk ka thënë që muxhtehidi¹³³, i cili jep të gjithë mundin e tij për të kërkuar të vërtetën, është gjynahqar nëse nuk e qëllon atë, qoftë në parime apo në degëzime. Ky ndryshim mes parimeve dhe degëzimeve është shfaqur nga ‘muëtezilet’ dhe e kanë futur në librat e ‘usulu Fikhut’ ata që e kanë marrë prej tyre.” (“Mexhmuul fetaua” 13/125)

- E treta, në rastin e transmetimit të thënieve dhe mendimeve të dijetarëve në lidhje me këtë çështje, duhet të bëjmë ndryshimin ndërmjet teksteve të përgjithshme (absolute) dhe teksteve të kufizuara. Kjo sepse nëse shprehja është e përgjithshme ajo ka të bëjë me tekfirin në përgjithsi, si p.sh. “Kush i kërkon ndihmë dikujt tjetër përveç Allahut është kafir, mushrik”. Ky tekst është i përgjithshëm dhe nuk përcaktohet në të ndonjë person i caktuar. Siç e kemi sqaruar, ka ndryshim mes “tekfirit të përgjithshëm” dhe “tekfirit të veçantë”. Prandaj duhet të kemi parasysh se thënia e dijetarit, e cila përmban “tekfir të përgjithshëm”, nuk do të thotë se ai nuk e justifikon personin e veçantë që bie në shirk ose kufër nga padituria.

- E katërta, justifikimi me anë të paditurisë nuk përfshin ata njerëz që bien në gjëra të cilat përbëjnë zhvlerësim dhe mohim të përgjithshëm të parimeve të Islamit.

¹³²) Duhet të kemi parasysh se dijetarët që e kanë hedhur poshtë këtë ndarje, kanë pasur për qëllim refuzimin e praktikave dhe rregullave që janë bazuar mbi të, si cilësimin “kafir” të atij që gabon në parime dhe justifikimin e gabimtarit në degëzime, si dhe nënvleftësimi i disa çështjeve të rëndësishme që janë prej kushteve të fesë, të cilat si rrjedhojë e kësaj ndarjeje janë konsideruar prej degëzimeve. Prandaj, pas rishikimit të principeve për dallimin mes parimeve dhe degëzimeve, dhe sqarimit të saktë të rregullave që lidhen me çdonjërin prej tyre, nuk ka ndonjë pengesë që të bëhet një ndarje e tillë. Ibnu Tejmija ka thënë: “E vërteta është që çështjet madhore, qofshin të njohurive apo të praktikës, konsiderohen parime, kurse çështjet e hollësishme e të vogla, konsiderohen degëzime. Kështu që njohja e pesë shtyllave të fesë dhe besimi që janë të ndaluara haramet e qarta e ‘mutevatire’, është si puna e njohjes që Allahu është i Fuqishëm mbi çdo gjë, që e di çdo gjë, që është Gjithëdhëgues e Gjithëshikues, që Kur’ani është fjalë e Allahut, e të tjera çështje të qarta ‘mutevatire’. Prandaj ai që mohon rregullat praktike, për të cilët është pajtuar i gjithë Umeti, bën kufër, njëlloj sikur që bën kufër ai që i mohon këto njohuri që përmendëm.”

¹³³) Është ai që bën “ixhtihad”, d.m.th.dijetari që ka përmbushur kushtet për të dhënë fetua.

- E pesta, justifikimi me anë të paditurisë përfshin edhe bërjen ose thënien e asaj që është shirk. Ibnu Tejmija ka thënë: “Ne, pas njohjes së asaj me të cilën ka ardhur i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), mësojmë detyrimisht se Pejgamberi nuk ia ka lejuar Umetit të tij që t’i lutet të vdekurve, profetëve, njerëzve të mirë dhe as dikujt tjetër, qoftë duke përdorur shprehjen e ‘istigathës’ (kërkimit të shpëtimit), të ‘istiadhes’ (kërkimit të mbrojtjes), apo ndonjë shprehje tjetër. Po ashtu nuk ia ka lejuar Umetit të tij të bëjë sexhde për të vdekurin ose për të gjallin e të tjera si këto. Përkundrazi, ne e dimë që Profeti i ka ndaluar këto gjëra dhe e dimë që ato janë shirk, të cilin e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem). Por për shkak të dominimit të injorancës dhe dijes së pakët në lidhje me gjurmët e profecisë tek shumë nga njerëzit dhe gjeneratat e mëvonëshme, nuk është e mundur t’i cilësojmë këta të fundit ‘kafirë’ për shkak të këtyre gjërave, derisa t’u bëhet e qartë ajo që ka sjellë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), dhe ajo që nuk e ka sjellë dhe nuk është prej fesë së tij.” (“Erred-du alel bekrij-j” 376)

- E gjashta, ndoshta ndonjërit mund t’i përcillet argumenti në lidhje me një çështje dhe ai e kupton domethënien e tij, por e interpreton dhe i jep një kuptim tjetër, për shkak të një mëdyshjeje (dileme) të konsiderueshme që ka hasur. Faktikisht, nga interpretimi që ka bërë, ai e ka refuzuar argumentin, por për shkak të mëdyshjes së konsiderueshme që i ka lindur, nuk cilësohet “kafir”.

Kështu që muslimani justifikohet kur e interpreton argumentin, megjithëse i ka arritur dhe e ka kuptuar, nëse ka hasur në një mëdyshje të konsiderueshme.

Më gjerë do të sqarojmë në pengesën e tekfirit që vijon.

Pengesa e dytë. Interpretimi

Ibnu Tejmija ka thënë: “Tekfiri është prej ‘ueidit’. Kur dikush thotë diçka që është përgënjeshtër i asaj që e ka thënë i Dërguari, nuk cilësohet ‘kafir’ me këtë përgënjeshtër, derisa t’i arrijë argumenti (të informohet mirë rreth asaj çështjeje me argument), sepse mund të jetë i ri në Islam, ose mund të jetë rritur në një zonë të largët. Ndoshta njeriu mund të mos i ketë dëgjuar ato argumente, ose i ka dëgjuar dhe nuk i vlerëson të sakta sipas mendimit të tij, ose sipas tij i ka kundërshtuar një argument tjetër më i fortë, i cili e obligon interpretimin e tyre. Ai në këto mendime është gabimtar, por ato vlejné për ta justifikuar. Unë gjithmonë kam përmendur hadithin që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, për atë personin që tha: ‘Kur unë të vdes, më digjni, më thërmoni dhe pastaj më hidhni në det, se betohem në Allahun, në qoftë se Allahu do të ketë fuqi të më

ringjallë, do të më ndëshkojë me një ndëshkim me të cilin nuk ka ndëshkuar asnjë njeri më parë.’ Vepruan me të ashtu siç i porositi. Allahu i tha: (pasi e ringjalli) ‘Çfarë të shtyu që ta bëje këtë?’ Tha: ‘Frika nga Ti.’ Allahu i lartësuar e fali. Ky burrë dyshoi në fuqinë e Allahut dhe në ringjalljen e Tij pasi të thërmohej dhe të hidhej në det. Madje besoi se nuk do të ringjallej. Kjo është kufër tek të gjithë muslimanët unanimit, por ai ishte i paditur dhe ishte besimtar. Ai kishte frikë se Allahu do ta ndëshkonte, ndaj Allahu e fali. Interpretuesi, prej atyre që kanë kapacitet për të bërë ixhtihad dhe është i interesuar për ndjekjen e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), ka më tepër përparësi që të falet se sa personi që u përmend më lart.”

Gjithashtu ai ka thënë: “Po kështu tekfiri është e drejtë e Allahut. Nuk cilësohet ‘kafir’ veçse ai që e ka cilësuar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Gjithashtu çështja e gjyqimit ndaj një personi të caktuar se është ‘kafir’, dhe lejimi i vrasjes së tij, varet nga arritja e argumentit fetar (dijes), të cilin kush e kundërshton bëhet ‘kafir’. Ndryshe, nuk bëhet çdonjëri që nuk di diçka të fesë, ‘kafir’. Prandaj kur një grup prej sahabëve dhe tabiinëve, si Kudametu ibnu Medhunë dhe shokët e tij, e lejuan pirjen e alkoolit pasi menduan se i lejohet atij që punon punë të mira, bazuar në perceptimin e gabuar të ajetit të sures ‘Maide’¹³⁴, të gjithë dijetarët e sahabëve si Umeri, Aliu dhe të tjerë, u pajtuan me mendimin që t’u kërkohej të pendoheshin. Pastaj, nëse do të këmbëngulnin në lejimin e pirjes së alkoolit, bëheshin ‘kafirë’, dhe nëse do të pohonin që kishin pirë alkool, do të goditeshin sipas masës ndëshkuese që parashikon Sheriati. Pra, nuk i bënë ‘kafirë’ që në fillim se e quajtën të lejuar pirjen e alkoolit, për shkak të mëdyshjes (dilemës) që kishin hasur, derisa t’u qartësohej e vërteta.” (“Err-rred-du alel bekrij-ji” 258)

Ibnu Tejmija ka thënë: “Ndërsa për sa i përket tekfirit, e vërteta është se ai që përpiqet nga Umeti i Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) për të vërtetën dhe e synon atë, por gabon, nuk bëhet ‘kafir’, madje i falet gabimi.

Ai që i sqarohet ajo që ka ardhur me të i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dhe ndjek një rrugë të ndryshme nga ajo e besimtarëve, është ‘kafir’. Ai që ndjek epshin e tij, neglizhon në kërkimin e së vërtetës dhe flet pa dije, është gjynahqar dhe mund të cilësohet ‘fasik’ (mekatar i madh). Mundet që të mirat e tij të jenë më të shumta se të këqijat e tij, pra tekfiri ndryshon sipas ndryshimit të gjendjes së personit. Nuk është çdo gabimtar, as çdo bidatçi, as çdo i paditur dhe as çdo i humbur ‘kafir’, madje as ‘fasik’ dhe as gjynahqar.”

¹³⁴) Bëhet fjalë për ajetin 93 të sures “El Maide”.

Po ashtu ka thënë: “Kështu është edhe puna e thënieve të cilat nëse dikush i thotë, bën kufër. Ndoshta atij që i thotë, nuk i kanë arritur argumentet që ia mundësojnë të njohë të vërtetën, ose ndoshta i kanë arritur, por sipas tij, nuk janë evidente e të sakta, nuk i është dhënë mundësia për t’i kuptuar, ose ndoshta has në dilema për të cilat Allahu ia pranon arsyen dhe e justifikon. Allahu ia fal gjynahun besimtarit që është përpjekur për të njohur të vërtetën dhe nuk e ka qëlluar, cilido qoftë ai.”

Interpretimi për të cilin një person justifikohet dhe interpretimi për të cilin nuk justifikohet

Jo çdo interpretim i argumenteve të Sheriatit, është justifikues për atë që e bën dhe nëpërmjet tij refuzon realitetet e Sheriatit.

Për të bërë dallimin mes interpretimit, për shkakun e të cilit personi justifikohet dhe atij për të cilin nuk justifikohet, duhet t’i ndajmë interpretimet e konstatuara nga grupet dhe individët e ndryshëm në tri pjesë dhe të mësojmë qëndrimin e dijetarëve të Umetit ndaj çdonjëres prej tyre.

- E para, janë ato çështje për të cilat nuk ka mosmarrëveshje mes dijetarëve për sa i përket justifikimit të interpretuesit të tyre. Këto interpretime bazohen në mëdyshje, të cilat nga pikëpamja shkencore dhe gjuhësore janë të arsyeshme, d.m.th. ka një farë lidhjeje gjuhësore mes argumentit dhe interpretimit që i kanë bërë. Nuk ka dyshim se interpretimet e tyre janë të gabuara, por meqenëse i kanë bërë si rrjedhojë e mëdyshjeve të konsiderueshme¹³⁵ që u kanë lindur, justifikohen. Ndër shembujt e këtyre interpretimeve janë disa interpretime të esh’arijve, mu’tezilëve, murxhieve e të tjerëve si puna e tyre, të cilët bazohen në mëdyshjet (dilema) e marra nga disa tekste.

- E dyta, interpretimet për të cilat personi nuk justifikohet, pa kundërshtim mes dijetarëve, si puna e interpretimeve të batinijve,¹³⁶ filozofëve e të tjerëve

¹³⁵) Këto mëdyshje janë të konsiderueshme duke marrë parasysh pikëpamjet e tyre, sepse në të vërtetë ato janë të papranueshme e të pasakta.

¹³⁶) Sektet “batinij” dhe grupet e tyre, janë ata që e fshehin kufrin dhe armiqësinë e tyre ndaj Islamit dhe muslimanëve. Ata ua shfaqin realitetin e besimit të tyre vetëm atyre që i konsiderojnë të besueshëm, veçanërisht kur janë ndërmjet muslimanëve dhe muslimanët kanë pushtet. Kufri dhe armiqësia e tyre shfaqet dhe evidentohet nëpërmjet interpretimeve të tyre, me të cilat synojnë të shembin parimet e fesë islame dhe nëpërmjet ndihmës që ua japin kafirëve për të ngadhënjyer mbi muslimanët. Faktikisht, grupet e batinijve i kanë inspiruar kafirët për të shpërbërë unitetin e Umetit islam dhe për të kurdisur kurthe kundër tij. Prej grupeve të batinijve dhe llagapeve të tyre mund të përmendim këtu: el karamita, el ismailij-jeh, en-nusejrijeh, el alevijeh, bektashijtë, kadjanitë etj. Batinijtë janë kafirë. Kufri i tyre është më i madh se sa kufri i çifutëve dhe kristianëve, me pajtimin dhe unanimitetin e të gjithë muslimanëve. Nuk lejohet këmbimi i martesës me ta, nuk lejohen mishrat e therur prej tyre, nuk varrosen në varrezat e muslimanëve, nuk u falet xhenazja, nuk lejohet që të shërbejnë në llogoret e

prej atyre që e kanë tepruar dhe kanë kaluar në ekstreme. Kufri i tyre është i qartë. Ata e bëjnë interpretimin për t'u maskuar me të.

- E treta, janë çështjet, gjykimi ndaj interpretimit të të cilave vërtitet ndërmjet dy pjesëve të kaluara, pra midis llojit të parë dhe të dytë, kështu që dijetarët kanë mendime dhe pikpamje të ndryshme në lidhje me justifikimin e interpretuesit të tyre.

Do ta mbyllim temën e interpretimit me një sqarim mjaft të mirë që Abdurr-Rahman es-Sa'di i bën qëndrimit të "ehli sunetit" ndaj grupeve të bidatçinjve dhe atyre që justifikohen ose jo prej tyre. Ai ka thënë: "Ehli suneti dhe xhemati gjejnë ndaj bidatçinjve në mënyrë të drejtë, bazuar në parime dhe rregulla fetare. Ata gjejnë drejt, janë të paanshëm dhe nuk bëjnë 'kafirë' prej tyre, veçse atë që e ka bërë të tillë Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem). Ata besojnë se vendimi dhe gjykimi për kufër dhe besim është prej të drejtave më të mëdha të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Bidatçiu që mohon atë që ka sjellë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ose një pjesë të saj, pa pasur ndonjë interpretim, është 'kafir', sepse ai ka përgënjeshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe e ka refuzuar të vërtetën me mendjemadhësi e kryeneçësi.

Çdo bidatçi prej xhehmijve, kaderijve, havarixhëve, rafidijve e të tjerëve si puna e tyre, që e njeh se bidati i tij bie në kundërshtim me atë që ka ardhur në Kur'an dhe Sunet, dhe pastaj këmbëngul në bidatin e tij dhe e përkrah atë, ka bërë kufër, e ka mohuar Allahun e Madhërishëm dhe i është kundërvënë Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem), pasi i është qartësuar udhëzimi.

Ndërsa bidatçiu që i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem) në aparençë dhe me zemër, e madhëron Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe e pranon e i përmbahet asaj që ka sjellë i

muslimanëve ose në kështjellat e tyre dhe nuk lejohet të jenë pjesë përbërëse e ushtrisë së muslimanëve. Gjikimi "kafirë" ndaj batinijve është detyrë, sepse ideja e tyre vërtitet rreth pikave që vijojnë: 1) Mohimit të krijuesit. 2) Zhvlerësimit dhe mohimit të Sheriatit. 3) Përgënjeshttrimi të lajmeve që kanë ardhur rreth së fshehtës. 4) Mohimit të profecisë dhe bërjes së saj të pavlefshme. për sa i përket asaj pas së cilës fshihen dhe maskohen batinijtë, ata ndahet në dy pjesë: Batinijtë e shiitëve dhe batinijtë e sufive. Batinijtë e sufive janë ata që besojnë në panteizëm (unifikimin e Zotit me krijesat, në kuptimin që ekzistenca e gjithë është Zoti) dhe shkrirjen e Zotit në disa prej krijesave të tij. Në këtë rrymë sufiste përfshihen edhe ata që besojnë se njeriu mund të arrijë në një gradë që mos të jetë më i obliguar. Ata i interpretojnë argumentet në një mënyrë krejtësisht të ndryshme nga domethënia e tyre dhe pretendojnë që zotërojnë dijen e fshehtë dhe dijen reale, e cila u mungon të tjerëve, deri edhe vetë profetëve. Kufri i panteistëve sufistë është më i keq se sa kufri i çifutëve dhe i kristianëve. Batinijtë e shiitë ve janë të ndarë në shumë grupe e fraksione si p.sh.: Ismailijtë, Nusejritë, Bektashijtë etj. Kufri, devijimi, armiqësia dhe hipokrizia e tyre, pak a shumë vërtitet rreth pikave që i përmendëm më lart. Siç e sqaruam, të gjithë këta janë kafirë dhe kufri i tyre është më i keq se sa kufri i çifutëve dhe i kristianëve.

Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), por e kundërshton të vërtetën dhe gabon në disa mendime si dhe në interpretimin e tij, pa e mohuar udhëzimin që i është qartësuar, ai nuk është ‘kafir’. Një person i tillë është gjynahqar dhe bidatçi, bidatçi i humbur, ose i tillë që i falet gabimi për shkak se kishte të bënte me një çështje të paqartë e të panjohur, dhe për shkak se ka bërë përpjekje të madhe për kërkimin e së vërtetës të cilën nuk e arriti. Prandaj havarixhët, mu’tezilët, kaderijtë e të tjerë prej bidatçinjve, ndahen në lloje të ndryshme. Ka prej tyre kafirë pa asnjë dyshim, si p. sh. ekstremistët e xhehmijve,¹³⁷ të cilët mohuan emrat dhe cilësitë e Allahut pasi e dinin që bidati i tyre e kundërshton atë që ka sjellë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem). Këta e kanë përgënjeshtuar të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem) duke e ditur një gjë të tillë.

Ka prej tyre që janë bidatçinj, të humbur e gjynahqarë si puna e ‘havarixhëve interpretues’, dhe ‘mu’tezilijve interpretues’, të cilët nuk e kanë përgënjeshtuar të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem), por bidati i tyre i ka çuar në humbje, ndërkohë që ata mendonin se ishin në të vërtetën.

Sahabët kanë qenë të pajtuar në lidhje me gjykimin ndaj bidatit të havarixhëve dhe devijimit të tyre nga e vërteta, siç është përmendur në hadithe të sakta. Gjithashtu kanë qenë të pajtuar për mosdaljen e tyre nga Islami, megjithëse i bënë të lejuar gjakrat e muslimanëve, e mohuan ndërmjetësinë (shefatin) për mëkatarët e mëdhenj, dhe mohuan shumë parime fetare. Interpretimi që bënë, e pengoi cilësimin e tyre ‘kafirë’.

Ka prej bidatçinjve që janë më poshtë se këta, si shumë kaderij, kulabij dhe esh’arij. Këta janë bidatçinj dhe të humbur në parimet përmes të cilave kundërshtuan Kur’anin dhe Sunetin. Këto parime që ata i kundërshtuan janë të njohura. Ata janë renditur në disa rangje, sipas largësisë dhe afërsisë së bidateve të tyre me të vërtetën; sipas padrejtësisë, tiranisë dhe agresionit të tyre ndaj ‘ehli sunetit’ duke i cilësuar ‘kafirë’, gjynahqarë, të shthurur dhe bidatçinj; dhe sipas mundësisë së tyre për të arritur të vërtetën dhe përpjekjes për ta qëlluar atë, ose pamundësisë për ta bërë këtë gjë.”

Pengesa e tretë. Imitimi

¹³⁷) Xhehmijtë ekstremistë janë kafirë, ky është gjykim i përgjithshëm ndaj tyre. Ndërsa për sa i përket individëve të caktuar, ka prej tyre kafirë dhe ka që nuk janë të tillë. Kjo varet nga informimi rreth argumentit fetar ose jo, nga përpjekja që kanë bërë për të qëlluar të vërtetën dhe interpretimi që kanë bërë, ose nga refuzimi dhe përgënjeshtrimi ose jo i hakut.

Imitimi është pranimiti dhe ndjekja e thënieve dhe mendimeve të dijetarëve pa pasur argument. Ky imitim mund të jetë i lejuar ose i palejuar.

Duke sqaruar imitimin që lejohet dhe atë që nuk lejohet, Muhamed em in esh-Shenkiti thotë: “E vërteta që rezulton nga studimi dhe sqarimi i kësaj çështjeje është se imitimi ndahet në të lejuar, të ndaluar dhe në të tillë imitim, me anën e të cilit brezat e mëvonshëm të muslimanëve kanë kundërshtuar metodën e sahabëve dhe të tjerëve nga tri gjeneratat më të mira.

- Imitimi i lejuar, të cilin pothuajse nuk e kundërshton asnjë musliman, është imitimi që i bën i padituri (individit i thjeshtë i masës së muslimanëve) një dijetari të aftë për të dhënë fetva, në një ngjarje që i ka ndodhur. Ky lloj imitimi ishte i përhapur në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem). Në lidhje me të nuk ka mosmarrëveshje. Në atë kohë i padituri pyeste cilin të dëshironte prej shokëve të Profetit (salallahu alejhi ue selem), për të marrë gjykimin e ngjarjes që i kishte ndodhur apo çështjes që kishte hasur. Sahabi i jepte fetva dhe ai punonte me fetvanë e tij. Kur i ndodhte diçka tjetër, nuk ishte i lidhur me atë që i dha fetva fillimisht, por pyeste për të kë të dëshironte prej shokëve të të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe pastaj punonte me fetvanë e tij.

- Imitimi i ndaluar i cili nuk lejohet, pa kundërshtim mes dijetarëve, është imitimi që bën ‘muxhtehidi’¹³⁸ ndaj një ‘muxhtehidi’ tjetër, në rastin kur çdonjëri ka arritur në saj të ‘ixhtihadit’ në një përfundim të ndryshëm, lidhur me gjykimin e të njëjtës çështjeje. Dëshmi për këtë është ‘ixhmai’ (unanimiteti) i dijetarëve, të cilët kanë thënë: ‘Kur muxhtehidi arrin në një përfundim lidhur me gjykimin e një çështjeje, nuk i lejohet të imitojë një tjetër që e kundërshton në këtë mendim.’

- Ndërsa lloji i imitimit (taklidit) përmes të cilit të mëvonshmit kanë kundërshtuar rrugën e sahabëve dhe të muslimanëve të tre shekujve të parë, për të cilët është dëshmuar se janë më të mirët, është imitimi i një personi të caktuar dhe mosimitimi i asnjë dijetari tjetër përveç tij. Për këtë lloj imitimi nuk ka ardhur asnjë argument në Librin e Allahut dhe në Sunet. Asnjëri nga sahabet e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) dhe të tre shekujve që është dëshmuar se janë më të mirët, nuk e ka mbështetur dhe nuk ka pasur një ide të tillë. Ai bie në kundërshtim me thëniet e katër imamëve, Allahu i mëshiroftë. Asnjëri prej tyre nuk ka thënë se duhet të ngurtësohesh dhe të ndjekësh me fanatizëm mendimin

¹³⁸) Muxhtehidi është dijetari që ka përmbushur kushtet për të dhënë fetva. Ixhtihadi është përpjekja dhe munda që e jep muxhtehidi për t'i dhënë gjykimin e drejtë një ngjarjeje, ndodhie apo çështjeje.

apo thënieën e një personi të caktuar, dhe të mos ndjekësh asnjë tjetër veç tij nga dijetarët e muslimanëve.

Imitimi (në mënyrë të verbër, me fanatizëm) i një dijetari të caktuar, është prej bidateve të shekullit të katërt. Kushdo që pretendon ndryshe, le të na tregojë qoftë edhe një person të caktuar prej tre shekujve të parë, i cili i është përmbajtur medhhebit të një personi të caktuar. Nuk do të ketë mundësi ta gjejë një të tillë, sepse kjo nuk ka ekzistuar fare në atë kohë.” (“Edvaul bejan”)

Disa dijetarë që kanë ardhur pas gjeneratave të para, nuk e kanë lejuar imitimin në parimet e fesë dhe e kanë lejuar në degët e saj. Ata janë të mendimit se të gjithë njerëzit, pa përjashtim, e kanë detyrë të studiojnë, të meditojnë dhe të pajisen me argumente rreth parimeve të fesë. Nëse do të supozohej se ndarja e fesë në parime dhe degëzime është e saktë, atëherë imitimi duhej të ishte i lejuar edhe në parime, sepse njerëzit janë të obliguar për të dyja, si për parimet ashtu edhe për degëzimet. Nga kjo rezulton se mendimi i tyre nuk është i saktë. Për këtë tregon edhe fakti që ndryshimi mes parimeve dhe degëzimeve, i cili është baza mbi të cilën kanë mbështetur mendimin e tyre, është i pa saktë. Gjatë diskutimit rreth pengesës së paditurisë, kemi sqaruar që ndarja mes parimeve dhe degëzimeve është e pavërtetë.

Si përfundim, imitimi i lejohet të paditurit (njeriut të thjeshtë të masës së muslimanëve), i cili nuk ka mundësi të studiojë, të meditojë dhe të pajiset me argumente, ashtu siç i lejohet një gjë e tillë edhe në rregullat e Fikhut, pasi nuk ka ndryshim. Ndërsa atij që ka mundësi të pajiset me argumente, nuk i lejohet të imitojë as në çështjet e Akides dhe as në rregullat e Fikhut, për shkak të argumenteve të transmetuara, të cilat e dënojnë imitimin dhe i kritikojnë imituesit. Por megjithëkëtë, vëzhgimi, studimi, meditimi dhe pajisja me argumente, nuk është kusht për saktësinë e besimit.

Deri këtu kemi sqaruar se nuk ka ndryshim mes çështjeve të Akides dhe të Fikhut (rregullave praktike) për sa i përket lejimit të imitimit, për atë që është i paaftë të pajiset me argumente. Në vijim do të sqarojmë se imitimi është një ndër pengesat e tekfirit të atij që bie në kufër.

Nga studimi dhe meditimi mbi thëniet e dijetarëve, rezulton se justifikimi dhe shfajësimi i imituesit, përfshihet në llojin e justifikimit me anë të paditurisë dhe interpretimit. Kjo duke e konsideruar imituesin të paditur e të tillë që nuk e kupton argumentin. Përderisa justifikohet ai që bie në kufër për shkak të interpretimit, megjithëse ka dije dhe aftësi për të bërë “ixhtihad”, justifikimi i të paditurve që e imitojnë është edhe më i arsyeshëm.

Ibnu Tejmija ka thënë: “Të parët e asaj kohe (qeverisësit) besonin dhe shprehnin besimin e xhehmijve që ‘Kur’ani është i krijuar’, që ‘Allahu nuk shikohet në Ahiret’ e të tjera, i ftonin njerëzit për të përqaftuar këto besime, i sprovonin e i ndëshkonin nëse nuk u përgjigjeshin dhe i bënë ‘kafirë’, aq sa kur e kapnin robin, nuk e linin të lirë derisa të pohonte besimin e tyre. Githashtu nuk ngarkonin me punë e përgjegjësi dhe nuk i caktonin pjesë nga ‘bejtulmal’ (arka e pasurisë) veçse atij që pranonte thëniet e tyre.

Megjithëkëto, imam Ahmedi ka kërkuar falje dhe mëshirë për ta, ngaqë e dinte se atyre nuk ua kishin sqaruar se ishin duke përgënjeshtuar të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem). Ata nuk kishin për qëllim të mohonin atë që ka ardhur nëpërmjet të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), por interpretuan dhe si rrjedhojë gabuan, ose imituan ata që ua thanë këto gjëra.” (“Mexhmuul fetaua”, 23/349)

Ibnul Kajim, gjatë sqarimit të kategorive dhe llojeve të bidatçinjve ka thënë: “Ndërsa bidatçinjte që pajtohen me muslimanët, por që i kundërshtojnë në disa parime, si puna e rafidijve, kaderijve, xhehmijve, ekstremistëve të murxhieve e të tjerë, ndahen në disa grupe (pjesë, kategori).

- Të paditurit, të cilët imitojnë pa njohuri dhe pa argument. Këta nuk cilësohen ‘kafirë’ dhe as gjynahqarë dhe nuk refuzohet dëshmia e tyre, përderisa nuk kanë pasur mundësi për të mësuar udhëzimin. Këta kanë të njëjtin gjykim me të dobëtit, burrat, gratë dhe fëmijë të cilët nuk mund të gjejnë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugën e tyre. Për këta ka shpresë se Allahu do t’i falë.

- Ata që kanë mundësi të pyesin, të kërkojnë udhëzimin dhe të njohin të vërtetën, por këtë gjë e lenë, duke u preokupuar me punët e dynjasë, karrierës, kënaqësisë, jetës etj. Këta janë neglizhentë, e meritojnë të ndëshkohen dhe konsiderohen mëkatarë, sepse e kanë lënë pas dore devotshmërinë që e kanë pasur detyrë sipas mundësisë. Gjykimi i këtyre njerëzve është i njëjtë me gjykimin e atyre që i lenë disa detyra. Nëse bidati dhe epshi i tyre dominon mbi Sunetin dhe udhëzimin, refuzohet dëshmia e tyre, ndërsa nëse dominon pasimi i Sunetit dhe udhëzimi që kanë, u pranohet dëshmia.

- Ata që pyesin, e kërkojnë të vërtetën, qartësohen rreth saj dhe pastaj e lenë, për shkak të imitimit dhe pasimit me fanatizëm, ose për shkak të urrejtjes që kanë ndaj atyre që pasojnë të vërtetën. Për njerëz të tillë, shkalla më e ulët është të cilësohen gjynahqarë, të prishur e të shthurur, ndërsa cilësimi i tyre ‘kafirë’, është objekt ‘ixhtihadi’ dhe shkoqitjeje.” (“Et-turukul hukmijetu”)

Pengesa e katërt. Gabimi

Gabim do të thotë që personi të ketë për qëllim diçka, dhe të bëjë ose të thotë diçka tjetër që nuk e ka pasur për qëllim. Shkurtimisht, është ajo vepër që nuk bëhet qëllimisht.

Më poshtë po rendisim argumentet që dëshmojnë për justifikimin e atij që thotë ose bën diçka gabimisht:

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“I thirrni ata (fëmijët e adoptuar me emrat) e baballarëve të tyre, kjo është më e drejtë tek Allahu. Por nëse nuk i njihni baballarët e tyre, i thirrni ata vëllezër të një besimi dhe Mevalikum (robët tuaj të liruar), dhe nuk përbën gjynah për ju në lidhje me gabimin e bërë për këtë çështje, por ajo që vlen është qëllimi i zemrave tuja. Dhe Allahu është vazhdimisht Falës i Madh, kurdoherë Mëshirëplotë.” El Ahzab: 5.

Ibnu Haxher ka thënë: “Dijetarët kanë rënë të gjithë dakort që ajeti është i përgjithshëm për heqjen e gjynahut të atij që e bën gabimisht.”

“Allahu nuk e rëndon askënd mbi mundësitë që ai ka. Secili merr shpërblim për atë (të mirë) që ka fituar dhe (po kështu) secili merr dënimin për atë (të keqe) që ka fituar. Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime. Zoti ynë! Mos na ngarko me barrë të rëndë siç i ngarkove ata para nesh (çifutët dhe kristianët). Zoti ynë! Mos na ngarko me barrë më të rëndë se sa kemi mundësi për të (që ta mbajmë). Na fal ne, na liro nga gjynahet, dhe ki mëshirë për ne. Ti je Meula (Zoti, Mbrojtësi, Ruajtësi) ynë, pra, na ndihmo dhe na jep fitore përmbi popullin kafir (mohues, mosbesimtar).” El Bekareh: 286.

Në hadith të saktë është transmetuar se Allahu i është përgjigjur kësaj lutjeje dhe ka thënë: **“E kam bërë”** (d.m.th. e kam pranuar lutjen tuaj, kështu që nuk ju ndëshkoj në qoftë se harroni ose gaboni).

Prej argumenteve është edhe hadithi i njohur, për justifikimin e atij që bën diçka gabimisht: “Vërtet Allahu ia ka hequr Umetit tim gjynahun e asaj që e bën gabimisht, nga harresa dhe të asaj që detyrohet me forcë për ta bërë.” Transmeton ibn Maxhe dhe hadithi është i saktë.

Ai që përpiqet dhe jep mundin e tij për të qëlluar të vërtetën, nuk merr gjynahe nëse gabon, qoftë në çështjet e Akides apo në çështjet e Fikhut. Faktikisht justifikimi i atij që gabon në çështjet e Akides apo në çështjet e Fikhut, është si puna e justifikimit të të paditurit dhe interpretuesit.

Ndarja e çështjeve të fesë në parime për të cilat nuk justifikohet i padituri, dhe në degëzime për të cilat i padituri justifikohet, nuk është e saktë. Kjo nuk është e bazuar në ndonjë argument dhe nuk është e njohur nga të parët tanë. Justifikimi me anë të gabimit përfshihet në llojin e justifikimit me anë të paditurisë, prandaj të parët tanë kanë sqaruar se dijetari “muxhtehid”, i cili gabon si rrjedhojë e “ixhtihadit” që bën, nuk merr gjynah, as në parime dhe as në degëzime.

Ibnu Tejmije ka sqaruar bindjen e të parëve dhe dijetarëve si ebu Hanife, Shafii, eth-Theur etj. dhe ka thënë: “Ata nuk e konsiderojnë gjynahqar dijetarin që bën ‘ixhtihad’ dhe si pasojë gabon, as në çështjet parimore dhe as në ato praktike, siç ka transmetuar prej tyre ibnu Hazmi e të tjerë. Prandaj ebu Hanife, Shafiu e të tjerë, e pranuan (në çështjet gjyqësore) dëshminë e bidatçinjve përveç hatabijve. Ata gjykonin se namazi pas imamit bidatçi është i saktë. Sikur t’i konsideronin ‘kafirë’, nuk do ta pranonin dëshminë e tyre dhe nuk do të faleshin pas tyre, sepse kafirit nuk i pranohet dëshmia kundër muslimanëve dhe namazi pas tij nuk është i saktë. Ata janë bazuar në faktin që ky ka qenë qëndrimi i njohur i sahabëve, tabiinëve dhe dijetarëve të fesë. Asnjë ‘muxhtehid’ që gabon nuk e cilësojnë ‘kafir’, ‘fasik’ ose gjynahqar, qoftë në çështje teorike (dije, bindje, Akide) apo praktike. Sipas tyre, ndryshimi mes çështjeve që kanë të bëjnë me parimet dhe çështjet që kanë të bëjnë me degëzimet është prej thënieve të bidatçinjve, filozofëve ‘ehlul kelam’ si mu’tezilët e xhehmijtë dhe ata që kanë marrë rrugën e tyre.”

Ibnu Tejmije ka përmendur disa shembuj nga të parët e Umetit: “Shumë nga të parët tanë (selefë), kanë gabuar në mjaft çështje (akide) dhe megjithëkëtë kanë qenë të pajtuar për të mos cilësuar ndokënd ‘kafir’ për shkak të këtyre gjërave. P.sh. disa sahabë e kanë mohuar faktin që i vdekuri e dëgjon thirrjen e të gjallit;¹³⁹ disa e kanë mohuar faktin që mirazhi i Profetit (salallahu alejhi ue selem) është bërë në gjendje zgjimi (jo në ëndërr); disa e kanë mohuar që Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) e pa Zotin e tij dhe për disa të tjerë njihen thëniet e tyre të njohura në lidhje me ‘hilafetin’ dhe preferencat mes sahabëve. Disa prej tyre kanë thënë të njohura për sa i përket luftimit mes vetit, mallkimit të njëri-tjetrit dhe cilësimit ‘kafir’ të njëri-tjetrit. El kadi (gjykatësi) Shurejh, nuk e pranonte leximin e atij që lexonte ‘**bel axhibtu**’ (por u habita) dhe

¹³⁹) Të vdekurit nuk i dëgjojnë të gjallët, me përjashtim të rasteve të veçanta, si p.sh. kur largohen përcjellësit e xhenazes nga varri dhe i vdekuri dëgjon zhurmat e këpucëve të tyre. Ky është mendimi më i saktë në lidhje me këtë çështje. Sahabët që e kanë mohuar se i vdekuri dëgjon thirrjen dhe fjalët e të gjallit, kanë pasur të drejtë, përveç rasteve të veçanta. Ndërsa ata që e kanë pohuar, kanë pasur për qëllim pikërisht këto raste. Për më gjerë shiko “El ajatul bej-jinat fi ademi semail emvat”.

thoshte se ‘Allahu nuk habitet’, kështu që e lexonte ajetin e Kur’anit **‘bel axhibte’** (por ti Muhamed u habite). Pra ai ka mohuar një mënyrë të saktë leximi (kiraeti) dhe ka mohuar një cilësi për të cilën tregon Kur’ani dhe Suneti, e megjithëkëtë Umeti është i pajtuar për konsiderimin e tij si një nga prijësit e muslimanëve. Po kështu, disa selefë i mohuan disa shkroja të Kur’anit si p.sh. mohimin e fjalës së Allahut **‘Efelem jejesil-ledhine amenu’**. (Er-Rra’d: 31) Në lidhje me këtë kanë thënë që është **‘Evelem jetebejenil-ledhine amenu’**. Disa të tjerë e mohuan të ishte ajeti i Kur’anit **‘Ue kada rabbuke el-la taëbudu il-la ij-jahu’**, kështu që thane se ai është **‘ue uas-sa rab-buke...’**. Disa i hoqën dy suret e fundit të Kur’anit ‘Felek’ dhe ‘Nas’ nga Mus’hafi, dhe thanë se ato nuk bëjnë pjesë në Kur’an. Ky është një gabim, për të cilin dëshmon konsensusi (ixhmai) dhe transmetimi ‘mutevatir’,¹⁴⁰ por megjithëkëtë, meqë transmetimi i përcjellë tek ata në lidhje me këtë gjë, nuk ka qenë ‘mutevatir’, ata nuk bënë kufër (nuk dolën nga feja). Në lidhje me këto gjëra, nëse njeriu mohon pasi i arrin argumenti me transmetim ‘mutevatir’, bëhet kafir.” (“Mexhmuul fetaua”)

Si përfundim, justifikimi i atij që gabon përfshin çështje të Akides dhe çështjet praktike.

Ndoshta ndonjëri mund të pyesë: “Në qoftë se do të themi se ‘muxhtehidi’ që gabon në çështjet e Akides nuk është gjynahqar, a mund të themi se ai që gabon në çështjet e Akides merr një shpërblim, si puna e ‘muxhtehidit’ në rregullat dhe çështjet praktike?”

Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është se tekstet e transmetuara tregojnë për heqjen e gjynahut nga “muxhtehidi” që gabon, dhe nuk ka asnjë tregues në to për të faktuar se shpërblehet çdo “muxhtehid” i cili gabon, me përjashtim të fjalës së Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kur gjykon gjykatësi sipas ‘ixhtihadit’ të tij dhe e qëllon të vërtetën, ka dy shpërblime, ndërsa kur gjykon sipas ‘ixhtihadit’ të tij dhe gabon, ka një shpërblim.” Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Siç vihet re qartë nga konteksti i hadithit, ai bën fjalë veçanërisht për gjykatësin, dhe si puna e tij është edhe muftiu.

Në lidhje me këtë çështje ibnu Tejmije ka thënë: “Po kështu shpërblehet çdo njeri që bën një ibadet të ndaluar pa e ditur që është i tillë, përderisa puna e tij përfshihet në llojin e ibadeteve të ligjshme për të cilat jemi urdhëruar, si p.sh. ai që i ka arritur urdhëri i përgjithshëm për t’u falur dhe nuk i ka arritur ndalimi i faljes në kohë të caktuara dhe si rrjedhojë falet në to, ose ai që bazohet në një

¹⁴⁰) Transmetimi mutevatir është ai që përcillet nga një numër i madh transmetuesish në mënyrë të njëpasnjëshme dhe brez pas brezi, gjë nga e cila përfitohet bindja për saktësinë e një hadithi.

argument, megjithëse ka një tjetër më të fortë dhe më përparësor se ai. P.sh. disa selefë kanë falur dy rekate pas ikindisë, sepse Profeti (salallahu alejhi ue selem) i ka pas falur, ose p.sh. namazin, ligjshmëria e të cilit është transmetuar në një hadith të dobët ose të trilluar, si puna e namazit ‘tesbih’¹⁴¹ të cilin e ka falur Abdullah ibnul Mubarek, e të tjerë shembuj. Nëse këto ibadete përfshihen në tërësinë e preferencës (ligjshmërisë) së namazit dhe nuk u ka arritur argumenti i veçantë që i ndalon, ata shpërblehen për to...”

Ndryshe është gjykimi i punëve, lloji i të cilave nuk është i lejuar e i ligjshëm si p.sh. shirku. Për këto lloj punësh nuk ka shpërblim, megjithëse Allahu nuk i ndëshkon vepruesit e tyre veçse pas arritjes së argumentit, siç ka thënë Allahu në Kur’an:

“Kushdo që ecën drejt, ai ecën drejt për të mirën e vetes së vet dhe kushdo që ecën shtrembër, ai ecën shtrembër me humbje të vetes së vet. Asnjë i rënduar me barrë, nuk mund të mbajë barrën e një tjetri (secili mban barrën e vet) dhe Ne nuk ndëshkojmë përderisa të çojmë të Dërguar (për të udhëzuar e këshilluar)”. Isra: 15.

Por siç e sqaruam, edhe pse nuk ndëshkohen, ata nuk shpërblehen. Përfundimi i tyre do të jetë siç ka përmendur Allahu në Kur’an:

“Ne do t’i kthehemi çfarëdolloj pune që e bënë ata (mosbesimtarët) dhe do t’i bëjmë veprat e tilla si grimca pluhuri që fluturojnë në hava.” El Furkanë: 23.

Abdullah ibnul Mubarek ka thënë: “Këto janë punët që janë punuar për të tjerë përveç Allahut.”

Muxhahidi ka thënë: “Këto janë punët që nuk janë pranuar...”¹⁴²

Pengesa e pestë. Detyrimi me forcë

Shumica e dijetarëve ka thënë se detyrimi me forcë për të bërë diçka ndahet në dy lloje: detyrim i plotë dhe detyrim i pjesëshëm.

- Detyrimi i plotë është ai që e pëson vetë i detyruari, dhe si pasojë e këtij detyrimi atij nuk i mbetet më fuqi dhe vullnet, si p.sh. kur kërcënohet me vrasje ose për t’iu prerë njëra prej gjymtyrëve të tij, si dora ose këmba; kur kërcënohet me rrahje të rëndë që përfundon në shkatërrim ose kërcënohet për prishjen dhe shkatërrimin e krejt pasurisë së tij. Nëse mendon se mundësia më e madhe është

¹⁴¹) Shumë dijetarë mendojnë se namazi “tesbih” nuk është bidat. Hadithi i transmetuar në lidhje me këtë namaz, është i saktë sipas Ibnu Haxherit, Albanit e të tjerë.

¹⁴²) Për më gjerë në lidhje me këtë çështje shiko “Mexhmuul fetaua” (20/30-33).

që të pësojë atë me të cilën është kërcënuar, i lejohet ta bëjë atë që i kërkohet nëpërmjet kërcënimit, duke e konsideruar këtë rast domosdoshmëri fetare.

- Detyrimi i pjesshëm (jo i plotë), është kërcënimi për diçka që nuk sjell shkatërrim të njeriut ose të një gjymtyre të tij, por të diçkaje, dëmi i së cilës është më i vogël, si p.sh. kërcënimi për goditje, prangosje, burgosje ose shkatërrim të një pjese të pasurisë. Ky lloj detyrimi ia zhduk njeriut kënaqësinë e pëlqimit por nuk ia zhduk vullnetin, sepse nuk e ka të domosdoshme bërjen e asaj për të cilën është kërcënuar, për arsye se durimi ndaj saj është i mundshëm. Nuk ka dyshim se gjykimi ndaj këtij lloj detyrimi, ndryshon nga i pari.

A është i mjaftueshëm vetëm kërcënimi i thjeshtë për ndëshkim për t'u konsideruar personi i detyruar dhe i imponuar, edhe sikur të mos shoqërohet me ndonjë farë dhune fizike, apo patjetër duhet të shoqërohet kërcënimi me një farë dhune fizike, në mënyrë që të konsiderohet detyrim me forcë?

Ibnu Tejmija ka thënë: “Kam medituuar rreth mendimeve të ndryshme mbi këtë temë dhe kam konstatuar që detyrimi me forcë ndryshon sipas personit që detyrohet. Ajo që konsiderohet detyrim me forcë për të thënë fjalët e kufrit, nuk është e njëjtë me atë që konsiderohet detyrim në çështjet që kanë të bëjnë me dhuratat etj. Imam Ahmedi ka theksuar tekstualisht në disa vende që ‘detyrimi me forcë për kufër nuk merret në konsideratë, vetëm nëse shoqërohet me dhune fizike si goditje ose prangosje, ndërsa thjesht fjalët kërcënuese nuk janë detyrim me forcë’. Nga ana tjetër ai ka thënë që ‘sikur gruaja t’ia dhurojë mehrin e saj burrit në banesën e tij, ka të drejtë ta kthejë’. Kjo bazuar në faktin që ajo nuk ia jep mehrin, veçse kur frikësohet se mos e lëshon ose e keqtrajton dhe nuk sillet mirë me të. Pra në këtë rast, frikën nga shkurorëzimi dhe keqtrajtimi e ka konsideruar detyrim. Në një vend tjetër ka arsyetuar duke thënë: ‘Sepse ai e ka detyruar’.

Një frikë e tillë nuk mund të jetë detyrim për sa i përket kufrit. Prandaj kur frikësohet robi musliman që e kanë robëruar kafirët, se ata nuk do ta lënë të marrohet ose të bashkohet me gruan e tij, nuk i lejohet të thotë fjalët e kufrit.”

Vërehet qartë se ibnu Tejmije bën ndryshim ndërmjet detyrimit për kufër dhe ndërmjet detyrimit për gjëra të tjera. Ai që detyrohet me forcë (kërcënimi) për të bërë ose thënë atë që është kufër, nuk i lejohet një gjë e tillë, veçse pasi të ndëshkohet e të ushtrohet dhunë ndaj tij. Ndërsa në gjërat e tjera mjafton thjesht kërcënimi dhe frikësimi me fjalë.

Nga kjo që sqaruam dalim në përfundimin se kërcënimi konsiderohet detyrim me forcë, sidomos kur kërcënimi është për vrasje. Përrjashtohet nga ky përfundim detyrimi me forcë për të bërë kufër. Në të, nuk mjafton thjesht

kërcënimi i cili nuk shoqërohet me dhunë fizike, vetëm nëse ai që kërcënon për vrasje ka fuqi dhe aftësi të vrasë, dhe i kërcënuari mendon që mundësia më e madhe është që ta pësojë atë për të cilën kërcënohet.

Kushtet sipas të cilave detyrimi (dhunimi për kufër) konsiderohet justifikim

Nuk pranohet prej çdo njeriu që pretendon se është detyruar (dhunuar për të bërë kufër), justifikimi i tij. Patjetër duhet që të plotësohen disa kushte, në mënyrë që detyrimi të jetë i konsiderueshëm dhe influencues në thëniet, veprat ose lëniet (mospraktikimet) që konstatohen nga i obliguari me obligime fetare. Këto kushte janë siç vijon:

1) Detyruesi (dhunuesi) të jetë i aftë e i fuqishëm për të realizuar atë që kërcënon ta bëjë, sepse detyrimi (dhuna) nuk mund të realizohet veçse nëpërmjet fuqisë. Nëse nuk është i fuqishëm, detyrimi nuk ka kuptim dhe nuk merret në konsideratë.

2) I detyruari të mos ketë mundësi për të shmangur pasojën e kërcënimit, si p.sh. duke u arratisur, duke kërkuar ndihmë ose duke bërë rezistencë etj.

3) Të mendojë që mundësia më e madhe është pësimi i asaj për të cilën kërcënohet, nëse nuk do ta bëjë atë që i kërkohet nëpërmjet kërcënimit.

4) Të kërcënohet për diçka nga e cila dëmtohet shumë nëse do ta pësojë, si p.sh. vrasja, goditja e rëndë, prangosja dhe burgimi i gjatë. Ndërsa sharja, ofendimi dhe marrja e një sasive të vogël të pasurisë, nuk janë detyrim justifikues.

Argumenti që tregon se detyrimi kur i plotëson kushtet është justifikim, është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Ai që pas besimit të tij e mohon Allahun, me përjashtim të atij që detyrohet (dhunohet për të mohuar) e zemra e tij është e bindur plotësisht me besim, por fjala është për atë që ia hap gjoksin mosbesimit. Ata i ka kapur hidhërimi nga Allahu dhe ata kanë një dënim të madh.” Nahl: 106.

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është se mushrikët e morën Ammar ibnu Jasirin dhe filluan ta ndëshkonin e ta dhunonin dhe nuk hoqën dorë derisa bëri atë që kërkuan prej tij, e shau Muhamedin (salallahu alejhi ue selem) dhe i përmendi për mirë idhujt e tyre. Atëherë ata e lanë të lirë. Kur erdhi tek i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), ai i tha: “Çfarë të ka ndodhur?” Tha: “Diçka e keqe o i Dërguari i Allahut. Nuk më lanë të lirë derisa fola kundër teje (të përmenda për keq) dhe i përmenda idhujt e tyre për mirë.”

Profeti i tha: “Në ç’gjendje e ke zemrën?” Tha: “Të qetë dhe të bindur për besimin.” Profeti (salallahu alejhi ue selem) i tha: “Nëse do ta përsërisin, përsërite.”

Ibnu Haxher ka thënë: “Dijetarët janë pajtuar të gjithë që shkak i zbritjes së ajetit të Kur’anit: ‘...**me përjashtim të atij që detyrohet** (dhunohet për të mohuar) **dhe zemra e tij është e qetë, e bindur plotësisht për besimin...**’, ka qenë Ammari.”

Ibnul Batal dhe ibnul Mundhir kanë thënë: “Të gjithë dijetarët janë pajtuar se ai që detyrohet me dhunë e forcë për të bërë kufër, aq sa frikësohet se do ta vrasin, kështu që bën kufër (me gojë ose me vepër) ndërkohë që zemrën e ka të qetë e të bindur me besim, nuk gjykohet që është bërë kafir.”

Por duhet të dimë se megjithëse lejohet thënia ose veprimi i kufrit për shkak të detyrimit, durimi në raste të tilla dhe mosthënia e kufrit ose mosveprimi i tij, është më i mirë dhe ka shpërblim më të madh.

Ibnu Batal ka thënë: “Dijetarët janë pajtuar për atë se kush detyrohet për të bërë kufër dhe zgjedh të vritet për të mos e thënë apo vepruar atë, ka shpërblim më të madh tek Allahu se ai që zgjedh të veprojë sipas tolerimit të Sheriatit në raste të tilla.”

Ibnu Kethiri ka thënë: “Më e mira dhe më përparësorja është që muslimani të qëndrojë i paepur në fenë e tij, edhe sikur kjo rezistencë ta çojë në vdekje.”

Për epërsinë dhe përparësinë e rezistencës dhe vendosmërisë në raste të tilla, dijetarët kanë përmendur shumë argumente, prej të cilëve është edhe hadithi që e transmeton Habab ibnul Erett, ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ndodhte që në besimtarët e popujve të kaluar, të merrej burri, të bëhej për të një gropë në tokë dhe të vendosej në të. Pastaj merrej sharra, vendosej mbi kokën e tij dhe i ndahej trupi në dy gjysma. Po ashtu me krehër prej hekuri i ndahej mishi nga kocka, dhe të gjitha këto nuk e kthenin nga feja e tij.”

Kërkesa për durim dhe rezistencë është më e fortë dhe më e theksuar në të drejtën e personit të cilin e pason masa e njerëzve në veprimet dhe thëniet e tij. Sikur një i tillë të shprehte kufirin i detyruar, ndërkohë që ekziston mundësia që shumë njerëz të thjeshtë të mos e njohin realitetin e çështjes, d.m.th. të mos e dinë se po shfaq diçka të ndryshme nga ajo që beson me zemër, kjo gjë do të çonte në sprovë, konfuzion dhe ndoshta edhe në kufër. Madje në të drejtën e tij, thënia ose veprimi i kufrit duke qenë i detyruar, mund të jetë haram për shkak të shkatërrimit që shkakton nënshtrimi i tij ndaj asaj gjëje që i kërkohet nëpërmjet kërcënimit.

Në këtë kontekst vjen fjala e imam Ahmedit, i cili është pyetur se a i lejohet dijetarit të fshehë besimin dhe të shprehë kufrin duke u bërë lajka atyre që e detyrojnë, për të shpëtuar prej tyre. Ai ka thënë se: “Nëse do të përgjigjet dijetari kështu, ndërkohë që i padituri nuk di, kur do të sqarohet e vërteta?”

Si përfundim, këto ishin disa studime, fetva, thënie dhe sqarime në lidhje me rregullat e tekfirit. Nuk kemi synuar të përfshijmë çdo çështje dhe temë, si dhe detajet e sqarimet e hollësishme që lidhen me çështjen e tekfirit, sepse kjo do të bënte që materiali të ishte shumë i gjatë, gjë e cila të shmang nga objektivi ynë dhe kërkon shumë kohë e mund. Por kemi synuar që të sqarojmë qëndrimet dhe thëniet e dijetarëve të “ehli sunetit” që kanë të bëjnë me temën e tekfirit, në një mënyrë që i përshtatet masës së gjerë të muslimanëve të vendit tonë.

Besojmës se ky material është i mjaftueshëm për ta konceptuar drejt këtë temë dhe për të qenë të kujdesshëm kur gjykojmë ndaj të tjerëve. Në qoftë se janë të aftë (d.m.th. i njohin rregullat e tekfirit) për të dhënë gjykimin “kafir” ndaj një personi që pretendon se është musliman prej “ehlul kible”, u lejohet të gjykojnë. Ndryshe, nëse nuk kanë dije rreth rregullave të tekfirit, u mjafton që të cilësojnë veprën që është kufër ose shirk, siç e ka cilësuar Sheriati, dhe të cilësojnë në përgjithësi atë që bie në kufër ose shirk “kafir” ose “mushrik”. Ndërsa për sa i përket personave të veçantë prej “ehlul kible”, që bien në kufër apo shirk, meqenëse nuk kanë dije për të gjykuar ndaj tyre, duhet të pyesin të diturit ose të heshtin, siç e sqaruam më lart.

Kjo për sa u përket atyre që i përfshin termi i “ehlul kibles”, të cilët mund të justifikohen për shkak të paditurisë etj. ndërsa ata që nuk deklarohen muslimanë por ateistë, të pafë, besimtarë të feve të tjera, përqaftues të ideve filozofike që kundërshtojnë Islamin dhe të sekteve batinij, ose janë të tillë që nuk mund të justifikohen me anë të paditurisë, është detyrë të cilësohen “kafirë” pa hezitim dhe pa rezerva nga të gjithë muslimanët pa përjashtim.

Për të pasur një përfytyrim të plotë rreth kësaj teme është e nevojshme të njihen edhe shumë tema të tjera të cilat kanë të bëjnë me besimin, si dhe shumë të tjera që kanë të bëjnë me kufrin, llojet dhe shkaqet e tij. Ndoshta në të ardhmen do të na jepet mundësia, inshaAllahu, që të përpilojmë një material i cili i përfshin këto tema.

Për të qenë sa më realistë dhe korrektë në këtë temë të rëndësishme dhe delikate, jemi përpjekur që materiali, kryesisht të përbëhet nga fetvatë dhe studimet e dijetarëve.

Kreu 6. Kush është kafir dhe kush është bidatçi¹⁴³

Material i përkthyer nga një kasetë e Muhamed Nasirud-din el Albanit (rahimehullah)

Teksti i përkthyer i kasetës

Pyetësi - Shejhu ynë, më kanë obliguar të rinjtë e Emirateve të vij tek ju për t'ju drejtuar disa pyetje të cilat i bëjnë dobi Umetit inshaAllah. Çfarë gjykimi keni për ata të cilët thonë se “nuk themi ‘Allahu i mëshiroftë’ ata të cilët kanë kundërshtuar Akiden e selefëve, si p. sh. Neueuiu, ibn Haxher, ibn Hazmi, ibn el Xheuzi etj, ndërsa në këtë kohë Sejid Kutubi dhe Hasen el Benna, ndërkohë që ju e dini se ç’ka Benna në librin e tij “Mudhekirat ed-daueti ed-daijeh” dhe Sejid Kutubi në “Dhilalul Kur’an”?

Shejhu - Ne besojmë se mëshira, ose me shprehje më të saktë, duaja për mëshirë, është e lejuar për çdo musliman dhe e ndaluar ndaj çdo kafiri. Kjo përgjigje rrjedh nga besimi që mban vetë personi. Kështu që kush mendon se ata që u përmendën në pyetje e të tjerë si shembulli i tyre, janë muslimanë,

¹⁴³) Ky material është përkthyer nga kaseta me titull: “Kush është kafir dhe kush është bidatçi” e dijetarit të madh, muhadithit dhe imamit të “ehli sunetit” në këtë kohë, shejh Muhamed Nasirud-din el Albani (rahimehullah). U pa arsyeshme të përkthehej kjo kasetë, pasi në të shejhu ka trajtuar disa çështje të rëndësishme për Umetin në përgjithësi. Disa nga këto, si problemet e kohëve të fundit që kanë filluar të përhapen edhe në trojet shqiptare, kanë sjellë si pasojë preokupimin e nxënësve të dijes, thirrësve dhe një pjese të rinisë muslimane, me ato gjëra të cilat nuk u bëjnë dobi në dynja, përkundrazi, i dëmtojnë ata personalisht dhe punën e tyre, qoftë ajo individuale, apo kolektive dhe Allahu e di më së miri se çfarë do të gjejnë në botën tjetër. Një pjesë e tyre kanë harruar atë çka e kanë obligim dhe i janë kushtuar asaj çka është e ndaluar në fenë e Allahut, si p.sh. gibeti, thashethemet, mendimi i keq për vëllain musliman, paragjykimet, për të mos thënë se edhe shpifja zë një vënd të madh. Ajo që me të vërtetë është për të ardhur keq, është se këto gjëra shpeshherë bëhen në emër të fesë. Ata të cilët i kanë hyrë kësaj rruge të gabuar, i këshilloj që t’i kushtohen dijes së Kur’anit dhe Sunetit dhe të ruhen prej të devijuarve. Nëse shikojnë apo dëgjojnë prej vëllait të tyre ndonjë gabim, të sigurohen dhe më pas të këshillojnë dhe jo t’i përhapin këto gjëra nga të katër anët, sepse kjo nuk është rruga e saktë dhe do t’u sjellë dëm vetë atyre që i përhapin këto fitne (sprova) në dynja dhe në Ahiret, duke dëmtuar në këtë mënyrë thirrjen e saktë. E nëse me të vërtetë dëshirojnë hakun, atëherë le të lexojnë këtë material e të tjerë veç tij prej dijetarëve të mëdhenj në këtë kohë. Të mundohen të përfitojnë prej tij dhe të korigojnë ato gabime që kanë rënë në to. Këtë fjalë e drejtoj tek të gjithë muslimanët në trojet shqiptare, në veçanti tek rinia muslimane dhe në mënyrë më të veçantë tek nxënësit e dijes, brenda dhe jashtë këtyre trojeve, sepse mbi ta bie pesha dhe përgjegjësia më e madhe. Dhe së fundi lus Allahun e Madhëruar me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta, që të na udhëzojë në rrugën e drejtë dhe të na bashkojë zemrat dhe mendimet tek e vërteta. Menhexhi merret nga të tillë dijetarë dhe jo nga të vegjlit, siç transmetohet nga ibnu Abasi. (Sh. i përkthyesit të kasetës, Bilal Shkrepi)

atëhere përgjigjja është se lejohet të lutesh për ta për mëshirë dhe falje. Ndërsa kush mendon se muslimanët që u përmendën në pyetje nuk janë të tillë (muslimanë), atëherë nuk i lejohet të bëjë dua e të kërkojë mëshirë për ta. Sepse është e ndaluar të kërkojë mëshirë për kafirët. Kjo është përgjigjja e asaj që u përmend në pyetje.

Pyetësi - E qartë, por ata thonë se nuk ka qenë prej metodikës së selefëve që të luteshin për mëshirë ndaj bidatçinjve, dhe meqenëse i konsiderojnë të lartpërmendurit bidatçinj, nuk thonë “rahimehullah” (Allahu i mëshiroftë) për ta.

Shejhu - Ne thamë një fjalë. Duaja për mëshirë lejohet për muslimanin dhe nuk lejohet për kafirin, kjo fjalë a është e saktë apo jo?

Pyetësi - Po, është e saktë.

Shejhu - Nëse është e saktë atëhere pyetja e dytë nuk është e pranueshme, ndërsa nëse nuk është e saktë atëherë dialogimi është i pranueshëm. A nuk u falet xhenazja atyre për të cilët disa thonë se janë prej bidatçinjve, sikurse u falet xhenazja muslimanëve? Ndërkohë që prej bindjeve të selefëve të cilat i kanë trashëguar pasardhësit prej paraardhësve, është se falemi pas çdo të miri dhe të prishuri dhe ja falim xhenazen çdo të miri dhe të prishuri, ndërsa kafirit nuk i falet xhenazja. Kështu që a u falet xhenazja atyre për të cilët bënte fjalë pyetja e dytë apo jo? Nuk dua të futem në dialogim vetëm nëse do të detyrohem, prandaj nëse përgjigjja është se u falet xhenazja, atëhere kjo pyetje është pa vend, ose në të kundërt, diskutimi është i hapur dhe i pranueshëm.

Pyetësi - Dakord shejh, por si t’u përgjigjemi atyre që thonë se nuk u falet xhenazja sepse janë bidatçinj?

Shejhu - Cili është argumenti i tyre?

Pyetësi - Argumentohen me veprën e selefëve, p.sh. bëjnë dallim midis gjynahqarëve (fusakëve, të prishurve, të shthururve) dhe bidatçinjve të cilët kanë shpikur gjëra të reja në fe, sepse selefët nuk ua falnin xhenazen këtyre të fundit, as nuk uleshin me ta, as nuk u flisnin, as nuk hanin dhe as nuk pinin me ta, për këtë arsye e thonë këtë fjalë.

Shejhu - Ti përmende pretendimin e tyre dhe jo argumentin, ndërkohë që pretendimi nuk është argument. Prandaj edhe njëherë po ta përsëris pyetjen. Cili është argumenti i atij që thotë se nuk i falet xhenazja muslimanit bidatçi?

Pyetësi - Nuk kanë argument tjetër veç veprës së selefëve.

Shejhu - Vepra e selefëve, a është argument?!

Pyetësi - Kështu thonë.

Shejhu - Mirë, po ku ndodhet ky argument?

Pyetësi - Nuk përmendin vendndodhje dhe fjala e tyre gjithmonë është e përgjithshme.

Shejhu - Është e saktë që selefët i shkëpusnin marrëdhëniet me disa njerëz për shkak të ndonjë gjynahu apo bidati, por kjo mos vallë tregon se ata i bënë kafirë?

Pyetësi - Jo.

Shejhu - Atëherë i konsideruan muslimanë.

Pyetësi - Sigurisht.

Shejhu - Atëherë ne dalim në përfundimin se kemi dallim midis muslimanit dhe kafirit, s'kemi të mesme sikurse kanë mu'tezilët, gradë midis dy gradëve, kështu që njeriu s'mund të trajtohet edhe si musliman edhe si kafir. Fjala e tyre se selefët nuk ia falnin xhenazen shumicës së bidatçinjve apo krejt bidatçinjve është thjesht një pretendim i disa njerëzve të mire, të cilët i marrin çështjet me vrull dhe ndjenja, të pashoqëruara me dijen e saktë e cila është "ka thënë Allahu, ka thënë i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem)". Të përmenda një premisë paraprake për të cilën janë pajtuar që të gjithë se njeriu është musliman ose është kafir. Muslimanit, sidoqoftë gjendja e tij, i falet xhenazja, trashëgohet, trashëgon, lahet, qefinoset dhe varroset në varrezat e muslimanëve, e nëse nuk është musliman hidhet siç hidhen farat dhe varroset në varrezat e kafirëve. Nuk kemi diçka të mesme. Por nëse dikush prej dijetarëve nuk ia fal namazin e xhenazes dikujt prej muslimanëve, kjo nuk do të thotë se nuk lejohet t'i falet namazi i xhenazes, por do të thotë se ai ka për qëllim një urtësi e cila mbase nuk mund të realizohet vetëm se nëpërmjet tij, si shembulli i haditheve në të

cilat përmendet se Profeti (salallahu alejhi ue selem) u thoshte shokëve të tij: “Faljani xhenazen shokut tuaj”, dhe vetë nuk ia falte xhenazen. Kush është më i rëndësishëm, bojkotimi që i bëri Profeti (salallahu alejhi ue selem) faljes së namazit të xhenazes së një muslimani, apo bojkotimi që i bën asaj një dijetar?

Pyetësi - Lënia e Profetit (salallahu alejhi ue selem).

Shejhu – Bukur! Atëherë nëse lënia e Profetit (salallahu alejhi ue selem) nuk tregon se falja e saj është e ndaluar, në mënyrë parësore nuk tregon lënia e dijetarit se nuk lejohet falja e xhenazes së tij, por edhe nëse tregon se nuk i falet xhenazja, mos do të thotë kjo se nuk lutemi për të që ta mëshirojë Allahu dhe ta falë, përderisa ne besojmë se ai është musliman. Shkurtimisht, lënia e namazit të xhenazes ndaj disa muslimanëve nga ana e selefëve, për shkak të disa bidateve që kanë pasur, nuk mohon ligjërimin e namazit të xhenazes ndaj muslimanit që ka bidate, sepse kjo ka qenë qortim dhe edukim për të tjerët si shembulli i tyre, sikurse Profeti (salallahu alejhi ue selem) nuk ia fali xhenazen atij që vdiq pa e shlyer borxhin. Po ashtu edhe atij që vodhi prej ganimës (plaçkës së luftës) e të tjerë si shembulli tyre. Pra, lënia e namazit të xhenazes nga Profeti (salallahu alejhi ue selem), është më e rëndësishme se lënia e disa prej dijetarëve të parë, e megjithatë as e para dhe as e dyta nuk tregojnë se nuk lejohet falja e xhenazes së muslimanit bidatçi. Dhe pikërisht këtu kemi nevojë për një shtjellim. Duhet patjetër të dimë se kush është bidatçiu, ashtu sikurse duhet të dimë se kush është kafir. Këtu lind pyetja: A çdokush që bie në kufër bie kufri mbi të? (d.m.th. a bëhet kafir çdonjëri që thotë ose bën atë që është kufër), po kështu çdokush që bie në bidat, a bie bidati mbi të? Nëse përgjigjja është se nuk bie kufri dhe bidati mbi çdo person që bie në kufër apo bidat, atëherë vazhdojmë, e nëse është e pa kuptueshme, duhet patjetër që ta sqarojmë.

Po e përsëris çështjen duke e sqaruar disi. Çfarë është bidati?

Bidati është një gjë e re e cila e kundërshton rrugën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), nëpërmjet së cilës personi kërkon të afrohet sa më shumë te Allahu. Atëherë a është çdonjëri që shpik një bidat, bidatçi? Dëshiroj që ta dëgjoj përgjigjen shkurtimisht, jo ose po.

Pyetësi - Jo.

Shejhu - Atëherë kush është bidatçiu?

Pyetësi - Është ai, të cilit i qartësohet argumenti dhe më pas ngul këmbë në bidatin e tij.

Shejhu – Bukur! Atëherë atyre për të cilët po themi se janë bidatçinj, a u është qartësuar argumenti? Unë them “Allahu e di”, po ti çfarë thua?

Pyetësi - Edhe unë them sikurse thatë ju, shejh.

Shejhu - Allahu ta shpërbleftë me të mirë! Pra, origjina tek ata a është Islami apo kufri?

Pyetësi - Islami.

Shejhu - Mirë, atëherë origjina është të themi për ta “Allahu i mëshiroftë”, a nuk është kështu?

Pyetësi - Sigurisht.

Shejhu - Atëherë përfundoi procesi. Për këtë arsye nuk lejohet që të shpikim një mendim të ri dhe të themi se nuk lejohet të bëjmë lutje për mëshirë për filanin, filanin dhe filanin prej muslimanëve të thjeshtë, jo më të veçantët, e aq më tepër kur bëhet fjalë për dijetarët. Pse? Për dy shkaqe, dhe kjo është përmbledhja e gjithë asaj që folëm.

- Shkaku i parë është se ata janë muslimanë.

- Shkaku i dytë është se nuk e dimë a iu qartësua argumenti apo jo dhe a këmbëngulën më pas në bidatin dhe humbjen e tyre apo jo. Për këtë arsye unë them se këto janë prej gabimeve të rënda të kësaj kohe, të cilat i bëjnë disa djem që mendojnë se janë të kapur pas Kur’anit dhe Sunetit, por që në të vërtetë e kundërshtojnë Kur’anin dhe Sunetin pa e ditur dhe pa e ndjerë. Si rrjedhim më takon mua, bazuar në mendimin e tyre, që t’i quaj bidatçinj, sepse ata kanë kundërshtuar Kur’anin dhe Sunetin, por unë nuk e kundërshtoj besimin dhe parimin tim. Origjina tek ata është Islami. Ata nuk e bëjnë bidatin qëllimisht dhe nuk e refuzojnë argumentin, për këtë shkak themi se ata gabuan duke kërkuar të saktën. Nëse do ta kuptojmë këtë realitet, do të shpëtojmë nga shumë prej çështjeve të ndërlikuara në këtë kohë, siç janë ato të shkaktuara nga

xhemati “hixhreh dhe tekfir” të cilët kanë qenë në Egjipt. Ata përhapën disa prej mendimeve të tyre dhe vazhduan derisa arriti mendimi i tyre në Siri dhe më pas këtu në Jordani. Këtu kemi pasur disa vëllezër që kishin menhexh (metodë) selefij, të cilët u ndikuan nga ajo ide e kotë dhe e lanë namazin me xhemat, madje lanë edhe xhumatë. Faleshin në shtëpitë e tyre, derisa u ulëm së bashku dhe kryem tri bashkëbisedime.

Takimi i parë u bë midis akshamit e jacisë dhe nuk u falën pas nesh, pra pas nesh, selefive! Thoshin se “bazohemi tek librat e tu”, e megjithatë nuk falshejin pas meje. Arsyeja, sipas tyre, ishte se nuk i bënë kafirë ata muslimanë, të cilët këta persona i bënë kafirë. Kjo në takimin e parë, ndërsa i dyti që në shtëpinë e tyre dhe zgjati deri në gjysmën e natës. Por filluan shenjat e mira të shfaqen në përgjigjen e tyre rreth ftesës së vërtetë, sepse thirrëm ezanin, ikametin para mesit të natës dhe u falën pas nesh. Ky ishte takimi i dytë. Ndërsa takimi i tretë vazhdoi prej namazit të jacisë deri në atë të sabahut. Dhe që përfundimtari i këtyre çështjeve, ata vëllezër sot janë së bashku me ne dhe kanë kaluar nga ajo ditë afërsisht dymbëdhjet vjet, uel hamdulillah (falenderimi i takon Zotit). Nuk ishin vetëm se disa dyshime të cilat u erdhën nga moskuptimi i Kur’anit dhe Sunetit. Të kuptuarit e fesë sot nuk është diçka e lehtë, pasi kemi trashëguar ide të ndryshme dhe ekzistojnë grupacione të shumta, qoftë në Akide apo në Fikh. Kështu që nuk ka mundësi nxënësi fillestar të hyjë në thellësinë e këtyre çështjeve, vetëm pasi të ketë kaluar një kohë të gjatë, shumë të gjatë në studimin e asaj çka quhet sot “Fikhun mukaran” (Fikhun e krahasueshëm, i ballafaquar mes medh’hebeve). Po ashtu të ketë studiuar argumentet e kundërshtarëve, qoftë në baza apo degëzime. Dhe për realizimin e kësaj në praktikë, personi ka nevojë për një jetë të gjatë dhe sukses nga Zoti i botëve, që të realizojë atë çka thoshte i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) në hapjen e namazit të natës: “O Allah, më udhëzo në ato çka janë kundërshtuar, me të vërtetë Ti udhëzon në rrugën e drejtë atë që dëshiron.” Për këtë arsye, ne e këshillojmë rininë tonë sot, që të maten dhe të mos japin gjykime bazuar në përfytyrimet e tyre sipërfaqësore të disa argumenteve fetare, sepse nëse do t’iu përmbahen përfytyrimeve të tyre sipërfaqësore, dija e tyre vazhdimisht do të jetë e paqëndrueshme dhe e pabazuar.

Duhet të dish se medh'hebi më i afërt me Kur'anin dhe Sunetin është medh'hebi i "ehli hadithit". "Ehlul hadithi" e pranon transmetimin e bidatçinjve, nëse janë të sigurtë, të vërtetë dhe me kujtesë të fortë. Kështu që këta persona, nuk i kanë futur në grupin e kafirëve dhe as të atyre ndaj të cilëve nuk kërkojnë mëshirë për ta. Madje ka disa imamë (prijës në dije), për të cilët askush prej dijetarëve të vërtetë nuk dyshon se janë muslimanë, dhe jo vetëm kaq, por janë edhe prej dijetarëve të lartë, e megjithatë kanë rënë në gabime, të cilat kundërshtojnë Kur'anin, Sunnetin dhe selefët e ndershëm në shumë çështje. P.sh. imam Numan ibn Thabit ebu Hanife (rahimehullah), thotë se besimi nuk shtohet dhe as nuk pakësohet dhe thotë se "nuk i lejohet besimtarit që të thotë se 'unë jam besimtar inshaAllah', e nëse thotë 'inshaAllah' nuk është besimtar". Nuk ka dyshim se kjo fjalë është bidat në fe, sepse ka kundërshtuar Kur'anin dhe Sunetin, por ai nuk kishte për qëllim bidatin, ai kishte për qëllim hakun, por gaboi. Kështu që hapja e portës dyshimeve ndaj dijetarëve të muslimanëve, qofshin të hershëm apo të mëvonshëm, është në kundërshtim me rrugën e muslimanëve, ndërkohë që Zoti ynë thotë:

"Kush e kundërshton Profetin pasi i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër veç rrugës së besimtarëve, e lëmë atë në atë që ka zgjedhur e më pas e djegim në zjarrin e Xhehenemit, e sa përfundim i keq është ky."

Së fundi, dua të përmend një të vërtetë rreth së cilës nuk ka kundërshtim, por nuk mendon në të rinia jonë sot. Ky realitet është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): "Kush e bën kafir muslimanin ka bërë kufër." Në këtë realitet nuk ka dyshim dhe dihet sqarimi i këtij hadithi në disa trasmetime të tjera në të cilat Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka sqaruar se nëse është kafir ai që i jepet një gjykim i tillë, gjykuesi e ka qëlluar të vërtetën dhe nuk ka pasoja, ndryshe, nëse nuk është i tillë, atëhere kufri i kthehet gjykuesit,¹⁴⁴ sepse ia ka mveshur vëllait të tij (padrejtësisht).

Kjo pikë nuk ka nevojë për shumë shkoqitje sepse hadithi është i qartë, por ajo që dua të theksoj është se kush i thotë një muslimani "bidatçi" dhe ai nuk

) Që do të thotë se do të vuajë pasojën e akuzimit të vëllait të tij musliman padrejtësisht, sepse kufri i atij që ¹⁴⁴ cilëson muslimanin kafir padrejtësisht, është i vogël dhe jo i madh.

është i tillë, atëherë “bidatçi” është ai që e thotë. Ky është ai realitet për të cilin thashë më parë se të rinjtë tanë të cilët i bëjnë dijetarët bidatçinj, kanë rënë vetë në bidat, por ata nuk e dinë dhe as nuk e duan bidatin, madje ata e luftojnë atë. Shembulli i tyre është si ajo fjala e vjetër që thotë:

Sadi i çoi për të pirë devetë,

I mbështjellë me gunë.

Jo, more i gjori Sad,

S’çohen kështu devetë në lumë.

Për këtë arsye i këshillojmë të rinjtë tanë që të kapen pas Kur’anit dhe Sunetit, t’i praktikojnë brenda kufijve të dijes që kanë, të mos i tejkalojnë ato dhe të mos u pëlqejë vetja e të mendojnë se janë më të mëdhenj në dije se të tjerët, me të cilët nuk mund të krahasohen as në dije, as në perceptimin (Fikhun) e saj dhe as në devotshmëri, si p.sh. Neueuiu dhe ibn Haxher el Askalani. Nuk mund të gjesh si këta dy burra sot në botën islame. Lere Sejid Kutubin (në kuptimin që nuk ia vlen të përmendet e të krahasohet me ata që kaluan e të radhitet me ta në një pyetje), këtë burrë ne e vlerësojmë për xhihadin që ka bërë, por megjithatë nuk ka qenë më shumë se një shkrimtar, letrar. Ai nuk ka qenë dijetar, kështu që nuk është për t’u çuditur që të dalin prej tij gjëra të shumta të cilat nuk përputhen me rrugën e saktë. Por ata që u përmendën me të, Neueuiu dhe ibn Haxher el Askalani e të tjerë si shembulli i tyre, uallahi është padrejtësi që të thuhet për ta se janë prej bidatçinjve. Unë e di se ata janë prej esharijve, por ata nuk dëshironin që të kundërshtonin Kur’anin dhe Sunetin, por menduan dy gjëra që i trashëguan prej Akides esharijeh. E para, se imam ebul Hasen el Esharij e thotë një gjë të tillë, ndërkohë që ai këto fjalë i thoshte hershëm dhe më pas u kthye prej tyre, dhe e dyta, e menduan të saktë dhe ajo nuk ishte e saktë.

Pyetësi - Shejh, a është e vërtetë se selefët nuk gjykonin për dikë se është prej “ehli sunneh” vetëm pasi të karakterizohej me cilësitë e Sunetit, e nëse do të bënte ndonjë bidat apo do të lavdëronte dikë prej bidatçinjve, konsiderohej bidatçi, sikurse thoshin selefët: “Kush thotë se Allahu nuk është në qiell është xhehmij”?

Shejhu - Gjendet diçka e tillë, por mos harro çka të thashë më parë. Kjo nuk do të thotë se ai nuk është musliman, sikurse Profeti (salallahu alejhi ue selem) e la faljen e namazit të xhenazes ndaj atij që vdiq dhe kishte borxhe, ndaj atij që mori prej ganimes (plaçkës së luftës), apo atij që vrau. Këta njerëz Profeti (salallahu alejhi ue selem) nuk i konsideronte jomuslimanë. Kjo është mënyrë edukative, sikurse e përmendëm edhe më parë. Nga ana tjetër duhet të dimë se metoda e marrëdhënieve dhe qëndrimeve ndaj bidatçinjve bazohet në gjurmët e selefëve, të cilat janë të shumta, të njëpasnjëshme dhe mbështetëse e përforcuese të njëra-tjetrës. Nuk duhet të krijojmë metodikë apo qëndrim duke u bazuar në qëndrimin e një personi prej selefëve ¹⁴⁵ dhe kështu në këtë mënyrë të kundërshtojmë rrugën e njohur të tyre. Muslimani nuk del prej Islamit thjesht për faktin se ra në një gjynah apo bidat. Prandaj, nëse gjejmë diçka që e kundërshton këtë rregull, atëherë ajo interpretohet sipas asaj që e përmenda më parë, pra, ajo është mënyrë qortuese dhe edukative. Disa dijetarë të hadithit e lanë hadithin e imam Buhariut dhe nuk transmetuan prej tij, sepse ai ka thënë se “shprehja ime e Kur’anit është e krijuar”,¹⁴⁶ ndërkohë që Imam Ahmedi ka thënë se “kush thotë që ‘shprehja ime e Kur’anit është e krijuar’, është xhehmij”. Duke u bazuar tek fjala e imam Ahmedit, disa dijetarë më pas gjykan mbi Buhariun se nuk i merret hadithi, për arsye se tha fjalën e xhehmijve. Besimi i Buhariut ndryshon nga besimi i xhehmijve sepse ata nuk thonë vetëm “shprehja ime e Kur’anit është e krijuar”, por besojnë se Kur’ani nuk është fjala e Allahut, sipas tyre ai është krijesë prej krijesave të Allahut të Madhëruar. Atëherë si gjykohet ndaj Buhariut i cili tha se “shprehja ime e Kur’anit është e krijuar” dhe si interpretohet thënia e imam Ahmedit “kush thotë se ‘shprehja ime e Kur’anit është e krijuar’, është xhehmij”? Të dyja thëniet duhet t’i interpretojmë në mënyrë korrekte, e cila arrihet duke i interpretuar në përputhje me rregullat. Para se të vazhdoj, mendoj se ti e dallon ndryshim ndërmjet fjalës “Kur’ani është i krijuar” dhe fjalës “shprehja ime e Kur’anit është e krijuar”, apo jo?

) Sepse ai mund të ketë pasur arsye e rrethana të veçanta të cilat nuk vlejné për ne.¹⁴⁵

) Me këtë fjalë Buhariu nuk nënkuptonte që Kur’ani është i krijuar, siç e interpretuan disa njerëz, sepse ai besonte ¹⁴⁶ si gjithë selefët se Kur’ani është fjalë e Zotit e i pakrijuar, por kishte për qëllim që veprat, punët dhe lëvizjet e njerëzve janë të krijuara.

Pyetësi - Sigurisht.

Shejhu - Në rregull. Atëherë si t'i përgjigjemi fjalës së imam Ahmedit “kush thotë se ‘shprehja ime e Kur’anit është e krijuar’ është xhehmij”? Nuk ka përgjigje tjetër veçse të themi se ka dashur të paralajmërojë dhe t’u tërheqë vëmendjen muslimanëve ndaj kësaj fjale e cila mund të përdoret si mjet nga ana e bidatçinjve dhe të humburve, të cilët janë xhehmijet. Dikush mundet që ta thotë fjalën “shprehja ime e Kur’anit është e krijuar” për të futur në dyshime ata që ka përreth dhe të ketë për qëllim vetë Kur’anin. Por kjo nuk do të thotë se çdo musliman që e thotë këtë fjalë ka për qëllim po atë qëllim të keq që kishte i pari. Imam Buhari nuk ka nevojë që dikush t’i bëjë “tezkije” (lavdëratë), sepse Allahu i ka bërë “tezkije”, ngaqë e ka bërë librin e tij më të pranueshmin libër mbas Kur’anit tek shumica e muslimanëve, edhe pse vetë ata janë në mospërputhje me njëri-tjetrin. Imam Buhari kur tha “shprehja ime e Kur’anit është e krijuar” tha fjalë të saktë, ndërsa më herët imam Ahmedi, nga frika se ajo keqpërdorej, tha se kush thotë kështu është xhehmij. Atëherë kjo është mënyrë paralajmëruese dhe për të tërhequr vërejtjen dhe nuk është besim se çdokush që thotë kështu me të vërtetë është xhehmij, jo. Për këtë arsye nëse gjejmë në disa shprehje të selefëve gjykimin ndaj një personi i cili ka rënë në një bidat, se është bidatçi, ta dimë se ajo është për paralajmërim dhe tërheqje vërejtjeje, jo prej besimit të kësaj gjëje. Mbase është e përshtatshme me këtë rast të përmendim ndodhinë e personit që erdhi tek imam Maliku dhe i tha: “O Malik, Mëshiruesi mbi Arsh ‘isteua’ (u lartësua), si është ‘istiua-ja’ mbi Arsh?” Imam Maliku tha: “Lartësimi (istiua-ja) mbi Arsh është i kuptueshëm, ndërsa mënyra është e paditur dhe pyetja rreth saj (pra mënyrës) është bidat. Nxirreni jashtë këtë person sepse ai është bidatçi!” Ai nuk u bë bidatçi thjesht pse pyeti për qëndrimin mbi Arsh, sepse ai donte të sqarohej rreth diçkaje, por imam Maliku u frikësua se mos kishte qëllim të keq përmes kësaj pyetjeje e cila kundërshton Akiden e selefëve, prandaj edhe tha “nxirreni jashtë këtë person sepse ai është bidatçi”.

Shiko se si mjetet tani ndryshojnë. A mendon ti, unë, Zejdi, Amri, apo kushdo qoftë, se nëse na vjen një musliman i thjeshtë dhe na bën të njëjtën pyetje, do t’i kthejmë të njëjtën përgjigje të imam Malikut dhe të themi

“nxirreni këtë person jashtë sepse është bidatçi”? Kurrresi. Përse? Sepse koha ndryshoi dhe mjetet që atë kohë ishin të pranueshme, sot janë të papranueshme për arsyen se ato dëmtojnë më shumë sesa rregullojnë. Kjo fjalë ka lidhje me parimin e shkëputjes së marrëdhënieve (bojkotin), e cila njihet në Islam, ose ndryshe “hexhri” për hir të Allahut. Shpesh pyetemi se filani është shoku ynë, por nuk falet, pi duhan, bën kështu e kështu, a t’i shkëpusim marrëdhëniet apo jo? Unë ju them jo, mos i shkëpusni, sepse ai këtë dëshiron (d.m.th. të shkëputet) dhe shkëputja jote prej tij nuk i bën dobi, përkundrazi, e ndihmon që ai të vazhdojë në humbjen e tij. Me këtë rast po kujtoj një shembull sirian në të cilin flitet për një tregtar të prishur që vendosi të pendohet dhe kur shkoi në xhami të falet e gjeti derën mbyllur dhe tha: “Ti mbyllur dhe unë hiç.” Kur i miri kërkon t’i shkëpusë lidhjet me këtë të prishur, është njësoj sikur t’i thotë atij: “Ti mbyllur e unë hiç.” Marrëdhënia e të mirit me të keqin e pengon të keqin nga e keqja dhe ai nuk e dëshiron një gjë të tillë, ndërkohë që kur ti i shkëput marrëdhënien, ai kënaqet. Për këtë arsye shkëputja e marrëdhënieve është një mjet i ligjëruar për të realizuar një interes të ligjëruar, i cili është edukimi i personit të bojkotuar. Nëse shkëputja nuk e edukon, por përkundrazi ia shton devijimin më shumë, atëherë nuk lejohet. Ne sot nuk duhet që të bazohemi te mjetet e selefëve,¹⁴⁷ pasi ata punonin me to sepse kishin fuqi në atë kohë, ndërsa sot e shikon se si është gjendja e muslimanëve. Të dobët kudo që janë, jo vetëm si shtete, por edhe si individë. Gjendja sot është sikurse ka thënë Profeti (salallahu alejhi ue selem): “Filloi Islami i huaj dhe i huaj do të kthehet, prandaj tuba (pemë në Xhenet) është për të huajt.” Thanë: “Kush janë ata.” Tha: “Njerëz të pakët dhe të mirë në mesin e njerëzve të shumtë, ata që i kundërshtojnë janë më të shumtë se ata që u binden atyre.” Prandaj, nëse do ta hapim portën e shkëputjes, “hexhrit” dhe cilësimit të njerëzve “bidatçinj” (në kundërshtim me rregullat), duhet patjetër që të mos jetojmë vetëm se maleve. Por ajo që kemi obligim sot është: **“Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi, këshillë të mirë dhe polemizo me ta me mënyrën më të mirë.”**

Pyetësi - Vëllezërit që trajtojnë çështje të tilla, nuk e bëjnë haram të thuhet për ta “rahimehullah” dhe as nuk e pengojnë një gjë të tillë, por meqenëse

) Ka për qëllim pa marrë parasysh rregullat, arsyet, dobitë që synonin dhe dëmet që kërkonin t’i shmangnin.¹⁴⁷

thënia e kësaj fjale për ta është e lejuar dhe nuk është vaxhib, ata nuk e thonë kur përmendin emrat e tyre, sepse nëse do ta thoshin do të ishte lavdërim (tezkije) për ta. Gjithashtu duke arsyetuar ata thonë: “Ne mbase nuk themi se ata janë prej bidatçinjve apo prej kokave të bidatit, por nuk i lavdërojmë dhe kur i përmendim, nuk themi për ta ‘imam’, p.sh. kur përmendim Neueuiun, nuk themi ‘imam Neueuij’.” Pra, e mënjanojnë këtë gjë, si dhe transmetimin e citateve prej tyre. Kur kanë përmendur disa vëllezër në ligjëрата citate të shkëputura nga librat e tyre, të cilat janë të sakta dhe përputhen me rrugën e selefëve, u thanë: “Si i përmendni ju fjalët e tyre (nuk kam për qëllim ata që përmendi shejhu ynë, si Neueuij apo ibn Haxheri, por kam për qëllim Sejid Kutubin dhe Muhamed Kutubin), ndërkohë që ata njihen se nuk janë në rrugën e të parëve tanë dhe ti si selefij që je, kur përmend fjalët e tyre sikur i ke lavdëruar dhe kjoletë kuptohet se ata janë në rrugën e të parëve tanë. Kjo gjë mund t’i mashtrojë të rinjtë dhe t’i shpjerë në bidat si puna e tyre.” Shejhu ynë, nëse e shikon të përshtatshme të flasësh diçka rreth kësaj, e mirëpresim.

Shejhu - E para, nuk besoj se ky është qëllimi i tyre. E dyta, nëse me të vërtetë ky është qëllimi i tyre, atëherë kjo është mënyrë edukimi.

Megjithatë unë po them, ata që përmende a e lexojnë “Fethul bari”, apo nuk e lexojnë? Cilëndo përgjigje që të japin, prej saj do të rezultojë se metoda e tyre është gabim. Nëse thuhet se nuk e lexojnë, atëherë prej nga do ta kuptojnë “Sahihul Buhari”, komentimin, Fikhun, mospërputhjet, terminologjinë e hadithit etj. Nuk kanë për të gjetur selefist, ashtu sikur dëshirojmë ne, në të gjithë dynjanë që të ketë shpjeguar Buhariun, por edhe nëse do të gjejnë një shpjegim të tillë, ai do të jetë i përciptë. Ndërsa këtë det të gjerë dijeje që ka përfshirë ky libër, dije e cila i është dhuruar autorit të librit, nuk kanë për ta gjetur në asnjë libër tjetër në të cilin një autor i caktuar të ketë shpjeguar “Sahihul Buhari”, kështu që do të humbasin dije të shumtë. Nëse u tërheqin vërejtjen njerëzve të mos përfitojnë prej këtij imami, e humbën dijen. Prandaj duhet të përfitojnë dobitë dhe t’i shmangen dëmit (gabimeve) të librit, sikurse veprojnë dijetarët, sepse kjo është një gjë e mundshme. Që mbas Neueuijit dhe Askalanit, nuk ka dijetar në botë deri më sot, që të mos ketë nevojë për shpjegimin e këtyre të dyve, Buhariut dhe Muslimit. Megjithatë dijetarët edhe

pse përfitojnë prej librave të tyre, e dinë se ata, në shumë çështje janë esharinj, në kundërshtim me metodikën e të parëve të ndershëm, por dija ua mundësoi të marrin prej librave të tyre atë që u bënte dobi dhe të linin atë që u bënte dëm. Ajo që më bën të ndjehem i ndrojtur prej fjalës së tyre, është se mos mbas kësaj fjale të ëmbël, synojnë t'i paralajmërojnë njerëzit të ruhen prej librave të tyre dhe t'i urdhërojnë të mos përfitojnë prej tyre, atëherë kemi të bëjmë me një humbje. E nëse thonë: “Jo, ne përfitojmë prej tyre, i lexojmë këto libra dhe i nxisim të tjerët që t'i lexojnë”, atëherë çfarë dobie ka kjo mënyrë, pra, të ndalohemi nga thënia për ta “rrahimehullah” megjithëse ata janë muslimanë, sikurse thamë në fillimin e fjalës. Po ashtu cili është fryti i fjalës së tyre: “Ne nuk mendojmë se thënia ‘rahimehullah’ është haram, por nuk e themi atë”? Përse? Sepse kanë rënë në bidat. Ne përmendëm edhe më parë se jo çdokush që bie në bidat bie mbi të bidati, sikurse jo çdokush që bie në kufër, bie kufri mbi të. Këtë e ka prekur kufri dhe atë bidati, e përmendëm edhe më parë këtë çështje, kështu që ky lloj rezervimi nuk bën dobi. Nuk shkon edhe selefizëm dhe halefizëm,¹⁴⁸ mos vallë dijetarët prej të cilëve trashëguam këtë davet të frytshëm, këtë qëndrim kanë pasur ndaj këtyre imamllarëve, si këta të rinj të cilët pretendojnë selefizmin? Mos vallë ata kanë qenë si këta!? E kundërta është e saktë, të sotmit duhet të jenë si shembulli i atyre që na paraprinë në këtë davet të frytshëm.

Pyetësi - Disa persona thonë se kush bën një bidat që në vetvete është kufër, del prej “ehli sunetit”, ndërsa kush bën bidat që në vetvete është fisk (mëkat), nuk del prej “ehli sunetit” edhe nëse i përcillet argumenti dhe këmbëngul në të. A konsiderohet ky person prej “ehli sunetit” në këtë rast?

Shejhu - Fillimisht kush është bidati që është kufër dhe bidati që nuk është kufër?

Pyetësi - Bidat që është kufër, është p.sh. thënia se Allahu nuk është i Lartësuar mbi Arsh e të tjera si kjo, ndërsa bidati që është fisk, është p.sh. të bëjë një bidat që ka të bëjë me adhurimin, si mevludi.

) D.m.th. nuk është e përshtatshme të pretendojë njeriu selefizmin (ndjekjen e rrugës së dijetarëve të parë) dhe të¹⁴⁸ mos respektojë rregullat, qëndrimet, dhe perceptimet e tyre në mënyrë të përpiktë.

Shejhu - Kjo fjalë nuk është e saktë dhe bazën e ka nga “ehlul kelami” (filozofët). Dallimi midis bidatit në baza dhe bidatit në degëzime, apo bidatit në gjykime dhe bidatit në adhurime, vetë ky dallim është bidat. Nëse shikon një person i cili në një sunet prej suneteve të Profetit (salallahu alejhi ue selem), p.sh. sunetet e sabahut, i bën katër rekat dhe këmbëngul në këtë gjë, çfarë lloj bidati është ky, nga lloji i parë, apo nga lloji i dytë?

Pyetësi - Në bazë të sqarimit të parë ai klasifikohet në bidatet që janë fisk.

Shejhu - Kjo fjalë është e kotë. Prej gjërave që i kanë trashëguar njerëzit nga paraardhësit e tyre (ehlul kelami), është dallimi mes gabimeve në baza dhe gabimit në degëzime. Thonë se gabimi në degëzime falet, ndërsa gabimi në baza nuk falet. Dhe për hadithin e njohur në saktësinë e tij: “Nëse gjykon gjykatësi dhe ia qëllon ka dy shpërblime e nëse gabon ka një shpërblim”, thonë se kjo ka të bëjë me degëzimet, ndërsa në baza gabimi është i pafalshëm.

Kjo gjë nuk ka bazë në Kur’an, as në Sunet dhe as në fjalët e selefëve të ndershëm. Ajo që gjendet në fjalët e selefëve të ndershëm është frika ndaj shpikjes e veprimit të bidateve në përgjithësi, në besim qofshin, apo në adhurim (ibadet). Përmenda më parë një realitet, i cili qe se kush bën një musliman “kafir” pa të drejtë, ka bërë kufër dhe i bashkangjita çështjen se kush bën një musliman bidatçi... e kështu deri në fund. Sepse në të vërtetë kjo gjë nuk ka dallim dhe ndryshim tek unë, pra ndërmjet kufrit dhe bidatit.¹⁴⁹ Nëse një musliman bën një bidat dhe i qartësohet se kjo gjë është bidat, por megjithëkëtë këmbëngul në të, ky është si ai që mohon Lartësinë e Allahut mbi Arshin e Tij, apo mohon se Kur’ani është fjalë e Tij etj. Nuk ka aspak dallim, ngaqë të dy bëjnë kufër dhe dalin nga feja, përderisa këmbëngulin në të pavërtetën pasi u përcillet argumenti, ndërsa pa u arritur argumenti asnjëri nuk bëhet “kafir”. Mu’tezilet dhe huarixhët puqen në disa humbje dhe ndahen në disa të tjera. P.sh. huarixhët takohen me mu’tezilët në thënien se Kur’ani është i krijuar, a e di këtë gjë?

Nuk ka ndryshim për sa i përket aspektit që kush e cilëson kafir një musliman që nuk është evidentuar kufri në të ¹⁴⁹ drejtën e tij, ai bën kufër (bëhet fjalë për kufër të vogël) sipas hadithit të saktë, po ashtu kush e cilëson një musliman që nuk evidentohet bidati në të drejtën e tij, ka rënë në bidatë, sepse cilësimi bidatçi i muslimanit të drejtë që nuk është provuar të jetë i tillë, është prej bidateve që kundërshtojnë Kur’anin dhe sunetin. Nuk është qëllimi shejhut që nuk ka dallim mes tyre në të gjitha aspektet.

Pyetësi - Po.

Shejhu - Mirë, të përmenda më parë se muhadithinët (dijetarët e hadithit) nuk i bëjnë huarixhët kafirë. Atëherë si mund të pranohet logjikisht mendimi se kush mohon diçka të besimit është kafir, ndërsa kush bën bidat në adhurim është fasik, ndërkohë që vërejmë dijetarët e hadithit të transmetojnë prej huarixhëve dhe mu'tezilëve edhe pse e kanë kundërshtuar Akiden e saktë në më shumë se një çështje. P.sh. ata të cilët thonë se Kur'ani është i krijuar, mohojnë gjithashtu shikimin tek Allahu në ahiret. Prandaj si mohimin e shikimit tek Allahu, po ashtu edhe thënien se Kur'ani është i krijuar e të tjera gjëra, i përfshin rregulli i mëparshëm: “Që këto gjëra janë kufër, por jo çdokush që bie në kufër, bie kufri mbi të”. Dijetarët e hadithit, të parët e këtij Umeti si ibn Tejmija, ibn Kajimi dhe të tjerë, padyshim gjykojnë që huarixhët dhe mu'tezilet janë të humbur, por nuk gjykojnë se janë kafirë (të dalë nga feja e tyre), sepse ata marrin parasysht së pari mundësinë e paqartësive dhe dilemave që i kanë hasur, dhe së dyti se nuk janë informuar për argumentin fetar.

T'i kthehem edhe njëherë temës sonë të parë. Këta janë bidatçinj, por ne nuk e dimë se a e kanë pasur për qëllim bidatin apo jo, se a u ka arritur argumenti apo jo, e të tjera gjëra që duhen verifikuar. Kjo është metoda e dijetarëve. Ata japin gjykimin për humbjen e mu'tezilëve, huarixhëve dhe të esharinjve në shumë çështje, por nuk i bëjnë kafirë (nuk i nxjerrin nga feja islame), për shkak të arsyeve që përmenda më parë, të cilat po i përmend edhe një herë.

E para, se ata nuk e bënë qëllimisht këtë bidat apo kundërshtim, dhe e dyta, se nuk dihet a u ka arritur argumenti apo jo. Prandaj gjykojmë se llogari do të japin tek Allahu. Ndërsa rregullat ne i bazojmë në atë që shfaqin. Ata shfaqin Islamin, kanë vdekur muslimanë, janë varrosur në varrezat e muslimanëve, kështu që janë muslimanë. Për këtë arsye dallimi midis bidatit që në vetvete është kufër dhe atij që në vetvete është fisk, së pari është dallim terminologjik i lindur prej skolastikëve (filozofët, “ehlul kelam”) dhe së dyti, nuk ka rreth tij asnjë argument absolutisht.

Po e përfundoj fjalën time rreth kësaj çështjeje me një hadith i cili e argumenton rregullin që përmenda më parë, se jo çdokush që thotë ose bën atë që është kufër, bie kufri mbi të (d.m.th. bëhet kafir). Kam për qëllim hadithin që e transmeton Buhariu nga dy sahabët e mëdhenj, ebu Seid el Kudri dhe Hudhejfe ibnul Jeman, se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë:

“Ka qenë në mesin e paraardhësve tuaj, një burrë. Kur i erdhi vdekja mblodhi fëmijët e tij rreth vetes dhe u tha: ‘Çfarë babai kam qenë për ju?’ Thanë: ‘Më i miri prind!’ Tha: ‘Por unë jam gjynahqar me Zotin tim, e nëse Allahu do të ketë mundësi, do të më dënojë mua me një dënim të rëndë. Prandaj, kur të vdes, më digjni dhe gjysmën e lëndës së mbetur nga trupi im i djegur përhapeni në det, e gjysmën në tokë.’ Pasi vdiq, e dogjën dhe ia përhapën gjysmën në tokë e gjysmën në det. Allahu i tha grimcave të hirit të tij: ‘Formohu filan!’, dhe u formua siç qe. Allahu i Madhëruar tha: ‘O robi Im, çfarë të shtyu ty që ta bësh këtë gjë?’ Tha: ‘O Zoti im, frika prej Teje.’ Allahu i tha: ‘Shko se të kam falur’.”

Tani ne pyesim, a bëri kufër ky person apo jo? Padyshim që bëri kufër me fjalën e tij: “...nëse Allahu do të ketë mundësi, do të më dënojë mua me një dënim të rëndë”, por Allahu e fali atë.

Ne kemi mësuar prej Kur’anit të nderuar se Allahu nuk fal t’i bëhet Atij shok dhe fal të tjerat veç ortakërisë, për atë që dëshiron. Si bëhet pajtimi mes ajetit të Kur’anit dhe hadithit të kaluar mbi të cilin mbështetëm sqarimin tonë? Pajtimi vetëkuptohet prej asaj që shtjelluam më parë. Allahu nuk fal t’i bëhet shok qëllimisht me dashje¹⁵⁰ dhe veç ortakërisë fal kë dëshiron. Pra, kuptimi i ajetit është që nuk fal t’i bëhet shok e ortak qëllimisht, kështu që ai është i kushtëzuar me veprimin në mënyrë të qëllimshme. Çfarë mendimi ke për këtë kushtëzim?

Pyetësi - Është i saktë.

Shejhu - Mirë, por a ndodhet në ajet?

Pyetësi - Nuk ndodhet.

) Do të thotë të ketë për qëllim veprimin ose thënien që është shirk ose kufër.¹⁵⁰

Shejhu - Pra, nuk ndodhet në ajet. Atëherë nga e nxorrëm, e shpikëm vetë? Jo. (Por këtë kusht e kemi përfituar nga studimi i argumenteve të Sheriatit në tërësi.)¹⁵¹ Kështu është Sheriati, nuk mund të merret prej një ajeti, apo një hadithi, (në rastin kur lidhur me atë temë ka më shumë se një argument), por duhet të mblidhen të gjitha ajetet dhe hadithet që kanë lidhje me këtë çështje. Për këtë arsye, jo vetëm në çështjet e Fikhut duhet t'i mbledhim argumentet që kanë të bëjnë me një çështje, që të arrijmë të njohim gjykimet, por duhet bërë kjo gjë edhe në Akide, madje akidja është shumë më parësore se Fikhu në këtë gjë. Zakonisht dijetarët, kur shpjegojnë këtë ajet nuk i përkushtohen këtij lloj sqarimi, sepse çështja për mendimin e tyre është e qartë dhe nuk ka nevojë për shumë sqarim. Por kur shfaqen dyshimet dhe problemet, atëherë dijetari detyrohet që të nxjerrë atë çka ka prej dijes. Kështu që ky person la testament për atë gjë e cila nuk ka shembull në padrejtësi, mizori dhe kriminalitet, pra kërkoi të digjet që të fshihej prej Zotit të tij, ndërkohë që Allahu thotë:

“Na solli ne një shembull dhe e harroi zanafillën e krijimit të tij. Tha: ‘Kush i ngjall kockat kur ato të jenë bërë pluhur?’”

E megjithatë Zoti ynë e fali atë, përse? Sepse kufri nuk kishte hyrë në zemrën e tij.¹⁵² Ai përfytyroi gjynahet e tij karshi Zotit dhe iu frikësua dënimit të rëndë të Tij. Kjo frikë ia verboi besimin e saktë, prandaj edhe urdhëroi për këtë testament makabër. Dhe hadithi është mëse i qartë: “Shko se të kam falur.”

Kështu që ne nuk duhet të përfytyrojmë se Sejid Kutubi, kur shprehu fjalët që tregojnë për panteizëm, e pati për qëllim (këtë domethënie) dhe e besoi me zemër atë, sikurse ibn Arabiu, i cili humbi bashkë me veten e tij miliona

) Fjalja në kllapa është shtuar nga redaktori, bazuar në kontekstin e fjalëve të shejhut për t'u bërë më i qartë¹⁵¹ qëllimi i tij.

) Jo çdo njeri tek i cili shfaqet kufri, d.m.th. që bën ose thotë kufirin në pamje të jashtme, është i tillë me zemër,¹⁵² d.m.th. është kafir me zemër nga brenda, sepse bashkëlidhja ndërmjet asaj që shfaqet dhe asaj që është në zemër është e domosdoshme, por ajo nuk është absolute. Ka raste që përjashtohen, si për shembull ai që imponohet ose detyrohet me dhunë për të bërë kufër. Që të jetë i drejtë gjykimi ndaj një njeriu se është kafir, duhet patjetër të përputhet ajo që e shfaq me atë që e ka në zemër, d.m.th. gjykimi ndaj një personi se është kafir, është gjykim nga brenda dhe nga jashtë. Faktikisht bashkëlidhja (korrelacioni) mes asaj që e shfaq njeriu dhe asaj që e ka në zemër është një temë që duhet trajtuar me shumë kujdes dhe vëmendje sepse ka njerëz që e kanë menduar si gjë absolute kështu që kanë rënë në problemet e havarixhëve, e ka të tjerë që nuk besojnë se ekziston kjo bashkëlidhje, ose e besojnë që ekziston por jo në nivelin e duhur, kështu që kanë rënë në problemet e murxhieve. Do të ishte mirë ta kishim trajtuar këtë temë në rregullat e tekfirit, por inshaAllahu na jepet mundësia për të më vonë. Mjafton këtu që tërhiqem vëmendjen për rëndësinë e saj.

muslimanë prej sufistëve. Mbase kjo ka qenë një ide sufiste kalimtare që i ka lindur Sejjidit në kokë kur ishte i burgosur dhe nuk ka mundur të thellohet në njohjen e kësaj çështjeje e ta përvetësojë atë, kështu që e shkruajti atë shprehje të cilën unë isha nga të parët që e kritikuan.¹⁵³ Nuk gjykojmë mbi të me kufër, sepse ne nuk e dimë a e besoi me zemër dhe a i arriti argumenti apo jo, aq më tepër që ai ka qenë edhe në burg. E prej nga do t'i mundësohej kjo gjë? Për këtë arsye nuk duhet të mendojmë se ka lidhje të domosdoshme (absolute, pa përjashtim) mes rënies së muslimanit në kufër dhe cilësimit të tij “kafir”.¹⁵⁴ Kjo është e para gjë të cilën e kam përsëritur disa herë me qëllim paralajmërimi dhe e dyta është se nuk duhet të bëjmë dallim midis bidatit në besim dhe bidatit në adhurim (ibadet), sepse që të dyja, ose janë humbje ose janë kufër.¹⁵⁵

¹⁵³) Disa njerëz, për të përligjur qëndrimet e tyre ekstreme, mendojnë që dijetarët nuk e kanë njohur gjendjen e Sejjidit dhe më vonë janë informuar për gabimet e tij nga persona që po merren me të dhe me gabimet e tij. Si rrjedhojë, në thëniet e dijetarëve lidhur me Sejjidin, paska të hershme dhe të mëvonshme që kanë abroguar të hershmet! Kjo fjalë që ka thënë shejhu këtu është dëshmi se e ka njohur Sejjidin dhe i ka kritikuar gabimet e tij para tyre.

Shejhul islam ibn Tejmije ka thënë: “Nuk lejohet provokimi i njerëzve me emra të cilët nuk gjenden në Kur’an dhe as në Sunet. Me të vërtetë kjo gjë është në kundërshtim me atë çka ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe është shkak për krijimin e fitneve dhe përçarjes mes Umetit.”

Figura e Sejjid Kutubit dhe e disa të tjerëve është kthyer në element për provokimin e muslimanëve nga disa njerëz. Sipas tyre ai që i shan është me grupin e tyre e ai që nuk i shan nuk është me ta. Tamam si paraardhësit e tyre gjatë shekujve të kaluar që provokonin muslimanet nëpërmjet Jezid ibni Muavijes dhe kështu bëheshin shkak për formimin e grupacioneve dhe përçarjen e muslimanëve duke e bërë dashurinë e urrejtjen për hir të personave dhe grupeve. E gjithë kjo ndodh ndërkohë që lidhur me persona të caktuar mund të mos pajtohen mendimet e gjykimet për arsye të konsiderueshme, por kjo nuk duhet të shpjerë në përçarje, përderisa rregullat e bazat janë të njejta, veçse kanë lindur mosmarrëveshjet lidhur me zbatimin e tyre ndaj personave të veçantë. Mospajtime të këtij karakteri ka pasur mes dijetarëve në të kaluarën, por ata e kanë dënuar përçarjen për shkak të tyre. Njerëzit që iniciojnë nga larg krijimin e grupacioneve, trazirave dhe përçarjes përmes provokimit duke ngritur disa njerëz e duke sharë disa të tjerë, e dinë mirë se kanë zgjedhur një mënyrë të arrirë për të realizuar qëllimin e tyre, sepse ajo i ka dhënë efektet e saj të këqija në të kaluarën. Faktikisht grupacionet e krijuara si rrjedhojë e provokimeve të tilla i kanë tejkualuar përmasat e grupacioneve fanatike në të kaluarën dhe e habitshme është të vëresh disa njerëz që më së shumti pretendojnë luftimin e grupacioneve brenda Umetit islam, të jenë pre e saj në format më ekstreme që ka njohur historia islame. Nuk ka dyshim që muslimanët e kanë detyrë të pyesin dijetarët, por nuk lejohet të kalojnë në fanatizëm duke u ngurtësuar në mendimet e një dijetari. Disa njerëz po e rikthejnë fanatizmin medhhebist, pasojat e të cilit vazhdon t'i vuajë Umeti.

) Fjalja është rregulluar në përputhje me qëllimin e shejhut.¹⁵⁴

) Vetëkuptohet nga sqarimi i shejhut se ai nuk pranon posaçërimin e bidatit që është fisk (mëkat, gjynah) vetëm¹⁵⁵ për gjërat e rregullave dhe ibadeteve, kurse atë që është kufër vetëm për çështjet e besimit, sepse bidatet si në besim po ashtu edhe në ibadete, mund të jenë kufër që të nxjerr nga feja dhe mund të jenë fisk, humbje. P.sh. ai që e bën të lejuar të bëhen sunetet e sabahut katër rekate, bën kufër edhe pse është në ibadet. Për këtë që sqaruam dëshmon fjala e tij: “Nuk duhet të bëjmë dallim midis bidatit në besim dhe bidatit në adhurim (ibadet), sepse që të dyja, ose janë humbje ose janë kufër”. Prandaj ata që kanë shfrytëzuar këtë fetva për të thënë se shejhu mendon që nuk ka ndryshim mes bidatit që është kufër dhe bidatit që është fisk, janë gabuar.

Pyetësi - Shejh, a lejohet lavdërimi i bidatçinjve edhe pse mund të pretendojnë shërbimin ndaj Islamit dhe se ata lodhen për këtë gjë, si Turabi e të tjerë si shembulli i tij?

Shejhu - Përgjigjja ndryshon me ndryshimin e vendeve. Nëse kemi për qëllim lavdërimin e një muslimani që e mendojmë bidatçi, dhe nuk themi për të bidatçi, sepse mbas gjithë asaj ligjërate të gjatë mendoj se bëjmë dallim midis dy çështjeve inshaAllah, pra, nëse është për qëllim me lavdërimin e tij, mbrojtja e tij karshi kafirëve, atëherë kjo gjë është obligim. Ndërsa nëse është për qëllim me lavdërimin e tij, zbukurimi i metodikës së tij dhe ftesa e njerëzve tek ajo, kjo gjë përbën çorientim e çoroditje, prandaj nuk lejohet.

Pyetësi - A është e vërtetë ajo çka dëgjojmë, se “hexhri” i bidatçinjve në këtë kohë nuk praktikohet?

Shejhu - Ai ka dashur të thotë se nuk është i përshtatshëm të praktikohet, sepse faktikisht nuk praktikohet ngaqë bidatçinjtë dhe të prishurit janë shumicë. Dhe mbase pyetësi më ka mua të parin për qëllim, prandaj them se po, kështu është, nuk është i përshtatshëm që të praktikohet dhe e thashë këtë gjë shumë qartë më parë kur përmenda shembullin sirian që thotë “ti mbyllur dhe unë hiç”.

Pyetësi - Nëse gjendet një ambient shumica e të cilit janë “ehli suneh” dhe në të shfaqen disa bidatçi që bëjnë bidate në fenë e Allahut të Madhëruar, po këtu a praktikohet apo jo?

Shejhu - Gjenden në të njëjtin xhemat?

Pyetësi - Po, në të njëjtin ambient që dominon e vërteta shfaqet bidati, nuk e dimë fjalën tuaj në këtë rast.

Shejhu - Në këtë rast është obligim përdorimi i urtësisë. Grupi i fuqishëm dhe mbizotërues, nëse e shkëput marrëdhënien me këtë grupacion të devijuar prej xhematit, a i bën dobi grupit të kapur mbas hakut apo i bën dëm? Kjo njëra anë, tjetra, se a i bën dobi grupit të bojkotuar apo jo? U përmend edhe më parë kjo përgjigje. Nuk duhet që këto çështje t’i marrim me vrull dhe ndjenja, por duhen marrë me maturi dhe urtësi. P.sh. këtu tek ne njëri devijoi, nuk duhet që menjëherë ta braktisim. Jo, të jemi të butë me të, ta këshillojmë dhe ta drejtojmë. Nëse nuk ka më shpresë tek ai së pari, dhe së dyti, frikësohemi se

sëmundja e tij kalon tek të tjerët, atëherë shkëputen marrëdhëniet me të, nëse mendojmë se ky është ilaçi. Në një fjalë të urtë arabe thuhet: “Ilaçi i fundit është të mjekuarit më hekur të nxehtë”.

Unë në këto ditë nuk këshilloj që të përdoret ilaçi i shkëputjes, sepse ai dëmton më shumë se sa përmirëson. Dhe më i madhi argument për këtë është fitnja që ndodhet në Hixhaz (krahina që përfshin Meken dhe Medinen). Të gjithë i bashkon thirrja në Teuhid, e cila është thirrja e Kur’anit dhe Sunetit, por disa prej tyre kanë aktivitet të veçantë, qoftë në politikë, apo në disa mendime të cilat nuk njiheshin më parë nga dikush prej dijetarëve. Këto mendime mund të jenë të gabuara dhe mund të jenë të sakta. Për këtë arsye nuk duhet që të na bëjnë këto fjalë të reja të cilat i dëgjojmë, sidomos kur fillimisht i mendojmë të gabuara, të ngrihemi dhe t’i luftojmë këta njerëz. Kjo gjë është gabim. Kjo është gabim, vëlla. Mos vallë dëshiron të kesh një shok tek i cili nuk ka asnjë gabim!? Dhe a ka dru aromatik që digjet pa bërë tym!? Ne dëshirojmë prej “Thuan el Muslimin” që të jenë me ne vetëm në Teuhid, që të jemi me ta. Por ata as në Teuhid nuk janë dakord me ne. Dhe thonë se cekja e këtyre çështjeve e përçan Umetin. Ndërsa ata vëllezër të cilët u ndanë nga xhemati, ose xhemati është ndarë nga ata, Allahu e di më së miri, janë bashkë me ne në vijën e Kur’anit, Sunetit dhe metodikën e selefëve të ndershëm. Me të vërtetë ata kanë ardhur me diçka të re, një pjesë e së cilës është gabim dhe një pjesë është e saktë. Për këtë arsye, përse të përhapim në mesin tonë këtë përçarje, grupacion (te hazub) dhe fanatizëm? E pasi qemë një grup u bëmë dy grupe, e pasi u bëmë dy u formua dhe i treti, u bën seferijinë dhe sururijinë e kështu me radhë. Allahu Ekber!

¹⁵⁶ Dhe nuk i ka përçarë ndonjë gjë që e meriton të përçahesh për hir të saj. Nuk kanë mosmarrëveshje në çështjet e mëdha tek të cilat nuk mund të imagjinohet se selefijtë përçahen në to. Ne të gjithë e dimë se sahabët nuk u përputhën në disa çështje e megjithatë metodika e tyre ka qenë e njëjtë. Kështu që nëse një grup prej “ehli sunetit” (disa individë) kundërshtojnë, ndryshojnë

) Kjo tregon se shejhu nuk është i kënaqur me përçarjen që ndodhi mes disa davetçinjve që prej disa vitesh në ¹⁵⁶ krahinën e Hixhazit.

dhe sjellin gjëra të reja, duhet ta trajtojmë çështjen e tyre me butësi dhe të përpiqemi të ruajmë qëndrimin e tyre me xhematin dhe të mos i shkëpusim lidhjet me ta dhe as mos u bëjmë “hexhër”, vetëm nëse do të frikësohemi prej tyre. Dhe kjo gjë nuk shfaqet menjëherë, pra me të shfaqur dikush një mendim ndryshe nga ai i xhematit, nuk duhet që menjëherë t’i shkëpusim marrëdhëniet, por të presim se mbase Allahu ia udhëzon zemrën, ose të na bëhet e qartë se shkëputja prej tij është më parësore.

Pyetësi - A janë ihuanët dhe tebligsat prej grupeve të cilat i ka përmendur Profeti (salallahu alejhi ue selem) në hadithin e grupeve të zjarrit, apo jo?

Shejhu - Jo, jo, ihuanët në gjirin e tyre kanë përfshirë njerëz nga grupe të ndryshme. Gjenden tek ata selefij, shija etj. me rradhë. Për këtë arsye nuk është e saktë që të thuhet për ta një cilësi e vetme (d.m.th. t’u jepet një gjykim i vetëm). Por themi se kush ndjek një metodë që bie në kundërshtim me rrugën e Kur’anit dhe Sunetit, ai person nuk është prej grupit të shpëtuar, por prej grupit të shkatërruar. Ndërsa si xhemat,¹⁵⁷ vallahi, unë edhe për selefijtë nuk them se janë prej grupit të shpëtuar. Çfarë mendimi keni për këtë?

Pyetësi - Shejh, nuk bëhet fjalë për metodën e selefëve?

Shejhu - Sigurisht.

Pyetësi - Gjykimi shejh, lidhet me individët.

Shejhu - Të lumtë.¹⁵⁸ Subhaneke Allahumme ue bihamdike, esh-hedu en la ilahe il-la ente, estagfiruke ue etubu ilejke.

Kreu 7. Metoda e “ehli suneh uel xhemaah” në referim dhe argumentim

“Ehli suneh uel xhemaah”, për të argumentuar rreth çështjeve të fesë

) D.m.th. që nuk janë të gjithë ata që pretendojnë pëkatësinë selefije, prej grupit të shpëtuar, sepse ka prej tyre që¹⁵⁷ në të vërtetë janë thjesht pretendentë dhe nuk ecin në rrugën e selefëve.

) Në përgjigjen që ka dhënë shejhu këtu për ihuanët dhe tebligët ka pasur për qëllim individët e tyre, siç kuptohet¹⁵⁸ qartë nga leximi i të gjithë fetvasë. Kurse për sa i përket metodës së tyre, ajo padyshim nuk përputhet me rrugën e të parëve. Në dritën e kësaj që sqaruam këtu, duhet të kuptohen edhe thëniet e dijetarëve të tjerë lidhur me këto xhemate.

bazohen në Librin e Allahut, Sunetin e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe “ixhmain” (pajtimin) e selefëve (të parëve) të mirë. Kurse, për sa i përket “kijasit” (analogjisë), dijetarët nuk janë pajtuar në lidhje me konsiderimin e tij argument, megjithëse shumica e tyre e konsideron si një nga burimet e argumentimit, nëse i përmbush kushtet.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për një çështje, parashtrojeni atë tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” En-Nisa: 59.

“Në çdo gjë për të cilën jeni në mosmarrëveshje, gjykimi është tek Allahu.” Esh-Shura: 10.

“Çdo gjë që t’jua japë i Dërguari merreni, dhe çdo gjë që ai jua ndalon juve, hiqni dorë prej saj.” El Hasher: 7.

“Atë që i kundërvihet të Dërguarit, pasi i është bërë e qartë e vërteta, dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që ka zgjedhur (në dynja) dhe e fusim në xhehenem. Përfundim i keq është ai.” En-Nisa: 115.

Të bazuarit në tri burimet e pagabueshme të cilat janë Kur’ani, Suneti dhe “ixhmai”, është themeli i fesë islame. Metoda e “ehli sunetit” në përfitimin e përfundimeve nga Kur’ani dhe Suneti bazohet në tri parime.

- 1- Madhërimi i teksteve fetare dhe nënshtrimi ndaj tyre.
- 2- Mbështetja në hadithet e sakta.
- 3- Perceptimi i drejtë i teksteve.

Qëllimi jonë me burimet e Akides, janë rrugët prej të cilave përftohen realitetet e Akides islame. Ato janë rrugët që përdorën selefët e këtij Umeti për pohimin e çështjes së Akides. për sa i përket qenies së librit të Allahut dhe Sunetit të saktë të të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem), burimet (argumentet) e Akides islame janë të shumta nga libri i Allahut, por ne do të

përmendim vetëm disa prej tyre.

Do të flasim në mënyrë të përmbledhur për këto tri parime sepse ato e sqarojnë metodën e “ehli sunetit” në referim dhe argumentim.

Parimi i parë. Madhërimi i teksteve fetare dhe nënshtrimi ndaj tyre

Themeli i fesë islame të cilin Allahu e ka zgjedhur dhe e ka pëlqyer për robërit e tij besimtarë është dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Kthehuni tek Zoti juaj dhe dorëzohuni Atij.”** Ez-Zumer: 54.

Realiteti i dorëzimit është madhërimi i urdhërit të Allahut të Lartësuar dhe ndalimit të Tij, nënshtrimi ndaj tyre dhe qëndrimi në kufijtë e asaj që Allahu e ka zbritur mbi Muhamedin (salallahu alejhi ue selem). Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Pra kështu. Kush madhëron atë që Allahu e bëri të shenjtë, ajo është më e dobishme për të tek Zoti i vet. Juve ju janë lejuar kafshët, përveç atyre që u lexohen (në Kur’an), pra largohuni nga ndyrësitë e idhujve dhe fjalës shpifëse.” El Haxh: 30.

“Kjo është kështu! E kush madhëron dispozitat e Allahut, ajo është shenjë devotshmërie.” El haxh: 32.

Detyra jonë ndaj fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem) është t’i madhërojmë, t’i pranojmë plotësisht, t’u nënshtrohemi atyre dhe t’i respektojmë, sepse vetëm kjo është rruga e shpëtimit dhe e ngadhënjimit, siç ka thënë Allahu:

“Fjala e vetme e besimtarëve të vërtetë kur ata thirren tek Allahu (te fjala e tij Kur’ani) dhe i Dërguari i Tij për të gjykuar mes tyre, është që të thonë: ‘Dëgjuam dhe u bindëm’. Dhe mu ata janë ata që fitojnë lumturinë (xhenetin e pasosur). Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, i frikësohet Allahut dhe i përkushtohet Atij, tamam këta janë të fituarit.”

En-Nur 51-52.

Allahu e ka ndaluar t'i japim përparësi dikujt apo diçkaje tjetër, para Allahut, të Dërguarit të Tij dhe fjalës së tyre. Ai ka thënë:

“O ju që keni besuar! Mos vendosni para se të vendosë Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe kini frikë Allahun. Vërtet që Allahu është Gjithëdëgjues, i Gjithëditur.” El Huxhurat: 1.

Kur na vjen një urdhër prej urdhërave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, atëherë nuk ka më hapësirë për të zgjedhur apo për të hezituuar. Allahu ka thënë:

“Nuk është as për besimtarin dhe as për besimtaren, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë vendosur për një çështje, që ata të kenë zgjedhje tjetër në vendimin e tyre. Dhe kushdo që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, padyshim që ka humbur në gabim të qartë.” El Ahzab: 36.

Allahu ia ka mohuar besimin krejtësisht atij që shmanget nga gjykimi i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), apo ndjen në zemrën e tij pakënaqësi ndaj tij:

“Por jo për Zotin tënd! Ata nuk mund të kenë aspak besim përderisa të të bëjnë ty (o Muhamed) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet e tyre derisa të mos mbetet në vetvetet e tyre asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve të tua dhe derisa t'i pranojnë ato plotësisht të nënshtruar.” En-Nisa: 65.

Allahu i ka paralajmëruar për sprovim dhe ndëshkim ata që i kundërshtojnë urdhërat e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem):

“Dhe kushdo që kundërshton të Dërguarin, pasi t'i jetë treguar qartë atij Rruga e Drejtë dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne do ta mbajmë në atë drejtim që ai ka zgjedhur dhe do ta djegim atë në zjarr, e sa përfundim i keq.” En-Nisa: 115.

“Mos e bëni thirrjen ndaj të Dërguarit (Muhamedit) mes jush, siç thërrisni njëri-tjetrin. Allahu i di ata të cilët shkëputen vjedhurazi duke u fshehur (pas ndonjë arsyeje pa marrë leje për t'u larguar nga i Dërguari). Dhe

le ta kenë mendjen ata që nuk pajtohen me urdhërin e të Dërguarit (sUNETIN e tij, rrugën e tij, zbatimin në jetë të urdhrave të Allahut, të Islamit, me fjalën e këshillat e tij), **që të mos bjerë mbi ta ndonjë fitne** (mosbesim, sproVë, vështirësi ose fatkeqësi, tërmet, vrasje, nënshtrim nga tiranë etj.), **ose t’u jepet një ndëshkim i dhembshëm.**” En-Nur: 63.

Shkaku i shmangies nga respektimi i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) është ndjekja e epshit dhe dëshirave të nefsit. Për këtë dëshmon fjala e Allahut në Kur’an:

“Por nëse ata nuk të përgjigjen ty (nuk të besojnë ty dhe Mesazhin tënd të besimit islam, as nuk të ndjekin ty), **atëherë dije pra se ata ndjekin vetëm dëshirat e tyre. Dhe kush është më i gabuar sesa ai i cili ndjek dëshirat e veta pa udhëzim nga Allahu? Sigurisht që Allahu nuk e udhëzon popullin Dhalimun** (politeist, mosbesimtar, keqbërës e të pabindur ndaj Allahut).” El Kasas: 50.

Allahu i Lartësuar i ka dënuar e qortuar ata që nuk e madhërojnë dhe nuk i zbatojnë urdhërat e Tij, dhe të cilët nuk u përmbahen ndalesave:

“Ç’është me ju (që nuk e keni frikë Allahun për ndëshkimin e Tij dhe) **që nuk shpresoni për shpërblim** (nga Allahu ose që nuk besoni në Njëshmërinë e Tij)?” Nuh: 13.

Metoda e të parëve të mirë, në madhërimin e teksteve të Sheriatit

Të parët e Umetit tonë kanë dhënë shembujt më të shkëlqyer në zbatimin dhe madhërimin e urdhërit të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) dhe në mostejkalimin e caqeve të caktuar prej tij, pa e tepruar dhe pa i mangësuar ato.

Dëshmitë që tregojnë për këtë shfaqen në disa aspekte, prej të cilave veçojmë këto që vijojnë:

1- Madhërimi i fjalës së Profetit (salallahu alejhi ue selem).

Rrëfen ebi Katade i cili thotë: “Ishim te Imran ibn Husejn, ndërkohë që mes nesh ishte i pranishëm edhe Bushejr ibni Ka’b. Atë ditë Imrani na tregoi se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ‘Turpi është i gjithi i

mirë’, ose ka thënë: ‘turpi i gjithë është i mirë’. ‘Ne gjejmë të shënuar në disa libra urtësie, se ka një lloj turpi që është i lavdëruar, është qetësi, dhe i tillë që përmban madhërim ndaj Allahut të Madhëruar, por ka edhe një lloj turpi që është dobësi’ - , i tha Bushejri. Atëherë Imrani u nevikos aq shumë sa iu skuqën sytë dhe i tha: ‘Mos të ndodhë më që të të flas për atë që e ka thënë Profeti (salallahu alejhi ue selem), dhe ti ta kundërshtosh’. Transmetuesi rrëfen se Imrani e përsëriti hadithin, por Bushejri tha përsëri të njëjtën gjë. Atëherë Imrani u nevikos më shumë, aq sa ne menduam se po dyshonte për të, prandaj vazhduam t’i thoshim: ‘Ky është prej nesh o ebu Nuxhejd, është njeri që nuk ka asgjë të keqe (d.m.th. nuk është munafik)’.” Transmeton Muslimi.

Muslimi transmeton se Abdullah ibn Umer ka dëgjuar Profetin (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: “Mos i pengoni gratë tuaja që të shkojnë në xhami, në qoftë se ato ju kërkojnë leje.”

Kur e dëgjoji këtë fjalë, Bilal ibn Abdil-lah tha: “Uallahi do t’i ndalojmë!” Atëherë Abdullah ibn Umer u kthye drejt tij, e qortoi dhe e shau aq keq, sa nuk e kam dëgjuar të shante ndonjëherë ashtu. Pastaj i tha: “Të lajmëroj nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe thua uallahi do t’i ndalojmë!?”

Një herë Abdullah ibn Abbasi tha: “Profeti e ka bërë haxhin ‘temetuë’.¹⁵⁹ Atëherë Urvetu ibn Zubejr tha: “Ebu Bekri dhe Umeri e kanë ndaluar të kryhet haxhi në këtë mënyrë.”

“Çfarë tha Urve?”, - i pyeti të pranishmit ibn Abasi.

“Thotë se ebu Bekri dhe Umeri e kanë ndaluar të kryhet haxhi në mënyrën ‘temetuë’.” - iu përgjigjën.

Ibn Abasi tha: “Siç vërej po shkatërrohen. Unë them se ka thënë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), kurse ai më thotë se ebu Bekri dhe Umeri e kanë ndaluar.” Transmeton imam Ahmedi në “Musnedin” e tij dhe Ahmed Shakir e ka vlerësuar të saktë.

) Temetuë është njëra prej tri mënyrave të kryerjes së haxhit.¹⁵⁹

Transmetohet se Abdullah ibni Mugaffel pa njërin prej shokëve të tij duke gjuajtur gurë me gishtërinj dhe i tha: “Mos gjuaj, sepse i Dërguari i Allahut e ndalonte të hedhësh gurë, ngaqë kështu as nuk gjuhet gjahu dhe as nuk plagoset e vritet armiku, por kjo lloj gjuajtjeje thyen dhëmbin dhe nxjerr syrin.” Pas një farë kohe e pa përsëri duke gjuajtur dhe i tha: “Të kam lajmëruar që i Dërguari i Allahut e ka ndaluar të gjuash me gurë, dhe përsëri të vërej të gjuash. Nuk të flas për kaq e aq kohë!” Transmeton Muslimi.

Në prani të Harun Rreshidit, ebu Muavijetu ed-Darir ka përcjellë hadithin e ebi Hurejres rreth dialogut mes Ademit dhe Musës. Njëri prej të pranishmëve tha: “Si mund të ndodhte kjo gjë, ndërkohë që ndërmjet Ademit dhe Musës ka pasur një periudhë të gjatë kohore?” Atëherë Haruni brofi i nevrikosur duke thënë: “Të flet për atë që e ka dëgjuar nga i Dërguari i Allahut, kurse ti e kundërshton duke thënë si!?” Vazhdoi t’ia thoshte këto fjalë derisa kundërshtari heshti.

Një burrë i tha imam Zuhriut: “O ebu Bekër, çfarë thua për fjalën e Profetit ‘nuk është prej nesh ai që godet faqet’, ‘nuk është prej nesh ai që nuk respekton të madhin tonë’, e të tjera hadithe si këto?” Imam Zuhriu e uli kokën për një farë kohe, pastaj e ngriti dhe tha: “Prej Allahut na ka ardhur dija, detyra e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) ka qenë përcjellja e saj, kurse detyra jonë është t’i dorëzohemi.” (Këtë thënie e ka përmendur Buhariu në “Sahihun” e tij, pa pyetjen në fillimin e saj, ndërsa së bashku me pyetjen e ka transmetuar el Halalu në “Es-Suneh”).

Ebu Saib thotë: “Ndërkohë që ishim te Veki ibnil Xherrah, ai i tha një burri të pranishëm prej atyre që merren me analogjitë dhe mendimet e njerëzve (err’j): ‘I Dërguari i Allahut i ka bërë shenjë kurbanit në njërin prej dy anëve të gungës, duke ia prerë ose çarë lëkurën me gërshërë në mënyrë që të dilte gjak dhe të njihej që ishte për kurban, kurse ebu Hanife thotë se ai është gjymtim (d.m.th. shenja që i bëhet kurbanit për t’u njohur). Atëherë burri i tha: ‘Është

transmetuar nga Ibrahim en Nahai se shenjimi i kurbanit është gjymtim'.¹⁶⁰

Transmetuesi thotë se Vekiu u nevrikos shumë nga fjalët e tij dhe tha: 'Të them se ka thënë i Dërguari i Allahut dhe më thua ka thënë Ibrahim?! Sa e meriton ti që të burgosesh dhe pastaj të mos dalësh nga burgu derisa të tërhiqesh nga ky mendim'.' (Është përcjellë në "El fekih vel mutefekih".)

2- Të sigurohesh përpara se ta veprosh një sunet, derisa të merret vesh mirë që është i tillë.

Selefët e këtij Umeti siguroheshin mirë në veprimin e Sunetit dhe ruheshin nga bidatet. Ata nuk bënë asgjë veçse me dije, dhe nuk mbështeteshin në mendimet e tyre, apo të vlerësonin si të ligjshëm me logjikë një ibadet ose një formë ibadeti që nuk e ka praktikuar i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem).

Nga ngjarjet ose rastet e çuditshme që tregojnë qëndrimin e tyre ndaj sunetit të të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) janë këto që vijojnë.

Një burrë që ishte pranë Abdullah ibn Umerit teshtiu dhe pas teshtimës tha "elhamdulillah ues selamu ala resulil-lah". Ibn Umer i tha: "Edhe unë them 'elhamdulillah ues selamu ala resulil-lah', por Profeti nuk na ka mësuar të themi kështu pas teshtimës. Ai na ka mësuar të themi 'elhamdulillah ala kuli hal' (falenderimi i takon Allahut për çdo gjendje)." Transmeton Tirmidhiu, i cili thotë se hadithi është hasen.

Ibnu Xhurejxhi rrëfen se Tavusi e ka lajmëruar se ka pyetur Abdullah ibni Abasin për dy rekatet pas ikindisë, dhe ai e ka ndaluar t'i falte.¹⁶¹ Tavusi rrëfen se i tha: "Nuk do t'ilëpa falur!" Atëherë ibnu Abasi i përmendi fjalën e Allahut

) Profeti e ka ndaluar gjymtimin, por nga ana tjetër i ka bërë shenjë kurbanit që e çonte për në Mekë. Kjo tregon ¹⁶⁰ se gjymtimi ndryshon nga bërja e shenjës në trupin e kafshës, dhe si rrjedhojë edhe gjykimi është i ndryshëm.

) Ibnu Abasi e ka ndaluar bazuar në fjalën e Profetit: "Nuk ka namaz pas ikindisë derisa të perëndojë dielli", por ¹⁶¹ në një hadith tjetër ka ardhur se Profeti nuk i linte pa i falur dy rekatet pas ikindisë. Për këtë arsye, në lidhje me këto dy rekatet janë dhënë dy mendime, i pari të falen, dhe i dyti të mos falen. Mendimi më i saktë në lidhje me këtë çështje është ligjshmëria e faljes së dy rekatëve pas ikindisë me kusht që të mos ketë anuar dielli për të perënduar (d.m.th. të mos falen në kohën e ndaluar para perëndimit të diellit). Kjo për arsye se hadithi i parë e ndalon namazin pas ikindisë në përgjithësi, kurse hadithi i dytë përjashton faljen e dy rekatëve. Raste të tilla përjashtimesh në Sheriat ka shumë. Në këtë mënyrë bëhet pajtimi mes dy argumenteve dhe jepet mundësia që të praktikohen që të dy. Ajo që vlen të theksohet këtu, është fakti se Abdullah ibnu Abasi ishte shumë i prerë në qëndrimin tek ajo që e ka ligjëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, sipas asaj që e dinte nga suneti i të Dërguarit të Allahut.

të Lartësuar: **“Nuk është as për besimtarin dhe as për besimtaren, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë vendosur për një çështje, që ata të kenë zgjedhje tjetër në vendimin e tyre. Dhe kushdo që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, padyshim që ka humbur në gabim të qartë.”** El Ahzab: 36.

E ngjashme me atë që kaloi, është ajo që ka ndodhur me Said ibnil Musejjib, i cili pa një person që fali pas agimit të sabahut më shumë se dy rekate, në të cilat shpesh bënte ruku dhe sexhde, dhe ai e ndaloi. Atëherë personi i tha: “A do të më ndëshkojë mua Allahu sepse fal namaz, o ebu Muhamed!?” “Jo, - i tha ai, - por të ndëshkon për kundërshtimin e Sunetit.” Transmeton Abdurrezzaku me isnad të mirë.

Një burrë e pyeti imam Malikun: “O ebu Abdil-lah, që nga të bëj ‘ihram’ (të bëj nijetin për haxh ose për umre dhe të vesh rrobat e ihramit)?” “Që nga Dhil hulejfe, - iu përgjigj Maliku, - atje ku ka bërë ihram i Dërguari i Allahut.” “Unë dua të bëj ihram që nga xhamia te varri”, - i tha ai. ‘Mos e bëj këtë, - ia ktheu Maliku, - se kam frikë mos të prek fitneja (sprova, ndëshkimi).’ “Çfarë fitneje ka në këtë gjë?, - ia priti ai, - unë nuk po bëj gjë tjetër veçse po shtoj disa milje (disa kilometra)!” Maliku i tha: “Cila sprovë është më e madhe se sa të mendosh që ke paraprirë në një të mirë, bërjen e së cilës e ka neglizhuar i Dërguari i Allahut?! Allahu i Lartësuar ka thënë: **‘Mos e bëni thirrjen ndaj të Dërguarit (Muhamedit) mes jush, siç thërrisni njëri-tjetrin. Allahu i di ata të cilët shkëputen vjedhurazi duke u fshehur (pas ndonjë arsyeje pa marrë leje për t’u larguar nga i Dërguari). Dhe le ta kenë mendjen ata që nuk pajtohen me urdhërin e të Dërguarit (sunsetin e tij, rrugën e tij, zbatimin në jetë të urdhrave të Allahut, të Islamit, me fjalën e këshillat e tij), që të mos bjerë mbi ta ndonjë fitne (mosbesim, sprovë, vështirësi ose fatkeqësi, tërmet, vrasje, nënshtrim nga tiranë etj.), ose t’u jepet një ndëshkim i dhembshëm.’** (En-Nur: 63.)” Transmetohet në “El fekih” dhe “El mutefekih.”

Në të gjithë këta shembuj vërejmë se kundërshtarët e Sunetit niseshin nga

pikëpamja e rezervimit apo dëshirës për të shtuar në ibadet. Por megjithëkëtë, dijetarët e selefëve e theksuan madhërimin e teksteve dhe respektimin e caqeve të tyre. Qëndrimet e tyre mbështeteshin në një bazë madhështore për pasimin e Sunetit, të cilën e ka përmendur Said ibni Xhubejr në fjalën e tij: “Vërtet shumë mirë ka vepruar ai që kthehet tek ajo që e ka dëgjuar.”

Sufjan eth-Theuri ka thënë: “Nëse mundesh të mos e kruash kokën veçse duke pasur një shembull të cilin e pason, kështu vepron.”¹⁶²

Buhariu ka thënë: “Prijësit pas Pejgamberit, konsultoheshin me dijetarët e besueshëm për gjërat e lejueshme, në mënyrë që të merrnin atë që është më e lehtë. Por kur u qartësohej kufiri ose rregulli i Kur’anit dhe Sunetit, nuk e tejkalonin. Kështu ata merrnin për shembull atë që e bënte Profeti (salallahu alejhi ue selem).”

Ibnu Tejmije ka përmendur se Ahmed ibni Hambeli e preferonte haxhin “temetuë” (d.m.th. fillimisht të përfundohej umreja, pas së cilës njeriut i lejohet të përjetojë të gjitha kënaqësitë e ndaluara për shkak të ihramit gjatë umres. dhe në ditën e tetë të dhilhixhxes të fillojë haxhin), aq sa ai dhe të tjerë prej dijetarëve të hadithit preferonin që ta kthente njetin për umre edhe ai që e kishte filluar haxhin “mufrid” ose “karín”,¹⁶³ dhe kështu të përjetonte kënaqësitë e ndaluara për shkak të ihramit, nga përfundimi i umres, deri kur të fillonte haxhin në ditën e tetë. Kjo për arsye se kanë ardhur disa hadithe të sakta që e mbështesin këtë mendim. Për këtë arsye Selemetu ibni Shebib i tha imam Ahmedit: “I ke forcuar zemrat e rrafidijve o ebu Abdil-lah, ngaqë u ke dhënë fetva banorëve të Horasanit për t’u kënaqur në periudhën pas umres dhe para fillimit të haxhit!” Imam Ahmedi i tha: “O Selemeh, mua më vinin lajme që ti je i marrë, por nuk i besoja dhe të mbroja, por tani e vërtetova që ti je me të vërtetë i tillë. Kam njëmbëdhjetë hadithe të sakta nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) në lidhje me këtë çështje, e si mund t’ilëpër

) Qëllimi i këtij shembulli është përforsimi i faktit që çdo gjë e cila ka të bëjë me fenë, duhet të jetë e ¹⁶² argumentuar në Kur’an dhe Sunet.

) “Mufrid” ose “karín” janë dy mënyrat e tjera të kryerjes së haxhit.¹⁶³

mendimin tend!?” Marrë nga “Minhaxhus-Suneh.”

Prandaj ibnul Kajim ka thënë: “Selefët e ndienin shumë të rëndë të kundërshtoheshin argumentet e Kur’anit e të Sunetit me mendimet e njerëzve, dhe nuk e pranonin një gjë të tillë.”

Nga shembujve që vlejné të përmenden në këtë temë është ai që e përcjell Abdullah ibnu Zubejr el Humejdi i cili rrëfen: “Një ditë Imam Shafi'u transmetoi një hadith, kështu që unë i thashë: ‘A i referohesh këtij hadithi për argumentim?’ ‘Mos vallë po më shikon duke dalë nga ndonjë kishë, apo po shikon të kem shtrënguar brez priftërinjsh në mes, - më tha ai, - aq sa kur të dëgjoj një hadith nga i Dërguari i Allahut të mos punoj me të?!’”

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me ibnu Huzejmen, i cili pasi ka transmetuar një hadith i është thënë: “A bazohesh në këtë hadith?” Ibnu Huzejme ia ktheu: “Mos vallë po shikon të kem shtrënguar brez priftërinjsh në mes!? Mos thuaj për hadithin e Profetit ‘a punon me të?’ por thuaj ‘a është i saktë ai?’, sepse kur hadithi vjen i saktë nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), unë e pranoj atë, dua apo nuk dua.”

Nga kjo që sqaruam mësojmë se Kur’ani dhe Suneti janë kriteri me të cilin vlerësohen mendimet dhe “ixhtihadet”. Askush nuk mund të ketë besim të vërtetë, veçse duke i madhëruar argumentet e Kur’anit dhe Sunetit, duke besuar atë që ka ardhur në to, dhe duke zbatuar thëniet e veprat që tregojné për to. Imam Tavaviu e ka përmbledhur metodën e “ehli sunetit” me fjalën e tij: “Nuk mund të bëhet njeriu musliman, veçse përmes nënshtrimit dhe dorëzimit (ndaj asaj që e ka thënë Allahu dhe i Dërguari i Tij). Cilindo që synon të arrijë atë dije që i është ndaluar ta hulumtojë, dhe nuk është i bindur të dorëzohet, ky qëllim do ta pengojë nga Teuhidi i pastër, njohuria e kulluar dhe besimi i saktë.”

El Berbehari në “Sherhus-Suneh” ka thënë: “Nëse e dëgjon personin të flasë kundër haditheve të Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe thënieve e gjurmëve të transmetuara nga selefët, t’i refuzojë ose t’i referohet diçkaje tjetër, atëherë

akuzoje në Islamin e tij, sepse ai është pasues i epshit dhe bidatçi.”

Shejhul islam ibn Tejmije ka thënë: “Prej mirësive më të mëdha që Allahu ia ka bërë “ehli sunetit” është bazimi në Kur’an dhe në Sunet. Prandaj prej parimeve në të cilat janë pajtuar sahabet dhe pasuesit e tyre më të mirë, është që të mos pranohet prej asnjërit të kundërshtojë Kur’anin me mendimin e tij, as me shijen e midenë e tij, as me logjikën e tij, as me kijasin (analogjinë) e tij, dhe as me ndjenjat e preferencat e tij. Kjo sepse argumentet e prera dhe faktet e qarta tregojnë se Profeti (salallahu alejhi ue selem) erdhi me udhëzimin dhe fenë e drejtë, dhe se Kur’ani udhëzon për atë që është më e mirë dhe e përsosur.”

Gjithashtu ai ka thënë: “Ai që i mbështet sqarimet dhe diskutimet lidhur me çështjet e besimit dhe çështjet praktike në Kur’an, Sunet dhe gjurmët e transmetuara nga të parët, e ka qëlluar rrugën e drejtë të Profetit (salallahu alejhi ue selem). Po ashtu edhe ai që i bazon punët e zemrës, të cilat janë themelet dhe burimet e punëve të jashtme, dhe punët e gjymtyrëve në besimin, Sunetin dhe udhëzimin me të cilin erdhi Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) dhe shokët e tij, ai është në rrugën e profecisë.”

3- Mbështetja në hadithet e sakta

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar t’i bindemi të Dërguarit të Tij, Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), në shumë ajete:

“Çdo gjë që t’jua japë i Dërguari merreni atë dhe çdo gjë që ai jua ndalon juve hiqni dorë prej saj.” El Hasher: 7.

“Kushdo që i bindet të Dërguarit ai i është bindur Allahut.” En-Nisa: 80.

“O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për një çështje, parashtrojeni atë tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” En-Nisa: 59.

“Dhe kur u thuhet atyre: ‘Ejani tek ajo që ka shpallur Allahu dhe i Dërguari (Muhamedi (salallahu alejhi ue selem))’, ata thonë: ‘Neve na mjafton ajo që gjetëm e që ndiqnin baballarët tanë’, megjithëse baballarët

e tyre nuk kishin asnjë dije dhe asnjë udhëheqje.” El Maide: 104.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë në hadithin e saktë që ka transmetuar ebu Daudi në “Sunenin” e tij: “Mua më është dhënë Kur’ani dhe së bashku me të edhe një gjë tjetër si ai.”

Çdo gjë që na ka ardhur nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) është e drejtë dhe e vërtetë padyshim. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“As nuk flet ai nga dëshira (e vetë atij). Është vetëm Shpallje që i frymëzohet.” En-Nexhm: 3-4.

Gjithashtu i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kam lënë tek ju dy gjëra, pas të cilave nëse do të kapeni, nuk do të humbni kurrë, Librin e Allahut dhe sunetin tim.” Transmeton Maliku. Albani në “Sahihul xhami” e ka vlerësuar hadithin të saktë.

Suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem) është ai që sqaron Kur’anin, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

“(Ne i çuam të dërguarit) me shenja të qarta dhe me Libra, ndërsa edhe ty (o Muhamed) me përkujtuesin me këshilla (Kur’anin), që ti të mund t’u shpjegosh njerëzve qartë se çfarë u është zbritur atyre dhe që të mund të mendojnë.” En-Nahl: 44.

“Allahu ka përgatitur për ta ndëshkim të ashpër. Kini pra frikë Allahun dhe përmbushni detyrimin ndaj Tij, o njerëz të brymosur me mendje të shëndoshë që keni besuar! Tashmë Allahu me të vërtetë ju ka zbritur juve Përkujtues (Kur’anin). (Ai ju ka çuar edhe) të Dërguar (Muhamedin), i cili ju këndon vargjet e Allahut (Kur’anin) që përmbajnë shtjellime të qarta, me qëllim që Ai të nxjerrë ata që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi nga errësira (e politeizmit, mohimit) në dritë (në besimin e vërtetë islam). Dhe kushdo që beson Allahun dhe punon mirësi dhe drejtësi, Ai do ta shpjerë në kopshtet e Xhenetit nën të cilët rrjedhin lumenj, për të banuar aty përgjithnjë. Allahu vërtet që i ka siguruar atij Rrizkun (furnizimin e mirësinë) më të shkëlqyer.” Et-Talak: 10-11.

Allahu u ka dhuruar mirësi të madhe besimtarëve me dërgimin e të Dërguarit të tij Muhamedit (salallahu alejhi ue selem):

“Vërtet Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe kur Ai çoi ndërmjet tyre një të dërguar (Muhamedin, salallahu alejhi ue selem) nga mesi i tyre, duke ju lexuar atyre Vargjet e Tij (Kur’anin), duke i pastruar ata (nga gjynahet e tyre duke e ndjekur atë) dhe duke u këshilluar atyre Librin (Kur’anin) dhe Hikmetin (urtësinë dhe sunetin e Pejgamberit, rrugën e tij të zbatimit të rregullave të Islamit, fjalët, veprimet e faljes etj.), edhe pse para kësaj ata kanë qenë në gabim (humbje) të qartë.” Ali Imran: 164.

“Ai është i cili çoi mes analfabetëve një të dërguar (Muhamedin, salallahu alejhi ue selem) nga vetë mesi i tyre duke u kënduar atyre Vargjet e Tij, duke i pastruar ata (nga ndyrësitë e mosbesimit dhe politeizmit) dhe duke u mësuar atyre Librin (Kur’anin, Islamin dhe ligjet e tij) dhe Hikmetin. Dhe vërtet që më parë qenë në gabim e humbje të qartë.” El Xhumuah: 2.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) e ka dënuar veprimin e atyre të cilët lenë atë që ka ardhur në sunetin e tij: “Është afruar koha kur një burri të ulur mbi kolltukun e tij, i arrin hadithi im dhe ai thotë: ‘Mes nesh dhe mes jush është libri i Allahut, atë gjë që e gjejmë në të hallall, e konsiderojmë hallall, dhe atë që e gjejmë në të haram, e konsiderojmë haram.’ Nuk ka dyshim se ajo që e bën të ndaluar i Dërguari i Allahut është si ajo që e ka ndaluar Allahu i Lartësuar.”

Prej qëndrimeve të vyera (të shkëlqyeshme) të sahabëve në lidhje me sunetin e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) janë këto që vijojnë:

- Ndërkohë që Imran ibn Husejni ishte i ulur me shokët e tij, njëri prej tyre tha: “Mos na fol veçse me Librin e Allahut.” “Afrohu”, - i tha Imrani, dhe ai u afrua. “Çka mendon ti, sikur të liheshit ti dhe shokët e tu për të marrë çdo sqarim nga Kur’ani? A do të gjeje në të se farzi i drekës është katër rekate, i ikindisë katër rekate dhe i akshamit tri rekate, ku në dy të parat lexohet me zë? Çka mendon sikur të liheshit ti dhe shokët e tu për të marrë çdo sqarim në

Librin e Allahut? A do të gjenit në të se tavafi rreth Kabes është shtatë herë, dhe a do të gjeje në të ‘sa’jin’ (angazhimin, ecjen) ndërmjet Safasë dhe Mervas?” Pastaj vazhdoi e u tha: “O njerëz, merrni prej nesh, sepse betohem në Allahun, në qoftë se nuk do të merrni prej nesh do të humbni.”

- Abdullah ibn Mes’ud ka thënë: “Allahu i mallkoftë ato gra që bëjnë tatuazhe dhe ato që kërkojnë t’u bëhet tatuazhi, ato që i shkulin qimet e fytyrës (vetullat) dhe ato që i mprehin dhëmbët (që i ndajnë dhëmbët) për bukuri, të cilat ndryshojnë natyrën e krijesave që i ka krijuar Allahu.” Këto fjalë i mbërritën një gruajë nga fisi benu Esed, pseudonimi i së cilës ishte umu Ja’kub. Kështu që erdhi te Abdullahi dhe i tha atij: “Jam lajmëruar se ti ke mallkuar kështu e kështu.”

“E pse të mos i mallkoj ato që i ka mallkuar i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dhe kjo gjendet edhe në Librin e Allahut?”, - i tha ibnu Mes’udi.

“E kam lexuar të gjithë Kur’anin dhe nuk e kam gjetur një gjë të tillë në të”, - tha ajo.

“Nëse e ke lexuar, patjetër që e ke gjetur, - ia ktheu ai, - a nuk e ke lexuar fjalën e Allahut: **‘Çdo gjë që t’jua japë i Dërguari merreni dhe çdo gjë që ai jua ndalon hiqni dorë prej saj’** (El Hasher: 7)?”

“Po, kjo gjendet në Kur’an”, - i tha ajo. “Përderisa kjo është në Kur’an, atëherë Profeti (salallahu alejhi ue selem) i ka ndaluar këto gjëra”, - i tha ibnu Mes’udi. “Por bashkëshortja jote e bën këtë”, - tha ajo.

“Shko dhe shikoje”, - i tha ai.

Kështu ajo shkoi, e pa dhe nuk vuri re asgjë. Atëherë ibn Mes’udi tha: “Sikur ajo ta bënte këtë, unë nuk do të kryeja marrëdhënie intime me të.”

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Prandaj ibnu Tejmije ka thënë: “Sqarimi më i plotë dhe i përkryer është ai që ka bërë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), sepse ai është më i dituri i krijesave rreth së vërtetës, dhe këshilluesi më i sinqertë ndaj tyre, gojëtari dhe elokuenti më i aftë për sqarimin e saj. Kështu që sqarimi që i ka

bërë emrave të Allahut, cilësive të Tij, lartësisë së Tij dhe shikimit tek Ai (nga besimtarët), ka arritur kulminacionin e mundshëm për sa i përket kësaj teme.” (Marrë nga “Minhaxhus-Sunneh”)

Gjithashtu ka thënë: “Shpërblimi arrihet duke vepruar atë që e ka sjellë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem). Ndihma dhe fitorja do të jenë për atë që e ndihmon atë. Lumturia do të jetë për atë që e ndjek atë. Salavatet e Allahut dhe të melaikeve do të jenë mbi ata që besojnë në të dhe u mësojnë njerëzve fenë e tij.¹⁶⁴ E vërteta sillet rreth tij ngado që ai të rrotullohet. Më i dituri i krijesave rreth së vërtetës dhe pasuesi më i përkushtuar i saj, është ai që e di më shumë sunetin e tij dhe që e ndjek më shumë atë. Çdo thënie (mendim) që kundërshton thënien e tij, është ose çështje fetare e abroguar, ose diçka e ndryshuar në fe, e cila asnjëherë nuk ka qenë e ligjshme.” (Marrë nga “Minhaxhus-Sunneh”.)

Meqenëse suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem) ka këtë gradë kaq të lartë, “ehli suneti” është interesuar shumë për mësimin dhe praktikimin e tij. Ai u interesua për mbrojtjen, mësimin e tij përmendësh dhe transmetimin e tij, për studimin dhe shqyrtimin e hollësishëm të tij, si dhe për dallimin e Sunetit të vërtetë nga i pavërteti, sidomos pas shfaqjes së trazirave, daljes së bidatçinjve dhe përhapjes së gënjeshtërisë. Atëherë vëmendja e selefëve për Sunetin u shtua më shumë. Prandaj Abdullah ibn Abasi ka thënë: “Një herë e një kohë, kur ne e dëgjonim një burrë duke thënë: ‘Ka thënë i Dërguari i Allahut’, me shpejtësi i përqëndronim shikimet tek ai dhe e dëgjonim me vëmendje të madhe, por pasi njerëzit filluan të bënin çdo lloj gjëje, të thoshin të saktën e të pasaktën, dhe të ndërmerrnin çfardolloj mënyre e rruge (si shpifje, gënjeshtër, bidate e tjerë) për t’i realizuar, atëherë nuk merrnim prej askujt, përveç atij që e njihnim.”

Trasmeton Muslimi në parathënien e “Sahihut” të tij.

Dijetari i madh Muhamed ibn Sirin ka thënë: “Njerëzit e interesuar për të

) Salavatet e Allahut për krijesat, janë lavdërimi i tyre të melaikeve, falja e gjynaheve të tyre dhe mëshirimi i tyre.¹⁶⁴ Kurse salavatet e melaikeve mbi besimtarët janë kërkimi i faljes dhe mëshirës për ta.

mësuar e transmetuar hadithet, fillimisht nuk pyesnin për ‘isnadin’ (zinxhirin, vargun e transmetuesve), por kur ndodhën trazirat thanë: ‘Na i thoni burrat (transmetuesit) tuaj, në mënyrë që të merret vesh kush është i ‘ehli sunetit’ dhe të merret hadithi i tij, dhe kush është bidaçi që të mos merret hadithi i tij’.” Transmeton Muslimi në parathënien e “Sahihut” të tij.

Imam Malik ibn Enes ka thënë: “Kjo dije është gjaku yt dhe mishi yt, për të do të pyetesh Ditën e Gjykimit, prandaj shiko nga cili po e merr.”

Ibnu Tejmije e sqaron arsyen e studimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: “Ndërmjet nesh dhe Profetit janë qindra vite. Domosdoshmërisht dihet që në ato që i përcjellin njerëzit prej tij ka të vërteta dhe gënjeshtër. Është transmetuar nga Profeti se ai ka thënë: ‘Do të gënjehet rreth meje.’ Nëse ky hadith është i vërtetë, patjetër do të gënjehet rreth tij, dhe nëse është gënjeshtër, ai është fakt që është gënjer. Meqenëse është kështu, atëherë nuk i lejohet asnjërit të bazohet në një hadith derisa të sqarojë atë që e bën të pranueshëm e të vlefshëm për t’u mbështetur në të (d.m.th. të provojë vlefshmërinë e hadithit për argumentim, sipas rregullave dhe parimeve të vendosura nga dijetarët e kësaj fushe).”

Dijetarët e hadithit kanë projektuar një metodë shkencore të qartë për rregullimin e parimeve të transmetimit dhe vendosjen e bazave të tij. Kështu e kanë mbrojtur Sunetin nga kotësitë dhe fallsifikimi. Prandaj ne u referohemi atyre për të njohur hadithin e saktë dhe hadithin e dobët. Ibnu Tejmije ka thënë: “Në ato që janë transmetuar ka shumë gjëra të vërteta dhe ka shumë gënjeshtër. Për të dalluar të vërtetën nga gënjeshtër u referohemi dijetarëve të hadithit, sikurse u referohemi gjuhëtarëve, për të dalluar gramatikën arabe nga ajo joarabe, për të dalluar atë që është prej gjuhës nga ajo që nuk është prej saj. Po kështu edhe dijetarëve të poezisë, mjekësisë etj. Çdo dije ka njerëzit e saj të njohur. Ndër të gjithë këta, dijetarët e hadithit janë më të nderuarit, më të vërtetët, më të lartët në pozitë dhe më të devotshmit. Ata janë ndër njerëzit më të vërtetë, më të besueshëm, më të ditur dhe më me përvojë, për sa i përket asaj

që e përmendin në lidhje me ‘xherhin’ dhe ‘ta’dilin’,¹⁶⁵ si Maliku, Shu’ëbe, Sufjani... .” (Marrë nga “Minhaxhus-Sunneh”.)

Nga e gjithë kjo që sqaruar, mësojmë se argumentimi i saktë shkencor, mbështetet në hadithet e sakta dhe të mira, ndërsa me hadithet e trilluara dhe të dobëta nuk lejohet argumentimi dhe është detyrë të paralajmërojmë për t’u ruajtur prej tyre. Prandaj Abdullah ibnul Mubarek ka thënë: “Bazimi në hadithet e sakta të preokupon për të mos u marrë me hadithet e dobëta (d.m.th. mbështetja në hadithet e sakta e bën të panevojshme dhe të palejueshme të bazohesh në hadithet e dobëta).”

Jahja ibn Said el Kattan ka thënë: “Mos shikoni tek hadithi, por shikoni tek ‘isnadi’. Nëse ai është i vërtetë pranojeni hadithin, ndryshe mos u mashtroni me hadithin përderisa nuk është i saktë ‘isnadi’ i tij.”

Ibnu Kudame ka thënë: “Përsa i përket haditheve të trilluara të cilat i kanë shpifur zindikët, për t’ua errësuar e përzierë fenë muslimanëve, ose haditheve të dobëta, për shkat të dobësisë së transmetuesve, për shkak të të qenët e tyre të panjohur, ose për defekte të tjera, nuk lejohet të bazohesh në to dhe as të besosh atë që e përmbajnë, madje ekzistenca e tyre është njësoj si mosekzistenca.”

Shejhul islam ibn Tejmije ka thënë: “Është detyrë të bëhet dallimi mes hadithit të vërtetë dhe hadithit të rremë, sepse suneti i Profetit është e vërteta dhe jo e pavërteta. E vërteta janë hadithet e sakta dhe jo të trilluarat. Ky është një parim i madh te muslimanët në përgjithësi, dhe tek ata që pretendojnë ndjekjen e Sunetit në veçanti.”

Gjithashtu ai ka thënë: “Me pajtim të të gjithë dijetarëve, nuk lejohet bazimi në gjëra që nuk njihet saktësia e tyre, sepse kjo do të thotë të flasësh pa dije, gjë e cila është e ndaluar, bazuar në Kur’an, Sunet dhe ‘ixhmain’ e dijetarëve.”

Parimi i dytë. Mbështetja në hadithet e sakta

) Xherhi është përmendja e transmetuesit me një cilësi që obligon mospranimin e transmetimit të tij. Kurse ¹⁶⁵ ‘ta’dili’ është përmendja e transmetuesit me një cilësi që obligon pranimin e transmetimit të tij.

Dijetarët janë pajtuar se nuk lejohet bazimi në hadithet e dobëta për evidentimin dhe pohimin (konfirmimin) e rregullave, gjykimeve dhe vendimeve të Sheriatit, për gjërat që janë “vaxhib” (të detyrueshme), “mustehab” (të pëlqyeshme), “mekruh” (të papëlqyeshme), haram, kontrata të vlefshme, të pavlefshme etj. Për të argumentuar gjëra të tilla vlejné veçse hadithet e vërteta ose të mira. Ibnu Tejmije ka thënë: “Për pohimin e çështjeve të Sheriatit, nuk lejohet të bazohesh në hadithe të dobëta, të cilat nuk janë as të sakta dhe as të mira, por Ahmed ibni Hanbel e të tjerë dijetarë, e lejuan të transmetohen, lidhur me mirësitë dhe epërsitë e punëve të mira, hadithe që nuk dihet se janë të sakta, përderisa nuk është faktuar që janë të rreme. Kjo, sepse kur mësohet që puna është e ligjshme me argument fetar të vlefshëm, dhe në lidhje me mirësinë (shpërblimin) e tij transmetohet një hadith që nuk është faktuar se është i rremë, atëherë shpërblimi i përmendur në të mund të jetë i vërtetë. Asnjëri prej dijetarëve nuk ka thënë që të bëhet diçka e detyrueshme ose e pëlqyeshme, bazuar në një hadith të dobët. Ai që e thotë këtë ka kundërshtuar ‘ixhmain’.” Pastaj ka shtuar e ka thënë: “Ahmed ibn Hanbel e të tjerë dijetarë si puna e tij, nuk bazoheshin në hadithe të tilla për t’u dhënë gjykim çështjeve fetare. Ai që ka përcjellë se Ahmedi bazohej në hadith të dobët që nuk është as i saktë dhe as i mirë, ka gabuar...”

Ndërsa për sa i përket përfitimit prej haditheve të dobëta, të cilët përmendin mirësi e shpërblime që ngjallin interesin për veprimin e punëve të mira, dijetarët nuk janë pajtuar. Por, mendimi më i saktë është që të mos përfitohet asgjë prej haditheve të dobëta, qoftë edhe për mirësitë e shpërblimet, të cilat ngjallin interesin për veprimin e punëve të mira, apo për frikësimin e punuesit të punëve të këqija. Ky është mendimi i shumë dijetarëve si ibn Mu’ini, Buhariu, Muslimi e të tjerë.

Dijetarët që e kanë lejuar përfitimin prej haditheve të dobëta në mirësitë dhe shpërblimin e punëve të mira kanë vendosur tri kushte:

1- Të mos jetë dobësia e hadithit shumë e madhe.

Me këtë kusht përjashtohen hadithet që përcillen nga gënjeshtarët, nga ata që akuzohen për gënjeshtëri dhe ata që bëjnë gabime fatale e të rënda në transmetimet e tyre.

2- Puna për të cilën tregon hadithi të përfshihet nën një bazë të përgjithshme. Kështu përjashtohen gjërat për të cilat nuk dëshmon asnjë bazë.

3- Të mos besohet se është i saktë, kur punon apo përfiton prej tij.

Pra, duhet të besohet se është hadith i dobët. Kjo në mënyrë që të mos i mvishet Profetit (salallahu alejhi ue selem) ajo që nuk e ka thënë.

Në lidhje me këtë mendim të këtyre dijetarëve dhe kushtet që kanë vendosur duhet të bëjmë tri sqarime:

a) Kushti i parë tregon se çdonjëri e ka detyrë ta njohë gradën e hadithit me të cilin do të punojë, në mënyrë që të mos bazohet në të, në rastin kur është shumë i dobët. Njohja e gradës së çdo hadithi dhe njohja e çdo hadithi të dobët me të cilin duan të punojnë, është e vështirë për shumicën dërrmuese të njerëzve, sepse dijetarët e hadithit, të cilët nuk u flasin njerëzve veçse me hadithe të sakta dhe i paralajmërojnë njerëzit nga hadithet e dobëta, janë të paktë, sidomos në këtë kohë. Prandaj ata që janë të dhënë pas punimit me hadithe të dobëta, e kundërshtojnë këtë kusht haptazi. Pothuajse sa herë që ndonjëri prej tyre, qoftë edhe dijetar në fusha të tjera veç hadithit, mëson një hadith të dobët, shpejton të punojë me të pa e ditur, dhe kur i tërheq vëmendjen ndonjëri rreth dobësisë së hadithit, menjëherë përmend si mbështetje rregullin e tij të pretenduar se “punohet me një hadith të dobët në mirësitë dhe shpërblimin e punëve të mira”. Por nëse do t’i përmendet ky kusht, hesht dhe nuk thotë asgjë. Për këtë po përmendim vetëm një shembull, i cili dëshmon për metodën e tyre në mosrespektimin e këtij kushti.

Ebul Hasenat el Eknevi përcjell në librin e tij “El exhvibeh” nga dijetari i nderuar Elkari se ai ka thënë për hadithin: “Dita më e mirë është Dita e Arafatit, nëse përkon me ditën e xhuma. Ajo është më e mirë se 70 haxhe”: “Këtë hadith

e transmeton Rruzejni. Ajo që e kanë përmendur disa dijetarë të hadithit lidhur me ‘senedin’ e tij, pra që është i dobët, edhe sikur të jetë konsideratë e saktë, nuk e dëmton synimin e hadithit, sepse hadithi i dobët është i konsiderueshëm në mirësitë dhe shpërblimet e punëve të mira.” El Eknevi pasi e ka përmendur thënien e tij, e ka konfirmuar.

Lidhur me konkluzionin që kanë nxjerrë këta dy dijetarë, shejh Albani thotë: “Lexues i nderuar! Vëre se si nuk e kanë respektuar këta dy dijetarë të nderuar rregullin e lartpërmendur. Medoemos që ata nuk e kanë lexuar ‘senedin’ e këtij hadithi dhe nuk kanë mësuar gjë për të, se ndryshe do ta sqaronin gradën e tij dhe nuk do t’i kundërpërgjigjeshin pretendimit se është i dobët duke polemizuar me fjalët e tyre: ‘edhe sikur të merrej si e saktë thënia që hadithi është i dobët’! E si mund të jetë i saktë përfundimi i tyre, ndërkohë që dijetari i madh e i njohur për thëniet e tij të vërteta, ibnul Kajim el Xheuzije në “Zadul mead”, për këtë hadith ka thënë: ‘I pavlefshëm e i pavërtetë. Nuk është përcjellë me ‘sened’ as nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), as nga sahabët dhe as nga tabiinët’.”

Pas kësaj shejh Albani ka dalë në përfundimin se respektimi i këtij kushti në praktikë, do të çojë në lënien e haditheve që nuk evidentohen si të sakta apo të mira, për arsye se njohja e dobësisë së theksuar të një hadithi është e vështirë për shumicën e njerëzve. Pra, rezultati i respektimit të këtij kushti, bën që ky mendim të përputhet (praktikisht) me mendimin që kemi zgjedhur (d.m.th. mospranimin në mënyrë absolute të hadithit të dobët).

b) Kushti i dytë tregon se faktikisht, praktikimi i punës së mirë nuk është bazuar në hadith të dobët, por në bazën e përgjithshme (d.m.th. në ajet kuranor dhe hadith të vërtetë e të mirë), kështu që praktikimi i kësaj pune është i argumentuar, ekziston hadithi i dobët apo nuk ekziston. Ndërsa puna që është transmetuar vetëm me hadith të dobët, nuk mund të jetë e argumentuar dhe nuk lejohet të praktikohet nëse nuk është e mbështetur në bazë të përgjithshme. Me këtë kusht, punimi me hadith të dobët mbetet një gjë formale dhe joreale. Këtu

duhet bërë e qartë se, si kushtin e parë, po ashtu edhe këtë kusht, nuk e kanë respektuar sepse kanë vlerësuar shumë punë si të pëlqyeshme e të mira, megjithëse janë transmetuar vetëm në hadithe të dobëta dhe nuk ka një bazë që dëshmon për to. Madje ndonjëherë mendimi i tyre me pretekstin e bazimit në këtë rregull, bie ndesh me të dy kushtet e sapopërmendura, ngaqë hadithi në të cilin mbështeten është shumë i dobët ose i trilluar dhe nuk ka argument të saktë që dëshmon për punën që përmban, si p.sh. hadithi që nxit për namazin “ragaib”.

c) Kushti i tretë pajtohet me kushtin e parë për domosdoshmërinë e njohjes së dobësisë së hadithit, në mënyrë që të mos besohet se është i saktë. Nga ajo që sqaruar mëson se shumica dërrmuese e atyre që punojnë në mirësitë e punëve të mira me hadithe të dobëta, nuk e dinë që janë të tillë.

Si përfundim, i këshillojmë të gjithë vëllezërit muslimanë të mos punojnë me hadithe të dobëta në mënyrë absolute dhe t’i përkushtohen praktikimit të asaj që ka ardhur në hadithe të sakta nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), sepse në to ka punë që janë të mjaftueshme dhe e bëjnë të panevojshëm të punuarit me këto hadithe. Nëse do të bazohemi vetëm në hadithe të sakta e të mira, kjo do të na mbrojë nga gënjeshtria ndaj të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), sepse nga përvoja kemi mësuar se ata që na kundërshtojnë në këtë çështje kanë rënë në gënjeshtër (qoftë edhe padashje), ngaqë punojnë me çfardolloj hadithi. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka folur për këtë në thënien e tij: “I mjafton njeriut prej gënjeshtres që të flasë çdo gjë që e dëgjon.” Transmeton Muslimi në parathënien e “Sahihut” të tij.

Parimi i tretë. Perceptimi i drejtë i teksteve të Kur’anit dhe Sunetit

Perceptimi i drejtë i teksteve fetare është një ndër bazat kryesore të referimit të vlefshëm e të vërtetë. Njeriu nuk mund të njohë qëllimin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem), veçse nëpërmjet kuptimit të drejtë të

argumenteve të Kur'anit dhe Sunetit. Shumë bidate janë shpikur për shkak të keqkuptimit dhe keqinterpretimit. Umer ibnul Hattabi i dërgoi një letër ebu Musa el Esh'ariut, në të cilën ndër të tjera i shkruante: “Pastaj interesohu të kuptosh e të perceptosh drejt çështjet që të parashtrihen, gjykimi i të cilave nuk është përmendur as në Kur'an e as në Sunet, bëj analogji (krahasim) mes gjërave, mësoji shembujt e ngjashëm me çështjet që të paraqiten, pastaj gjyko sipas asaj që e vëren më të dashur te Allahu dhe më të ngjashme me të vërtetën.” “Sunen Darelkutni”, “Sunen el Bejhaki”. Albani thotë se transmetimi është i saktë.

Ibnul Kajim ka thënë: “Perceptimi i drejtë e i saktë dhe qëllimi i mirë janë prej mirësive më të mëdha me të cilat Allahu ka begatuar robin e tij. Madje pas mirësisë së Islamit, asnjë robi nuk i është dhënë mirësi më e madhe se këto të dyja. Ato janë dy boshtet e Islamit, prej të cilëve varet përfytyrimi i drejtë i kësaj feje dhe të cilat e sigurojnë robin që të mos jetë në rrugën e atyre, qëllimi i të cilëve ka qenë i keq e me të cilët Zoti është i hidhëruar, dhe as në rrugën e të humburve, të cilët devijuan në botëkuptimet dhe përfytyrimet e tyre. Përmes këtyre dy mirësive, robi bëhet prej atyre që Allahu i ka begatuar me mirësitë e Tij dhe të cilët kanë botëkuptime e qëllime të mira e të drejta. Këta janë ata, të udhëzuarit në rrugën e drejtë, dhe jemi urdhëruar t'i kërkojmë Allahut në çdo namaz që të na udhëzojë në rrugën e tyre. Perceptimi i drejtë është një dritë që Allahu e hedh në zemrën e robit, e nëpërmjet së cilës ky i fundit bën dallimin mes të saktës dhe të pasaktës, të vërtetës dhe të pavërtetës, udhëzimit dhe humbjes, orientimit dhe devijimit. Robin në këtë drejtim e fuqizon dhe e ndihmon qëllimi i mirë, përpjekja për të qëlluar të vërtetën dhe frika prej Zotit në fshehtësi e në publik, por e ndërpret dhe e shmang ndjekja e epshit, parapëlqimi i jetës së kësaj bote, kërkimi i lëvdatave të njerëzve dhe mospasja frikë prej Allahut.”

Parimet e perceptimit të teksteve fetare dhe studimit të tyre

Në mënyrë që interpretimi i teksteve të Sheriatit dhe deduktimi e përfitimi i rregullave, ligjeve e normave prej tyre të jetë i drejtë e i saktë, është detyrë që perceptimi dhe studimi i tyre të mbështetet në parimet që vijnë:

1. Mbështetja në metodën e sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre.

Sahabët kanë një gradë të lartë sepse Allahu i ka nderuar, i ka lavdëruar, i ka lartësuar pozitat e tyre, i ka ngritur vlerat e gradat e tyre dhe i ka cilësuar të drejtë, që prej shtatë qiejve:

“Me ata të cilët të parët përquafuan Islamin nga Muhaxhirunët (besimtarët që u shpërngulën nga Meka në Medine) dhe Ansarët (besimtarët e Medinës që i strehuan dhe i ndihmuan ata), si dhe ata që i ndoqën besnikërisht ata (në besim), me këta Allahu është mjaft i kënaqur dhe ata janë më se të kënaqur me Të. Ai ka përgatitur për ta Kopshte të Begatë nën të cilët rrjedhin lumenj, për të banuar atje ngaherë. Ky është ngadhënjimi madhështor.” Et-Teube: 100.

“Muhamedi është i Dërguari i Allahut dhe ata që janë me të janë të ashpër ndaj mohuesve (të Allahut) dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre. I sheh ata të përkulen (në Ruku) dhe të lëshohen me fytyrë në tokë (në sexhde kur i falen Allahut), duke kërkuar Begati nga Allahu dhe Kënaqësinë e Tij. Shenja e tyre (e besimit të tyre) është në fytyrat e tyre nga gjurmët e sexhdes (gjatë faljes). Ky është përshkrimi i tyre në Teurat, ndërsa shembulli i tyre në Inxhil përshkruhet si një farë (e mbjellë) e cila lëshon lastarin, pastaj e forcon atë dhe ai qëndron vetë në trungun e vet duke i mrekulluar mbjellësit, që Ai t’i tërbojë mosbesimtarët me anë të atyre nga mesi i tyre të cilët besojnë (të gjithë ata që besojnë në Njëshmërinë e Allahut, në të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s. dhe e ndjekin Fenë e Allahut, Islamin, deri në Ditën e Fundit) dhe punojnë mirësi e drejtësi (sipas këtij besimi) falje dhe shpërblim tepër të madh (Kopshte të begatë të Xhenetit të pafund).” El Fet’h: 29.

Gjithashtu në Kur'an Ai ka lajmëruar se është i kënaqur prej tyre dhe se e di që në zemrat e tyre kanë qëllime të mira, të pastra e të drejta:

“Sigurisht që Allahu ishte i kënaqur me besimtarët kur ata të dhanë besën ty (Muhamed a.s.) nën pemë. Ai e dinte mirë çfarë kishte në zemrat e tyre, pra Ai zbriti es-Sekineh (butësinë, gjakftohtësinë e qetësinë) mbi ta dhe Ai i shpërbleu ata me një fitore të afërt.” El Fet'h: 18.

“Ehli sune uel xhemaah” respektojnë metodën e sahabëve në kuptimin dhe interpretimin e Kur'anit dhe Sunetit, sepse ata jetuan me Profetin (salallahu alejhi ue selem), e dëgjuan atë dhe ishin të pranishëm kur zbriste shpallja. Profeti (salallahu alejhi ue selem) u përcillte atyre shpalljen dhe ua komentonte atë. Ata e kanë njohur mirë gjuhën arabe, synimet e Sheriatit dhe shkaqet e zbritjes së ajeteve të Kur'anit. Për të gjitha këto arsye, ata sigurisht i dinë më mirë sesa gjeneratat e ardhëshme domethëniet e Kur'anit, Sunetit dhe synimet e Sheriatit. Prandaj Abdullah ibnu Mesudi ka thënë: “Kushdo që të marrë për shembull dikë, le të marrë për shembull shokët e Muhamedit (salallahu alejhi ue selem). Ata kanë qenë njerëzit me zemrat më të mira, më të devotshme e më të pastra të këtij Umeti, kanë pasur dijen më të thellë, nuk shtireshin dhe nuk i trillonin gjërat, kanë qenë në udhëzimin më të drejtë dhe në gjendjen më të mirë. Ata janë njerëzit që Allahu i zgjodhi për të shoqëruar Profetin e Tij (salallahu alejhi ue selem), kështu që mësojeni, vlerësojeni epërsinë e tyre dhe pasojini gjurmët e tyre, sepse ata vërtet kanë qenë në udhëzimin e drejtë.” (Ibnul Abdil Berr në “Xhamiu bejanil ilmi”)

Metoda e sahabëve në perceptimin, interpretimin dhe praktikimin e Kur'anit dhe Sunetit është rruga e vetme për të qëlluar të vërtetën mes ideve, mendimeve, interpretimeve, rrymave e rrugëve të ndryshme të cilat qarkullojnë mes muslimanëve. Ajo është e vetmja që të çon në shpëtim:

“Kush kundërshton të Dërguarin pasi i është bërë i qartë udhëzimi dhe ndjek një rrugë tjetër e jo rrugën e besimtarëve (sahabëve), Ne do ta mbajmë atë në atë rrugë që ai ka zgjedhur për veten e tij, do ta djegim në

zjarrin e xhehenemit, dhe sa përfundim i keq është ky.” En-Nisa: 115.

Rruga e besimtarëve që Allahu e ka cilësuar si të vetmen mënyrë për t’i shpëtuar zjarrit të xhehenemit, është rruga e sahabëve, ndërsa ata që kundërshtojnë të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem) dhe ndjekin rrugë e interpretime të tjera, janë të kërcënuar me djegie në zjarrin e tij.

Për këtë tregon edhe hadithi që e ka transmetuar Abdullah ibn Amr, i cili thotë se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Do të shfaqen në Umetin tim ato veprime që u shfaqën te çifutët. Ata do të ecin me veprimet e tyre paralel me atë që e bënë beni israilët, aq sa nëse ka pasur mes beni israilëve të tillë që u vinin nënave të tyre haptasi, do të ketë në Umetin tim që do të veprojnë në këtë mënyrë. Vërtet beni israilët u përçanë në 72 grupe dhe ky Umet do të përçahet në 73 grupe, të gjithë do të jenë në zjarr, përveç njërit.” Sahabët e pyetën: “Kush është ky grup o i Dërguari i Allahut (na e përshkruaj neve atë)?” Profeti u tha: “Janë ata të cilët e zbatojnë Islamin kështu si unë dhe shokët e mi.” Transmeton Tirmidhiu dhe Albani thotë se hadithi është hasen.

Në këtë hadith përmendet qartë se grupi i shpëtuar janë ata të cilët e praktikojnë dhe e kuptojnë Islamin ashtu si Profeti (salallahu alejhi ue selem) dhe shokët e tij. Prandaj duhet ta perceptojmë, ta interpretojmë dhe ta praktikojmë Kur’anin dhe Sunetin ashtu si shokët e Profetit (salallahu alejhi ue selem) e jo sipas logjikës së devijuar, epsheve dhe mendimeve, shijeve e medhhebeve të ndryshme, të cilët bien ndesh me ta, siç veprojnë bidatçinjtë, sepse rruga e drejtë dhe e shpëtimit, është të mos i tejkalojmë domethëniet që sahabët ia kanë dhënë Kur’anit dhe Sunetit.

Në vijim do të përmendim disa thënie të dijetarëve, të cilat dëshmojnë se duhet të ndjekim “menhexhin” (metodën) e sahabëve në perceptimin, studimin dhe interpretimin e Kur’anit dhe Sunetit.

Ibnu Hazmi ka thënë: “Për ata, të cilët Allahu na ka lajmëruar se është i kënaqur ndaj tyre, e di atë çfarë gjendet në zemrat e tyre dhe se e ka zbritur qetësinë mbi ta, në asnjë mënyrë nuk është e lejuar që të dyshojmë në çështjen

dhe gjendjen e tyre (besueshmërinë, korrektësinë, sinqeritetin etj.)” Këto fjalë që i ka thënë për sahabët, ibnu Hazmi i ka përfituar nga fjala e Allahut:

“Vërtet Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore.” El Fet’h: 18.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Në çështjet e Akides, muslimanët kanë nevojë të njohin dy gjëra:

E para, të njohin qëllimin e fjalëve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Kjo bëhet duke njohur domethëniet e tyre në gjuhën arabe dhe me njohjen e komentit që i kanë bërë sahabët, tabiinët dhe mbarë dijetarët e Islamit që kanë ardhur më pas. Kjo sepse i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), kur u foli sahabëve me Kur’anin dhe Sunetin, ua ka bërë të njohur domethënien e tyre, dhe prandaj ata i njohën dhe i mësuan domethëniet e ajeteve dhe haditheve në mënyrë të plotë dhe të përkryer, siç mësuan përmendësh tekstet e ajeteve dhe haditheve. Po kështu përcjellja e domethënieve të ajeteve dhe haditheve tek tabiinët nga ana e tyre, ka qenë madhështore dhe më e përkryer se përcjellja e shkronjave dhe fjalëve.” (“Mexhmuel fetaua”)

Gjithashtu ka thënë: “Kush e komenton dhe e interpreton Kur’anin dhe hadithin në kundërshtim me tefsirin (komentin) e njohur nga sahabët dhe tabiinët, është shpifës (gënjeshtar) ndaj Allahut, devijues i fakteve, argumenteve dhe ajeteve të Allahut dhe keqinterpretues i fjalëve të Tij. Kjo padyshim i hap rrugën kufrit, devijimit dhe rrënimit të parimeve e realiteteve të fesë, gjë e cila njihet domosdoshmërisht se është e pavlefshme dhe e pavërtetë në fenë islame.” (“Mexhmuurr-rresail el munirije”)

Po kështu ka thënë: “Kush kundërshton thënien e tyre dhe e komenton Kur’anin ndryshe nga tefsiri i tyre, ka gabuar në argumentin që ka sjellë dhe në mendimin që ka synuar ta mbështesë me të.” (“Et-tefsirul kebir”)

Ibnu Rexheb el Hanbeli ka thënë: “Dija e dobishme prej të gjitha këtyre

njohurive është mësimi i teksteve të Kur'anit dhe Sunetit, si dhe kuptimi i domethënive të tyre duke u bazuar në atë që është transmetuar nga sahabët, tabiinët dhe pasuesit e tyre. Gjithashtu të konsiderohet e mjaftueshme ajo që është transmetuar prej tyre lidhur me çështjet e hallallit dhe haramit, asketizmit, njohurive që zbusin zemrën e të tjera. Pastaj të bëhet përpjekje për të dalluar të vërtetën nga e pavërteta së pari, dhe së dyti të njihen domethëniet e të kuptohen mirë. Këto njohuri fetare janë të mjaftueshme për atë që logjikon dhe interesohet të marrë dije të dobishme e të preokupohet me të.” (“Fadlu ilmis-selefi alel khalefi”)

Esh-Shatibi ka thënë: “Prandaj selefët e mirë të këtij Umeti, në të cilët përfshihen sahabët, tabiinët dhe ata që i kanë pasuar ata, ishin më të diturit rreth Kur'anit dhe njohurive të tij...” (“El muvafakat”)

Ibnu Abdil Hadi ka thënë: “Nuk lejohet të shpikësh për ndonjë ajet ose hadith, një koment ose interpretim që nuk ka ekzistuar në kohën e selefëve dhe ata nuk e kanë njohur dhe nuk ia kanë sqaruar Umetit, sepse kjo nënkupton se ata nuk e kanë njohur të vërtetën dhe kanë devijuar prej saj, ndërkohë që është udhëzuar dhe e ka qëlluar ky kundërshtar i mëvonshëm!” (“Es-sarimul munki”)

2. Njohja e gjuhës arabe.

Që të kuptosh argumentet e Kur'anit dhe Sunetit në mënyrë të saktë, patjetër duhet të njohësh gjuhën arabe në të cilën ka zbritur Kur'ani fisnik dhe me të cilën Profeti (salallahu alejhi ue selem) u foli shokëve të tij. Prandaj interesimi i dijetarëve të Umetit dhe prijësve të tij për gjuhën e Kur'anit ka qenë shumë i madh, me qëllim që tekstet e Sheriatit të kuptohen ashtu siç duhet. Umer ibnul Hattabi çonte shkresa anembanë territorit të halifatit që njerëzit të mësonin Sunetin, rregullat e trashëgimisë dhe rregullat e gjuhës arabe, ashtu siç mësonin Kur'anin. (“Xhamiu bejanil ilmi”)

Imam esh-Shafi'i, në librin e tij “Er-Risale” ka theksuar domosdoshmërinë e njohjes së mirë të gjuhës arabe për të kuptuar Kur'anin dhe Sunetin.

Ibn Tejmije ka thënë: “Njohja e gjuhës arabe me të cilën na është

komunikuar feja, është prej gjërave që të ndihmojnë për ta kuptuar fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Po kështu edhe njohja e semantikës së fjalëve, sepse në përgjithësi humbja e bidatçinjve ka lindur për këtë shkak, ngaqë ata i jepnin fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij atë kuptim që pretendonin, megjithëse nuk ishte i vërtetë.” (“Mexhmuul fetaua”)

Esh-Shatibi ka thënë: “Qëllimi është të sqarojmë se Kur’ani ka zbritur në gjuhën arabe, kështu që kuptimi i tij mund të arrihet vetëm nëpërmjet kësaj gjuhe:

‘Nuk ka dyshim që Ne e zbritëm Kur’anin në gjuhën arabe me qëllim që ju të kuptoni.’ Jusuf: 3.

‘Sigurisht që ky (Kur’ani) është shpallje nga Zoti i Aleminit (i gjithësisë, Zoti i njerëzve dhe i xhindëve), të cilin Ruh (meleku Xhibril) i besueshëm e ka zbritur në zemrën tënde (o Muhamed) që të mund të jesh prej këshilluesve, (i zbritur) në gjuhën arabe të qartë.’ Shuara: 192-195.

‘Ne vërtet e dimë se mosbesimtarët thonë: ‘Atë (Muhamedin) vetëm se e mëson ndonjë njeri i mençur. Gjuha e atij njeriu të cilit ata i referohen, është krejt e huaj, ndërsa ky (Kur’ani) është gjuhë arabe e qartë.’ En-Nahl: 103.

Ka dhe plot argumente të tjera të cilat tregojnë se Kur’ani është arabisht, në gjuhën arabe dhe jo në ndonjë gjuhë të huaj, prandaj për atë që kërkon ta kuptojë, mënyra e vetme është arabishtja. Nuk ka rrugë tjetër për ta kuptuar përveç kësaj gjuhe.” (“El muvafekat”)

Këtu është një çështje shumë e rëndësishme të cilën duhet ta kemi parasysh. Argumentet dhe treguesit fetarë i kufizojnë domethëniet gjuhësore, u japin fjalëve dhe shprehjeve kuptime të caktuara, specifike dhe i sqarojnë ato.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Nëse Profeti (salallahu alejhi ue selem) e sqaron kuptimin e një fjale dhe përmbajtjen e saj, nuk është e domosdoshme ta ketë marrë nga gjuha apo të ketë shtuar në të, por rëndësi ka që është njohur qëllimi i tij. Sido që të jetë raporti i fjalës së përdorur me gjuhën, e rëndësishme është

të njohim qëllimin e Profetit (salallahu alejhi ue selem).”

Prandaj sqarimet e përmendura në Sheriat për termat dhe shprehjet kanë përparësi mbi çdo sqarim tjetër. Shumë bidatçinj, për arsye se nuk e kanë marrë në konsideratë këtë realitet, i komentuan termat fetare që kanë të bëjnë me parimet e fesë, duke u mbështetur krejtësisht në aspektin gjuhësor, pa marrë parasysh synimet e Sheriatit (p.sh. murrxhiet i dhanë fjalës “iman” vetëm kuptimin e njohjes dhe vërtetimit, pa marrë parasysh qëllimin e Sheriatit në përdorimin e kësaj fjale). (Shiko “Mexhmuul fetaua”, 7/289)

3. Mbledhja e të gjithë argumenteve që kanë të bëjnë me një çështje.

Tekstet fetare manifestojnë një tërësi unike dhe plotësojnë e përsosin njëri-tjetrin, kështu që nuk mund të qartësohet një çështje, derisa të mblidhen të gjitha argumentet që lidhen me të. Argumentet e sakta të Kur’anit dhe Sunetit, përputhen me njëri-tjetrin dhe nuk bien në kundërshtim, sepse ato kanë dalë nga një burim i vetëm, prandaj nuk mund të ketë në to kundërthënie. Allahu i Lartësuar e ka përshkruar Librin e Tij:

“Vërtet ata që nuk besuan në Mesazhin Përkujtues (Kur’anin) kur ai u erdhi atyre (do të marrin dënimin). Dhe ai është një Libër i nderuar dhe i vlerësuar (sepse ai është Fjala e Allahut dhe Ai e ruan atë nga çdo shtrembërim). Nuk hyn gënjeshtër në të as nga para e as nga prapa, ai është i zbritur nga (Allahu) më i Urti, më i Denji dhe Zotëruesi i të gjitha lavdërimeve.” Fussilet: 41-42.

“A nuk mendojnë thellë për Kur’anin?! Po të kishte qenë ai prej dikujt tjetër e jo prej Allahut, sigurisht që do të kishin gjetur në të mjaft kundërthënie e mospërputhje.” En-Nisa: 82.

Me këtë që sqaruam mësojmë se nuk lejohet të merret një tekst dhe të lihet një tjetër në të njëjtën temë, sepse kjo çon në copëtimin e teksteve, sakatimin dhe gjymtimin e tyre. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Atëherë a besoni vetëm në një pjesë të librit dhe mohoni pjesën tjetër!?” El Bekare: 85.

Lidhur me këtë temë imam Ahmedi thotë: “Nëse nuk do t’i grumbullosh rrugët e hadithit, nuk e kupton atë, sepse hadithet sqarojnë njëri-tjetrin dhe variantet e një hadithi shpjegojnë njëri-tjetrin.”

Ibnu Tejmije ka thënë: “Dijetari, pasi të dallojë atë që e ka thënë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) nga ajo që nuk e ka thënë, ka nevojë të kuptojë qëllimin e tij, kështu që duhet të bëjë pajtimin mes haditheve, të bashkojë gjërat e ngjashme e si rrjedhojë të bashkojë mes atyre gjërave që ka bashkuar Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe të ndajë e të bëjë dallim mes gjërave që Allahu dhe i Dërguari i Tij i kanë bërë të ndryshme. Kjo është dija prej së cilës përfitojnë muslimanët dhe të cilën është detyrë ta pranojmë. Me këtë dije kryesuan dijetarët e muslimanëve, si tre dijetarët e mëdhenj e të tjerë, kënaqësia e Allahut qoftë mbi të gjithë.” (“Mexhmuul fetaua”)

Shatibiu ka thënë: “Strumbullari i gabimit në nxjerrjen e rregullave nga argumentet e Sheriatit është vetëm një gjë, e kjo është mosnjohja e synimeve të Sheriatit dhe mosbashkimi e mospajtimi mes argumenteve të tij. Sipas dijetarëve të vendosur në dije, metoda e saktë e deduktimit të rregullave nga tekstet, është të merret i gjithë Sheriati si një formë e vetme, duke i renditur çështjet e pjesshme në çështjet e tërësishme, duke përjashtuar prej argumenteve të përgjithshme gjërat e veçanta që janë përjashtuar po me argument, duke e kufizuar tërësinë e argumenteve absolute me argumentet e kufizuara, duke i shkoqitur e sqaruar argumentet e përgjithshme e të pashtjelluara me argumentet sqaruese, e të tjera aspekte e drejtime...”

Pas kësaj Shatibiu ka thënë: “Të vendosurit dhe të mëkëmburit në dije, e përfytyrojnë Sheriatin si një formë (njësi) të vetme, argumentet e së cilës i shërbejnë njëri-tjetrit, si pjesët e trupit të njeriut, nëse do të përfytyroheshin në një formë frytdhënëse.”

Gjithashtu ai ka thënë: “Shpesh i vëren injorantët që t’i mbështesin mendimet e tyre në argumente të pavlefshme ose argumente të sakta, por mendimin e kanë formuar duke u kufizuar vetëm me një argument të caktuar

dhe duke mos i marrë në konsideratë argumentet e tjerë, të cilët e mbështesin atë mendim ose e kundërshtojnë.”

Nga ky sqarim që ka bërë Shatibiu, mësojmë se është e domosdoshme të mbledhim argumentet që kanë të bëjnë me një çështje të caktuar dhe të vendosim çdo tekst në vendin e duhur.

4. Njohja e synimeve të Sheriatit.

Prej mirësisë dhe mëshirës së Allahut të Lartësuar ndaj këtij Umeti, është që të gjitha rregullat i ka ligjëruar për synime dhe përfundime madhështore. Të gjitha rregullat dhe ligjet e Sheriatit janë të themeluara mbi realizimin e interesave për robërit në dynja dhe ahiret. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“O njerëz! Ju ka ardhur juve një këshillë e mirë nga Zoti juaj (Kur’ani i cili ju urdhëron për çdo të mirë dhe ju ndalon nga çdo e keqe) dhe shërim për atë (sëmundje të padijes, dyshimit, hipokrizisë, dallimeve etj.) në gjokset tuaj, udhëzim dhe mëshirë (duke shpjeguar e dalluar të lejuarën e të palejuarën) për besimtarët.” Junus: 57.

Dijetarët e Umetit tonë, në shumë thënie kanë theksuar se Sheriati ynë është zbritur për të realizuar dhe për të plotësuar e kompletuar dobitë dhe interesat për njerëzit, si dhe për të zhdukur dhe eliminuar, ose për t’i minimizuar dëmet dhe të këqijat në dynja dhe në ahiret.

Shatibiu ka thënë: “Sheriati është vendosur nga Allahu për të realizuar dobitë dhe interesat e robërve në dynja dhe në ahiret (në të tashmen e të ardhmen) dhe për të shmangur dëmet dhe të këqijat prej tyre.”

El Iz-z ibnu Abdus-Selam thotë: “I gjithë Sheriati është në dobi dhe interes të njerëzve. Ai ose përmban shmangien e dëmeve, ose arritjen e dobive dhe realizimin e interesave.”

Ibnul Kajim thotë: “Sheriati është i bazuar dhe i themeluar mbi objektivin e realizimit të urtësive, dobive dhe interesave për robërit në jetën e dynjasë dhe të ahiretit. Të gjitha rregullat dhe ligjet e Sheriatit janë të drejta, dobiprurëse dhe të vendosura në vendin e duhur. Çdo çështje që devijon nga drejtësia për në

padrejtësi, nga mëshira për në të kundërtën e saj, nga dobia dhe interesi për në dëm, dhe nga urtësia, saktësia dhe preçiziteti për në kotësi, parregullsi dhe në konfuzion, nuk është prej Sheriatit. Ajo edhe sikur t’i mvishet Sheriatit me anë të keqinterpretimit, nuk i përket atij, sepse Sheriati është drejtësia e Allahut ndërmjet robërve të Tij dhe mëshira e Tij ndërmjet krijesave.”

Ibnu Tejmije ka thënë: “Sheriati është i themeluar mbi realizimin e dobive dhe kompletimin e tyre, si dhe eliminimin e dëmeve e të këqijave dhe minimizimin e tyre sipas mundësisë. Ai na udhëzon të njohim më të mirën e dy të mirave dhe më të dëmshmin e dy dëmeve ose dy të këqijave, në mënyrë që kur përplasen dy të mira dhe s’mund të bëhen të dyja, t’i jepet përparësi asaj që është më e rëndësishme, dhe kur përplasen dy dëme dhe s’mund të shmangen të dy, t’i jepet përparësi shmangies së dëmit më të madh.” (“Minhaxhus-Suneh”)

Disa çështje që lidhen me metodën e “ehli sunetit” në referim

1 - “Ihxmai” i selefëve.

Në fillimin e këtij kapitulli kemi përmendur se burimi i tretë është “ixhmai” i selefëve. “Ehli sune uel xhemaah” besojnë se njerëzit më të ditur pas Profetit (salallahu alejhi ue selem) janë sahabët, prandaj nuk ka dyshim se pajtimi i tyre në lidhje me një çështje nuk mund të jetë i gabuar. Kështu që “ixhmai” i sahabëve është një nga argumentet në të cilat bazohemi. Sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, të cilin e ka përmendur dhe e ka zgjedhur ibn Tejmije në “Mexhmuul fetaua”, “ixhmai” i vlefshëm ka ekzistuar vetëm në kohën e sahabëve, sepse pas tyre kanë lindur shumë mosmarrëveshje dhe Umeti është zgjeruar shumë, gjë e cila e bën të pamundur të merret e të njihet mendimi i të gjithë “muxhtehidëve” në lidhje me një çështje fetare. Prej civateve të ibn Tejmijes lidhur me këtë çështje është fjala e tij: “Ihxmai i selefëve mund të jetë veçse i saktë”, si dhe fjala e tij: “Muslimanët në të gjitha çështjet e fesë bazohen në Kur’an, Sunet dhe ixhmain e selefëve. Këto tri parime janë të pagabueshme

(të mbrojtura nga gabimi).”

2 - Është detyrë pranimi i çdo hadithi të saktë që na ka ardhur nga Profeti (salallahu alejhi ue selem) dhe punimi me të, qoftë ai “muteuatir” apo “ehad”, si në çështjet e Akides, ashtu edhe në çështje të tjera të fesë.

Hadithi “muteuatir” është hadithi që e ka transmetuar një grup i madh njerëzish, të cilët zakonisht nuk mund të pajtohen në gënjeshtëri. Ky numër i madh transmetuesish duhet të jetë në të gjitha hallkat e senedit. Lajmi i tyre duhet të jetë i mbështetur në atë që e kanë dëgjuar, parë ose prekur dhe të mos jetë konkluzion logjik. Si shembull për hadithin “muteuatir” kemi fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush gënjen ndaj meje me dashje, le të përgatisë karrigen e tij në zjarr.” Këtë hadith e kanë transmetuar më shumë se 70-të prej sahabëve. Vërtetësia e hadithit “muteuatir” është e padiskutueshme dhe prej tij përfitohet bindje e sigurtë.

Hadithi “ehad” është ai që nuk i ka plotësuar kushtet e hadithit “muteuatir”. Dijetarët e hadithit e kanë ndarë hadithin “ehad”, për sa i përket numrit të rrugëve të tij, në tri lloje:

a. *Meshhur*. Ky është hadith që e kanë transmetuar tre transmetues ose më shumë në çdo hallkë të senedit, por që nuk e arrin numrin e hadithit “muteuatir”, si p.sh. hadithi: “Allahu nuk e merr dijen duke e shkëputur nga gjokset, por duke u marrë jetën dijetarëve, derisa të mos mbetet asnjë dijetar. Atëherë do të pyeten injorantët, të cilët do t’i humbin vetet e tyre dhe ata të cilët i pyesin.” Buhariu, Muslimi.

b. *Aziz*. Ky është hadithi që nuk ka më pak se dy transmetues në të gjitha hallkat e senedit, si p.sh. hadithi i Enes ibn Malik dhe ebu Hurejres (radijallahu anhum) nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem): “Nuk beson asnjëri prej jush derisa unë të jem më i dashur tek ai se babai i tij, fëmija e tij dhe të gjithë njerëzit.” Buhariu dhe Muslimi.

c. *Garib*. Ky është hadithi që e ka transmetuar vetëm një transmetues, qoftë edhe në një hallkë prej hallkave të senedit, si p.sh. hadithi i nijetit që e

transmeton Umer ibnul Hattab, Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

Hadithi “ehad” mund të jetë i saktë, i mirë, i dobët, shumë i dobët dhe i trilluar, prandaj duhet të vërejmë vlerësimin që i kanë bërë dijetarët, në mënyrë që të punojmë me hadithe të sakta në të gjitha çështjet e fesë, qoftë në Akide, në rregullat e Fikhut apo më gjerë dhe të largohemi nga hadithet e pasakta.

Dijetarët e selefëve të mirë besojnë se çdo gjë që na ka lajmëruar Allahu për të, ose që na ka lajmëruar i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), dhe e cila na ka mbërritur nëpërmjet një rruge të saktë, jemi të obliguar ta besojmë. Ata nuk bëjnë ndryshim mes lajmit “muteuatir” dhe lajmit “ehad” përderisa është i saktë. Kështu ata i konfirmojnë çështjet e Akides pa dallim, me të dyja llojet.

Një grup i humbur mendon se nuk vlen të mbështetesh në hadithe të sakta “ehad” në çështjet e Akides. Prandaj ata nuk bazohen për pohimin e çështjeve të Akides veçse në Kur’an e në hadithe “muteuatir”. Argumentimi me Kur’an dhe hadith “muteuatir”, sipas tyre, është i vlefshëm vetëm në rastin kur kuptimi i tekstit është i prerë e i padiskutueshëm. Ky mendim e ka prejardhjen nga “ehlul kelam”, të cilët i japin përparësi logjikës para argumenteve të Kur’anit dhe Sunetit. Në këtë mendim i pasuan disa dijetarë të “usulul Fikhut”, por në kohën tonë ky mendim u përhap shumë, aq sa gati u harrua besimi i vërtetë, megjithëse dijetarët në të kaluarën dhe në të tashmen e kanë zbuluar dilemën që u ka lindur përfaqësuesve të këtij mendimi, si dhe kanë sqaruar pavlefshmërinë dhe rrezikshmërinë e saj.

Sqarimi i dilemës së tyre është si më poshtë.

Ata kanë thënë se argumentet në të cilat mbështesim çështjet e Akides, duhet të jenë të formës së prerë dhe të përfitohet prej tyre bindje e sigurtë “jekin”. Nga hadithet “ehad” dhe tekstet e Kur’anit e të haditheve “muteuatir” që kanë kuptim të diskutueshëm (jo të prerë), nuk përfitohet bindje e sigurtë, por ato janë argumente “dhannije” (prej të cilëve përfitohet një mendim, ose një mundësi më e madhe lidhur me një çështje, por që nuk arrin nivelin e bindjes së

sigurtë “jekin”), prandaj ato nuk vlejnë për argument në Akide. Argumentet prej të cilëve përfitohet “dhann”, nuk lejohet të përdoren si dëshmi për çështjet e Akides, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Ata nuk kanë asnjë dije për këtë. Ata ndjekin vetëm se ‘edh-dhann’¹⁶⁶ (hamendje) dhe padyshim se hamendja nuk vlen aspak ndaj së vërtetës (që ta zëvendësojë atë).” En-Nexhm: 28.

“Ata ndjekin vetëm se ‘edh-dhann’ dhe atë që ata dëshirojnë.” En-Nexhm: 23.

Ata thonë se në këto ajete e të tjera, Allahu i Lartësuar i ka sharë mushrikët për shkak se ata ndjekin “edh-dhann”. Sipas tyre këtu përfshihet edhe mbështetja për çështjet e Akides, në hadithe “ehad” dhe në ajete e hadithe “muteuatir” që nuk kanë domethënie të prerë. Të bazuarit në këto ajete e të tjera për të përligjur mendimin e tyre nuk është i saktë, sepse “dhann-i” që ka ndaluar Allahu të ndiqet në ajetet e Kur’anit, nuk është “dhann-i” që kanë për qëllim ata, por ai është “dhann-i” që merr kuptimin e dyshimit, hamendjes dhe gënjeshtërisë. Këtë lloj e ka ndaluar Allahu në Kur’an dhe jo punimin me hadithet “ehad”, sepse prej tyre përfitohet bindje e sigurtë ose më e pakta, mendimi më i fortë dhe mundësia më e madhe, siç do ta sqarojmë në vijim, inshaAllah.

- “Dhann-i” i përmendur në ajet, të cilin e ka hedhur poshtë Allahu i Lartësuar, nuk është ai prej të cilit përfitohet mendimi më i fortë dhe mundësia më e madhe rreth diçkaje, por është ndjekja e dyshimeve, hamendjeve dhe gënjeshtreve. Prej gjërave që e përforcojnë këtë është fjala e Allahut të Lartësuar për mushrikët:

“Ata nuk ndjekin gjë tjetër veçse edh-dhann (hamendjen, dyshimet) dhe ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse gënjejnë.” (En Aam: 116), që do të thotë se me fjalën “dhann” ka pasur për qëllim gënjeshtren, hamendjen.

) Sipas tyre “edh-dhann” do të thotë argument prej të cilit nuk përfitohet bindje, por përfitohet mendimi ose ¹⁶⁶ mundësia më e madhe. Ky koment që i kanë bërë fjalës “edh-dhann” nuk është i saktë, siç do ta mësojmë nga kundërpërgjigja, pasi kuptimi i saktë i saj është hamendja, gënjeshtër dhe trillimi që e ndiqnin mushrikët.

- Sikur thënia e tyre të ishte e saktë, atëherë nuk do të lejohej punimi me hadithe “ehad” edhe në çështjet e Fikhut, sepse Allahu e ka ndaluar punimin me “edh-dhann” në përgjithësi, pa bërë dallim mes çështjeve të Akides dhe të Fikhut dhe sepse në ajetin e sures “En-Aam”, ku Allahu i Lartësuar ka dënuar ndjekjen e “dhann-it” nga ana e mushrikëve, ka përmendur edhe disa rregulla Fikhu, gjë e cila tregon se ky lloj “dhann-i” është i dënuar në të gjitha çështjet, si të Akides ashtu edhe të Fikhut:

“Ata që i bënë shok Allahut të Lartësuar do të thonë: ‘Po të kishte dashur Allahu, ne nuk do t’i kishim bërë shokë Atij në adhurim, as edhe baballarët tanë (nuk do ta kishin bërë këtë), - ky fragment bën fjalë për çështje besimi - , dhe se nuk do të kishim ndaluar ndonjë gjë’ (përkundër dëshirës së Tij). - ky fragment bën fjalë për gjëra që kanë të bëjnë me rregullat. Në të njëjtën mënyrë përgënjeshtroan ata që ishin para tyre (ata kundërshtuan padrejtësisht të Dërguarin e Allahut), derisa shijuan Zemërimin Tonë. Thuaj: ‘A mos keni ju ndonjë dijeni (provë mbrojtëse) që mund ta sillni para nesh? Vërtet që ju nuk ndiqni gjë tjetër, por vetëm dhann (hamendje) dhe nuk bëni gjë tjetër përveçse gënjeni’.” En Aam: 148.

Pastaj ne nuk e pranojmë thënien e tyre se prej hadithit “ehad” nuk përfitohet bindje e sigurtë, sepse një gjë e tillë mund të jetë e mundur. Siddik Hasen Khan ka thënë: “Mospajtimi i dijetarëve lidhur me përfitimin e bindjes së sigurtë nga hadithi ‘ehad’, është vetëm në rastin kur atij nuk i bashkangjitet diçka që e përforcon, ndërsa nëse do t’i bashkangjitet diçka që e përforcon, ose hadithi të jetë ‘meshhur’, atëherë nuk ka kundërshtim se prej tij përfitohet bindje e sigurtë.”

Ajo që rezulton nga studimi i qëndrimeve dhe thënieve të selefëve dhe të shumë dijetarëve të mëvonshëm si ibnus Salah, ibn Tejmije, ibn Kethir e të tjerë, është se hadithi “ehad” është bindës, nëse ekzistojnë shenja e tregues që e përforcojnë. Hadithet që shoqërohen me cilësi përforcuese prej të cilave përfitohet bindje, janë këto që vijojnë:

a) Hadithet që janë transmetuar në librat e hadithit, të cilat janë vlerësuar të sakta nga dijetarët dhe nuk i ka hedhur poshtë asnjëri prej tyre. Në këtë rast padyshim përfitohet prej tyre bindje, sepse Umeti është pajtuar për saktësinë e tyre.

b) Hadithet që i ka transmetuar Buhariu dhe Muslimi së bashku, ose njëri prej tyre dhe nuk i ka kundërshtuar asnjë prej dijetarëve të hadithit në saktësinë e tyre.

c) Hadithet “meshhur”, të cilat kanë tri ose më shumë rrugë.

d) Hadithet që i kanë transmetuar dijetarë të mëdhenj si Malik nga Nafi’, nga Abdullah ibn Umer etj.

Madje disa dijetarë janë të mendimit se nga çdo hadith i saktë përfitohet bindje e plotë (jakin). Ky është mendimi i disa dijetarëve të medhhebit maliki, shafi’, hanbeli, si dhe mendimi i ibn Hazmit. Në kohën tonë këtë mendim e ka zgjedhur shejh Albani.

Nga kjo që sqaruam dalim në përfundimin se dijetarët e “ehli sune uel xhemaah” i pranojnë hadithet “ehad” si të sakta, qoftë në besim apo në rregullat e Fikhut, pa bërë dallim. Tregon për këtë fakti që dijetarët e Sunetit si Maliku, Ahmedi, Buhariu, Muslimi, ebi Davudi, Tirmidhiu e të tjerë, i kanë transmetuar e regjistruar në librat e tyre hadithet që përmbajnë çështje të Akides, megjithëse e dinin se hadithet “muteuatir” janë shumë pak, dhe se shumica e tyre janë “ehad”. Sikur të mos e pranonin bazimin në to për çështjet e Akides, nuk do të ishin lodhur me transmetimin e tyre dhe do t’u kishte shkuar e gjithë kjo punë kot. Kushdo që u mvesh atyre ndonje mendim tjetër, ka shpifur ndaj tyre. Pastaj diskutimi nëse përfitohet prej hadithit “ehad” bindje apo jo, nuk ka arsye që të lidhet me temën e Akides, sepse dijetarët që thonë se përfitohet prej tij “dhann”, e pranojnë atë në Akide përderisa është i saktë. Ibnu Abdil Berr është i mendimit se nga hadithi “ehad” përfitohet “dhann” dhe jo “jekin”, megjithatë ai e pranon atë në çështjet e Akides dhe thotë se ky është qëndrimi i dijetarëve të “ehli sunetit”.

Faktet nga Kur’ani dhe Suneti që tregojnë se është detyrë të pranohet hadithi “ehad” në çështjet e Akides

“Nuk është e përshtatshme për besimtarët të dalin për luftë të gjithë. Nga çdo grup i tyre vetëm një pjesë duhet të marshojë, me qëllim që të njihen me fenë (Islamin), të mund të këshillojnë njerëzit e tyre kur të kthehen tek ata dhe të mund të jenë të vetëdijsëm (për të keqen).” Et-Teube: 122.

Në këtë ajet Allahu i ka urdhëruar fiset, të dërgojnë një palë prej tyre për të mësuar çështjet e fesë, me qëllim që kur të kthehen t’ua mësojnë njerëzve të fisit ato. Fjala “taife” që është përmendur në ajet, nga ana gjuhësore përdoret për një person e më shumë, që do të thotë se sikur një fis të çojë vetëm një person për të mësuar çështjet e fesë, pasi të kthehet në mesin e tyre, e kanë detyrë të pranojnë prej tij çdo gjë të fesë, qoftë në çështjet e Akides apo të Fikhut. Madje çështjet e Akides janë më me përparësi për t’i pranuar, sepse janë më të rëndësishme. Ajeti është argument i qartë për pranimin e hadithit “ehad” që transmetohet nga një ose më shumë persona, pa bërë dallim ndërmjet çështjeve të Akides dhe të Fikhut.

Këtë e konfirmon edhe hadithi që ka transmetuar Buhariu në “Sahihun” e tij nga Malik ibnul Huvejrith i cili thotë: “Erdhëm tek Profeti (salallahu alejhi ue selem), ndërkohë që ishim të rinj dhe pothuajse në të njëjtën moshë. Pranë tij qëndruam njëzet ditë. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ishte i mëshirshëm, zemërbutë e i dhembshur, prandaj kur mendoi se na mori malli për familjet tona, na kërkoi ta lajmëronim për njerëzit që kishim në shtëpi. Pasi e lajmëruam na tha: ‘Kthehuni në familjet tuaja, qëndroni mes tyre, mësojuni atyre fenë, urdhërojini ata dhe faluni siç më keni vërejtur mua duke u falur’.”

Pra, Profeti (salallahu alejhi ue selem) i urdhëroi të kthehen në familje dhe t’u mësojnë çështjet e fesë. Më të rëndësishmet e çështjeve të fesë janë ato të

besimit, kështu që në qoftë se do të ishte i saktë mospranimi i hadithit “ehad” në Akide, këta djem nuk do t’u flisnin familjeve për besimin dhe ata nuk do ta kishin detyrë të pranonin çdo gjë prej tyre.

Gjithashtu Allahu i Lartësuar ka thënë:

“O ju që keni besuar! Nëse një njeri i poshtër e i lig ju vjen me ndonjë lajm, sqaroheni e bëjeni të qartë, që të mos dëmtoni njerëzit nga padija e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.” El Huxhuratë: 9.

Ajeti tregon se kur na vjen një mëkatar me ndonjë lajm, nuk e pranojmë menjëherë prej tij, por e shqyrtojmë dhe e verifikojmë. Në të kundërt, kur na vjen me çfardolloj lajmi një njeri i drejtë dhe i besueshëm, argumenti nëpërmjet tij konsiderohet i përcjellur dhe është detyrë ta pranojmë prej tij menjëherë, pa qenë e nevojshme ta shqyrtojmë e verifikojmë. Padyshim që në lajmet e njerëzve të besueshëm, përfshihen edhe çështjet e besimit.

Ka ardhur në “Sahihun” e Buhariut dhe të Muslimit se banorët e Jemenit erdhën te Profeti (salallahu alejhi ue selem) dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut! Dërgo me ne një burrë që të na mësojë Islamin dhe Sunetin!” Profeti kapi përdore ebu Ubejde ibnul Xherrah dhe tha: “Ky është besniku i këtij Umeti.”

Gjithashtu Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka dërguar dhe të tjerë prej sahabëve në vende të ndryshme për t’u mësuar njerëzve Islamin, si Ali ibn ebi Talib, Muadh ibn Xhebel dhe ebu Musa el Eshari. Hadithet e tyre gjendet te Buhariu, Muslimi e të tjerë libra të hadithit. Ata u mësuan njerëzve çështjet e fesë, ku përfshiheshin padyshim edhe ato të Akides dhe njerëzit ishin të obliguar të pranonin prej tyre. Nëse nuk do të ishte detyrë pranimi i lajmit të përcjellë nga një person apo dy e më shumë, që nuk arrin gradën “muteuatir” (hadithi “ehad”), Profeti (salallahu alejhi ue selem) nuk do t’i dërgonte në këtë formë e me këtë numër dhe njerëzit nuk do të ishin të obliguar të pranonin prej tyre.

Disa aspekte që hedhin poshtë mendimin e atyre të cilët nuk bazohen në

hadithin “ehad” për çështjet e Akides:

- Mospranimi i hadithit “ehad” në çështjet e Akides apo thënia se nuk është detyrë të punohet me të në Akide, është diçka e shpikur që s’e kanë njohur selefët e këtij Umeti. Çdo gjë e tillë është e refuzuar, sepse Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë në hadithin e transmetuar nga Aishja në “Sahihun” e Muslimit: “Kush shpik në fenë tonë atë që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar dhe e papranueshme.”

- Thënia e tyre se hadithi “ehad” nuk vlen për argument në Akide, është në vetvete një çështje prej Akides që ka nevojë për argument të prerë. Një argument të tillë, kurrë s’mund ta gjejnë. Në këtë mënyrë ata kanë kundërshtuar vetveten dhe kanë rënë në kundërthënie.

- Sikur të kishte ndonjë argument të formës së prerë (“jekin”) që nuk pranohet hadithi “ehad” në Akide, do ta kishin njohur sahabet dhe do ta kishin deklaruar. Po ashtu edhe ata që erdhën pas tyre prej të parëve të këtij Umeti. Përderisa ata nuk e kanë njohur një argument të tillë, kjo tregon se ai nuk ekziston.

- Mospranimi i hadithit “ehad” në Akide bie ndesh me metodën e sahabëve, të cilët e pranonin hadithin e atij që u përcillte fjalët e Profetit (salallahu alejhi ue selem), duke qenë të bindur në to. Asnjëri prej tyre nuk e refuzonte lajmin e vëllait të tij me pretekstin se hadithi i përcjellë prej tij është “ehad”.

- Faktet që dëshmojnë për detyrën e pranimi të argumenteve të Kur’anit dhe Sunetit, përfshijnë temat e besimit dhe rregullat e ligjet e Sheriatit. Përyjashtimi i temave të Akides kur hadithet janë “ehad”, është një përyjashtim pa argument.

Disa nga çështjet e Akides që kanë ardhur në hadithe të sakta

- Profecia e Ademit, si dhe e disa profetëve të tjerë, për të cilët Kur’ani nuk përmend se janë profetë.

- Epërsia e Profetit tonë, Muhamedit (salallahu alejhi ue selem), mbi të gjithë

të dërguarit.

- Shumë çështje që kanë të bëjnë me fillimin e krijimit të krijesave, cilësinë e melaikeve, xhindëve, xhenetit, zjarrit, se ato janë të krijuara dhe se guri i zi i Kabes është i ardhur nga xheneti.

- Shumë prej shenjave të Kijametit, përveç atyre që kanë ardhur në hadithe “muteuatir”.

- Besimi se dhjetë të përgëzuarit me xhenet janë prej banorëve të xhenetit.

- Shumë prej mrekullive dhe veçorive të Profetit.

- Shumë gjëra që lidhen me jetën e varrit, kijametin, dhe Ditën e Gjykimit.

- Shumë çështje që kanë të bëjnë me kaderin.

Grupet e humbura, për shkak se s’kanë dijeni rreth haditheve të Profetit (salallahu alejhi ue selem), kanë mohuar shumë çështje të Akides që kanë ardhur në hadithe “muteuatir”, me pretendimin se janë transmetuar në hadithe “ehad”, duke kundërshtuar kështu atë që e kanë theksuar ekspertët e kësaj fushe, dijetarët e hadithit. Prej gjërave që kanë mohuar është dalja e Dexhalit, zbritja e Isait, shikimi i Allahut në xhenet dhe shumë prej mrekullive të Profetit tonë Muhamedit (salallahu alejhi ue selem).

3 - Profeti ynë, Muhamedi (salallahu alejhi ue selem), i ka sqaruar çështjet e fesë, prandaj çdo shpikje në fe është bidat i refuzuar.

Allahu e ka plotësuar fenë e Tij, nuk ka në të asnjë lloj mangësie, prandaj nuk lejohet të pakësohet, të shtohet, apo të ndryshohet ndonjë gjë në të. Allahu thotë në Kur’an:

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe.” Maide: 3.

Për këtë ka thënë Profeti (salallahu alejhi ue selem) në hadithin e transmetuar nga Irbad ibni Sarije: “Na këshilloi i Dërguari i Allahut me një këshillë, prej së cilës u frikësuan e u zbutën zemrat dhe lotuan sytë. Atëherë ne i thamë: ‘O i Dërguari i Allahut! Duket sikur kjo është një këshillë lamtumire apo ndarje prej nesh, prandaj na porosit (me diçka që t’i përmbahemi pas teje).’ Profeti u tha:

‘U këshilloj t’i frikësoheni Allahut, të dëgjoni dhe të respektoni, edhe sikur prijësi juaj të jetë një rob, sepse kush jeton prej jush do të vërejë shumë përçarje. Prandaj kapuni pas Sunetin tim (rrugës time) dhe Sunetin e halifëve të drejtë e të udhëzuar. Shtrëngojeni atë me dhëmballët tuaj (d.m.th. kapuni fort pas tij). Ruhuni nga shpikjet në çështjet e fesë sepse çdo bidat është humbje’.” Transmeton ebu Daudi dhe Tirmidhiu, i cili thotë se hadithi është hasen, sahih.

Në një transmetim të hadithit të Irbad ibn Sarijeh Profeti (salallahu alejhi ue selem) thotë: “Ju kam lënë në një rrugë të drejtë, nata e së cilës është si dita e saj. Nuk devijon nga ajo vetëm se një i shkatërruar.” Kjo do të thotë se Profeti (salallahu alejhi ue selem) e ka sqaruar çdo gjë të fesë, kështu që ai që shton, ndryshon e devijon diçka në të, është i shkatërruar.

Transmeton imam Shafiu dhe Taberani se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk kam lënë ndonjë gjë që ju afron te Allahu i Lartësuar, veçse ju kam urdhëruar për të.”

Aishja transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush shpik në fenë tonë diçka që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”

Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Në “Sunenin” e Nesaiut ka ardhur hadithi i saktë ku Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Me të vërtetë më e mira fjalë është fjala e Allahut të Lartësuar dhe më i miri udhëzim është udhëzimi i të Dërguarit të Tij. Çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje përfundimin e ka në zjarr.” Hadithin e ka transmetuar edhe Muslimi, përveç fragmentit të fundit.

Imam Ahmedi transmeton nga Abullah ibn Mes’udi, i cili rrëfen se Profeti (salallahu alejhi ue selem) bëri një vijë të drejtë dhe tha: “Kjo është rruga e drejtë që ka ligjëruar Allahu i Lartësuar.” Pastaj bëri vija djathtas e majtas dhe tha: “Në krye të secilës prej këtyre rrugëve ka një shejtan që i fton njerëzit të ecin në të.” Më pas lexoi fjalën e Allahut: **“Vërtet, kjo është rruga Ime e drejtë, kështu që ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera, pasi ato do t’ju ndajnë e do t’ju largojnë nga Udha e Tij. Për këtë ju ka porositur që të**

mund të bëheni Muttekinë (të përkushtuar në Besimin e pastër islam).” En Aam: 153.

Gjithashtu ka transmetuar Hudhejketu ibnil Jeman, i cili thotë: “Njerëzit e pyesnin Profetin (salallahu alejhi ue selem) për të mirën, kurse unë e pyesja për të keqen nga frika se mos më prekte, kështu që i thashë: ‘O i Dërguari i Allahut! Ne kemi qenë në xhahilijet dhe në sherr dhe Allahu na solli këtë të mirë. A do të ketë pas kësaj të mire, të keqe dhe sherr? Profeti tha: ‘Po.’¹⁶⁷ I thashë: ‘Po pas kësaj të keqeje a ka hajër?’ Profeti u përgjigj: ‘Po, dhe ai do të shoqërohet me ‘dekhan’¹⁶⁸ (inat, urrejtje, armiqësi, prishje të zemrave dhe trazira e turbullira).’ I thashë: ‘Çka është ‘dekhan-i’ i asaj periudhe, o i Dërguari i Allahut!?’ Profeti tha: ‘Një popull që udhëheqin jo me udhëzimin tim, të cilët bëjnë punë që i pranon dhe punë që nuk i pranon.’ I thashë: ‘Po pas këtij hajri a ka sherr?’ Tha: ‘Po, ka ftues për në dyert e xhehenemit, kushdo që u përgjigjet, ata e hedhin në të.’¹⁶⁹ ‘O i Dërguari i Allahut! Na i përshkruaj ata!’ M’u përgjigj: ‘Ata janë nga mesi ynë, flasin gjuhën tonë dhe janë të fesë sonë.’ I thashë: ‘Çfarë më urdhëron të bëj nëse e arrij atë kohë?’ Tha: ‘Të kapesh pas xhematit të muslimanëve dhe kryetarit, prijësit të tyre.’ Thashë: ‘Po në qoftë se muslimanët atë ditë nuk kanë as xhemat dhe as prijës?’ Tha: ‘Largohu nga të gjitha ato grupe edhe sikur të shtrëngosh rrënjët e një peme, derisa të të vijë vdekja duke qenë në atë gjendje.’” Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Abdullah ibn Mes’udi ka thënë: “Ndiqni rrugën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) e të shokëve të tij dhe mos shpikni risi e bidate, sepse u mjafton ajo që ka qenë në të i Dërguari dhe shokët e tij.”

Abdullah ibn Umer ka thënë: “Çdo bidat është humbje, edhe pse njerëzit e konsiderojnë të mirë.”

) Dijetarët kanë thënë se bëhet fjalë për fitnet (trazirat) që kanë ndodhur pas Uthmanit.¹⁶⁷

) Dijetarët kanë thënë se bëhet fjalë për bashkimin dhe respektin e njerëzve, gjë e cila ndodhi në kohën e Aliut¹⁶⁸ dhe të Muavijes, ndërsa “dekhan”, janë veprimet e disa guvernatorëve në kohën e tyre. Kjo sipas një varianti në komentin e hadithit.

) Ftuesit për në dyert e xhehenemit janë havarixhet e të tjerë prej bidatçinjve. Shiko për më gjerë komentin e këtij hadithi në “Fethul bari”.

4 - Logjika e shëndoshë është krejtësisht në përputhshmëri me argumentet e sakta të Sheriatit, d.m.th. argumentet e sakta logjike që rrjedhin nga mendja e pastër, e shëndoshë dhe e drejtë, janë në përputhshmëri me Kur'anin dhe hadithet e sakta të Profetit (salallahu alejhi ue selem). Si rrjedhojë, kurrsesi nuk mundet që një argument i prerë e i saktë logjik, të bjerë në kundërshtim me një argument të prerë e të saktë të Sheriatit.

Grada dhe vlera e mendjes në Islam

Mendja është një dhuratë dhe një nder i madh që Allahu ia ka bërë njeriut. Allahu i Lartësuar i ka dhuruar mendjes së njeriut aftësi dhe përgatitje për të kryer procese logjike të cilat janë të dobishme për jetën e tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Vërtet Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit dhe Ne i kemi mbartur ata në tokë e në det dhe i kemi furnizuar ata me gjithë të mirat, si edhe i kemi parapëlqyer ata përmbi shumë prej atyre që Ne i kemi krijuar me mirësi të veçantë.” El Isra: 70.

Vlera dhe rëndësia e mendjes në Sheriat vihet në dukje nga aspektet që vijnë:

- Allahu i Lartësuar ia drejton fjalët e Tij vetëm të mençurve, sepse ata e kuptojnë fenë e Tij. Allahu në Kur'an ka thënë:

“Përkujtim e këshillë për zotëruesit e mendjes.” Sad: 53.

- Një ndër gjërat prej të cilave varet obligimi me detyrat fetare është mendja, dhe ai që nuk e posedon nuk është i obliguar. Profeti (salallahu alejhi ue selem) në një hadith ka thënë: “Është ngritur lapsi për tre persona (d.m.th. është hequr obligimi dhe nuk merren në llogari, përderisa janë në atë gjendje)...”, dhe njëri prej tyre është i çmenduri derisa t'i vijë mendja.

- Allahu e ka dënuar (sharë) atë që nuk përdor mendjen, siç ka përmendur për banorët e zjarrit:

“Dhe thonë: ‘Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit’.” Mulk: 10.

Gjithashtu ka thënë duke dënuar veprimin e atyre që nuk ndjekin Sheriatin dhe udhëzimin e Profetit (salallahu alejhi ue selem):

“Kur u thuhet atyre: ‘Ndiqni atë që ka zbritur Allahu’, ata thonë: ‘Jo! Më mirë të ndjekim çfarë gjetëm nga baballarët tanë’. (A do ta bëjnë këtë?) Edhe pse baballarët e tyre nuk kuptonin gjë dhe nuk ishin të drejtuar?”
Bekare: 170.

- Kur’ani ka përmendur dhe ka nxitur për shumë procese logjike që kryen njeriu si p.sh. mendimi, meditimi, vëzhgimi etj. Në ajetet që vijojnë Allahu i Lartësuar ka thënë:

“A nuk mendojnë thellë për Kur’anin?”, “Në mënyrë që të mendoni”, “A nuk kuptoni?”

- Allahu i ka lavdëruar ata që përdorin logjikën për njohjen e së vërtetës:

“Ndërkaq, ata që u larguan prej adhurimit të idhujve dhe ju drejtuan Allahut, kanë gëzim të madh, e ti përgëzoji robërit e Mi, të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që Allahu i udhëzoi në Rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.” Ez-Zumer: 17-18.

- Allahu ka dhënë shumë shembuj në Kur’an që i shohim ose i dëgjojmë, në mënyrë që ne të logjikojmë e të mendojmë:

“Ai na solli Neve një shembull, e harroi krijimin e vet dhe tha: ‘Kush i ngjall eshtrat duke qenë të kalbura!?’” Ja Sin: 78.

- Allahu në Kur’an ka përmendur shumë fakte që shkojnë sipas standarteve, kritereve dhe arsyeve logjike, si p.sh:

“A mos u krijuam prej kurgjësë, apo ata vetë janë krijues!? A mos ata i krijuan qiejt e tokën!? Jo, por ata nuk janë të bindur.” Et-Tur: 35-36.

“Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) të adhuruar të tjerë me të drejtë përveç Allahut, ato të dyja do të shkatërroheshin.” El Enbija: 22.

“A nuk mendojnë thellë për Kur’anin!? Sikur të ishte prej dikujt tjetër përveç Allahut, do të gjendeshin në të kontradikta të shumta.” En-Nisa: 82.

- Kur’ani ka përcaktuar fushat e mendimit dhe përdorimit të mendjes:

“A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si Ne e kemi ndërtuar atë, e kemi zbukuruar dhe s’ka asnjë të çarë në të!? Edhe tokën! Ne e kemi shtrirë atë dhe kemi vendosur në të male që qëndrojnë fort, si dhe kemi sjellë në të çdo lloj bime të mrekullueshme në çift. Një ndriçim dhe përkujtues për çdo rob që i kthehet Allahut me pendim (rob i cili beson në Njëshmërinë e Allahut, i plotëson detyrat në nënshtrim ndaj Tij dhe që gjithnjë kërkon faljen e Tij).” Kaf: 6-8.

- Përdorimi i gjurmës si argument që tregon për lënësin e saj. Ky është një proces logjik që ka nevojë për njohjen e lidhjes midis pasojës dhe shkakut të saj. Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur’an:

“I cili ka krijuar shtatë qiejt të renditur një përmbi një, ju nuk mund të shihni asnjë gabim në krijimin e të Gjithmëshirëshmit. Kthe pra shikimin përsëri! A mund të shohësh ndonjë të çarë?” El Mulk: 3-4.

- Sqarimi i gjërave që mendja nuk arrin t’i njohë, si p.sh. fjala e Allahut:

“Dhe të pyesin ty (Muhamed a.s.) për ruhin (shpirtin). Thuaj: ‘Ruhu është prej atyre gjërave, dija për të cilën është vetëm tek Allahu’, ndërsa nga Dija (juve o njerëz) ju është dhënë fare pak.” El Isra: 85.

“Ai (Allahu) e di çfarë u ndodh atyre (krijesave të Tij) në këtë botë dhe çfarë do t’u ndodhë atyre (në jetën e fundit) dhe ata kurrë nuk do të përfshijnë ndonjë gjë nga Dija e Tij.” Ta Ha: 110.

Abdullah ibnu Abbasi ka thënë: “Kaderi është një gjë që Allahu e ka bërë sekret, të fshehtë.”

Qëndrimi i “ehli sunetit” ndaj arsyes logjike

Do të përmendim disa pika, të përmbledhura nga shkrimet e ibnu Tejmijes

në këtë fushë, të cilat e sqarojnë këtë qëndrim:

- Njeriu me mendjen e tij ka aftësi t'i kuptojë e t'i njohë gjërat, por bazuar në arsyen logjike, ai mund t'i njohë e t'i perceptojë gjërat (që kanë të bëjnë me besimin dhe rregullat e fesë) në mënyrë të përgjithshme dhe jo në mënyrë të detajuar.

- Argumentet fetare kanë përparësi mbi konkluzionet logjike, për arsye se Sheriati është i pagabueshëm, ndërsa konkluzionet logjike mund të jenë të gabuara. Kjo sepse arsyet logjike janë produkt i mendjes së njeriut, i cili gabimin e ka në natyrën e tij, kurse burimi i argumenteve të Sheriatit është hyjnor.

- Gjykimet logjike që janë të sakta, të qarta e të padiskutueshme, nuk mund të bien ndesh me Sheriatin.

- Arsyet logjike janë të sakta vetëm kur përputhen me Sheriatin, ndërsa kur e kundërshtojnë atë, janë të parregullta e të pavlefshme. Prandaj standardet dhe kriteret logjike që përputhen me Sheriatin janë të sakta, kurse ato që e kundërshtojnë atë janë të pavlefshme.

- Në rast se nga vështrimi sipërfaqësor i një teksti (citati) do të vërehet se ai bie ndesh me një argument të saktë, të qartë e të prerë logjik, kjo padyshim ndodh ose për shkak të një dileme që duhet zbuluar e qartësuar, ose për shkak të interpretimit të gabuar të tekstit, si p.sh. kur fjala ka dy ose më shumë variante që mund të interpretohet dhe njëri prej tyre bie ndesh me arsyen e qartë e të prerë logjike. Kjo gjë tregon se ai variant nuk mund të jetë kuptimi i saj, për shkak se hadithi që bie ndesh me arsyen logjike të saktë, është i dobët ose i trilluar si p.sh.: "Allahu i Lartësuar zbret mbrëmjen e DSitës së Arafatit mbi një devé dhe përqafton kalorësit e ata që ecin në këmbë." Kjo padyshim është gënjeshtër.

- Ligjet dhe rregullat, mund të njihen në mënyrë të detajuar vetëm nëpërmjet Sheriatit, kështu që ato janë prej veçorive të tij.

- Në mënyrë të përgjithshme, njeriu me mendjen e tij e dallon atë që është e

shëmtuar dhe e keqe dhe e dallon atë që është e bukur dhe e mirë, qoftë edhe pa i arritur argumenti fetar. Mirëpo njeriu nuk është i obliguar për asgjë derisa t'i arrijë argumenti fetar, dhe si rrjedhojë, shpërblimi dhe ndëshkimi për veprat e tij varet po nga arritja e argumentit fetar.

- Sheriati mund të sjellë gjëra që e hutojnë mendjen, si p.sh. ndëshkimi i shpirtit së bashku me trupin në varr, por jo gjëra që janë të paarsyeshme e të papranueshme logjikisht.

- Asgjë s'mund t'i bëhet detyrë Allahut përmes asaj që e gjykon mendja e njeriut, sepse Allahu siç ka lajmëruar për veten e Tij është **“Veprues i asaj që dëshiron”**. Por ai mund t'i bëjë detyrë Vetes së Tij atë që dëshiron dhe mund ta ndalojë Vetën e Tij nga ajo që dëshiron, për t'u bërë mirësi robërve të tij, si p.sh. fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem) se Allahu ka thënë në hadith kudsî: **“Unë ia kam ndaluar padrejtësinë vetes time”**, si dhe fjala e tij: **“E drejta e robërve ndaj Allahut është që të mos e ndëshkojë atë që nuk i bën shok atij.”**

- Logjika është burim (referencë) dytësor, e varur nga argumentet fetare dhe e nështruar ndaj tyre. Tekstet e Kur'anit dhe Sunetit janë të mjaftueshme si burime fetare dhe e bëjnë të panevojshëm të bazuarit në konkluzionin logjik, por nuk e pengojnë pranimin e tij kur është i saktë.

Çdo mendim që bie në kundërshtim me këtë që sqaruam lidhur me logjikën, është i pasaktë dhe në kundërshtim me qëndrimin e “ehli sunetit”.

Kreu 8. Xhemati i vërtetë dhe gjërat që lidhen me emrin dhe metodën e daves së tij. Metodën e gabuara të daves dhe qëndrimi i muslimanit ndaj tyre, nxitja për bashkim, dënimi i përçarjes, sqarimi i llojeve të mosmarrëveshjes e të tjera çështje

Ç'do të thotë “ehli suneh uel xhemaah” dhe cilët janë ata

Fillimisht do të shpjegojmë domethënien e çdonjërës prej dy pjesëve që përbëjnë termin “ehli suneh uel xhemaah”.

1- “Es-sunne” në gjuhën arabe do të thotë rrugë. Me këtë kuptim është përdorur në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Do të ndiqni rrugën (senene) e atyre që kanë qenë para jush, pëllëmbë më pëllëmbë e krah për krah, derisa sikur të futeshin në vrimën e hardhucës, do t’i ndiqnit.” I thanë: “O i Dërguari i Allahut, çifutët dhe kristianët do të ndjekim!?” U tha: “Kush mund të jetë tjetër veç këtyre?” Gjithashtu është përdorur në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush punon në Islam një rrugë (sunne) të mirë (d.m.th. bëhet shembull për një punë ose një traditë të mirë e cila është e bazuar në argument), ai e ka shpërblimin e saj dhe do të marrë njëlloj si shpërblimi i atyre që e punojnë këtë vepër të mirë sipas shembullit të tij, duke mos u pakësuar shpërblimi i vepruesve aspak.” Trans. Muslimi.

Sipas dijetarëve të hadithit, Suneti është çdo gjë e transmetuar nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), thëniet, veprat, pohimet (konfirmimet), cilësitë fizike e morale dhe jetëshkrimi i tij, qoftë para Shpalljes apo pas saj.

Kurse qëllimi i dijetarëve të Akides kur përdorin termin “sunne” është: Besimi, veprat dhe thëniet në të cilat ka qenë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe shokët e tij. Prandaj të parët tanë e përdornin fjalën “Sunet” si term që përfshin krejtësisht fenë. Për këtë ka folur Profeti (salallahu alejhi ue selem) në hadithin e transmetuar nga Irbad ibni Sarije: “Na këshilloi i Dërguari i Allahut me një këshillë prej së cilës u frikësuan e u zbutën zemrat dhe lotuan sytë. Atëherë ne i thamë: ‘O i Dërguari i Allahut! Kjo duket sikur është një këshillë lamtumire apo ndarjeje prej nesh, prandaj na porosit (me diçka që t’i përmbahemi pas teje).’ Profeti na tha: ‘U këshilloj t’i frikësoheni Allahut, të dëgjoni dhe të respektoni, edhe sikur prijësi juaj të jetë një rob, sepse kush jeton prej jush do të vërejë shumë përçarje. Prandaj kapuni pas sunetit tim (rrugës sime) dhe sunetit të halifëve të drejtë e të udhëzuar!

Shtrëngojeni atë me dhëmballët tuaj (d.m.th. kapuni fort pas tij)! Ruhuni nga shpikjet në çështjet e fesë sepse çdo bidat është humbje’.” Transmeton ebu Daudi dhe Tirmidhiu, i cili thotë se hadithi është hasen, sahih.

Pikërisht këtë domethënie përfshirëse ka kur thuhet “ehlus suneh”: Ata të cilët besojnë në Akiden e saktë të bazuar në Kur’an dhe Sunet, dhe i refuzojnë të gjitha bidatet, devijimet dhe humbjet që i kanë shpikur njerëzit në çështjet e Akides.

2 - El xhemaah, nga ana gjuhësore është një grup i bashkuar e i papërçarë. Dijetarët me këtë fjalë kanë për qëllim Profetin (salallahu alejhi ue selem), shokët e tij, tabiinët dhe ndjekësit e tij më të mirë deri në Ditën e Gjykimit. Profeti (salallahu alejhi ue selem) e ka përmendur grupin e bashkuar në hadithin e Enes ibn Malik, i cili rrëfen se ai ka thënë: “Në të vërtetë çifutët u përçanë në 72 grupe dhe ky Umet do të përçahet në 73 grupe. Të gjithë do të jenë në zjarr, veç njërit. Ai është ‘el xhema’h’.” Transmeton ibn Maxhe dhe Ahmed. E ka vlerësuar të saktë Albani.

Nga kjo që sqaruam, dalim në përfundimin se “ehli suneh uel xhemaah” janë të kapurit pas Kur’anit, sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem), dhe pas atyre gjërave për të cilat janë pajtuar sahabet dhe pasuesit e tyre deri në ditët e sotme, dhe të cilët nuk kanë kundërshtuar asgjë prej parimeve të fesë. Në këtë përkufizim të “ehli sunetit” përfshihet edhe masa e muslimanëve që pasojnë dijetarët e “ehli sunetit”. Nga ky emër, siç e përkufizua, përjashtohen të gjithë shpikësit, përqafuesit dhe pasuesit e dëshirave dhe bidateve, sepse kanë kundërshtuar parimet që u përmendën më lart, dhe për të cilat është pajtuar “ehli suneti”.

Janë quajtur “ehli sunne” sepse janë të kapur pas Sunetit dhe e ndjekin atë. Grupi i tyre është cilësuar “el xhema’ah” sepse janë të bashkuar në ndjekjen e së vërtetës, e respektojnë prijësin e muslimanëve dhe nuk rebelohen kundër tij.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka folur rreth këtij grupi dhe rrugës e cilësisë së tij, në hadithin që e ka transmetuar Abdullah ibn Amr, i cili thotë se

ai ka thënë: “Do të shfaqen në Umetin tim ato veprime që u shfaqën tek çifutët. Ata do të ecin me veprimet e tyre paralel me atë që e bënë ‘beni israilët’, aq sa nëse ka pasur mes ‘beni israilëve’ të tillë që u vinin nënave të tyre haptasi, do të ketë në Umetin tim që do të veprojnë në këtë mënyrë. Vërtet ‘beni israilët’ u përçanë në 72 grupe dhe ky umet do të përçahet në 73 grupe, të gjithë do të jenë në zjarr, përveç njërit.” “Kush është ky grup o i Dërguari i Allahut (na e përshkruaj neve atë)?”, - i thanë shokët e tij. Profeti u tha: “Janë ata të që e zbatojnë Islamin kështu si unë dhe shokët e mi.” Transmeton Tirmidhiu. Albani thotë se hadithi është hasen.

Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) në fjalën e tij që e përcjell Enes ibn Malik, se grupi i shpëtuar është “el xhemaah”, ka për qëllim grupin që është i kapur pas së vërtetës, qofshin edhe pak, prandaj Abdullah ibn Mes’ud ka thënë: “Xhemati është të qenët në përputhshmëri me të vërtetën, edhe sikur të jesh i vetëm.”

Selefët, selefizmi dhe selefijtë

Çdo të thotë “selef”? Në gjuhën arabe “selef” do të thotë dikush që është para të tjerëve në kohë. Kështu që nga pikëpamja gjuhësore, selefët janë të parët që na paraprijnë si stërgjyshërit, gjyshërit dhe baballarët, pra paraardhësit.

Sipas dijetarëve të Islamit, selefët janë tri gjeneratat e para të këtij Umeti, për të cilat Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka dëshmuar se janë gjeneratat më të mira të të gjitha kohërave. Ai ka thënë në hadithin që e përcjell Imran ibn Husejni: “Më të mirët e njerëzve janë ata që jetojnë në shekullin tim, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre.” Imrani ka thënë se “nuk e di a përmendi Profeti (salallahu alejhi ue selem) dy shekuj pas gjeneratës së tij, apo tre shekuj”. Pastaj i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka vijuar me fjalën e tij: “Pas këtyre gjeneratave vijnë njerëz të cilët tradhetojnë dhe për këtë arsye njerëzit nuk ua besojnë amanetet; dëshmojnë, ndërkohë që nuk u është kërkuar të dëshmojnë; zotohen për kryerjen e disa adhurimeve dhe nuk i

përmbushin zotimet e tyre (premtimet), dhe tek ata shfaqet dhjamosja (mbipesha).” Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Ky hadith tregon se njerëzit më të mirë të Umetit janë sahabet, tabiinët (pasuesit e sahabëve) dhe tabiut-tabiinët (pasuesit e tabiinëve). Për gjeneratën e parë Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur’an:

“Me ata të cilët të parët përqafuan Islamin nga Muhaxhirët (besimtarët që u shpërngulën nga Meka për në Medine) dhe Ensarët (besimtarët e Medines që i strehuan dhe i ndihmuan ata) si dhe ata që i ndoqën besnikërisht ata, me këta Allahu është i kënaqur dhe ata janë të kënaqur me Të. Ai ka përgatitur për ta kopshte të begatë nën të cilët rrjedhin lumenj, për të banuar atje ngaherë. Ky është ngadhënjimi madhështor.” Teube: 100.

Gjithashtu në suren Ahzabë ka thënë:

“Ka prej besimtarëve burra të cilët e mbajtën besën, premtimin që i dhanë Allahut të Lartësuar. Prej tyre ka që vdiqën (ranë dëshmorë duke mbajtur premtimin e Allahut të Lartësuar) dhe prej tyre ka që vazhdojnë të punojnë e të luftojnë dhe aspak ata nuk kanë ndryshuar.”

Dijetarët e Umetit tonë, si në të kaluarën po ashtu edhe në këtë kohë, e përdorin shpesh shprehjen “selefus-salih”, për të parët e mirë të Umetit. Buhariu p.sh. e ka përdorur këtë emërtim në disa vende në “Sahihun” e tij.

Ç’është selefizmi?

Ai është rruga e të parëve të këtij Umeti në besim, ibadete, rregulla, kontrata e marrëdhënie ndërmjet njerëzve, edukim dhe pastrim të shpirtit.

Ç’do të thotë të jesh “selefi”?

Të jesh “selefi” do të thotë të ndjekësh rrugën e selefëve.

Atëherë, “selefi” është ai që ndjek të parët e Umetit në besim, perceptimin e çështjeve të Fikhut, ibadet, sjellje, edukim dhe pastrim të shpirtit. Me këtë kuptojmë se “selefi” i vërtetë është ai që ndjek rrugën e të parëve të Umetit në këto që përmendëm.

Në lidhje me këtë çështje ibn Tejmije në “Mexhmul fetaua”, (4/149) ka thënë: “Nuk ka asnjë mangësi (të metë) ai që shfaq medhhebin e selefëve dhe i dedikohet e i atribuohet atij (medhhebi). Madje kjo duhet të pranohet prej tij pa kundërshtim, sepse medhhebi i selefëve nuk mund të jetë vetëm se i vërtetë.”

Ibnu Haxher, gjatë shpjegimit të fjalës “selef” në “Fethul bari” ka thënë: “Ata janë sahabet dhe ata që kanë ardhur pas tyre. Ndërsa ‘selefi’ është ai që i atribuohet selefëve (të parëve) për të ndjekur rrugën e tyre.”

Me këtë që sqaruam mësojmë se pasimi i rrugës së selefëve në besim, dije dhe praktikë, është detyrë për çdo musliman.

Ndërsa për sa i përket atribuimit me emrin “selefi” ndaj pasimit të tyre, kjo është një gjë e ligjshme, madje është e preferuar, për t’u dalluar nga bidatçinjtë. Të parët e kanë dalluar veten nga bidatçinjtë me emrin “ehlus suneh”, ose “ehlul hadith” etj. Asnjë problem nuk përbën emri, përderisa tregon për kuptim të mirë. Mirëpo në lidhje me emërtimin “selefi” duhet të kemi parasysh tri gjëra:

- E para, nuk lejohet që përdorimi i këtij emri të kthehet në pengesë për daven dhe përhapjen e saj, sepse qëllimi parësor është përmbajtja e vetë daves selefije dhe jo emri “selefi”. Kështu që mund të fillosh me plotësimin e qëllimit, qoftë edhe pa përmendjen e emrit. P.sh., kur thirrësi gjendet në një ambient ku e ka të vështirë përmendjen e këtij emri, atëherë i lejohet ta vonojë dhe nuk e dëmton mospërmendja e tij, sepse mund të fillojë menjëherë daven në Teuhid e Sunet pa përmendur ndonjë emër, mund të bëjë dave duke u identifikuar si “ehlus suneh vel xhemaah”, ose “pasues i metodës së tre shekujve më të mirë” e të tjerë emra që tregojnë për të njëjtën gjë. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) e ka fshirë fjalën “resulull-llah” (i Dërguari i Allahut) në marrëveshjen që bëri me mushrikët në Hudejbije. Nuk ka dyshim se fjala “resulull-llah” është më e madhërishme se fjala “es-selefije”.

- E dyta, nuk lejohet që mosmarrëveshja në lidhje me emërtimin ose mosemërtimin “selefi” të kthehet në grindje e përçarje, përderisa është rënë

dakort në lidhje me rrugën e ndjekur.

- E treta, pretendimi se emri “selefi” është bidat, është i pasaktë, sepse kuptimi është përmbajtja, dhe kuptimi, përderisa është i saktë, nuk ka se si të jetë bidat.

Bazuar në këtë që thamë, ai që e mohon këtë emërtim, nuk është jashtë selefizmit, përderisa e pohon përmbajtjen e tij. Po ashtu edhe ai që e pohon nuk është bidatçi.

Sqarimet e shejh Albanit lidhur me selefët, selefijtë dhe rrugën e tyre

Pyetje - Cili është realiteti i selefizmit?

Përgjigje - Kur ne themi “selefët”, kemi për qëllim palën, grupin më të mirë të njerëzve që janë gjendur mbi faqen e dheut pas të dërguarve. Ata janë shokët e Profetit (salallahu alejhi ue selem) të cilët kanë jetuar në shekullin e parë dhe pas tyre tabiinët, të cilët kanë jetuar në shekullin e dytë dhe tabit-tabiinët (pasuesit e tabiinëve) të cilët kanë jetuar në shekullin e tretë pas Profetit (salallahu alejhi ue selem). Pra njerëzit e tre shekujve janë selefët (të parët). Përderisa Umeti ynë është më i miri i të gjithë Umeteve, nga kjo konstatojmë se ata që ishin mbas Profetit (salallahu alejhi ue selem) janë më të mirët e njerëzve me përjashtim të të dërguarve dhe enbijave.

Kur flasim për njerëz që i dedikohen selefëve, kjo do të thotë se i dedikohen tre shekujve më të mirë d.m.th. pasojnë tre shekujt më të mirë. Duhet të kemi parasysh se kjo nuk do të thotë t’i përkasim dhe t’i atribuohemi një personi të caktuar apo një grupi që mund të jetë në gabim ose në humbje të tërësishme ose të pjesëshme.

Shenja e grupit të shpëtuar nuk është vetëm pretendimi që po ndjekim Kur’anin dhe Sunetin, siç thonë disa grupe të kësaj kohe. Nuk mund të jetë shenja e grupit të shpëtuar vetëm deklarimi se i përket punës sipas Kur’anit dhe Sunetit, sepse këtë përkatësi nuk mund ta mohojë asnjë musliman, edhe sikur të mos jetë nga grupi i shpëtuar. Pra asnjëri prej grupeve të humbura, qofshin në të

kaluarën apo në kohën tonë, nuk mund të deklarojë se nuk ndjek Kur'anin dhe Sunetin, sepse nëse do ta deklarojë një gjë të tillë, kjo do të thotë të ngrejë flamurin e daljes nga Islami. Prandaj të gjitha xhematet islame dhe grupet që Profeti (salallahu alejhi ue selem) i ka përmendur dhe ka treguar për to në hadithin e kaluar, kanë një gjë të përbashkët, e cila është deklarimi që ndjekin Kur'anin dhe Sunetin. Kurse ata që i përmendëm në fillim të kësaj fjale, selefijtë dhe të tjerët që ecin në rrugën e tyre e i përmbahen drejtimit të tyre, megjithëse mund të quhen me emër tjetër, ndryshojnë nga grupet e tjera islame, sepse ndjekin edhe diçka tjetër e cila i mbron të mos dalin nga Kur'ani dhe Suneti me pretendimin se po i ndjekin ato. Kjo mburojë është të kapurit pas asaj që kanë qenë dhe kanë vepruar shokët e Profetit (salallahu alejhi ue selem), muhaxhirët dhe ensarët, ndjekësit dhe ndjekësit e ndjekësve të tyre (tabiinët dhe ndjekësit e tabiinëve), në shekujt që Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka dëshmuar se janë më të mirët, në hadidhin e saktë, madje në hadithin “mutevatir”: “Më të mirët e njerëzve janë shekulli im, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas atyre”

Ndjekësit e brezit të parë, brezit të sahabëve të mire e të pastër, pastaj ata që erdhën pas tyre thonë: **“Zoti Ynë, na fal ne dhe vëllezërit tanë që na paraprinë në besim”**

Kush dëshiron që të jetë prej grupit të shpëtuar, patjetër duhet të përfundojë tek punimi i asaj që kanë qenë në të sahabët dhe tabiinët, këta janë selefët e mirë të cilët ne i marrim për shembull dhe i ndjekim.

(Marrë nga: “El menhexhu es-selefi inde shejh el Albani”)

Është pyetur gjithashtu - “Pse të quhemi selefij? Kjo është propagandë për t’u bërë parti, grup apo medhheb, apo ky është një grupim i ri në Islam?”

Shejh Albani u përgjigj - Fjala “Selef” është e njohur në gjuhën arabe dhe në gjuhën e Sheriatit. Ajo që na intereson tani është sqarimi i kësaj fjale nga ana e Sheriatit. Ka ardhur në hadithe të sakta nga Profeti (salallahu alejhi ue selem), se ai në sëmundjen e vdekjes së tij, i ka thënë zonjës Fatime (radijallahu anha): “Frikësoju Allahut dhe duro, sa selef (paraardhës) i mirë jam unë për ty.” Dijetarët e përdorin shumë fjalën “selef”. Kjo është përmendur aq shumë në

fjalët e tyre saqë nuk mund të numërohet dhe të llogaritet. Na mjafton të marrim një shembull për këtë. Për të luftuar bidatin ata thonë: *“Çdo e mirë është në ndjekjen e Selefëve (të parëve) dhe çdo e keqe është në shpikjet e atyre që kanë ardhur më vonë, halefijve.”*

Por disa që pretendojnë se kanë dije, e mohojnë këtë dedikim (përkatësi) duke menduar se kjo nuk ka bazë, dhe thonë: “Nuk i lejohet muslimanit të thotë ‘unë jam selef’.” Të thuash kështu është njëlloj sikur të thuash se nuk i lejohet muslimanit të thotë “unë ndjek selefët e mirë në Akiden, ibadetin dhe sjelljen e tyre”. Nuk ka dyshim se sikur ta ketë me qëllim këtë mohim, kjo do të thotë të deklarojë se nuk është në Islamin e saktë që ishin në të “selefu-salih”, në krye të të cilëve ka qenë Profeti (salallahu alejhi ue selem). Siç tregon hadithi “mutevatir” në “Sahihun” e Buhariut dhe të Muslimit e të tjerë: “Më i miri i njerëzve është shekulli im pastaj ata që vijnë pas tij, pastaj ata që vijnë pas tyre.”

Nuk i lejohet muslimanit të mos i ndjekë selefët e mirë dhe të mos i dedikohet e t’i përkasë rrugës së tyre. Ndërkohë, në qoftë se do të deklarojë se nuk ka asnjë përkatësi tjetër, asnjë i ditur nuk mund ta cilësojë “kafir” ose të prishur, gjynanqar. Ai që e mohon këtë emërtim (të emërtuarit “selef”), mos vallë nuk i përket asnjë medhhebi, qoftë ky medhheb në lidhje me Akiden apo me Fikhun?!

Ai do të jetë eshari ose maturidi (përsa i përket Akides) dhe prej “ehlul hadithit” (ndjekësve të hadithit) ose hanefi, shafii, maliki, hanbeli (përsa i përket Fikhut). Këto medhhebe përfshihen nën emërtimin “ehlus-sunneh vel xhemaah”. Përderisa i përket medhhebit esharij, apo njërit nga katër medhhebet, kjo do të thotë që u atribohet personave që padyshim nuk janë të pagabueshëm, megjithëse ndërmjet tyre ka dijetarë që e qëllonjë të vërtetën. Atëherë pse nuk e mohon përkatësinë në medhhebet e disa personave, të cilët nuk janë të pagabueshëm?

Kurse ai që u dedikohet selefëve të mirë, faktikisht i përket dhe i dedikohet rrugës që është e mbrojtur nga gabimi në përgjithësi. Shenja e grupit të shpëtuar, sipas asaj që ka përmendur Profeti (salallahu alejhi ue selem), është

kapja pas asaj që ka qenë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dhe shokët e tij. Atij që kapet pas rrugës së tyre, padyshim që Zoti i tij i ka dhuruar udhëzim.

Përkatësia në rrugën e selefëve të mirë të jep nder dhe ta lehtëson ndjekjen e rrugës së grupit të shpëtuar. Këtë gjë nuk e arrijnë ata që kanë përkatësi të tjera, sepse këto përkatësi ose janë dedikim ndaj një personi që nuk është i pagabueshëm, ose dedikim ndaj atyre që ndjekin rrugën e këtij personi që nuk është i mbrojtur nga gabimi. Kështu që përsëri nuk janë bazuar në pagabueshmëri. Ndërsa rruga e shokëve të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) është e mbrojtur nga gabimi. Profeti (salallahu alejhi ue selem) na ka urdhëruar të kapemi pas sunetit të tij dhe pas rrugës së shokëve të tij.

Ne këmbëngulim dhe kërkojmë që kuptimi i Kur'anit dhe Sunetit të bëhet sipas “menhexhit” të sahabëve, në mënyrë që të jemi të mbrojtur nga animi majtas e djathtas dhe që të mos devijojmë me ndonjë botëkuptim të ri, që nuk ka argument të mbështetur nga Kur'ani dhe suneti i të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem).

Lind pyetja: Pse të mos na mjaftojë përkatësia e Kur'anit dhe Sunetit (cilësia se ndjekim Kur'anin dhe Sunetin)?

Dy gjëra janë shkak. Njëra prej tyre ka të bëjë me argumentet e Sheriatit dhe tjetra ka të bëjë me aktualitetin e grupeve islame.

Përsa i përket shkakut të parë, në argumentet e Sheriatit gjejmë urdhër për t'ju bindur edhe diçkaje tjetër përveç Kur'anit dhe Sunetit. Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur'an:

“Kush e kundërshton të Dërguarin pasi që iu bë i qartë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne do ta mbajmë në atë që ka zgjedhur, do ta fusim në xhehenem dhe sa përfundim i keq që është ky.”
(En-Nisa 115)

Nuk ka dyshim se Allahu nuk i përmend fjalët kot, pa qëllim. Sigurisht që Allahu e ka përmendur rrugën e besimtarëve në ajet për urtësi dhe dobi të plotë e të qartë. Ajeti tregon për një vaxhib të rëndësishëm, i cili është se ndjekja e librit të Allahut dhe sunetit të të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) duhet të jetë në përputhshmëri me atë që kanë praktikuar muslimanët e parë. Ata janë

sahabët e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) pastaj ata që vijnë mbas tyre, pastaj ata që vijnë mbas tyre. Kjo është “davja selefije” dhe në këtë gjë është përqendruar themeli dhe metoda e saj edukative. Davja e vërtetë selefije e bashkon Umetin, ndërsa çdo dave tjetër e përçan atë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Jini me të drejtët.”** Ai që ndan ndërmjet Kur’anit e Sunetit nga njëra anë dhe ndërmjet selefëve të mirë nga ana tjetër, nuk mund të jetë kurrë i çiltër, besnik e i drejtë.

Ndërsa për sa i përket shkakut të dytë, grupet dhe partitë bashkëkohore nuk e përfillin fare ndjekjen e rrugës së besimtarëve që është përmendur në ajet dhe që e kanë përforcuar disa hadithe, prej të cilëve është hadithi i 73 grupeve, ku Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka lajmëruar se të gjitha janë në zjarr përveç një grupi. I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e ka përshkruar: “...se është grupi i kapur pas asaj që jam unë dhe shokët e mi.” Gjithashtu prej haditheve që përmendin cilësinë e grupit të shpëtuar dhe palës së ndihmuar është hadithi i Irbad bin Sarijete në të cilin thuhet: “Kapuni pas sunetit tim dhe sunetit (rrugës) të halifëve të drejtë e të udhëzuar pas meje.”

Atëherë ne kemi të bëjmë me dy sunete (dy rrugë), atë të të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) dhe sunetin e halifëve të drejtë. Domosdoshmërisht ne të mëvonshmit duhet të kthehemi tek Kur’ani, Suneti dhe rruga e besimtarëve të parë. Nuk lejohet të themi: “Vërtet ne e kuptojmë Kur’anin dhe Sunetin në mënyrë të pavarur, pa iu kthyer asaj që kanë qenë në të selefët e mirë.” Në këtë kohë është e domosdoshme të kesh një përkatësi (rrugë dhe metodë që i dedikohesh), e cila të dallon nga grupet e tjera. Nuk është e mjaftueshme të themi “Unë jam musliman” dhe vetëm kaq! Ose “Medhhebi im është Islami”! Sepse të gjitha grupet e thonë këtë si rafiditë, ibaditë, kadjanitë etj. Çfarë gjëje të bën të dallosh nga ata!?

Sikur të thuash “Unë jam musliman i bazuar në Kur’an dhe në Sunet”, nuk do të ishte e mjaftueshme gjithashtu, sepse pasuesit e grupeve si esharitë, maturiditë dhe ndjekësit e partive (hizbijtë) pretendojnë që i ndjekin këto dy baza. Nuk ka dyshim se emërtimi i qartë që të dallon nga grupet e tjera është të thuash “Unë jam musliman i kapur pas Kur’anit dhe Sunetit sipas metodës së të

parëve tanë të mirë”. E thënë me një fjalë në mënyrë të shkurtuar, “Unë jam selefi”.

Nga kjo që sqaruar rezulton se e vërteta, të cilës nuk mund t’i shmangemi, është se nuk mjafton të bazohemi në Kur’an dhe në Sunet pa iu kthyer metodës së selefëve tanë të mirë, e cila na sqaron mënyrën e kuptimit të dy bazave, mënyrën e përfytyrimit, mësimin dhe praktikimit të tyre, mënyrën e ftimit në to dhe mënyrën e xihadit për mbrojtjen ose përhapjen e tyre. Ne e dimë se të parët nuk kanë qenë fanatikë ndaj një medhhebi ose personi të caktuar. Ata nuk u ndanë në njerëz që i përkisnin dhe pasonin ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin ose Aliun. Pra ata nuk ishin të ndarë në medhhebe si bekrij, umerij, uthmanij dhe alijij, por kur u jepej mundësia të pyesnin ebu Bekrin, Umerin ose ebu Hurejren, i pyesnin. Kjo sepse ata besuan që nuk lejohet të ndjekësh në mënyrë absolute përveçse një person të vetëm: ai është i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) i cili nuk flet sipas dëshirës së tij. Ajo që ai e thotë nuk është vetëm se shpallje që i shpallet.

Sikur thjesht për dialog të pranohim të quheshim vetëm muslimanë, pa thënë se jemi selefij (i përkasim selefizmit), megjithëse kjo është një përkatësi e lartë, e nderuar dhe e saktë, a do të pranohim ata të mos emërtoheshin me emrat e partive të tyre, të medhhebeve të tyre ose të rrugëve të tyre, sidomos kur ato janë të paligjshme dhe të pasakta!? Ju mjafton ky dallim ndërmjet nesh, çdo enë do të nxjerrë atë që ka brenda.

(Marrë nga: “El menhexhu es-selefi inde shejh el Albani”.)

A është emërtimi me emrin “selefi” bidat? Disa kanë thënë se emërtimi “selefi” është bidat sepse sahabët në kohën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) nuk janë emërtuar me këtë.¹⁷⁰

Përgjigje - Nuk ka qenë përdorur fjala “selefi” në kohën e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe shokëve të tij, sepse muslimanët e parë kanë qenë në Islamin e saktë. Nuk ka pasur nevojë për fjalën selefi, se ata ishin

¹⁷⁰) Është një pyetje që e ka formuluar një nxënës i shejh Albanit në një libër të tijin dhe i ka kthyer përgjigjen duke e përforcuar me një dialog të shejh Albanit të regjistruar në një kasetë të serisë “Silsiletu huda uen-nur”.

në natyrën e pastër (Islamin e vërtetë), ashtu siç edhe kanë qenë folës të arabishtes së pastër pa gabime gjuhësore. Prandaj nuk kanë qenë të nevojshme rregullat gramatikore (gjuhësore), derisa u shfaq gabimi në të shprehur. Atëherë lindi nevoja për këtë dije që rregullonte këto devijime gjuhësore. Po kështu, kur u shfaq devijimi i grupeve nga xhemati (bashkësia) i muslimanëve, lindi nevoja e përdorimit të emrit “selefi” ngaqë i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka tërhequr vëmendjen për të, në hadithin e ndarjes së Umetit tek fjala e tij: “Në atë që jam sot unë dhe shokët e mi.”

Kur u shtuan grupet dhe çdonjëri pretendonte se është në rrugën e drejtë, në rrugën e Kur’anit dhe Sunetit, atëherë dijetarët e Umetit, për të bërë dallimin ndërmjet tyre dhe grupeve të humbura, thanë se ne jemi pasuesit e hadithit dhe të selefëve. Selefijtë dallojnë nga grupet e tjera islame, duke iu atribuar asaj që u siguron atyre vazhdimësinë në rrugën e saktë të Islamit. Kjo gjë është kapja, shtrëngimi pas asaj që kanë qenë sahabët e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) prej muhaxhirëve dhe ensarëve, si dhe atyre që i ndoqën ata në të mirë. Këta janë njerëzit e tre shekujve për të cilët është dëshmuar se janë më të mirët.

Thuhet se pse ta emërtojmë veten tonë “selefi”, kur Allahu thotë në suren Haxh 78: **“Ai ju ka emërtuar juve muslimanë qysh përpara...”**?

Atëherë le të sjellim për lexuesin e nderuar dialogun e mprehtë e të bukur mes shejhut tonë (Allahu e ruajtë!), (në atë kohë shejhu ka qenë gjallë), dhe profesor Abdul Halim ebu Shikatu, autori i librit “Tahrirul mereti fi arsi erisaleti”.

Shejhu - Nëse do të të pyesë dikush se çfarë medhhebi ke (ndjek), ç’do të thuash? Të thuash musliman, kjo nuk mjafton.

Profesori - Allahu na ka emërtuar ne muslimanë. (Dhe lexoi fjalën e Allahut në suren Haxh 78.)

Shejhu - Kjo është përgjigje e saktë nëse ne do të ishim në kohët e mëparshme, përpara se të përhapeshin grupet. Sikur ne të pyesim tani ndonjë prej këtyre grupeve me të cilat ndryshojmë rrënjësisht në Akide, nuk do të ndryshonte përgjigjja e tij nga kjo fjalë. Të gjithë: shiitët, rafiditë, hauarixhiët,

durxhitë, nusajritë, elalevijtë, do të thoshin: “Ne jemi muslimanë”. Atëherë kjo nuk mjafton në këto ditë.

Profesori - Unë atëherë them se jam musliman i bazuar në Kur’an e Sunet.

Shejhu - Edhe kjo gjithashtu nuk mjafton.

Profesori - Pse?

Shejhu - A ka ndonjë nga këta që ne i morëm si shembull, të thotë se është musliman por jo sipas Kur’anit dhe Sunetit? Kush është ai që thotë se unë nuk jam musliman i bazuar në Kur’an dhe Sunet?

(Pastaj Shejhu sqaroi rëndësinë që ka edhe kjo shtesë që ne e kemi adoptuar, e cila është Kur’ani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve).

Profesori - Atëherë unë jam musliman sipas Kur’anit dhe Sunetit ashtu siç e kanë kuptuar selefët e mirë.

Shejhu - Nëse të pyet dikush për medhebin tend, a do t’ia thuash atij këtë?

Profesori - Po.

Shejhu - Çfarë mendimi ke ti, ta shkurtojmë këtë nga ana gjuhësore, pasi më e mira fjalë është më e shkurtra e më domethënësia, e të themi “selefi”?

Profesori - Ndoshta këtu për të të bërë qejfin ty po them po, mirëpo besimi im nuk i ka paraprirë kësaj, sepse së pari, kur njeriu dëgjon se ti je selefi, i shkon mendja te shumë gjëra që praktikohen, në të cilat ka ashpërsi.

Shejhu - E supozojmë se fjala jote është e saktë. Kur ti të thuash se je musliman, a nuk të shkon mendja tek shiitët, rafiditë ose durxhijtë e ismailijtë etj.?

Profesori - Mundet, por unë (i jam përmbajtur) kam ndjekur ajetin: “**Ai ju emërtoi të këtillë më parë**”.

Shejhu - Jo o vëlla, ti nuk e ke ndjekur ajetin, se ajeti ka për qëllim Islamin e saktë dhe duhet t’u flitet njerëzve sipas kapacitetit logjik të tyre. A kupton ndonjëri nga ata prej teje, se ti je musliman sipas kuptimit të ajetit? Kurse gjërat që ti u ruhesh dhe të cilat i përmende, mund të jenë të sakta ose jo. Ashpërsia mund të jetë tek disa persona, mirëpo nuk është metodë besimi e pune. Atëherë

le t'i lëmë këto persona ngaqë këtu ne po flasim për menhexhin. Qëllimi ynë me emrin “selefi”, është të dallojmë nga grupet e humbura si shiitët, durxhitë, havarixhët, sufite ose mutezilitët, kështu që shqetësimet që përmende nuk kanë pse të lindin këtu. Atëherë ajo që përmende në lidhje me disa persona nuk është tema jonë, sepse ne po kërkojmë një fjalë që tregon për medhhebin e personit, me të cilin i bindet Allahut. Sahabët, a nuk kanë qenë të gjithë muslimanë?

Profesori - Po.

Shejhu - Mirëpo ka pasur prej tyre edhe ndonjë që vodhi, e ndonjë tjetër që bëri imoralitet. Kjo nuk u bë shkas për askënd prej atyre që të thotë: “Unë nuk jam musliman”. Sahabiu që ka gabuar është musliman, besimtar në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) si menhexh. Mirëpo ndoshta e kundërshton menhexhin e tij ndonjëherë, se ai nuk është i siguar e i ruajtur nga gabimet.

Barekallahu fik! (Allahu të begatoftë!) Prandaj ne po flasim për një fjalë që tregon për Akiden tonë dhe mendimin tonë, për pikënisjen tonë në jetën tonë, në çështje që kanë lidhje me fenë tonë me të cilën e adhurojmë Allahun. për sa i përket çështjes se filani është i ashpër ose tolerues, kjo është çështje tjetër.

Dua që ti të mendohesh në këtë fjalë të përmbledhur që të mos mbetesh këmbëngulës në fjalën “musliman”, duke qenë se ti e di se nuk ka ndonjë që kupton prej teje atë që ti do të thuash me këtë fjalë, kurrë. Atëherë folu njerëzve sipas logjikave të tyre dhe Allahu të begatoftë në përgjigjen tënde.

Grupi i shpëtuar (el firkatun naxhije)

Ky emër është marrë nga kuptimi i hadithit të përçarjes së Umetit në 73 grupe, të cilët do të përfundojnë të gjithë në zjarr, përveç një grupi që do të shpëtojë. Për këtë arsye, grupi që Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka lajmëruar se do të shpëtojë, ka marrë emrin “grupi i shpëtuar”. Ibnu Tejmija ka thënë: “Përderisa grupi i shpëtuar është cilësuar se janë pasuesit e sahabëve që shoqëruan Profetin (salallahu alejhi ue selem), dhe kjo gjë është simboli dhe

rruga e ‘ehli sunetit’, atëherë ata janë grupi i shpëtuar.”

Pala e ndihmuar (et-taifetul measure)

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë në hadithin e Muauijes: “Do të vazhdojë të qëndrojë një grup prej Umetit tim i kapur pas së vërtetës. Atyre nuk u bën dëm askush që i braktis (nuk i ndihmon) apo i kundërshton. Kështu ata do të vazhdojnë të jenë ngadhënjimtarë, triumfues e të shfaqur mes njerëzve, derisa të vijë Dita e Gjykimit.” Transmeton Muslimi.

Gjithashtu në një hadith tjetër, të cilin e transmeton Theubani, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Do të vazhdojë një grup prej Umetit tim të jetë i shfaqur e ngadhënjimtar me të vërtetën, të cilin nuk e dëmton ai që e braktis dhe nuk e ndihmon. Ai do të vazhdojë të qëndrojë i pandryshueshëm, derisa të vijë Dita e Gjykimit.” Transmeton Muslimi. Këtë hadith e kanë transmetuar edhe mjaft të tjerë nga shokët e Profetit (salallahu alejhi ue selem), gjë e cila tregon se hadithi është i njohur ose “mutevahir”.

Dijetarët kanë thënë se “pala e ndihmuar” janë të diturit rreth hadithit të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem). Prej dijetarëve që e kanë thënë këtë, përmendim këtu Abdullah ibnul Mubarek, Ali ibnul Medini, Jezid ibn Harun, Ahmed ibn Hanbel, Ahmed ibn Sinan, Muhamed ibn Ismail el Buhari e të tjerë. Të diturit rreth hadithit të Profetit (salallahu alejhi ue selem) janë “pala e ndihmuar”, sepse ata e njohin Sunetin dhe çdo gjë që ka të bëjë me hadithin. Ata janë njerëzit më të ditur rreth sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem), udhëzimit të tij, sjelljes e moralit të tij, luftrave të tij dhe të çdo gjëje që lidhet me të. Gjithashtu, sepse ata e praktikojnë dhe e zbatojnë Sunetin dhe i japin përparësi atij para mendimeve, thënieve dhe shijeve të njerëzve. Kjo për faktin sepse e njohin atë dhe pas tij do të jenë të kapur. Ndërkohë që të tjerët të cilët nuk e njohin Sunetin dhe nuk merren me studimin e tij, janë fanatikë për mendimet dhe thëniet e tyre, apo të mësuesve e të dijetarëve të tyre, të cilat bien

ndesh me të.

Në palën e ndihmuar dhe grupin e shpëtuar përfshihet edhe masa e muslimanëve që pasojnë dijetarët e hadithit në besim, ibadet, rregulla e sjellje, por që nuk janë të ditur. Sepse edhe në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), njerëzit nuk kanë qenë të gjithë dijetarë, por ka pasur të ditur dhe të paditur. Imam Neveviu në “Sherh sahihul Muslim” rrëfen se Kadi I’jad, në lidhje me thënien e imam Ahmedit ka thënë: “Ahmedi përmes fjalës së tij ka pasur për qëllim ‘ehlus suneh vel xhemaah’, të cilët janë të gjithë ata që kanë besimin e ‘ehlil hadithit’ (të diturit rreth hadithit dhe pasuesit e tij).”

Të diturit rreth hadithit dhe pasuesit e tij (ehlul hadithi uel ether)

Meqenëse “ehli suneh uel xhemaah” e njohin hadithin e saktë të Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem), punojnë me të dhe i japin përparësi atij përpara logjikës dhe thënieve të njerëzve të humbur, si dhe u largohen bidateve, janë quajtur “ehlul hadith”.

Drejtuar atyre të cilët nuk i japin rëndësi fjalës “Filani, është apo nuk është selefi”¹⁷¹

Është pyetur shejh ibn Uthejmini - Kush janë veçoritë më të dukshme të grupit të shpëtuar? Mangësia në këto veçori a e nxjerr njeriun prej këtij grupi?

Përgjigje - Më e dukshme veçori e grupit të shpëtuar është të kapurit mbas asaj çka ka qenë në të i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), në Akide,

¹⁷¹) Ky material është përkthyer nga libri i dijetarit të madh të Islamit në këtë kohë, fakihut dhe edukatorit Muhamed ibn Salih el Uthejmin (rahimehullah) “Fetaua arkanil Islam”, fq. 22-26. (Shën. i përkthyesit)

adhurim, moral dhe marrëdhënie. Këto katër gjëra janë cilësi të dukshme të grupit të shpëtuar.

- Në Akide i gjen të shtrënguar pas asaj që dëshmon libri i Allahut dhe suneti i të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem), siç është njësimi i Allahut në adhurim, “rububije” dhe në emrat dhe cilësitë e Tij.

- Në adhurim ky grup dallohet për praktikimin e çdo gjëje të cilën e ka praktikuar Profeti (salallahu alejhi ue selem), qoftë në llojet e adhurimit, format, masën, kohët, vendet dhe shkaqet e tij. Për këtë arsye ata nuk i vëren të bëjnë bidate në fe. Përkundrazi, ata janë shumë të edukuar me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), prandaj nuk i japin përparësi asgjëje para asaj që ka ligjëruar Allahu dhe i Dërguarit i Tij, si dhe nuk bëjnë asgjë prej adhurimeve që nuk i ka lejuar Allahu.

- Në sjellje dallojnë nga të tjerët me moralin e lartë që kanë, si p.sh. dëshirimi i së mirës për muslimanët, zemërgjerësia, fytyra e qeshur, fjala e mirë, bujaria, trimëria e të tjera morale të larta dhe sjellje të mira.

- Karakteri i marrëdhënieve dhe kontratave të tyre me njerëzit, është vërtetësia dhe qartësia, dy cilësi këto të cilat i ka përmendur Profeti (salallahu alejhi ue selem) në fjalën e tij: “Shitësi dhe blerësi janë të lirë të zgjedhin përderisa nuk janë ndarë, nëse ata thonë të vërtetën dhe qartësojnë (të metat e mallit), u jepet bereqet në shitblerjen e tyre. E nëse gënjejnë dhe fshehin, zhduket bereqeti i shitblerjes së tyre.”

- Mangësia në çështjen e Teuhidit mundet që ta nxjerrë njeriun nga grupi i shpëtuar, si p.sh. mangësia në sinqeritet, po kështu edhe bidati. Njeriu mundet të shpikë ose të bëjë bidate që e nxjerrin nga ky grup. Ndërsa mangësia në moral dhe marrëdhënie nuk e nxjerr njeriun nga grupi i shpëtuar, edhe pse ia ul gradën.

- Në çështjen e moralit kemi nevojë për sqarim. Prej gjërave më të rëndësishme në moralin e njeriut është përputhja me të vërtetën, gjë për të cilën na ka porositur Allahu i Madhëruar në fjalën e Tij:

“Ai (Allahu) ka përcaktuar e urdhëruar për ju të njëjtën Fe (Besimin e pastër islam në një Zot të vetëm) të cilën Ai e pati urdhëruar për Nuhun, atë

të cilën Ne ta kemi frymëzuar ty dhe atë të cilën Ne e urdhëruam për Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë që ju të vini në zbatim çfarë përmban e urdhëron Feja e Allahut dhe të mos bëni ndarje në të (në degë e parti).” Esh-Shura: 13.

Po ashtu na ka njoftuar se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) është i pastër dhe larg prej atyre që e përçanë fenë e tyre dhe u bënë grupe-grupe:

“Vërtet me ata që e ndajnë fenë e tyre dhe përçahen në sekte e grupe (të çfardo lloji qofshin), ti (O Muhamed) nuk ke aspak të bësh.” En Aam: 159.

Për këtë arsye, uniteti dhe bashkimi i zemrave është prej veçorive më të dalluara të grupit të shpëtuar (ehli sunne uel xhema).

- Nëse ndodh një mosmarrëveshje në mesin e grupit të shpëtuar si rrjedhojë e “ixhtihadit” në çështje ku ai është i pranueshëm, asnjëri prej tyre nuk armiqëson e ta urrejë tjetrin, përkundrazi, ata besojnë se janë vëllezër me njëri-tjetrin edhe pse ka mes tyre mosmarrëveshje, aq sa dikush prej tyre falet pas atij që e konsideron pa abdes sipas mendimit të tij në fik’h, për arsye se imami e konsideron veten me abdes në bazë të mendimit të tij. P.sh. një person falet pas një imami që ka ngrënë mish deveje dhe nuk ka marrë abdes, sepse imami ka pranuar mendimin se ngrënia e mishit të deveve nuk ta prish abdesin, ndërsa personi që falet pas tij është i mendimit se ngrënia e mishit të deveve ta prish atë, e megjithatë e shikon namazin pas tij të saktë, edhe pse një gjë të tillë, nëse do ta vepronte vetë, do ta konsideronte të pasaktë. E gjitha kjo, për arsyen se ata mendojnë që mosmarrëveshja e lindur nga “ixhtihadi”, në çështje ku ai lejohet, në realitet nuk është mosmarrëveshje, sepse çdonjëri sipas mendimit të tij ka ndjekur atë që ia obligojnë argumentet, të cilat nuk i lejohet t’i kundërshtojë. Ata mendojnë se vëllai i tyre është i bashkuar me ta, edhe nëse i kundërshton në ndonjë çështje, si rrjedhojë e mbështetjes në një argument që është i vlefshëm, sipas mendimit të tij. Grupi i shpëtuar fton për pasimin e argumentit kudo qoftë ai, kështu që nëse ndonjëri i kundërshton të tjerët për të qenë në pajtim me argumentin që e mendon të vlefshëm, në realitet ai është në përputhje me ta, sepse ka ndjekur parimin në të cilin të gjithë i thërrasin e i udhëzojnë njerëzit, dhe që është zbatimi i Librit të Allahut dhe Sunetit. Mosmarrëveshjet që kanë

ndodhur mes sahabëve në çështje si shembulli i këtyre, janë të njohura, derisa edhe në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) ka pasur mosmarrëveshje të kësaj natyre, e megjithatë ai nuk ka kritikuar dhe nuk ka qortuar asnjërin për to.

Kur u kthye Profeti (salallahu alejhi ue selem) prej luftës së Ahzabit, i erdhi Xhibrili dhe i tregoi që të drejtohej për tek fisi Beni Kurejdha, të cilët e prishën marrëveshjen. Profeti (salallahu alejhi ue selem) dha urdhër që të niseshin shokët e tij dhe u tha: “Të mos e falë askush prej jush ikindinë pa arritur tek Beni Kurejdha.” Shokët e tij dolën nga Medina dhe u drejtuan për në Beni Kurejdha, por lindi një mosmarrëveshje lidhur me faljen e namazit të ikindisë. Disa prej tyre e vonuan derisa arritën atje dhe e falën pasi kishte dalë nga koha, sepse zbatuan urdhërin e Profetit (salallahu alejhi ue selem), ndërsa të tjerët e falën namazin në kohën e tij dhe thanë: “Profeti (salallahu alejhi ue selem) donte prej nesh që të dilnim sa më shpejt dhe nuk kishte për qëllim të vononim namazin nga koha e tij.” Këta të fundit e qëlluan të vërtetën.¹⁷² E megjithatë Profeti (salallahu alejhi ue selem) nuk qortoi asnjërin prej dy grupeve dhe asnjëri prej tyre nuk krijoi armiqësi ndaj tjetrit dhe as urrejtje, për shkak të mosmarrëveshjes në kuptimin e këtij teksti.

Për këtë arsye, e shoh obligim mbi muslimanët të cilët pasojnë Sunetin, që të jenë një Umet i vetëm dhe të mos krijohen mes tyre grupacione duke u anëtarësuar njëri në një grupacion, tjetri në një grupacion të dytë, e i treti në një grupacion të tretë e me radhë, saqë fillojnë të kacafyten mes njëri-tjetrit me një fjalor të ashpër dhe lind armiqësia e urrejtja mes tyre për shkak të disa çështjeve, në të cilat “ixhtihadi” është mëse i pranueshëm. Nuk është e nevojshme që të përmend çdo grupacion me emrin e tij, sepse i mençuri kupton dhe i qartësohen çështjet.

E shoh se është obligim mbi “ehli sunne uel xhema” që të bashkohen edhe nëse nuk pajtohen në gjëra të cilat sipas perceptimit të tyre, nuk kundërshtojnë argumentet e Kur’anit dhe Sunetit, sepse kjo është diçka e gjerë, elhamdulillah. I rëndësishëm është bashkimi i zemrave dhe unifikimi i qëndrimeve, sepse armiqtë e muslimanëve dëshirojnë që muslimanët të përçahen, qofshin ata

) Nuk përmendet tekstualisht në hadith se kush e qëlloi të vërtetën, por kjo kuptohet nga qëllimi i Profetit ¹⁷² (salallahu alejhi ue selem) dhe argumentet e tjera të Sheriatit.

armiq të hapur, apo armiq të cilët na shfaqen si miq të muslimanëve apo të Islamit dhe nuk janë të tillë.

Është obligim që të dallohemi me këtë gjë, e cila është edhe veçori dalluese e grupit të shpëtuar, pra ajo është bashkimi në një fjalë të vetme.

(“Fetava erkanil Islam”, fq. 22-26.)

Shejh Albani dhe parimi i pastrimit dhe i edukimit (et-tesfije dhe et-terbije)

Ne sot jetojmë në një kohë kur muslimanët kanë rënë në një shkallë shumë të ulët poshtërimi dhe robërimi nga të tjerët. Kaq ulët kanë rënë muslimanët sot, saqë nuk është e mundur të bjerë më poshtë dhe më keq se kaq muslimani që i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Duke qenë se të gjithë e ndjejnë poshtërimin që i ka përfshirë vendet islame, e pyesim njëri-tjetrin në kuvendet e përgjithshme e të veçanta, nëpër konferenca, tubime etj., rreth shkakut që i çoi muslimanët në këtë gjendje të rënduar. Po kështu e pyesim njëri-tjetrin për trajtimin dhe ilaçin që duhet të përdorim për të shpëtuar nga ky poshtërim dhe mjerim. Mendimet dhe vërejtjet për trajtimin e këtij problemi janë të ndryshme dhe çdonjëri vjen me një metodë ose rrugë që mendon se e zgjidh këtë problem.

Unë mendoj se këtë problem i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) e ka përmendur dhe e ka përshkruar në disa hadithe të vërteta, duke e sqaruar ilaçin me të cilin duhet trajtuar. Prej këtyre haditheve është fjala e tij: “Kur të shisni dhe të blini me ‘el ineh’ (shitblerje që përmban kamatë) dhe t’ju preokupojë blegtorja e bujqësia dhe si rrjedhojë të lini xhihadin në rrugë të Allahut, atëherë Allahu do të lëshojë mbi ju një poshtërim, të cilin nuk do ta heqë derisa të ktheheni në fenë tuaj.”¹⁷³ Në këtë hadith, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka përmendur dy lloje sëmundjesh që janë përhapur ndërmjet muslimanëve si shembull, dhe jo për të përcaktuar të gjitha sëmundjet që do të preken prej tyre muslimanët.

) Përkthimi i hadithit është bërë sipas komentit që i kanë bërë dijetarët si p.sh. në “Ounul maëbud”. Hadithin e ¹⁷³ transmetojnë Ahmedi dhe ebu Daudi. Ai është i saktë.

1- Muslimanët veprojnë disa haramë me hile dhe mashtrim duke e ditur që ato janë haramë. Për këtë tregon fragmenti i parë i hadithit të Profetit (salallahu alejhi ue selem) “Kur të shisni dhe të blini me ‘el ineh’...” Mënyra e kësaj shitblerjeje është siç vijon. Të blejë një person prej tregtarit një mall të caktuar si p.sh. një makinë, me kusht që paratë t’ia japë me këste në një kohë të caktuar. Pastaj blerësi ia shet përsëri po atij tregtari të cilit ia bleu, por këtë rradhë me një çmim më të ulët se sa e bleu vetë, kundrejt dhënies së vleftës në dorë (kesh). Kështu që shitësi i parë (tregtari), i cili në kontratën e dytë të shitblerjes u kthye në blerës, e jep çmimin e mallit në dorë, por më të ulët sesa e bleu pala tjetër, e cila do ta shlyejë me këste në një afat të caktuar. Në shembullin që morëm, në qoftë se makina është shitur 10 000 lira, të cilat do të paguhen me këste, blerësi ia shet po atij që ia bleu me 8 000 lira, të cilat ia merr në dorë. Nga kjo marrëdhënie shitblerjeje, në të cilën malli është përdorur thjesht si mjet për të legjitimuar kamatën, rezultojnë 2 000 lira shtesë, të cilat janë kamatë. Muslimani që i ka dëgjuar ajetet dhe hadithet që e ndalojnë kamatën, duhet të mos e lejojë dhe të mos e ushtrojë këtë lloj kontrate, sepse ajo përmban kamatë të hapur. Por disa njerëz e kanë lejuar, ngaqë është përmendur në kapitullin e shitblerjes dhe përfshihet në tërësinë e fjalës së Allahut: **“Allahu e lejoi shitblerjen dhe e ndaloi kamatën.”** Prandaj kanë thënë se përderisa kjo kontratë është shitblerje, nuk ka gjë se ngrihet apo ulet çmimi. Por e vërteta është se blerësi që e bleu 10 000 L. me afat, pastaj ia shiti të njëjtit person 8 000 L. në dorë, pati për qëllim të merrte 8 000 lira borxh, duke qënë i vetëdijshëm se shitësi, që supozohet të jetë musliman, nuk i jep borxh 8 000 kundrejt 8 000 që do të lahen më vonë, sepse do që t’ia japë kundrejt një shtese (fajdeje, përfitimi). Kështu që e bënë këtë hile për të lejuar shtesën (kamatën) në emër të shitblerjes.

Së pari, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) u sqaron njerëzve Kur’anin siç ka thënë Allahu i madhëruar:

“Ne ta kemi zbritur Kur’anin që ti të mund t’u shpjegosh njerëzve qartë se çfarë u është zbritur atyre dhe që të mendojnë.” En-Nahl: 44.

Së dyti, ai është i mëshirshëm dhe i butë ndaj besimtarëve, siç e ka përshkruar Allahu në Kur’an: **“Ndaj besimtarëve është i butë, i mëshirshëm.”** Et-Teube: 128.

Prej mëshirës dhe butësisë së të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) ndaj nesh, është se ai na ka tërhequr vëmendjen që të ruhem i prej hileve, mashtrimeve, intrigave dhe kurtheve që shejtani i bën kundrejt nesh. Profeti (salallahu alejhi ue selem) na ka bërë thirrje që të jemi të vëmendshëm në

shumë hadithe, një prej të cilëve është edhe ky që përmendëm. Lejimi i kamatës në rastin e sapopërmendur, nën pretekstin se është shitblerje, është më i rrezikshëm sesa të veprojë muslimani haramin i vetëdijshëm se është haram, sepse për këtë të fundit shpresojmë që të pendohet, pasi e di se është duke bërë haram. Ndërsa atij që i është hijeshuar puna e tij e keqe, për shkak të interpretimit të gabuar ose padituriës, dhe si rrjedhojë mendon se puna që kryen nuk ka ndonjë problem, është e natyrshme që të mos i bjerë ndërmend të pendohet. Kështu që rrezikshmëria e haramit që besohet se është hallall, është më e madhe se e haramit të hapur. Rrezikshmëria e atij që e ha kamatën duke e ditur që është kamatë dhe haram, megjithëse është në luftë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem), është më e vogël se e atij që e ha kamatën duke besuar se po ha hallall!

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) në këtë hadith ka përmendur shitblerjen si shembull për të treguar se pasoja e çdo harami që e vepron muslimani duke e besuar të lejuar si rrjedhojë e interpretimit që bën, do të jetë poshtërimi që ia lëshon Allahu i Lartësuar. Për shkak të tij mund të poshtërohen edhe muslimanët, në qoftë se veprimi i gjynahut përhapet.

2- Të dhënët dhe angazhimi pas dynjasë, nën pretekstin se po angazhohen për kërkimin e rizikut që na ka urdhëruar Allahu ta kërkojmë. Kështu, muslimanët e teprojnë në këtë drejtim dhe i harrojnë detyrat që i ka urdhëruar Allahu t'i kryejnë. Ata i preokupon bujqësia dhe blegtoria e të tjera gjëra fitimprurëse, të cilat i bëjnë të harrojnë detyrat fetare. Profeti (salallahu alejhi ue selem), xhiadin e ka përmendur si shembull.

Siç e vëreni ky hadith është shenjë që tregon për vërtetësinë e mesazhit të Profetit (salallahu alejhi ue selem). Vërtet ne tani gjendemi në poshtërim. Prandaj duhet të marrim ilaçin nga ky hadith, sepse ai, pasi e përshkroi sëmundjen që çon në poshtërim, na tregoi ilaçin që e kuron këtë sëmundje. Detyra jonë është që të zbatojmë ilaçin (rrugën, metodën) të cilin na e përshkroi i Dërguari i Allahut. Ai ka deklaruar që nëse do të kthehemi tek Allahu, ai do të na e heqë poshtërimin që na ka kapluar. Njerëzit e lexojnë këtë hadith dhe e dëgjojnë shpesh thënien e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “derisa të ktheheni në fenë tuaj”, dhe pastaj mendojnë se kthimi në fenë e Allahut është i lehtë. Unë mendoj se kthimi i Umetit në fenë e Allahut nuk është aq i lehtë sa e mendojnë. Të gjithë e dimë që janë bërë përpjekje të shumta për ndryshimin dhe keqinterpretimin e kësaj feje. Një pjesë e ndryshimit që ka pësuar besimi, ibadeti dhe sjellja e muslimanëve, është e njohur nga shumë njerëz, ndërsa pjesa tjetër nuk është e njohur. Shumica e njerëzve, disa gjëra të besimit dhe të

rregullave të Fikhut i konsiderojnë prej fesë, ndërkohë që ato nuk janë prej fesë. Shitblerja “El ineh” është shembull i qartë për këtë që po diskutojmë. Kjo kontratë shitblerjeje, megjithëse i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e ka ndaluar dhe ka lajmëruar se është shkak për dekadencën dhe poshtërimin e muslimanëve, është një shembull ndër dhjetra shembuj që tregojnë për këtë që po përmendim, d.m.th. për faktin që duhet të rifillojmë ta kuptojmë fenë sipas Kur’anit dhe sunetit të Profetit (salallahu alejhi ue selem). Synimi jonë në diskutimin e kësaj çështjeje, nuk është që të akuzojmë apo të nënvlerësojmë dijetarët që e kanë lejuar këtë lloj shitblerjeje. Ne synojmë që të këshillojmë muslimanët sinqerisht dhe të bashkëpunojmë me të gjithë, veçanërisht me ata që merren me studimin e rregullave të Fikhut, që të kuptojnë devijimin që pësuan disa njerëz për cilindo shkak qoftë. Kjo do të arrihet duke zbatuar një ajet në Librin e Allahut, i cili është fjala e Tij:

“Nëse keni mosmarrëveshje për ndonjë gjë mes jush, drejtojeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse besoni në Allahun dhe në Ditën e Fundit. Kjo është më e mirë dhe më e përshtatshme për përcaktimin e fundit.” En-nisa: 59.

Muslimanët janë në mosmarrëveshje lidhur me shumë çështje të fesë. Mosmarrëveshjet nuk janë vetëm në disa rregulla të pakta siç mendojnë, por përkundrazi, mosmarrëveshjet ekzistojnë në shumë çështje që kanë të bëjnë me besimin. Pra, mosmarrëveshjet në temat e besimit ekzistojnë ndërmjet grupeve të cilat llogariten prej muslimanëve. Atëherë cila është feja në të cilën duhet të kthehen muslimanët? Mos vallë është sipas botëkuptimit të medhhebit (rrugës) të njërit apo të tjetrit!? E njëjta pyetje mund të bëhet për të gjitha botëkuptimet dhe idetë. Sikur të diskutonim rreth mosmarrëveshjeve që ekzistojnë ndërmjet medhhebeve të “ehli sunetit”, do të vërenim se çdo medhheb ka dhjetra çështje të cilat e kundërshtojnë Sunetin, në qoftë se disa prej tyre nuk kundërshtojnë edhe Kur’anin.

Prandaj unë mendoj se ftuesit në Islam, të cilët punojnë për të ngritur shtetin Islam me sinqeritet, duhet të kthehen për të kuptuar fenë islame fillimisht vetë, dhe së dyti t’i mësojnë Umetit fenë që e solli i Dërguari (salallahu alejhi ue selem). Të gjithë fukahatë (dijetarët e jurisprudencës islame) janë pajtuar se kjo nuk mund të arrihet pa e studiuar Kur’anin dhe Sunetin.

Prijësit e medhhebeve i kanë paralajmëruar pasuesit e tyre që të mos i ndjekin verbërisht dhe të mos i bëjnë ata bazë të referimit dhe si rrjedhojë të harrojnë Kur’anin dhe Sunetin. Le të japim disa shembuj konkretë, të cilët përmenden në tekstet mësimore të shkollave fetare islame.

- Në një medhheb thuhet që namazfalësi i lëshon duart në namaz dhe nuk i lidh. Dijetarët e hadithit janë përpjekur që të gjejnë për të justifikuar këtë mendim, qoftë edhe një hadith të dobët, madje edhe të trilluar, por nuk e kanë gjetur. Atëherë kështu është Islami!?

Ndoshta disa do të thonë se kjo është prej gjërave dytësore në çështjet e Fikhut. Ndonjëri mund të shprehet se kjo është prej gjërave të parëndësishme.

Unë besoj se çdo gjë që na ka ardhur nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dhe që ka lidhje me fenë dhe ibadetin, është e rëndësishme. Çdo gjë që ka ardhur nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) duhet të konsiderohet prej fesë dhe t'i jepet gjykimi i duhur. Në qoftë se është farz, të thuhet se është farz dhe t'i jepet rëndësia e farzit, dhe në qoftë se është sunet, të punohet si sunet dhe t'i jepet rëndësia e sunetit. Nuk është prej edukatës islame që të quhen gjëra të parëndësishme ose të përcipta ato që i përmban Sheriati, sepse janë të pëlqyeshme! Sidomos kur dihet që thelbin nuk mund ta ruajmë dhe të kujdesemi për të, veçse duke ruajtur dhe duke mbrojtur sipërfaqen. Kjo e fundit vlen nëse do të dëshiroja të polemizoja me ta rreth shprehjes së përdorur prej tyre.

Megjithëse lëshimi i duarve në namaz bie në kundërshtim me shumë hadithe që tregojnë se Profeti (salallahu alejhi ue selem) i lidhte duart, shumë muslimanë vazhdojnë të imitojnë dhe të ngurtësohen verbërisht, duke qenë në kundërshtim me imamët të cilët kanë thënë se “në qoftë se vërtetohet ardhja e hadithit në lidhje me një çështje, ai është mendimi im”.

Nëse disa njerëz nuk kënaqen me këtë shembull të thjeshtë, u sjellim një shembull tjetër.

Në disa libra Fikhu është përmendur se pijet alkoolike (dehëse) ndahen në dy grupe. Një pjesë janë ato që merren nga rrushi. Këto, pakica dhe shumica e tyre janë haram. Pjesa tjetër janë ato që merren nga lëndë të tjera e jo prej rrushit si elbi, misri, hurmat arabe e të tjera gjëra që i përpunojnë kafirët. Sipas tyre, këto pije dehëse, nuk janë krejtësisht haram, por vetëm nëse të dehin. (D.m.th. po të pish një sasi që nuk të deh, është hallall, ndërsa po të pish aq sa të deh, është haram!) Ky mendim është përmendur në disa libra të Fikhut dhe disa njerëz përpiqen ta mbështesin, megjithëse bie në kundërshtim me shumë hadithe të qarta dhe të sakta nga Profeti (salallahu alejhi ue selem), si.p.sh. me fjalën e tij: “Në qoftë se shumica e një pije të deh, atëherë edhe pakica e saj është haram.” “Çdo pije dehëse është verë, dhe çdo lloj vere është haram.”

Në shumë vende Islame merren vendime nëpër gjykata, se muslimania e pjekur (e cila ka arritur moshën e pjekurisë dhe është e mençur) ka të drejtë të

martojë veten pa lejen e kujdestarit të saj, megjithëse i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka deklaruar dhe ka thënë: “Kur një grua martohet pa lejen e kujdestarit të saj, akti i martesës së saj është i pavlefshëm, akti i martesës së saj është i pavlefshëm, akti i martesës së saj është i pavlefshëm.”

Nëse duam të zbatojmë ilaçin “derisa të ktheheni në fenë tuaj”, që na e përshkroi i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) pasi përshkroi sëmundjen, duhet të kthehemi në fenë e Allahut me besim dhe me punë.

Shumë muslimanë nuk i përmbahen detyrimeve për të cilat tregojnë dy dëshmitë: “La il-lahe il All-llah” dhe “Muhammedurr-rresulull-llah”, dhe nuk e komentojnë shehadetin siç e meriton. Sot janë zgjuar shumë të rinj dhe shkrimtarë muslimanë, duke theksuar faktin se prej së drejtës së shehadetit, është njësimi i Allahut në gjykim dhe ligjvënie. Unë deklaroj qartë se të rinjtë dhe shkrimtarët muslimanë sot, e kanë kuptuar realitetin se gjykimi i takon vetëm Allahut dhe se vendosja e ligjeve tokësore dhe përdorimi i tyre për zgjidhjen e problemeve të sotme, bie në kundërshtim me këtë parim. Por shumë prej këtyre shkrimtarëve nuk pajtohen plotësisht me këtë zgjim që i kanë kushtuar vëmendjen, sepse ligji dhe gjykimi i Allahut është ligji dhe vendimi që ka ardhur në Kur’an dhe Sunet. Pse duhet të gykojmë që kur na vjen vendimi ose ligji nga aksh kafir, e konsiderojnë në kundërshtim me ligjin e Allahut, ndërsa kur na vjen nga një “ixhtihad” i gabuar i një dijetari “muxhtehid”, nuk e konsiderojmë në kundërshtim me ligjin e Tij!?

Unë besoj se nuk ka ndryshim për sa i përket aspektit se ajo që bie ndesh me Kur’anin dhe Sunetin nuk duhet të pranohet. Muslimanit nuk i lejohet që të pranojë asnjë mendim, kushdo qoftë burimi i tij, përderisa bie në kundërshtim me Kur’anin dhe Sunetin. Por nuk ka dyshim se ka ndryshim ndërmjet atij që ka dhënë vendimet dhe ligjet e kufrit dhe ndërmjet atij që ka dhënë mendime të gabuara prej muslimanëve, pasi ai që ka dhënë vendimet dhe ligjet e kufrit është kafir dhe i përhershëm në zjarr, ndërsa dijetari “muxhtehid”, jo vetëm që nuk merr gjynah, por shpërblehet me një shpërblim për mendimin dhe vendimin e tij të gabuar, siç ka ardhur në hadith të saktë.

Për t’u kthyer muslimanët në fenë e Allahut duhet që muslimanët e specializuar në fushën e Fikhut dhe të hadithit të bëjnë krahasimin ndërmjet mendimeve të ndryshme dhe të zgjedhin atë që është në pajtim me Kur’anin dhe Sunetin. Për të ngritur shtetin islam duhet që patjetër të kemi një legjislacion të qartë. Lind pyetja: Mbi cilin medhheb do të bazohet ky legjislacion? Të marrim një shembull për këtë.

Një shkruer ka hartuar një grumbull ligjesh mbi të cilat do të bazohet shteti islam. Shumë ligje i hartoi sipas mendimit të një medhhebi. Në një prej neneve të tij thuhet: “Kur muslimani e vret ‘edh-dhim-mij-j’,¹⁷⁴ vritet.” Ky është një mendim i njohur në Fikhun islam, por ka edhe një mendim tjetër, i cili është krejtësisht i kundërt me të. Ai është se “kur muslimani e vret ‘edh-dhim-mij-j’, nuk vritet për shkak të tij”.¹⁷⁵ Ky mendim është bazuar në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) që ka ardhur në “Sahihun” e Buhariut: “Muslimani nuk vritet për shkak të kafirit.” Çfarë e motivoi këtë shkruer të nderuar bashkëkohor që të vendosë në ligjin islam se muslimani vritet për shkak të kafirit, në kundërshtim me hadithin e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem)!? Si puna e këtij shembulli ka edhe shumë të tjerë.

Të kthehesh në fenë e Allahut do të thotë t’i kthehesh dhe t’i referohesh Kur’anit dhe Sunetit, sepse kjo është feja e drejtë, pa kundërshtim tek dijetarët.

Dy burimet e lartpërmendura na mbrojnë nga devijimi dhe humbja. Kjo bazuar në thënien e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem): “Midis jush kam lënë dy gjëra, nëse do të kapeni pas tyre nuk do të humbisni, Librin e Allahut dhe sunetin tim.” (“Sahihul xhamii”) Ne kemi dhënë shumë shembuj të cilët i obligojnë njerëzve të dijës të kthehen në Kur’an dhe Sunet për të kuptuar fenë, në mënyrë që muslimanët të mos e bëjnë të lejuar atë që e ka ndaluar Allahu, duke menduar se është e lejuar.

Në qoftë se duam që Allahu të na japë krenarinë, të heqë poshtërimin që na ka mbuluar dhe të na ndihmojë kundër armikut, duhet që përveç korigjimit të botëkuptimeve dhe zhdukjes së mendimeve që keqinterpretojnë argumentet e Sheriatit, të punojmë me dijen e pastër. Dija është mjet për të punuar me të. Në qoftë se njeriu mëson, qoftë edhe dije të pastër, dhe nuk punon me të, dija e tij nuk është e frytshme. Kështu që dija e pastër duhet të shoqërohet me punë. Të diturit duhet të marrin përsipër edukimin e brezit të ri musliman, nën dritën e asaj që ka ardhur në Kur’an dhe Sunet. Nuk lejohet që t’i lëmë njerëzit në botëkuptimet dhe gabimet që i kanë trashëguar nga të parët, sepse disa botëkuptime janë të pavërteta, të pavlefshme, pa diskutim tek dijetarët. Në lidhje me disa të tjera, dijetarët nuk janë të pajtuar. Ka mendime dhe “ixhtihade” që janë të vlefshme dhe ka mendime e “ixhtihade” që janë në kundërshtim me Kur’anin dhe Sunetin.

Pra, pas sqarimit të këtyre gjërave dhe qartësimit të rrugës drejt së cilës duhet të nisemi dhe të ecim në të, patjetër duhet të edukohet brezi i ri në dijen e

) Edh-dhim-mij-j - Rezidenti kafir në vendet islame, të cilit muslimanët i kanë dhënë të drejtën e qëndrimit.¹⁷⁴
) Por ka masa të tjera penale.¹⁷⁵

saktë. Ky edukim do të frymëzojë një shoqëri të pastër islame dhe si rezultat do të ngrihet shteti islam. Pa realizimin e këtyre dy gjërave, dijen e vërtetë dhe edukimin e saktë të bazuar në këtë dije, është e pamundur, sipas bindjes sime, të ngrihet pushteti, ligji ose shteti islam.

Do të jap një shembull për të sqaruar domosdoshmërinë e edukimit të saktë, të bazuar në dije të vërtetë. Në Sham kemi një grup muslimanësh që duan të punojnë për Islamin dhe të edukojnë të rinjtë në të, por ne e dimë shumë mirë që shumë edukatorë të tyre kanë nevojë ta studiojnë Islamin gjerësisht sipas kësaj metode të vërtetë që e sqaruar. Kemi vërejtur shumë të rinj, që ftojnë njëri-tjetrin për t'u grumbulluar dhe për të qëndruar duke bërë ibadet të gjithë natën e xhuma. Grumbullimi për t'iu bindur Allahut është gjë e mirë, por për arsye se ata nuk e kanë studiuar Sunetin, bien në kundërshtim me të. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Mos e veçoni natën e xhuma me falje namazi ndryshe nga netët e tjera dhe mos veçoni ditën e xhuma me agjërim ndryshe nga ditët e tjera.” Atëherë si të rrimë të zgjuar për ibadet veçanërisht në natën e xhuma, ndërkohë që Profeti (salallahu alejhi ue selem) na e ka ndaluar!? Përgjigjja është se nuk kanë dije, dhe të diturit duhet t'i këshillojnë se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) e ka ndaluar këtë gjë.

Disa të rinj të tjerë dëgjojnë muzikë duke e menduar se është hallall, sepse dëgjojnë stacionet radiofonike të japin muzikë, dhe askush nuk i këshillon se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e ka ndaluar dëgjimin e saj.

Përderisa i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e ka përmendur se ilaçi për të hequr poshtërimin, është kthimi në fenë e Allahut, atëherë ne, me anë të njerëzve të ditur, duhet ta kuptojmë fenë saktësisht sipas Kur'anit dhe Sunetit, dhe të edukojmë brezin e ri në Islamin e pastër. Kjo është rruga për trajtimin e problemit prej të cilit ankohet çdo musliman.

Më ka bërë përshtypje një fjalë që e kanë thënë disa reformatore të kohës sonë, e cila faktikisht është përmbledhje e asaj që e sqarova, dhe sipas mendimit tim, është sikur të kishte zbritur nga qielli: “Ngrijeni qeverinë islame në zemrat tuaja që të ngrihet ajo mbi tokën tuaj.”

Patjetër duhet të rregullojmë vetet tona të bazuar në Islam. Kjo siç e përmenda nuk mund të bëhet me injorancë, por me dije. Nëse do të rregullojmë vetet tona, do të ngrihet shteti islam mbi tokën tonë.¹⁷⁶

¹⁷⁶) Në lidhje me këtë gjë Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur'an: “Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ata të ndryshojnë gjendjen e tyre.” Shejhu ka sqaruar metodat e ligjshme dhe të suksesshme për rimëkëmbjen e muslimanëve. Ai e ka bazuar këtë metodë në argumentet e Kur'anit dhe Sunetit, të cilat tregojnë se rimëkëmbja e muslimanëve do të bëhet nëpërmjet kthimit të tyre në fenë e Allahut. Kjo do të thotë se ajo nuk mund

të realizohet pa u kthyer muslimanët në besimin, ibadetin dhe sjelljen islame, qoftë kjo edhe në një vend ku do të krijohet baza e shoqërisë dhe mëkëmbjes islame. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“O ju që keni besuar! Nëse ju ndihmoni Allahun (në çështjen e Tij), Ai do t’ju ndihmojë juve dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”** Muhamed: 7. **“Allahu u ka premtuar atyre që besuan dhe bënë vepra të mira nga mesi juaj, se do t’i bëjë zotërues në tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre, dhe se Ai do t’u sigurojë fuqinë për të zbatuar e përmbushur fenë e tyre, atë të cilën ai e ka zgjedhur për ta (Islamin). Dhe padyshim që në vend të frikës Ai do t’u dhurojë siguri, (me kusht që) këta besimtarë të më adhurojnë vetëm Mua dhe të mos bashkojnë gjë tjetër (në adhurim) me Mua. Por kushdo që nuk beson pas kësaj, këta janë fasikunë (kryeneçë, të pa bindur ndaj Allahut, të prishur e të ligj).”** En-nur: 55 **“Atyre që janë përzënë nga shtëpitë e tyre padrejtësisht vetëm pse këta thonin: ‘Zoti ynë është Allahu’. Dhe po të mos kishte qenë se Allahu sprovon një grup njerëzish me anë të një grupi tjetër, manastiret, kishat, sinagogat, dhe xhamitë në të cilat përmendet shumë emri i Allahut, sigurisht që do të ishin rrafshuar përtokë dhe nuk ka dyshim se Allahu do të ndihmojë ata të cilët e ndihmojnë (në çështjen e tij) Allahun. Vërtet që Allahu është Fuqiplotë, i Gjithëfuqishëm.”** **“(Allahu i ndihmon) Ata të cilët, nëse i mëkëmb (u japim fuqi) në tokë, e falin namazin , japin Zekatin, urdhërojnë El Ma’ruf (besimin dhe ligjin islam) dhe ndalojnë El Munker (mosbesimin, politeizmin dhe gjithçka që ka ndaluar Islami, duke zbatuar në këtë mënyrë Kur’anin, Ligjin e Allahut si të vetmin ligj për drejtimin e vendit të tij). Dhe tek Allahu është përfundimi i të gjitha çështjeve (të krijesave të Tij).”** El Haxh: 40-41.

Nga meditimi mbi jetën dhe veprën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), rezulton se kjo ishte metoda e tij për ndryshimin e gjendjes së asaj kohe, për krijimin e bazës së shoqërisë islame dhe si rrjedhojë ngadhënjimin e muslimanëve. Profeti (salallahu alejhi ue selem) është shembulli ynë, prandaj duhet ta ndjekim atë për të realizuar objektivat që na i obligon Sheriati. Çdo metodë dhe përpjekje, ndryshe nga kjo që u bë e qartë, është e paligjshme dhe e pasuksesshme. Prej tyre muslimanët nuk kanë për të arritur gjë tjetër veçse më shumë poshtërim, dobësim dhe përçarje, Zoti na ruajt. Muslimanët duhet të marrin mësim dhe përvojë nga ajo që ka ndodhur në shumë vende islame. Një fjalë e urtë thotë: **“I mençur është ai që merr mësim prej të tjerëve.”** Nga përvojat e hidhura që kanë pasur shumë njerëz gjatë përpjekjeve për ndryshimin e aktualitetit, kanë nxjerrë mësim dhe janë distancuar nga metodat që bien ndesh me metodën e Profetit (salallahu alejhi ue selem). Ata i kanë këshilluar muslimanët që t’i lenë metodat e shpikura e të importuara dhe të merren me edukimin e muslimanëve në Islamin e pastër. Përpjekjet dhe angazhimet e aktivistëve muslimanë për ndryshimin e gjendjes, duhet të jenë në përputhshmëri me metodën e profetëve, e cila është rruga islame që e kanë përfaqësuar të parët e këtij Umeti. Nuk lejohet të përdoren rrugë dhe metoda të tjera për ndryshimin e gjendjes dhe të lihet rruga islame. Këto metoda, përveçse janë në kundërshtim me rrugën e të dërguarve dhe të ndaluar, ato janë të pasuksesshme dhe muslimanët nuk kanë prej tyre dobi. Allahu i lartësuar ka thënë: **“Vërtet, kjo është rruga Ime e Drejtë, kështu që ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera, pasi ato do t’ju ndajnë e do t’ju largojnë nga Udhë e Tij. Këtë jua ka urdhëruar Ai, që të mund të bëheni muttekinë (të përkushtuar në besimin e pastër islam).** En Aam: 153. I Dërguari ynë (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: **“Nuk është prej nesh ai që punon me rrugën e të tjerëve.”** (“Sahihul xhamii”) Ndër metodat e importuara prej kafirëve, të cilat i kanë përdorur disa grupe në Egjipt, Siri, Algjeri etj., janë demonstratat anarkiste, revolucionet e egra, shpërthimet e përgjakshme, atentatet personale, zgjedhjet parlamentare e të tjera gjëra të ngjashme me këto. Këto janë gjëra që nuk i kanë njohur të parët tanë dhe as gjeneratat e mëparshme deri në shekullin e kaluar. Prej këtyre metodave Umeti ka vuajtur shumë. Në disa vende ato janë bërë shkak për bllokimin e daves. Ai i cili dëshiron që t’i kthehet Umetit tonë sovraniteti dhe krenaria, le të ndjekë metodën e profetëve në përpjekjet për ndryshim. Rruga e profetëve fillon me ndryshimin e gjendjes së njerëzve nëpërmjet dijes së dobishme, punës së çiltër e të vërtetë dhe thirrjes në rrugë të Allahut me urtësi dhe këshillë të mirë. Imam Malik ka thënë: **“Nuk rregullohet gjendja e fundit të këtij Umeti, përveçse nëpërmjet rrugës me anë të së cilës u rregullua fillimi i tij. Është detyrë që t’i bëjmë analizë çdo sëmundjeje që ka prekur Umetin tonë dhe ta trajtojmë atë. Domosdoshmërisht duhet të trajtojmë sëmundjen e paditurisë që dominon mbi shumicën e muslimanëve, të forcojmë besimin e tyre dhe të krijojmë një ambient të mirë e të përshtatshëm për ta. Më pas, gjatë punës sonë duhet të kemi parasysh pikat që vijojnë.**

- Çdo fatkeqësi që na ndodh është për shkak të asaj që e kemi punuar vetë. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Çfardo e mire që të vjen, ajo është prej Allahut, kurse çdo e keqe që të bie ty, ajo është nga vetja jote. Dhe Ne të kemi çuar ty (O Muhamet a.s.) si të dërguar për të thirrur njerëzimin dhe është më se i mjaftueshëm Allahu si dëshmues.”** En-Nisa: 79. Rimëkëmbja dhe triumfi i muslimanëve është i lidhur me kapjen e tyre pas fesë dhe bashkimit të tyre. Muslimanët përmes devotshmërisë do të arrijnë të mundin armikun dhe të shkatërrojnë kurthet e tij. Kështu, nëse muslimanët neglizhojnë në zbatimin e fesë, stuhitë e kafirëve kundër tyre do të vazhdojnë, dhe nëse bëhen të devotshëm, planet dhe kurthet e kafirëve shkojnë kot. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Kështu që jini duruar**

Si përfundim, i porosis të gjithë ata që munden të marrin pjesë për realizimin e kësaj nisme madhështore, që të bashkëpunojnë me ata, të cilët kanë specializime të tjera, për të sqaruar Islamin që ka ardhur në Kur'an dhe Sunet dhe për të edukuar brezin e ri në të. Kjo është këshillë përkujtuese, e cila u bën dobi besimtarëve.

Paqja, shpëtimi, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi ju.

Në një fetva tjetër shejhu ka thënë: “Synimi ynë me fjalën ‘tesfije’ (pastrimi) është që të pastrojmë Islamin nga gjërat që janë futur në të, pasi ato janë të shumta. Kërkohet një mund i madh nga të diturit për ta bërë këtë pastrim. Duhet të pastrojmë Islamin nga idetë, bindjet dhe besimet që bien në kundërshtim me të dhe të pastrojmë librat e Sunetit nga hadithet e dobëta e të trilluara. Të pastrojmë librat e tefsirit nga israilijatet (lajmet e transmetuara nga ithtarët e librit) shkatërruese, të pastrojmë librat e Fikhut nga disa rregulla që akoma vazhdojnë shumë dijetarë t’i marrin në konsideratë, si dhe të pastrojmë librat e moralit dhe të sjelljes.”

“Në disa këshilla të mëparshme, unë kam thënë dhe vazhdoj të them se nuk mund të ngrihen muslimanët pa realizimin e këtyre dy themeleve: pastrimit dhe

(o Muhamed a.s.). **Sigurisht që Premtimi i Allahut është i vërtetë dhe kërko falje për gabimin tënd dhe lartëso lavditë e Zotit tënd në Ashi** (nga mesdita deri në perëndim) **dhe në Ibkar** (nga agimi deri në mesditë).” Gafir: 55. Duke u bazuar në këtë që thamë duhet të punojmë për zhdukjen e paditurisë, përçarjes dhe neglizhencës, në mënyrë që të mos na prekin fatkeqësitë dhe të eliminohen vështirësitë.

- Të fillojmë me ndryshimin e vetvetëve tona dhe rregullimin e besimit, adhurimit dhe sjelljes. Nëse kështu do të veprojmë do të rregullohet gjendja jonë, do të rregullohen prijësit tanë dhe do të përparojnë muslimanët në të gjitha sferat.

- Që të na ndihmojë Allahu, duhet të praktikojmë fenë islame, të ftojme në të dhe ta mbrojmë atë. Allahu i lartësuar ka thënë: “...”

- Respektimi i mënyrës graduale në shtrimin e çështjeve të fesë dhe ndryshimit të gjendjeve të njerëzve. Kjo bëhet duke ua zëvendësuar atë që u ndalohet ose u mungon, duke u mësuar atë që nuk e dinë, duke u korrigjuar bindjet dhe ibadetet. Gjithashtu të ftohen me urtësi dhe këshillë të mirë natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, të urdhërohen për të mirë dhe të ndalohen nga e keqja, sipas rregullave të “ehli sunetit” për sa i përket interesave dhe dëmeve, të edukohen për të ushtruar rregullat e fesë praktikisht dhe për t’u pajisur me sjelljen islame, si dhe të nxiten vazhdimisht për të lexuar Kur’an, për të përmendur Allahun, për t’i bërë ibadet Atij dhe për të rregulluar punët e zemrës e të gjymtyrëve. Duhet të vazhdojnë në këtë rrugë derisa Allahu të sjellë fitoren e tyre. Allahu ka thënë: **“Ai është i Cili çoi mes analfabetëve një të Dërguar (Muhamedin a.s.) nga mesi i tyre duke u kënduar atyre Vargjet e Tij, duke i pastruar ata** (nga ndytësia e mosbesimit dhe e politeizmit) **dhe duke u mësuar atyre Librin** (Kur’anin, Islamin dhe ligjet e të Dërguarit të Allahut, rrugën, sjelljen dhe vënien në jetë të ligjit të Allahut sipas shembullit të tij a.s.) **Dhe vërtet që më parë qenë në gabim e humbje të qartë.”** El Xhumuatu: 2.

- Marrja parasysh e niveleve të njerëzve, kushteve dhe ambienteve që jetojnë, si dhe gjendjeve e rrethanave të shoqërive. Në çdo vend bëhet kuvendi që i përket dhe çdo ngjarje ka shtjellimin e saj. Kështu, muslimanët që jetojnë në një ambient të mirë, kanë disa rregulla dhe qëndrime të cilat ndryshojnë nga ato të muslimanëve që jetojnë në shoqëri kufri e paqësore. Po ashtu ndryshon qëndrimi i muslimanëve në një vend islam që luftohen nga armiku, nga ai i muslimanëve të dobët që jetojnë të shtypur dhe nuk kanë mundësi për rezistencë e përballim. Të parët mbrohen, përballojnë dhe luftojnë, ndërsa të tjerët kanë rregulla të tjera si durimi, shpërngulja etj. Si përfundim, gjykimet fetare që u jepen situatave dhe gjendjeve të ndryshme, duhet të jenë të drejta dhe korrekte sipas Sheriatit.

edukimit. Duhet patjetër të bëjmë pastrimin. Eh, sikur të përhapeshin me qindra dijetarë muslimanë në tokën islame dhe të derdhnin mundin e tyre për të kthyer muslimanët në rrugën e të parëve tanë! Pra, për të kuptuar në mënyrë të vërtetë Kur'anin dhe Sunetin dhe për ta praktikuar atë, do të duheshin shumë vite.”

Një herë shejhu është pyetur - Deri kur, o shejhu ynë, do të ulen dijetarët e të thonë: “Ky është hadith i saktë dhe ky hadith i dobët, kjo është sunet dhe kjo është bidat”, d. m. th. metoda selefiste është rrugë e gjatë dhe armiqtë kanë zënë pusi. A nuk mundet që ta shkurtojnë këtë rrugë?

Ai tha - Do të përgjigjem me një hadith të saktë. I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ishte ulur me shokët e tij kur u vizatoi atyre një vijë të drejtë në tokë dhe vija të tjera të shkurtra në anët e saj, e pastaj lexoi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Dhe vërtet, kjo është rruga Ime e Drejtë, kështu që ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera, pasi ato do t’ju ndajnë e do t’ju largojnë nga udha e Tij. Këtë jua ka urdhëruar Ai që të mund të bëheni Muttekinë (të përkushtuar në besimin e pastër Islam).” (En Aam: 153)

Njerëzit pyesin se deri kur do të ecim në këtë rrugë. Ne duhet të vazhdojmë të ecim në këtë rrugë, ndërsa arritja është në dorë të Allahut. Zoti ynë nuk na ka obliguar për më shumë se dy gjëra:

Së pari, të dimë dhe të mësojmë: **“Dije se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.”** (Muhamed: 19)

Së dyti, të punojmë: **“Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni.”** (Es-saf: 33)

Në qoftë se muslimani do të ecë në këtë rrugë, siç ka thënë Profeti (salallahu alejhi ue selem): “Atij që merr rrugën e kërkimit të dijes, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në xhenet”, sado e gjatë që të jetë ajo, ne nuk jemi të obliguar të shkojmë djathtas dhe majtas e të marrim rrugët e shkurtra, duke menduar se këto rrugë do të na bëjnë të realizojmë, zbatojmë dhe vëmë në jetë Islamin. Sa keq mendojnë dhe sa keq shprehen! Rruga e Islamit është siç është shprehur i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem): “Xheneti është i rrethuar me gjëra të urryera për nefsën dhe zjarri është i rrethuar me epshe dhe gjëra të dashura për të.” Këta njerëz, të cilëve u duket e gjatë rruga e ftimit në Kur’an dhe Sunet dhe e edukimit të muslimanëve në të, mos vallë kanë për qëllim që të adhurohet Allahu si të dojë gjithsecili, ose pa dituri!? Ne duhet të mësojmë dhe të punojmë me atë që e kemi mësuar. Realiteti është që sot janë të shumtë ata njerëz, të cilët akoma nuk e kanë kuptuar që detyra e tyre është të mësojnë Islamin dhe ta praktikojnë atë. Sado e gjatë që të jetë, ne duhet të

përpiqemi të ecim në rrugën që na ka urdhëruar Allahu. Pastaj, në qoftë se arrijmë të realizojmë shtetin islam, kjo është mirësi e madhe dhe padyshim që është nga Allahu, i cili ka thënë: **“Nëse e ndihmoni Allahun (fenë e tij), Ai ju ndihmon juve.”** (Muhamed: 7) Ndërsa në qoftë se brezi ynë nuk e arrin, na mjafton që ofruam atë për të cilën kishim mundësi dhe kështu shfajsohemi. Allahu nuk e obligon njeriun përtej mundësive të tij.

(Marrë në mënyrë të përmbledhur nga “El menhexhus-selefi”)

Obligimi i gjykimit sipas ligjit të Sheriatit dhe refuzimi i çdo ligji tjetër që e kundërshton atë

Shejh ibn Bazi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“Allahu i ka krijuar xhindët dhe njerëzit për ta adhuruar, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: **‘Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit veçse për të më adhuruar Mua.’** (Edh-Dharijat: 56)

Dijetarët e kanë komentuar adhurimin me kuptime të përafërta. Ndër përkufizimet më gjithëpërfshirëse është ai që e ka thënë ibn Tejmije: ‘Adhurimi (ibadeti) është një emër që përfshin çdo gjë që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, qoftë kjo prej fjalëve ose punëve, të jashtme ose të brendshme. Kjo tregon se adhurimi nënkupton nënshtrimin e plotë ndaj Allahut në urdhër, ndalim, thënie dhe punë.’

Ky përkufizim tregon se e gjithë jeta e njeriut duhet të jetë e bazuar në Sheriat. Të bëjë hallall atë që e ka bërë Allahu hallall, të bëjë haram atë që e ka bërë Allahu haram, dhe t’i nënshtrohet Sheriatit në të gjitha sjelljet, punët dhe veprat e tij. Të zhvishet nga dëshirat, pasionet dhe prirjet e nefsit dhe të epshit të tij. për sa i përket këtij gjykimi të gjithë janë të barabartë, individi dhe bashkësia, burri dhe gruaja. Nuk mund të jetë i përulur me adhurim ndaj Allahut ai që i nënshtrohet Allahut në disa anë të jetës dhe u nënshtrohet krijesave në disa anë të tjera. Këtë kuptim e thekson fjala e Allahut të Lartësuar:

‘Por jo, për Zotin tënd! Ata nuk mund të kenë aspak Besim përderisa të të bëjnë ty (o Muhamed) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, derisa të mos mbetet në veten e tyre asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve të tua dhe derisa t’i pranojnë ato (vendimet e tua) plotësisht të nënshtruar.’ (En-Nisa: 65)

‘A mos kërkojnë atëherë gjykimin e kohës së padijes (para Islamit)? E kush është më i mirë në gjykim se sa Allahu, për një popull që ka Besim të fortë?’ (El Maideh: 50)

Nuk plotësohet besimi i robit vetëm në qoftë se i beson Allahut, kënaqet me gjykimin e Tij në çdo gjë, të vogël apo të madhe, dhe shkon për t’u gjykuar nga Sheriati në çdo gjë që ka të bëjë me të, në çështjet e gjakut, të pasurisë dhe të nderit, sepse ndryshe bëhet adhurues i të tjerëve veç Allahut, siç ka thënë Allahu në Kur’an:

‘Me të vërtetë që Ne kemi çuar tek çdo Ummet (popull) të Dërguar (duke shpallur): ‘Adhuroni vetëm Allahun dhe shmangiuni e i rrini larg Tagutit (gjithçka që adhurohet përveç apo përkrah Allahut)’.’ (En-Nahl: 36)

Ai që i nënshtrohet Allahut të Lartësuar, i bindet dhe shkon për t’u gjykuar nga shpallja e Tij, është i përlur në adhurimin ndaj Tij. Ndërsa ai që u nënshtrohet të tjerëve dhe shkon për t’u gjykuar nga ligje të tjera, ai ka adhuruar ‘tagutin’ dhe është nënshtrohet ndaj tij, siç ka thënë Allahu në Kur’an:

‘Ai që i beson dhe i bindet të Dërguarit (Muhamedit a.s.), vërtet ai i ka besuar dhe i është bindur edhe Allahut, por për atë që shmanget, atëherë ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed) si roje e vëzhgues për ta.’ (En-Nisa: 80)

Adhurimi i Allahut një të Vetëm, largimi dhe distancimi nga adhurimi i ‘tagutit’ dhe mosvajtja për t’u gjykuar nga ai, është diçka për të cilën tregon domethënia e dëshmisë ‘Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, një, i Vetëm e pa shok është Ai, dhe Muhamedi është robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij’.

Allahu i Lartësuar është zotëruesi i njerëzve dhe i adhuruari i tyre me të drejtë. Ai i ka krijuar, Ai i urdhëron dhe i ndalon, Ai ua jep jetën dhe Ai ua merr atë, Ai i merr në llogari dhe i shpërblen, Vetëm Ai e meriton të adhurohet dhe askush tjetër përveç Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

‘Padyshim që i Tij është krijimi dhe komandimi (urdhërimi, ligjvënia).’ (El A’raf: 54)

Ashtu sikurse Allahu është Krijuesi i vetëm, Ai është Urdhëruesi dhe Ligjvënësi i vetëm, të Cilit e kemi detyrë t’i bindemi dhe të respektojmë urdhërat dhe ligjet e Tij.

Allahu na ka lajmëruar në Kur’an rreth çifutëve dhe kristianëve, se ata i morën rabinët dhe murgjit ‘zota’ në vend të Allahut, ngaqë iu bindën në bërjen hallall të haramit dhe në bërjen haram të hallallit:

‘**Ata** (çifutët dhe kristianët) **morën rabinët dhe murgjërit e tyre si ‘zota’ në vend të Allahut** (duke iu bindur atyre në gjërat që i bënë ata vetë të ligjshme ose të paligjshme sipas dëshirave të tyre, pa u urdhëruar nga Allahu dhe në kundërshtim me ligjet e Tij), (morën për Zot të tyre) **edhe Mesihun, birin e Merjemes, ndërkohë që ata** (çifutët dhe kristianët) **qenë urdhëruar** (në Teurat dhe Inxhil) **të mos adhurojnë kënd tjetër por vetëm një Ilah** (një të adhuruar të vetëm, Allahun) **La ilahe il-la Huve** (Askush nuk meriton, nuk ka të drejtë, e nuk duhet të adhurohet përveç Atij) **Lavdi e Madhështi i qoftë Atij.** (I Lartë është Ai) **nga të pasurit shokë ata që ia mveshin Atij!’** (Et-teube: 31.)

Është transmetuar se Adij ibni Hatem ka menduar që adhurimi i rabinëve dhe i murgjve bëhet vetëm duke therur kurban për ta, duke u zotuar (nedhër) për ta, duke bërë sezhde dhe ruku për ta, e të tjera si këto, kështu që kur erdhi tek i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem), pasi kishte pranuar fenë islame dhe e dëgjoi të lexonte këtë ajet, i tha: ‘O i Dërguar i Allahut! Ne nuk i adhurojmë (kishte për qëllim kristianët, sepse para se të bëhej musliman ka qenë i krishterë). I Dërguari i Allahut i tha: ‘A nuk ua kanë bërë haram atë që ua ka lejuar Allahu dhe ju e keni bërë haram si ata, dhe a nuk ua kanë bërë të lejuar atë që e ka ndaluar Allahu dhe ju e keni lejuar?’ Tha: ‘Posi jo’ I tha: ‘Ky ishte adhurimi ndaj tyre.’ Transmeton Ahmed i dhe Tirmidhiu, i cili e ka cilësuar të mirë.

Ibnu Kethiri në tefsirin e tij thotë: ‘Prandaj Allahu i Lartësuar ka thënë: ‘**Ata nuk janë urdhëruar përveçse që të adhurojnë një ‘Ilah’** (të adhuruar) **të vetëm**’, d.m.th. Atë, që nëse e ndalon diçka ajo është haram, dhe atë që e lejon Ai, është hallall, ajo që e bën ligj duhet ndjekur dhe ajo që Ai e gjykon, duhet zbatuar’.”¹⁷⁷

Fetva në lidhje me xhihadin e mbrojtjes¹⁷⁸

¹⁷⁷) Shkëputur nga broshura e Ibnu Bazit, Allahu e mëshiroftë, “Obligimi i gjykimit me ligjin e Sheriatit dhe flakja e çdo ligji që e kundërshton atë”.

¹⁸¹) Xhihadi është dy llojesh: “Xhihadi i çlirimit e i kërkimit” dhe “Xhihadi i mbrojtjes”. Këtu janë përmendur fetvatë që kanë të bëjnë me xhihadin e mbrojtjes, megjithëse në përmbajtjen e tyre është sqaruar ndryshimi mes tij dhe xhihadit të çlirimit e të kërkimit. Kjo për të njohur mirë se cilat rregulla të xhihadit i përshtaten gjendjes aktuale të muslimanëve në shumë vende, rreth të cilave diskutohet shumë, herë duke pohuar dhe herë duke mohuar xhihadin në to. Ky konfuzion, me sa duket, lind tek shumë njerëz, si rrjedhojë e mosnjohjes së rregullave që kanë të bëjnë me çdonjërin prej llojeve të xhihadit, mosnjohjes së ndryshimit mes tyre, mosnjohjes së aktualitetit të vendeve rreth të cilëve diskutohet, ose mungesës së dijes dhe aftësisë për t’i dhënë aktualitetit të vendit rreth të cilit bëhet fjalë, gjykimin fetar që i përshtatet.

Ibnu Tejmija ka thënë: “Kur armiku do dhe tenton të sulmojë muslimanët, bëhet detyrë për të gjithë të sulmuarit të mbrohen dhe ta largojnë atë, dhe për të tjerët që nuk janë sulmuar, që t’i ndihmojnë, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: **‘Në qoftë se kërkohen ndihmën tuaj në fe, është detyra juaj t’i ndihmoni ata, përveçse kundër atij populli me të cilët ju keni marrëveshje bashkëpunimi të ndërsjelltë.’**”

Po ashtu edhe i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka urdhëruar ta ndihmojmë muslimanin. Në këtë rast është detyrë mbi të gjithë, qofshin mercenarë apo jo. Çdonjëri e ka detyrë, sipas mundësisë, të bëjë xhihad me fizikun (veten) dhe me pasurinë e tij, së bashku me pakicën qoftë apo shumicën, në këmbësori apo në kalorësi, ashtu siç ishin dhe siç vepruan muslimanët në luftën e vitit të Hendekut. Allahu nuk ia lejoi asnjërit të linte xhihadin në këtë rast, ndryshe nga rasti kur ua lejoi të mos merrnin pjesë në xhihad për shkak se lufta nisej nga ana e muslimanëve për kërkimin e armikut. Allahu i Lartësuar i ka ndarë muslimanët në rastin kur lufta niset prej tyre, në të tillë që marrin pjesë në xhihad dhe të tillë që nuk marrin pjesë,¹⁷⁹ dhe ka sqaruar epërsinë e atyre që marrin pjesë mbi ata që nuk marrin pjesë, gjë e cila tregon se xhihadi në këtë rast nuk është detyrë për të gjithë. Ndërsa kur u sulmuan nga armiku në vitin e Hendekut, e dënoi aktin e atyre që kërkuan leje nga Profeti (salallahu alejhi ue selem) të largoheshin dhe të mos merrnin pjesë:

‘Një grup prej tyre kërkoi leje nga Pejgamberi duke i thënë: ‘Me të vërtetë që shtëpitë tona janë të hapura (për armikun).’ Ato nuk janë të hapura, veçse ata deshën t’ia mbathnin.’

Kjo sepse lufta bëhej për mbrojtjen e fesë, të nderit dhe të gjakut, kështu që si e tillë, është e domosdoshme. Ndërsa kur niset nga muslimanët ajo zgjidhet me vullnetin e tyre, për të ngritur e lartësuar fenë dhe për të frikësuar armikun, si puna e luftëtarëve në luftën e Tebukut e të tjera.

(Marrë nga “Mexhmuul fetaua”, 28/359)

Po ashtu ai ka thënë: “Xhihadi i mbrojtjes kundër kafirëve, është detyrë e gjithkujt.”

“Kur sulmon armiku, mbrojtja e fesë, gjakut dhe nderit nga dëmtimi i tij është detyrë. Ky është mendimi i të gjithë dijetarëve. Kur hyn armiku në vendet

) Ka për qëllim fjalën e Allahut në Kur’an: “Nuk janë të barabartë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre,¹⁷⁹ përveç atyre që janë të pamundur, me ata që përpiqen dhe luftojnë për Çështjen e Allahut me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre. Allahu i ka preferuar në shkallë më të lartë ata që përpiqen dhe luftojnë me pasurinë e tyre dhe me jetën e tyre, përmbi ata që rrinë në shtëpitë e tyre. Për secilin Allahu ka premtuar mirësi (Xhenet), por Allahu ka parapëlqyer ata që luftojnë, përmbi ata që rrinë në shtëpi, me një shpërblim të madh.” En-nisa: 95.

islame, nuk ka dyshim që është detyrë të marshohet drejt tij, pa qenë detyrë të merret leje nga prindi dhe as nga huadhënësi.”

Gjithashtu, pasi ka përmendur hadithin e Ubades: “Muslimani e ka detyrë ta dëgjojë dhe t’i bindet prijësit musliman në rast varfërie dhe pasurie, në gjërat që i shkojnë pas qejfit dhe në gjërat që i urren, si dhe në rastin kur përvetësohet e drejta e tij”, ka thënë: “Pra e ka bërë detyrë respektimin, themeli i të cilit është marshimi në xhihad në rast pasurie dhe varfërie. Ky është argument i qartë dhe i prerë, për obligimin e xhihadit, qoftë edhe në rast varfërie, ndryshe nga haxhi, i cili është detyrë vetëm për atë që ka pasuri. Kjo për sa i përket luftës së kërkimit. Ndërsa për sa i përket luftës së mbrojtjes, e cila është ndër llojet më të forta e më të theksuara të mbrojtjes së nderit dhe të fesë nga sulmuesi agresiv, ajo është detyrë, me pajtimin e të gjithë dijetarëve. Nuk ka gjë më të obligueshme pas besimit, sesa shmangia e largimi i armikut, sulmuesit agresiv, i cili shkatërron fenë dhe dynjanë. Për t’u mbrojtur dhe për ta larguar atë nuk ka asnjë kusht, por shmanget dhe largohet sipas mundësisë.”

Përgjigja e shejh Albanit lidhur me xhihadin e mbrojtjes

Pyetje - Në qoftë se një shtet kafirësh pushton një vend islam për të mbizotëruar të ardhurat ekonomike që gjenden në të, a e kemi detyrë ta mbrojmë këtë vend, apo në periudhën aktuale të dorëzohemi dhe të ngremë armët (në shenjë dorëzimi), pasi muslimanët nuk janë të përgatitur për realizimin e fitores, as nga ana e fesë dhe besimit dhe as nga ana ushtarake, dhe sepse i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka lajmëruar se poshtërimi nuk do të hiqet nga Umeti derisa të kthehet në fenë e Allahut, siç është përmendur në hadithin: “Kur të shisni dhe të blini me ‘el inetu’...”. Siç dihet kthimi për në fenë e Allahut akoma nuk është realizuar.

Përgjigje - Janë dy gjëra ndërmjet të cilave duhet të bëjmë dallim.

E para është xhihadi në rrugë të Allahut, për të cilin duhet të plotësohen shumë kushte, një prej të cilëve është fakti që duhet të jetë nën flamurin islam që e ngre Halifi musliman. Për këtë gjë muslimanët me keqardhje nuk janë të përgatitur.¹⁸⁰

) Ka për qëllim xhihadin e çlirimit. Për më gjerë rreth kushteve dhe rregullave të tij duhet të lexohet kapitulli i ¹⁸⁰ xhihadit në librat e Fikhut. Dëshiroj të tërheq vëmendjen se mund të konstatojmë fetva të disa dijetarëve bashkohorë, në të cilat përmendet se nuk janë plotësuar kushtet e xhihadit ose muslimanët nuk janë të përgatitur për xhihad e fjalë të ngjashme me këto. Këto fetva duhet të konceptohen sipas asaj që sqarohet në këtë kapitull, sepse ata mund të kenë për qëllim llojin e parë të xhihadit ose ndonjë vend të caktuar, kështu që nuk është e saktë të thuhet se e mohojnë ekzistencën e xhihadit të mbrojtjes tërësisht në kohën tonë.

E dyta është mbrojtja e vendit islam që e sulmojnë kafirët. Kur muslimani sulmohet në shtëpinë e tij, është detyrë të shpejtojme për mbrojtjen e tij. Gjykimi është i njëjtë, si në rastin kur sulmi i drejtohet një individ, po ashtu edhe kur i drejtohet bashkësisë së muslimanëve. Nuk lejohet ta lëmë kafirin të na sulmojë në tokën tonë dhe ne të rrimë duarlidhur! Përkundrazi, duhet të shpejtojme për mbrojtjen e vendit me sa mundësi që të kemi. Pra kjo është mbrojtje ndaj vetvetes, kështu që është e domosdoshme, siç tregon fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush vritet për mbrojtjen e pasurisë së tij është shehid.”¹⁸¹

Në qoftë se një qeveri kafire, sulmon një zonë islame, muslimani e ka detyrë që ta mbrojë, edhe sikur muslimanët e atij vendi të jenë të papërgatitur, si nga ana e konceptimit të vërtet të fesë islame, po ashtu edhe nga ana e përgatitjes materiale, për të cilën jemi të urdhëruar në Kur’an. Pra mbrojtja ndryshon nga xhahadi, nisja e të cilit bëhet atëherë kur muslimanët fillojnë të përzënë të gjithë ata që nuk gjykojnë dhe nuk qeverisin sipas asaj që e ka zbritur Allahu, qofshin kafirë apo të maskuar nën petkun e emrit islam. Për këtë lloj xhahadi duhet të kemi përgatitje të mjaftueshme në aspektin e konceptimit të qartë dhe të saktë të fesë, në aspektin e praktikimit të Islamit dhe të edukimit të muslimanëve në të, si dhe në aspektin e fuqisë dhe pajisjes me armë ushtarake konvencionale. Kurse për të mbrojtur veten dhe vendin çdonjëri duhet të përdorë mënyrën që ka mundësi.

Pyetësi - A mund të kuptoj nga përgjigjja juaj se xhahadi i afganëve tani, për të larguar pushtuesit rusë nga vendi i tyre, konsiderohet “farz ajn” për çdo musliman?

Shejhu - Patjetër që po.

Pyetësi - A është i saktë xhahadi i tyre?

Shejhu - Po. Xhahadi i tyre është i saktë, sepse ata janë sulmuar në vendin dhe shtëpitë e tyre, kështu që patjetër duhet të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që kanë për të larguar armiqtë dhunues. Realiteti i hidhur është se kjo nuk është vetëm detyra e tyre, por është detyrë për të gjithë botën islame. Ky aktualitet i dhimbshëm tregon se muslimanët nuk janë duke bashkëpunuar ashtu siç i ka urdhëruar Allahu i Lartësuar. Afganët luftojnë të vetmuar, ndërsa bota islame sheh se çfarë bëhet dhe nuk u ofron ndihmat e mundëshme. Ajo po i ndihmon me pasuri, por ndihma vetëm me pasuri nuk mjafton. Domosdoshmërisht duhet t’i ndihmojë me armë dhe me njerëz që t’i mundin armiqtë dhe të ngadhënjë

) Hadithi ka edhe dy fragmente të tjera të cilat thonë: “Kush vritet për mbrojtjen e vetes së tij është shehid, kush ¹⁸¹ vritet për mbrojtjen e fesë së tij është shehid, kush vritet për mbrojtjen e nderit të tij është shehid.” Hadithi është në “Sunenin” e ebi Daudit e të tjerë.

mbi ta. Kjo gjë është detyrë. Por vendet islame sot me punët e tyre, po tregojnë se mendojnë vetëm për vete. Arsyeja është se çdo shtet është i lidhur politikisht me njërin nga dy shtetet e mëdha, Rusinë dhe Amerikën, dhe asnjëri prej tyre nuk mund të bëjë ndonjë hap pa u urdhëruar nga zotnia e tij. Prandaj muslimanët kanë përpara një xhihad të vërtetë, të punojnë për t'i administruar vendet e tyre. Kjo gjë nuk mund të bëhet e mundëshme kurrë, përveçse duke u kthyer në fenë e Allahut siç është përmendur në hadith.

Pyetësi - Ajo që kuptoj nga hadithi i shitblerjes “el ineh” është se afganët nuk mundet të realizojnë fitoren kundër rusëve, për arsye se nuk i kanë punuar shkaqet e fitores. Atëherë çfarë dobie ka rezistenca dhe mbrojtja përballë tyre?

Shejhu - Ne nuk vërejmë përfundimet, por vërejmë rrethanat paraprake dhe ndodhirat. Sikur të vërenim të gjitha gjërat sipas përfundimeve, nuk do të dinim se si të gjykonim. Detyra jonë është të zbatojmë rregullat e Sheriatit, ndërsa a kanë mundësi të fitojnë afganët kundër rusëve apo jo, është gjë tjetër. Ata duhet të punojnë shkaqet për të cilat janë urdhëruar dhe që u mundësojnë mbrojtjen e vetvetes. P.sh. po të vërejmë numrin e paktë të muslimanëve dhe numrin e shumtë të mushrikëve në luftën e Bedrit, ndoshta ndonjëri do të mendojë: “Si do të fitojë kjo pakicë mbi këtë shumicë?” Ne nuk jemi të obliguar të mendojmë kështu, por jemi të obliguar të punojmë shkaqet e mundëshme për fitore. Pasi të punojmë atë që kemi mundësi, Allahu do të bëjë ngadhënjimtar atë që do të dëshirojë. Në lidhje me këtë temë, do të supozosh se afganët e kanë detyrë të mbrohen ose nuk e kanë detyrë të mbrohen. Nëse do të supozosh të parën, atëherë nuk bën të themi që nuk mund të fitojnë, sepse ata duhet të kryejnë detyrën, edhe sikur të shfarosen të gjithë. Ai që vritet për të mbrojtur pasurinë e tij është shehid, kështu që ata, po u vranë, bien dëshmorë. Mundësia që Allahu t'i trajtojë afganët me mirësinë e Tij dhe jo me drejtësinë, ekziston. Kam për qëllim të them se afganët si xhemat (grumbull) muslimanësh, janë si xhematet e tjera të muslimanëve. Ata kanë gabime në perceptimin e Islamit, punojnë me gjykime dhe rregulla që u kanë vendosur dijetarët e tyre, pa iu kthyer Kur'anit dhe Sunetit dhe kanë edhe shumë gjëra të tjera të cilat e bëjnë njeriun të mendojë në vetvete se këta njerëz nuk meritojnë ndihmën e Allahut, për arsye se i janë larguar konceptimit të vërtetë të Islamit. Por shpesh Zoti i botërave i trajton robërit e Tij me mirësinë e Tij dhe jo me drejtësinë e Tij. Drejtësia do të thotë që, nëse muslimani nuk i përmbush shkaqet e fitores, sidomos ato që kanë të bëjnë me Akiden, të mos ndihmohet, por ndoshta Zoti ynë i Lartësuar nuk i trajton muslimanët sipas drejtësisë së Tij, por sipas

mirësisë së Tij. Që Allahu t'i trajtojë me mirësinë e Tij dhe të ngadhënjejnë është e mundëshme.

Prandaj ne gjykojmë se çdo popull musliman e ka detyrë të punojë me aq sa ka mundësi për të mbrojtur vendin e vet, pastaj ndihma është në dorë të Allahut.¹⁸²

Pyetësi - Ju përmendët se është detyrë ta mbrojmë vendin kur përpiqet një shtet kafirësh për ta mbizotëruar. Po nëse kryetari i këtij vendi islam është si kafirët në besimin dhe në mënyrën e jetesës, veçse maskohet nën emrin e Islamit, çfarë ndryshimi ka qeverisja e popullit islam nga një kafir me kufër të deklaruar, me atë të një kafiri i cili shtiret si musliman?

Shejhu - Nuk ka ndryshim, por e rëndësishme është që të vërtetohet domethënia që është përmendur në pyetjen e kaluar se kur sulmohet vendi i muslimanëve, ata e kanë detyrë të mbrohen dhe ta përzenë armikun (sido që të jetë i pari i tyre).

(Përshtatur në gjuhën shqipe me disa ndërhyrje dhe rregullime të nevojshme nga “El havi”)

Qëndrimi që duhet mbajtur ndaj xhemateve të ndryshme të daves

Pyetje drejtuar ibn Bazit në lidhje me xhematet -

Shejh i nderuar, ju i dini sprovat që ekzistojnë në fushën e daves. Janë krijuar disa xhemate (grupe) si p.sh. “xhematu teblig”, “xhematu ihvanul muslimin”, “xhemati selefi” etj. dhe çdo xhemat thotë se është në të vërtetën dhe ndjek Sunetin. Prandaj o shejh, të kërkojmë për hir të Allahut të na lajmërosh se cili xhemat është në të vërtetën dhe cilin të ndjekim prej tyre. Përmendi me emër, Allahu të shpërbleftë me të mira.

Përgjigjja e shejhut - E ke dëgjuar gjatë ligjëratës dhe komentit që i bëra ligjëratës se cili është xhemati që duhet të ndiqet. Ata janë të udhëzuarit në rrugën e drejtë, janë ndjekësit e Profetit (salallahu alejhi ue selem), janë ndjekësit e Kur'anit dhe Sunetit, të cilët ftojnë për në Librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Ndërsa xhematet e tjera mos i dëgjo, vetëm në qoftë se e qëllonjë të vërtetën, qofshin “ihvanul muslimin”, “xhemati tablig”, “ensarus suneh”, ose ata që thonë se janë “selefij”, “el xhematul islamijeti”, ata që e emërtojnë veten “ehlul hadith” etj.

) Vërtet ashtu sikurse ka diskutuar shejhu në vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar, Allahu me mirësinë e Tij i¹⁸² ndihmoi afganët kundër rusëve dhe e fituan luftën, por si rrjedhojë e mungesës së dijës së saktë, ose si rrjedhojë e mospraktikimit të saj, u përfshinë më vonë në luftë civile, anarki dhe konflikte, derisa talebanët e shtrinë pushtetin e tyre në shumicën e trojeve afgane.

Të gjithë këta respektohen dhe ndiqen në të vërtetën. Pajtohesh me ta në gjërat për të cilat kanë argument, kurse gjërat për të cilat nuk kanë argument i refuzon. U thuhet p.sh. “jo, këtë e keni gabim, në këtë keni gabuar, keni gabuar o vëllezër, keni gabuar në këtë gjë. Pajtohem me ju në këtë çështje që përputhet me ajetin dhe hadithin fisnik, që përputhet me ‘ixhmain’ (unanimitetin) e dijetarëve dhe që përputhet me drejtimin e ‘ehlus-suneh uel xhemah’.”

Gjithashtu mund t’u thuhet për të korigjuar gabimet e tyre se thënia ose vepra e tyre është gabim.

Këto gjëra ua thonë të diturit, vetëm të diturit janë ata që i dinë këto gjëra. Ata ua sqarojnë gjërat dhe çështjet xhemateve islame, si “xhematu teblig”, “xhematu ihvan”, “xhematu ensarus-sune”, “xhemati selefi” etj. Gjërat në mënyrë të detajuar i njohin të diturit, ata që kanë dije rreth Kur’anit dhe Sunetit dhe ata që i kanë konceptuar çështjet fetare të bazuar në Kur’an dhe Sunet. Këto xhemate që u përmendën kanë gjëra të vërteta dhe të pavërteta. Asnjë grup nuk është i pagabueshëm. E vërteta është ajo që bazohet në argument. Çështja që bazohet në argument të saktë është e vërtetë, qoftë nga këto xhemate apo nga medhhebi hambeli, shafi, maliki, dhahirije, hanefi e të tjerë. Gjërat që bien në kundërshtim me argumentet e Kur’anit dhe Sunetit, janë gabim. Bartësit të mendimeve të gabuara, në qoftë se është prej pasuesve të së vërtetës dhe ka bërë “ixhtihad” për të kërkuar të vërtetën, i jepet një shpërblim. Ndërsa në qoftë se e qëllon të vërtetën me anë të “ixhtihadit” që bën për ta kërkuar atë, i jepen dy shpërblime.

Ata që ftojnë për në një rrugë tjetër dhe jo në atë të Kur’anit dhe Sunetit, nuk ndiqen dhe nuk imitohen, nuk përfillen mendimet e tyre, por u shpallet armiqësi, si p.sh. ftuesit për në shiizëm (err-rrafida, shiitët),¹⁸³ të cilët ftojnë njerëzit kundër “ehlu suneh uel xhemah”, shajnë sahabët dhe pretendojnë me gënjeshtër e mashtrime se ndjekin “ehlul bejt” (familjen e Profetit). Pretendimi i tyre është i pavlefshëm, sepse “ehlul bejti” është prej “ehlus-suneh uel xhemaah”. Aliu, Hasani e Husejni, pjesëtarët e tjerë të familjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem), si dhe pasardhësit e tyre të cilët njihen për të mirë,

) Shejhu, Allahu e mëshiroftë, i ka dhënë si shembull shiitë t dhe bidatin e tyre duke pasur si qëllim që ndaj të¹⁸³ gjithë atyre që i kanë këto bidate ose edhe të tjera bidate që janë në rangun dhe rrezikshmërin e tyre, duhet të kemi të njëjtin qëndrim, edhe sikur njerëzit që kanë të tilla bidate t’i përkasin ose t’i atribuohen ndonjërit prej xhemateve të përmendura më lart. Nga shkoqitja që i ka bërë shejhu trajtimit të gabimeve dhe bidateve në të cilat bien grupet e ndryshme, kuptojmë se nuk mbahet ndaj të gjithëve i njëjti qëndrim, d.m.th. me armiqësi, bojkotim dhe ashpërsi. Një ndër principet që duhet të kemi parasysh në këtë drejtim është edhe lloji i bidatit apo gabimit në të cilin ka rënë personi. Ai nga sqarimet dhe shembujt që ka dhënë e ka bërë të qartë se qëndrimi ynë duhet të ndryshojë sipas llojit të gabimit dhe rrezikshmërisë së tij. Është e padrejtë të konsiderohen të gjithë të barabartë për sa i përket qëndrimit të ndërmarrë ndaj tyre, meqenëse bidatet dhe gabimet janë të diferencuara.

të gjithë janë prej “ehli sunetit”, në rrugën e sahabëve. Pra ata kanë ndjekur të njëjtën rrugë që e ka ndjekur ebu Bekri dhe Umeri. Ai që e kundërshton “ehli bejtin” në besimin dhe rrugën e tyre dhe pretendon se ata e dinin të fshehtë, ose meritojnë të adhurohen përveç Allahut, kështu që i lutet atyre ose thotë se duhet të ngrihen faltore ose kubé mbi varret e tyre, ky njeri, padyshim është në të kotën dhe të pavërtetën, sepse të gjitha këto gjëra janë të kota dhe të pavlefshme. Prandaj njerëz të tillë nuk lejohet të ndiqen dhe as të imitohen.

Po kështu janë edhe shekullaristët (ata të cilët mendojnë se feja duhet të jetë e ndarë nga jeta, politika), të cilët ftojnë për në idetë që bien ndesh me Sheriatin. Ata ftojnë për t’u ndjekur tektrat dhe dëshirat e tyre dhe për t’u lënë pas dore ndjekja e Kur’anit dhe Sunetit. Qëllimi i tyre është që të shkojnë pas epsheve të njerëzve dhe dëshirave të tyre, dhe të punojnë për të rregulluar jetën e tyre në dynja. Këta njerëz duhet të luftohen dhe të mos respektohen. Ai që duhet të ndiqet dhe të respektohet është ai që fton për në Librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Këta respektohen në gjërat që e kanë qëlluar të vërtetën, kurse kur gabojnë, nuk pasohet gabimi i tyre. Kur ndonjëri prej tyre e qëllon të vërtetën i thuhet se ke bërë shumë mirë, ndërsa kur gabon i thuhet se gabove, pasi ke kundërshtuar aksh argument, kështu që e ke detyrë të pendohesh dhe të pranosh të vërtetën.

Këto gjëra ua thonë dhe ua sqarojnë njerëzit e ditur, ndërsa masa e gjerë e njerëzve, duhet të pyesin të diturit që njohin dhe ndjekin Kur’anin dhe Sunetin, dhe të cilët nuk ftojnë në ateizëm, devijim, shiizëm (në idetë e rafidive, shiitëve), në idetë e filozofëve si xhehmijtë e të tjerë, dhe as në të tjera ide dhe mendime të pavlefshme dhe të kota. Muslimani duhet të ndjekë ata që ftojnë për në Kur’an dhe në Sunet, me argument. Ai duhet të pyesë dijetarët, të cilët njihen se ndjekin Kur’anin dhe Sunetin, t’i pyesë ata dhe t’u thotë: “Çfarë thoni për thirrjen që bën filani?” Atëherë i dituri do t’i japë përgjigjen e duhur në mënyrë që pyetësi të qartësohet. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Pyetni të diturit në qoftë se nuk dini.”** (En-Nahl: 43)

Të diturit që Allahu na e ka obliguar t’i pyesim, janë ata që kanë dije rreth Kur’anit dhe Sunetit. Ndërsa bidatçinjtë nuk janë prej të diturve, pra ata që ftojnë për në bidate nuk janë prej të diturve.¹⁸⁴

¹⁸⁴) Marrë nga pyetjet dhe përgjigjet që janë përmendur në fundin e broshurës “El fikh fid-din ismetun minel fiteni”, që është botuar nën kujdesin e Kryesisë së Administratës së Kërkimeve Shkencore dhe Fetvave në Arabinë Saudite në vitin 1422 h. (2002 sipas kalendarit gregorian). Kur përballen disa njerëz me deklarime dhe fetva të tilla të dijetarëve, të thonë se kjo është abroguar nga një fetva ose qëndrim tjetër, ose ky ka qenë mendimi i shejhut, por më vonë e ka ndryshuar atë. Madje disa nuk ngurrojnë të thonë se ky është mendimi i tij, kurse ne mendojmë ndryshe, ose ta cilësojnë qëndrimin e tij si neglizhent dhe jokorrekt. E gjithë kjo thuhet sepse qëndrimi i tyre ndaj xhemateve

Është obligim të mos përkrahet një xhemat dhe të lihet një tjetër (tërësisht)

Pyetje - Unë jam student i universitetit, jetoj mes mendimesh e idesh të ndryshme e mes grupeve ku gjithsecili prej tyre pretendon se është më i mirë se të tjerët, dhe bën çmos për të mbledhur (fituar) pasues (p.sh. grupi “el ihvanul el muslimin”, xhemati “teblig” që del 40 ditë e 4 muaj për thirrje islame, xhemati “ensarus-suneh selefi”, dhe grupi “el Islami” i Abdul-Hamid bin Badis).

dhe individëve të ndryshëm, në shumë raste ndryshon nga ai i dijetarëve të mëdhenj si ibnu Bazi e të tjerë. Ndaj të gjithë këtyre kemi vërejtjet që vijojnë:

E para, ndodh që dijetari të japë një gjykim ose të ndërmarrë një qëndrim ndaj një personi të caktuar, si rrjedhojë e mosnjohjes së gjendjes së tij të mëparshme dhe mendimit të mirë për të, ose si rrjedhojë e ndryshimit të mëvonshëm të personit për të cilin është dhënë gjykimi. Në këtë rast është e natyrshme që të ketë ndryshuar mendimi dhe qëndrimi i tyre ndaj disa personave të caktuar. Ndërsa kur bëhet fjalë për mendimin dhe qëndrimin ndaj metodave dhe xhemateve të njohura, që kanë ekzistuar që prej dekadash, nuk është e natyrshme që të ndryshojnë fetvatë dhe mendimet e tyre, vetëm në qoftë se kanë pasur edhe vetë mendime të tilla ose kanë qenë të përfshirë në gabimet e tyre dhe i kanë ndryshuar më vonë. Dijetarë të mëdhenj si ibnu Bazi e të tjerë, janë larg luhatjesh dhe gjërash të tilla, sepse “menhexhi” i tyre ka qenë i qartë, i rregullt, i saktë dhe gjithmonë konform Kur’anit dhe Sunetit. Ata i kanë njohur mirë xhematet dhe grupet që kanë dekada që ekzistojnë, dhe në bazë të kësaj njohurie kanë gjykuar ndaj tyre, kanë sqaruar se çfarë qëndrimi duhet mbajtur dhe cila është mënyra për analizën dhe trajtimin e gabimit të tyre. Fetvatë, qëndrimet dhe këshillat e tyre bazohen në rregulla të sakta dhe të qëndrueshme, të cilët janë marrë nga Kur’ani dhe Suneti. Pretendimi se nuk e kanë njohur aksh xhemat dhe “menhexhin” e tyre dhe si rrjedhojë kanë gabuar ose toleruar, përbën akuzë ndaj tyre për mosnjohjen e aktualitetit që është shumë i prekshëm dhe i njohur në masë, dhe për lëshimin e fetvave pa dije të mjaftueshme rreth aktualitetit. Kjo është e ngjashme me akuzën që u bëjnë disa grupe për mosnjohjen e realitetit. Pra, këto dy palë ekstreme kanë motive të njëjta kundrejt dijetarëve, mosrespektimin e mospërfilljen e fetvave të tyre dhe ndjekjen e epsheve, dëshirave, tekave dhe fanatizmin për persona ose grupe të caktuara, megjithëse çështjet për të cilat diskutojnë janë të ndryshme. Madje i përkasin dy anëve ekstreme përballë njëra-tjetrës. Pasojat e këtij qëndrimi të tyre ndaj dijetarëve janë përçarja, shkatërrimi dhe prapambetja.

E dyta, fetvaja e ibnu Bazit ka të bëjë me xhemate të njohura, prandaj ajo tregon qartë se kjo është metoda e tij për trajtimin e gabimeve të tyre, siç e sqaruar më lart.

E treta, sikur të konsiderohej i qenësishëm ndryshimi i qëndrimeve të tij, kjo këshillë është bërë nga fundi i jetës së tij, kështu që si e tillë, ajo përmban metodën që iu përmbajt ibnu Bazi deri në fund.

E katërta, fetvaja e dijetarit mbetet në fuqi si mendim i tij, përderisa nuk është abroguar nga një fetva tjetër e tij.

E pesta, ata që e pranojnë këtë si këshillë të ibnu Bazit dhe fetva të tij dhe e konsiderojnë si gabim, duhet të dinë se ajo ka të bëjë me “menhexhin” e tij, kështu që kritika ndaj tij në çështje të tilla, do të thotë mospërputhje me “menhexhin” e tij. E njëjta përgjigje vlen edhe për fetvatë dhe thëniet e dijetarëve të tjerë që kanë të bëjnë me çështjet metodologjike.

E gjashta, ata që i konsiderojnë neglizhentë në çështjet e “menhexhit” dhe bidatit dhe tolerantë ndaj bidatçinjve, duhet të mësojnë edukatën e sjelljes me dijetarët dhe t’i përmbahen asaj. Gjithashtu duhet të dinë se nuk janë më të interesuar se dijetarët si puna e ibnu Bazit për luftimin e bidatit dhe përhapjen e Sunetit. Do të ishte më e mirë për ata që akuzojnë mendimin e tyre, të rishikonin qëndrimet e tyre dhe të mësonin se qëndrimi i ibnu Bazit është i mesëm dhe normal, por ngaqë ata vetë kanë kaluar në ekstrem e ashpërsi u duket tolerant e neglizhues.

E shtata, të meditojnë mbi fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Ruhuni nga ekstremizmi dhe teprimi në çështjet e fesë, sepse vërtet ata që ishin para jush i shkatërroi ekstremizmi dhe teprimi në këto çështje.” Transmeton Ahmed, ebu Davudi e të tjerë.

Për këtë, shpresoj dhe kërkoj prej jush të na drejtoni në rrugën e drejtë në të cilën gjendet lumturia jonë dhe ruajtja e fesë prej çdo ndikimi të rrymave të jashtme, të cilat po na gërryejnë kockat dhe ne s'e kuptojmë (nuk e dimë).

Përgjigje - Ajo që të del ty si obligim është që të kapesësh pas së vërtetës (hakut) për të cilën tregon argumenti dhe mos u antarëso në ndonjë xhemat (grup) të caktuar (e të lësh të tjerat). Grupi më parësor me të cilin mund të bashkëpunosh është ai grup që ruan Akiden (besimin) e saktë të imamëve, të parëve tanë të devotshëm (selefus-salih), Allahu qoftë i kënaqur me ta, dhe që punon me Librin e Allahut dhe sunetin e Profetit të Tij (salallahu alejhi ue selem), si dhe të lësh çdo bidat.

Suksesi është prej Allahut, falja dhe paqja e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), mbi familjen dhe shokët e tij.

Komisioni i përhershëm i hulumtimeve dhe i fetvave.

Kryetar: Abdul-Aziz bin Baz

Zv. kryetar: Abdurezak Afifi

Anëtarë: Abdullah bin Kuud, Abdullah bin Gudejan

(Marrë nga fetvatë e komisionit të përhershëm të hulumtimeve dhe fetvave.)

Grupi islam më i afërt me të vërtetën

Pyetje - Në botën islame sot ka shumë grupacione e sekte sufiste si p.sh. “xhemati tablig”, “el ihuanul muslimin”, sunitë, shiitët, etj. Cili prej tyre zbaton (dhe praktikon) sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem).

Përgjigje - Grupi islamik më i afërt me të vërtetën dhe që janë të kujdesshëm në praktikimin e saj janë “ehlus-sunneh”, ata janë “ehli hadithi” (që kapen pas hadithit dhe që e mësojnë atë) sikurse është edhe xhemati “ensarus-sunneh” e pastaj “el ihuanul muslimin”.

Por themi se çdo grup prej të përmendurve e të tjera grupe, kanë gabime dhe të drejta (të vërteta).

Ajo që të del ty si obligim është që të bashkëpunosh me ta aty ku kanë të drejtë (kur janë me të vërtetën) dhe të largohesh prej gjërave që i kanë gabim, duke u këshilluar dhe bashkëpunuar në punë të mira e devotshmëri.

Suksesi është prej Allahut. Falja dhe paqja e Tij qoftë mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), familjen e tij dhe shokët e tij.

(Komisioni i përhershëm i hulumtimeve dhe fetvave)

Xhematet e ndryshme

Pyetje - Në këtë kohë dëgjojmë të flitet shumë rreth xhemateve islame të cilat ftojnë për në fenë islame. Cilin prej tyre të ndjekim? Çfarë qëndrimi duhet të mbajë muslimani ndaj këtyre xhemateve të ndryshme?

Përgjigje - Kjo çështje është shumë e dhimbshme dhe për të ardhur keq, sepse njerëzit kur përçahen bëhen siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Dhe mos u përçani e të dështoni e të shfaroseni.”**

Nëse përçaheni e bini në kontradikta, atëherë dështoni e shkoni drejt humbjes, shfaroseni e nuk ju mbetet më asnjë peshë e asnjë vlerë. Armiqtë e Islamit, të hapur e të fshehtë, gëzohen me këto përçarje dhe gjithmonë e ndezin zjarrin e tyre, i vijnë dikujt prej muslimanëve duke i thënë se filani ka këtë apo atë gjë, e kështu nxisin armiqtë e urrejtje ndërmjet vëllezërve, të cilët janë thirrës në rrugën e Allahut të Lartësuar.

Detyra jonë është të qëndrojmë larg kurtheve të armiqve të Allahut, të Profetit të Tij (salallahu alejhi ue selem), dhe të fesë së Tij. Të jemi një Umet i vetëm, të bashkohemi me njëri-tjetrin, të përfitojmë nga njëri-tjetri dhe të jemi sikurse një thirrës i vetëm. Kjo arrihet duke u bashkuar në çdo vend prijësit (paria) që u dëgjohet fjala nga vëllezërit e tyre, ta studiojnë gjendjen dhe të biem dakort për një plan që t’i bashkojë të gjithë. Edhe pse mund të ndryshojë

mënyra e thirrjes, kjo nuk ka rëndësi, dhe nuk përbën dëm.¹⁸⁵ E rëndësishme është të jemi vëllezër të dashur dhe të bashkuar në të vërtetën (hakun).

Ndërsa për sa i përket asaj se cili prej këtyre xhemateve është më i mirë, nëse do ta veçoja njërin grup, do ta aprovoja këtë përçarje, e unë kurrë nuk e aprovoj atë.

Por ajo që e shoh të domosdoshme është që të shikojmë çështjen tonë me sinqeritet dhe me pastërti për Allahun e Lartësuar, për librin e Tij, për Profetin e Tij (salallahu alejhi ue selem), për parinë e muslimanëve dhe masën e përgjithshme. Të jemi një dorë e vetme, ndërsa haku (e vërteta) është i qartë, elhamdulillah (falënderimi i takon Allahut).

E vërteta nuk mund t'i fshihet askujt përveç dy personave: ose dikujt që kthen shpinën e refuzon, ose mendjemadhit. Ndërsa atij që e dëgjon të vërtetën me vëmendje e me bindje, pa dyshim do t'i jepet sukcesi (prej Allahut).

Shejh ibn Uthejmin

(Marrë nga kapitulli “El xhihad ued-daueh”, fq. 274-279 i “El emru bil marufi uen-nahja anil munker”)

Këshilla e dijetarit Mukbil ibn Hadi el Vadi'i drejtuar “ehli sunetit” për t'u bashkuar

Buhariu (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Na ka treguar Ja'kub bin Ibrahim, Hushejmi, dhe Sejjeri i cili transmeton nga Shabiu, se Xherir ibn Abdil-lah ka thënë: ‘I kam dhënë besën të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) të dëgjoj e të bindem. Më tha: ‘Sa të kesh mundësi, gjithashtu të këshillosh çdo musliman.’” (Vëll. 13, fq. 193)

Imam Muslimi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë se Muhamed ibn Abbad el Mekki ka treguar që Sufjani i ka thënë: “I thashë Suhejlit se Amri na ka treguar diçka të transmetuar nga Kaëkaë prej babait tënd, dhe ai më tha se mendonte ta

) Nuk ka dyshim që shejhu ka për qëllim shumëllojshmërinë e mënyrave përderisa janë të ligjshme siç kuptohet¹⁸⁵ nga fetvatë e tjera të tij, të cilat janë përmendur në këtë libër.

transmetonte atë me zinxhir transmetimi më të shkurtër, pasi edhe ai e kishte dëgjuar prej atij që e kishte dëgjuar babai i tij.

Pra, na ka treguar Sufjani nga Suhejli, i cili transmeton nga Ataë ibn Jezid dhe ky nga Temim ed-Dari, se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Feja është çiltërsi, vërtetësi, dhe këshillë e sinqertë!” Thanë: “Për kë?” Tha: “Për Allahun, Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, për krerët e muslimanëve dhe masat e gjera të tyre!” (Vëll. 1, fq. 74)

Këshilla ime për “ehli sunetin” është që t’i largohen shkaqeve që çojnë në përçarje dhe kontradikta.

Akideja (besimi) i “ehli sunetit” është një, drejtimi i tyre është një, kështu që nuk ka asgjë që t’i shtyjë ata në përçarje e kontradikta përveç injorancës, padrejtësisë dhe shejtanit.

Transmetohet në librin e haditheve të vërteta të imam Muslimit se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Vërtet shejtani e ka humbur shpresën të adhurohet në gadishullin arabik prej atyre që kryejnë faljen, por ka shpresë të fusë përçarje midis muslimanëve.”

Dihet që kontradiktat janë sherr (diçka e keqe), sikurse ka thënë Abdullah ibn Mes’ud (radijallahu anhu), kur Uthmani (radijallahu anhu) fali namazin në Mina katër rekate: “Kam falur namazin me të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) në Mina dy rekate, me ebu Bekrin e me Umerin gjithashtu dy rekate! Ah sikur të kishim falur dy rekate të pranueshme tek Allahu!” (Buhariu).

Ndërsa në transmetimin e ebu Daudit shtohet, sikurse përmendet në “Fet’hul bari”, se dikush i tha Abdullahit (radijallahu anhu): “Vlerësove të metë (të mangut, jo të saktë) veprën e Uthmanit, e ti vetë fale katër rekate?!” Atëherë Abdullah ibn Mes’ud (radijallahu anhu) tha: “Kontradikta është sherr (gjë e keqe). Zoti ynë thotë në Librin e Tij të madhërueshëm: **‘E mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë.’**” (El Enfalë: 46)

Në hadithin e vërtetë që transmetohet nga Xhundub, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Lexojeni Kur’anin derisa ju bashkohen zemrat me të dhe në të, por nëse bini në konflikte, atëherë çohuni dhe lereni leximin!”

Në “Musnedin” e imam Ahmedit (me kuptim) transmetohet nga Abdullah bin Amr ibn ul As (radijallahu anhu) se një grup sahabësh u ulën në dhomën e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe filluan të binin në kontradikta. Njëri argumentohej me një ajet, e tjetri me një tjetër, derisa doli Profeti (salallahu alejhi ue selem) i zemëruar e tha: “Nuk jeni dërguar me këtë gjë, mos e godisni një pjesë të Kur’anit me një tjetër, pse nuk bëni si këta dy burra?” (d.m.th Abdullah ibn Amri dhe një tjetër, të cilët ishin ulur larg nga të pranishmit).

Gjithashtu në hadithin e vërtetë që transmetohet nga ebu Hurejre, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Më lini përderisa unë ju lë (mos më pyesni përderisa nuk u tregoj), sepse ato që i kanë çuar në humbje ata që ishin para jush, kanë qenë pikërisht pyetjet e shumta dhe kontradiktat me profetët e tyre.”

Transmetohet në “Sahihul Buhari” se Abdullah ibn Mes’udi kishte dëgjuar një burrë duke kënduar një ajet, ndryshe nga mënyra që ai e kishte dëgjuar ta këndonte (atë ajet). Më pas Abdullahi thotë: “E mora për dore dhe bashkë me të shkova tek Profeti (salallahu alejhi ue selem) i cili na tha: ‘Të dy keni vepruar mirë, lexoni (ajo që më kujtohet më mirë) se ata që kanë qenë para jush kanë rënë në kontradikta!’”

Ndërsa hadithi: “Kontradiktat (ihtilafi) e Umetit tim janë mëshirë”, është hadith i kotë (jo i saktë), si në zinxhirin e transmetimit, ashtu edhe në përmbajtje (kuptim), sepse zinxhiri i transmetimit (senedi) është “muëdal”,¹⁸⁶ ndërsa përmbajtjen (metnin) e tij e hedhin poshtë argumentet e lartpërmendura. Nga thënia e Allahut në Kur’an: “**...E ata vazhdojnë të jenë në kontradikta (të përçarë) përveç atij që ka mëshiruar Zoti yt...**”, kuptohet se ata të cilët janë në kontradikta e në përçarje nuk janë prej atyre që i ka mëshiruar Allahu. Allahu e di më së miri!

Nuk mund t’ju sjell si argument juve që jeni prej “ehli sunetit”, thënien e Allahut të Lartësuar: “**Gjithsecili grupacion, i kënaqur në idenë e tij.**”, sepse ju, falenderimi i takon Allahut, nuk e keni përçarë fenë tuaj, por keni rënë në

) Pra në zinxhirin e transmetimit të tij mungojnë dy ose më shumë transmetues njëri pas tjetrit në radhë.¹⁸⁶

kontradikta (mospajtime) për disa çështje për të cilat edhe të parët tanë (selefët), Allahu i mëshiroftë, kanë pasur mospajtime, madje në çështje edhe më të mëdha se tuajat, vetëm se kjo nuk shkaktoi bojkotim (hexhër), e as shkëputje të lidhjeve mes njëri-tjetrit (katiah).

Ai i cili lexon librin “El muhal-la” të ebu Muhamed ibn Hazm, “Ihtilafu ulema” të Muhamed bin Nasr el Meruezi, “El eusetu fis-suneni uel ixhmai uel ihtilaf” të ibnul Mundhir, “Fet’hul bari”, ose “Tefsirin” e ibn Kethirit (Allahu i mëshiroftë të gjithë), vëren se të parët tanë kanë pasur mospajtime në shumë çështje që kanë të bëjnë me ibadetet (adhurimet), apo marrëdhëniet e ndryshme (muamelatet), por kjo nuk bëri që dijetarët të bojkotonin njëri-tjetrin, ndërsa tek ata që erdhën më pas, mbase ka ndodhur një gjë e tillë për shkak të injorancës apo fanatizmit.

Falenderimi i takon Allahut që “ehli suneti” nuk është si të tjerët, të cilët bien në kontradikta në Akiden e tyre si huarixhët p.sh., që cilësojnë kafirë njëri-tjetrin. Po ashtu edhe krerët e muëtezileve cilësojnë kafirë njëri-tjetrin, sikurse sqarohet në “El milel uen-nihal”. Ndërsa shumica e mospajtimit dhe kontradiktave të “ehli sunetit”, falenderimi i takon Allahut, është në të kuptuarit e hadithit, në adhurime të cilat feja i ka sqaruar në forma të ndryshme, ose në saktësimin apo dobësimin e ndonjë hadithi, e të tjera shkaqe të cilat i ka përmendur shejhul islam ibni Tejmije (Allahu e mëshiroftë).

Ju e dini mirë o “ehli sunet”, se armiqtë tuaj gëzohen kur ju shohin keq, dhe se armiqtë e Islamit vetëm juve ju frikësohen, prandaj edhe përpiqen t’ju përçajnë me çdo mënyrë.

Ajo që është obligim për “ehli sunetin”, është që të jenë i gatshëm për zgjidhjen e problemeve të të gjithë botës, sepse vetëm ai e meriton një gjë të tillë, pasi vetëm atij i ka dhuruar Allahu të kuptuarit e drejtë të Kur’anit dhe të sunetit të Profetit të Tij (salallahu alejhi ue selem).

“Ehli suneti” llogaritet si shumica e botës islame, por përçarja dhe mospajtimet midis tyre, si dhe mosnjohja e gjendjes së njëri-tjetrit, i ka bërë të asimilohen nëpër shoqëri të ndryshme. Shpresoj që Allahu t’i dhurojë sukses revistës “El bejan” për të qartësuar gjendjen e “ehli sunetit” dhe përhapjes së

shkrimeve rreth gjendjes së tij, se mbase Allahu e mbledh dhe e bashkon atë. A nuk je i pari o “ehli sunet”, që të jesh i bashkuar dhe në një fjalë të vetme!?

E Allahu i Lartësuar në Librin e Tij thotë: **“E kapuni fort pas litarit (fesë) të Allahut e mos u përçani.”** (Ali Imran: 103).

Ndërsa Profeti (salallahu alejhi ue selem) sikurse tansmetohet në “Sahihul Buhari” dhe “Sahihul Muslim” nga ebu Musa el Esharij, thotë: “Besimtari për besimtarin është si ndërtesa, pjesët e së cilës përforcojnë njëra-tjetrën.” (në origjinal: forcojnë vetveten).

Gjithashtu thotë në hadithin e Nu'man bin Beshirit, siç transmetohet në sahihët e Buhariut dhe Muslimit: “Shembulli i besimtarëve në dashurinë midis tyre dhe në mëshirim, është sikurse një trup i vetëm, nëse ankohet ndonjë gjymtyrë (organ, pjesë) të gjithë trupin e kaplon temperatura e pagjumësia.”

Rafidat (shijat) e kanë shfrytëzuar informacionin për qëllimet e tyre në të gjithë botën dhe janë bërë shkak për humbjen e shumë njerëzve, madje i kanë prishur edhe ritet e haxhit. Në vend që të përmendin Allahun në ato vende të bekuara, shikohet se si shiitët dalin në demonstratat e injorancës duke thirrur: “Humejni, Humejni”. Kush mund t’i shpërndajë këto grupime që kanë dalë jashtë urdhërave të Allahut dhe që haxhin e kanë kthyer në moto (parrullë), zhurmë, rrëmujë dhe thirrje të xhahilijetit? Nuk mundet askush, me lejen e Allahut, përveç “ehli sunetit”, nëse bashkohen në një fjalë të vetme. Njimend bëhu sikurse duhet të jetë “ehli suneti”.

Ky rizgjim i popujve muslimanë, ka nevojë për përkujdesje, e kush mund të përkujdeset përveç “ehli sunetit”!?

Shërimi i kontradiktave dhe mospajttimeve që ekzistojnë ndërmjet “ehli sunetit” në kohën tonë

S’ka dyshim se mospajtimi dhe kontradiktat midis “ehli sunetit” shuhën me lejen e Allahut, por duhet gjithashtu të mbahen parasysh disa çështje.

- Vënia e Kur’anit dhe Sunetit si gjykues (në çdo çështje).

Allahu i Lartësuar thotë:

“Nëse bini në konflikt (kontradiktë) për diçka, kthejeni atë (për gjykim) tek Allahu dhe i Dërguari, nëse e besoni Allahun dhe Ditën e Fundit.” En-Nisa: 59.

“Për çdo gjë që bini në kontradiktë, gjykimin e saj (e gjeni) tek Allahu.” El Shura: 10.

“Madje kur u vjen atyre ndonjë lajm qetësues ose shqetësues, ata e përhapin atë, e sikur t’ia linin Pejgamberit dhe krerëve të tyre, ata do të dinin të nxirrnin përfundime. Po sikur të mos ishte dhuntia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, atëherë ju, pos një pakice, do të ndiqnit rrugën e djallit.”

- Pyetja e dijetarëve të “ehli sunetit”.

Allahu thotë:

“Pyetni të diturit nëse nuk dini.” En-Nahl: 43.

Mirëpo disa nxënës dije u mjaftuan me dijen që kanë, dhe kanë filluar të debatojnë me cilindo që i kundërshton, gjë e cila është shkak që çon në përçarje e kontradikta.

Transmeton imam Tirmidhiu në librin e tij “Xhamiut-Tirmidhi” nga ebu Umame se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Çdo popull që ka humbur pasi ka qenë i udhëzuar, ka humbur në debatime”, e pastaj lexoi: **‘Nuk ta sollën ty si shembull atë, vetëm se për të të kundërshtuar (debatuar me ty). Vërtet ata janë popull armiqësor.’** Ez-Zuhruf: 58.

- Përkushtimi në kërkimin e dijes.

Nëse do të shikoje mangësitë e vetvetes, madje që t’i nuk je asgjë në krahasim me dijetarët e kaluar, siç kanë qenë ibn Kethiri e të tjerë hafizë të njohur në dije të ndryshme, do të kishe punë të mjaftueshme për t’u marrë me vetveten, para se të merreshe me kritikimin e të tjerëve.

- Marrja në konsideratë e mospajtimeve që kanë pasur midis tyre sahabët dhe dijetarët e njohur që kanë ardhur pas tyre.

Nëse do të shikoje në to, do të trajtoje në mënyrë më paqësore kundërshtimin, e nuk do të kërkoje me këmbëngulje t'i nënshtrohej ndokush mendimit tënd. Do të kuptoje mirë që duke i kërkuar një gjë të tillë (që t'i nënshtrohet mendimit tënd) je duke e thirrur që të mos përfillë logjikën dhe të kuptuarit e tij, je duke e thirrur që të bëjë “taklid” (pasim verbërisht, pa argument) dhe “taklidi” në fe është i ndaluar:

“Dhe mos thuaj atë për të cilën nuk ke dije. Me të vërtetë për shikimin, dëgjimin, mendjen, për të gjitha këto njeriu do të merret në llogari...”, e të tjera argumente që sqarojnë këtë, të cilat i ka përmendur imam Sheukani në librin e tij “El kaulul mufid fi edil-letil ixhtihadi uet-teklid”.

- Vështrimi i gjendjes së botës islame dhe rreziqet që e rrethojnë atë.

Më e keqja qëndron se muslimanët nuk e dinë këtë, e nëse do të vështroje botën islame, nuk do të kishe kohë të merreshe me vëllain tënd i cili nuk pajtohet me ty në të kuptuarin tënd, e kështu që do t'i jepje përparësi asaj që është më e rëndësishme në vend të asaj që është më pak e tillë. Profeti (salallahu alejhi ue selem) kur dërgoi Muadhin (radijallahu anhu) në Jemen i tha: “Le të jetë gjëja e parë që t'i thërrasësh në të, dëshmia se s'ka Zot tjetër që me të drejtë meriton të adhurohet përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.” Transmeton Buhariu, Muslimi nga ibni Abasi.

Gjithashtu ne kemi vërejtur se çështjet në të cilat “ehli suneti” ka mospajtime e kontradikta mes veti, (duke përjashtuar këtu ata të cilët bien në kontradikta e mospajtime duke ndjekur epshin) janë rreth 30-të. Këto çështje, si dhe hadithet që kanë lidhje me to, ua kemi shpërndarë vëllezërve tanë prej “ehli sunetit”, të cilët do t'i përmendim me zinxhirë transmetimi, sikurse do të shikojnë atë që kanë thënë dijetarët lidhur me kuptimin e këtyre haditheve. Dhe nëse do të jetë e nevojshme të shikohen librat e dijetarëve të Fikhut (fukahave), Allahu i mëshiroftë, do të bëhet një gjë e tillë.

Nëse vëllezërit tanë të revistës “El bejan” do të prisnin me gjokse të hapura botimin e tyre, dhe ne e dimë mirë se atyre u intereson çështja e muslimanëve dhe janë të përmalluar për kryerjen e kësaj gjëje, atëherë me lejen e Allahut do t'u dërgohet çdo çështje më vete, për ta botuar. Pasi të përfundojnë krejtësisht,

mund të mblidhen e të botohen në një libër të vetëm. Kjo gjë bëhet për të bashkëpunuar në punë të mira e devotshmëri, për të dëshmuar interesimin që kemi për rregullimin e gjendjes së muslimanëve dhe për t'i prerë gjuhët atyre që kanë smirë “ehli sunetin” dhe duan të tallen me ta duke thënë se ata bien në kontradikta për gjëra të kota, atyre që i bëjnë thirrje njerëzve të largohen prej “ehli sunetit” dhe u mveshin atyre gjëra që s'i kanë, sikurse bëjnë bidatçinjtë dhe ata që ndjekin epshin në çdo vend e kohë.

Ibn Kutejbe (Allahu e mëshiroftë) ka treguar në librin e tij “Te’uil muhtefil hadith”, se si kanë përfunduar shumë prej talljeve dhe tallësve të “ehli sunetit” kur shprehet: “Vdiq Nadh-dhmani sikurse ebul Hudhejli e të tjerë prej armiqve të Sunetit, ndërsa suneti i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) mbeti i pastër e i bardhë. Asgjë nga talljet e tyre nuk e dëmtoi atë.”

Po ashtu do të vdesin edhe armiqtë e sotëm të Sunetit dhe do të mbesë suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem) sepse Allahu ka garantuar ruajtjen e tij:

“Ne e kemi zbritur përkujtim (Kur’anin) dhe Ne do ta mbrojmë atë.” El Hixhr: 9.

Dhe “përkujtimi” përmbledh Kur’anin dhe Sunetin, sepse që të dy janë shpallje prej Allahut të Lartësuar:

“Dhe ai nuk flet nga vetvetja, por ajo është shpallje që i shpallet.” En-Nexhm: 3-4.

Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Vërtet mua më është dhënë Kur’ani dhe bashkë me të edhe diçka si ai (Suneti).”

Ne nuk kërkojmë që “ehli suneti” bashkëkohor të mos kenë mospajtime në vërtetësinë e ndonjë hadithi ose në dobësimin e tij, apo të mos kenë mospajtime në kuptimin e argumenteve, sepse një gjë e tillë ka ndodhur edhe ndërmjet selefëve, Allahu i mëshiroftë, sikurse na tregon historia.

Kjo është këshilla ime për hir të Allahut, drejtuar vëllezërve të mi të “ehli sunetit” dhe së fundi, e lus Allahun t'i ndihmojë ata dhe t'u dhurojë sukses.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin me Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), familjen dhe shokët e tij.¹⁸⁷

) Janë disa lloje mosmarrëveshjes të cilat duhet t'i sqarojmë në mënyrë që të mësojmë se çfarë qëndrimi duhet¹⁸⁷ të mbajmë ndaj çdonjëres prej tyre:

- Mosmarrëveshje luksi.

Kjo ka të bëjë me gjëra që nuk prekin çështje besimi ose praktike, ose që nuk kundërshtojnë ndonjë argument dhe nuk kanë ndonjë fryt, si p.sh. numri i banorëve të shpellës (ashabul kehfi), vendi i tyre, pema prej së cilës hëngri Ademi etj. Nuk duhet të merremi me këtë lloj mosmarrëveshje nëse na humb kohë, sepse shfrytëzimi i kohës është më i rëndësishëm se sa preokupimi me këto gjëra. Ndërsa, nëse nuk përbën humbje kohe, nuk ka pengesë që t'i njohësh si çështje, por me kusht që të mos çojnë në grindje dhe përçarje.

- Mosmarrëveshje shumëllojshmërie.

Kjo është në rastin kur kemi disa gjëra të ligjshme, ose disa variante të ligjshme si p.sh. kiraetet e leximit të Kur'anit (mënyrat e leximit të Kur'anit). Në këtë rast muslimanit i lejohet të zgjedhë cilën të dëshirojë për të praktikuar.

- Mosmarrëveshje e konsiderueshme, ose e thënë me fjalë të tjera, mosmarrëveshja që lind si rrjedhojë e perceptimeve dhe "ixhtihadeve" të ndryshme.

Mosmarrëveshja cilësohet e tillë kur personi që e krijon atë ka tri cilësi: 1) Të ketë kapacitet dhe aftësi për të bërë "ixhtihad" (personi të ketë plotësuar kushtet). 2) Të ketë parime të sakta, d.m.th. t'i ketë të sakta parimet e fesë, të besimit dhe të deduktimit e përfitimit të rregullave e fetvave nga argumentet fetare. Nuk ka dyshim se parimet janë të vërteta vetëm kur janë në pajtim me rrugën e "ehli sunneh uel xhemaah". 3) Gjykimi (vendimi) i tij të jetë i mbështetur në baza, arsye e dëshmi të konsiderueshme, d.m.th. gjykimi që ka dhënë të jetë i bazuar në provat dhe argumentet që janë të konsiderueshme tek "ehli suneti", si në Kur'an, Sunet, ose në "ixhma". Pra, gjykimi i "muxhtehidit" nuk duhet të kundërshtojë "ixhmain", dhe as tekstin e një argumenti që dijetarët janë pajtuar lidhur me kuptimin e tij. "Ixhtihadi" i tij duhet të jetë i bazuar në parimet dhe argumentet e konsiderueshme të Fikhut. Ai nuk duhet të jetë i varur nga interesa joreale e të pakonsiderueshme në Sheriat, as nga rezultatet, as nga gjendja e tanishme dhe as nga hulumtimi i tolerimeve dhe pretendimi për heqjen e vështirësive. Faktikisht realizimi i dobive, shmangia e dëmeve, heqja e vështirësive dhe njohja e rrethanave dhe aktualitetit, janë gjëra që Sheriati i konsideron dhe kanë ndikimin e tyre në fetvatë që jep "muxhtehidi", por ato respektohen në kuadrin e kufijve dhe caqeve që i ka përcaktuar Sheriati, d.m.th. në pajtim me bazat që u përmendën më lart. Kështu që me frazën që përmenda kam për qëllim ata që abuzojnë me mbrojtjen e interesave dhe heqjen e vështirësive në kundërshtim me parimet e Sheriatit dhe argumentet e tij. Si shembull për mosmarrëveshjen e konsiderueshme është mospajtimi i sahabëve lidhur me faljen e namazit të ikindisë në beni Kurejdha, mospajtimi i dijetarëve në lidhje me leximin e sures "Fatiha" në namazet me zë etj. Kur kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje të tillë, sqarojmë mendimin e saktë, vëmë në dukje gabimin e mendimit kundërshtar, por pa i sharë dhe pa i akuzuar kundërshtarët, sepse ai tek i cili konstatohet kjo lloj mosmarrëveshje, justifikohet. Ky lloj kundërshtimi mbetet brenda kuadrin të mosmarrëveshjes së konsiderueshme, përderisa nuk shfaqet ndonjë argument i prerë që është vendimtar në çështjen konfliktuale.

Disa forma të mosmarrëveshjes së konsiderueshme:

- Çdo mosmarrëveshje që është shfaqur mes "ehli sunetit" në të kaluarën, dhe që nuk janë pajtuar në asnjë mendim. Mospajtimi në çështje të tilla është i konsiderueshëm, kështu që nuk lejohet të grindemi, të përçahemi, të ndahemi dhe të krijojmë grupacione për shkak të tyre, si p.sh. gjykimi ndaj atij që le namazin nga përtacia, krijesa e parë, të qenët e fytyrës së femrës auret etj.

- Nëse pajtohen lidhur me parimet dhe bazat e pastaj lindin mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e tyre në terren, ose kur i japin gjykim formave, çështjeve dhe shembujve që renditen nën ato baza, në këtë rast mosmarrëveshja është e konsiderueshme, kështu që nuk lejohet të akuzojnë apo të shajnë njëri-tjetrin. Këtë formë të mosmarrëveshjes së konsiderueshme po e ilustruj me dy shembuj: 1) Kur janë pajtuar lidhur me rregullat e tekfirit dhe kanë mosmarrëveshje për sa i përket një personi të caktuar se a është kafir apo jo. 2) Kur pajtohen lidhur me rregullat e bidatit dhe lindin mosmarrëveshje për sa i përket një çështjeje se a është bidat apo sunet si p.sh. namazi "tesbih", ose për sa i përket një personi të caktuar se a është bidatçi apo jo. Nuk lejohet që këto gjëra të jenë burim grindje e përçarje.

- Nëse nuk pajtohen lidhur me përfytyrimin e një çështjeje ose një aktualiteti dhe si rrjedhojë nuk pajtohen edhe në gjykimin që i japin asaj si p.sh. mospajtimi i Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe shokëve të tij lidhur me robërit e luftës së Bedrit, mosmarrëveshja lidhur me kontratat që përfundojnë me pronësi, ose mosmarrëveshja lidhur me rastet e paqes dhe të luftës në disa vende etj.

Rregullat e bashkëpunimit me xhematet e ndryshme

Pyetje - S'ka dyshim se bashkëpunimi midis thirrësve të ndryshëm është çështje e domosdoshme për suksesin e thirrjes së tyre dhe pranimin e saj nga njerëzit, por në botën islame ka shumë thirrës dhe gjithsecili ka mënyrën dhe rrugën e tij të caktuar. Mund të ndodhë që midis tyre të ketë kontradikta në çështje të rëndësishme siç është Akideja (besimi).

Cilat janë rregullat të cilave duhet t'u përmbahemi në punë dhe bashkëpunim me ta, duke pasur parasysh që të gjithë këta thirrës kanë nevojë për udhëzimet tuaja, Allahu ju dhëntë sukses!

Përgjigje - Padyshim rregulli (më i mirë) në këto kontradikta është kthimi në ato që ka udhëzuar Allahu në thënien e Tij:

“O ju besimtarë, bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit të Tij (salAllahu alejhi ve selem) dhe prijësve tuaj! Në qoftë se keni mosmarrëveshje në ndonjë çështje, kthehuni tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, në qoftë se i besoni Allahut dhe Ditës së Gjykimit. Kjo është më e mirë dhe me përfundim më të mirë.”

“Nëse bini në kontradikta për diçka, gjykimi i saj është tek Allahu.”

Pra është obligim që atij i cili del nga besimi i saktë, puna e saktë apo çdo çështje në dije e në vepër, t'i sqarohet e t'i bëhet e qartë e vërteta. Nëse kthen rrugë është begati prej Allahut për të, nëse jo, atëherë kjo për të është sprovë prej Allahut të Lartësuar. Ndërsa detyra jonë është të sqarojmë gabimin në të cilin ka rënë dhe t'i tërheqim vërejtje për këtë gabim me sa kemi mundësi e

- Nëse nuk pajtohen lidhur me shpjegimin e një ajeti ose një hadithi, pasi edhe dijetarët e mëhershëm nuk janë pajtuar.

- Mosmarrëveshja e pakonsiderueshme, për shkak të së cilës kundërshtari i “ehli sunetit” kalon në humbje. Mosmarrëveshja cilësohet e tillë kur personi që e krijon atë, nuk ka kapacitet dhe aftësi për të bërë “ixhtihad”, d.m.th nuk ka plotësuar kushtet e ixhtihadit (kur nuk i ka të sakta parimet e fesë, të besimit dhe të deduktimit e përfitimit të rregullave e fetvave nga argumente fetare, dhe kur gjykimi (vendimi) i tij nuk është i mbështetur në baza, arsye e dëshmi të konsiderueshme të “ehli sunetit”). Këtu përfshihen thëniet e bidatçinjve të cilët kanë kundërshtuar “ehli sunetin”, si p.sh. besimi se Allahu nuk do të shihet në Ahiret, se Kur'ani është i krijuar, ose thënia se renegati (ai që le fenë islame) nuk vritet, lejimi i përzirjes së meshkujve me femrat etj.

Si përfundim, dijetarët kanë bërë mjaft shpjegime lidhur me mosmarrëveshjen, por këtu u përmendën vetëm disa gjëra që mendojmë se janë të nevojshme.

duke mos u bërë pesimistë, se Allahu ka udhëzuar njerëz me bidate shumë të mëdha e i ka bërë prej “ehli sunetit”.

Dihet prej shumicës sonë se ebul Hasen el Esh’arij qëndroi në idetë e muëtezilëve dyzet vjet prej jetës së tij. Pastaj për një kohë ndryshoi disi për mirë, derisa e udhëzoi Allahu në rrugën më të drejtë, për në besimin e imam Ahmedit, i cili është besimi i “ehli sunetit dhe xhematit”.

Pra, ajo që dua të them është se çështjet e Akides janë më të rëndësishmet, prandaj edhe këshillimi i njerëzve për to është shumë i rëndësishëm.

Mosmarrëveshjet e dijetarëve, janë në çështjet “amelije” (praktike). Ndërsa në çështjet e besimit (“ilmije”-“akaidije”), nuk ka “hilafet” (kundërshtime), edhe pse mund të përmendet diçka e kësaj natyre në disa çështje si ajo e shuarjes së zjarrit, se çfarë do të peshohet në peshore në Ditën e Gjykimit e të tjera si këto. Por, mosmarrëveshjet në çështjet “ilmije” e “akaidije”, nëse krahasohen me kundërshtimet në çështjet praktike, vërehet se ato janë në një rreth shumë të ngushtë, falenderimi i takon Allahut.

Por sido që të jetë, ne duhet t’i këshillojmë ata të cilët kundërshtojnë në çështjet “ilmije” apo “amelije” dhe t’u bëjnë atyre të qartë të vërtetën.

Shejh ibnu Uthejmin.

(Kapitulli “El xhihad ued-daueh uel emru bil marufi uen-nahju anil munker”)

Sqarimet e shejh Albanit lidhur me organizimin e selefijve

Pyetje - A është detyrë që i riu selef i të ftojë për në daven e saktë brenda xhematit të selefijve, apo i lejohet të ftojë i vetmuar pa asnjë farë lidhjeje dhe bashkëpunimi me të.

Përgjigje - Zoti ynë thotë: **“Bëhuni me të vërtetët.”** Profeti ynë (salallahu alejhi ue selem) thotë: “Dora e Allahut është me grumbullin e bashkuar në të vërtetën.” Gjithashtu thotë: “Përmbaju xhematit (grumbullit të bashkuar në të vërtetën) sepse vërtet ujku nga bagëtitë, shqyen atë që shkëputet nga tufa.”

Ne nga përvoja dhe studimi i argumenteve të Sheriatit, kemi mësuar se përfundimi i këtij njeriu do të jetë vetmia në dave. Kjo duke u nisur nga fakti që Allahu i është drejtuar Musës në Kur’an duke thënë: **“Padyshim që do të ta**

forcojmë krahun me vëllain tënd.” Musa ishte i dërguar të cilin Allahu e zgjodhi për përcjelljen e mesazhit dhe i foli me fjalë, e megjithatë kishte nevojë për forcim, atëherë kush duhet të jetë qëndrimi i muslimanit? A nuk ka nevojë të forcojë krahun me anë të vëllait të tij? Nuk ka dyshim se përgjigjja është po. Prandaj i riu selefi patjetër duhet t’i bashkangjitet xhematit që është në vendin e tij, përderisa thirrja është e njëjtë, sepse kjo përbën fuqi për atë vetë dhe për xhematin, siç kuptohet prej ajetit. Ndërsa në qoftë se do të këmbëngulë për të qëndruar larg xhematit, padyshim që ujqërit do ta hanë, siç tregon hadithi, do ta bëjnë grupet e tjera për vete dhe kështu devijon nga vija e duhur, e ndjen apo nuk e ndjen një gjë të tillë. Si përfundim themi: **“Bëhuni me të vërtetët”**, ai që do të jetojë i vetmuar për të bërë thirrjen e pretenduar, padyshim që është në një dështim të qartë. (“El havi”)

Pyetje - Ju përmendët që thirrësi selefi e ka detyrë të bëjë dave nën kujdesin dhe organizimin e xhematit selefi, d.m.th. ekzistenca e tij brenda xhematit është detyrë. A keni për qëllim që ky grup të ketë një kryetar të respektuar, bazuar në hadithin që urdhëron për të vendosur një të parë në udhëtim?

Përgjigje - Kryetarin (të parin) që e përmende, nuk mendoj se ka ndonjë pengesë për ta vendosur, me kusht që të mos lidhim me të rregullat që kanë të bëjnë me prijësin më të lartë, i cili është kujdestari i shtetit islam. Kryetari dhe i pari i vendosur, duhet të jetë për rregullimin dhe organizimin e punëve dhe jo sipas asaj që tregon fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush vdes pa i dhënë besën prijësit, vdes i karakterizuar nga xhahilijeti”, e të tjera rregulla që kanë të bëjnë me prijësin e lartë (halifen). Pra, ndryshe nga ajo që ekziston tek disa grupe, qoftë edhe praktikisht, të cilët zgjedhin një të parë dhe si rrjedhojë i mveshin të gjitha rregullat dhe të drejtat që kanë të bëjnë me halifen më të lartë të muslimanëve. Nëse drejtimi që synon, është organizimi dhe sistemimi i punëve, nuk mendoj se ka diçka që e pengon, madje kjo është më e dobishmja. (“El aui”)

Mendimi i Shejh Albanit në lidhje me organizatat, shoqatat ose xhematet dhe grupet që grumbullohen për një qëllim të veçantë ose për të punuar në një sferë, fushë të caktuar

Unë nuk jam kundër ekzistencës së xhemateve (grupeve të punës), që kanë qëllime dhe synime të shumëllojshme. Nuk jam kundër që të ketë një xhemat

për shembull, që merret me rregullimin e Akides së njerëzve dhe me korigjimin e botëkuptimeve dhe ibadeteve të tyre, edhe pse nuk merren p.sh. me aktivitete sportive. E si rrjedhojë nuk e kundërshtoj idenë që një xhemat të merret në mënyrë specifike me aktivitete sportive, me qëllim që të forcojnë fizikisht muslimanët, bazuar në fjalën e njohur të Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Besimtari i fortë është më i dashur dhe më i mirë tek Allahu se sa besimtari i dobët dhe në të gjithnjë ka hajër (mirësi).”

Nuk jam kundër mendimit që të ketë sot një xhemat (grup) që punon p.sh. në çështjet ekonomike dhe një grup tjetër që punon në politikë e të tjera fusha. Por unë vendos një kusht të vetëm: që të punojnë të gjithë brenda kufijve të fesë islame, nën dritën e Kur’anit dhe të Sunetit. Kurse aprovimi i grumbullimeve dhe grupimeve në të gjitha fushat e ndryshme të cilat i përmendëm më parë, pa u bazuar në metodën e Kur’anit dhe Sunetit, do të thotë të pohosh përçarjen e Umetit dhe t’i japësh asaj ngjyrë fetare. Kjo është në kundërshtim me ajetet e qarta të Kur’anit dhe hadithet e sakta e të qarta të Sunetit.

Atëherë nuk është e lejueshme që të vendosim prijës (emirë) dhe t’u japim besën sikurse i jepet besa halifes. Por natyrisht nuk ka ndonjë pengesë që çdo xhemat të ketë organizim dhe sistem (d.m.th. rregulla që sistemojnë dhe koordinojnë punët e tyre), sepse me anë të këtij sistemimi, xhemati realizon qëllimet e tij të ligjshme. Nuk lejohet që kryetarit (ose kryesisë) të këtij organizimi t’i japim të drejtat dhe rregullat e aftësitë, të cilat janë të veçanta për halifët dhe për ata që i kanë emëruar këto halifë.

Shejh Albani në një vend tjetër ka thënë: “Unë e përkrah ngritjen e xhemeve (ka për qëllim organizatat, grupet e punës dhe komisionet që ngrihen për funksione të caktuara) dhe përkrah idenë që të specializohet çdo grup në një rol të caktuar, qoftë politik, ekonomik ose shoqëror e të tjera, por unë vendos si kusht që të jetë Islami ai që i bashkon të gjitha këto xheme.”

Dijetarët janë kundër përçarjes së Umetit dhe ndarjes së tij në grupacione

Shejh Albani, në lidhje me ndarjen e muslimanëve në parti dhe në grupe ka thënë: “Ne qartë e luftojmë ndarjen e muslimanëve në parti e grupacione, sepse për këto grupacione bën fjalë ajeti i Kur’anit:

‘Mos u bëni prej mushrikëve që e përçanë fenë e tyre dhe u bënë grupe. Çdo parti kënaqet me atë që ka.’

Në Islam nuk lejohet ndarja në parti apo grupe, sepse Allahu tekstualisht në Kur’an ka lajmëruar se ka vetëm një parti dhe një grup (e jo më shumë):

‘Në të vërtetë partia e Allahut janë fitimtarët.’ (Muxhadeleh: 12.)

Partia e Allahut janë xhemati (grumbulli) i të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Që njeriu të jetë në rrugën e sahabëve, duhet të ketë dije rreth Kur’anit dhe Sunetit.”

Gjykimi i shejh Albanit ndaj vendosjes së kryetarëve të cilët kush i kundërshton ka kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij (ose liderë e “emirë” siç mund ta emërtojnë veten, apo udhëheqës)

Pyetje - Shejh i nderuar, disa xhemate islame të cilat ftojnë në Akiden selefije, vendosin “emirë” (kryetarë, liderë, udhëheqës të përgjithshëm për zona të ndryshme nën urdhërat e “emirit” kryesor), i detyrojnë pasuesit e tyre që t’u binden atyre duke thënë se kjo kryesi është fetare dhe si e tillë është vaxhib të respektohet, dhe se kundërshtimi i saj është kundërshtim ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Ata bazohen në hadithin: “Kush e kundërshton ‘emirin’ tim (kryetarin e vendosur nga unë) ai më ka kundërshtuar mua.” Cili është mendimi juaj për këtë?

Shejh Albani - Është e qartë se ky lloj argumentimi nuk është i saktë, sepse fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush e kundërshton ‘emirin’ tim, ai më ka kundërshtuar mua”, bën fjalë për emirin që e ka vendosur vetë Profeti (ose prijesi, halifi i muslimanëve). Këtë “emir” që ka vendosur veten e tij të parin e një grupi që arrin mijëra ose miliona njerëz, kush e bëri të parë, kryetar?

Vërtet Profeti (salallahu alejhi ue selem) është i Dërguari për të gjithë njerëzit. Kur ai vendos ndonjë “emir” është detyrë që t’i bindemi atij. Është detyrë t’i bindemi halifit që vjen mbas Profetit (salallahu alejhi ue selem), ashtu

siç është detyrë që t'i bindemi të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem), sepse në aspektin e respektimit të tij, gjykimi për të është si gjykimi për të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem). Allahu thotë:

“Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe prijësve tuaj.”

Bindja ndaj të Dërguarit është detyrë sikurse është bindja ndaj Allahut. Prandaj Allahu e ka përsëritur foljen “binduni” në fjalën e tij, kur ka përmendur bindjen ndaj të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), ndërsa kur përmendi prijësit nuk e përsëriti atë por tha **“dhe prijësve”**. Arsyeja është se bindja ndaj prijësve nuk bëhet e pavarur si bindja ndaj të Dërguarit, por ajo rrjedh nga bindja e tyre ndaj të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem). Kështu që nuk është aspak e saktë të merret si argument thënia e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush i bindet ‘emirit’ tim më është bindur mua, dhe kush kundërshton ‘emirin’ tim më ka kundërshtuar mua”, për çdo grup të cilët kanë një metodë të veçantë, qoftë edhe sipas Sheriatit, që të vendosin kryetarë (duke i mveshur statusin e kryetarit të lartë të muslimanëve), sepse kjo gjë ua shton muslimanëve ndarjen, largimin nga njëri-tjetri dhe përçarjen. “Emiri” që është detyrë t'i bindemi, është ai që e ka emëruar prijësi i parë, halifi i muslimanëve. Prandaj unë gjithmonë kam thënë se hadithet që kanë ardhur nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) të pakufizuara ose të përgjithshme, duhet të komentohen sipas mënyrës që i kanë zbatuar selefët e mirë të Umetit. Nuk ka pasur tek ata përveçse një prijës të vetëm, nga i cili vareshin shumë kryetarë për administrimin e punëve të shtetit, ashtu siç e shikonte të arsyeshme prijësi. Me të drejtë po shprehem që prijësi i parë nuk ka rival, sepse Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë, siç është transmetuar në “Sahihun” e Muslimit: “Në qoftë se u jepet besa dy halifëve, vriteni atë të fundit.”

Ky tekst, në mënyrë të qartë tregon se nuk është e lejuar që të ketë dy halifë, d.m.th dy “emirë”, ku çdonjëri prej tyre të urdhërojë xhematin e tij. Kjo, ashtu siç thamë, ua shton njerëzve ndarjen dhe humbjen.

Muslimanët në të kaluarën ishin shumë të kujdesur dhe të interesuar për të pasur një “emir” i cili kishte të drejtën e emërimit të administratorëve sipas interesit të muslimanëve. Kurse kjo që ka ndodhur në këtë kohë, në realitet

është një dukuri të cilën duhet ta kemi parasysh dhe të mos mashtrohemi me të, sepse përfundimi i saj është që të bëhen muslimanët grupe dhe parti. Allahu i Lartësuar qartë në Kur'an ka thënë:

“Mos u bëni nga mushrikët të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u bën grupe (parti), çdo grup i gëzuar me atë që ka.” (Er-Rum: 31-32).

Unë nuk jam kundër ekzistencës së xhemateve (grupeve të punës), që kanë qëllime dhe synime të shumëllojshme. Nuk jam kundër që të ketë një xhemat për shembull, që merret me rregullimin e Akides së njerëzve dhe me korigjimin e botëkuptimeve dhe ibadeteve të tyre, edhe pse nuk merren p.sh. me aktivitete sportive. E si rrjedhojë nuk e kundërshtoj idenë që një xhemat të merret në mënyrë specifike me aktivitete sportive, me qëllim që të forcojnë fizikisht muslimanët, bazuar në fjalën e njohur të Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Besimtari i fortë është më i dashur dhe më i mirë tek Allahu se sa besimtari i dobët dhe në të gjithnjë ka hajër (mirësi).”

Nuk jam kundër mendimit që të ketë sot një xhemat (grup) që punon p.sh. në çështjet ekonomike dhe një grup tjetër që punon në politikë e të tjera fusha. Por unë vendos një kusht të vetëm: që të punojnë të gjithë brenda kufijve të fesë islame nën dritën e Kur'anit dhe të Sunetit. Kurse aprovimi i grumbullimeve dhe grupimeve në të gjitha fushat e ndryshme të cilat i përmendëm më parë, pa u bazuar në metodën e Kur'anit dhe Sunetit, do të thotë të pohosh përçarjen e Umetit dhe t'i japësh asaj ngjyrë fetare. Kjo është në kundërshtim me ajetet e qarta të Kur'anit dhe hadithet e sakta e të qarta të Sunetit.

Atëherë nuk është e lejueshme që të vendosim prijës (emirë) dhe t'u japim besën sikurse i jepet besa halifes. Por natyrisht nuk ka ndonjë pengesë që çdo xhemat të ketë organizim dhe sistem (d.m.th. rregulla që sistemojnë dhe koordinojnë punët e tyre), sepse me anë të këtij sistemimi, xhemati realizon qëllimet e tij të ligjshme. Nuk lejohet që kryetarit (ose kryesisë) të këtij organizimi t'i japim të drejtat dhe rregullat e aftësitë, të cilat janë të veçanta për halifët dhe për ata që i kanë emëruar këto halifë.

Si rrjedhojë e marrjes për argument të këtij hadithi disa prej tyre zbatojnë në të drejtën e “emirëve” të tyre, thënien e Profetit (salallahu alejhi ue selem):

“Kush vdes dhe nuk ka në qafën e tij ‘bejatun’ (besë të dhënë prijësit, d.m.th. nuk i ka dhënë besën për ta njohur si imam të muslimanëve dhe për ta respektuar, ose pasi ia ka dhënë atë, heq dorë nga ajo dhe del kundër tij), ai vdes në vepër ose karakter xhahilijeti, injorance.” Prandaj zgjedhin një “emir” dhe i japin besën.

“Emiri” të cilit është detyrë t’i jepet besa nuk është ky, por muslimanët duhet që të punojnë me të gjitha fuqitë dhe dijen që u është dhënë për të formuar shoqërinë islame, mbi të cilën do të jetë kryetar një burrë i vetëm. Ky është halifja të cilit kanë për detyrë të gjithë muslimanët t’i japin besën. Kurse të vendosë grupi një “emir” dhe t’ua bëjë detyrë individëve që t’i japin besën, dhe në qoftë se nuk e bëjnë këtë (“bejan”) vdesin në vepër injorance, ky është keqinterpretim i fjalëve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Kjo është prej gabimeve në të cilat muslimanit nuk i lejohet të bjerë.

Mendimi i shejh Albanit në lidhje me përcarjen aktuale të muslimanëve dhe thirrjen e disave që të bashkohemi dhe t’i lëmë përcarjet që kemi mes njëri-tjetrit

Pyetje - Muslimanët sot janë të përcarë në parti dhe grupe, kur Allahu na e ka ndaluar që të përcahemi dhe të kemi mosmarrëveshje. Muslimanët sot janë “selefij”, “esharij”, “sufij”, “maturidi” etj. A nuk mund ta anashkalojmë tematikën e “el uela uel bera” (miqësisë e dashurisë dhe armiqësisë e urrejtjes) me qëllim që të bashkohen muslimanët për luftimin e armiqve të Allahut dhe të Dërguarit të tij (salallahu alejhi ue selem)?

Përgjigje - Kjo është një pyetje e çuditshme. Ajo tregon se shumë prej muslimanëve, në qoftë se nuk do të themi shumica e tyre, nuk dinë akoma si munden që të luftojnë armiqtë e Allahut. Ata janë siç i përshkruan vetë pyetësi, të përcarë në grupe dhe në parti të shumta. Si mendon ky pyetës, të lëmë kërkimin dhe studimin në temën që ka të bëjë me besimin në Allahun, ndërkohë që kjo është tema e parë e besimit me të cilin u urdhërua Profeti (salallahu alejhi ue selem) në fjalën e Allahut: **“Zotin tënd madhëroje!”** (El Mudethir: 3) dhe: **“Dije se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut.”** (Muhamed: 19)!?

Në qoftë se muslimanët janë në kundërshtim në lidhje me kuptimin e kësaj fjale të mirë, si mund të jenë një dorë e vetme për t'u përballur me armiqtë e Allahut dhe për t'i luftuar ata!? Me sa duket, ky pyetës dhe të tjerë si puna e tij, duan prej nesh të mos zbatojmë Sheriatin e Allahut, duke menduar se me moszbatimin e tij mundemi t'i luftojmë armiqtë! Kjo është sipas mendimit të ebi Nevasit i cili tha: “Ma mjeko sëmundjen me sëmundje!”

Zoti ynë ka thënë:

“Në qoftë se keni mosmarrëveshje në ndonjë çështje, kthehuni tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, në qoftë se i besoni Allahut dhe Ditës së Gjykimit. Kjo është më e mirë dhe me përfundim më të mirë.”

Gjithashtu ka thënë në ajetin që e kemi përmendur disa herë më parë:

“Kush e kundërshton të Dërguarin, pasi i është sqaruar udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër, jo rrugën e besimtarëve, Ne do ta mbajmë në atë rrugë që ai ka marrë, do ta fusim në xhehenem dhe sa përfundim i keq është ai.”

Si është i kënaqur ky pyetës dhe të tjerë si puna e tij që të lenë pas dore gjithë këto ajete të qarta!? Vallë si mund të përfytyrohet mundësia e bashkimit të muslimanëve me gjithë mosmarrëveshjen e madhe që gjendet ndërmjet tyre!?

Nuk është, sikurse thonë, vetëm në çështjet e Fikhut, por kundërshtim gjendet edhe në parime (çështjet e Akides) dhe jo vetëm në parime, por edhe në parimin e parimeve, i cili është besimi në Allahun, Krijuesin e botëve.

Më vjen shumë keq t'ia kujtoj këtij pyetësi dhe të tjerëve si ai, faktin që ne fluturonim nga gëzimi kur na arrinin lajmet e fitores së vëllezërve tanë muslimanë afganë kundër komunistëve rusë dhe bishtave të tyre. Pastaj aq sa u gëzuam, u hidhëruam kur ata qëndruan vetëm para dy qyteteve nga i tërë Afganistani. Shkaku i këtij mospërparimi ishte se udhëheqësit dhe krerët e tyre u grindën mes njëri-tjetrit. Zoti ynë thotë:

“Mos u grindni (mos u përçani) ndërmjet jush që të humbni, të dështoni dhe të shkojë fuqia juaj.” (El Enfalë: 46)

Ky pyetës nuk është duke u përqëndruar në hadithin e përçarjes së Umetit në 73 grupe prej të cilëve vetëm një grup është i shpëtuar. Ai është grupi që ecën

në rrugën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe të shokëve të tij, i cili e kupton dhe e zbaton Kur'anin dhe Sunetin si Profeti (salallahu alejhi ue selem) dhe shokët e tij.

Kur muslimanët t'i bashkohen këtij menhexhi që bazohet në Kur'an dhe Sunet, ashtu siç e kanë kuptuar dhe praktikuar të parët tanë, sahabët e Profetit (salallahu alejhi ue selem), atëherë ata mund të përballen me armiqtë e Allahut dhe t'i luftojnë. Kurse që ta lëmë të vjetrën në vjetërsinë e saj, siç thonë, dhe të përpiqemi për t'u bashkuar në mënyrë që të luftojmë armikun, kjo është diçka e pamundur. Ajeti i lartpërmendur, lufta e Hunejnit e të tjera raste, janë nga shembujt më të mëdhenj që tregojnë për domosdoshmërinë e bashkimit të fjalës së muslimanëve. Nuk ka dyshim se ky bashkim mund të realizohet vetëm në qoftë se themelohet mbi Kur'an dhe Sunet. Ajeti i kaluar është tregues i mjaftueshëm për këtë çështje insha-Allah.

“O ju që keni besuar, bindjuni Allahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit tuaj. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë kthejeni atë tek Allahu dhe tek i Dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së fundit. Kjo do të bëjë që shpërblimin dhe përfundimin ta keni më të mirë.”
(En-Nisa: 59)

Atëherë le të shtrëngohemi pas Librit të Allahut, Sunetit dhe menhexhit të selefëve, në qoftë se duam që të bashkohemi me të vërtetë.

(Marrë nga “El menhexhu es-selefi inde shejh el Albani”.)

Gjykimi i shejh Uthejmit për gjurmimin e të metave të dijetarëve, lëndimin e tyre, si dhe të folurën mbi ta

Pyetje - Çfarë mendimi keni ju shejh për disa të rinj, veçanërisht për disa nxënës dije, puna e të cilëve është bërë të folurit mbi njëri-tjetrin, largimi i njerëzve nga njëri-tjetri dhe paralajmërimi që njerëzit të ruhen prej njërit apo tjetrit? A është e lejuar kjo punë, dhe a merret shpërblim apo dënim për këtë?

Përgjigje - Ajo që mendoj unë është se kjo punë është haram (e ndaluar). Nëse nuk i lejohej ta përflasë e ta përgjojë muslimanin, si mund të lejohet të përflasë e të përgjojë të diturit prej tyre!? Është obligim për njeriun besimtar të mbajë gjuhën nga përgojimi i vëllezërve besimtarë:

“O ju besimtarë, largojuni (ruhuni) shumë prej paragjykimeve, se disa prej tyre janë gjynah, mos spiunoni e mos përgojoni njëri-tjetrin, a dëshiron dikush prej jush të hajë mishin e vëllait të tij të vdekur? Ju e urreni këtë gjë, pra frikësojuni Allahut...”

Dhe ta dijë ai që është sprovuar me të folurit mbi dijetarët, se kjo gjë do të bëhet shkas që ai të mos pranojë të vërtetën që thonë dijetarët e përfolur prej tij. Kështu që më e pakta në këtë rast, është të marrë gjynahun e refuzimit të së vërtetës, e për më tepër se kaq, është se ai nuk ka përfolur e përgojuar një njeri të thjeshtë, por trashëgimtarin e Profetit (salallahu alejhi ue selem).

Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve, nëse do të vlerësoheshin qëndrimet e dijetarëve gabim e të përfliteshin, njerëzit nuk do të besonin më në dijen e tyre, edhe pse është e trashëguar nga Profeti (salallahu alejhi ue selem). Dhe si rrjedhojë do të fillojë mosbesimi në gjërat e Sheriatit që i thonë dijetarët. Nuk po them që dijetarët nuk gabojnë, sepse çdo njeri gabon, por nëse shikon ndonjë gabim të dijetari sipas mendimit tënd, bisedo me të dhe sqarohu. Nëse të del në pah se e vërteta është me të, e ke obligim ta ndjekësh mendimin e tij. Nëse të rezulton e kundërta, por ai ka argument dhe arsyetim fetar, të del obligim të mbash gjuhën. Nëse nuk ka argument ose arsyetim, ki kujdes prej thënies së tij, sepse pranimi i gabimit nuk lejohet. Por mos e përfol përderisa ai është shquar si dijetar i çiltër e i sinqertë.

Nëse do të fillonim të përfllisnim dijetarët e njohur për sinqeritet, për shkak të gabimeve që kanë bërë në çështjet e jurisprudencës islame, kjo do të na çonte që të përfllisnim edhe dijetarët e mëdhenj, prandaj kundrejt gabimeve të dijetarëve është detyrë të mbajmë qëndrimin që e përmendëm më lart.

Kur sheh te dijetari një gabim, atëherë diskuto me të, sepse në këtë rast ose do të dalë në pah që e vërteta është me të dhe do ta pasosh, ose që është me ty dhe do të të pasojë. Nëse asnjëra palë nuk qartësohet dhe mbetet

mosmarrëveshja lidhur me çështjen në diskutim, atëherë çdonjëri le të mbajë mendimin e tij, por ti duhet të ruash gjuhën ndaj dijetarit.

Falenderimi i takon Allahut sepse “hilafi” (mospajtimi) nuk ka ndodhur vetëm në këtë kohë, ai ka qenë që në kohën e sahabëve dhe vazhdon deri në ditët e sotme. Por, nëse atij (kundërshtarit në mendim) i bëhet e qartë e vërteta dhe vazhdon të këmbëngulë në gabimin e tij për të shfaqur veten triumfues (pa të drejtë), në këtë rast duhet ta sqarosh këtë gabim në mënyrë që të tjerët të mos bien në të.

Nuk lejohet të nisësh debatin i motivuar nga qëllimi për të nënvlerësuar kundërshtarin dhe për t’u hakmarrë ndaj tij, sepse nëse këtë çështje ai e ka gabim, mund të ketë të drejtë në çështje të tjera.

E rëndësishme është që unë i tërheq vërejtjen vëllezërve të mi, të largohen nga kjo bela (fatkeqësi) dhe nga kjo sëmundje,¹⁸⁸ sikundër e lus Allahun të na shërojë nga çdo gjë që dëmton fenë tonë dhe jetën tonë në dynja.

Shejh ibn Uthejmin

(Marrë nga kapitulli “El xhihad ued-daueh el emru bil marufi uen-nahju anil munker”, fq. 277-278)

) D.m.th. përfolja e dijetarëve dhe e thirrësve, sikurse kuptohet nga vetë pyetja dhe përgjigjja e shejhut¹⁸⁸

Provokimi i njerëzve¹⁸⁹

Shejhul islam ibn Tejmije ka thënë: “Nuk lejohet provokimi i njerëzve me emra të cilat nuk gjenden në Kur’an dhe as në Sunet. Me të vërtetë kjo gjë është në kundërshtim me atë çka ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe është shkak për krijimin e fitneve dhe përçarjeve mes Umetit. Robi më i nderuar tek Allahu është më i devotshmi i tyre, prej çdo grupi qoftë ai. Tekste të shumta nga Kur’ani dhe Suneti kanë ardhur të nxisin Umetin për bashkim dhe të tërheqin vërejtjen prej përçarjes. E megjithëkëtë, si i lejohet Umetit të Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) që të përçahet, sa që personi miqëson një grup dhe armiqëson një tjetër, me paramendime dhe teka, pa pasur argument prej Allahut!? Allahu e ka shfajësuar Profetin e Tij (salallahu alejhi ue selem) prej atyre që janë në këtë gjendje. Këtë gjë e kanë praktikuar bidatçinjtë, si shembulli i hauarixhëve, të cilët përçanë xhematin e muslimanëve dhe e bënë të lejuar gjakun e tyre. E keqja më e vogël që ndodhet në këtë gjë, është se personi vlerëson dikë për shkakun se i shkon pas epsheve e tekave të tij, edhe pse dikush tjetër është më i devotshëm se ai. Ndërkohë që obligimi është t’i jepet përparësi atij që i ka dhënë përparësi Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem).

Përçarja e Umetit, qoftë e krijuar prej dijetarëve, udhëheqësve, apo njerëzve me pozitë, është shkak që ka bërë të sundojnë armiqtë mbi ne, dhe kjo ngaqë Umeti e ka lënë respektimin e urdhrave të Allahut dhe respektimin e urdhërave të të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Armiqësia dhe përçarja në mesin e muslimanëve ndodh kur njerëzit lenë disa urdhëra të Allahut dhe të Dërguarit të tij (salallahu alejhi ue selem). Nëse një popull përçahet, atëherë

¹⁸⁹) Ky material është përkthyer nga libri “Tarikul usul ila el ilmil me’mul bi marifetil kauaidi ued-davebiti uel usul”, të cilin e ka mbledhur dijetari i madh i këtij shekulli, Abdurrahman ibn Nasir es-Sadi (rahimehullah). Ka mbledhur në të rregulla dhe baza në fusha të ndryshme të dijes dhe jetës, të shkëputura këto të gjitha, prej librave të shejhul islam ibn Tejmije dhe nxënësit të tij ibnul Kajim (rahimehumullah). Ky rregull ndodhet në librin e lartpërmendur me nr. 628 në fq. 195 dhe është shkëputur nga fjala e shejhul islam ibn Tejmije (rahimehullah). (Shën. i përkthyesit)

dobësohet dhe shkatërrohet, kurse nëse bashkohet dhe rregullohet, atëherë sundon. Me të vërtetë bashkimi është mëshirë dhe përçarja është dënim.”

Gjithashtu ka thënë: “Dënimi i të padrejtëve dhe nderimi i të devotshmëve, është prej shkaqeve më madhore që kënaqin Allahun dhe të Dërguarin e Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe që rregullojnë punët e muslimanëve.

Pozita apo vendi që zenë dijetarët në Islam

Dijetarët zënë vendin më të rëndësishëm në Islam sepse ata janë trashëgimtarët e profetëve. Ata janë të obliguar më shumë se kushdo tjetër për të sqaruar dijen që kanë marrë dhe për të bërë thirrje (dave) për tek Allahu i Madhëruar. Për njerëzit në tokë, dijetarët janë si yjet në qiell, u tregojnë rrugën e drejtë njerëzve të humbur dhe të pavëmendshëm, u qartësojnë atyre të vërtetën dhe u tërheqin vërejtje të bëjnë kujdes nga gjërat e këqija (sherri). Ata janë si shiu që bie mbi tokën e shkretë, e ajo me urdhërin e Allahut fillon të mbijë e të çelë.

Dijetarët, më shumë se çdokush tjetër, janë të obliguar të vënë në zbatim ato që dinë dhe të pajisen me moralin dhe edukatën e lartë, sepse ata janë shembuj që ndiqen nga njerëzit dhe duhet të jenë të saktë në praktikimin e moralit dhe virtyteve të larta të Sheriatit.

(Nga fetvatë e ibn Uthejminut që mbajnë firmën e tij)

Forma e kritikës ndërmjet thirrësve (Nga dijetari i madh ibn Baz, Allahu e mëshiroftë)

Falenderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Profetin (salallahu alejhi ue selem), mbi familjen, shokët e tij dhe mbi ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Me të vërtetë Allahu urdhëron drejtësi e bamirësi dhe ndalon padrejtësinë (dhulmin), shtypjen dhe mizorinë. Ai e ka dërguar Muhamedin (salallahu alejhi ue selem) me të njëjtin mesazh që dërgoi dhe profetët e tjerë, të ftojë në Njëshmërinë (Teuhidin) dhe sinqeritetin në adhurimin e Zotit të vetëm.

Allahu e urdhëroi Profetin (salallahu alejhi ue selem) të mbajë drejtësi, e ndaloi nga padrejtësia e të adhuruarit dikë tjetër përveç Allahut, e ndaloi nga ndarja, si dhe t'u bëjë padrejtësi njerëzve.

Në kohën tonë është përhapur së tepërmi prej disave që paraqiten si njerëz të dijes dhe daves, marrja nëpër këmbë e nderit të vëllezërve të tyre prej nxënësve të dijes dhe thirrësve të njohur. I përflasin vëllezërit e tyre dhe e bëjnë këtë fshehurazi në takimet e tyre, ndoshta i regjistrojnë në kaseta dhe ua shpërndajnë njerëve. Ka raste që këto gjëra i thonë hapur gjatë ligjëratave që mbajnë nëpër xhami të ndryshme.

Kjo rrugë e ndjekur prej tyre është në kundërshtim të plotë me atë çfarë ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem), dhe kjo e parë në shumë këndvështrime:

- Kjo është shkelje e të drejtave të besimtarëve, madje e besimtarëve më të rëndësishëm, nxënësve të dijes dhe thirrësve të cilët vunë në përdorim dhe shpenzuan çka mundën për informimin e njerëzve, udhërrëfimin e tyre, korrigjimin e ideologjive dhe metodologjive (menahixh) të tyre, e gjithashtu u munduan për mbajtjen e mësimëve, ligjëratave dhe botimin e librave të dobishëm.

- Kjo sjell shturjen e bashkimit dhe unitetit të muslimanëve dhe përçarje në radhët e tyre, në një kohë kur besimtarët kanë nevojë emergjente të jenë të bashkuar, larg nga përçarjet, nga shpifjet dhe thashethemet midis tyre, aq më tepër që këta vëllezër që u është bërë kjo padrejtësi, janë prej “ehli sunetit” dhe xhematit, të njohur për luftën e tyre të hapur kundër bidatit dhe legjendave boshe, për qëndresën e tyre përballë atyre që i veprojnë dhe i thërrasin njerëzit për te këto bidate dhe të njohur për demaskimin e planeve të bidatçinjve.

Prej gjithë kësaj katrahure, dalin të fituar vetëm armiqtë e pashmangshëm jobesimtarë, munafikë dhe bidatçinj të humbur.

- Kjo punë shërben si mbështetje dhe ndihmesë për ata që e kanë vënë Islamin në shënjestër siç janë laikët, properëndimorët apo edhe ateistët, që tashmë e kanë bërë modë të marrin nëpër këmbë nderin e thirrësve, të shpifin për ta dhe të nxisin njerëzit kundër tyre.

Nuk është shenjë e vëllazërisë islame, që këta vëllezër të nxituar të ndihmojnë armikun e të gjithëve, kundër vëllezërve të tyre që janë nxënës të dijes dhe thirrës.

- Kjo bëhet shkak për prishjen e zemrave të njerëzve të thjeshtë dhe të atyre me peshë, bëhet shkak për përhapjen dhe reklamimin e shpifjeve dhe supozimeve të kota, bëhet shkak për përhapjen e gibetit dhe thashethemeve. Gjithashtu, kjo punë u hap derën atyre personave të dobët dhe të ulët, interesi i të cilëve është futja e dyshimeve dhe ndezja e fitneve, që padrejtësisht t'i mundojnë besimtarët e ndershëm.

- Shumë prej atyre që thuhet nuk janë të vërteta, por janë supozime dhe dyshime të cilat shejtani i ka zbukuruar në mendjet e këtyre njerëzve (intrigantëve) dhe i ka mashtruar me to. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an:

“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime! Me të vërtetë mjaft nga dyshimet përbëjnë gjynahe. Edhe mos përgjoni e as mos përgojoni njëri-tjetrin...” El Huxhuratë: 12.

Besimtari duhet t'u gjejë fjalëve të vëllait të tij kuptimin më të mirë, ashtu siç kanë thënë disa prej selefëve: “Mos mendo keq për fjalën e nxjerrë nga vëllai yt, kur ke mundësi t'i japësh asaj një shpjegim të mirë.”

- Për mendimet që i kanë dhënë në kuadër të “ixhtihadit” disa dijetarë apo nxënës dije, në gjëra për të cilat dera e “ixhtihadit” është e hapur, nuk fajësohen dhe as nuk qortohen, n.q.s. kanë qenë ekspertë në çështjet e “ixhtihadit”. Nëse dikush tjetër e konteston atë çka “muxhtehidi” ka menduar, do të ishte më e mira që kontestuesi të dialogonte me të në mënyrën më të mirë e me kujdesin maksimal për të arritur të vërtetën, duke ndjekur rrugën më të shkurtër dhe për t'i bërë ballë vesveseve të shejtanit, depërtimit të poshtërsive dhe shkatërrimit të tij ndërmjet besimtarëve.

Nëse kjo nuk arrihet dhe dikush e sheh të domosdoshme sqarimin e mendimit të kundërt, le ta bëjë atë duke përdorur shprehjet më të mira dhe duke demonstruar lëvizjet më të mirësjella dhe më të përmbajtura, pa akuza, ofendime dhe pa trillime të cilat do ta detyronin palën tjetër ta kundërshtojë të vërtetën dhe t'i kthejë shpinën asaj. Le ta bëjë këtë pa përmendur emra individësh, pa paragjykuar njetet dhe pa i shtuar fjalët. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) kur vihej përballë çështjeve të tilla thoshte: “Si e kanë hallin ata njerëz që kanë thënë kështu e kështu...?”

I këshilloj ata vëllezër që kanë marrë nëpër këmbë nderin e thirrësve, të pendohen tek Allahu për ato gjëra që i kanë shkruar me duart e tyre apo i kanë folur me gjuhët e tyre, e të cilat janë bërë sebeb për shkatërrimin apo rrënimin e zemrave të shumë djelmohave. Këto gjëra i kanë mbushur zemrat e tyre me urrejtje dhe inat. Këto gjëra i kanë lënë prapa në kërkimin e dijes, gjithashtu duke u marrë me shpifje dhe thashetheme kanë mbetur prapa edhe në dave, dhe e gjithë puna e tyre tani është insistimi në gjuetinë dhe kërkimin e gabimeve të tjerëve.

Gjithashtu, i këshilloj që të shlyejnë atë ç’kanë punuar, duke e pranuar gabimin publikisht për çfarë kanë thënë në të kaluarën. Kështu do të heqin dyshimet që kanë pushtuar mendjet e ndjekësve të tyre. Duhet të veprojnë punë të frytshme të cilat të afrojnë më shumë tek Allahu dhe janë të dobishme për krijesat. Duhet të mos nxitohen në akuzimin e njerëzve si kafirë, të poshtër (fasikë) apo bidatçinj, pa pasur një argument të qartë dhe të pranuar. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush i thotë vëllait të tij ‘kafir’, atëherë kjo fjalë i përket njërit prej këtyre të dyve.” D.m.th., në qoftë se ti i thua një muslimani “kafir” dhe më pas rezulton se ai nuk është i tillë, atëherë ky cilësim të takon ty. Transmeton Buhariu (6104) dhe Muslimi (60).

Do të ishte më mirë për thirrësit dhe nxënësit e dijes, që kur të mos jenë të qartë rreth një çështjeje apo fetvaje të dijetarëve, të ktheheshin për t’u sqaruar tek dijetarët e mirëfilltë, të cilët do t’ua sqaronin thelbin e çështjes, të vërtetën rreth saj dhe do të largonin kundërshtimet dhe dyshimet nga gjokset e tyre. Kjo është mënyra që ka përmendur Allahu në Kur’an:

“Kur atyre u vjen rëndë ndonjë çështje që prek sigurinë e njerëzve apo frikë, ata e përhapin atë (ndër njerëz). Sikur t’ia kishin paraqitur atë (për shqyrtim) të Dërguarit apo njerëzve të tjerë drejtues të tyre, shqyrtuesit përkatës do ta kishin kuptuar atë prej tyre (menjëherë). Po të mos kishte qenë Mirësia dhe Mëshira e Allahut mbi ju, ju do të kishit ndjekur shejtanin, përveç një pakice prej jush.” Nisa: 83.

Lus Allahun e Madhëruar që të rregullojë gjendjet e gjithë muslimanëve, t’i bashkojë zemrat dhe punët e tyre me devotshmëri, të mbështesë dhe t’u japë sukses të gjithë dijetarëve të muslimanëve dhe të gjithë thirrësve për çdo gjë që e kënaq Allahun dhe u sjell dobi krijesave. Lus Allahun që fjalën e tyre ta bashkojë në udhëzim (huda), t’i ruajë ata nga ato gjëra që u sjellin ndarje dhe divergjenca.

Lus Allahun që me këta njerëz të devotshëm të ndihmojë hakun dhe të poshtërojë të kotën (el-batil). Ai është i Zoti i kësaj pune dhe i Vetmi që ka fuqinë për ta realizuar.

Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Profetin e Tij, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), familjen e tij, shokët e tij, dhe mbi ata që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

(Fetva e shejh ibn Baz, marrë nga libri me titull “Mexhmu fetava ve mekalat muteneviah”, 7/311-314)

Drejtuar atyre që u bëhet qejfi kur tjetri gabon apo bie në bidat, me qëllim që të justifikojnë ngatërresat që ngjallin mes muslimanëve

(Marrë nga kasetat e mësimëve të shejh Abdul-Muhsin el Abad el Bedr, në xhaminë e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) nën pyetjen “Men jefrahu bi vukuil akhjari fil bida”)

Pyetje - Shejh i nderuar, cili është gjykimi për atë person që gëzohet kur vëllai i tij i Sunetit bën ndonjë gabim ose bie në bidat?

Përgjigje - Përderisa vetë nuk e pëlqen që ndonjë tjetër të gëzohet me të nëse do të binte në ndonjë gabim, po kështu të mos gëzohet për tjetrin, t'i vijë keq, të dëshirojë për vëllain që të mos e ketë gabim, e nëse do të ketë rënë në të, le të dëshirojë të dalë prej saj me selamet. Ky është qëndrimi obligativ që duhet mbajtur. Njeriu nuk duhet të gëzohet për gabimin që bën vëllai i tij, por duhet të mërzhitet dhe duhet të kënaqet kur ai kthehet nga gjynahu tek e drejta.

Drejtuar atyre që në emër të “xherh ue ta’dil” (analizës së gabimeve) po bëjnë hallall gibetin (përgojimin) dhe përçarjen

(Marrë nga kasetat e mësimave të shejh Abdul-Muhsin el Abad el Bedr, në xhaminë e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), nën pyetjen “El meukif min dhahireti xherhi ve ta’dil fi hadha zeman”)

Pyetje - Shejh i nderuar, jetojmë në një kohë që janë pakësuar ndihmuesit e Sunetit, që janë shtuar shumë bidatet dhe që është futur shirku (politeizmi) në disa vende islame. Dhe në vend që të bashkohen përpjekjet dhe mundi i “ehli sunetit”, janë përhapur ca ngatërresa të cilat i përçanë rreshtat e i dobësuan thirrësit e rrugës së drejtë. E gjithë kjo, ndodh nën pretekstin se një punë e tillë është prej “xherh ue ta’dil”, saqë po akuzohen për të këqinj e të papranueshëm, disa prej dijetarëve të Sunetit. Si rrjedhojë e kësaj katrahure të shkaktuar, njerëzit nuk po bëjnë dot dallimin ndërmjet “gibetit” dhe “xherhit” të lejuar. Kërkojmë të përfitojmë prej jush, duke na sugjeruar disa rregulla bazë të Sheriatit.

Përgjigje - Është vaxhib për gjithsecilin të ruajë gjuhën e tij e ta falënderojë Allahun për këtë mirësi e begati. Kam për qëllim begatinë e të folurit dhe të shprehurit, prej së cilës janë privuar disa njerëz (memecët). Kështu që le të bëjë ato gjëra që i kthehen në dobi personit në fjalë, folësit, e të ruhet nga përdorimi i fjalës në ato gjëra që e dëmtojnë. Ajo që i del për detyrë “ehli sunetit” është të ndihmojnë njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë ndërmjet njëri-tjetrit, të vënë në dijeni njëri-tjetrin kur gabojnë për të ndrequr gabimin, por e gjithë kjo me butësi, me vigjilencën më të madhe për ta udhëzuar, për ta shpëtuar tjetrin, e të jetë kështu “ehli suneti” një dorë e vetme kundër atyre që kundërshtojnë e që dëmtojnë Sunetin. Ndërsa angazhimi i “ehli sunetit” për të kundërshtuar e për t’u

konfrontuar me njëri-tjetrit, pa dyshim është prej fitneve (ngatërresave) që po ngjallin disa prej njerëzve sot. E lusim Allahun, për të gjithë ata, që t’i udhëzojë e t’u japë sukses në të drejtë.

Si përmbledhje e gjithë kësaj, themi se është obligim i domosdoshëm sot për muslimanin, të përpiket sa më shumë në kërkimin e dijes e të mos angazhohet me “filani ka thënë” e “filani ka bërë”, apo duke u marrë me atë se “filani i ka bërë tjetrit ‘xherh’” (ngriti akuzë për të) e “filani jo”. Ndërsa ai që ngre akuza kundër disa dijetarëve, kundër atyre që janë të angazhuar në kërkimin e dijes, apo kundër disa të tjerëve, punën e të cilëve Allahu e ka bërë të dobishme, në radhë të parë dëmton veten e tij, pastaj ata të “ehli sunetit” që i ka akuzuar. Pra, ai që flet keq për ata që ndihmojnë Sunetin, për ata që bëjnë dave për hir të Allahut të Lartmadhëruar, apo për ata që kanë shkrime të mira në Akide, në rradhë të parë, dëmton veten e tij.

Ajo që del për detyrë së pari, është që nxënësit e dijes të kthehen tek dijetarët për njohjen e njerëzve. Le të kenë si pikë referimi p.sh. Komisionin e Përhershëm të Hulumtimeve dhe Fetvave. Persona të tillë duhet të pyeten për njerëzit, nëse akuzohen. Jo çdokujt që akuzon dikë, duhet t’i merret për bazë fjala e të ngrihemi kundër atij që akuzohet. Është detyrë që për të tilla çështje të pyetet myftiu ose anëtarët e tjerë të Komisionit. Akuzat e ndërsjellta që janë shfaqur kohët e fundit, janë padyshim fitne (ngatërresa) me të cilat janë angazhuar pjestarët e “ehli sunetit” me njëri-tjetrit dhe me ata që nuk janë “ehli sunet”, duke dëmtuar kështu vetveten. Është obligim për “ehli sunetin” të sillen me butësi mes njëri-tjetrit e të jenë të gjithë të bashkuar në rrugën e drejtë.

Metoda e krahasimit ndërmjet të mirave dhe të këqijave (muvazenati) (Nga fetvatë e ibn Uthejminit)

Është pyetur shejh Uthejmini - Disa të rinj thonë se prej drejtësisë, paanësisë dhe pastërtisë, është që kur njeriu të përmendë dikë që ka ndonjë bidat, të mos përmendë vetëm bidatin e tij, por bashkë me të, të përmendë edhe të mirat që ky person ka. Pra, a është prej “menhexhit të selefëve”, që nëse përmendim ndonjë bidatçi, shiit, kaderij, muëtezilij ose kundërshtues të thirrjes së “ehli

sunetit”, të themi: “Por ai i kushton rëndësi faljes së namazit, është adhurues i madh, është zahid (asket), sillet mjaft mirë me komshiun” etj.?

Shejhu u përgjigj - Vërtet kjo është pyetje e çuditshme. Nëse njeriu flet për dikë duke pasur për qëllim vlerësimin e tij, në këtë rast duhet t’i përmendë të mirat dhe të këqijat, e më pas të gjykojë sipas asaj që rezulton nga krahasimi i tyre. Nëse dominojnë të mirat e lavdëron, dhe nëse dominojnë të këqijat e përmend për keq. Ndërsa kur ka për qëllim t’i kundërpërgjigjet bidatit të tij dhe ta hedhë poshtë, në këtë rast nuk ka arsye për të përmendur të mirat e tij, sepse përmendja e të mirave të tij në momentin që i kundërpërgjigjesh, nënkupton se kundërpërgjigjja është e dobët ose e papranuar. Prandaj çështja ka nevojë për sqarim. Nëse dua të vlerësoj një person kur përmend jetën e tij ose kur flas për biografinë e tij, patjetër duhet të përmend të mirat dhe të këqijat, pastaj të gjykoj për të sipas asaj që rezulton nga raporti i tyre. Por nëse dua t’i kundërpërgjigjem bidatit të tij, nuk ka pse të përmend të mirat e tij, madje përmendja e të mirave të tij në këtë rast e dobëson kundërpërgjigjen dhe e bën lexuesin ose dëgjuesin të dyshojë në vërtetësinë e saj. Prandaj sipas vendit bëhet edhe kuvendi.

Pyetësi - Megjithëse ju, shejh i nderuar, u çuditët prej pyetjes, në lidhje me të janë shkruar libra të tërë. Rreth çështjes së krahasimit ndërmjet të mirave dhe të këqijave, dhe “menhexhit të ehli sunetit” në kritikën ndaj xhemateve (të ndryshme) ose sekteve, janë përpiluar disa libra. Ka autorë që kanë përpiluar libra, për të sqaruar se patjetër duhet të përmenden të mirat dhe të këqijat. Këtë e bazojnë në thënien e Allahut: **“Ndër ithtarë të librit, ka të tillë që nëse i besohet një sasi e madhe pasurie (ari), do ta shlyejë atë shumë shpejt dhe ta mban besën, por ndër ta ka edhe të tillë që nëse i besohet një dinar (vlerë fare e vogël), nuk ta kthen atë, po të mos ia kërkosh pa iu ndarë...”** (Ali Imran: 75), si dhe në thënien e Tij: **“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: ‘Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëzit, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre’.”** (El Bekare). Pra janë përmendur të dyja anët e medaljes. Kështu ata të thonë se Allahu ka përmendur të mirën dhe të keqen e alkoolit. Ndërsa Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë për shejtanin: “Të vërtetën të ka thënë, megjithëse është gënjeshtar e mashtrues.” Pra, duke u bazuar në këto argumente, ata të thonë se kjo tregon që nuk lejohet të përmendësh asnjë të prishur e të shthurur dhe asnjë bidatçi, vetëm nëse do të përmendësh edhe të mirat e tij.

Shejhu - Kjo, o vëllai im, është e saktë kur bëjmë vlerësimin e dikujt (kur duam të japim gjykim ndaj tij). Në këtë rast patjetër duhet të përmendësh këtë

anë dhe anën tjetër. E vërteta detyrimisht duhet të pranohet nga çdokush, qoftë edhe nga çifuti, shejtani apo mushriku (idhujtari). A nuk e pranoi ose e vërtetoi Profeti (salallahu alejhi ue selem) thënien e shejtanit: “Kush lexon ajetin ‘Kursij’ në një natë, do të vazhdojë të jetë nën ruajtjen e Allahut dhe nuk do t’i afrohet shejtani derisa të gdhijë.”!? A nuk e pranoi (ose e vërtetoi) thënien e rabinit çifut: “Allahu i vendos qiejt në një gisht dhe tokat në një gisht.”!? A nuk e pranoi Allahu thënien e mushrikëve (idhujtarëve): **“E kur ata bënin ndonjë vepër të turpshme thonin: ‘Gjetëm baballarët tanë që e vepronin atë dhe Allahu na urdhëroi për të.’ Thuaj: ‘Allahu nuk urdhëron për vepra të turpshme.’”**!? Pra i ktheu përgjigje për thënien e dytë, ndërsa për të parën **“Gjetëm baballarët tanë që e vepronin atë”**, nuk iu përgjigj, sepse ajo është e vërtetë. Prandaj thashë që çështja ka nevojë për shpjegim. Arsyeja që më bëri të çuditësja është se ka ndryshim ndërmjet kundërpërgjigjes dhe vlerësimit e gjykimit.¹⁹⁰

Ndikimi i kohës tek fetvatë

Pyetje - Diskutohet së tepërmi midis njerëzve se çështjet që dikur kanë qenë të ndaluara, si për shembull, radioja, sot janë bërë hallall. Thonë gjithashtu se ndryshimi i kohës dhe i vendit ndikojnë tek fetvatë. Shpresoj prej jush sqarimin e së vërtetës rreth kësaj çështjeje dhe si t’i kundërshtojmë me argumente ata që hedhin këto fjalë. Allahu jua shpërbleftë me të mira!

¹⁹⁰) Fetvaja është regjistruar në kasetë me datë 16/12/1416 h. dhe e përkthyer të plotë siç është regjistruar nga vetë shejh Muhamed bin Salih el Uthejmin. Kjo që e ka përmendur shejhu është përmbledhje e asaj që kanë thënë dijetarët tanë në lidhje me këtë çështje. Ata kanë sqaruar se në rastin e vlerësimit, gjykimit ndaj personave dhe shkrimit gjerësisht të biografisë së tyre, duhet të përmenden të mirat dhe të këqijat, për të bërë krahasimin mes tyre dhe për të dhënë gjykimin e drejtë sipas asaj që rezulton nga ky proces. Puna e vlerësuesit është si puna e gjykatësit, i cili e studion çështjen nga të gjitha anët dhe pastaj merr vendimin. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë në hadith të saktë: “Kur ulen para teje dy palët në konflikt, mos gjyko derisa të dëgjosh prej palës tjetër ashtu siç dëgjove prej së parës, sepse kështu bëhesh më i denjë dhe më me meritë për të njohur vendimin e drejtë.” Thëniet e dijetarëve që e mbështesin këtë metodë, në këtë rast janë të shumta. Madje nuk di të ketë ndonjë dijetar që mendon ndryshe nga kjo që e sqaruar, pasi nuk mund të arrijmë në vlerësime të drejta në lidhje me personat, veçse në këtë mënyrë.

Ndërsa në rastin e kundërpërgjigjes ndaj kundërshtarit, paralajmërimit për t’u ruajtur prej tij ose këshillës, nuk është kusht që të bëhet krahasimi. Madje krahasimi mes të mirave dhe të këqijave, në disa raste mund të jetë i dëmshëm, si në rastin e paralajmërimit rreth bidatçit. Meqenëse në rastin e kundërpërgjigjes, paralajmërimit dhe këshillës nuk synohet vlerësimi, por sqarimi i bidatit, i devijimit, ose i gabimit dhe neglizhencës, nuk është kusht përmendja e të mirave. Në këtë kuadër është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem) për atë personin që mori leje për të hyrë në shtëpinë e tij: “Jepini leje, sa vëlla i keq i fisit që është”, ose “sa bir i keq i fisit që është”. (Transmeton Buhariu nga Aishja, nr. 6054 dhe 6131) Gjithashtu edhe fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem), kur Fatimetu binti Kajsi u konsultua me të për çështjen e martesës së saj: “Përsa i përket ebi Xhehmit, ai i godet shumë gratë, kurse për sa i përket Muavijes ai është i varfër, nuk ka pasuri.” (Transmeton Muslimi, nr. 1480)

Përgjigje - Me të vërtetë fetvaja nuk ndryshon me ndryshimin e kohës, as me ndryshimin e vendit e as me ndryshimin e njerëzve. Nëse ligji apo vendimi i Sheriatit, vihet në përdorim në varësi të një shkak, nëse gjendet ky shkak, zbatohet, në të kundërt nuk ka se si të vihet në zbatim.

Myftiu (ai që jep fetva) mund t'i privojë njerëzit nga diçka që është hallall nëse është i bindur se njerëzit me veprimin e kësaj vepre mund të bien në haram, siç bëri Umeri (radijallahu anhu), kur pa se njerëzit, sapo nxeheshin me gratë e tyre, menjëherë i divorconin tri herë (d.m.th. duke thënë tri herë “ti je e divorcuar”). Në të njëjtin vend apo moment, i ndaloi Umeri (radijallahu anhu) njerëzit që pas kësaj të ktheheshin përsëri tek gratë e tyre. Ai e konsideroi këtë lloj divorci si tri herë, pra të përfunduar, edhe pse thënia tri herë në të njëjtin moment “ti je e divorcuar”, në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), ebu Bekrit (radijallahu anhu) dhe në dy vitet e para të udhëheqjes së Umerit (radijallahu anhu), konsiderohej një herë, pra, një divorc i vetëm. E njëjta gjë ndodhi edhe me dënimin e atij që kapej duke pirë alkool. Në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe ebu Bekrit (radijallahu anhu), nuk goditej më shumë se 40 shkopinj. Më pas filloi frekuentimi në masë i alkoolit. Umeri (radijallahu anhu) mbledhi sahabët e tjerë dhe pasi u këshilluan, arritën në konkluzionin se dënimi duhej bërë 80 shkopinj.

Me ligjet e Sheriatit askush nuk mund të luajë si dëshiron, duke i konsideruar gjërat haram apo obligim sipas qejfit të tij, por ligjet e Sheriatit janë në varësi të shkaqeve, të cilat vendosin zbatimin apo jo të tyre.

Ndërsa sa i përket radios, nuk di që ndonjëri prej dijetarëve që merren me kërkime dhe saktësime, të ketë thënë që ajo është haram, por këtë gjë e kanë thënë disa njerëz të padijshëm, dritëshkurtër, pa e ditur fare domethënien e kësaj çështjeje. Ndërsa dijetarët hulumtues dhe në veçanti mësuesi ynë, shejh Abdurrahman ibn Sadi, nuk e kanë klasifikuar radion tek haramet, por kanë thënë se kjo është prej atyre shumë gjërave që Allahu ia mësoi mendjes njerëzore. Në këtë kontekst ajo mund të jetë një mjet dobiprurës ose dëmtues, gjithmonë duke ju referuar asaj ç'ka transmetohet në të. Po kështu disa njerëz refuzuan përdorimin e mikrofonit kur u fut në përdorim, por dijetarë hulumtues, nuk mbajtën qëndrim të njëjtë me këtë grup njerëzish të paditur, por e

konsideruan këtë shpikje të re si begati nga Allahu për robërit e Tij, që të dëgjoheshin ligjëratat dhe hytbet e tyre sa më larg.

Cili është përkufizimi i plotë në çështjen e përngjasimit me jobesimtarët

Përngjasimi me jobesimtarët është një nocion i gjerë, pra mund të realizohet në shumë gjëra, si psh. në paraqitjen e jashtme, në mënyrën e të veshurit, në mënyrën e të ngrënit etj.

Përkufizimi i plotë i përngjasimit të ndaluar, është që një person të kryejë diçka e cila është karakteristike dhe specifike e jobesimtarëve, aq sa kush e vëren atë duke e kryer këtë veprim, mendon se ai është jobesimtar.

Ndërsa, në qoftë se diçka përhapet së tepërmi tek besimtarët dhe jo tek jobesimtarët, atëherë përngjasimi në këtë rast është i lejuar edhe në qoftë se mësohet se origjina e kësaj gjëje rrjedh nga jobesimtarët, për sa kohë që kjo gjë nuk është haram në vetvete, si p.sh. veshjet e mëndafshita.

(Përmbledhje e mësimëve dhe fetvave në haremin e Mekës, vëll. 3 fq. 367. Muhamed ibn Salih el Uthejmin)

Cili është standardi bazë në përngjasimin me jobesimtarët

Standardi i përngjasimit është që të veprojë përngjasuesi diçka që është e veçantë për të përngjasuarin d.m.th. për atë që imitohet.

Më konkretisht, në qoftë se besimtari vepron diçka që është karakteristike dhe veçori specifike për jobesimtarët, kjo konsiderohet përngjasim me ta.

Ndërsa për sa i përket atyre gjërave, veprimi i të cilave është përhapur në shkallë të gjerë mes besimtarëve, këto nuk mund të konsiderohen më si veçori apo karakteristikë e jobesimtarëve, kështu që veprimi i tyre nuk është haram, për arsye se prej besimtarëve nuk konsiderohen si përngjasim. Ky është synimi dhe ajo çka përmban kjo frazë.

Në mënyrë të ngjashme me çka shprehëm është deklaruar edhe nga ibn Haxheri në “El feth” (10/272)

Disa prej selefëve e kanë urryer veshjen e *burnus-it*¹⁹¹ me pretendimin se kjo rrobë është rrobë murgjish. Imam Malik, kur është pyetur rreth kësaj çështjeje ka thënë: “Nuk ka problem nëse vishet kjo rrobë.” Dikush i ka thënë: “Këtë rrobë e përdorin të krishterët.” Imam Malik ia ka kthyer: “Dikur është veshur edhe këtu tek ne.”

Kjo ishte përgjigjja e imam Malikut, por do të ishte akoma më e plotë në qoftë se imami do të përmendte hadithin e Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) kur e pyetën se ç’rrobë duhet të veshë “muhrimi” gjatë ritit të haxhit apo umres. Atëherë Profeti (salallahu alejhi ue selem) tha: “Nuk duhet të veshë këmishë, pantallona (sirvale), dhe as *burnus-in*.”

(Fetva për Akiden, fq.245)

Gjykimi ndaj “ilahive” me përmbajtje islame

Pyetje - E dimë se këngët muzikore të njohura sot midis nesh, janë të ndaluara për shkak të fjalëve ofenduese, të ulëta e të tjera gjëra si p.sh. harxhimi i kohës në diçka pa dobi. Ne jemi disa të rinj që Allahu na i ka ndriçuar zemrat me të vërtetën. Si zëvendësim për muzikën kemi zgjedhur “ilahitë” me përmbajtje islame, të cilat nxisin vullnetin, ndjenja të mira e të tjera si këto.

Këto “ilahi” përbëhen nga vargje vjershash të thirrësve të Islamit (Allahu i forcoftë!), të cilat këndohen me melodi, si p.sh. “kasidja” (poezia) “Ehi” (Vëllai im) e Sejjid Kutub (Allahu i Lartësuar e mëshiroftë).

Çfarë gjykimi kanë “ilahitë” me përmbajtje të pastër islame, të cilat kanë fjalë nxitëse për punë të mira dhe prekëse, që i kanë shprehur thirrësit muslimanë bashkohorë, ose të mëparshmit, me fjalë të sinqerta?

Po nëse në to përdoret qypi, dajrja apo defi, a lejohet dëgjimi i tyre? Me aq sa dimë ne me dijen tonë të kufizuar, Profeti (salallahu alejhi ue selem) e ka lejuar

¹⁹¹⁾ Rrobë e gjatë me një kapuç nga prapa, e ngjashme me rrobën e murgjve të krishterë.

defin natën e martesës, kur dihet se defi është vegla më e thjeshtë muzikore, e është sikur t'i bihet çdo gjëje tjetër.

Na jepni mundësi që të përfitojmë prej jush, Allahu ju dhëntë sukses në çdo vepër të dashur e të kënaqshme për Të!

Përgjigje - Në gjykimin për këngët që sot nuk lejohen, keni thënë të drejtën, për shkaqet që edhe ju i keni përmendur, se ato përmbajnë fjalë të ndyra e të ulëta, se në to nuk ka dobi, madje kanë gjëra të kota të cilat ngjallin (ngacmojnë) eprshet dhe dëshirën seksuale, sikurse edhe përmbajnë pislleqe të cilat përherë ndjellin dëgjuesit për keq, Allahu na dhëntë ne dhe juve sukses për çdo vepër të mirë!

Lejohet që në vend të tyre të dëgjosh “ilahi” me përmbajtje islame, të cilat përmbajnë urtësi, këshilla, mësim e të tjera gjëra që ndjellin entuziazëm, dashuri për fe, ngjallin ndjenjat fetare, largojnë nga të këqijat dhe nga gjërat që çojnë në to. Lejohet të dëgjosh ato “ilahi” të cilat nxisin kënduesin dhe dëgjuesin e tyre për bindje ndaj Allahut, për t’u larguar nga gjynahet, nga tejkalimet e kufijve islame, ngjallin ndjenjën e mbrojtjes së fesë (Sheriatit) dhe për xhihadin në rrugën e saj.

Megjithatë nuk duhet që të dëgjohen shumë e të bëhet zakon që të teprohen. Por dëgjohen herë-herë në raste të përshtatshme e momente të veçanta si p.sh. dasma (festa), udhëtime etj, ose në raste kur nevojitet ngritje e moralit dhe ndikim për mire, si shtytje në vepra të mira e largim nga veprat e këqija. E më e mirë se dëgjimi i tyre, është që njeriu t’i caktojë vetes një pjesë të caktuar të Kur’anit e ta lexojë atë, ose disa duá (lutje të sakta) profetike, sepse kjo është më e mirë për të, më e pastër dhe ndikon më shumë në hapjen e zemrës dhe qetësimin e saj:

“Allahu ka zbritur fjalën më të mirë, Librin, të ngjashëm me mrekulli, të përsëritur herë pas here (në këshilla e dispozita) që prej dëgjimit të tij rrënqethen lëkurat e atyre që kanë ndrojtë Zotin e tyre, e pastaj me përkujtim ndaj Allahut u qetësohen lëkurat dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzim i Allahut, me të udhëzon atë që do. E atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzim.” (Ez-Zumer: 23)

“Ata që besuan, me të përmendur Allahun, zemrat e tyre qetësohen, pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat qetësohen, rehatohen.” (Er-Rad 28)

Dihet që çështja më parësore e sahabëve, ishte rëndësia dhe përkushtimi në Librin e Allahut dhe sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem), në të mësuarit përmendësh, në nxjerrjen e mësimeve prej tyre dhe në veprimin e tyre, e megjithëkëtë, ata kishin “enashidë” (ilahi) dhe vjersha që i këndonin me melodi, si p.sh. në hapjen e hendekut, në ndërtimin e xhamive, në marshimin për në xhihad e të tjera raste, pa i bërë moton e tyre, apo pa i kushtuar atyre interesin më të madh dhe përkujdesin kryesor, por duke i llogaritur si diçka çlodhëse dhe ndikuese (gjallëruese) në ndjenjat e tyre.

Përsa i përket qypit, defit e të tjera veglave muzikore, nuk lejohet përdorimi i tyre në këto “enashidë”, sepse as Profeti (salallahu alejhi ue selem) e as sahabët nuk e kanë vepruar një gjë të tillë. Allahu është Ai i Cili udhëzon në rrugën e drejtë. Paqja, falja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhamedin (salallahu alejhi ue selem), familjen dhe shokët e tij.

(Marrë nga libri “Fetva islamije” i Komisionit të Përhershëm të Dijetarëve, 4/532-534, si dhe nga “Fetvatë e Komisionit të Përhershëm”, fq. 236)¹⁹²

Kreu 9. Thirrja (davja), rregullat e mjetet e saj, si dhe urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja

Thirrja dhe nevoja e njerëzve për të

) Nëse ndonjëri prej vëllezërve merr mendimin tjetër të dijetarëve, të cilët e kanë ndaluar dëgjimin e “ilahive”,¹⁹² duke qenë i çiltër dhe i sinqertë për ndjekjen e së vërtetës, le ta dijë se kjo është njësoj si çështjet e tjera që dijetarët e nderuar kanë dhënë mendimet e tyre, prandaj të mos e marrë si shkak për të mbajtur qëndrim ndaj kundërshtarëve, se mosmarrëveshja në këtë çështje është e konsiderueshme.

Pyetje - A është i mendimit hirësia juaj, se pranimit i thirrjes nga shoqëria e sotme është më i mirë dhe më rezultativ se ai i shoqërive të kaluara, në kuptimin se sot nuk ekziston më ai muri ndarës midis thirrjes dhe shoqërisë?

Përgjigje - Njerëzit kanë nevojë emergjente për thirrjen në rrugën e Allahut (daven). Është e vërtetë se rezultatet e pranimit të saj nga njerëzit janë të larta. Kjo vjen si shkak i shtimit të numrit të thirrësve, kapitullimit të ideologjisë komuniste, apo edhe prej këtij rizgjimi të fuqishëm që vërehet sot tek muslimanët. Kështu që njerëzit, sipas informacioneve që na kanë mbërritur nga të katër anët e botës, kanë filluar ta pranojnë Islamin. Kanë filluar të bëhen pjesë e tij dhe po kështu shprehin interesim të madh për ta mësuar dhe kuptuar këtë fe të madhe.

Këshilla ime për të gjithë dijetarët dhe ata që meren me daven, do të ishte që ata të shfrytëzonin në maksimum këtë rast, të vënë në dispozicion të daves çdo gjë të disponueshme, sipas mundësisë, për t'i thirrur njerëzit tek rruga e Allahut, për t'i mësuar atyre me gojë apo me shkrim (d.m.th. me libra), se ata janë krijuar për të adhuruar vetëm Allahun dhe për t'iu bindur plotësisht Atij, fakte të cilat mund t'i përcjellin tek njerëzit në hutben e xhumasë, në ligjëratat e organizuara, në grumbullimet e rasteve, me shkrimin e librave nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj elektronike etj. Pra, dijetari apo thirrësi duhet ta shfrytëzojë këtë rast për t'i thirrur njerëzit tek rruga e Allahut duke përdorur çdo lloj mjeti të ligjshëm dhe të lejuar (hallall), dhe këto, falenderimi i takon Allahut, janë të shumta.

Duke vërejtur se njerëzit pranojnë çdo gjë që u thuhet, qoftë kjo e mirë apo e keqe, del si detyrë për ata që posedojnë dijen fetare nga Kur'ani dhe suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem), ta shfrytëzojnë këtë rast për t'i orientuar njerëzit për tek e mira dhe tek udhëzimi mbi baza të shëndosha nga Kur'ani dhe suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem). Gjithashtu duhet që thirrësit të dinë dhe të kuptojnë në mënyrë perfekte të gjitha gjërat që ua përcjellin njerëzve nga Kur'ani dhe Suneti, në mënyrë që të mos bëjnë dave me injorancë, por ajo të jetë e mbështetur në dijen e sigurtë, ashtu siç ka përmendur Allahu në suren "Jusuf", 108:

“Thuaj: ‘Kjo është udha ime. Unë ju ftoj drejt Allahut me dije të sigurtë.’”

Nga kriteret bazë që duhet të plotësojë dijetari apo thirrësi për të bërë dave, është që ai të ketë dije të plotë për ato gjëra që u përcjell njerëzve dhe i fton në to.

Duhet bërë kujdes që të mos lihet pas dore kjo çështje, sepse ndodh që njeriu ta neglizhojë këtë pikë dhe si rrjedhojë fillon t’i thërrasë njerëzit tek e kota dhe i ndalon nga e vërteta. Pra arrijmë në konkluzionin se njeriu duhet të sigurohet në çdo gjë që duhet të kryejë, dhe në rastin tonë, thirrësi, në të gjitha rastet duhet të jetë i pajisur me dijen e plotë dhe të sigurtë.

(Shkëputur nga revista “El buhuth”, nr. 40, fq. 143-144, nga shejh ibn Bazi)

Mënyrat e thirrjes në kohën e sotme

Pyetje - Si e vlerësoni gjendjen aktuale të daves në ditët e sotme? Cilat janë pikat ku duhet të përqendrohet më tepër vëmendja midis zhvillimeve të reja dhe sfidave bashkëkohore?

Përgjigje - Njëpërmjet formave dhe mjeteve të reja të cilat nuk ekzistonin për ata që kanë qenë para nesh, Allahu e ka bërë më të lehtë çështjen e daves, kështu që përcjellja e argumentit fetar për njerëzit bëhet në mënyra të shumëllojshme, si për shembull me anë të medias elektronike dhe asaj të shkruar.

Prandaj nuk mbetet gjë tjetër për dijetarët dhe thirrësit, vetëm se të kryejnë këtë obligim (daven) dhe të mbështesin njëri-tjetrin në këtë punë, me idealin e madh që të përcjellin tek njerëzit atë çka Allahu ka zbritur, të mos nënshtrohen ndaj presionit të fajësimeve të mundëshme, të mos frikësohen në thirrjen e tyre nga askush, i madh apo i vogël qoftë, i pasur apo i varfër, por të vazhdojnë të përcjellin tek njerëzit atë çka na ka urdhëruar Allahu, ashtu siç është zbritur nga Ai dhe ashtu siç ka vendosur vetë Ai.

Kjo punë (davja) mund të arrijë gradën e obligimit të detyrueshëm (“farz ajn”) për një person, kur askush nuk bën dave në vendin ku ai jeton.¹⁹³ Në qoftë se ti jeton në një vend ku njerëzit nuk e marrin përgjegjësinë për të bërë publike urdhërat e Allahut, atëherë bëhet obligim për ty të mbash mbi supe përgjegjësinë e kryerjes së këtij adhurimi. Por nëse gjendet dikush tjetër veç teje që e kryen daven, urdhëron në punë të mira dhe ndalon nga punët e këqija etj, atëherë kjo punë nuk konsiderohet për ty si obligim, por si një punë e pëlqyeshme (sunet). Këtë punë duhet ta kryesh me kujdes dhe përkushtim të plotë, edhe në rastin kur për ty është sunet, sepse në këtë mënyrë bëhesh prej atyre që garojnë për të kryer punë të mira. Një nga argumentet që na tregojnë se në rastet kur ka kush e bën daven, ajo nuk është detyrë për të gjithë, është fjala e Allahut në suren “Ali Imran”, 104:

“Le të dalë nga ju një grup njerëzish të përkushtuar që të ftojnë njerëzit tek mirësia, të urdhërojnë për të mirën dhe të ndalojnë nga e keqja.”¹⁹⁴

Është e ditur se Profeti (salallahu alejhi ue selem), gjatë kohës që qëndroi në Meke sipas urdhërit të Allahut, i ka bërë dave njerëzve aq sa kishte mundësi, po kështu edhe shokët e tij, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Ata kanë bërë dave në Meke, sipas konditave dhe mundësive që kishin. Pasi u shpërngulën për në Medine, filluan të bënin më shumë dave. Po kështu edhe pas vdekjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem), pasi u përhapën nëpër vende të tjera, ata vazhduan të bënin dave dhe kurrë nuk e lanë pas dore këtë obligim, gjithsecili sipas mundësisë që kishte dhe sipas dijes që posedonte. Por në kohën kur mbizotëron injoranca, kur shtohet kryerja e veprave të këqija dhe numri i thirrësve është i vogël, (siç është gjendja në kohët e sotme), atëherë davja bëhet obligim për çdo besimtar sipas mundësisë. Ndërsa në një vend të kufizuar, për shembull në një

) Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyrë për të gjithë sipas mundësisë, por këtu bëhet fjalë për një person ose grup njerëzish që duhet të merren me dave dhe të jenë vazhdimisht të disponueshëm e të përkushtuar për të. Prandaj, nëse ka në një vend njerëz që e kryejnë këtë detyrë, angazhimi deri në këtë nivel i pjesës tjetër të njerëzve është gjë e pëlqyeshme.

) Ibn Kethiri ka thënë në komentin e tij rreth ajetit të mësipërm: “Qëllimi i ajetit është që të jetë një grup i posaçëm prej Umetit, i përkushtuar e i angazhuar për të kryer këtë punë të madhe (thirrjen), megjithëse kjo është detyrë mbi çdo individ të Umetit sipas mundësisë, siç ka ardhur në “Sahihun” e Muslimit nga ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: ‘Kush shikon prej jush një të keqe, le ta ndryshojë atë me dorën e tij, e nëse nuk ka mundësi le ta ndryshojë me gojën e tij, e nëse nuk ka mundësi le ta ndryshojë me zemrën e tij, dhe kjo është grada më e ulët e besimit.’”

qytet apo fshat, nëse gjendet një numër i mjaftueshëm thirrësish që e kryejnë siç duhet këtë obligim, për të tjerët kjo mbetet sunet. Kjo sepse këta thirrës arrijnë t'ua përcjellin argumentin njerëzve dhe të zbatojnë kështu urdhërin e Allahut.

Për sa i përket pjesës tjetër të njerëzve nëpër botë, del si detyrë për dijetarët dhe krerët e shteteve, që sipas mundësive që kanë, ta përcjellin fjalën e Allahut në të gjithë botën me anë të çdo mjeti që disponojnë, dhe ky është obligim (“farz ajn”), gjithmonë sipas mundësisë.

Nga e gjithë kjo, kuptojmë se kalimi i daves, njëherë si obligim pastaj si sunet, është një kalim i pjesshëm e i ndryshueshëm, sepse davja mund të jetë obligim për disa njerëz apo për disa personalitete, ose mund të jetë sunet për ata, në momentin kur ka kush e kryen këtë punë dhe është e mjaftueshme. Ndërsa krerët e shtetit dhe ata që posedojnë mundësi të mjaftueshme, kanë obligime më të mëdha për ta përhapur fjalën e Allahut në të gjitha skajet e botës, gjithmonë sipas mundësisë.

(“Kitabu dave”, Muhamed ibn Salih el Uthejmin, nr. 5, 2/160-162)

Këshillë e shejh Uthejminit drejtuar thirrësve

Ata që thërrasin për tek e kota, pra thirrësit e sherrit, kërkojnë që t'i përçajjnë thirrësit e së drejtës që thërrasin për tek Allahu, sepse ata e dinë shumë mirë se bashkimi i thirrësve të drejtë dhe bashkëpunimi i tyre me njëri-tjetrin është çelësi i suksesit të tyre dhe se përçarja do të ishte shkak për dështimin e tyre. Çdokush është i predispozuar për të bërë gabime. Nëse dikush nga ne vëren se vëllai i tij ka gabuar, menjëherë le të kontaktojë me këtë vëlla që të diskutojnë rreth çështjes në të cilën është gabuar. Një çështje ne mund ta konsiderojmë gabim sipas mendjes sonë, por në të vërtetë ajo mund të mos jetë e tillë. Po kështu nuk lejohet që gabimi të bëhet pretekst për ta zhvlerësuar thirrësin, për ta sharë atë dhe për t'u larguar prej tij. Këto nuk janë cilësi të besimtarit e akoma më tepër të thirrësit që thërret për tek Allahu i Madhëruar.

Thirrja e qëlluar, e realizuar plotësisht është ajo që bazohet në dije, siç thotë Allahu i Madhëruar:

“Thuaj: ‘Kjo është udha ime, unë ju ftoj drejt Allahut me dije të sigurtë, unë dhe kushdo që më ndjek mua.’”

Thirrësi duhet të ketë dije për gjërat në të cilat i fton njerëzit, për gjendjen e njerëzve që do t’u bëjë dave dhe për mënyrën e daves. Pra janë tri gjëra:

1) Duhet të kesh dije për gjërat në të cilat thërret.

Të kesh dije të plotë për këto gjëra dhe të flasësh vetëm për ato gjëra që ti je i sigurtë se janë të sakta. Nëse thërret me injorancë, pa pasur dije për atë që po thua, ti më tepër shkatërron sesa ndërton. Mbi të gjitha ngarkohesh me një gjynah të madh. Allahu thotë në Kur’an:

“Mos ndiq (o njeri, mos fol, mos bëj) atë gjë për të cilën nuk ke dijeni. Me të vërtetë që për të parët, të shikuarit edhe zemrën, për secilën prej tyre do të pyetet.” (El Isra: 36)

2) Të dish gjendjet e njerëzve që do t’i bësh dave, pra të dish e të dallosh të paditurin nga ai që e kundërshton hakun (të vërtetën) me mendjemadhësi.

3) Të dish mënyrën se si të thërrasësh, pra të dish se si t’i thërrasësh njerëzit, jo me dhunë apo me forcë, ose duke i ofenduar për punët që ata bëjnë. Duhet t’i thërrasësh me qetësi, të jesh i butë me ta dhe t’ua shtrosh bukur atë që u thua.

(“Libri i daves”, nr. 5, ibn Uthejmin, 2/173-175)

Pyetje drejtuar shejh Albanit - A është davja në rrugë të Allahut “farz” për çdo musliman që ka një farë dije në fe? Nëse përgjigja është po, a konsiderohet detyrë për çdo musliman, të bëjë çdo gjë që lidhet me daven si organizimin e mësimeve, piknikëve, botimin e librave, vizitat dhe ligjëratat?

Përgjigje - Faktikisht sot fjala “dave” ka marrë një kuptim të ri, ndryshe nga kuptimi i kaluar të cilin e kupton çdo i ditur rreth Kur’anit dhe Sunetit, p.sh. nga fjala e Allahut: **“Kush është më fjalëmirë sesa ai që fton në fenë e Allahut, që punon punë të mira dhe thotë: ‘Unë jam nga muslimanët?’”** (Fusilet: 33)

Botëkuptimi i kësaj thirrjeje ndryshon nga botëkuptimi i një pjese të daves sot. Kuptimi i thënies në ajet është përcjellja e Islamit tek njerëzit dhe bërja e tij e njohur tek ata, ashtu siç ka dashur Allahu dhe siç e ka përcjellë i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem). Thirrja sipas këtij kuptimi, hyn tek parimi i urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja. Si rrjedhojë, përgjigjja ndaj fragmentit të parë të pyetjes është se ajo është detyrë, por kjo detyrë nuk është e njëjtë për çdo musliman. Kjo ndryshon sipas kulturës dhe njohurive fetare që ka personi. Nuk është i barabartë analfabeti me atë që shkruan e lexon, as i padituri me dietarin. Ndërmjet tyre ka diferencë të madhe diturie, të cilën e di vetëm Allahu. Prandaj mund të themi një fjalë përmbledhëse: muslimanit, sa më shumë dije të ketë, aq më shumë i zgjerohet rrjeti i detyrimeve që ka për të ftuar në rrugë të Allahut, dhe e kundërta.

Ndërsa thirrja që sot është formuluar me një kuptim të ri, ndryshe nga kuptimi i mëparshëm i saj, ose përballë kuptimit të mëparshëm, është thirrja që bëjnë disa grupe apo parti islame me një metodë të caktuar. Kjo thirrje, pa marrë parasysh burimet e njohurive që i mbartin këta thirrës, ***mund të jetë*** prej detyrave vullnetare. E theksova ***mund të jetë***, sepse ka njerëz që u dedikohen këtyre grupeve dhe marrin përsipër daven, por ata ftojnë në Islam vetëm në mënyrë të përgjithshme. Me fjalë të tjera, nuk u japin mundësi të ftuarve që ta kuptojnë Islamit ashtu siç duhet dhe ashtu siç përfitohet nga fjala e Allahut në Kur'an:

“Thuaj (O Muhamed): ‘Unë jam vetëm një njeri si edhe ju, (por) mua më është frymëzuar e më është shpallur se i Adhuruari juaj është Një i Adhuruari i Vetëm, Allahu.’ Kështu pra, kushdo që shpreson për takimin me Zotin e tij, le të punojë mirësi e drejtësi dhe të mos i bashkojë askënd për shok në adhurim Zotit të tij.” (El Kehf: 110)

Thirrja e tyre nuk e ka qartësinë e duhur, pra nuk u sqarojnë njerëzve punën e mirë, shirkun, syfaqësinë që e zhvlerëson dhe e prish punën e të tjera gjëra, të cilat, nëse muslimani do t'i njihte, do të ishte i qartë dhe i mirinformuar rreth fesë së vet, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

“Thuaj (o Muhamed): ‘Kjo është Udha ime, unë ju ftoj drejt Allahut (njësimi të Tij) me dije të sigurtë, unë dhe kushdo që më ndjek mua (duhet të ftojnë në Islam dhe në njësimin e Allahut me dije të kulluar si drita e syrit). Lavdi i qoftë Allahut dhe unë nuk jam prej mushrikëve (politeistë, paganë, idhujtarë ose çdo fe tjetër që mohon Njëshmërinë e Allahut ose adhuron të tjerë përkrah a në vend të Allahut)’.” (Jusuf: 108)

Që të qartësohet mirë muslimani rreth Islamit, duhet që të ftohet në të ashtu siç e ka sqaruar i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem).

Në qoftë se muslimani e di që daven e ka detyrë dhe vdes pa i ditur shumë prej metodave në dave që i ndërmarrin disa grupe, nuk është përgjegjës përpara Allahut, sepse gjykimi më i mirë që mund të jepet për to, është se janë “farz kifaje”, të cilin nëse e bëjnë disa njerëz, hiqet përgjegjësia nga të tjerët. P.sh. disa grupe merren me politikë për të ngritur qeverinë islame dhe u japin pasuesve të tyre një kulturë të caktuar, ose u mësojnë disa rregulla në detaje, si diskutimi se a ka të drejtë votimi femra apo jo. Kështu që shumë grupe lenë pas dore atë që është më e rëndësishme, Akiden dhe dijen rreth fesë, dhe merren me gjëra që kanë rëndësi shumë më të vogël. Madje ndoshta nuk ka asnjë lloj urtësie e mençurie diskutimi rreth tyre, si p.sh. problemi i votimit dhe zgjedhjes së gruas përfaqësuese ose deputete.

Si përfundim thirrja ka marrë dy kuptime:

1) Kuptimin që kanë sqaruar të parët tanë.

Sipas këtij kuptimi është detyrë për çdo musliman, sipas kulturës dhe njohurive islame dhe sipas mundësisë që ka, të ftojë në rrugë të Allahut. Kjo bazuar në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush shikon prej jush një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij, nëse nuk mundet me gojën e tij...”, deri në fund të hadithit. Pra çdo njeri është i obliguar të bëjë dave brenda kufijve të dijes dhe mundësisë që i ka dhënë Allahu.

2) Kuptimin që synojnë disa grupime të sotme.

Kjo pa dyshim nuk është detyrë për çdo njeri, sepse ajo është thirrje nëpërmjet disa mënyrave që i shikojnë të arsyeshme disa thirrës. Këto mënyra, nëse janë të sakta janë “farz kifaje”, dhe nëse janë të gabuara, atëherë duhet të largohemi prej tyre, siç është për shembull gjykimi se gruaja ka të drejtë të votojë dhe të votohet.

(Marrë me ndërhyrje dhe shkurtime nga “El havi”)

Mjetet e thirrjes (daves)

Pyetje drejtuar shejh Albanit - Në lidhje me mjetet e daves janë dhënë tri mendime:

1) Mjetet e daves janë “teukifije”¹⁹⁵ parimisht dhe në mënyrë të shkoqitur, të detajuar.

2) Mjetet e daves janë “ixhtihadije”.¹⁹⁶

3) Mjetet e daves janë “teukifije” parimisht, ndërsa për sa i përket praktikimit, ndryshojnë sipas ndryshimit të kohës, kërkesave dhe nevojave të saj.

Përgjigje - Çështja ka lidhje të madhe me temën e “el mesalih el murseletu” (interesat e lira), për të cilat kemi folur në disa raste dhe kemi bërë dallimin ndërmjet tyre dhe ndërmjet asaj që e emërtojnë “el bida’tu hasenetu” (bidat i mirë). Ne, për t’iu kundërvënë pretendimit të ndarjes së bidatit në të mirë dhe të keq, domosdoshmërisht dhe me shumë lehtësi përmendim fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Çdo bidat është humbje dhe çdo humbje e çon të zotin e saj në zjarr.” Ky hadith, përgjithësisht e ka cilësuar çdo bidat në fe humbje. Ndërsa mjetet e shpikura kanë të bëjnë me “el mesalihul murselat”. Ne nuk i refuzojmë “el mesalihul murselat” krejtësisht, siç mendojnë disa medhhebe, dhe as nuk i pranojmë krejtësisht, por patjetër bëjmë shkoqitje. Këtë detajim në lidhje me to e kemi përfituar nga shejhul islam ibnu Tejmije, i cili kur ka diskutuar rreth bazës fetare “çdo bidat është humbje dhe çdo humbje përfundon në zjarr”, në mënyrë të detajuar ka theksuar se “Kjo bazë është e tërësishme dhe prej saj nuk bëhet asnjë përjashtim”. Pastaj ka diskutuar rreth “el mesalihu murselat”. Ai ka përmendur se për çdo gjë të re që shpiket dhe synohet të shfrytëzohet nën emrin e “el mesalihul murselat” duhet të vërehet:

1) Nëse arsyeja dhe nevoja për ta përdorur në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) ka ekzistuar, dhe megjithatë ai nuk e ka përdorur, atëherë përdorimi i saj është i palejuar.

2) Nëse arsyeja dhe nevoja ka lindur pas kohës së Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe përdorimi i saj është në dobi dhe interes të muslimanëve, përsëri nuk lejohet të thuhet se është e lejuar krejtësisht (totalisht), por duhet të vërejmë motivin që i shtyn muslimanët ta shfrytëzojnë këtë mjet. A është motivi neglizhenca e muslimanëve në zbatimin e disa rregullave fetare që janë të bazuara në argumente apo jo? Në qoftë se motivi i shfrytëzimit të mjetit të ri të shpikur është neglizhenca në zbatimin e disa rregullave fetare, ai nuk lejohet, sepse përdorimi i këtij mjeti çon në zhvlerësimin dhe mosfunksionimin e disa rregullave fetare në emër të një mjeti (të ri) që u sjell dobi fetare muslimanëve. Ndërsa, në qoftë se motivi i përdorimit të këtij mjeti të ri që u sjell

) D.m.th. të tilla që merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti dhe nuk ka hapësirë për “ixhtihad” në to.¹⁹⁵

) D.m.th. të tilla që ka në to hapësirë për të bërë “ixhtihad”. “Ixhtihadi” është përpjekja që e bën dijetari ¹⁹⁶ “muxhtehid” për të arritur në gjykimin fetar të një çështjeje, bazuar në një argument fetar të llojit shkoqitës.

muslimanëve dobi (meslaha murseleh), nuk është neglizhenca në zbatimin e rregullave të fesë, por është ndryshimi i rrethanave, në këtë rast themi se përderisa mjeti i ri nuk përbën kundërshtim të ndonjë rregulli fetar, qoftë edhe një mjeti fetar (i përmendur në Sheriat), ai lejohet të përdoret. Mendoj se kjo çështje e cila u sqarua në mënyrë të detajuar, është përgjigjja e këtij konfuzioni që po përcillet nga këta kërkues dije.

Rreth asaj që sqarova do të jap disa shembuj:

- Arsyeja dhe nevoja për t'u thirrur ezani për namaze të tjera përveç pesë namazeve, ka ekzistuar në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem). Madje besoj se arsyeja dhe nevoja për t'u thirrur ezani për disa namaze të tjera vjetore si p.sh. dy namazet e Barjemit, është më e madhe, sepse njerëzit janë të shkujdesur, kështu që kanë nevojë t'i përkujtosh me anë të ezanit, ose më së pakti me thirrjen "es-salatu xhamiaten" (namazi bashkarisht). Por i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) nuk e bëri këtë gjë. Pra arsyeja dhe nevoja për ezan ose për diçka që e zëvendëson ezanin si p.sh. thënia "es-salatu xhamiah", ka ekzistuar në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem). Përderisa ai nuk ka bërë gjëra të tilla, kjo tregon se përdorimi i ezanit ose diçka që e zëvendëson, si mënyrë për të thirrur njerëzit për grumbullim në raste të tilla, është prej shpikjeve në fe. Dijetarët që i kanë dhënë rëndësi dallimit ndërmjet Sunetit dhe bidatit (humbjes), nuk pranojnë që të thuhet as "es-salatu xhamiaten", sepse kjo nuk ka ekzistuar në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), aq më tepër për ezanin.

Sot, në çështjet e Fikhut (jurispudencës) vërehen dy gjëra të ndryshme krejtësisht.

Së pari, në asnjë medhheb të ndjekur nuk është lejuar thirrja e ezanit për dy bajramet, por disa medhhebe e konsiderojnë të ligjshme të thuhet për dy bajramet "es-salatu xhamiaten", megjithëse nuk ka ndryshim.

Së dyti, ka ardhur një hadith me tekst të qartë në "Sahihun" e Muslimit, ku është përmendur se për dy bajramet nuk thirrej as ezan dhe as "es-salatu xhamiaten".

- Një shembull tjetër, për një mjet që ka lindur (është shpikur) pas kohës së Profetit (salallahu alejhi ue selem), janë taksat. Ky mjet padyshim sjell dobi (interes) fetare për muslimanët, por Sheriati ka vendosur mjete fetare, të cilat e realizojnë këtë dobi që synohet të realizohet nëpërmjet këtyre mjeteve të shpikura. Taksavënësit i obliguan njerëzit të jepnin taksa në vend të mjeteve fetare që i ka ligjëruar Allahu për të furnizuar arkën e pasurisë së muslimanëve (bejtumalil muslimine) si zekati, trashëgimi që nuk ka kush e trashëgon, vakëfet

etj. Këta njerëz, të gjitha këto mjete dhe rregulla fetare i kanë nxjerrë jashtë funksionit të tyre. Si rrjedhojë u boshatis arka e pasurisë së muslimanëve dhe prandaj shpikën taksat. Në lidhje me taksat duhet të thuhet se janë mjete të paligjshme sepse shkatërrojnë dhe zhvlerësojnë mjetet e ligjshme. Nga ky sqarim duhet të merret përgjigjja e pyetjes së kaluar.

Pyetësi - Shejhu ynë! Për më shumë sqarim, në qoftë se na lejoni, do të jap disa shembuj rreth të cilëve diskutohet shumë.

Mjaft thirrës i grumbullojnë njerëzit rreth vetes me veprimtari teatrale të cilat i emërtojnë “Teatri islam” ose me “ilahi” të cilat i emërtojnë “Ilahi islame”. Disa prej tyre nuk përdorin dajre gjatë këndimit të “ilahive”. Gjithashtu i mbledhin njerëzit me anë të piknikëve (ekskursioneve) si mënyra të vazhdueshme, futbollit, lojrave të tjera sportive e të tjera mjete, rreth të cilave diskutohet shumë.

Shejhu - Në lidhje me gjërat e reja (të shpikura) unë gjykoj siç gjykon ibnu Tejmije, se “orgjina dhe parimi në ibadetet (adhurimet) është ndalimi (mosveprimi), derisa të gjendet argumenti që i ligjëron, dhe origjina e parimi në zakonet (gjërat që kanë të bëjnë me dynjanë), është lejimi i veprimit, përveç rastit kur bëhet i ditur argumenti që i ndalon”. Mjetet që përmendët futen në njërën prej këtyre dy bazave.

“Ilahitë” që emërtohen në kohën tonë “islame”, nëse do të supozonim se nuk përmbajnë kundërshtim ndaj Sheriatit për sa i përket kuptimit të tyre, dhe gjithashtu nuk përmbajnë shkelje të tjera si p.sh. imitimin e këngëtarëve të shthurur në këndimin e tyre etj., pra, në qoftë se do të supozonim se janë të pastra nga çdo shkelje, gjykojmë se parimi dhe origjina në gjëra të tilla është lejimi.

Pyetësi - Aktualiteti i “ilahive” ekzistuese, a është i pastër nga shkeljet e përmendura dhe të papërmendura, apo jo?

Shejhu - Me sa di unë, ato nuk janë të pastra nga shkeljet. Më e pakta është që ato dëgjohen në vend të Kur’anit dhe tek shumë njerëz kanë zënë vendin e tij. Të rinjtë muslimanë po këndojnë “ilahitë” dhe po lenë pas dore fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Kush nuk e këndon Kur’anin, nuk është prej nesh. Përsëriteni, lexojeni Kur’anin shpesh dhe këndojeni atë, sepse betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, ai përpiket të largohet nga kraharorët e burrave më shumë se devet nga freri (litari) me të cilin janë lidhur.”

Njëherë isha duke trajtuar këtë temë në një mexhlis (kuvend) dhe njëri nga të rinjtë që janë sprovuar me këtë gjë më tha: “O shejh, ti ke të drejtë! Vërtetë këto “ilahi” na kanë shmangur nga dëgjimi i Kur’anit.”

Gjatë qëndrimit në dyqanin e rregullimit të orëve, kur isha i vogël, e vendosja Kur’anin përpara dhe përpiqesha jo vetëm të lexoja, por edhe të mësoja përmendësh. Kështu e shfrytëzoja kohën e lirë gjatë punës. Me këtë që bëja synoja të zbatoja hadithin e lartpërmendur. Asnjëherë nuk më ka rënë në mendje të këndoja “ilahi islame”, por kishte raste që mësoja vargje poezish, të cilat përmbanin mençuri e urtësi. Vargjet që mësonim kishin dobi, sepse të edukonin, ndërsa “ilahitë” ekzistuese këndohen sipas notave të muzikës. Por, në qoftë se do të supozohet që ato nuk përmbajnë shkelje, atëherë ne i përmbahemi parimit të gjërave të tilla, i cili është lejimi.

- Shembulli tjetër, futbollit. Ai është një mjet sportiv për edukimin dhe forcimin fizik të muslimanit. Nuk mendojmë se ka ndonjë pengesë që të luhet futboll, por a zbatohen në lidhje me këtë lojë rregullat e Sheriatit? Përgjigjja është jo. Veçse vitet e fundit, po ashtu edhe disa vite më herët, kam vërejtur “Ihuanul muslimin” të zbatojnë rregullat e Sheriatit. Kjo është një gjë që duhet ta përmendim, për të qenë të paanshëm ndaj këtij grupi. Ky grup ka qenë ndër grupet e pakta që merreshin me futboll. Në atë kohë unë isha shumë i dhënë pas gazetës “Ihuanul muslimin” që botohej në Kajro në kohën e Hasen el Ben-na (Allahu e mëshiroftë). Në të përmendeshin edhe lajme sportive. Ndër lajmet e tjera përmendej se gjatë zhvillimit të një ndeshjeje hyri koha e namazit, prandaj e ndërpreu lojën dhe u falën me xhemat në fushën e futbollit. Ata visheshin me rroba të gjata të cilat nuk e shfaqnin aurretin. Kjo është gjë e lejueshme, sepse ata iu përmbajtën rregullave të fesë islame gjatë kësaj loje.

Si përfundim, këto mjete, në qoftë se nuk kundërshtojnë ndonjë aspekt fetar, sipas origjinës janë të lejuara. Madje mund të jenë prej gjërave të pëlqyeshme ose të obliguara në qoftë se me anë të tyre realizohet ndonjë detyrë fetare, si p.sh. fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Që të gjuani është më e dashur tek unë sesa të kalëroni” dhe fjala e tij: “Gjuani” e të tjera hadithe që nxisin për këtë lloj stërvitje. Gjuajtja e bajonetave, heshtave dhe shigjetave sot është bërë si një gjë e ndaluar, por nuk ka dyshim që vendin e tyre e kanë zënë llojet e ndryshme të qitjeve ushtarake. Asnjë musliman nuk thotë që mjete të reja, të cilat përdoren për ushtrime, nuk lejohet të shfrytëzohen sepse janë të reja! Por përkundrazi, ndoshta mund të jetë detyrë të përdoren sipas asaj që u sqarua.

Kështu që shembujt e përmendur, patjetër duhet të trajtohen sipas këtij sqarimi fetar, të cilit duhet t'i përmbahen të gjitha grupet islame.¹⁹⁷

¹⁹⁷) Sheriati ynë është zbritur për të realizuar dhe për të plotësuar dobitë dhe interesat për njerëzit në dynja dhe në Ahiret, si dhe për të zhdukur dhe eliminuar dëmet dhe të këqijat ose për t'i minimizuar ato në dynja dhe në Ahiret. Shatibiu ka thënë: "Sheriati është vendosur nga Allahu për të realizuar dobitë dhe interesat për robërit në dynja dhe në Ahiret (në të përsheptuarën dhe të vonuarën, të ardhmen) dhe për të shmangur dëmet dhe të këqijat prej tyre." El iz-z ibnu Abdus-sela thotë: "I gjithë Sheriati është në dobi dhe interes të njerëzve. Ai ose përmban shmangien e dëmeve, ose arritjen e dobive dhe realizimin e interesave."

Ibnul Kajjim thotë: "Sheriati është i bazuar dhe i themeluar mbi objektivin e realizimit të urtësive, dobive dhe interesave për robërit në jetën e dynjasë dhe të Ahiretit. Të gjitha rregullat dhe ligjet e Sheriatit janë të drejta, dobiprurëse dhe të vendosura në vendin e duhur. Çdo çështje që devijon nga drejtësia për në padrejtësi, nga mëshira për në të kundërtën e saj, nga dobia dhe interesi për në dëm, dhe nga urtësia, saktësia dhe preçiziteti për në kotësi, parregullsi dhe në konfuzion, nuk është prej Sheriatit. Ajo edhe sikur t'i mvishet Sheriatit me anë të keqinterpretimit, nuk i përket atij, sepse Sheriati është drejtësia e Allahut ndërmjet robërve të Tij dhe mëshira e Tij ndërmjet krijesave të Tij."

Nga kjo që sqaruar, bëhet e qartë se interesat dhe dobitë që i ka konsideruar Sheriati janë hajër, mirësi dhe në dobi të njerëzve në këtë dynja dhe në botën e përtejme, edhe sikur ndonjë njeri të mendojë ndryshe. Ndërsa gjërat që Sheriati nuk i ka pranuar dhe nuk i ka marrë në konsideratë, faktikisht nuk janë të dobishme për njerëzit, edhe sikur të mendohet se janë të tilla. Në këtë rast, për shkak se disa njerëz këto gjëra i konsiderojnë të dobishme, ato quhen interesa imagjinare (jo të vërteta).

Dobitë dhe interesat, për sa i përket pranimit dhe mospranimit në Sheriat, ndahen në tri lloje:

- 1) *Interesat e ligjërhuara*. Këto janë interesa që Sheriati i ka pranuar dhe i ka konsideruar si të dobishme, p.sh. interesi (dobia) i agjërit, drejtësisë, martesës, ligjit për të përfshirë në trashëgimi mashkullin dhe femrën etj.
- 2) *Interesat e papranueshme dhe të pakonsiderueshme*. Këto janë interesat që Sheriati nuk i ka pranuar dhe nuk i ka konsideruar të dobishme si p.sh. interesi i kamatës, bixhozit, imoralitetit etj.
- 3) *Interesat e lira, "el mesalihul murseletu"*. Këto janë interesat dhe dobitë për të cilat nuk ka argument specifik (të veçantë) në Sheriat që të tregojë për konsiderimin ose jo të tyre si të dobishme. Megjithëse në Sheriat nuk është folur për këto interesa në mënyrë specifike, bazat dhe parimet e Sheriatit e sqarojnë se a pranohen apo jo. Sheriati ynë ka kapacitet për t'u dhënë gjykim në lidhje me pranimin ose mospranimin, të gjitha mjetet dhe interesave të reja. Imam Ahmedi ka thënë: "Nuk ka asnjë çështje për të cilën nuk kanë folur selefët e Umetit. Ata kanë folur për çdo çështje në mënyrë të veçantë ose për llojin e tyre." Kështu, nëse ka argument specifik për një mjet ose interes, gjykimin merret prej tij, ndryshe u referohemi bazave dhe parimeve të Sheriatit, për të njohur gjykimin e interesit ose mjetit për të cilin bëhet fjalë. Si shembull për intereset e lira kemi grumbullimin e Kur'anit në kohën e sahabëve etj. Fetvaja e shejh Albanit bën fjalë për "el mesalihul murseleh". Ai ka sqaruar rastet, të ilustruara me shembuj, se kur janë mjetet dhe interesat e lira të pranueshme dhe kur janë bidate të papranueshme. Kjo që ka thënë Albani (siç thotë edhe vetë) është përmbledhje e sqarimit që ia ka bërë ibnu Tejmija kësaj çështjeje në "Iktidaus-siratil mustekim". Ibnu Tejmija në lidhje me këtë temë ka thënë: "Parimi i kësaj teme është siç vijon. Njerëzit nuk shpikin asgjë, vetëm në qoftë se e mendojnë të dobishme (interes), sepse nëse do ta besonin të dëmshme nuk do ta shpiknin, ngaqë nuk ka arsye, as logjike e as fetare që t'i bëjë ta shpikin atë. Në lidhje me atë që njerëzit e mendojnë interes të dobishëm, duhet të vërehet shkaku që e ka bërë të nevojshme shpikjen e tij. Në qoftë se shkaku dhe arsyeja që e bën të nevojshëm këtë mjet ose këtë interes, është diçka që ka ndodhur pas jetës së Profetit (salallahu alejhi ue selem), ndërkohë që shpikja e tij nuk është influencuar nga neglizhenca jonë në zbatimin e rregullave të fesë, në këtë rast mund të lejohet shpikja e asaj që është e nevojshme. Po kështu edhe kur arsyeja dhe nevoja për ta bërë ka ekzistuar në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem), por ai e ka lënë për shkak të ndonjë pengese që është zhdukur me vdekjen e tij (si p.sh. namazi i taravive me xhemat në xhaminë e tij, në kohën e tij). Ndërsa, në qoftë se nuk ka shkak dhe arsye që e bën të nevojshme shpikjen e mjetit (të interesit), ose shkaku që e bëri të nevojshme shpikjen e tij janë gjynahet e robërve, në raste të tilla nuk lejohet. Çdo gjë që arsyeja dhe shkaku për ta bërë ka ekzistuar në kohën e Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe ai nuk e ka bërë, nuk është interes i dobishëm, edhe sikur të imagjinohet i tillë. Gjërat, për shpikjen e të cilave shkaku dhe arsyeja ka lindur pas vdekjes së Profetit (salallahu alejhi ue selem) dhe nuk kanë ardhur si shkak i gjynaheve të krijesave, mundet të jenë interesa të dobishme (të pranueshme)."

Ky sqarim që ka bërë ibni Tejmije dhe pas tij Albani, është kundërpërgjigje ndaj dy linjave ekstreme në këtë temë.

Pyetje drejtuar shejh ibn Uthejminut rreth mjeteve dhe mënyrave të thirrjes

Pyetje - A janë mjetet dhe mënyrat e thirrjes në rrugë të Allahut të pandryshueshme, d.m.th. a lejohet të përfitohet nga mjetet dhe mënyrat bashkëkohore në thirrjen islame si p.sh. mjetet e informacionit etj., apo duhet të mjaftohemi me mjetet dhe mënyrat që janë përdorur në kohën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem)?

Përgjigje - Patjetër duhet të dimë një rregull i cili është: “El usail bihasebil me kasid” - Mjetet dhe mënyrat gjykohen sipas qëllimeve.

Sikurse kanë konstatuar dijetarët, çdo mjet ose mënyrë merr gjykimin sipas qëllimit të saj, përderisa nuk është e ndaluar, haram në fenë tonë. Nëse është e ndaluar s’ka hajër në të. Nëse është e lejuar dhe çon në arritjen e fryteve të mira në fenë tonë, atëherë nuk ka asgjë të keqe në përdorimin e tyre, por kjo nuk do të thotë që të dalim nga libri i Allahut dhe suneti i të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem) dhe prej këshillave e porosive të tyre. Mundet që ne ta konsiderojmë një mjet të ligjshëm, kurse të tjerët të mos e konsiderojnë të tillë, në këtë rast, duhet të përdorim ato mjete për të cilat bien dakord të gjithë.

Të parët janë ata që e kanë zhvlerësuar thënien e Profetit (salallahu alejhi ue selem) “çdo bidat është humbje”, duke e ndarë bidatin në bidate të mira dhe të këqija, dhe si rrjedhojë i kanë hapur rrugën vetes ose të tjerëve për të shpikur ibadete dhe mjete që janë shpikje dhe humbje në fenë e Allahut.

Të dytët janë ata njerëz në kohën tonë, që me të drejtë e cilësojnë çdo bidat humbje, sipas hadithit të lartpërmendur të Profetit (salallahu alejhi ue selem), por nuk dinë ose nuk marrin parasysh parimin e interesave të lira dhe dallimin ndërmjet tyre dhe ndërmjet bidatit, kështu që kanë refuzuar shumë mjete dhe interesa të dobishme për të cilat dëshmojnë bazat dhe argumentet e përgjithshme të Sheriatit, sipas sqarimit që dijetarët e kanë përmendur më lart. Madje disa njerëz, duke qenë në konfuzion dhe padituri të plotë në lidhje me parimet që kanë të bëjnë me bidatin, i cilësojnë shfrytëzuesit e disa mjeteve, megjithëse i përdorin sipas rregullave të Sheriatit, bidatçinj, ose në kundërshtim me metodën e selefëve!

Te librat e “usulul Fikhut” është përmendur përkufizimi i “el mesalihul el murseleh”, kushtet e lejimit dhe shfrytëzimit të tyre, si dhe diskutimet dhe mendimet e dijetarëve në lidhje me to. Në këtë shënim nuk mund të zgjerohemi më gjerë se kaq. Për më gjerë në lidhje me “el mesalihul murseleh” dhe dallimin ndërmjet tyre dhe bidatit, kthehu tek libri i lartpërmendur i Ibnu Tejmijes, vëll. 2, fq. 82-106 dhe “El iëtisam” i Shatibiut, fq. 607-635.

Gjithashtu duhet të dimë se është në interes të thirrjes së të rinjve për në Librin e Allahut dhe sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selem), që të fitohen e të zbuten zemrat e tyre përmes disa gjërave të lejuara, të cilat nuk e dëmtojnë as fenë, as thirrjen. Pra bëhet fjalë për përdorimin e disa mjeteve dhe disa gjërave për t'i afruar dhe për të fituar zemrat e tyre, në mënyrë që të mos mërzhiten e të largohen, nëse vërejnë një seriozitet të vazhdueshëm gjatë gjithë kohës.

(Shejh ibn Uthejmin. Marrë nga i njëjti kapitull, fq. 295.)

Pyetje drejtuar shejh ibn Uthejminit rreth mjeteve dhe mënyrave të reja të thirrjes

Pyetje - Ndër gjërat për të cilat thirrësit nuk janë pajtuar, janë mjetet dhe mënyrat e thirrjes. Ka prej tyre që i konsiderojnë këto mjete e mënyra si adhurime fikse (të pandryshueshme), dhe kështu i konsiderojnë gabimtarë ata që ushtrojnë aktivitete të ndryshme kulturore, sportive apo teatrale si mjete e mënyra që tërheqin e afrojnë rininë për t'i thirrur në fe. Ashtu siç ka edhe nga ata thirrës që mendojnë se mjetet dhe mënyrat e thirrjes ndryshojnë dhe rinovohen sipas kohës, kështu që thirrësit mund të përdorin çdo mjet e mënyrë të lejuar për të thirrur njerëzit në fe. Shpresojmë prej jush, i nderuar, të na sqaroni më të saktën në këtë çështje!

Përgjigje - Falenderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. S'ka dyshim se thirrja për në rrugën e Allahut është adhurim, sepse Allahu i Lartësuar ka urdhëruar për të në librin e Tij:

“Thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të bukur dhe debato me ta në mënyrën më të mirë!”

Gjatë kryerjes së thirrjes për në fenë e Allahut të Lartësuar, thirrësi ndjen se është duke bërë një detyrë që ia ka obliguar Allahu dhe në këtë mënyrë shpreson që të afrohet tek Ai. Nuk ka dyshim se gjëja më e mirë me të cilën mund të thirret për në fenë e Allahut është libri i Tij dhe suneti i të Dërguarit të Tij

(salallahu alejhi ue selem), sepse libri i Allahut është këshilluesi më madhështor për mbarë njerëzimin:

”O njerëz, ju ka ardhur këshillë prej Zotit tuaj, shërim për çka gjendet në gjokse (zemra) dhe udhëzim e mëshirë për besimtarët.”

Po ashtu edhe thëniet e Profetit (salallahu alejhi ue selem) janë fjalët më këshilluese e më të efektshme. Aq prekëse ishin këshillat e tij, saqë ndonjëherë shokët e tij i përshkruanin: “Na këshilloi i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) me një këshillë, prej së cilës u frikësuan, u zbutën zemrat dhe lotuan sytë.” Nëse njeriu posedon të tillë këshillë, s’ka dyshim se kjo është mjete dhe mënyra më e mirë për thirrje, pra me Librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). E nëse ndonjëherë dëshiron të shtojë mjete e mënyra të tjera të cilat nuk përmbajnë gjëra të ndaluara, nuk ka asgjë të keqe, por me kusht që këto mjete e mënyra të mos përmbajnë gjëra të ndaluara, si p.sh. gënjeshtër, role mosbesimtarësh ose role sahabësh në pjesë teatrale, apo role imamësh. Kam për qëllim imamët pas sahabëve, figura e të cilëve mund të ulet nga aktorët që luajnë rolin e tyre, sepse s’bëhen dot si ata.

Gjithashtu ndër gjërat e palejueshme është që në pjesët teatrale burrat t’u përngjajnë grave duke luajtur role të tilla ose e kundërta, se këta janë të mallkuar nga Profeti (salallahu alejhi ue selem), siç ka ardhur në hadith të saktë: “I ka mallkuar Profeti gratë që u përngjajnë burrave dhe burrat që u përngjajnë grave.”

Pra, e rëndësishme është që nëse thirrësi përdor ndonjëherë të tilla mjete e mënyra për afrimin e njerëzve dhe për fitimin e zemrave të tyre, nuk mendoj se ka ndonjë të keqe, përderisa nuk përmbajnë diçka të ndaluar.

Nuk jam dakort që këto mjete të shumohen e të bëhen si mënyra bazë e thirrjes për në fenë e Allahut, dhe kështu të mënjanohet libri i Allahut e suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selem) me pretekstin se njerëzit nuk ndikohen vetëm se me të tilla mjete e metoda. Madje mendoj që është e ndaluar, sepse në këtë mënyrë njerëzit drejtohen për tek diçka tjetër dhe jo për tek libri i Allahut dhe sunetit i të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), e kjo në thirrje është e urryer.

Por, nëse veprohen ndonjëherë nuk mendoj se ka ndonjë të keqe, përderisa nuk përmbajnë gjëra të ndaluara.

(Shejh ibn Uthejmin. Marrë nga i njëjti libër dhe i njëjti kapitull, fq. 292)

Shumëllojshmëria e tematikave dhe mënyrave të thirrjes është rahmet (mëshirë)

Pyetje - Dikush prej thirrësve zgjedh edukimin dhe mësimdhënien si mënyrë për të bërë dave, dikush tjetër zgjedh këshillën dhe përkujtimin në vende publike apo të hapura ku mblidhen gratë. Cili është mendimi juaj rreth kësaj dhe cila nga metodat ka më shumë sukses?

Përgjigje - Mendoj se është begatia e Allahut për robërit e Tij ajo që i ka bërë të zgjedhin mënyra të ndryshme nga njëra-tjetra për të bërë dave. Dikujt Allahu i ka dhënë forcën e të shprehurit, fjalët e tij janë tepër të qarta, prekëse dhe ngjitëse, ky person e konsideron “vazën” (këshillimin e njerëzve) si mjetin më të përshtatshëm për të. Dikujt Allahu i ka dhënë elasticitetin, butësinë dhe urtësinë. Në sajë të këtyre cilësive ai arrin të depërtojë në zemrat e njerëzve edhe pse nuk di të shprehet bukur, sepse ka prej thirrësve që janë të ditur, por nuk dinë të komunikojnë me njerëzit. Me të vërtetë mirësia e Allahut është e shpërndarë tek të gjithë robërit e Tij, por Allahu i ngriti disa prej tyre në shkallë të larta nderi mbi të tjerët. Mendoj se njeriu duhet të përdorë atë metodë që atij i duket më e dobishme dhe më rezultative, dhe të mos e ngarkojë veten e tij me diçka që është e pamundur për të. Gjithashtu duhet të jetë i sigurt në vetvete, se me ndihmën e Allahut, do të arrijë të mbyllë çdo problem që do t’i dalë përpara.

(Ibn Uthejmin, “Libri i daves”, nr. 5, 2/170-171)

Kasetat islame janë të domosdoshme

Pyetje - Cili është mendimi juaj për shitjen dhe shpërndarjen e kasetave me përmbajtje islame (ligjërata, fjalime islame), dhe cili është mendimi juaj rreth “enashidëve” (ilahive) me përmbajtje islame të cilat i këndojnë të rinjtë?

Përgjigje - Kasetat me tema islame të cilat përmbajnë ligjërata, fjalime dhe “ilahi” me kuptim të mirë, nuk ka gjë që të dëgjohen, madje kështu duhet.

(Marrë nga fetuatë e shejh ibni Bazit, “El xhihadu ued-da’ue”, fq. 280)

Gjykimi i shpërndarjes së kasetave si mjet për të bërë dave

Pyetje - Mua më pëlqen shumë thirrja dhe i përkushtohem asaj, vetëm se unë nuk di të shprehem shumë mirë. A është e mjaftueshme që unë të zgjedh një kasetë të një dijetari apo të një thirrësi të njohur në fe dhe t’ia dhuroj atë të afërmëve të mi ose muslimanëve në përgjithësi?

Përgjigje - Po, nëse kasetë është e përgatitur nga një dijetar i njohur për besimin e tij (Akiden e tij) të pastër. Nëse ti ia dhuron këtë kasetë dikujt prej vëllezërve të tu muslimanë, atëherë ke vepruar shumë mirë dhe për këtë do të shpërblehesh ashtu sikurse ai të cilit ia dhurove. Profeti (salallahu alejhi ue selem) në një hadith thotë: “Kush rrëfen për një punë të mirë, ai e ka shpërblimin njëlloj sikurse ai që e vepron atë punë.” (Muslimi, nr. 1893)

Ndërsa për ato gjëra që ti i di, nuk të ndalon askush që t’ua transmetosh me mënyrën më të mirë të gjithë besimtarëve, si p.sh. t’i nxisësh të falin namazin me xhemat, të japin zekatin, t’u tërheqësh vëmendjen prej përgojimit (gibetit), si dhe prej thashethemeve (nemimeh), mosrespektimit të prindërve, ndërprerjes së lidhjeve farefisnore dhe prej të gjitha gjërave të turpshme që i ka ndaluar Allahu, sepse ato punë janë të njohura mjaft mirë nga të gjithë muslimanët.

(Revista “El buhuth”, nr. 36, fq. 126-127, nga shejh ibn Bazi)

Merr dijen e tij dhe lëre punën (veprimin) e tij

Pyetje - Cili është mendimi juaj rreth disa thirrësve për në Islam, tek puna dhe marrëdhëniet e të cilëve vërehet singëritet, por veprojnë ndonjë gjynah apo ndonjë gjë të ndaluar? A pengon kjo gjë që të përfitohet prej punës dhe thirrjes së tyre?

Përgjigje - Nuk është kusht që thirrësi apo mësuesi të jetë i plotë, pa mangësi, në mënyrë që njerëzit të përfitojnë prej tij. Ata duhet të përfitojnë prej tij, edhe pse ka ndonjë mangësi në sjelljen e tij. Mirëpo të gjitha këto nuk pengojnë që ai të këshillohet dhe t'i jepen udhëzime të mira, me fjalë të buta dhe me mënyrën më të bukur.

Ndodh që mësuesi të jetë përtac në kryerjen e faljes me xhemat, kështu që për këtë duhet të këshillohet; mund t'i ketë rrobat të gjata, e për këtë duhet të këshillohet; mund të rruajë mjekrën, por këshillohet dhe i qartësohet thënia e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Shkurtoni mustaqet dhe lini mjekrat, kundërshtoni idhujtarët (ose mos u përngjani idhujtarëve).”

(Marrë nga fetvatë e shejh ibni Bazit “El xhihadu ued-da’ue”, fq. 275.)

Pyetje drejtuar shejh Albanit

- Një grup muslimanësh kanë mendime të gabuara, dhe megjithëse iu tërhoq vëmendja për t'i lënë ato, vazhduan me këmbëngulje në gabimet e tyre. Më pas u goditën me një sprovë, lëndim dhe shtypje si rrjedhojë e gabimeve. A lejohet t'i ndihmojmë dhe t'i nxjerrim nga kjo ngushticë, duke u bazuar në hadithin: “Muslimani është vëllai i muslimanit, nuk lejohet t'i bëjë padrejtësi dhe nuk i lejohet ta braktisë”, apo një gjë të tillë e kemi detyrë? Apo nuk lejohet që t'i ndihmojmë, sepse kjo i nxit që të gabojnë?

Përgjigje - Nuk ka dyshim se ndihmesa në gjërat e dobishme për fenë dhe dynjanë e tyre është detyrë. Fakti që nuk kanë pranuar disa gjëra të vërteta, të cilat janë ftuar që t'i pranojnë, nuk do të thotë që t'i braktisësh. Përkundrazi, është detyrë t'i ndihmosh për t'i shpëtuar nga humbja, sidomos kur nga përvoja kemi mësuar se shumë njerëz që vazhdojnë me këmbëngulje në devijim, pasi janë informuar rreth udhëzimit dhe së vërtetës, ka rezultuar se nuk e kanë bërë me qëllim të keq, por duke menduar se janë në të drejtën dhe se ajo që ftohen për ta pranuar është devijim. Prandaj thirrësi selefi duhet të durojë ndaj thirrësve të tjerë dhe të mos i ndërpresë shpresat për kthimin e tyre tek e vërteta.

Si përfundim patjetër duhet që t'i ndihmohet, përderisa ndihmesa nuk i bën të kundërshtojnë Sheriatin.

Pyetje - Selefizëm, sipas vështrimit të disa njerëzve, do të thotë ashpërsi dhe rreptësi. Kështu që disa thirrës janë të mendimit që të mos diskutohet rreth disa haramëve si p.sh. muzika, fotografia, rruajtja e mjekrës ose pulat e mbytura. Këtë e justifikojnë me faktin që këto gjëra i largojnë njerëzit nga davja, dhe selefijtë i konsiderojnë të rreptë dhe ekstremistë.

Përgjigje - Cilësimi i këtyre selefijve si të ashpër është një gjë e parëndësishme, sepse në çdo grup prej grupeve islame ka njerëz të ashpër, tolerantë, liberalë dhe të mesëm. Ajo që na intereson është “davja selefije”. Nëse e kanë kuptuar siç duhet se ajo bazohet në Kur'an dhe Sunet, atëherë thënia e tyre se nuk duhet diskutuar rreth rruajtjes së mjekrës, televizionit, fotografive dhe mishit të ndaluar, është e papranueshme. Ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse tregojnë se thirrja që bëjnë, nuk është thirrje për në Islamin e plotë e të tërësishëm që nuk thjeshtohet dhe përpjestohet, por është thirrje për në një pjesë të Islamit. Kjo është e mjaftueshme për të treguar se këta njerëz janë të devijuar nga Islami i vërtetë, për të cilin Allahu thotë në Kur'an: **“Padyschim feja e vetme e pranuar tek Allahu është Islami.”** (Ali Imran: 19)

Islami është fe e plotë, e përkryer, kështu që duhet marrë i gjithi në tërësinë e tij dhe jo të merret një pjesë dhe të lihet një tjetër. Për këtë arsye, në këta thirrës i konsiderojmë gabimtarë, sepse ata kërkojnë prej selefijve të shmangin diskutimin rreth këtyre gjërave për të kënaqur dëshirat e disa njerëzve, midis të cilëve ndoshta mund të jenë edhe vetë ata. Nga pyetja kuptohet se këta thirrës kanë nevojë përpara të tjerëve që të ftohen në Islam, në mënyrë që ta kuptojnë mirë, të bëhen entuziastë për të dhe t'i ftojnë njerëzit në të, sepse ai që nuk e posedon diçka, nuk mund t'ua japë atë të tjerëve.

Pyetje - Njerëzit u afrohen më shumë disa grupeve islame të cilët preferojnë heshtjen ndaj haramëve të tilla. A nuk mendoni se në këtë mënyrë realizojmë një dobi të madhe për muslimanët, kundrejt një dëmi të vogël që mund të shkaktohet?

Përgjigje - Çfarë dobie ka mbledhja e një grumbulli njerëzish që nuk e kuptojnë Islamin, rreth disa thirrësve që nuk e kuptojnë vetë atë? Ky grumbullim është i padobishëm. Cili prej dijetarëve e percepton Islamin si të tillë, që të merret një pjesë dhe të afatizohet një tjetër, sidomos kur pjesa që shtyhet është prej gjërave të ndaluara ose prej detyrave!? Ndërsa për sa i përket

gjërave të pëlqyeshme, në lidhje me to është e mjaftueshme të njohim thënien që bedeviu i tha Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Nuk shtoj më shumë se këto dhe nuk do të mangësoj.” I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) tha: “Nëse do të jetë i çiltër dhe i vërtetë do të fitojë.”

Në qoftë se do të thonim për gjërat e ndaluara ose për obligimet si p.sh. lënien e mjekrës, se duhet ta shtyjmë diskutimin rreth tyre, kjo do të thotë se ne jemi prekur nga një gjë e ngjashme me atë që i goditi të krishterët, pra keqinterpretimi dhe ndryshimi i librit.

Ne nuk e pranojmë parimin “qëllimi justifikon mjetin”. Nuk është ndër qëllimet tona që të shtojmë radhët me njerëz të painformuar dhe të paedukuar. Është më e dashur për ne që të mblidhen rreth nesh njerëz që kanë besim, kuptojnë dhe kanë formim e pjekuri, sesa të mblidhet shumica e njerëzve të cilët nuk dinë asgjë nga feja. Prandaj duhet ta harrojmë parimin e mendimit dhe praktikimit sipas masës së njerëzve apo shumicës, sepse argumentet e Kur’anit dhe Sunetit tregojnë se shumica nuk lavdërohet dhe se pakica është me të vërtetën: **“Pak nga robërit e Mi janë falenderues.”**

Pyetje - Ata bazohen në një hadith, ku një kafir erdhi tek i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe e pranoi Islamin, me kusht që të falte në ditë një namaz në vend të pesë namazeve. Profeti (salallahu alejhi ue selem) ia pranoi këtë kusht në mënyrë që të pranonte Islamin dhe të shpëtonte. A është i saktë ky hadith dhe a është argumentimi i tyre i saktë?

Përgjigje - Hadithi është i saktë, por për dy namaze, jo për një. Ndërsa argumentimi nuk është në vendin e duhur, sepse hadithi bën fjalë për mënyrën e thirrjes. Kur erdhi ky njeri që u trajtua siç u përmend në hadith, Profeti (salallahu alejhi ue selem) i ftonte njerëzit të falnin pesë namaze, apo dy? Natyrisht që i ftonte të falnin pesë.

Njerëzit që përmende, nëpërmjet metodës së tyre duan që të ndryshojnë realitetin e daves. Ata duan që të mos u sqarojmë njerëzve atë që e ka ndaluar dhe atë që e ka obliguar Allahu. Qëllimi i tyre nuk është që t’i ftojnë njerëzit në gjërat e fesë që i lenë pas dore, në mënyrë graduale dhe duke i renditur sipas rëndësisë që kanë. P.sh. nëse na vjen një njeri që nuk falet dhe mban unazë floriri në dorë, fillojmë ta ftojmë për faljen e pesë namazeve dhe e shtyjmë diskutimin rreth unazës së floririt që ai mban. Ata nuk kanë këtë qëllim, sepse sikur të ishte kështu ne do të pajtoheshim me ta. Por synimi i tyre është që të ndryshojnë daven. Sqarimi i Islamit, parimeve dhe çështjeve të tij është diçka, dhe trajtimi i një individi të veçantë është diçka tjetër. Për mënyrën se si i perceptojnë ata çështjet e daves, bazimi në këtë hadith nuk është korrekt, sepse

davja është një gjë, dhe trajtimi i individëve të ftuar për në thirrjen islame është gjë tjetër.

Pyetje - Si ka mundësi që i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ra dakort që personi të falte dy namaze në vend të pesë namazeve?

Përgjigje - Hadithi bën fjalë për mënyrën e thirrjes. Ka një hadith që vlen si përgjigje për një pyetje të tillë. Ai është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selem): “Ata do të japin sadaka dhe do të bëjnë xhihad kur të pranojnë Islamin.”¹⁹⁸ D.m.th. këta njerëz, nëse do të kënaqemi që për të pranuar Islamin të bëjnë pak, pasi janë mushrikë e kafirë, do të bëjnë më shumë në të ardhmen dhe do të zbatojnë më shumë obligime. Kjo është një metodë që e përmban politika e Sheriatit, por ndaj individëve dhe jo me vetë daven (realitetet, përmbajtjet dhe temat e daves). Davja duhet të përcillet ashtu siç është zbritur, pa mangësim, ndërsa individët trajtohen çdonjëri sipas asaj që i përshtatet gjendjes së tij.

Prandaj ne e konsiderojmë gabim fetvanë që është dhënë për një ngjarje, e cila thuhet se ka ndodhur para një shekulli, kur disa rusë vendosën që të pranonin fenë islame, por thanë se “nuk mundemi të lëmë alkoolin sepse vendet tona janë të ftohta”. Kështu që i dërguan një pyetje Myftiut të Stambollit në lidhje me këtë problem. Ai u tha që kjo nuk bën. Këtë përgjigje e konsiderojmë të gabuar, bazuar në këtë hadith. Detyra jonë është t’u përcjellim daven dhe t’u themi që alkooli është haram, prandaj duhet të përpiqeni ta minimizoni këtë sprovë (haram). Tani për tani dëshmoni se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut (La ilahe il-lall-llah) dhe se Muhamedi është i Dërguar i Allahut (Muhamed-dun rresulu-llah), faluni, agjëroni etj.. Përpiquni me sa mundësi që keni ta pakësoni haramin që bëni, në mënyrë që ta evitoni krejtësisht. Pra kjo është një metodë e politikës së Sheriatit në lidhje me mënyrën e ftesës dhe trajtimit të individëve të tillë. Ndërsa t’u thuhet: “Ta fshehim Sheriatin dhe të themi se nuk janë pesë namaze por dy”, kjo nuk është prej daves së vërtetë. Patjetër duhet bërë ndryshimi ndërmjet thirrjes në Islam dhe ndërmjet një individi që mund të trajtohet në një mënyrë të veçantë për ta tërhequr në Islam.¹⁹⁹

¹⁹⁸) Bëhet fjalë për hadithin që e transmetojnë Ahmedi dhe ebu Daudi nga Xhabiri, se fisi Thekif, kur i dhanë besën Profetit (salallahu alejhi ue selem) për pranimin e Islamit, i vunë kusht që të mos jepnin sadaka dhe të mos shkonin në xhihad, dhe se Xhabiri më vonë e ka dëgjuar Profetin (salallahu alejhi ue selem) të thoshte: “Do të japin sadaka dhe do të bëjnë xhihad kur të pranojnë Islamin.” Ndërsa hadithin për të cilin pyet pyetësi, e transmetojnë Ahmedi dhe Nesaiu.

¹⁹⁹) Thirrësi për në rrugë të Allahut duhet të ketë parasysh gjërat që vijojnë.
- Të ftojë me urtësi, e cila ndër të tjera nënkupton:

(Me pak ndrërhyrje dhe shkurtime nga “El havi”)

Pyetje drejtuar shejh Albanit - Çfarë mendimi keni për njerëzit që dalin në rrugë të Allahut për të bërë dave me pasuritë dhe vetet e tyre?

Përgjigje - Dalja që emërtohet në kohën tonë “dalje në rrugë të Allahut”, nuk është praktikuar në këtë mënyrë nga të parët e këtij Umeti, prandaj nuk

a) Fjalën e mirë dhe komunikimin e butë, siç ka thënë Allahu në Kur’an: **“Dhe i flisni atij butë e shtruar, mbase mund të marrë qortim ose mund të frikësohet (prej Meje).”** Ta Ha: 44.

b) Çështjet e fesë t’u paraqiten të ftuarve në mënyrë graduale, duke filluar nga Teuhidi deri tek ibadetet; nga besimi deri tek praktikimi dhe rregullat e fesë; nga themelet, bazat dhe principet deri tek ilustrimi i tyre me shembuj dhe nga pralajmërimi rreth shirkut e kufrit fillimisht, deri tek paralajmërimi rreth mëkateve të mëdha së dyti, rreth mëkateve të vogla së treti e kështu me radhë. Në hadithin e Abdullah ibnu Abasit ka ardhur se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) kur e dërgoi Muadhin në Jemen i tha atij: “Ti po shkon tek njerëz të cilët janë ithtarë të librit, prandaj gjëja e parë që duhet t’i ftosh në të, duhet të jetë dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Nëse të binden për këtë gjë, lajmëroi se Allahu u ka bërë obligim pesë namaze në çdo ditënatë...” Transmeton Buhariu e të tjerë.

- Të jetë i durueshëm, i matur dhe i vetëpërmbajtur. Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur’an: **“Bëj durim pra, (o Muhamed) për gjithçka që ata thonë dhe lartëso Lavditë e Zotit tënd para lindjes së diellit (falja e agimit) dhe para perëndimit (falja e mesditës dhe e pasditës).”** Kaf: 39.

- Gjatë thirrjes nuk lejohet të shfaqë asnjëlloj ashpërsie, nuk lejohet ta bëjë thirrjen si hakmarrje për veten e vet dhe nuk lejohet të përdorë ndonjë rrugë tjetër përveç rrugës së Profetit (salallahu alejhi ue selem), qoftë edhe sikur të hasë në lëndime e vështirësi. Allahu i Lartësuar, duke treguar thirrjen e të dërguarve dhe fazat e saj ka thënë: **“A nuk ju ka ardhur juve (o njerëz) lajmi i atyre para jush, i popullit të Nuhit, Adit dhe Themudit dhe i të tjerëve pas këtyre? Askush nuk i njuh ata veç Allahut. Tek ata shkuan të dërguarit e tyre me prova të qarta, por ata futën duart në gojë (duke ngrënë gishtat nga inati) dhe thanë: ‘Sigurisht që ne mohojmë atë me të cilën ju jeni dërguar dhe në të vërtetë jemi në dyshim të thellë në atë që ju na ftoni (në adhurimin e një Zoti të Vetëm)’. Të dërguarit e tyre u thanë: ‘(çfarë?) A ka dyshim për Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të tokës? Ai ju thërret ju (në adhurimin e njësisë së Tij dhe të jeni të bindur e të nënshtruar ndaj Tij), që t’ju falë gjynahet tuaja dhe t’ju japë afat për një kohë të caktuar’. Ata u thanë: ‘Ju s’jeni veçse qenie njerëzore si dhe ne! Ju doni të na largoni ne nga ata që kanë adhuruar gjithnjë prindërit tanë! Na sillni atëherë ndonjë forcë a provë të qartë (për çfarë thoni)’. Të dërguarit u thanë atyre: ‘Ne nuk jemi veçse qenie njerëzore si dhe ju, por Allahu dhuron Mëshirën e Tij mbi atë që Ai do nga robërit e Tij. Nuk është për ne që t’ju sjellim ndonjë fuqi bindëse ose provë të qartë, por veçse me Lejen dhe Vullnetin e Allahut dhe tek Allahu le të mbështeten e t’i varin shpresat besimtarët. Dhe përse të mos mbështetemi tek Allahu, ndërkohë që Ai padyshim na ka udhëzuar në rrugët që ndjekim? Ne padyshim që do të përballojmë me shumë durim gjithë dhimbjet që mund të na shkaktoni dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten ata që kërkojnë të mbështeten (diku)’. Ndërsa ata që nuk besuan u thanë të dërguarve të tyre: ‘Me të vërtetë që ne do t’ju përzemë nga vendi ynë, ose ju do të ktheheni në fenë tonë’. Por Zoti i tyre u frymëzoi këtë mesazh: ‘Vërtet që Ne do t’i shkatërrojmë Dhalimunët (mosbesimtarët, keqbërësit, shkatërruesit). Dhe padyshim që Ne do t’ju bëjmë ju të trashëgoni tokën pas tyre. Kjo është për të atillët që kanë frikë të qëndrojnë para Meje (Ditën e Llogarisë ose që kanë frikë Ndëshkimit Tim) dhe i tremben Kërcënimit Tim (për ndëshkim).’ (Ibrahim: 9-14) Pra të dërguarit e kanë filluar daven me përhapjen e dijes, me purifikimin (pastrimin) dhe me edukimin e pasuesve të tyre për t’iu shtuar besimi, siç ka thënë Allahu: **“Ai është i Cili çoi mes analfabetëve një të Dërguar (Muhamedin) nga mesi i tyre duke u kënduar atyre Vargjet e Tij, duke i pastruar ata (nga ndyrësia e mosbesimit dhe e politeizmit) dhe duke u mësuar atyre Librin (Kur’anin, Islamin dhe ligjet e të Dërguarit të Allahut, rrugën, sjelljen dhe vënien në jetë të ligjit të Allahut sipas shembullit të tij) Dhe vërtet që më parë qenë në gabim e humbje të qartë.”** (El Xhumatu: 2) Është e rëndësishme të bëjmë dallimin këtu, ndërmjet mënyrës së thirrjes në të cilën kërkohet butësi e urtësi gjithmonë, qoftë edhe ndaj bidatçinjve, dhe ndërmjet masave ndëshkuese si puna e bojkotimit e të tjera, të cilat ushtrohen ndaj mëkatarëve dhe bidatçinjve, sipas rregullave përkatëse që i kanë përcaktuar dijetarët. Disa njerëz, ngaqë i kanë përzierë gjërat, bëjnë thirrje me ashpërsi dhe vrazhdësi, gjë e cila bie në kundërshtim me rrugën e të dërguarve.**

është prej Sunetit. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka pas dërguar individë nga dijetarët e sahabëve, fukahatë dhe të mëdhenjtë e tyre, për t'i ftuar njerëzit në Islam. Ndërsa të dalin njerëzit siç bëhet sot, megjithëse më i dituri i grupit pohon se nuk është dijetar dhe se ka nevojë të mësojë, kjo lloj dalje në këtë mënyrë, nuk është praktikuar nga të parët tanë të mirë dhe as nga ata që kanë ardhur pas tyre, por ajo është shpikur në kohën tonë. Për këtë arsye ne i këshillojmë këta vëllezër që të ulen nëpër xhami, të gjunjzohen në radhë dhe të kërkojnë dijen, veçanërisht të marrin dijen e Kur'anit dhe të Sunetit. Kjo në mënyrë që të mësojnë se puna e mirë nuk është ajo që e konsideron të mirë njëri apo tjetri prej disa dijetarëve apo njerëzve të mirë, por puna e mirë është ajo që bëhet në përputhshmëri me Sunetin dhe sinqerisht për Allahun e Lartësuar.

Pyetje drejtuar shejh Albanit - Çfarë mendimi keni për bidatçinjtë dhe njerëzit me mendime Fikhu të gabuara?

Përgjigje - Me bidatçinjtë në përgjithësi dhe me njerëzit që kanë mendime Fikhu të gabuara, ne duhet të sillemi butë dhe të na vijë keq për ta më shumë sesa të hakmerremi ndaj tyre, siç bëjnë disa selefij të rinj! Këtë që bëjnë këta të rinj nuk e shikojmë të saktë. Njerëzit që kanë rënë në bidate dhe gabime kanë nevojë për mëshirë për dy arsye: ose nuk ka pasur kush t'ua përcjellë fjalën e Allahut në këto çështje konfliktuale, ose për arsye se ai që i ka ftuar nuk ka qenë i aftë për t'u përcjellë të vërtetën. Thirrësi nuk duhet të jetë i vrazhdë dhe i rreptë gjatë këshillës, por të thotë fjalën e tij dhe të vazhdojë të ecë në drejtimin e vet, sepse udhëzimi është në dorë të Allahut.

Sqarimet e ibnu Tejmijes lidhur me urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja

Dobia e urdhërimit për të mirën dhe e ndalimit nga e keqja duhet të jetë më e madhe se pasoja e tij negative (dëmi)

Për sa i përket urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, duke qenë se është një nga detyrimet ose aktet urdhëruese më të mëdha të Islamit, është thelbësore që përfitimet e tij (mirësitë) të jenë më të mëdha se dëmet që mund të shkaktojë (pasoja negative). Kjo është në përgjithësi shpirti i mesazhit të profetëve dhe i librave të shpallur, e Allahut s'i pëlqen kaosi dhe shkatërrimi.

Çdo gjë që Allahu ka urdhëruar është frytdhënëse (në mirësi) dhe përsosje e mirësisë. Allahu e ka lavdëruar “salah-un” (të drejtën, të mirën), i ka lavdëruar ata që sjellin drejtësi, mirësi e reforma dhe i ka lavdëruar ata që besojnë e bëjnë vepra të mira. Ndërsa shkatërrimin dhe shkaktuesit e tij i ka dënuar shumë herë në Kur’an. Pra, sa herë që pasojat negative në veprimet që bëjmë, janë më të mëdha se përfitimet, atëherë ato nuk janë pjesë e asaj që Allahu ka urdhëruar, edhe në qoftë se janë veprime të mira. Kjo, sepse besimtari duhet t’i frikësohet Allahut në lidhje me robërit e Tij dhe s’është në dorën e tij udhëzimi i tyre. Kjo është një pjesë e kuptimit të ajetit: **“O ju që keni besuar, vetja juaj është përgjegjësia juaj. Ata që largohen prej rrugës së drejtë nuk mund t’ju dëmtojnë ju në qoftë se kapeni fort pas udhëzimit.”**

Kapja fort pas udhëzimit arrihet duke zbatuar detyrimet e Allahut. Kur një besimtar zbaton detyrimet që ka në urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja, ata që s’besojnë dhe rruga e gabuar e tyre s’mund t’i bëjnë asgjë atij (besimtarit).

Metodologjia e urdhërimit për të mirën dhe e ndalimit nga e keqja

Urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja, ndonjëherë bëhet me zemër, ndonjëherë me gjuhë, e ndonjëherë me dorë (forcë fizike). Për sa i përket atij me zemër, ai është detyrim i çdo muslimani në çdo kohë a situatë, meqë praktikimi i tij nuk sjell vështirësi. Kush nuk e bën as këtë, s’është besimtar, ashtu siç ka ardhur në “Sahihun” e Muslimit nga ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ai që shikon prej jush një të keqe, le ta ndryshojë atë me dorën e tij, e nëse nuk ka mundësi, le ta ndryshojë me gojën e tij, e nëse nuk ka mundësi, le ta ndryshojë me zemrën e tij, dhe kjo është grada më e ulët e besimit.” Dhe gjithashtu në vijim të hadithit, sipas një varianti tjetër ka thënë: “Pas kësaj nuk mbetet prej besimit as edhe sa një farë mustarde.”

Ibnu Mes’udi u pyet njëherë: “Kush janë të vdekurit e gjallë?” Ai u përgjigj: “Ata që s’e kuptojnë të drejtën (të mirën) siç është dhe s’e dënojnë të keqen.”

Ai i referohej personit që përmendet në hadithin: “Sprovat i paraqiten zemrave si copat që i jepen rrogosdarit për të thurur rrogosin, fije për fije. Ajo zemër që i pranon dhe i thith ato, bëhet me një pikë të zezë dhe ajo që i refuzon bëhet me një pikë të bardhë. Kjo gjë vazhdon derisa të kemi dy lloje zemrash. Njëra e lëmuar dhe e pastër si një xhevahir, e cila nuk do të preket nga sprova të tjera për sa kohë të zgjasin qiejt dhe toka; tjetra e zezë dhe e njollosur si një tas

i kthyer përmbys ku nuk mund të qëndrojë as edhe një pikë ujë. Ajo as që e kupton të vërtetën e as e dënon të keqen, përveç asaj që përputhet me epshin e saj, në të cilin kjo zemër është e zhytur plotësisht.”

Vështirësitë e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit të së keqes

Dy grupe njerëzish gabojnë këtu:

- Të parët lenë pas dore detyrimet që kanë në të urdhëruarit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, duke keqinterpretuar ajetin: **“O ju që keni besuar, vetja juaj është përgjegjësia juaj...”**

Ebu Bekri e shpjegoi një herë këtë gabim në hutbe duke thënë: “O njerëz, me të vërtetë ju e lexoni këtë ajet, por ju e keqinterpretoni atë. Unë kam dëgjuar Pejgamberin (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: ‘Me të vërtetë, kur njerëzit e shikojnë bërësin e së keqes dhe s’e ndalojnë atë, atëherë Allahu do t’i ndëshkojë ata me një dënim të madh’.”

- Grupi i dytë kërkojnë t’i urdhërojnë për të mirën dhe t’i ndalojnë nga e keqja njerëzit me gojët dhe duart e tyre në çdo lloj situatë, pa pasur njohuri të mjaftueshme mbi Sheriatin, pa pasur durim a tolerancë, pa pasur parasysht përfitimet dhe dëmet (kush është më i madh), e pa pasur parasysht atë që është e mundëshme dhe atë që s’është. Ashtu siç na thuhet në hadithin e trasmetuar nga ebu Tha’leba el Khusheni: “...Urdhëroni për të mirën dhe ndaloni nga e keqja, derisa të shihni dëshirë të madhe për pushtet e fuqi, ndjekje të epsheve, preokupim për këtë botë dhe ndjekje nga çdokush të opinionit të vet, si dhe përderisa të shihni ndonjë situatë mbi të cilën s’keni ç’të bëni. Atëherë merruni me punët tuaja dhe lerini punët dhe çështjet e masës. Me të vërtetë, po vijnë ditë në të cilat të bësh durim është njësoj si të mbash thëngjillin e zjarrit në dorë.

Shpërblimi për ata që kryejnë detyrimet në ato ditë është sa për 50 burra (të kohës sonë) që veprojnë si ata.”

Ky grup urdhëron për të mirën dhe ndalon nga e keqja, duke kujtuar se po zbaton urdhërat e Allahut, por në të vërtetë ata janë kalues të kufijve të Tij. Në këtë mënyrë, shumë prej grupeve të devijuara e konsideruan veten si urdhërues të së mirës dhe ndalues të së keqes, si p.sh. havarixhët, mu’tezilët, shiitët dhe shumë të tjerë, të cilët gabuan në kuptimin e asaj që Allahu kishte urdhëruar, për sa i përket urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, për xhihadin dhe çështje të tjera. Dëmi që vjen nga ky lloj i urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja është më i madh se dobia e tij.

Rebelimi kundrejt imanit të muslimanëve

Për këtë arsye, Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) na urdhëroi të jemi të durueshëm kur bëhen padrejtësi nga ana e drejtuesve muslimanë dhe na e ndaloi të luftonim me ta përderisa ata falen, duke thënë: “Jepuni atyre çfarë ka të bëjë me ta dhe kërkojini Allahut atë që ju takon juve.” (Muslimi).

Pra, një prej parimeve kryesore të “ehli sune uel xhemaah” është besnikëria ndaj grupit të madh të Umetit islam, mosrebelimi ndaj drejtuesve të tij dhe qëndrimi larg betejave dhe vendeve ku ka fitne (ngatërresa, trazira).

Kurse grupet e humbura si mu’tezilet, e shohin luftimin mes drejtuesve dhe muslimanëve si pjesë e fesë së tyre. Ata e ngrenë fenë e tyre mbi pesë shtylla:

- Mbi Teuhidin, që në gjuhën e tyre do të thotë mohimi i emrave dhe cilësive të Allahut; mbi drejtësinë hyjnore, që për to do të thotë mohim i Kaderit; mbi teorinë e stadiit të mesëm (teoria e gabuar se cilido që mëkaton s’është më besimtar, por as kafir i plotë, pra është diku në mes) dhe mbi marrjen në mënyrë sipërfaqësore të kërcënimeve që Allahu bën kundrejt kryerjes së mëkateve të ndryshme. Pjesë e teorisë së tyre është edhe lufta kundrejt drejtuesve të muslimanëve.

Parimet themelore të urdhërimit dhe ndalimit

Çdo gjë që kemi thënë është rrjedhim i një parimi themelor, i cili thotë se kur përfitimi dhe dëmi përplasen (ose ekzistojnë të dyja dhe përzihen bashkë), në këtë rast duhet zgjedhur dobia, nëse është më e madhe se dëmi, dhe shmangia e dëmit nëse është më i madh se dobia. Urdhërimi dhe ndalimi, edhe pse sjellin arritjen e ndonjë përfitimi ose shmangien e ndonjë dëmi, duhet të marrin në konsideratë edhe të kundërtën që shkaktojnë. Në qoftë se në këtë lloj urdhërimi e ndalimi, përfitimi i humbur është më i madh se ai i fituar, ose dëmi i sjellë është më i madh se ai i larguar, atëherë kjo s’është më pjesë e asaj që Allahu ka urdhëruar. Kjo është e ndaluar, sepse dëmi është më i madh sesa dobia.

Dobitë dhe dëmet përcaktohen sipas kritereve të Sheriatit

Shkallët (gradat) e dobive dhe dëmeve përcaktohen sipas kritereve të sheriatit. Kur njeriu ka mundësi ta ndjekë një tekst të drejtpërdrejtë, s’i lejohet që t’i kthejë shpinën atij (bëhet fjalë kur ka argument nga Kur’ani e Suneti dhe

kërkon tjetër). Nëse nuk ka tekst për problemin e tij, atëherë mund të përdorë mendjen e tij për të bërë analogji (në disa raste). Shumë e rrallë është të mos gjejë mbështetje te citatat e shariatit, ai që i njeh ato, njeh mënyrën që tregon për rregullat dhe se si deduktohen rregulla prej tyre.

Pra, në qoftë se një individ apo grup, në mënyrë konstante bashkon diçka të keqe me të mirën dhe s'bën dot një të mirë pa tjetër (d.m.th. o të dyja, o asnjërën), në këtë rast nuk lejohet të urdhërohen për të mirën e as të ndalohen nga e keqja, por çështja duhet analizuar. Në qoftë se e mira (përfitimi) është më e madhe, atëherë duhet të urdhërosh për të edhe pse sjell dëm, pasi ky dëm është më i vogël sesa e mira. Dhe nëse ndalimi i një të keqeje sjell humbjen e një të mire më të madhe, atëherë s'duhet ta ndalosh këtë të keqe. Në fakt, ky lloj ndalimi i së keqes, do të thotë të bllokosh rrugën e Allahut dhe të japësh një shtytje për mosbindje ndaj Tij dhe Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem), si dhe për mosveprimin e së mirës.

Në anën tjetër, në qoftë se e keqja është më e madhe, atëherë duhet ndaluar, edhe pse kjo mund të sjellë humbjen e ndonjë të mire. Në këtë rast urdhërimi për këtë të mirë që sjell më shumë dëm sesa dobi, do të thotë të urdhërosh për keq dhe të futesh në rrugën e rebelimit ndaj urdhërave të Allahut dhe Pejgamberit të Tij (salallahu alejhi ue selem).

Në qoftë se e mira dhe e keqja për një çështje, janë të barabarta dhe s'i ndajmë dot, atëherë as duhet urdhëruar e mira, e as duhet ndaluar e keqja.

Kështu që ndonjëherë kërkohet urdhërimi për të mirën sepse është i dobishëm, i përshtatshëm dhe i rregullt, ndonjëherë kërkohet ndalimi nga e keqja sepse kjo është më e përshtatshme dhe ndonjëherë nuk kërkohet as njëri e as tjetri. Kjo, kur në një punë është e bashkëlidhur e mira me të keqen dhe janë të barabarta, gjë e cila ndodh në raste të caktuara. Për sa i përket llojit, e mira duhet urdhëruar në mënyrë absolute dhe e keqja duhet ndaluar në mënyrë absolute, kurse individi i veçantë apo grupi, pranohet dhe urdhërohet për të mirën që ka, dhe refuzohet e dënohet e keqja që ka, aspektet e tij të mira lavdërohen dhe ato negative kritikohen, në mënyrë të tillë që urdhërimi për të mirën të mos sjellë humbjen e të mirave (që personi ka) dhe as shtimin e së keqes tek ai. Gjithashtu edhe ndalimi i së keqes të mos i sjellë shtimin e të këqijave dhe humbjen e të mirave.

Kur çështja është e paqartë, besimtari duhet të përpiket që ta kuptojë derisa t'i bëhet e qartë, në mënyrë që të mos bëjë asnjë ibadet, përveçse me dije dhe me qëllim të saktë. Në qoftë se nuk qartësohet, ai është mëkatar. Kështu, mosveprimi i asaj që është detyrë, është mëkat dhe bërja e gjërave të ndaluara

në fushën e urdhërimit për të mirën, është mëkat. Kjo është një fushë e gjerë dhe e rrezikshme dhe s'ka ndihmë e fuqi tjetër përveç asaj që të jep Allahu. Një shembull i mirë nga Suneti, është kur Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) la të lirë Abdullah Ubejj ibën Selul dhe të tjerë udhëheqës të hipokrizisë si ai, për shkak të njerëzve të shumtë besnikë ndaj tyre. Heqja e së keqes që vinte duke ndëshkur ata, do të sillte humbjen e disa të mirave më të mëdha, sepse do të sillte zemërimin e fisit të Abdullahit dhe nxitjen e armiqësisë kundrejt Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) dhe muslimanëve. Gjithashtu do të sillte dhe neveritje të njerëzve, kur të dëgjonin se Pejgamberi i Allahut (salallahu alejhi ue selem) vriste shokët e tij. Prandaj, kur Abdullahi shpifi mbi Aishen dhe më pas mohoi të kishte bërë një gjë të tillë, Sa'ad bin Muadhi i foli rëndë, siç e meritonte, dhe i tregoi që ishte hipokrit, por Sa'd ibën Ubade (edhe pse një besimtar i mirë) e mori Abdullahin në mbrojtje dhe fiset e tyre mbështetën secili pjesëtarin e vet. Dhe aq shumë u rëndua gjendja, sa gati nuk plasi një luftë e përgjakshme.

Mëshira, durimi e toleranca, janë kushte të urdhërimit për të mirën

Këto detyrime (urdhërimi e ndalimi) duhen bërë me butësi e dhembshuri (mëshirë). Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk hyn butësia në ndonjë gjë e të mos e zbukurojë atë, e nuk hiqet prej ndonjë gjëje e të mos e shëmtojë atë.” (Muslimi dhe të tjerë)

Po ashtu ai thotë: “Oj Aishe, me të vërtetë Allahu është i Butë dhe e do butësinë. Ai jep me anë të butësisë, atë që s'e jep me anë të forcës (ashpërsisë).” (Muslimi dhe të tjerët)

Në të njëjtën kohë, ai që urdhëron për të mirën dhe ndalon nga e keqja, duhet të jetë durimtar, i matur e tolerant në përballimin e situatave të ndryshme, të persekutimeve dhe kundërshtimeve nga të tjerët. Në qoftë se je me të vërtetë urdhërues i së mirës dhe ndalues i së keqes, persekutimi (vështirësitë) do të të ndjekë patjetër. Në qoftë se urdhëruesi i së mirës dhe ndaluesi i së keqes s'është i durueshëm, tolerant dhe i zgjuar (s'tregohet i tillë) në këtë fushë, do të sjellë më shumë dëm sesa dobi. Allahu na tregon për Llukmanin që i thoshte djalit të tij:

“O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara.” Lukman: 17.

Pra, Allahu i urdhëroi profetët e Tij, e ato janë imamët (prijësit) e urdhërimit

për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, të jenë durimtarë, ashtu siç e urdhëroi dhe vulën e profetëve, Muhamedin (salallahu alejhi ue selem). Urdhëri për durim erdhi njëkohësisht me atë të përhapjes së Islamit. Kur Pejgamberi ynë (salallahu alejhi ue selem) u urdhërua për herë të parë që t'u paraqiste Islamit njerëzve, Allahu i shpalli suren "Mudethir", që erdhi pas pesë ajeteve të para të sures "Alak", e cila shënoi fillimin e profecisë:

"O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiq vërejtjen (duke i thirrur). Madhëroje Zotin tënd. Rrobat e tua pastroi dhe së keqes së ndyrë largoju. Mos u mburr me atë që jep e të duket shumë dhe për hir të Zotit tënd duro." Mudethir: 1-7.

Këto shtatë ajete që ngarkojnë Pejgamberin (salallahu alejhi ue selem) me përcjelljen e mesazhit hyjnor të krijesat, Allahu i Madhëruar i filloi me urdhërin për t'i paralajmëruar njerëzit prej ndëshkimit, dhe i mbylli me urdhërin për të bërë durim. Lajmërimi i njerëzve për ndëshkimin e Allahut, padyshim, është urdhërim për të mirën dhe ndalim nga e keqja, kështu që durimi është i domosdoshëm për atë që e kryen këtë detyrë. Për këtë çështje Allahu thotë:

"Ti bëj durim në vendimin e Zotit tënd se ti je nën mbikqyrjen Tonë, dhe kur të ngrihesh madhëroje me falenderim Zotin tënd." Et-Tur: 48.

"Bëj durim ndaj asaj që të thonë dhe largoju atyre i matur." El Muzemmil: 10.

"Ti (Muhamed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta, sepse ditën kur do ta përjetojnë atë (dënimin) që u është premtuar, atyre u duket sikur nuk kanë jetuar vetëm se një çast të shkurtër të ditës. Kumtesë e mjaftueshme! A mos shkatërrohet kush pos popullit të shfrenuar." El Ahkaf: 35.

"Bëhu i durueshëm në pritje të vendimit të Zotit tënd, e mos u bëj si ai që e gëlltiti peshku, i cili Ne na thirri kur ishte në pikëllim të thellë." El Kalem: 48.

"Bëhu i durueshëm. Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Mos u pikëllo për ata, as mos u brengos për dredhitë që bëjnë." En-Nahl: 127.

"Bëhu i durueshëm, se Allahu nuk ua humb shpërblimin mirëpunuesve." Hud: 115.

Pra, tri gjëra janë thelbësore: dituria, mëshira e durimi. Dija kërkohet përpara se të urdhërosh për të mirën e të ndalosh nga e keqja, mëshira gjatë praktikimit e durimi pas tij. Kjo ndarje nuk do të thotë të mohojmë faktin se këto tri cilësi duhet të jenë të pranishme në çdo kohë. Kjo që sqaruar mbështetet në thënien e disa dijetarëve të brezave të parë, të cilën e transmeton ebu Ja'la në librin e tij

të titulluar “El mu’temed”: “Askush s’duhet të urdhërojë për të mirën dhe të ndalojë nga e keqja, përveç atij që ka dije në atë që urdhëron dhe në atë që ndalon, atij që ka mëshirë e butësi dhe atij që ka maturi e durim në to.”

Vështirësitë e kushteve

Këto kushte të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, krijojnë një shkallë të lartë vështirësie për shumë njerëz, në disa situata të caktuara.

Prandaj disa kujtojnë se s’janë të ngarkuar me këtë detyrë, për shkak të disa mangësive që kanë në përgatitje dhe si rrjedhojë e lenë atë. Kjo i dëmton më tepër sesa i dëmton urdhërimi e ndalimi, me disa mangësi në një apo më tepër nga këto kushte. Por, ndoshta mund t’i dëmtojë edhe më pak. Mosplotësimi i kushteve të urdhërimit për të mirën është mosbindje ndaj Allahut, po ashtu edhe moskryerja e detyrës së urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja është mosbindje ndaj Tij. Ai që kërkon të largohet nga një vepër mosbindjeje ndaj Zotit (nga një haram) për tek një tjetër, është si ai që kërkon mbrojtje prej nxehtësisë së shkaktuar nga rrezet e diellit, duke u hedhur në zjarr, ose si ai që largohet nga një fe e rreme për tek një tjetër, ku e dyta mund të jetë më e keqe se e para, ose njësoj me të. Po kështu është edhe puna e atij që e lë pas dore urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja, si dhe e atij që nuk respekton e nuk plotëson kushtet e tij. Mund të jetë mëkati i atij që e lë pas dore më i madh, ose e kundërta, mund të jetë më i madh mëkati i atij që nuk plotëson kushtet, ose mëkati i të dyve mund të jetë njëloj.

Mosbindja ndaj Allahut sjell vështirësi dhe bindja ndaj Tij sjell lehtësim

Shenjat që Allahu na ka treguar në qiell dhe në vetet tona, si dhe ajo që ka përmendur në Librin e Tij, dëshmojnë se mosbindja ndaj Tij është shkak fatkeqësish dhe vështirësish. Dhe kjo vjen si pasojë e veprave që kryejnë vetë njerëzit. Po ashtu bindja ndaj Allahut sjell lehtësim e bollëk. Kështu, mirëbërja nga ana e robit, është shkak që Allahu të kënaqet e t’i japë begati atij:

“Çfardo e keqe që mund t’ju godasë, është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai ju fal.” Esh-Shura: 30.

Premtimet dhe kërcënimet për ndëshkim ishin pjesa e parë e shpalljes

Teuhidi, premtimet për shpërblime dhe kërcënimet për ndëshkim, ishin

pjesët e para të Kur'anit që zbritën.

Në "Sahihun" e Buharit, Jusuf ibn Muhak tregon: "Isha tek Aishja (radijallahu anha), nëna e besimtarëve, kur një iraken erdhi e tha: 'Cila mbulesë (qefin) është më e mira?' Aishja (radijallahu anha) i tha: 'Mjerë për ty, çfarë të shqetëson?' Ai tha: 'O nëna e besimtarëve, ma jep pak Mus'hafin tënd.' Aishja (radijallahu anha) tha: 'Pse?' Ai tha: 'Në mënyrë që ta radhis e ta rregulloj Kur'anin sipas tij, sepse po lexohet pa rregull e renditje.' Aishja (radijallahu anha) i tha: 'Çfarë shqetësimi të sjell ty kjo? Në të vërtetë në fillim u shpall një sure e shkurtër ku përmendet xheneti dhe xhehenemi. Pasi njerëzit u futën në Islam, u shpallën hallalli e harami. Në qoftë se gjëja e parë që do shpallej do të ishte: 'Mos pini alkool', ata (njerëzit) do të thonin: 'Ne s'do ta lëmë kurrë atë'. Në qoftë se do të shpallej: 'Mos bëni zina', do të thonin: 'Ne s'do ta lëmë atë'. Me të vërtetë ajeti i mëposhtëm iu shpall Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) në Mekë kur unë isha fëmijë i vogël dhe luaja:

'Jo, ora e gjykimit është më e rëndë dhe e pakëndëshme (sesa vështirësitë që mund të gjejë një musliman në rrugën e Allahut).'

Dhe suret "Bekare" dhe "Nisa" (që përmbajnë rregullat e hallallit dhe haramit) iu shpallën kur unë isha gruaja e tij.' Më pas Aishja (radijallahu anha) mori Mus'hafin dhe ia tregoi ajetet."

Ndryshimet e urdhërimit dhe ndalimit janë shkak i përçarjes

Kufri, ligësia dhe mosbindja janë shkak i së keqes. Një person apo grup mund të bjerë në mëkat e mosbindje. Dhe më pas një grup tjetër hesht dhe s'e mban detyrimin e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, e mëkati bëhet edhe i tyre. E një grup tjetër urdhëron e ndalon, por në mënyrën e ndaluar nga Allahu dhe ai bëhet edhe mëkat i tyre. Përfundimi është përçarja, ndryshimi, konflikti dhe e keqja. Kjo është një prej burimeve kryesore të kaosit dhe të së keqes në çdo kohë, në të kaluarën dhe të tashmen. Kjo sepse njeriu si natyrë është dhaloum (i dhënë pas së keqes) dhe xhahil (injorant, i paditur). Ky kriminalitet dhe kjo injorancë janë të llojeve të ndryshme. Mizoria dhe injoranca (çmenduria) e personit apo grupit të parë (që ishte kryeneç e s'i bindej Allahut) është e njërit lloj, kurse ajo e grupit të dytë e të tretë (që e panë të keqen dhe heshtën, si dhe urdhëruan në mënyrë joislame) është e llojit tjetër.

Çdokush që vëzhgon konfliktet dhe kaosin që përfshin muslimanët, do të shikojë se kjo është arsyeja. I gjithë ky pështjellim dhe e gjithë fitneja mes drejtuesve të Umetit, dijetarëve të tij dhe besimtarëve të thjeshtë, ka këtë si

originë. Gjithashtu këtu futen edhe rastet e devijimit si p.sh. ndjekja e epshit në çështje fetare a dynjaje, bidati në fe dhe pesimizmi në jetë. Këto janë të përgjithshme dhe vlejné për të gjithë racën njerëzore, si pasojë e prirjes së saj drejt së keqes. Disa njerëz mëkatojnë duke i bërë mizori vetes (duke mos iu bindur Zotit), e të tjerë duke bërë zina ose homoseksualitet, duke pirë alkool ose duke bërë krime të ndryshme ekonomike si p.sh. duke prerë në besë në (tregti), duke vjedhur apo duke marrë pjesën e tjetrit pa të drejtë, ose duke i bërë presion etj..

Kreu 10. Rregullat e trajtimit të fitneve (trazirave)

Nga Salih Ali Shejh

O vëllezër! Kërkoni mbrojtjen e Allahut nga fitnet të cilat djegin (shkatërrojnë) fenë, logjikën, trupin dhe çdo gjë tjetër! Kërkoni mbrojtjen e Allahut nga fitnet sepse në to nuk ka asnjë mirësi! I Dërguari (salallahu alejhi ue selem), nëpërmjet lutjeve të tij të shpeshta, i kërkonte Allahut mbrojtjen prej fitneve. Po kështu ai tërhoqte vërejtje për t'u ruajtur prej tyre. Për këtë arsye, imam Buhariu në librin e tij të saktë, e ka filluar kapitullin e fitneve me fjalën e Allahut:

“Ruhuni prej një fitneje e cila nuk godet vetëm ata që kanë bërë mizori prej jush (por i godet të gjithë)” (Enfalë: 25), dhe me vërejtjen që ka tërhequr i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) për t'u ruajtur prej fitneve.

Kjo për arsye se kur fitnet ndodhin, ato nuk godasin vetëm shkaktarin e tyre, por të gjithë, duke e lënë çdokënd të shtangur e pa fjalë. Prandaj detyra jonë është që të ruhem prej tyre para se ato të ndodhin dhe t'i largojmë vetet tona sa më shumë nga çdo gjë që çon në fitne, pasi shfaqja e shumtë e tyre është nga shenjat e Kohës së Fundit, siç ka ardhur në një hadith të saktë nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ku thuhet: “Do të afrohet koha, do të pakësohet puna, do të përhapet kopracia dhe do të shfaqen fitnet.” Kjo do të thotë se kur fitnet përhapen, ato sjellin probleme të cilat afrojnë Kijametin.

Mirëpo nga mëshira e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) mbi ne, është se ai ka tërhequr vëmendjen për t'u ruajtur nga të gjitha fitnet. Po kështu Allahu

na ka tërhequr vërejtjen për t'u ruajtur prej tyre me fjalën e Tij në suren “Enfalë”, të cilën e përmendëm më lart.

Ibn Kethiri, Allahu e mëshiroftë, në komentin e këtij ajeti ka thënë: “Edhe pse Allahu me këtë ajet i është drejtuar shokëve të Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem), ai është i përgjithshëm për çdo musliman, pasi i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka tërhequr vëmendjen për t'u ruajtur prej fitneve.

Ndërsa Alusi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Në ajetin **‘Ruhuni prej një fitneje e cila nuk godet vetëm ata që kanë bërë mizori prej jush** (por i godet të gjithë)’, fjala ‘fitne’ është komentuar si: nxitja në urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja; përçarja dhe kundërshtimi; lënia e kundërshtimit të bidatit kur ai shfaqet e të tjera veç këtyre.”

Pastaj thotë: “Për çdonjërin prej këtyre kuptimeve, veprohet sipas situatës, pra kur është koha e përçarjes dhe kundërshtimit, atëherë le të paralajmërojmë njëri-tjetrin për t'u ruajtur me anë të fjalës së Allahut: **‘Ruhuni prej një fitneje e cila nuk godet vetëm ata që kanë bërë mizori prej jush** (por i godet të gjithë).”

Pra, ndikimi i përçarjes dhe kundërshtimit nuk përqendrohet vetëm tek mizori, i cili i shkakton ato, por i përfshin të gjithë. Prandaj ne dëshirojmë t’jua përkujtojmë këtë çështje, pasi vëmë re një rizgjim të orientuar (të pjekur) të Islamit, me lejen e Allahut, në ato vende të cilat janë të kapura pas Teuhidit (njësimit) dhe që punojnë për thirrjen në të, në këtë kohë ku shohim të punojnë për thirrjen në Teuhid vetëm ata të cilët ka dëshiruar Allahu.

Prandaj është e nevojshme t’i përkujtojmë ata dhe vetet tona se është e domosdoshme t’i japim rëndësi dijes së dobishme, Akides së “selefët të drejtuar” dhe Akides së “ehli sunne uel xhemaah”.

Nga ky rizgjim i begatshëm, shpresojmë të përhapet feja e Allahut dhe të bëhet Sheriati dhe përqendrimi në këtë fe i dashur për njerëzit, ashtu siç shpresojmë nga kjo, që të përqendrohen të rinjtë tanë në dijen e dobishme, pasi ata janë shumë të interesuar për të dhe për fjalët e “ehli sunne uel xhemaah”.

Për këtë arsye e shoh si detyrë t’i përkujtoj dhe t’u sqaroj atyre gjithçka që di prej thënieve të imamëve tanë të “ehli sunetit”, të cilat bazohen në fjalën e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij (salallahu alejhi ue selem).

Nëse nuk hidhet një vështrim mbi gjendjen e fitneve dhe pasojat e tyre, atëherë gjendja në të ardhmen do të përkeqësohet, prandaj dijetarët duhet të kenë largpamësi dhe vlerësim real të situatës, gjë e cila i mëson ata si të sillen në pajtim me atë që do Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem), në situatat e reja të krijuara dhe në gjithçka që shfaqet në rast fitness. Për këtë

arsye, duhet që robi të vështrojë këto baza dhe rregulla, pasi me anë të tyre ai mbron veten e tij prej rënies në gabim. Nëse ne do t'i përmbahemi rregullave të Sheriatit dhe bazave që duhen respektuar, nëse do të punojmë me to dhe do të ndjekim gjurmët e tyre, atëherë do të arrijmë mirësi të mëdha, për të cilat nuk kemi për t'u penduar kurrë, me lejen e Allahut. Pra për çdo çështje duhet të njihet rregulli i saj, në mënyrë që ti o musliman, ta mbrosh veten tënde dhe të mos arrish në atë gjendje, përfundimi i së cilës është i panjohur për ty, dhe nuk e di se si do të përfundojë kjo çështje, me dëm apo dobi.

Nga sa u tha më sipër, mësohet se duhet patjetër të vështrojmë këto baza dhe rregulla, të cilat janë sqaruar nga “ehli suneti”.

Cili është përkufizimi i “Rregullit” dhe “Bazës”

Rregulli në një çështje është parimi i cili ndërlidh dhe përfshin çështjet e një kapitulli, ndërsa baza është diçka e tërësishme që përfshin çështjet e kapitujve të ndryshëm.

Kështu që është detyrë për ne të veprojmë sipas këtyre rregullave dhe bazave, me të cilat ka vepruar “ehli suneti”.

I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Ai që do të jetojë pas jush, ka për të parë përçarje të shumta. Prandaj kapuni pas sunetit tim dhe pas rrugës së halifëve të udhëzuar e të drejtë që vijnë pas meje. Kapuni pas tij dhe shtrëngojeni me dhëmbë!”²⁰⁰

Me të vërtetë, sahabët pas tij (salallahu alejhi ue selem) e përjetuan përçarjen dhe shpëtuan prej saj vetëm si rezultat i kapjes pas bazave të qarta, në të cilat ka qenë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dhe halifët e drejtë e të udhëzuar.

Dobitë që përfitohen nga ndjekja e këtyre rregullave dhe bazave

1- Ruajtja e rregullave dhe bazave e mbron muslimanin nga rënia në kuptime të cilat nuk i pohon Sheriati. Ndjekja e tyre e mbron të kuptuarit dhe përmirëson logjikën në perceptim.

Është e ditur se kur muslimani e percepton një çështje të caktuar pa u bazuar në rregullat dhe bazat, atëherë logjika e tij do të devijojë në drejtime të ndryshme, si në veprime me veten e tij ashtu edhe në familjen, shoqërinë dhe Umetin e tij.

) Hadith i saktë. E transmeton ebu Daudi, nr. 4596, Tirmidhiu, nr. 2676, ibn Maxhe, nr. 4344 dhe imam Ahmedi ²⁰⁰ në “Musnedin” e tij (4/126-127). Tirmidhiu ka thënë se është hadith hasen, sahih. Shejh Albani e ka saktësuar, shiko “Sahihut terhib”, nr. 37. Gjithashtu ibn Hibani dhe ebu Nuejmi e kanë saktësuar atë.

Nga sa thamë më lart, bëhet e qartë rëndësia e respektimit të këtyre rregullave dhe bazave sepse ato rregullojnë përfytyrimet e muslimanit, prej të cilave rrjedhin sjelljet e tij.

2- Një tjetër dobi e cila përfitohet nga respektimi i tyre, është mbrojtja e muslimanit prej gabimeve.

Nëse muslimani në rast të ndonjë ndodhie apo sprove, ndjek mendimin e tij dhe e zgjidh atë duke u bazuar në logjikën e tij dhe jo në rregullat dhe bazat e “ehli sunetit”, atëherë ai nuk mund të jetë i sigurtë nëse ka gabuar apo jo, kur dihet që pasojat e gabimit nuk janë të lavdëruara pasi ai përshkallëzohet, përhapet dhe ndoshta sa vjen e bëhet edhe më i madh.

Prandaj dhe themi se dobia e mbështetjes në këto rregulla dhe baza është mbrojtje nga rënia në gabim, sepse ato i ka vendosur “ehli suneti” në pajtim me argumentet që kanë ardhur dhe kushdo që ecën sipas argumentit dhe sipas “ehli sunetit” nuk ka për t’u penduar kurrë.

3- Një dobi tjetër e të pasuarit të këtyre rregullave dhe bazave është shpëtimi i muslimanit nga mëkatet.

Nëse muslimani do të veprojë sipas mendimit të tij dhe sipas gjithçkaje që ai e mendon si të drejtë, pa u bazuar në këto rregulla dhe baza, atëherë ai nuk do të jetë i sigurtë për shmangjen e mëkatit, pasi ai nuk e di se si do të jetë gjendja e tij në të ardhmen, përfshirë këtu fjalët apo veprat e tij. Mirëpo, nëse muslimani i përmbahet argumenteve të këtyre rregullave dhe bazave të përgjithshme, atëherë ai, me lejen e Allahut, ka për të shpëtuar prej mëkatit dhe Allahu ka për ta justifikuar atë, pasi ai u bazua në argument. Sa mirë ka vepruar ai që është sjellë sipas asaj që ka dëgjuar! Prandaj vëllezër muslimanë, nëpërmjet këtyre tri dobive qartësohet për të gjithë ne, domosdoshmëria e të vepruarit sipas këtyre rregullave dhe bazave, të cilat do të sqarohen në vijim.

Rregullat dhe bazat që do të sqarohen më poshtë, e marrin argumentin e tyre në njërin nga këto dy burime.

1- Nga argumentet e Sheriatit në Kur’an ose në Sunet dhe sipas këtyre argumenteve ka vepruar “ehli suneti”.

2- Nga praktikat e respektuara sipas të cilave kanë vepruar sahabët (shokët e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem), pas tyre tabiinët dhe pas tabiinëve imamët e “ehli sunetit”. Këta kanë përjetuar ngjarje (momente) konkrete gjatë jetës së tyre, në rastin kur shfaqeshin fitnet apo ndryshonin gjendjet. Në të tilla raste ata kanë vepruar duke u bazuar në argumente dhe duke i zbatuar ato praktikisht. Nëse edhe ne do të ndjekim rrugën e tyre dhe do të veprojmë sipas

asaj që kanë vepruar ata praktikisht, e nëse do të bazohemi në argumentet tek të cilat ata janë bazuar, atëherë nuk do të devijojë as shikimi e as logjika jonë.

Nga mëshira e Allahut mbi ne është se Ai nuk na ka lënë pa një model për ta marrë si shembull dhe për ta pasuar. Dijetarët e “ehli sunetit” janë modeli ynë që duhet ta ndjekim dhe pasojmë. Ne duhet t’i referohemi perceptimeve, mendimeve dhe fjalëve të tyre, pasi ata kanë njohur bazat dhe rregullat e përgjithshme të Sheriatit që duhet të kihet parasysh për t’u mbrojtur nga gabimet dhe shkarjet.

Prandaj është e qartë se është detyrë të veproni sipas këtyre rregullave dhe bazave të cilat do të përmenden më poshtë. Gjithashtu sqarohet dobia dhe domosdoshmëria e të vepruarit sipas tyre, dobi e cila ndjehet në shoqërinë dhe familjet tuaja. Kush ndjek rrugën e të udhëzuarit dhe i është dhënë sukses në atë që është e argumentuar, mirësia (tuba) është për të, si në rrugën, ashtu edhe në udhëzimin e tij, dhe ai kurrë nuk ka për t’u penduar.

Rregullat dhe bazat e Sheriatit, ndjekja e të cilave është detyrë gjatë sprovave (fitneve)

Rregulli i parë. Në rast sprovash apo të ndryshimit të situatës, është detyrë për çdokënd butësia, matura, vetëpërmbytja dhe mosnxitimi.

Kjo bazë është tepër e rëndësishme pasi tri cilësitë e mësipërme janë detyrë për çdokënd.

Butësia. Në një hadith të saktë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk gjendet butësia në diçka, vetëm se e zbukuron atë, dhe nuk largohet ajo prej diçkaje, vetëm se e shëmton atë.”²⁰¹

Dijetarët kanë thënë se fjala “diçka” në hadith është në trajtën e pashquar dhe vjen në një fjali mohore: “nuk gjendet butësia në diçka vetëm se e zbukuron atë”. Kështu që duke u mbështetur në rregullat e gjuhës arabe, gjykojmë se fjala “diçka” përfshin të gjitha gjërat, pra gjithçka. Kjo do të thotë se butësia është e lavdëruar në çdo çështje dhe një gjë e tillë ka ardhur e pohuar edhe në një hadith tjetër të saktë të Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) ku thuhet: “Allahu e do butësinë në çdo çështje.”²⁰² Këto fjalë, i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ia ka thënë Aishes, të bijës së Siddikut, ndërsa

) Hadith i saktë. Shejh Albani e ka saktësuar në “Sahihul xhami”, nr. 5654.²⁰¹

) Kjo është një pjesë e shkëputur nga hadithi i saktë që e transmeton Buhariu, nr. 6024, 6390 dhe Tirmidhiu, nr. 2701.²⁰²

Buhariu në librin e tij të saktë, ka veçuar një kapitull me titull “Butësi në çdo çështje”.

Pra në çdo çështje duhet të jesh i butë e i matur dhe jo nervoz e i ashpër, sepse askush nuk pendohet për butësinë, pasi prezenca e saj në diçka vetëm se e zbukuron atë. Ajo zbukuron mendimet dhe qëndrimet tuaja²⁰³ në çdo çështje që gjeni brenda vetes, në çdo çështje që ju duhet të gjykoni, dhe çdo gjë që ju dëshironi të bëni.

Pra, është detyrë që të jemi të butë e të mos nxitohemi dhe të mos i përkrahim të nxituarit dhe ata që shpejtojnë, sepse vetëm kështu do të jemi zbatues të fjalës së të Dërguarit tonë, Muhamedit (salallahu alejhi ue selem): “Nuk gjendet butësia në diçka, vetëm se e zbukuron atë.”

Atëherë zgjidh të bukurën, zgjidh çështjen e zbukuruar e të mirë dhe pastaj ruhu prej të shëmtuarës, pasi ajo e largon butësinë prej fjalëve, veprave dhe çështjeve.

Vetpërmbajtja, (gjakftohtësia, mosnxitimi). I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) i ka thënë Eshexh Abdil Kajsit: “Tek ti gjenden dy cilësi të cilat i do Allahu dhe i Dërguari i Tij, matura dhe vetpërmbajtja.”²⁰⁴

Vetpërmbajtja është cilësi e lavdëruar dhe për këtë Allahu thotë: **“Njeriu lut (Allahun) për të keqen, sikur e lut për të mirën dhe njeriu është gjithmonë i nxituar.”**

Dijetarët kanë thënë se ky ajet është qortim për njeriun e nxituar. Ai që ka cilësi të tilla duhet qortuar për to, prandaj edhe Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem) nuk ka qenë i nxituar.

Maturia. Maturia është një cilësi e lavdëruar, si në kohë sprovash, po ashtu edhe në rastin e ndryshimit të situatave, pasi duke qenë i duruar mund të njohësh dhe perceptosh më qartë realitetin. Për këtë në “Sahihun” e Muslimit transmetohet një hadith prej Lejth ibën Sadit, nga Musa ibën Alij dhe ky nga babai i tij, se el Musteured el Kurejshij, kur ishte bashkë me Amr ibën el Asin, tha se e kishte dëgjuar të Dërguarin (salallahu alejhi ue selem) të thotë: “Do të bëhet Kijameti dhe romakët do të jenë njerëzit më të shumtë.”²⁰⁵

Amr ibn el Asi i tha: “Shiko se çfarë thua!”

Ai iu përgjigj: “Po them atë që ka thënë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem)!”²⁰⁶

) Bëhet fjalë për rastin kur të kërkohet të mbash qëndrim rreth diçkaje.²⁰³

) Hadith i saktë. E transmeton Muslimi, nr. 171, Tirmidhiu, nr.2011, ibn Maxhe, nr. 4188 dhe Buhariu në “El 204 edebul mufred”, nr. 585, 586. Shejh Albani e ka saktësuar.

) Hadith i saktë. E transmeton Muslimi, nr. 7279.²⁰⁵

) Përkthimi është rregulluar sipas transmetimit të Muslimit.²⁰⁶

Amr ibn e Asi i tha: “Nëse është kështu, kjo ndodh sepse romakët zotërojnë katër cilësi. Ata janë njerëzit më të matur në sprova; janë njerëzit që zgjohen (rimëkëmben) më shpejt pas goditjes...”, dhe kështu i numëroi katër cilësi të tyre duke i shtuar edhe një të pestë.

Dijetarët kanë thënë se Amr ibn el Asi, me fjalën e tij nuk ka pasur për qëllim lavdërimin e romakëve të krishterë e kafirë, por t’u bëjë të ditur muslimanëve se romakët do të ekzistojnë deri në Ditën e Kijametit dhe do të jenë më të shumtët në numër, pasi ata janë njerëzit më të matur në sprova. Kjo i bën që ta analizojnë me kujdes çdo çështje, ta zgjidhin atë dhe të mos humbin as veten dhe as miqtë e tyre.

Kjo është një vërejtje tepër e imtësishme, ku i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka sqaruar se nuk ka për t’u bërë Kijameti derisa romakët të jenë njerëzit më të shumtë në numër.

Amr ibn Asi ka sqaruar: “Sepse ata zotërojnë katër cilësi”. E para (e cila na intereson prej tyre) është se ata janë njerëzit më të matur në fitne. Kjo do të thotë se kur shfaqen sprovat dhe ndryshojnë situatat dhe gjendjet, ata tregohen të matur dhe nuk nxitohen e as zemërohen, me qëllim që të mbrojnë shokët e tyre të krishterë nga fitnet dhe vrasja, pasi ata e dinë që kur sprovat shfaqen, do të bien edhe mbi ta. Për shkak të kësaj cilësie, ata do të jenë njerëzit më të shumtë në numër deri në ndodhinë e Kijametit.

Prandaj çuditemi përse të mos jemi ne, ata që e posedojnë këtë cilësi për të cilën Amr ibn el Asi i ka lavdëruar romakët, kur ne duhet të jemi të parët që të pajisemi me çdo cilësi pozitive që gjejmë tek të tjerët.

Maturia është një prej cilësive të lavdëruara në çdo çështje, pasi ajo ndriçon logjikën në fitne, duke sjellë si pasojë butësinë dhe mosnxitimin. Kjo dëshmon për gjykimin dhe dijen (largpamësinë) e atij të cilit i është dhënë kjo cilësi.

Kjo është baza dhe rregulli i parë të cilin “ehli suneti” e ka respektuar në rast sprovash dhe ndryshim situatash.

Këto rregulla dhe baza janë përmendur të përziera këtu, për shkak të përfshirjes së tyre tek njëra-tjetra nga ana kuptimore.

Rregulli i dytë. Kur shfaqen sprovat apo ndryshojnë situatat, nuk duhet gjykuar mbi to pa i njohur dhe kuptuar mirë dhe duhet t’i përmbahemi rregullit: “Gjykimi mbi diçka është pasojë (rrjedhojë) e mënyrës së perceptimit të saj.”

Kësaj baze i janë përmbajtur të gjithë njerëzit e ditur para dhe pas Islamit. Argumenti i Sheriatit për këtë bazë tek ne, gjendet në Librin e Allahut: “**Mos ndiq atë gjë për të cilën nuk ke dijeni...**” El Isra: 36.

Kuptimi i këtij ajeti është: Ruhë nga të folurit mbi një çështje, rreth së cilës nuk ke dituri dhe nuk ke një përfytyrim të qartë. Nëse je udhëheqës, drejtues, shembull për të tjerët, apo gjykues, ruhu akoma më tepër, pasi ‘gjkimi mbi diçka rrjedh prej mënyrës së perceptimit të saj’.

Ky është një rregull të cilin ju e përdorni në çështjet tuaja të zakonshme dhe në situata të ndryshme, por gjithkush që ka logjikë duhet patjetër ta ketë parasysh këtë bazë, pasi asnjë sjellje nuk është e rregullt nëse nuk merret parasysh ajo, dhe nëse nuk bëhet një gjë e tillë, atëherë padyshim që do të gabohet.

Prandaj dhe Sheriati e ka vendosur atë në mënyrë të padiskutueshme dhe e ka sqaruar në formën më të mirë.

Për të sqaruar akoma më tepër këtë bazë, le të përmendim disa shembuj.

- Nëse ndonjërit prej jush do t’i drejtohej pyetja: “Cili është gjykimi i Islamit në lidhje me *bejul murrabeha* (shitblerjen me fitim).”²⁰⁷

Meqenëse një gjë e tillë është e ndaluar, atëherë arrijmë në përfundimin se kjo lloj tregtie nuk është e lejuar.

Dikush mund të përgjigjet: “Meqenëse fitimi është i lejuar, dhe në lidhje me të s’ka asgjë të keqe në Sheriat, atëherë arrijmë në përfundimin se edhe “shitblerja me fitim” është e lejuar dhe nuk ka asgjë të keqe në të.

Mirëpo një gjykim i tillë rreth kësaj çështjeje është gabim i qartë, pasi dhënësi i përgjigjes nuk arriti ta kuptojë se cili ishte qëllimi i pyetësit me fjalën e tij “tregti me fitim”. Ai mendoi se këtu bëhej fjalë për fitimin e nxjerrë nga shitja. Dhe për shkak të këtij përfytyrimi të gabuar, gjykimin fetar e dha të gabuar, sepse gjykimi i Sheriatit duhet të bazohet në një perceptim të qartë të realitetit të çështjes për të cilën bëhet fjalë.

Ndërsa për sa i përket “shitblerjes me fitim”, ajo është një formë e ndaluar tregtie, të cilën e përdorin disa banka islame ose joislame, për marrjen e kamatës nëpërmjet mashtrimit.

- Një shembull tjetër që qartëson rregullin “Gjkimi mbi diçka rrjedh prej mënyrës së perceptimit të saj” është nëse dikush prej jush do të pyetej: “Cili është gjykimi islam mbi grupin “Dëshmitarët e Jehovahit”. Cila do të ishte përgjigja?

) Kjo lloj shitblerje, sipas dijetarëve të Fikhut, do të thotë shitja e një malli me të njëjtin çmim që është blerë, plus një fitim të njohur nga të dyja palët. Ndërsa sipas juristëve muslimanë bashkëkohorë dhe ekspertëve ekonomikë të bankave islamike, ajo do të thotë të shkojë klienti në bankë dhe të kërkojë prej saj që ajo të blejë për të një mall të caktuar me cilësi të përcaktuara qartë. Kontrata e shitblerjes bazohet mbi premtimin që i jep klienti bankës për ta blerë prej saj mallin për të cilin kanë rënë dakord, me një përqindje fitimi e cila i kalon bankës. Klienti do ta paguajë çmimin me këste, sipas mundësive të tij.

Nëse i pyeturi do të përgjigjej: “Unë nuk kam njohuri rreth këtij grupi dhe as që kam dëgjuar diçka për të më parë”, atëherë ai nuk mund të japë gjykim rreth tij dhe as të sqarojë gjykimin e Sheriatit në lidhje me këtë grup, pasi ai nuk e ka perceptuar të kuptuarit se cili është ai dhe cilat janë parimet e tij. A i përket ai Islamit, krishtërit apo hebraizmit? Ai mund të japë një gjykim rreth tij, vetëm pasi ta ketë njohur atë.

Meqenëse një gjë e tillë u bë e qartë, atëherë për të ruajtur të drejtën dhe për të shpëtuar veten e tij, gjithashtu për të ruajtur të drejtën e muslimanëve në përgjithësi dhe për të qenë i mbrojtur nga të folurit rreth Allahut pa dije, nuk i lejohet as gjykatësit, as myftiut dhe as atij që flet rreth çështjeve të Sheriatit të gjykojë, vetëm se pasi të ketë arritur këto dy gjëra:

Së pari, përfytyrimin e plotë të çështjes së parashtuar, në atë formë që ajo të mos ngatërrohet me ndonjë çështje tjetër, pasi ndonjëherë mund të ndodhë që disa çështje të ngatërrohen si pasojë e ngjashmërisë dhe përafërsisë ndërmjet tyre. Kjo bën që të të shkojë mendja tek ndonjë çështje tjetër e ngjashme dhe jo tek ajo e duhura, dhe si rrjedhojë bie në gabim.

Së dyti, diturinë mbi gjykimin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem) rreth çështjes në fjalë dhe jo rreth çështjeve të ngjashme me të.

Nëse ky kusht realizohet, atëherë lind një pyetje e rëndësishme, të cilën dikush mund ta shtrojë. Si mund të arrihet përfytyrimi i saktë tek cili duhet të mbështetemi, rreth një çështjeje të caktuar, pasi mund të ndodhë që çështjet të jenë të dyshimta ose të ngjashme, disa të tjera të jenë problematike e për disa të tjera mund të ndodhë që të mos gjej askënd që të m’i sqarojë dhe të m’i përshkruajë ato në mënyrë të saktë?

Atëherë, përgjigja ndaj një pyetje të tillë është se perceptimi i saktë mbi një çështje mbi të cilin mbështeten rregullat e Sheriatit, duhet të plotësojë dy kushte.

Së pari, personi prej të cilit kërkohet sqarimi i çështjes duhet të jetë vetë pyetësi, pasi është ai i cili e ka këtë problem dhe kuptimi i saktë i kësaj çështjeje arrihet duke u mbështetur në sqarimin e tij.

Në këtë rast myftiu (gjykuesi i çështjes), ia sqaron pyetësit gjykimin rreth problemit, duke u mbështetur në sqarimin që mori prej tij.

Së dyti, perceptimi i saktë i çështjes, mund të arrihet duke u mbështetur në dëshminë e personave të besueshëm dhe muslimanë, të cilët nuk gabojnë në dëshminë e tyre, gjë e cila shmang dhe gabimin në gjykimin rreth saj.

Nga sa thamë, kuptojmë se përcjellësi i çështjes duhet të jetë i besueshëm dhe i drejtë.

Në rastin kur shfaqen sprovat dhe ndryshojnë situatat, nuk lejohet që të bazohemi tek fjalët e ndonjë mosbesimtari, duke përmendur të kuptuarit, analizën apo sqarimin e tij në media të ndryshme, qofshin këto elektronike apo të shkruara.

Në Sheriat, nuk lejohet që mbi këtë të bazohet gjykim, por ai duhet të bazohet në faktet që sillen nga muslimani i drejtë dhe i besueshëm. Po kështu veprohet edhe me hadithet e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem). Ato nuk pranohen prej çdokujt, por vetëm nëse zinxhiri i transmetuesve të tyre përbëhet nga përcjellës të drejtë e të përpiktë, nga transmetues të tjerë si shembulli i tyre e kështu deri në fund të zinxhirit.

Por nëse dikush në zinxhirin e transmetuesve është mëkatar (i prishur apo i shthurur), ose e përzien hadithin me diçka tjetër, hadithi i tij nuk pranohet dhe nuk vlen si bazë për gjykimet dhe rregullat e Sheriatit. Prandaj kësaj çështjeje i duhet kushtuar rëndësi.

Ta përmbledhim me pak fjalë atë që kemi thënë deri tani.

Themeli i bazës “Gjykimi mbi diçka rrjedh prej mënyrës së perceptimit të saj”, është vetë perceptimi, i cili është i saktë në Sheriat, vetëm nëse bazohet në sqarimin e muslimanit të drejtë e të besueshëm, ose prej vetë shpjeguesit të çështjes, edhe nëse ai është mëkatar.

Rregulli i tretë. Drejtësi dhe paanshmëri në çdo çështje.

Muslimani duhet t’i përmbahet drejtësisë dhe paanshmërisë në çdo çështje. Allahu thotë:

“Kurdoherë që të flisni mbani drejtësi, edhe nëse çështja mund t’i takojë një të afërmi tuaj...” En Aam: 52.

“Të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë sepse ajo është më afër devotshmërisë.” El Maide: 8.

Kjo çështje është sqaruar plotësisht (në Kur’an dhe Sunet) se drejtësia patjetër duhet të mbahet si në fjalë, ashtu edhe në gjykime. Ai që nuk mban drejtësi në fjalën apo gjykimin e tij, nuk e ka ndjekur Sheriatin ashtu siç duhet, që të shpresohet se do ta çojë në shpëtim.

Por, cili është kuptimi i drejtësisë dhe paanshmërisë për të cilën bëhet fjalë në këtë bazë?

Kuptimi i drejtësisë dhe paanshmërisë në gjykim, ka të bëjë me paraqitjen e çështjeve pozitive dhe të atyre negative, gjithashtu me paraqitjen e anëve që janë në interesin tënd ose jo, dhe më pas me vlerësimin e saktë të të gjitha këtyre. Kështu duhet të bëhet gjykimi. Kjo e mbron muslimanin të mos i

mveshë Allahut, Sheriatit, dhe ligjeve të Allahut për krijim dhe për rregullimin e punëve të krijesave, diçka që është në kundërshtim me atë që ka urdhëruar vetë Ai.

Pra duhet që patjetër të kesh në mendje si të bukurën, po ashtu edhe të shëmtuarën e një çështjeje, që të arrish në konkluzionin e duhur fetar. Në këtë mënyrë përfytyrimi yt, fjala jote, perceptimi dhe mendimi yt do të të shpëtojnë nga sprova, inshaAllah.

Kjo bazë është tepër e rëndësishme dhe patjetër që për të duhet të tregohet kujdes. Ai i cili nuk e vlerëson siç duhet, bën që epshi të hyjë në zemrën e tij nga të gjitha dyert e saj, dhe nuk ka siguri se ai nuk do ta hapë portën e epshit të tij edhe për të tjerët. Duke qenë i tillë, përfshihet në fjalën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): “Kush vepron një të keqe (kush përhap një traditë të keqe), ai ka mëkatin e saj dhe mëkatin e atyre që e veprojnë atë, deri në Ditën e Kijametit.”

Por e keqja bëhet akoma më e madhe, nëse veprimi kryhet prej atij që bën pjesë tek të diturit dhe “udhëzuesit” (drejtuesit), pasi ai është shembull e model për të paditurit (inJORANTËT) dhe për ata që zotërojnë një dije mjaft të pakët.

Pra, në të gjitha çështjet tona, duhet të tregojmë kujdes për këtë bazë dhe kushdo që shpëton prej epshit të tij, Allahu do ta shpëtojë atë, si në dynja, po ashtu edhe në ahiret.

Rregulli i katërt. Është ajo që argumenton fjala e Allahut:

“Mbahun i (kapuni) fort, të gjithë së bashku pas litarit të Allahut (Kur’anit) dhe mos u ndani (përçani).”

Këtë ajet e ka sqaruar i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) duke thënë: “Është detyrë për ju të kapeni pas xhematit dhe t’i ruheni ndarjes.”²⁰⁸

Po kështu në një hadith tjetër të transmetuar nga Abdullahu, i biri i imam Ahmedit (në “Zavaid musned ebih”) thuhet se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Bashkimi është mirësi, ndërsa ndarja është ndëshkim.”²⁰⁹

Ndarja me të gjitha llojet e saj, qofshin këto në mendime, fjalë apo vepra, është ndëshkim me të cilin Allahu ndëshkon cilindo që kundërshton urdhërin e Tij dhe cilindo që largohet prej udhëzimit të Tij drejt një rruge tjetër. Dhe i kapur pas xhematit quhet ai i cili është i kapur pas xhematit të “ehli sunetit” dhe që ndjek prijësit dhe dijetarët e tij, ndërsa ai i cili ndahet prej tyre, nuk ka siguri

) Hadith i saktë. E transmeton Tirmidhiu, nr. 2165 dhe thotë se është hasen, sahih. Shejh Albani e ka saktësuar atë ²⁰⁸ në “Kitabus suneh” të ibn ebi Asim, nr. 88 dhe në “Sahihul xhami”, nr. 2546.

) E transmeton Ahmedi në “Musnedin” e tij dhe ibn ebi Asim në “Kitabus-suneh”, nr. 98. Shejh Albani e ka ²⁰⁹ cilësuar si hasen në “Sahihul xhami”, 3109.

për veten e tij, nëse është apo jo prej atyre që kanë rënë në përçarje dhe që ndëshkohen prej Allahut, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Lusim Allahun që të na shpëtojë ne dhe të gjithë vëllezërit tanë muslimanë nga e gjithë kjo. Prandaj dhe i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Bashkimi është mëshirë, përçarja është ndëshkim.”

Bashkimi me të gjitha llojet dhe cilësitë e tij, si në udhëzim, po ashtu edhe në hak (në të vërtetë), është mëshirë nga Allahu mbi robërit e Tij, ndërsa përçarja është ndëshkim dhe në të nuk ka kurrë mirësi.

Prandaj pas fjalës së Tij: **“Mbahuni (kapuni) fort, të gjithë ju së bashku pas litarit të Allahut (Kur’anit) dhe mos u ndani (përçani)”**, Allahu në ajetin tjetër thotë: **“Le të jetë nga ju një grup që ftojnë njerëzit në mirësi (udhëzojnë në të mira) dhe të ndalojnë të keqen. Të tillët janë ata të shpëtuarit.”**

“Mos u bëni si ata të cilët u përçanë dhe u ndanë mes tyre, pasi u patën ardhur prova të qarta. Dhe mu për këta do të ketë ndëshkim të madh.”

Pra nuk ka siguri nga përçarja, devijimi dhe ndjekja e udhëzimit jo të drejtë, për ata të cilët u përçanë, si në fjalët, po ashtu edhe në veprat e tyre, pasi mbi ta zbritën argumentet dhe udhëzimi i drejtë.

Prandaj është detyrë për ne që të kapemi pas xhematit të “ehli sunetit”, t’i përmbahemi fjalëve të tij, të mos devijojmë nga bazat dhe rregullat e tij dhe as nga ajo që kanë vendosur dijetarët e tij. Ata janë dijetarë të aftë, janë të mëkëmbur, të vendosur në dije dhe zotërojnë vlerësim të përpiktë. Ata dinë parimet (themelet, bazat) e “ehli sunetit” dhe argumentet e Sheriatit, dinë atë që shumë prej njerëzve nuk e dinë dhe çka nuk e dinë shumë prej pjesëmarrësve në grupet e dijes.

Shiko se si veproi Abdullah ibn Mesudi kur ishte ne haxh me Uthman ibn Afanin.

Uthmani plotësoi namazin, fali në Mina katër rekate, ndërkohë që sipas sunetit, në Mina namazet katër rekatëshe falen vetëm dy rekate. Megjithatë Uthmani mendoi t’i falte ato me katër rekate, sipas një interpretimi të Sheriatit të cilin ai e përmendi. Pavarësisht nga kjo, ibn Mesudi thoshte: “Suneti i Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) ka qenë që në Mina, namazet katër rekatëshe i falte vetëm dy rekate.”

Të tjerët i thanë: “O Abdullah ibn Mesud, ti e thua këtë dhe përsëri fal bashkë me Uthmanin katër rekate?! Pse?”

Ai iu përgjigj: “O vëlla! Kundërshtimi është sherr, kundërshtimi është sherr, kundërshtimi është sherr.”²¹⁰ Transmeton ebu Daudi me zinxhir të fortë.

Kjo ndodhi për arsye se ata e kishin kuptuar mirë këtë bazë të saktë, ndërsa ai që vepron në kundërshtim me të, nuk ka siguri nga rënia në sprova, as për veten e tij, dhe as për të tjerët.

Rregulli i pestë. “Flamujt” (drejtimet, rrymat) e ndryshëm që ngrihen në sprova, qofshin ato qeverisësish apo “flamuj” propaganduesish, duhet që patjetër të vlerësohen sipas kritereve dhe standardeve të sakta të Sheriatit. Kriteret e sakta janë ato të “ehli sunetit”, dhe gjykimi e vlerësimi i kujtdo që vlerëson dhe gjykon me to, do të jetë i saktë.

Allahu thotë për peshoren e Tij:

“Ne do të vëmë peshojat e drejtësisë Ditën e Llogarisë, kështu që askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi në asnjë gjë.” El Enbija: 47.

Po kështu “ehli suneti” zotëron peshoret (kriteret) e drejtësisë me anë të së cilave vlerëson dhe gjykon mbi çështjet, situatat dhe flamujt e ndryshëm në raste trazirash dhe situatash të ndryshme.

Imamët e thirrjes tonë dhe dijetarët e “ehli sunetit” kanë sqaruar se këto kritere ndahen në dy grupe.

- Në grupin e parë futen ato kritere të cilat ndajnë Islamin nga joislami. Pra peshohet (vlerësohet) saktësia e pretendimit për përkatësinë në Islam, a është i tillë apo jo.

Shumë “flamuj” që ngrihen i atribuohen Islamit. Në këtë rast duhet që patjetër këta “flamuj” të vlerësohen, për të përcaktuar me saktësi nëse i përkasin Islamit apo jo. Dhe kur “flamuri” është Islam, atëherë rradhiten (renditen) një sërë rregullash të Sheriatit, të cilat duhen pasur parasysh patjetër, për t’iu përgjigjur kështu asaj që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem).

Pra, kriteret e grupit të parë ndajnë kufrin nga besimi. Ato përcaktojnë nëse një “flamur” është i besimtarëve muslimanëve apo i përket dikujt tjetër. Ndërsa kriteret e grupit të dytë përcaktojnë nëse ky “flamur” është i përputhur me udhëzimin që e do Allahu dhe është i kënaqur me të, apo në të ka mangësi.

Pasi qartësohet kjo, këtyre kritereve u renditen rregulla Sheriati.

Kriteret e grupit të parë ndahen në tri lloje.

) Hadith i saktë. E transmeton ebu Daudi, nr. 1957 (por teksti ndryshon pak: “E qortove Uthmanin dhe pastaj fale ²¹⁰ katër?” Tha: “Kundërshtimi është sherr” (vetëm një herë). Shejh Albani e ka saktësuar.

1- Të shikohet nëse realizohet adhurimi i Allahut, i vetëm, pa i shoqëruar Atij askënd apo jo? Sepse baza (origjina) e fesë së të dërguarëve ka qenë adhurimi i Allahut të Vetëm, pa i shoqëruar askënd. Të gjithë të dërguarit u dërguan për t'u adhuruar vetëm Allahu, pa i bërë Atij shok, dhe pikërisht për këtë, Njësimi (Teuhidi) është themeli i çështjes, fillimi dhe fundi i saj.

Një peshore e tillë tregon se çdokush që ngre “flamurin” e Teuhidit, pohon adhurimin e Allahut të Vetëm, pa i shoqëruar askënd dhe që nuk miraton adhurimin e dikujt tjetër veç Tij, është musliman, dhe ky “flamur” është islam, nëse plotësohen edhe dy llojet e tjera të peshoreve që do të trajtohen në vijim.

Pra, lloji i parë i peshoreve është që të shikohet nëse e praktikojnë apo jo Teuhidin, ithtarët e këtij “flamuri” të cilin e ngre Islami. A adhurohet nën këtë flamur dikush tjetër veç Allahut, apo adhurohet vetëm Allahu, pa i shoqëruar dikë tjetër Atij. Atëherë zemrat i drejtohen vetëm Allahut të Madhëruar:

“Tashmë kemi dërguar në çdo Umet të dërguar, (duke shpallur) adhuroni vetëm Allahun dhe shmanguni tagutit.” En-Nahl: 36.

“Ata (sundues muslimanë) të cilët, nëse Ne u japim fuqi në tokë, urdhërojnë për plotësimin e faljeve të rregullta ditore (në xhami) dhe për zekatin, që urdhërojnë el maruf (besimin dhe ligjin islam) dhe ndalojnë munker (mosbesimin, politeizmin dhe gjithçka që ka ndaluar Islami, duke zbatuar në këtë mënyrë Kur’anin, ligjin e Allahut si të vetmin ligj për drejtimin e vendit të tij). Dhe tek Allahu mbështetet përfundimi i të gjitha çështjeve (të krijesave të Tij).”

Disa komentues të Kur’anit kanë thënë se fjala **“urdhërojnë maruf”** (të mirën), do të thotë urdhërojnë për Teuhidin. Dhe **“ndalojnë nga munker”** (e keqja) do të thotë ndalojnë nga shirku, pasi e mira më e madhe është Teuhidi, ndërsa e keqja më e madhe është shirku.

2- Në llojin e dytë futen ato kritere të cilat përcaktojnë nëse realizohet apo jo dëshmia se Muhamedi (salallahu alejhi ue selem) është i Dërguari i Allahut. Një nga domethëniet e kësaj dëshmie është që të gjykohet sipas Sheriatit me të cilin ka ardhur i Dërguari (salallahu alejhi ue selem):

“Por jo, për Zotin tënd! Ata nuk mund të kenë aspak besim, përderisa të të bëjnë ty (o Muhamed) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, derisa të mos mbetet në vetet e tyre asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve të tua dhe derisa t’i pranojnë ato (vendimet tua) plotësisht të nënshtruar.” Nisa: 65.

“A mos kërkoni atëherë gjykimin e kohës së injorancës (para Islamit)? E kush është më i mirë në gjykim sesa Allahu për një popull që ka një besim të fortë.” El Maide: 50.

“Kushdo që nuk gjykon me atë që ka shpallur Allahu (me ligjin e Allahut), të tillët janë kafirë.” El Maide: 44.

Nëse njerëzit që kanë ngritur “flamurin” gjykojnë me ligjet e Allahut dhe i zgjidhin mosmarrëveshjet midis njerëzve me Sheriatin islam, atëherë e mëson se “flamuri” është musliman, pasi ithtarët e tij gjykojnë me ligjin e Allahut, ngrejnë gjykatat e Sheriatit për të gjykuar me atë që e ka zbritur Ai dhe askënd nuk e detyrojnë të gjykojë me ligje të tjera, të cilat nuk i ka zbritur Allahu.

3- Të shikohet nëse e bëjnë hallall haramin, apo përkundrazi, e urrejnë veprimin e haramëve dhe e ndalojnë.

Në rastin e shfaqjes së haramëve, për ndalesën e të cilave ka konsensus, hasim dy gjendje:

Së pari, kur këto haramë bëhen të lejuara, kjo është kufër, Allahu na ruajtë!

Së dyti, kur këto haramë nuk bëhen të lejuara, por ato ekzistojnë dhe ngritësi i “flamurit” e pohon se këto janë të këqija dhe të ndaluara. Atëherë nga kjo mësohet se ky “flamur” është i ligjëruar (në Sheriat) dhe se është “flamur” islam.

Këto ishin dhe tri llojet e peshoreve të grupit të parë, të cilat i kanë sqaruar dijetarët tanë, Allahu i mëshiroftë.

- Në grupin e dytë futen kriteret të cilat bëjnë qartësisht të dallueshëm zbatimin e plotë të Islamit nga ai jo i plotë, duke nxjerrë kështu në pah se cili i përmbahet atij dhe cili jo.

Ka ardhur në një hadith që i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e përqafoi Islamin plotësisht, ashtu siç ka zbritur prej Allahut. I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) është modeli të cilin ne duhet ta marrim si shembull. Një gjë të tillë e vepruan dhe halifët e drejtë, por pas tyre çështja shkoi drejt rënies graduale, drejt mangësimit të realizimit të plotë të Islamit dhe kjo vazhdon edhe në ditët tona.

I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Nuk vjen tek njerëzit ndonjë kohë (e vështirë) vetëm se ajo pas saj do të jetë edhe më e keqe se e para, derisa të takoni Zotin tuaj.”²¹¹

) Hadith i saktë. E transmeton Buhariu, nr. 7068 dhe Tirmidhiu, nr. 2206 (me tekst të përafërt). Shejh Albani e ka ²¹¹ saktësuar. Shiko “Sahihul xhami”, nr. 5731, 7576.

Kjo peshore të mundëson të vlerësosh se sa i zbatojnë njerëzit rregullat e Sheriatit, cila është gjendja e tyre në raport me namazin dhe në raport me urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja, për sa i përket farzeve dhe haramëve.

Kur të gjitha këto janë të plota, atëherë kjo argumenton për një përfaqim të plotë të Islamit, por kur në to ka mangësi, kjo argumenton për një përfaqim të mangët, sipas masës në të cilën kriteret e përmendura më lart realizohen.

Këto peshore janë shumë të rëndësishme, prandaj duhet që patjetër t'i keni në zemrat dhe mendjet tuaja e të mos i harroni ato, me qëllim që të mos humbisni në kohë humbjesh dhe të mos ketë konfuzion në mendjet tuaja rreth këtyre çështjeve në kohë trazirash dhe fitnesh.

Nëse kjo ju bëhet e qartë dhe nëse ju arrini të dalloni “flamurin” musliman nga “flamujt” e tjerë, atëherë sipas Sheriatit, bëhet detyrë për ju miqësimi (dashuria, ndihma) në të vërtetën dhe udhëzimin, për ata të cilët kanë ngritur “flamurin” musliman, pasi Allahu na ka urdhëruar për miqësinë dhe dashurinë ndaj muslimanëve, na ka nxitur për t'u kapur pas litarit të Tij dhe që të mos përçahemi.

Miqësia. Dashuria për “flamurin” e Islamit duhet të jetë e saktë. Gjithashtu miqësia jote për të, të jetë në mënyrë të saktë dhe pa devijime, konfuzion (përzierje të çështjeve me njëra-tjetrën) e hezitim, pasi në një çështje, ose ka Islam, ose ka kufër.

Pasi vërtetohet Islami, atëherë e pasojnë atë rregullat e Sheriatit, dhe pas kësaj nuk i lejohet muslimanit që ta bëjë mëkatin të lejuar (haramin hallall), dhe nuk i lejohet atij të mos i përmbahet asaj që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem). Pra, është detyrë për muslimanin t'i përmbahet miqësisë për besimtarët dhe për ata të cilët luftojnë në rrugë të Allahut.

Këshilla e sinqertë. Këshilla ndaj këtij “flamuri”, duhet të jetë e sinqertë dhe të burojë nga zemra.

“Ehli suneti” u veçua nga grupet e bidatçinjve të cilët dëshironin grupacionet. Ai i këshillon prijësit dhe bën duà (lutje) për ta, pavarësisht nëse vëren tek ata gjëra të cilat i urren. I këshillon me një këshillë, të cilën Allahu e di që buron nga zemra. Ai e bën këtë vetëm për të fituar shpërblimin dhe falenderimin e Allahut, e jo të dikujt tjetër veç Tij. Kur kjo këshillë gjendet në zemrat tona, atëherë ne me të vërtetë jemi pjesë e “ehli sunetit”.

Nëse shfletoni librat e Akides së “ehli sunetit”, do të shihni se në to ka kapituj të veçantë që flasin për të drejtat e imamit ndaj popullit të tij dhe për të

drejtat e popullit ndaj imamit, dhe se me këto arrihet bashkimi dhe afrimi me “ehli sunetin”.

Nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka ardhur një hadith, ku ai ka nxitur për t'i këshilluar prijësit e muslimanëve dhe njerëzit e thjeshtë: “Feja është këshillë.”²¹²

Atëherë u vërtetua se këshilla është vaxhib (detyrë) dhe se muslimani duhet të këshillojë patjetër.

Po si duhet që të jetë kjo këshillë dhe si duhet të jetë ky sqarim? Ajo duhet të jetë sipas shembullit që ka ardhur në sunetin e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe jo sipas mendjes sonë.

Në një hadith të saktë ka ardhur se Ijad ibn Ganem i tha Hihash ibn Hakimit: “A nuk e ke dëgjuar fjalën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): ‘Kush dëshiron të këshillojë atë që ka sundim, të mos e bëjë në mënyrë të hapur, por ta marrë përdore dhe të veçohet me të. Nëse ai e pranon këshillën prej tij, kjo është (ajo që dëshirohej), nëse jo, atëherë ai ka kryer atë që kishte për detyrë.”

213

Dëgjojeni pra sunetin e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem) sepse ju padyshim jeni të interesuar për të, ashtu sikurse edhe “ehli suneti uel xhemaah”.

Nëse nëpërmjet këtyre kritereve që u përmendën, dallohet “flamuri” musliman nga “flamujt” e tjerë jomuslimanë, atëherë mbi të renditen të drejtat (detyrimet) e Sheriatit. Kjo është një çështje tepër e rëndësishme, e cila shfaqet në rastin e ndryshimit të gjendjeve (trazirave) dhe rënies së sprovave.

I Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kush dëshiron të këshillojë atë që ka sundim, të mos e bëjë në mënyrë të hapur, por ta marrë përdore dhe të veçohet me të. Nëse ai e pranon këshillën prej tij, kjo është (ajo që dëshirohej), nëse jo, atëherë ai ka kryer atë që kishte për detyrë.”

Kjo na bën që të jemi të qetë, po kështu na bën të jemi pasues të fjalës së tij (salallahu alejhi ue selem). Nëse ne veprojmë sipas rrugës (fjalës) së tij, do të jemi të shpëtuar me lejen e Allahut, por nëse nuk veprojmë sipas saj, atëherë kemi për të hasur në neglizhencë dhe devijim nga rruga e “ehli sunetit”, për aq sa të kemi kundërshtuar Sheriatin.

Kur këto peshore (kritere) i përzihen në mendje muslimanit apo nxënësit të dijes, si duhen të veprojnë në lidhje me to?

Sigurisht që pikë referimi për ta duhet të jenë dijetarët të cilët vlerësojnë sipas kritereve të sakta. Dijetarët e “ehli sunetit” janë ata që gjykojnë në mënyrë

) Hadith i saktë. E transmeton Muslimi, nr. 196, Tirmidhiu, nr. 1926 dhe Nesaiu, nr. 4200.²¹²

) Hadith i saktë. E transmeton ibn ebi Asim në “Kitabus-suneh”, nr. 1096. Shejh Albani e ka saktësuar.²¹³

të saktë sipas Sheriatit. Kështu ata cilësojnë se kush është musliman dhe kush nuk është i tillë, kush është besimtar dhe kush është kafir. Pikë referimi për ne duhet të jenë dijetarët e “ehli sunetit” dhe jo nxënësit e dijes, të cilët ndoshta dinë disa gjëra dhe nuk njohin disa të tjera, ose ndoshta gjërat që nuk janë të përgjithshme i bëjnë të tilla. Pra, gjykatës në këtë çështje për ata të cilët nuk dinë të peshojnë me peshoren e saktë, janë vetëm dijetarët dhe është detyrë të merret në konsideratë fjala (mendimi) e tyre dhe përfundimi në të cilin ata kanë arritur. Gjithashtu është detyrë për ne që të vlerësojmë besimin dhe kufrin me anë të kësaj peshoreje që u përmend.

Nga rregullat që rrjedhin prej këtyre kritereve është edhe ai që ka sqaruar “ehli suneti”: Xihadi bëhet (vazhdohet) nën komandën e çdo prijësi, qoftë i devotshëm ose gjynahqar. Nuk i lejohet asnjërit të mos marrë pjesë në luftë nën “flamurin” e xihadit, për shkak se sunduesi ka gjëra që kundërshtojnë Sheriatin. Dhe kjo vlen në çdo vend dhe në çdo kohë.

Patjetër që ky rregull vlen në çdo kohë, pasi në të ardhmen, dhe në vitet që do të pasojnë në jetën tënde, mund të ndodhë ajo çka ne nuk e dimë, prandaj në bazë të këtyre rregullave ti sistemon (saktëson) çështjet e tua, gjithashtu vlerëson gjendjen dhe mendimet e tua.

Po kështu pjesë e këtyre të drejtave (detyrimeve) është duaja (lutja) për ata që Allahu i ka bërë prijës të muslimanëve.

El Berbehari (Allahu e mëshiroftë), i cili ka qenë ndihmues i Sunetit dhe prijës ndër prijësit e “ehli sunetit”, ka thënë në librin e tij “Es-suneh”, i cili është botuar dhe gjendet nëpër librari: “Nëse shikon ndokënd të lutet për sunduesin, dije se ai është pasues i Sunetit, dhe nëse e shikon atë të lutet kundër tij, dije se ai është bidatçi.”

Fudejl ibn Ijad lutej shumë për sunduesin në kohën e tij, ndërkohë që ne e dimë shumë mirë se si ishin sunduesit në kohën e abasitëve dhe çka ata kishin prej çështjeve të urryera. Mirëpo pavarësisht nga kjo, ai lutej për ta aq shumë, sa i thanë: “Lutesh për ta më shumë seç lutesh për veten tënde?!”

Fudejl ibn Ijad tha: “Po, sepse nëse unë përmirësohem (rregullohem), përmirësohem (rregullohem) vetëm për veten time dhe për ata që më rrethojnë mua, ndërsa përmirësimi i sulltanit është për të gjithë muslimanët.”

Prandaj çdokush që dëshiron rregullimin e muslimanëve në përgjithësi, le të shohë Allahu në zemrën e tij lutje të sigjerta për atë që Ai e ka bërë të parë mbi muslimanët, që Allahu t’i japë prijësit sukses për të vepruar sipas librit të Tij dhe sunetit të Resulullahut (salallahu alejhi ue selem). Dhe ne nuk shpresojmë

dhe as që lakmojmë më tepër sesa të veprohet sipas Kur'anit dhe Sunetit, ndërsa zemrat janë në dorë të Allahut, Ai i rrotullon ato (si të dëshirojë).

Rregulli i gjashtë. Gjatë sprovave ekzistojnë rregulla, si për fjalët po ashtu edhe për veprat, pra jo çdo fjalë që na duket e mirë duhet thënë, dhe jo çdo vepër që na duket e mirë duhet bërë, pasi fjalët dhe veprat e tua në situata të trazuara kanë pasoja. Nuk është e çuditshme të dëgjojmë se ebu Hurejre ka thënë: “Mësova nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) dy lloje të dijes. Njërën e shpërndava, dhe nëse do ta kisha shpërndarë tjetrën, do të më pritej fyti.”²¹⁴ Transmeton Buhariu në librin e tij të saktë.

Dijetarët kanë thënë se fjala e tij “do të më pritej fyti”, do të thotë se ai fshehu hadithe të cilat bënë fjalë për çështjet e fitnes, hadithe që kishin të bënin me Beni Umeje (emevitët), e të tjera hadithe të kësaj natyre. Ai i tha këto fjalë në kohën e Muavijes, ndërsa në kohën e tij u bashkuan njerëzit pasi qenë të ndarë dhe në luftë. Ju e dini se çfarë ndodhi atëherë dhe e dini historinë e tij.

Ebu Hurejre fshehu disa prej haditheve të Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) të cilat nuk kishin të bënin me rregullat e Sheriatit, por me diçka tjetër.

Përse e veproi ai një gjë të tillë?

Ai i fshehu ato për të shmangur fitnet ndër njerëz. Ai nuk tha se fjala e hadithit është e vërtetë dhe as se nuk lejohet që ta fshehësh dijen, sepse në kohën kur ebu Hurejre i tha këto fjalë, kjo dije duhej fshehur patjetër me qëllim që njerëzit të mos përçaheshin, pasi muslimanët u bashkuan në “vitin e bashkimit” (kështu quhej viti kur ata u bashkuan) me Muavije ibn Sufjan.

Muslimi në librin e saktë të tij, na ka transmetuar se ibn Mesudi ka thënë: “Nëse ti u flet njerëzve me fjalë të cilat ata nuk i perceptojnë drejt, ato bëhen fitne për disa prej tyre.”

Jo të gjithë njerëzit arrijnë ta kuptojnë çdo fjalë të folësit dhe çdo çështje të sprovës. Kështu mund të ndodhë që ata të dëgjojnë gjëra të cilat nuk mund t'i perceptojnë drejt me logjikën e tyre, dhe në këtë mënyrë i kuptojnë ato ndryshe, duke bazuar më pas në to (sipas asaj që ata vetë kanë kuptuar) sjelljet, gjendjet, veprat dhe fjalët e tyre, përfundimi i të cilave nuk është i lavdëruar. Prandaj selefët kanë vepruar shumë sipas këtij rregulli.

Shiko rastin kur Hasan el Basri shprehu mosaprovimin e tij ndaj Enes ibn Malik, kur ky i tregoi Haxhaxh ibn Jusufit për hadithin i cili tregon se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) vrau uranijinët.

) E transmeton Buhariu në “Sahihun” e tij, nr. 120.²¹⁴

Hasan el Basri i tha atij duke e kritikuar (ndaluar): “Pse ia tregove Haxhaxhit këtë hadith?”

Ai ia tha këtë sepse Haxhaxhi sillej mizorisht në çështjen e gjakut, dhe kështu ai do ta merrte këtë hadith si argument për të justifikuar veprimet e tij. Prandaj ishte detyrë që Haxhaxhit t’i fshihej ky hadith (kjo dije), në mënyrë që të mos mendonte sipas të kuptuarit dhe logjikës së tij, e cila nuk ishte e drejtë dhe e saktë, se ky hadith e mbështeste dhe ishte argument për të. Kështu që ai mund ta perceptonte në mënyrë të gabuar për të përligjur veprimet e tij të liga.

Hasan el Basri e kritikoi Enes ibn Malikun ndërkohë që ai ishte prej sahabëve, dhe pas kësaj, Enes ibn Malik u pendua që ia kallëzoi këtë hadith Haxhaxh ibn Jusufit.

Po kështu Hudhejfe, i fshehu ebu Hurejres hadithe të cilat kishin të bënin me trazirat, fitnet, pasi ai e kuptoi që njerëzit nuk kishin nevojë për to.

Gjithashtu imam Ahmedi e urrente të folurit duke përdorur hadithe të cilat kishin të bënin me daljen kundër sunduesit dhe kështu ai urdhëroi që ato të fshihen nga “Musnedi” i tij, pasi tha: “Nuk ka mirësi në fitne dhe nuk ka mirësi në daljen (kundër sulltanit).”

Po ashtu edhe ebu Jusuf urrente të flitej rreth gjërave të panjohura. Qëllimi i gjithë sa thamë, është se jo çdo gjë që dihet mund të thuhet në sprova dhe jo çdo gjë që thuhet (mund të tregohet) mund të bëhet e ditur në çdo gjendje. Prandaj duhet që patjetër të jemi të matur në veprime, pasi nuk e dimë se ç’pasoja do të sjellin fjalët, mendimet dhe perceptimet tona.

Selefët dëshironin t’u shmangeshin fitneve, prandaj ata kanë heshtur në shumë gjëra, duke synuar që të mos cënohej feja e tyre. Ata donin të dilnin para Allahut të pastër dhe të rregullt.

Në një transmetim ka ardhur se Sad ibn ebi Uekas iu drejtua të birit të tij (kur ai bisedoi me të për të kryer disa veprime në sprova) duke i thënë: “O biri im! A dëshiron ti që unë të jem prijës në fitne?! Jo, uallahi jo.”

Kështu Sad ibn Uekas ndaloi si të birin, po ashtu edhe veten e tij nga të qenët kryesues në fitne, qoftë me fjalë apo vepra, pasi edhe pse ai e mendonte një gjë të tillë si të drejtë, nuk kishte siguri nëse përfundimi i saj do të ishte i lavdëruar apo jo.

Prandaj, që njerëzit të shpëtojnë e të mos bien në gabim, duhet patjetër t’i peshojnë të gjitha çështjet me peshoren e saktë të Sheriatit. Pra, për çdo punë, veprim apo sjellje, ka rregulla të cilat duhen parë patjetër, pasi jo çdo veprim i lavdëruar në situata të zakonshme është për t’u lavdëruar në fitne, kur ai kuptohet jo në mënyrën e duhur.

Buhariu transmeton në librin e saktë të tij se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) i tha Aishes: “Sikur populli yt të mos kishte pak kohë që e ka lënë kufrin dhe të mos ishte i ri në Islam, do ta shembja Kaben, do ta ndërtoja në themelet e Ibrahimit dhe do t’i bëja dy dyer.”²¹⁵

Por i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) nuk e ndërmori një veprim të tillë. Ai druhej se nga prishja e Kabes, rindërtimi i saj mbi themelet e Ibrahimit, dhe bërja e saj me dy dyer, ku njëra do të shërbente për të hyrë dhe tjetra për të dalë, mund të vinte keqkuptimi i banorëve të Mekës, të cilët sapo e kishin pranuar Islamin. Ata mund të mendonin se Profeti (salallahu alejhi ue selem) donte të mburrej dhe të nënçmonte fenë e Ibrahimit etj., prandaj edhe ai e shmangu këtë veprim.

Buhariu, duke u argumentuar me këtë hadith, veçoi një kapitull madhështor me titull “Ai i la disa çështje rreth së cilave ishte në dilemë, nga frika se mos njerëzit nuk do ta kuptonin dhe si pasojë do të binin në një të keqe edhe më të madhe se ajo në të cilën ndodheshin aktualisht”.

Ky kapitull flet për ato çështje për të cilat jemi në dilemë nëse duhen thënë apo duhen lënë, nga frika se mos njerëzit nuk do t’i kuptojnë dhe si pasojë do të bien në një të keqe më të madhe se ajo në të cilën janë. Pikërisht në këtë kapitull, Buhariu ka përmendur edhe hadithin e mësipërm të Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem). Nga kjo kuptojmë se, si logjika, po ashtu edhe të kuptuarit e drejtë janë të domosdoshme, ndërsa të shpejtuarit dhe nxitimi nuk janë cilësi për t’u lavdëruar.

Atëherë ç’të obligon ty të diskutosh në çdo tubim apo shoqëri, rreth asaj që ti e mendon të drejtë në lidhje me fitnet (trazirat)?!

Nëse diçka është e vërtetë apo jo, atë e sqarojnë dijetarët e “ehli sunetit”. Prandaj, nëse ke ndonjë mendim apo ke kuptuar diçka (sipas mënyrës tënde), paraqite atë te këta dijetarë. Dhe nëse ata e pranojnë, kjo është ajo çka kërkohej, e nëse jo, ti e ke ruajtur veten nga publikimi i mendimit tënd ndër muslimanët e thjeshtë.

Rregulli i shtatë. Allahu ka urdhëruar për miqësimin (dashamirësinë) e muslimanëve dhe veçanërisht të dijetarëve:

“Besimtarët dhe besimtare janë eulija (ndihmues, mbrojtës dhe miq) për njëri-tjetrin...” Teube: 71.

Pra, është detyrë për çdo besimtar që t’i dojë besimtarët e tjerë, t’i ndihmojë ata dhe t’i shmanget talljes së tyre. E ç’mund të themi për ata besimtarë të cilët

) E transmeton Buhariu me një tekst të ngjashëm, nr. 1585 dhe 1586.²¹⁵

janë ndihmues të Sheriatit të Allahut, të cilët u sqarojnë njerëzve dallimin e hallallit nga harami dhe të vërtetës nga e kota!?

Është e ndaluar që dijetarët të përmenden për diçka, vetëm se kur ajo është e mirë. Ai mexhlis në të cilin dijetarët nuk përmenden për mirë, është mexhlis i keq, pasi dijetarët janë trashëgimtarët e të dërguarve dhe trashëgimia e të dërguarve nuk ishte as dinari e as dirhemi, por vetëm dija, dhe ai që e merr atë ka marrë fat të plotë. Ai që i respekton dijetarët e “ehli sunetit”, të cilët janë ithtarë të Teuhidit, i nderon ata dhe bazohet në fjalët e tyre, ka marrë nga trashëgimia profetike dhe nuk ia ka lënë atë të tjerëve.

Dijetarët të cilët duhet t’i miqësosh, t’i duash dhe tek fjala e të cilëve duhet të bazohesh, zotërojnë disa cilësi.

Së pari, ata në kohën e tyre kanë qenë prijës të “ehli sunetit”, prijës të Teuhidit dhe tek fjalët e tyre bazoheshin njerëzit në çështjet e Akides.

Së dyti, ata njohin rregullat e Sheriatit, njohin Fikhun (jurisprudencën) me të gjitha ndarjet, temat, dhe degët e tij. Ata njohin bazat e Sheriatit, usulet (themelet) që duhen pasur parasysh dhe nuk i kanë të përziera çështjet dhe as gjykimet e tyre.

Këtu është e nevojshme të përmendet diçka tepër e rëndësishme, pre e së cilës kanë rënë shumë vetë.

Disa pretendojnë se dijetarët tanë nuk e kuptojnë realitetin e sotëm. Ata arritën deri atje, sa që dikush prej tyre, në një tubim të vogël me disa vëllezër të tij të thotë: “Vërtet që si pasojë e këtyre situatave dhe ndodhive kemi kuptuar dallimin që ekziston ndërmjet dijetarëve”, duke i ndarë ato në dy grupe; në dijetarë që e kuptojnë realitetin dhe i sqarojnë rregullat e Sheriatit në lidhje me të, dhe në ata që nuk e kuptojnë realitetin.

Uallahi, vërtet kjo është një fjalë e keqe që dëshmon për moskuptimin e gjërave në të cilat bazohen (mbështeten) rregullat e Sheriatit dhe mbi të cilat bazohen dijetarët. Kjo dëshmon gjithashtu për moskuptimin e asaj që e marrin apo jo parasysh dijetarët kur perceptojnë një çështje.

Të kuptuarit e realitetit tek dijetarët ndahet në dy pjesë:

E para, e cila duhet të plotësohet patjetër, është të kuptuarit e së vërtetës (në një ngjarje) mbi të cilën bazohet gjykimi i Sheriatit. Kuptimi i këtij realiteti është detyrë e domosdoshme, pasi nëse gjykuesi i një çështjeje nuk e ka kuptuar realitetin e saj (pra se si ka ndodhur ngjarja në të vërtetë), atëherë ka për të gabuar në gjykim. Pra, meqenëse realiteti ndikon në gjykim, atëherë patjetër duhet të kuptohet.

E dyta, është aktualiteti që nuk ka ndikim në (dhënien) gjykimin e Sheriatit.

Këtu futen detajet e panevojshme për t'u ditur, të treguara në mënyrë të stërholluar dhe të cilat edhe pse janë të vërteta, nuk merren fare parasysh në gjykim. Histori apo situata të tilla nuk kanë absolutisht ndikim në gjykimin e Sheriatit. Në këtë rast dijetarët nuk e marrin parasysh këtë aktualitet në dhënien e gjykimit, megjithëse e kuptojnë fare mirë domethënien e saj. Jo çdo aktualitet ka të bëjë me gjykimin e Sheriatit.

Për të sqaruar dhe për të bërë më të kuptueshme sa thamë, le të përmendim disa shembuj për secilin rast.

Shembuj mbi realitetin, njohja e të cilit ndikon në gjykimin e Sheriatit

1) Kur gjykohet nëse dikush ka vdekur apo jo.

Kur ai vdes si pasojë e ndalimit të rrahjes së zemrës së tij apo kur “vdes” si pasojë e mosfunksionimit të trurit (vdekje klinike).

Kjo është diçka që ka ndodhur. Nëse në këtë rast dikush do të flasë mbi këtë çështje pa e njohur mirë realitetin e saj, apo pa i njohur gjendje të këtilla të mundshme, ai patjetër që do të japë një gjykim të gabuar. Pasi në një çështje të tillë, njohja e realitetit të saj ndikon në dhënien e gjykimit të Sheriatit.

2) Gjykimi nëse një qeveri është qeveri islame apo jo.

E si mund të gjykojmë për një qeveri nëse është islame apo jo, pa e njohur gjendjen dhe realitetin e saj?!

Për të gjykuar saktë në një çështje të tillë, dijetari duhet të njohë realitetin e saj në mënyrë që të japë gjykimin e Sheriatit, dhe, pasi ai e njeh këtë realitet, jep gjykimin duke u bazuar në këtë njohje. Këtu futet edhe gjykimi mbi xhematet e shumta islame të cilat janë formuar në kohën tonë. Nuk është aspak e lehtë, madje është e pamundur për dijetarët e Sheriatit, që të gjykojnë apo vlerësojnë këto xhemate, pa e njohur realitetin e tyre, pa njohur besimin (Akiden), bazat (themelet, parimet), “menhexhin” (metodën), mendimet dhe së fundmi rrugën e daves (thirrjes) së tyre.

Në këtë rast, dijetari duhet ta njohë aktualitetin, pasi njohja e tij ndikon në dhënien e gjykimit të Sheriatit, dhe kushdo që gjykon pa e njohur këtë aktualitet, nuk do të jetë i drejtë dhe as në pajtim me Sheriatin në gjykimin e tij.

Shembuj mbi realitetin, njohja e të cilit nuk ndikon në gjykimin e Sheriatit

1) Këtu futen fjalët e shumta që thonë përpara gjykatësit, dy kundërshtarët kundrejt njëri-tjetrit në rast grindjesh. Ata tregojnë në mënyrë të detajuar se ç'ndodhi ndërmjet tyre, duke thënë fjalë të shumta e të panevojshme, të cilat janë mjaft të njohura prej gjykatësve. Mirëpo edhe pse të gjitha këto janë reale (të vërteta), gjykatësi nuk i merr ato për bazë kur jep gjykimin mbi çështjen. Realiteti i tillë nuk ka ndikim në verdiktin e gjykatësit dhe nuk bazohet gjykimi mbi të.

Prandaj në të tilla raste myftiu apo kadiu thotë se “edhe sikur të ketë qenë ashtu (d.m.th. ashtu si thua), nuk ka të bëjë me vendimin që do të merret”.

2) Le të përmendim këtu diçka, e cila është përhapur shumë kohët e fundit, si shembull më i kapshëm për temën në fjalë.

Shumë prej thirrësve (disi të moshuar) përzihen me të vegjlit në salla të mëdha publike, zyra apo diku tjetër, i ftojnë ata dhe i këshillojnë, duke dëshiruar kështu udhëzimin dhe përmirësimin e tyre.

Ne e dimë që si pasojë e kësaj përzierjeje, pra e “të moshuarve” me të vegjlit, mund të ndodhin të këqija, madje dhe harame. E themi këtë, duke u bazuar në disa raste konkrete të njohura në mënyrë të hollësishme.

Njohja e këtij realiteti nuk na lejon të arrijmë në përfundimin se nuk lejohet për të moshuarit t'u bëjnë dave të vegjëlve. Pra, njohja e një realiteti të tillë negative, nuk na lejon të arrijmë në gjykimin se është e paligjëruar për të moshuarit thirrja në Islam e të vegjëlve, por kjo njohje vë në dukje një çështje tjetër tepër të rëndësishme, këshillimin për teube (pendim) të atij që ka rënë në këtë gabim ose haram, dhe i ka mveshur Sheriatit (fesë) diçka të paligjëruar, apo diçka me të cilën Allahu nuk është i kënaqur.

Njohja e një realiteti të tillë nuk ndikon në gjykimin e Sheriatit për lejim apo ndalim të daves nga të moshuarit, por ndikon në këshillën që u duhet dhënë atyre që kanë rënë në këtë gjendje, në mënyrë që të veprojnë të mirën pa sjellë dëm, apo diçka që nuk e do Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem).

3) Për të mos u zgjatur më tepër le të përmendim edhe një shembull të fundit për të cilin duhet tërhequr vëmendja.

Ka disa rregulla të Sheriatit, të cilat njerëzit e thjeshtë i besojnë në mënyrë të gabuar. Shembull për këtë është se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka urinuar në këmbë.

Atëherë themi se kur je i siguruar nga rënia e pikave të urinës në rrobën tënde, urinimi në këmbë është i lejuar, pasi kështu ka vepruar i Dërguari

(salallahu alejhi ue selem). Por njerëzit e thjeshtë dhe të paditur mendojnë se ai që e vepron këtë ka gabuar, dhe se ka vepruar diçka që ia ul autoritetin, etj.

Një besim i tillë nga ana e tyre është besim i injorantëve, dhe kjo për arsye se gjykimi i tyre nuk është i saktë, ndërsa, për sa i përket kësaj çështjeje (lejimit të urinimit në këmbë) nuk ka dyshim se është e saktë dhe e vërtetë.

Ky është gabimi i të paditurve në besimin (mendimin) dhe përfytyrimin e tyre në lidhje me këtë gjykim të Sheriatit, apo në lidhje me çfarëdo gjykimi tjerër, pas të cilit injorantët lidhen me besimin e tyre të gabuar.

Shërimi i gjithë kësaj arrihet duke mësuar të paditurit dhe jo duke ndryshuar atë që dijetarët e vlerësojnë si gjykim Sheriati të saktë.

Rregulli i tetë. Ky është një rregull tepër i rëndësishëm, të cilin çdokush duhet ta ketë parasysh. Ai ka të bëjë me miqësinë (et-teuelin) dhe dashurinë (mualat) e shprehur ndaj kufarëve (mohuesve). Si nga Sheriati, po ashtu dhe nga imamët e Teuhidit, në këtë rregull hasim dy shprehje që kanë kuptime të cilat shumë vetë i ngatërrojnë ndërmjet tyre dhe që për shumë të tjerë ato janë të ndryshme. Dhe pikërisht këto shprehje janë “et-teuelin” dhe “mualat”. Sipas tyre “et-teuelin” është kufër dhe “mualat” është haram, ndërsa për sa i përket të kërkuarit ndihmë dhe strehim prej kufarëve, kjo gjë është e lejuar me kushtet e saj.

Et-teuelin. Për këtë ka zbritur fjala e Allahut:

“O ju që keni besuar! Mos i zini çifutët dhe kristianët për eulija (shokë, miq e mbrojtës). Ata janë shokë, miq e mbrojtës për njëri-tjetrin dhe nëse ndonjëri prej jush i ze ata eulija, atëherë nuk ka dyshim se ai është një prej tyre. Sigurisht Allahu nuk e udhëzon atë popull që është dhalimun (keqbërës, mosbesimtar e i padrejtë).” El Maide: 51.

“Et-teuelin” ka të bëjë me ndihmën e dhënë kafirit kundër muslimanit në gjendje lufte mes tyre, duke pasur si qëllim triumfin e kafirëve mbi muslimanët.

Origjina e “et-teuelin” është dashuria e plotë ose ndihma e dhënë kafirit kundër muslimanit. Kushdo që e do kafirin për shkak të fesë së tij, ai e ka miqësuar atë, i ka bërë “et-teuelin” (miqësi, dashuri të plotë), dhe kjo është kufër.

El mualat. Kjo është dashuria e shprehur ndaj kafirëve. Do të thotë t’i duash ata për shkak të dynjasë, t’i vlerësosh apo t’i lavdërosh ata. Një gjë e tillë është mëkat, por jo kufër:

“O ju që keni besuar! Mos i zini armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj (mosbesimtarët, politeistët) miq e shokë duke treguar dashuri ndaj tyre...”,

deri tek fjala e Tij: “...Dhe kushdo prej jush (besimtarëve muslimanë) që e bën këtë, atëherë ai është larguar (tepër) nga udha e drejtë.” Mumtehine: 1.

Dijetarët kanë thënë se Allahu i ka thirrur ata me emrin e imanit, pra i ka përfshirë në këtë thirrje ata që treguan dashuri ndaj kafirëve dhe një gjë e tillë argumenton se veprimi i tij (hatibit) nuk është kufër, por humbje (largim) nga rruga e drejtë. Kjo për arsye se ai tregoi dashuri ndaj tyre për shkak të dynjasë dhe jo duke pasur dyshime në fe.

Prandaj dhe i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) e pyeti atë: “Ç’ të shtyu ta veprosht këtë?”

Ai tha: “Uallahi, s’ka tjetër në zemrën time, vetëm se besim tek Allahu dhe i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selem), por unë desha ndër ta një mbrojtës që Allahu të më mbrojë familjen dhe pasurinë time...” Hadithi është transmetuar në dy librat e saktë të hadithit (Buhariu dhe Muslimi).

Nga kjo sqarohet se dashuria ndaj kafirit dhe animi nga ai për shkat të dynjasë nuk është kufër për atë që tregon ndaj tij një farë dashurie, ndërkohë që në zemër ka besim dhe prehje në të (mbështetje).

Kërkimi i ndihmës prej kafirit. për sa i përket kësaj, dijetarët kanë thënë se lejohet kur plotësohen disa kushte, për të cilat ata (dijetarët) japin fetva në rastet kur e shohin të arsyeshme. Ndërsa për sa i përket dhënies së pasurisë kafirëve si sadaka për t’i afruar ata në Islam, apo për të larguar dëmin e tyre, një gjë e tillë nuk ka vend të diskutohet këtu, pasi ajo ndryshon nga llojet e sipërpërmendura.

Rregulli i fundit. Mos praktikoj o musliman hadithet e fitneve në aktualitetin në të cilin jeton!

Shumë njerëz pëlqejnë që në rast fitneshe të përsërisin hadithet e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), të cilat flasin për fitnet, duke i përmendur ato në tubimet e tyre dhe duke thënë se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë kështu e kështu, kjo është koha e kësaj sprove, kjo është koha e kësaj tjetres, e të tjera si këto.

Selefët na kanë mësuar se hadithet që flasin për fitnet, nuk kanë ardhur për t’u përmendur në ndodhitë aktuale, por për të vërtetuar besnikërinë e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), në atë që ai na ka lajmëruar për fitnet, pas ndodhjes dhe përfundimit të tyre, dhe gjithashtu për të pasur kujdes dhe për t’u ruajtur nga ato në përgjithësi.

Për shembull fjalën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): “Vërtet fitneja në kohën e fundit do të jetë nga një burrë prej ‘ehli bejtit’. Ai pretendon se është prej meje (në veprim, edhe pse është prej meje në prejardhje) por ai nuk

është prej meje (pra, nuk është prej meje në veprim, pasi nëse ai do të ishte prej meje, nuk do të kishte bërë fitne)”, disa e kanë komentuar se ai është filani i biri i filanit (një person i caktuar); fjalën e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem): “... derisa njerëzit të pajtohen për vendosjen e një burri si ai (që nuk shkon) mbi brinjën (d.m.th. të pajtohen për vendosjen e një prijësi të padenjë dhe të paaftë për të sunduar)”, se ai është filani i biri i filanit; ose fjala e të Dërguarit: “Do të jetë ndërmjet jush dhe romakëve një pajtim i sigurtë...” deri në fund të hadithit, dhe çka do të ndodhë pas kësaj, se kjo gjendje është në këtë kohë, etj.

Praktikimi i haditheve të fitneve në realitetin e sotëm dhe përhapja e kësaj ndër muslimanët, nuk është prej “menhexhit” të “ehli sunetit”. “Ehli suneti” përmend fitnet dhe hadithet që flasin për to, për t’u tërhequr vëmendjen muslimanëve dhe për t’i larguar nga afrimi dhe përfshirja në to, në mënyrë që të mos u ndodhin fitne, dhe gjithashtu për të vërtetuar saktësinë e asaj për të cilën na ka lajmëruar i Dërguari (salallahu alejhi ue selem).

Dhe së fundi e lus Allahun që të na e tregojë të vërtetën, të na bëjë rrizk ndjekjen e saj dhe të bëjë mirësi mbi ne me bashkim e fuqi në të vërtetën, të na forcojë në të, të na bëjë prej të kapurve në “menhexhin” e “ehli sunetit” dhe të na bëjë prej të kapurve në besimin e tyre, që nga e para çështje deri tek e fundit. E lus Allahun të na bëjë prej atyre që nuk ndryshojnë fjalët dhe rregullat që ata (dijetarët e “ehli sunetit”) kanë vendosur duke u argumentuar me argumente të Sheriatit.

O Zot, ne të lutemi Ty të na largosh prej fitneve të dukshme apo të padukshme!

Të lutemi Ty t’i furnizosh besimtarët muslimanë me rregull dhe qëndrueshmëri në vetet e tyre dhe në të parët e tyre, t’i drejtosh në të drejtën dhe t’i largosh prej të devijuarve!

Gjithashtu e lusim Allahun të na bëjë prej të mëshiruarve. Të na e mbyllë jetën tonë në të mirë, të bëjë të mirë përfundimin e këtyre fitneve që janë shfaqur, ta largojë prej nesh të keqen e tyre (fitneve) dhe ta drejtojë këtë të keqe mbi armiqtë e muslimanëve!

Ue salallahu ala nebijina Muhammed ue ala alihi ue sabihi ue men ihteda bi hadahi ila jeumid-din.

